VENDIM
Nr. 624, datë 8.11.2023

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR ISHËM 2024–2029

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "d", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 23, të kreut 3, të shtojcës II, të vendimit nr. 1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm 2024–2029, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm 2024–2029 fillon në vitin 2024.
3. Ngarkohen organet përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore dhe të gjitha institucionet e përmendura në tekstin e këtij plani për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Plani i Menaxhimi të Basenit Ujor

për

Basenin e Lumit Ishëm 2024-2029



Raporti Kryesor



LISTA E SHKURTESAVE

ADA/ADC	AGJENCIA AUSTRIAKE PËR ZHVILLIM/BASHKËPUNIMI AUSTRIAK PËR ZHVILLIM
AK	AUTORITETI KOMPETENT
AKM	AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
AKP	AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE
AKUM	AGJENCIA KOMBËTARE E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS SË MBETJEVE
AMBU	AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE
BE	BASHKIMI EVROPIAN
BU	BASEN UJOR
DIE	DIREKTIVA E EMETIMEVE INDUSTRIALE
DKU	DIREKTIVA KUADËR E UJIT E BE-SË
DN	DIREKTIVA E BE-SË PËR NITRATET
DSCM	DIREKTIVA E BE-SË PËR STANDARDET E CILËSISË SË MJEDISIT
DTUNU	DIREKTIVA E BE-SË PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA URBANE
DUN	DIREKTIVA E BE-SË PËR UJËRAT NËNTOKËSORE
DUP	DIREKTIVA E BE-SË PËR UJIN E PIJSHËM
ECB	ELEMENTET E CILËSISË BIOLOGJIKE
ERRU	ENTI RREGULLATOR I UJIT
ETVUN	EKOSISTEM TOKËSOR I VARUR NGA UJËRAT NËNTOKËSORE
EUSIWM	MBËSHTETJA E BE-SË PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE
I-E-M	ISHËM-ERZEN-MAT
IGJEO	INSTITUTI I GJEOSHKENCAVE
ISHP	INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
ITU	IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJIT (UJËSJELLËSI PUBLIK)
ITUN	IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KBU	KËSHILLI I BASENIT UJOR
KE	KOMISIONI EVROPIAN
KKBU	KADASTRA KOMBËTARE E BURIMEVE UJORE
KKU	KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KM	KRYEMINISTRIA
KMPK	KOMITETI I MENAXHIMIT TË PARQEVE KOMBËTARE
KQP	KURBA E QËNDRUESHMËRISË SË PRURJES
KR	KUSHTET E REFERENCËS
LMIBU	LIGJI PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE - LIGJI NR.111/2012
MBU	MENAXHIMI I BASENIT UJOR

MBZHR	MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MFE	MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MIBU	MENAXHIMI I INTEGRUAR I BURIMEVE UJORE
MIE	MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
MIZB	MENAXHIMI I INTEGRUAR I ZONËS BREGDETARE
MP	DIREKTIVA E BE-SË PËR PËRMBYTJET
MTM	MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
NCE	NIVELI I CILËSISË EKOLOGJIKE
NCM	NORMA E CILËSISË SË MJEDISIT
NPGJNR	MODELI NXITËS-PRESION-GJENDJE-NDIKIM-REAGIM
NSBU	NDOTËS SPECIFIK TË BASENEVE UJORE
OM	OBJEKTIV MJEDISOR
OPU	ORGANIZATA E PËRDORUESVE TË UJIT
PCRMU	PËRMBLEDHJA E ÇËSHTJEVE ME RËNDËSI NË MENAXHIMIN E UJIT
PE	PËRCJELLSHMËRIA ELEKTRIKE
PiM	PROGRAMI I MASAVE (terminologji e DKU-së)
PINB	PLANI I INTEGRUAR NDËRSEKTORIAL PËR BREGDETIN
PM	PRURJE MJEDISORE
PMBU	PLANI I MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR
PME	POTENCIALI I MIRË EKOLOGJIK
PMRP	PLANI I MENAXHIMIT TË RREZIKUT NGA PËRMBYTJET
PTS	PROCEDURAT TEKNIKE STANDARDE (të AMBU-t)
RBU (A)	RAJONI I BASENIT UJOR (AUTORITETI)
SCM	STANDARDET E CILËSISË MJEDISORE
SHA	SHTETET ANËTARE
SHGjSH	SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR
SKQU	SISTEMI I KULLIMIT TË QËNDRUESHËM URBAN
SME	STATUSI I MIRË EKOLOGJIK
TUA	TRUP UJOR ARTIFICIAL
TUB	TRUP UJOR BREGDETAR
TUN	TRUP UJOR NËNTOKËSOR
TUL	TRUP UJOR LUMOR
TULQ	TRUP UJOR LIQENOR
TUS	TRUP UJOR SIPËRFAQËSOR

KONTRIBUESIT

Projekti EUSIWM zbatuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA)

Ekspertiza teknike u ofrua nga Ekspertë Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë, të kontraktuar nga ADA.

Menaxhimi, Koordinimi dhe Mbikëqyrja e Projektit u mundësuan nga Ekipi i Projektit EUSIWM/ADA dhe nga përfaqësues të AMBU

Grupi Ekspert i Menaxhimit të Basenit ujor (GE-ja e MBL-së)

Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 24, datë 09.02.2021 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore lidhur me harmonizimin e të gjitha direktivave të BE-së në fushën e menaxhimit të burimeve ujore”, AMBU ka ngritur dhe po drejton dy grupe ndërinstitucionale pune për burimet ujore (çështjet ligjore, çështjet e menaxhimit të basenit ujor), përbërë nga katër palë kryesore interesi në fushën e burimeve ujore: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZhR), Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MFE), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministria e Mbrojtjes (MM), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS) së bashku me Institutin e Shëndetit Publik (IShP) dhe Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NjVKSh) që monitorojnë cilësinë e ujërave të larjes, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (ShGjSh), dhe Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile (AKMC). Puna tejet e koordinuar dhe efikase e këtyre grupeve nën kujdesin e AMBU-s është thelbësore për trajtimin e sfidave kryesore të sektorit, përfshi zhvillimin e monitorimit të burimeve ujore sipas standardeve të kërkuara. AMBU po udhëheq MIBU-në dhe zbatimin e menaxhimit të basenit ujor , po kryeson grupin e punës për çështjet ligjore dhe atë për çështjet eksperte të MBU-së, si dhe po drejton procesin e vendimmarrjes.

PËRMBAJTJA

1 OBJEKTIVAT, ADMINISTRIMI DHE KOORDINIMI 1-1

1.1 Objektivat 1-1

1.2 Statusi Ligjor i Autoritetit Kompetent 1-2

1.3 Marrëveshjet administrative 1-2

1.4 Koordinimi i Autoritetit Kompetent dhe Marrëdhëniet Institucionale 1-3

1.5 Struktura e Përgjithshme e Kuadrit të PMBU-së dhe Dokumentacionit 1-8

1.5.1 Komponentët Parësorë 1-8

1.5.2 Komponentët Dytësorë 1-8

1.5.3 Elementet Mbështetëse 1-9

1.5.4 Ilustrimi i Kuadrit të Raportimit të PMBU-së 1-9

2 MASAT E KONSULTIMIT ME EKSPERTËT DHE PUBLIKUN 2-1

2.1 Konteksti Ligjor 2-1

2.1.1 Shqipëri 2-1

2.1.2 Bashkimi Evropian 2-1

2.2 Masat Kryesore të Konsultimit për Basenin ujor të Ishmit 2-2

2.2.1 Deklarata e Konsultimit 2-2

2.2.2 Përmbledhja e Çështjeve të Rëndësishme të Menaxhimit të Ujërave (PCRMU) 2-2

2.2.3 Draft Plani i Menaxhimit të Basenit ujor 2-2

2.2.4 Takime me publikun, Fushata Prezantimi dhe Trajnime 2-2

2.2.5 Plani Përfundimtar i Menaxhimit të Baseneve Ujore 2-4

3 OBJEKTIVAT MJEDISORE PËR BASENIN UJOR 3-1

3.1 Vështrim i përgjithshëm 3-1

3.1.1 Shqipëri 3-1

3.1.2 Bashkimi Evropian 3-1

3.2 Koncepti i Statusit të Trupit Ujor 3-1

3.2.1 Statusi Ekologjik 3-1

3.2.2 Statusi Kimik 3-2

3.2.3 Statusi Sasior 3-2

3.2.4 Nivelet e Statusit 3-2

3.3 Objektivat Mjedisore për Trupat Ujorë Sipërfaqësorë 3-3

3.3.1 Kushtet Referencë për Elementet e Cilësisë Biologjike 3-4

3.3.2 Kushtet Referencë për Elementet e Cilësisë së Përgjithshme Fiziko-kimike 3-4

3.3.3 Kushtet referencë për substancat prioritare dhe disa ndotës të tjerë 3-5

3.3.4 Kushtet Referencë për “Ndotësit e Tjerë Specifikë për Basenin Ujor” 3-5

3.3.5 Kushtet Referencë për Prurjen Mjedisore 3-6
3.3.6 Kushtet Referencë për Ndikimin Hidromorfologjik 3-7
3.3.7 Kushtet Referencë për TUTM-të dhe TUA-të 3-7
3.3.8 Ndikimet Hidromorfologjike të Hidrocentraleve dhe Shpallja e TUTM-së 3-8
3.3.9 Format e Tjera të TUTM-ve dhe TUA-ve 3-10
3.3.10 Përcaktimi i Statusit Përfundimtar të Trupave Ujorë Sipërfaqësorë 3-10
3.4 Objektivat Mjedisore për Trupat Ujorë Nëntokësorë 3-11
3.4.1 Kushtet e Referencës për Sasinë e Ujërave Nëntokësore 3-11
3.4.2 Kushtet e Referencës për Cilësinë e Ujërave Nëntokësore 3-12
3.4.3 Kushtet e Referencës për Ujërat Nëntokësore të Varura nga Ekosistemet Tokësore 3-13
3.4.4 Testet e Ndara në Hapa për Statusin e Cilësisë dhe Sasisë së Ujërave Nëntokësore 3-14
3.5 Objektivat Mjedisore për Zonat e Mbrojtura 3-15
3.5.1 Zonat e Përvijuara për Nxjerrjen e Ujit të Pijshëm 3-16
3.5.2 Zonat e përvijuara për mbrojtjen e llojeve ujore me rëndësi ekonomike 3-16
3.5.3 Trupat ujorë të përvijuar si ujëra Rekreative 3-17
3.5.4 Zonat e Ndjeshme ndaj Lëndëve Ushqyese 3-18
3.5.5 Zonat e Shpallura për Mbrojtjen e Habitateve ose Specieve 3-19

4 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM RRETH BASENIT UJOR 4-1

4.1 Ndarja në Nënbasene 4-1
4.2 Klima dhe hidrometeorologjia 4-1
4.2.1 Klima dhe Meteorologjia - Baseni i Lumit Ishëm 4-2
4.2.2 Hidrologjia - Baseni i Lumit Ishëm 4-3
4.2.3 Përmbledhja e Bilancit Ujor të Basenit Ujor të Lumit Ishëm 4-4
4.2.4 Vlerësimi dhe Ndikimet e Ndryshimeve Klimatike Globale 4-5
4.2.5 Skenari Ndryshimeve Klimatike në nivel vendor - Basenet Ishëm dhe Erzen 4-7
4.3 Hidrologjia dhe Ujërat Nëntokësore 4-10
4.3.1 Vështrim i përgjithshëm 4-10
4.3.2 Formacionet dhe Veçoritë Gjeologjike - Baseni i Ishmit 4-10
4.4 Topografia dhe Përdorimi i Tokës 4-13
4.4.1 Basenin e Lumit Ishëm 4-13
4.5 Rajonet Bashkiake dhe Shpërndarja e Popullsisë 4-13
4.5.1 Njësitë Administrative Bashkiake dhe Popullsia 4-13
4.6 Përdorimet Kryesore të Ujit dhe Infrastruktura 4-14
4.6.1 Vështrim i përgjithshëm 4-14
4.6.2 Përmbledhja e Shërbimeve të Ujit 4-14
4.6.3 Infrastruktura Lidhur me Nxjerrjen e Ujit të Pijshëm 4-16
4.6.4 Infrastruktura Lidhur me Trajtimin e Ujërave të Ndotura 4-18

4.6.5 Infrastruktura Lidhur me Ujitjen 4-21
4.6.6 Infrastruktura lidhur me Hidroenergjetikën 4-23
4.6.7 Infrastruktura lidhur me Instalimet sipas Direktivës DEI (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes) 4-24
4.7 Sistemi i Kodimit të Unifikuar për Basenet, Trupat Ujorë dhe Bazën e të Dhënave, propozuar për Shqipërinë 4-25

5 KARAKTERIZIMI DHE PËRVIJIMI I TRUPAVE UJORË SIPËRFAQËSORË 5-1
5.1 Vështrim i përgjithshëm 5-1
5.1.1 Bashkimi Evropian 5-1
5.2 Kategorizimi dhe Tipologjia e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë 5-1
5.2.1 Kategoritë e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë 5-1
5.2.2 Tipologjia e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë 5-2
5.2.3 Tipologjia e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë që Ndikon Përvijimin 5-2
5.2.4 Presionet dhe Ndikimet e Trupit Ujor Sipërfaqësor që Ndikojnë Përvijimin 5-3
5.3 Koherenca dhe Metodologjia e Përvijimit të Trupave Ujorë 5-3
5.4 Trupat Ujorë Sipërfaqësorë në Basenin e Ishmit 5-4
5.4.1 Trupat Ujorë Lumorë 5-4
5.4.2 Trupat Ujorë Liqenorë 5-5
5.4.3 Ujërat e Përkohshme 5-5
5.4.4 Trupat Ujorë Bregdetarë 5-6
5.4.5 Trupat Ujorë Tepër të Modifikuar dhe Trupat Ujorë Artificialë 5-6

6 KARAKTERIZIMI DHE PËRVIJIMI I TRUPAVE UJORË NËNTOKËSORË 6-1
6.1 Vështrim i përgjithshëm 6-1
6.1.1 Shqipëri 6-1
6.1.2 Bashkimi Evropian 6-1
6.2 Kategorizimi dhe Tipologjia e Trupave Ujorë Nëntokësorë 6-1
6.2.1 Kategoritë e Trupave Ujorë Nëntokësorë 6-1
6.2.2 Llojet e Trupit Ujor Nëntokësor dhe Përvijimi Bazë 6-2
6.2.3 Përvijimi i Ndikuar nga Horizontet e Trupit Ujor Nëntokësor 6-2
6.2.4 Përvijimi i Ndikuar nga Presionet dhe Ndikimet e Trupit Ujor Nëntokësor 6-3
6.3 Vlerësimet e Mëparshme të Trupave Ujorë Nëntokësorë 6-4
6.3.1 Formacionet Kryesore Hidrogjeologjike 6-4
6.3.2 Identifikimi Paraprak i Trupave Ujorë Nëntokësorë në Shqipëri 6-4
6.4 Trupat Ujorë Nëntokësorë në Basenin e Ishmit 6-5
6.4.1 Sistemi i Rishikuar i Caktimit të Numrave për Trupat Ujorë Nëntokësorë 6-5
6.4.2 Trupat Ujorë Nëntokësorë të Përvijuar në Basenin e Ishmit 6-6

7 KARAKTERIZIMI DHE PËRVIJIMI I ZONAVE TË MBROJTURA 7-1

7.1 Vështrim i përgjithshëm 7-1
7.1.1 Shqipëri 7-1
7.1.2 Bashkimi Evropian 7-1
7.2 Zonat e Përcaktuara të Ujit të Pijshëm për Konsum nga Njeriu 7-1
7.2.1 Vështrim i përgjithshëm 7-1
7.2.2 Zona të Mbrojtjes së Ujit të Pijshëm në Ishëm 7-2
7.3 Zonat e Shpallura për Speciet Ujore me Rëndësi Ekonomike 7-2
7.3.1 Vështrim i përgjithshëm 7-2
7.3.2 Zonat e Mbrojtura me Rëndësi Ekonomike në Ishëm 7-2
7.4 Zonat e Përvijuara për Ujërat Rekreative dhe të Larjes 7-3
7.4.1 Vështrim i përgjithshëm 7-3
7.4.2 Zonat e Mbrojtjes së Ujërave Rekreative dhe të Larjes në Ishëm 7-4
7.5 Zonat e Përvijuara si Zona të Ndjeshme ndaj Lëndëve Ushqyese 7-5
7.5.1 Vështrim i përgjithshëm 7-5
7.5.2 Zonat e Ndjeshme ndaj Lëndëve Ushqyese në Ishëm 7-5
7.6 Zonat e Shpallura për Mbrojtjen e Habitateve dhe Specieve 7-6
7.6.1 Vështrim i përgjithshëm 7-6
7.6.2 Zonat e Mbrojtjes së Habitatit në Ishëm 7-6

8 RRJETET E MONITORIMIT DHE TË DHËNAT E MBIKËQYRJES 8-1

8.1 Konteksti Ligjor 8-1
8.1.1 Shqipëri 8-1
8.1.2 Bashkimi Evropian 8-1
8.2 Programi i Monitorimit të Sasisë së Ujërave Sipërfaqësore 8-1
8.2.1 Autoriteti Kompetent 8-1
8.2.2 Rëndësia e Rrjetit të Monitorimit të Sasisë së Ujërave Sipërfaqësore 8-2
8.2.3 Statusi i Rrjetit të Monitorimit të Sasisë së Ujërave Sipërfaqësore 8-2
8.3 Programi i Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore 8-2
8.3.1 Autoriteti Kompetent 8-2
8.3.2 Rëndësia e Rrjetit të Monitorimit Mbikëqyrës të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore 8-2
8.3.3 Statusi i Rrjetit të Monitorimit Mbikëqyrës të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore dhe të Dhënat 8-3
8.3.4 Fushata e Monitorimit gjatë 2019-s 8-4
8.3.5 Fushatat biologjike në terren gjatë 2021-shit 8-4
8.3.6 Vlerësimet hidromorfologjike 8-5
8.4 Programi i Monitorimit të Ujërave Nëntokësore 8-5
8.4.1 Autoriteti Kompetent 8-5
8.4.2 Rëndësia e Rrjetit të Monitorimit të Sasisë së Ujërave Nëntokësore 8-5
8.4.3 Statusi i Rrjetit të Monitorimit të Sasisë së Ujërave Nëntokësore dhe të Dhënat 8-5

8.4.4 Statusi i Rrjetit të Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Nëntokësore dhe të Dhënat 8-5
8.4.5 Fushata e Monitorimit gjatë 2019-s..... 8-6
8.5 Programet e Monitorimit të Zonave të Mbrojtura.....8-7
8.5.1 Autoritetet Kompetente 8-7
8.5.2 Monitorimi Kombëtar dhe Raportimi pranë Komisionit Evropian..... 8-7
8.5.3 Statusi Operacional i Rrjeteve të Monitorimit të Zonave të Mbrojtura në Ishëm 8-8

9 PËRMBLEDHJA E STRATEGJIVE DHE PLANEVE PLOTËSUESE 9-1

9.1 Vështrim i përgjithshëm 9-1
9.1.1 Shqipëri 9-1
9.1.2 Bashkimi Evropian..... 9-2
9.1.3 Plani i Menaxhimit të Burimeve Ujore..... 9-3
9.1.4 Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet 9-3
9.1.5 Plani i Menaxhimit të Risqeve nga Thatësirat..... 9-4
9.1.6 Plani i Menaxhimit të Zonave Bregdetare 9-4
9.2 Menaxhimi i Burimeve Ujore në Basenin ujor të Ishmit. 9-5
9.2.1 Autoriteti Kompetent dhe Masat e Koordinimit..... 9-5
9.2.2 Strategjia e Burimeve Ujore..... 9-5
9.2.3 Aktivitetet ose Skemat e Reja të Burimeve Ujore që Ndikojnë te Statusi i Trupit Ujor..... 9-6
9.3 Menaxhimi i Rrezikut nga Përmbytjet në Basenet e Ishmit. 9-6
9.3.1 Autoriteti Kompetent dhe Masat e Koordinimit..... 9-6
9.3.2 Përmbledhja e historikut të përmbytjeve..... 9-7
9.3.3 Strategjia e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet 9-9
9.3.4 Aktivitetet ose Skemat e Reja të Menaxhimit të Përmbytjes që Ndikojnë te Statusi i Trupit Ujor 9-10
9.4 Menaxhimi i Riskut nga Thatësirat në Basenin e Lumit Ishëm.....9-10
9.4.1 Autoriteti Kompetent dhe Masat e Koordinimit..... 9-10
9.4.2 Përmbledhja e Historikut të Thatësirave 9-11
9.4.3 Përmbledhja e Historikut të Thatësirave 9-11
9.4.4 Aktivitetet ose Skemat e Reja të Menaxhimit të Thatësirave që Ndikojnë te Statusi i Trupit Ujor 9-12
9.5 Plani i Menaxhimit të Zonave Bregdetare 9-12
9.5.1 Autoriteti Kompetent dhe Masat e Koordinimit..... 9-12
9.5.2 Strategjia për Menaxhimin e Bregdetit..... 9-12
9.5.3 Aktivitetet ose Skemat e Reja të Menaxhimit të Bregdetit që Ndikojnë te Statusi i Trupit Ujor9-13
9.6 Vlerësimi Strategjik Mjedisor 9-13
9.6.1 Autoriteti Kompetent dhe Masat e Koordinimit..... 9-13
9.6.2 Elementet Kryesore të Vlerësimit Strategjik Mjedisor 9-14
9.6.3 Përfundimet Kryesore të Vlerësimit Strategjik Mjedisor..... 9-15

10 PRESIONET NDAJ TRUPIT UJOR, STATUSI DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE 10-1
10.1 Vështrim i përgjithshëm 10-1
10.2 Shembuj të Presioneve dhe Ndikimeve 10-1
10.3 Vlerësimi i Standardizuar i Presioneve Mbështetur në Procedurat e Raportimit WISE 10-2
10.3.1 Lista Standarde e Numeracionit të Presioneve dhe Treguesve nga WISE 10-2
10.3.2 Identifikimi dhe Vlerësimi Sasior i Presioneve dhe Treguesve 10-3
10.3.3 Lista Standarde e Numeracionit të Llojeve të Ndikimit 10-5
10.4 Presionet e Trupit Ujor Sipërfaqësor dhe Vështrim i Përgjithshëm i Vlerësimit të Statusit 10-6
10.4.1 Vlerësimi i Presioneve në Nivel Nënbaseni 10-6
10.4.2 Metodologjia e Përcaktimit të Statusit në Nivelin e Trupit Ujor 10-7
10.4.3 Llojet e Përjashtimit për Trupat Ujorë Tepër të Modifikuar 10-8
10.5 Presionet e Ujërave Sipërfaqësore dhe Përmbledhja Kryesore e Statusit 10-8
10.5.1 Vështrim i përgjithshëm 10-8
10.5.2 Trupat ujorë më "në risk" 10-10
10.5.3 Programi i Monitorimit të Ujërave Sipërfaqësore 10-11
10.6 Presionet e Trupit Ujor Nëntokësor dhe Vështrimi i Përgjithshëm i Vlerësimit të Statusit 10-18
10.6.1 Vlerësimi i Presioneve në Nivelin e Trupit Ujor Nëntokësor 10-18
10.6.2 Përcaktimi i Vlerave Prag 10-19
10.6.3 Metodologjia e Përcaktimit të Statusit në Nivelin e Trupit Ujor 10-20
10.7 Presionet e Ujërave Nëntokësore dhe Përmbledhja Kryesore e Statusit 10-20
10.7.1 Vështrim i përgjithshëm 10-20
10.7.2 Programi i Monitorimit të Ujërave Nëntokësore 10-22

11 PËRMBLEDHJE E ANALIZËS EKONOMIKE 11-1
11.1 Analiza ekonomike sipas Nenit 5 të DKU-së, Shtojca III 11-1
11.2 Baseni i lumit Ishëm: përmbledhje e shkurtër 11-1
11.3 Karakteristikat dhe rëndësia ekonomike e përdorimeve të ujit 11-2
11.3.1 Treguesit e përgjithshëm socio-ekonomikë 11-2
11.3.2 Karakteristikat dhe rëndësia ekonomike e përdorimeve të veçanta të ujit 11-3
11.4 Shërbimet e Ujit 11-7
11.4.1 Prodhimi i ujit të pijshëm dhe shërbimi i furnizimit 11-8
11.4.2 Shërbimi i mbledhjes dhe trajtimit të ujërave të ndotura 11-10
11.4.3 Vlerësimi i niveleve aktuale të rikuperimit të kostove për shërbimet e ujit 11-10
11.5 Skenari bazë: me sytë drejt së ardhmes 11-15

12 POLITIKAT MJEDISORE NË NIVELIN E BASENIT UJOR 12-1
12.1 Politikat Mjedisore për Trupat Ujorë - Ishëm 12-1
12.1.1 Përmbledhja e Nismave për të Mbështetur Objektivat Mjedisore 12-1

12.1.2 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Monitorim të Përshtatshëm të Ujërave Nëntokësore 12-3
12.1.3 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Monitorim të Përshtatshëm të Cilësisë së Ujit 12-3
12.1.4 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Monitorim të Përshtatshëm Hidrobiologjik 12-3
12.1.5 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Kontrollet e Nxjerrjeve të Ujit 12-3
12.1.6 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Eficiencën e Përdorimit të Ujit 12-4
12.1.7 Politika dhe Ndërhyrjet Strategjike për Përputhshmërinë e Prurjes Ekologjike 12-4
12.1.8 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Përmirësimin e Raportimit nga Subjektet 12-6
12.1.9 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Kontrollin e Ndotjes në Terren 12-6
12.1.10 Politika dhe Ndërhyrjet Strategjike për Vetëmonitorimin e Subjekteve 12-6
12.1.11 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Restaurimin e Strukturave dhe Vazhdimësisë 12-7

13 PROGRAMI I MASAVE PËR BASENIN E ISHMIT 13-1

13.1 Vështrim i përgjithshëm 13-1
13.1.1 Koncepti i Masave dhe Masave të Llojeve Kyçe (MLlK) 13-1
13.2 Masat Bazë 13-8
13.2.1 Vështrim i përgjithshëm 13-8
13.2.2 Përputhshmëria Ligjore 13-8
13.2.3 Rëndësia Operacionale e Masave Bazë 13-8
13.3 Masat Plotësuese 13-9
13.4 Masat Shtesë 13-9
13.5 Qasja Sistematike për Identifikimin e Masave 13-10
13.6 Ndërhyrjet Operacionale për Trupat Ujorë që nuk i Arrijnë Objektivat Mjedisore 13-11
13.6.1 Menaxhimi Aktiv i Basenit Ujor 13-11
13.7 Identifikimi Numerik dhe Raportimi i Masave 13-11
13.7.1 Përdorimi i Treguesve për të Siguruar Arritjen e Masave 13-12
13.7.2 Informacioni për Raportimin e Masave të Përgjithshme dhe të Veçanta 13-12
13.8 Formatet e Përfunduara për Raportimin e Masave 13-15
13.8.1 Raportimi Përmbledhës i PiM-së në Nivelin e Basenit ujor 13-15
13.8.2 Përmbledhja e Formateve të Raportimit për PiM-në Kombëtare 13-16
13.9 Përmbledhje e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë që Rrezikojnë të Mos i Përmbushin Objektivat Mjedisore 13-23
13.10 Përmbledhje e Trupave Ujorë Nëntokësorë që Rrezikojnë të Mos i Përmbushin Objektivat Mjedisore 13-23
13.11 Masat për Trupat Ujorë Sipërfaqësorë në Risk 13-27
13.11.1 Grupi i Trupave Ujorë 351495-351493-351491 13-27
13.11.2 Grupi i Trupave Ujorë 351487-351485-351483 13-28
13.11.3 Grupi i Trupave Ujorë 351443-351441 13-28
13.11.4 Trupat Ujorë 35147 dhe 35145 13-29

13.12 Përcaktimi dhe Raportimi i Kostove dhe Burimeve të Financimit 13-30
13.12.1 Pasqyra e Kostove 13-30
13.12.2 Vështrimi i Përgjithshëm i Fondeve 13-30
13.12.3 Raportimi i Kostove dhe Fondeve 13-30
13.13 Përmbledhja e Kostove për Masat e Trupit Ujor Sipërfaqësor 13-31
13.14 Përmbledhja Përfundimtare e Statusit Aktual dhe të Parashikuar të Trupit Ujor Sipërfaqësor 13-32
13.15 Procedurat e Monitorimit dhe Vlerësimit të Planit 13-32
13.15.1 Detajet e programit të propozuar të monitorimit të ujërave sipërfaqësore për periudhën 2024-2029 13-32
13.16 Masat për Trupat Ujorë Nëntokësorë në Risk 13-47
13.16.1 Masat për parandalim dhe kufizim për Ujërat Nëntokësore 13-47
13.16.2 Masat për Parandalim dhe Kufizim që Zbatohen për të Gjithë Trupat Ujorë Nëntokësorë 13-48
13.16.3 Masat për Parandalim dhe Kufizim për GW35140101 dhe GW35140103 13-48
13.16.4 Masat për Parandalim dhe Kufizim për Grupin B të Trupave Ujorë Nëntokësorë (GW35140501, GW35140503 dhe GW35140505) 13-50
13.16.5 Grupi C i Trupave Ujorë Nëntokësorë (GW35140507 dhe GW35140509) 13-51
13.17 Përmbledhja e Kostimit të Masave për Ujërat Nëntokësor 13-51
13.18 Përmbledhja Përfundimtare e Statusit Aktual dhe të Parashikuar të Trupit Ujor Nëntokësor 13-51

14 SHTOJCA TEKNIKE 14-1

14.1 Dokumentacioni 14-1
14.2 Hartat 14-1
14.3 Lista e Shtojcave 14-1

Lista e Figurave

Figura 1-1 – Rregullimet Administrative për Qeverisjen e Burimeve Ujore 1-2
Figura 2-1 –Deklarata e Masave të Konsultimit 2-2
Figura 3-1 Elementet Cilësore të Statusit Ekologjik të Trupave Ujorë 3-3
Figura 3-2- Koncepti i Praktikës më të Mirë të Kurbave të Prurjes Mjedisore 3-6
Figura 3-3 – Koncepti i Pikut të Shfrytëzimit si pasojë e Hidrocentralit..... 3-9
Figura 3-4 –Procedura për Përcaktimin e Statusit të Përgjithshëm të Trupit Ujor 3-10
Figura 3-5 – Shembulli i Pakësimit të Prurjes Sipërfaqësore për Shkak të Nxjerrjes së Ujërave Nëntokësore 3-12
Figura 3-6 – Ilustrimi i Zonës Hiporike 3-13
Figura 3-7 – Procedura Standarde për Përcaktimin e Statusit të Përgjithshëm të Trupit Ujor Nëntokësor 3-14
Figura 4-1 - Kurbat e kohëzgjatjes së prurjes për lumin e Tërkuzës përpara dhe pas ndërtimit të Digës së Bovillës. 4-3
Figura 4-2 - Shembull i Kurbës së Qëndrueshmërisë së Prurjes në stacionin matës të Zall Dajtit, lumi i Tiranës - (*Majtas, kurba e kohëzgjatjes afatgjatë të prurjes dhe djathtas, kurbat vjetore*)..... 4-4
Figura 4-3 – Treguesit e Ndikimeve të Ndryshimeve Klimatike për Evropën Jugore..... 4-6
Figura 4-4 - Zonat Bregdetare të Rrezikuara nga Përmbytja të Parashikuara për Periudhën 10-vjeçare deri në 2050-n 4-6
Figura 4-5 – Ndryshimet e Reshjeve sipas Modelit të Shumëfishtë Global të IPCC-së – RCP8.5 [43] 4-7
Figura 4-6 – Llojet Kryesore të Përdorimeve të Tokës sipas Nënbaseneve 4-13
Figura 4-7 – Autoritetet Kryesore Bashkiake dhe Zonat Urbane 4-14
Figura 4-8 Popullsia që merr shërbime nga ujësjellësi për çdo bashki që i përket basenit ujor të Ishmit. 4-16
Figura 4-9 - Totali i tokës së punueshme, sipërfaqes potenciale për ujitje dhe sipërfaqes së tokës së ujitur në 2020-n për çdo bashki në basenin e lumit Ishëm. 4-21
Figura 4-10 - Digat e ujitjes për çdo bashki në basenin e lumit Ishëm 4-23
Figura 4-11 - Volumi i ujit të përdorur për ujitje në 2020-n për çdo bashki në basenin e lumit Ishëm4-23
Figura 5-1 – Shembull i një Trupi Ujor të Llojit të Ngjashëm me Status të Larmishëm 5-4
Figura 5-2 – Madhësitë e Trupave Ujorë Lumorë sipas Frekuencës – Ishëm 5-4
Figura 6-1- Ilustrimi i Trupave Ujorë të Shumtë brenda një Akuiferi të Vetëm..... 6-2
Figura 6-2 –Përvijimi i trupit ujor nëntokësor që vjen nga ndryshimi i statusit kimik 6-3
Figura 6-3 –Përvijimi i trupit ujor nëntokësor që vjen nga ndryshimi në statusin sasior 6-4
Figura 8-1 - Vlerësimi paraprak i statusit ekologjik të lumenjve..... 8-4
Figura 10-1 – Përqindjet e trupave ujorë të përvijuar në varësi të niveleve të statusit 10-9
Figura 10-2 – Përqindjet e TUTM-ve të përvijuar në varësi të niveleve të statusit 10-9
Figura 10-3 – Përqendrimet e Nitrateve te Ujërat Nëntokësore dhe Pikat e Presionit të Ndotjes në Basenin e Lumit Ishëm..... 10-21
Figura 12-1 – Koncepti i Restaurimit të Prurjes Ekologjike 12-5
Figura 13-1 – Shembull i zgjedhjes së Masave për Kategorinë e Presioneve “Burimet e shpërndara”13-11
Figura 13-2 - Përqindjet Aktuale dhe të Parashikuara të Statusit të Trupave Ujorë Sipërfaqësorë 13-32
Figura 13-3 - Pikat e Përputhshmërisë..... 13-47
Figura 13-4 – Përqindjet Aktuale dhe të Parashikuara të Statusit të Trupave Ujorë Nëntokësorë. 13-51

Lista e fotografive

Fotografia 3-1-Devijimi Maksimal i Prurjes dhe Piku i Shfrytëzimit nga HEC-i (HEC Cekreze) 3-9

Lista e hartave

Harta1-1 – Shtrirja e Basenit të Lumit Ishëm 1-7
Harta 4-1- Shpërndarja e Reshjeve, Lumenjtë Kryesorë dhe Rrjetet Hidrometrike 4-26
Harta 4-2 – Formacionet Kryesore Hidrogjeologjike..... 4-27
Harta 4-3 – Nënbasenet dhe përdorimi i tokës 4-29
Harta 4-4 – Infrastruktura Kryesore e Përdorimit të Ujit në Basenin e Lumit Ishëm..... 4-30
Harta 4-5 – Popullsia sipas rajoneve administrative dhe aglomerateve kryesore të basenit ujor 4-31
Harta 5-1 – Kategoria dhe Përvijimi i Trupit Ujor Sipërfaqësor 5-10
Harta 6-1 – Kategoria dhe Përvijimi i Trupit Ujor Nëntokësor..... 6-9
Harta 7-1 – Harta e të gjitha zonave të mbrojtura – Ishëm..... 7-11
Harta 8-1 – Vendndodhja e Pikave të Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore të AKM-së.. 8-9
Harta 10-1 – Harta e Presioneve të Nxjerrjeve, hidroenergjetike dhe morfologjike..... 10-15
Harta 10-2 – Harta e Shkarkimeve të Ujërave të Ndotura dhe e Presioneve të Ndotjes së Shpërndarë10-16
Harta 10-3 – Përcaktimi i Statusit Përfundimtar të Trupave Ujorë Sipërfaqësorë 10-17
Harta 10-4 – Vështrim i Përgjithshëm i Presioneve të Nxjerrjeve dhe Ndotjes së Ujërave Nëntokësore10-25
Harta 10-5 - Përcaktimi i Statusit Përfundimtar për të Gjithë Trupat Ujorë Nëntokësorë..... 10-26

Lista e Tabelave

Tabela 1-1 – Regjistri i Autoriteteve Kompetente Lidhur me Planin 1-4
Tabela 1-2 – Elementet Mbështetëse të Kuadrit të PMBU-së 1-10
Tabela 2-1 – Përmbledhja e Temave të Rëndësishme të Menaxhimit të Ujërave 2-5
Tabela 3-1 Skema e klasifikimit të AKM-së për vlerësimin e parametrave fiziko-kimikë të lumenjve 3-5
Tabela 3-2 – Zonat e Mbrojtura sipas Natura 2000 në basenin e lumit Ishëm 3-20
Tabela 4-1 – Variablat Klimatike Kryesore – Baseni Ishëm 4-2
Tabela 4-2 – Kurbat e Qëndrueshmërisë së Prurjes për Stacionet Matëse të Prurjeve në Basenin e Lumit Ishëm 4-4
Tabela 4-3 – Ndryshimi indikativ në % i Temperaturës Globale, IPCC, viti bazë 1990-a 4-7
Tabela 4-4 - Ndryshimi indikativ në % i Reshjeve Globale, IPCC, viti bazë 1990-a 4-7
Tabela 4-5 – Testi i Dallimeve Statistikore – Mesatarja aritmetike e Reshjeve Afatgjata 4-7
Tabela 4-6 – Bilanci i Përgjithshëm i Ujit për Basenin e Ishmit 4-9
Tabela 4-7 – Përmbledhja e Formacioneve Gjeologjike Kryesore dhe Potencialit të Ujërave Nëntokësorë 4-12
Tabela 4-8 – Përmbledhja e Nxjerrjeve, Përdorimeve dhe Konsumeve Kryesore Sektoriale të Ujit-Baseni Ishëm 4-15
Tabela 4-9 -: Furnizimi me ujë dhe kanalizimet në Rajonin e Basenit Ujor të Lumit Ishëm 4-17
Tabela 4-10 - Tarifat e shërbimit të ujit për çdo shoqëri UK në basenin e lumit Ishëm 4-18
Tabela 4-11 - Situata aktuale lidhur me mbledhjen e ujërave të ndotura në zonën e basenit të lumit Ishëm 4-18
Tabela 4-12 – Statistikat Kyç Përmbledhëse për nënbasenet e lumit Ishëm 4-28
Tabela 5-1 Baseni ujor i Ishmit, Karakterizimi i Trupit Ujor, Kategoria e LUMENJVE 5-8
Tabela 5-2 – Karakterizimi i Trupave Ujorë – Kategoria e LIQENEVE 5-9
Tabela 5-3 – Karakterizimi i Trupave Ujorë – Kategoria e Ujërave KALIMTARE 5-9
Tabela 5-4 – Karakterizimi i Trupave Ujorë – Kategoria e Ujërave BREGDETARE 5-9
Tabela 6-1– Llojet Kryesore të Ujërave Nëntokësore në Shqipëri, Raportimi 6-2
Tabela 6-2 – Përmbledhja Kombëtare e Formacioneve Hidrogjeologjike 6-4
Tabela 6-3 –Grupet e Raportimit për Trupat Ujorë Nëntokësorë në Basenin e Lumit Ishëm 6-7
Tabela 6-4 –Karakterizimi dhe Përvijimi i Trupave Ujorë Nëntokësorë 6-8
Tabela 7-1 – Lista e zonave të mbrojtura me rëndësi ekonomike 7-3
Tabela 7-2 - Protected Areas in the Ishmi River Basin 7-6
Tabela 7-3 – Regjistri i Zonave të Mbrojtura – Kategoria e ZONAVE TË MBROJTURA TË UJIT TË PIJSHËM 7-7
Tabela 7-4 - Regjistri i Zonave të Mbrojtura - Kategoria e LLOJEVE UJORE ME RËNDËSI EKONOMIKE 7-8
Tabela 7-5 – Regjistri i Zonave të Mbrojtura – Kategoria e UJËRAVE REKREATIVE DHE TË LARJES 7-9
Tabela 7-6 - Regjistri i Zonave të Mbrojtura – Kategoria e ZONAVE TË NDJESHME NDAJ LËNDËVE USHQYESE 7-9
Tabela 7 -7 – Regjistri i Zonave të Mbrojtura – Kategoria e HABITATEVE DHE LLOJEVE TË MBROJTURA 7-9
Tabela 8-1 – Stacionet e monitorimi të Cilësisë së Ujit në basenin e lumit Ishëm 8-3
Tabela 8-2 - Puset nxjerrëse të përdorura për monitorimin e nivelit të ujit. 8-6
Tabela 9-1 - Të dhënat e përgjithshme për dëmet nga përmbytjet gjatë periudhës 1946-2018 në Bashkinë Tiranë 9-7
Tabela 9-2 - Të dhënat e përgjithshme për dëmet nga përmbytjet gjatë periudhës 1961-2016 në Bashkinë Tiranë 9-8
Tabela 9-3 – Trupat Ujorë që Mund të Ndikohen nga Aktivitetet e Burimeve Ujore 9-10
Tabela 9-4 – Trupat Ujorë që Mund të Ndikohen nga Aktivitetet e Menaxhimit të Thatësirave 9-12
Tabela 9-5 – Trupat Ujorë që Mund të Ndikohen nga Aktivitetet e Menaxhimit të Bregdetit 9-13
Tabela 9-6 – Elementet Kryesore të Procesit të VSM-së 9-14
Tabela 10-1 – Llojet dhe Treguesit Standardë të Presionit, Lloji 1 deri në 3 10-3
Tabela 10-2 – Llojet dhe Treguesit Standardë të Presionit, Lloji 4 deri në 8 10-4
Tabela 10-3 – Llojet Standarde të Ndikimeve 10-5
Tabela 10-4 – Presionet dhe Analiza e Statusit – Lumenjt 10-13
Tabela 10-5 – Vlerat Prag të Propozuara 10-19
Tabela 10-6 – Presionet dhe Vlerësimi i Statusit Përmbledhje – Kategoria UJËRAT NËNTOKËSORE 10-24

Tabela 11-1 – Popullsia Historike e baseneve Ishëm-Erzen (2017-2020) 11-3
Tabela 11-2 – Ujitja: sipërfaqet që mund të ujiten dhe që janë ujitur, basenet Ishëm-Erzen dhe baseni i Ishmit, 2020 11-5
Tabela 11-3 – Volumet e Ujit: të prodhuar, faturuar dhe humbur në basenet ujore Ishëm-Erzen dhe basenin ujor Ishëm, 2020 11-9
Tabela 11-4 – Performanca Financiare e Shërbimit të Furnizimit me Ujë/Rikuperimi i Kostos, basenet Ishëm-Erzen dhe basenet Ishëm, 20 11-12
Tabela 11-5 – Norma e Rikuperimit të Kostos Totale për furnizimin me ujë, kanalizimet dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, basenet Ishëm-Erzen dhe basenin Ishëm, 2020. 11-14
Tabela 12-1 – Përmbledhja e Masave të Përgjithshme Politike ose Strategjike në Mbështetje të Objektivave Mjedisore 2024-2029 12-9
Tabela 13-1 – Masat e Llojeve Kyç të WISE të BE-së Hartëzuar në Programin Kombëtar Sektorial të Ujit 13-4
Tabela 13-2 –Lista Standarde e Numeracionit për Masat dhe Treguesit Kyç 13-14
Tabela 13-3 – Marrëdhënia midis Llojeve dhe Synimeve të Masave dhe Sistemit të Kodimit 13-18
Tabela 13-4 - Përmbledhja e presioneve dhe masave në nivel baseni: Baseni i Lumit Ishëm 13-19
Tabela 13-5 –Përmbledhje e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë që Rrezikojnë të Mos i Përmbushin Objektivat Mjedisore 13-24
Tabela 13-6 –Përmbledhja e Trupave Ujorë Nëntokësorë Rrezikojnë të Mos i Përmbushin Objektivat Mjedisore 13-26
Tabela 13-7 - Frekuencat e propozuara të monitorimit [një herë për interval të përmendur] 13-34
Tabela 13-8 – Përmbledhje e Programit të Masave sipas Trupit Ujor Sipërfaqësor 13-35
Tabela 13-9 Tabelat përmbledhëse për kostot dhe fondet e masave për ujërat sipërfaqësore 13-40
Tabela 13-10 – Përmbledhje e Programit të Masave sipas Trupit Ujor Nëntokësor 13-52
Tabela 13-11 Tabela përmbledhëse për kostot dhe fondet e masave për ujërat nëntokësor 13-54

Deklarata e Përputhshmërisë

Ky Dokument është në përputhje me kërkesat e Ligjit "Për konsultimin publik", të parashtruara në nenet 15 dhe 17.

Është hartuar në përputhje me nenin 14 "Konsultimi publik për hartimin e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore" dhe shtojcën VII të Direktivës së BE-së 2000/60/KE.

Parathënie

Të nderuar kolegë, ekspertë të ujit e mjedisit, si dhe palë interesi,

Sikurse jeni në dijeni, Shqipëria po zbaton Direktivën Kuadër të Ujit 2000/60/KE (DKU-ja e BE-së), si hallkë mjaft e rëndësishme e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Prandaj, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), si autoriteti përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor, me mbështetjen e projektit EUSIWM (Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit), që po zbatohet nga ADA (Agjencia Austriake për Zhvillim), ka hartuar këtë ***Plan Menaxhimi të Basenit Ujor për Basenin e Lumit Ishëm***, me këto elemente përbërëse:

- Mbrojtja dhe përmirësimi i trupave ujorë;
- Pjesëmarrje e gjerë publike në zhvillimin e procesit, deri në arritjen e statusit të mirë të trupave ujorë.

Uji është burimi ynë natyror më i vyer. Si i tillë, është jetik për gjallërimin e botës së egër, bujqësisë dhe biznesit. Për më tepër, është edhe një prej mjeteve që promovon rigjenerimin (strukturor dhe ekonomik), rekreacionin dhe turizmin. Ndaj, kjo përpjekje konsiderohet e mirëpritur, pasi do të mundësojë identifikimin e presioneve dhe ndikimeve te burimet ujore, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mjedisit ujor të basenit të lumit Ishëm, nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm.

Në vijim të rregullave të parashtruara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1015, datë 16.12.2020, Këshillat e Baseneve Ujore (KBU) duhet të sigurohen që të gjitha palët e interesit të çdo baseni ujor të përvijuar të kenë mundësinë t'i ndajnë mendimet e tyre profesionale lidhur me PMBU-në, duke bashkëpunuar me institucione, organizata dhe komunitete të ndryshme vendore. Për këtë qëllim, secili do të mund të fitojë njohuri të reja lidhur me menaxhimin e burimeve ujore dhe së bashku, do të bëjmë të mundur formalizimin e këtij plani.

Duke marrë parasysh sa më lart, do ta vlerësonim shumë përfshirjen tuaj, sipas fushës suaj të ekspertizës, në identifikimin e çështjeve që ju i shihni si të rëndësishme dhe në propozimin e masave të mundshme për zgjidhjen e tyre.
Duam të theksojmë se dokumenti përfundimtar duhet të përfshijë edhe propozimet e aktorëve në fushën e burimeve ujore përpara se të kalojë për miratim.

Ndaj, do të donim t'ju kujtonim se cikli i zbatimit të PMBU-së është 6 vjeçar. Aktualisht, në Evropë, Shtetet Anëtare kanë përmbyllur ciklin e dytë të PMBU-së (2016-2021) dhe sapo kanë nisur ciklin e tretë (2022-2027). Për këtë arsye, mendimet dhe sugjerimet tuaja shihen si mjaft të vlefshme, pasi shprehin përkushtimin e secilit prej nesh drejt procesit të anëtarësimit në BE, duke besuar se ***Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor për Basenin e Lumit Ishëm*** do të zbatohet gjatë një periudhe duke iu afruar sa më tepër të jetë e mundur cikltit të tretë të PMBU-së së BE-së.

Nënshkruar nga

Drejtoresha e Përgjithshme - AMBU

Gerta Lubonja

Përmbledhje ekzekutive

Projekti EUSIWM është bashkëfinancim i BE-së në kuadër të Programit të Veprimit IPA 2016 për Shqipërinë me qëllim Mbështetjen e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore dhe Agjencisë Austriake për Bashkëpunim (ADA). Sipas Marrëveshjes Nr. 2017/393-187, lidhur midis Komisionit Evropian dhe ADA-s më 21 dhjetor 2017, organi përgjegjës për zbatimin e projektit është Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA).

Sipas marrëveshjes së nënshkruar nga Qeveria Shqiptare dhe ADA më 14 nëntor 2018 (përditësuar në vijim të zgjatjes një vjeçare të projektit ekzistues) përfituesi i drejtpërdrejtë i projektit EUSIWM është AMBU. Projekti ka si qëllim të përgjithshëm të përmirësojë zbatimin e Reformës Kombëtare për Sektorin e Ujit në Shqipëri, në kuadër të kërkesave të legjislacionit për ujërat.

Ngushtësisht i lidhur me punën teknike, projekti ka si qëllim në vetvete të forcojë rolin e AMBU-së dhe institucioneve të tjera shqiptare në fushën e burimeve ujore jo vetëm për hartimin e një PMBU-je në veçanti, por edhe për zbatimin e menaxhimit të integruar të burimeve ujore në përgjithësi, sipas qasjes të metodologjisë së BE-së. Ky rend pune e ka ndihmuar AMBU-n ta përmbushë gradualisht rolin e saj drejtues përgjatë të gjithë procesit të MBU-së.

Objektivi i Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor (PMBU) për Lumin Ishëm

Hartimi i PMBU-së së Lumit Ishëm u mundësua falë mbështetjes së projektit EUSIWM, gjatë periudhës 2019-2021. Në fillim të programit, aspektet dhe veprimtaritë kryesore të MBU-së janë realizuar falë mbështetjes së gjerë të ekipit të projektit ADA/EUSIWM dhe ekspertëve kombëtarë e ndërkombëtarë.

Në 2021-shin, në zbatim të rekomandimeve të ekipit të projektit EUSIWM, u ngrit grupi ndërinstitucional i punës me ekspert për MBU-në, nën udhëheqjen e AMBU-së. Grupi përbëhej nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme për menaxhimin e burimeve ujore në vend, të cilët janë përfshirë drejtpërdrejtë në të gjitha fazat përgatitore të PMBU-së, veçanërisht në mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave.

Struktura e PMBU-së aktuale për basenin e lumit Ishëm është në përputhje të plotë me kërkesat e parashtruara në Shtojcën VII të DKU-së së BE-së 2000/60/KE[1]. Kapitujve dhe përmbajtjes së planit u janë bërë disa përshtatje, për t'iu përgjigjur më mirë nevojave dhe sistemeve operacionale kombëtare, të disponueshme për menaxhimin e burimeve ujore.

Puna sipas një metodologjie të qartë për MBU-në, duke mundësuar trajnimin e plotë të stafit të AMBU-së në kuadër të projektit EUSIWM, dhe për më tepër vendosja e dialogut ndërinstitucional në nivel teknik përmes GE-së së MBU-së shërbejnë si garanci se në të ardhmen, procesi i planifikimit të MBU-së për planet e reja 2024-2029, ndjekur nga zbatimi i tyre nëpërmjet Programit aktual të Masave (PM) sipas standardeve të BE-së, do të realizohet në mënyrë krejt profesionale nën drejtimin e AMBU-së dhe në bashkëpunim të ngushtë me institucionet në fushën e burimeve ujore.

Sfidat e hasura

Hartimi i PMBU-së është proces i vështirë dhe kompleks, sidomos duke marrë parasysh kushtet e Shqipërisë. Ndonëse përgatitja e PMBU-së mund të jetë përgjegjësi e një ose disa institucioneve, hartimi në vetvete është sipërmarrje komplekse që kërkon përfshirjen e të gjitha palëve të interesit, si për shembull ekspertë të fushave të ndryshme. Menaxhimi i integruar i burimeve ujore është proces "i detyrueshëm" që duhet zbatuar nga institucionet përkatëse për t'i menaxhuar më mirë burimet e disponueshme. Një prej kërkesave kryesore të realizimit të duhur të procesit të MBU-së është disponueshmëria dhe (*kur është e mundur*) besueshmëria e të dhënave. Një prej pikëpyetjeve më të mëdha gjatë përgatitjes së PMBU-së për basenin e lumit Ishëm ishte nëse duhej të prisnim përfundimin e mbledhjes së të gjitha të dhënave dhe vënies në funksion të sistemit të mirëorganizuar të monitorimit, apo të përqafonim qasjen "të përdorim ato që kemi në dispozicion" dhe të hartonim "udhërrëfyesin" për zgjidhjen e problemeve dhe trajtimit të sfidave.

Pra, AMBU duhet të presë deri kur të plotësohen të gjitha kushtet dhe më pas të vijojë me përgatitjen e PMBU-së, apo plotësimi i këtyre kushteve duhet të jetë pjesë përbërëse e vetë PMBU-së?

[1]https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:5c835afb-2ec6-4577-bdf8-756d3d694eeb.0004.02/DOC_1&format=PDF

Si lindi PMBU-ja?

DKU-ja e BE-së hyri në fuqi në vitin 2000, duke ngritur kështu kuadrin ligjor për mbrojtjen dhe përmirësimin e statusit të ekosistemeve ujore, parandaluar përkeqësimin e tyre dhe siguruar përdorimin afatgjatë e të qëndrueshëm të burimeve ujore brenda BE-së. Objektivi ishte që të gjithë trupat ujorë të brendshëm, kalimtarë dhe bregdetarë të arrinin statusin (ose potencialin) e mirë kimik dhe ekologjik dhe që ujërat nëntokësore të arrinin statusin e mirë kimik dhe sasior.

Është thelbësore që ujërat të jenë të pastra, pra që të mos jenë në presionin e lëndëve organike, ushqyese apo të rrezikshme. Megjithatë, kjo nuk mjafton nëse ekosistemi natyror, përfshi florën dhe faunën, është dëmtuar në mënyrë të konsiderueshme. Kjo është arsyeja se përse kjo qasje kaq e gjithanshme kërkon që ujërat sipërfaqësore të gëzojnë "statusin e mirë ekologjik": shtretërit e lumenjve duhet të jenë të mirëstrukturuar dhe duhet mjaftueshëm ujë që të sigurohen rrugëkalimet migratore dhe habitatet natyrore që mundësojnë vazhdimin e jetës së kafshëve dhe bimëve ujore.

Përmbledhja e Çështjeve të Rëndësishme të Menaxhimit të Ujërave (PCRMU)

Faza paraprake ishte identifikimi i CRMU-ve kryesore, për të pasur tablonë e çështjeve dhe presioneve kryesore të një BU-or të caktuar. Ky raport parashtrues paraqet çështjet aktuale në basenin ujor dhe propozon temat/aspektet kryesore që duhen trajtuar më tej nga PMBU-ja, në kërkim të zgjidhjeve.

Më poshtë renditen disa prej çështjeve më të rëndësishme:

1. Ndryshimet klimatike dhe burimet ujore;
2. Të dhënat hidrometeorologjike dhe sistemet e monitorimit;
3. Zonat e mbrojtura dhe ekosistemet ujore;
4. Përmbytjet dhe thatësirat;
5. Morfologjia dhe vazhdimësia e kanalit dhe zonës së përmbytshme;
6. Prurjet Mjedisore;
7. Përdorimi i ujit, marrja e ujit dhe lejet për marrjen e ujit;
8. Shkarkimet e ujit, ndotja e ujit dhe leja për shkarkim;
9. Digat dhe hidrocentralet;
10. Përdorimi, mbrojtja dhe monitorimi i ujërave nëntokësore;
11. Cilësia e ujërave bregdetare dhe habitateve;
12. Menaxhimi bregdetit, rreziqet dhe përmbytjet, erozioni.

Për çdo çështje, parashtrimi përshin informacion rreth:

- Rëndësisë së trajtimit;
- Situatës aktuale;
- Ndërlikimeve dhe nevojave në të ardhmen;
- Masave që mund të zbatohen në kuadër të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor.

Drejt kuadrit të PMBU-së për vendin

Bazuar te analiza e situatës dhe problemeve që propozohen të trajtohen në formën e ICRMU-ve, u dakorduan këto hapa të rëndësishëm: përcaktimi i një strukture të përshtatshme dhe të dobishme për PMBU-në, në përputhje të plotë me kërkesat e Shtojcës VII të DKU-së së BE-së dhe marrja parasysh e specifikave dhe problemeve të burimeve ujore në Shqipëri. Kjo strukturë u përgatit në 2020-n kryesisht nga eksperti ndërkombëtar i EUSIWM-it, Z. Brian Faulkner.

Draft PMBU-ja përmban 13 kapituj, të gjithë në përputhje me parashikimet e Shtojcës VII të DKU-së, por rendi i tyre është përshtatur paksa me kontekstin kombëtar. Përgatitja kërkoi më tepër kohë për Kapitullin 11 "Analiza ekonomike e përdorimit të ujit", e cila është realizuar për herë të parë në në Shqipëri në nivelin e basenit ujor.

Draft i parë i PMBU-së mori formën përfundimtare në prill të 2021-shit. PMBU-ja do të finalizohet në drejtimin e AMBU-së, me mbështetjen e ekipit ADA-EUSWIM dhe ekspertëve përkatës ndërkombëtarë e kombëtarë. Draft

raporti dhe përmbajtja e tij janë konsultuar plotësisht me palët e interesit dhe institucionet përkatëse përmes mbledhjeve të GE-së së MBU-së.

Draft PMBU-ja është përditësuar vazhdimisht, ku versioni i parë paraprak u përmbyll në dhjetor të 2021-shit dhe iu shpërnda të gjitha aktorëve në Konferencën Kombëtare të Ujit.

Programi i Masave

Bazuar te kërkesat e DKU-së, për çdo PMBU do të përgatitet PiM-ja, me qëllim arritjen e objektivave mjedisore (DKU Neni 11(1)2).

Masat e identifikuara nga PMBU-ja për lumin Ishëm janë hartuar në bazë të vlerësimit të statusit aktual të trupave ujorë të përvijuar, që është mbështetur te informacionet e analizës së presioneve dhe ndikimeve që prekin çdo trup ujor. Prandaj, çdo hap i procesit të planifikimit është i rëndësishëm për të siguruar zbatimin e masave të duhura në vendndodhjen e duhur.

Masat përcaktohen në varësi të "Masave të Llojit Kyç" (MLlK[3]) dhe të shkallës në të cilën do të siguronin trajtimin e këtyre presioneve. MLlK-të janë një grup masash të identifikuara nga Shtetet Anëtare, të cilat kanë si shënjestër të njëjtin presion ose qëllim. *MLlK mund të përfshijnë edhe masa me karakter kombëtar, por zakonisht mund të jenë më tepër se një masë kombëtare. Masat janë hartuar në bazë të vlerësimit të statusit aktual të trupave ujorë, plotësuar me informacione nga analiza e presioneve dhe ndikimeve që prekin trupat ujorë.*

Ky PMBU përcakton PiM-ve që do të zbatohet gjatë periudhës 2024-2029 për arritjen e "objektivave mjedisore", të përshkruara plotësisht në kapitullin 3, në përputhje me Nenin 4 të DKU-së[4]. Në Shtojcën 3 të WISE 2016 jepen edhe udhëzime për presionet dhe treguesit kryesorë të masave, me shembuj. Masat specifike (që hasen në kuadër të MLlK-ve) duhet të trajtojnë presione specifike 'Llojet Kyç të Presioneve' (LlKP)[5], që hasen në nivelin e trupit ujor. Mënyra më efikase për ta bërë masën të pasqyrojë presionin përkatës është që të përmblidhë elementet individuale që kontribuojnë në statusin ose potencialin e përgjithshëm të trupit ujor.

Masat kryesore të përcaktuara:

- Reduktimi i ndotjes nga lëndët organike

Panvarësisht investimeve të mëdha që janë bërë në infrastrukturën e ujërave të ndotura, nevojiten masa shtesë në të ardhmen. 52% e basenit ka nevojë për zhvillim infrastrukturor bazë që synon lidhjen me sistemet e kanalizimeve publike dhe të paktën me sistemet e trajtimit të ujit të ndotur urban. Shqipëria, si shtet joanëtar i BE-së, duhet të bëjë përpjekje për ta përmirësuar ndjeshëm atë duke ndërtuar një seri sistemesh kanalizimi dhe impiantesh të trajtimit të ujërave të ndotura deri në 2029-n.

- Reduktimi i ndotjes nga lëndët ushqyese

Masat në zbatim e PMBU do të kontribuojnë ndjeshëm në reduktimin e lëndëve ushqyese që depërtojnë te ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, por nevojitet më tepër përpjekje nga institucione të ndryshme të përfshira në këtë proces. Zbatimi i masave për ujërat e ndotura urbane, industriale dhe bujqësore duhet të vazhdojë.

Krahas kësaj, përdorimi i detergjentëve pa përmbajtje fosfati konsiderohet si masë e shpejtë dhe efikase për reduktimin e emetimeve fosfate në ujërat sipërfaqësore. Rregullorja e BE-së për detergjentët duhet zbatuar në të gjitha vendet BE, por edhe Shtetet Joanëtare të BE-së duhet të bëjnë përpjekje të ngjashme ose

[2]Neni 11 (1). Çdo Shtet Anëtar siguron hartimin e programit të masave për çdo rajon të basenit lumor, ose për një pjesë të rajonit të basenit lumor brenda territorit të tij, duke marrë parasysh rezultatet e analizave të kërkuara nga Neni 5, për arritjen e objektivave të përcaktuara në Nenin 4. Këto programe masash mund t'u referohen masave që rrjedhin nga legjislacioni i miratuar në nivel kombëtar dhe të mbulojnë të gjithë territorin e Shtetit Anëtar. Kur shihet e përshtatshme, Shteti Anëtar mund të miratojë masa të zbatueshme për të gjitha rajonet e baseneve lumore dhe/ose një pjesë të rajoneve të baseneve lumore ndërkombëtare që shtrihen në territorin e tij.

[3] Përmbledhur në Tabelën 13-1*(Masat e Llojit Kyç (MLlK) në përputhje me WISE-n e BE-së që janë miratuar në këtë raport PMBU-je)*

[4] Neni 4 : Objektivat mjedisore

[5] Përmbledhur në Tabelën 10-1 *(Masat e Llojit Kyç (MLlK) në përputhje me WISE-n e BE-së që janë miratuar në këtë raport PMBU-je)*

rekomandohet të bëjnë përpjekje të ngjashme, ndër të cilat edhe Shqipëria duhet të marr masa konkrete në këtë drejtim.

Ndotja e shpërndarë (difuze) luan rol kryesor në emetimet e përgjithshme të lëndëve ushqyese, ndaj zbatimi i masave që trajtojnë menaxhimin e tokës është shumë i rëndësishëm. Si mjet i përshtatshëm menaxhimi është identifikuar një grup me disa prej praktikave më të mira bujqësore për reduktimin e ndotjes dhe infiltrimeve për shkak të bujqësisë dhe menaxhimit të tokës.

Për më tepër, zbatimi i praktikave të mira bujqësore ose sigurohet me veprime rregullatore (përputhshmëri e kryqëzuar) ose nxitet nëpërmjet iniciantivave ekonomike (programet e zhvillimit rural) të mekanizmit financiar të Politikës së Përbashkët Bujqësore. Edhe Shtetet Joanëtare të BE-së nxiten të zbatojnë praktikat më të mira bujqësore të ngjashme.

- Reduktimi i ndotjes nga lëndët e rrezikshme

Trajtimi i duhur i ujërave të ndotura urbane dhe zbatimi i Teknikave më të Mira të Disponueshme (TMD) në impiantet industriale dhe fermat e mëdha bujqësore janë masa elementare që mund të kontribuojnë ndjeshëm në zbutjen e kontaminimeve nga lëndët e rrezikshme.

Në Shtetet Joanëtare të BE-së, përpjekjet për të zhvilluar dhe përmirësuar sektorin e ujërave të ndotura dhe teknologjitë industriale, si dhe për të zbatuar praktikat më të mira bujqësore do të kenë efekte pozitive edhe në statusin e ujit që lidhet me ndotjen nga lëndët e rrezikshme.

Nevojiten më tepër përpjekje për të identifikuar se cilat lëndë prioritare apo kimikate të tjera gjenden në sasi të konsiderueshme në basen. Për burimet e emetimeve që shkaktojnë kontaminimin e ujërave sipërfaqësore nga lëndët e rrezikshme ka informacion të kufizuar në dispozicion. Duhet të vijojë inventarizimi i shkarkimeve, emetimeve dhe humbjeve për të gjithë basenin. Për t'i mbështetur këto veprimtari, nevojitet më tepër informacion për përqendrimet në rrjedhat ujore dhe ngarkesat në lumë nëpërmjet monitorimit të rregullt (me pajisje të përmirësuara për kampionim më të shpeshtë) dhe fushatë specifike kampionimi (p.sh mbetje e lëngët pas trajtimit nga i njëjti burim pikësor).

- Përmirësimi i kushteve hidromorfologjike

Vlerësimi i modifikimeve hidro-morfologjike tregoi se vetëm 2 trupa ujorë janë në gjendje të dobët. Masat e propozuara janë lehtësimi/modifikimi i rrjedhës të peshqëve dhe heqja e pengesave për arritjen e vazhdimësisë të rrjedhave ujore përgjatë lumenjve.

- Përmirësimi i statusit të ujërave nëntokësore

<u>Cilësia e ujërave nëntokësore</u>

Duke marrë parasysh se nitratet janë faktorë kyç kundër arritjes së statusit të mirë kimik të një përqindjeje të konsiderueshme të TUN-ëve për mbarë basenin, ka shumë rëndësi të eliminohet ose reduktohet sasia e nitrateve që hyjnë në trupa ujorë. Parandalimi i përkeqësimit të cilësisë së ujërave nëntokësore duhet arritur pikë së pari nëpërmjet zbatimit të Direktivës së BE-së për Nitratet dhe të DTUNU-t.

<u>Cilësia e ujërave nëntokësore</u>

Duhen shmangur nxjerrjet e tepruara të ujit në TUN-e nëpërmjet menaxhimit efikas të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore. Andaj, nevojiten kontrolle të rrepta të përdorimeve të ujërave të ëmbla sipërfaqësore e nëntokësore dhe inventarizim i tyre. Gjithashtu, kërkesa për autorizim paraprak i përdorimit të ujërave. Në përputhje me DKU-në, duhet siguruar që norma mesatare vjetore e marrjes së ujit në plan afatgjatë të mos jetë më e madhe se burimi i disponueshëm i ujërave nëntokësore.

<u>Pjesëmarrja dhe Konsultimi Publik</u>

AMBU shpreh angazhimin për pjesëmarrje publike aktive në vendimmarrje, në mënyrë që të ofrojë mbështetje më të gjerë për politikat dhe për të rritur efikasitetin e përpjekjeve për zbatim. Palët përkatëse të interesit janë konsultuar që në fillim të periudhës së hartimit të PMBU-së së Ishëmit. Në nëntor të 2019-s, u mbajt mbledhja

e parë konsultuese, ku institucionet përkatëse diskutuan dhe identifikuan/ranë dakord së bashku për çështjet e rëndësishme të menaxhimit të burimeve ujore.

Për shkak të pandemisë Covid-19, gjatë 2020-ës është zhvilluar vetëm një mbledhje konsultuese (tetor 2020) me përfaqësues të BU-së së Ishëmit dhe Erzenit. PMBU-ja përfundimtare do të publikohet në faqen zyrtare të AMBU-së, për të përmbushur kërkesat e Nenit 14 të DKU-së së BE-së për pjesëmarrjen dhe përfshirjen publike.

Vetë Direktiva nuk e përfshin pikëpamjen gjinore, por AMBU, me mbështetjen e plotë të ekipit të EUSIWM-it, e ka marrë gjerësisht në konsideratë rolin e grave, në të gjitha fazat përgatitore të planit.

1 Objektivat, Administrimi dhe Koordinimi

1.1 Objektivat

Ky dokument paraqet kërkesat statutore të PMBU-së për basenin e lumit Ishëm, të parashikuara në Ligjin për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (LMIBU), sidomos në Nenet 17 dhe 24[6]. Paralelisht, PMBU-ja përputhet gjerësisht me objektivat dhe procedurat e DKU-së së BE-së, legjislacionin e përgjithshëm të BE-së për mbrojtjen e ujërave kombëtare dhe direktivat e saj përkatëse[7].

Qëllimi kryesor i DKU-së së BE-së ka të bëjë kryesisht me cilësinë e ujërave, përkufizuar gjerësisht si "status". Kontrolli i sasisë së ujit (rrjedhat ose volumet) është element dytësor i sigurimit të cilësisë së mirë të ujit ndaj duhen përcaktuar edhe masat për sasinë që t'i shërbejnë objektivit të sigurimit të cilësisë së mirë.

PMBU-ja është mjeti kryesor për menaxhimin e trupave ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë brenda një Rajoni të caktuar Baseni Ujor (RBU), që në këtë rast është zona e Basenit të Lumit Ishëm. Lidhur me qeverisjen e burimeve ujore, PMBU-ja përmban:

- përshkrimin e përgjithshëm të basenit ujor, duke përfshirë kryesisht: hidrometeorologjinë, përdorimin e tokës dhe përdorimin e ujit;
- kategorizimin e trupave ujorë në lumenj, liqene, ujëra sipërfaqësore kalimtare dhe bregdetare, trupa ujorë nëntokësorë, si dhe përcaktimin e tipologjisë së tyre përkatëse dhe kushteve referencë për të gjithë trupat ujorë;
- vlerësimin teknik të gjendjes bazë (aktuale) të të gjithë trupave ujorë në basenin ujor lidhur me cilësinë dhe statusin sasior;
- identifikimin e zonave të mbrojtura në basenin ujor ku uji ka përdorim ose rëndësi të veçantë që kërkon mbrojtje;
- përmbledhjen e presioneve dhe ndikimeve antropogjene në trupat ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë;
- përmbledhjen e masave që synojnë zbutjen e ndikimeve të identifikuara te trupa ujorë të veçantë nëse janë nën statusin e kërkuar minimal "Mirë";
- analiza ekonomike dhe/ose teknike për ata trupa ujorë që zakonisht përshkruhen "si tepër të modifikuar" (TUTM), për të cilët nuk është e mundur arritja e "statusit të mirë";
- analizën ekonomike për identifikimin e rikuperimit të nevojshëm të burimeve dhe kostove mjedisore të shërbimeve të ujit, duke marrë parasysh parashikimet afatgjata të kërkesës dhe ofertës për ujë në basenin ujor;
- regjistrin dhe përmbledhjen e planeve më të detajuara, të propozuara për nënbasenet, sektorët, çështjet e menaxhimit ose kategoritë e ujit që mund të ndikojnë ose mund të ndikohen nga objektivat mjedisore dhe programi i masave të këtij Plani;
- përmbledhjen e masave të marra nga konsultimi publik dhe se si këto konsultime janë marrë parasysh në formulimin e objektivave të PMBU-së dhe programit të masave;
- listën e Autoriteteve Kompetente që kanë detyrime ose që ndikohen nga ky Plan, përfshi marrëdhënien e tyre me autoritetet e tjera të koordinuara brenda Shqipërisë, dhe kur është e nevojshme, përmbledhjen e marrëdhënieve institucionale të krijuara për të siguruar koordinimin me Rajonet ndërkombëtare të Baseneve Ujore;
- regjistrin e nxjerrjeve dhe lejeve të tyre, kur këto nxjerrje mund të ndikojnë te statusi i trupit ujor [8].

---

[6] Qeveria Shqiptare, Ligji 111/2012, ndryshuar me Ligjin nr. 6/2018 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"

[7] Direktiva Kuadër e Ujit 2000/60/KE për ngritjen e kuadrit për veprimin e Komunitetit në fushën e politikave ujore - "Direktiva Kuadër e Ujit", Shtojca VII, Shtojca IX

[8] Komisioni Evropian, Direktiva 2000/60/KE – Neni 11(3)

Periudha e parashikuar e Planit është gjashtë vjet (2024-2029), duke u afruar me legjislacionin kombëtar dhe DKU-në dhe përfaqëson ciklin e 3-të të këtyre Planeve për Shtetet Anëtare të BE-së, me të cilat Shqipëria po përpiqet të përafrohet. PiM-ve i përcaktuar në PMBU-në që parashtron objektivat mjedisore të cilat rrjedhin nga Neni 25 (1) i LMIBU-së pritet të bëhet ligjërisht e detyrueshme për autoritetet kompetente, operatorët ose palët e interesit, sipas rastit, me t'u miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit dhe Këshilli i Ministrave.

1.2 Statusi Ligjor i Autoritetit Kompetent

Baseni ujor i Ishëmit është përvijuar si i pavarur[9], por ndodhet në Rajonin e Basenit Ujor të Lumit të Tiranës, Shqipëri (Harta 1-1). Për qëllimet e këtij Plani, AMBU vepron si Autoriteti Kompetent për bashkërendimin dhe kontrollin e punës së organeve vendore të menaxhimit të burimeve ujore, sikurse parashikohet në Ligjin nr.111/2012 (Neni 11). Kompetencat e veçanta të AMBU-së rregullohen nga Neni 11 i Ligjin nr.111/2012 -t dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 221, datë 26.04.2018 për organizimin dhe funksionimin e AMBU-t.

AMBU-ja ka përgjegjësinë të sigurohet se kërkesat e parashtruara në Ligjin nr.111/2012 dhe DKU-në e BE-së, sidomos objektivat mjedisore dhe programi i masave të përcaktuara në PMBU, të jenë koordinuar përgjatë të gjithë sektorëve dhe programeve brenda basenit ujor[10].


1.3 Marrëveshjet administrative

LMIBU përkufizon kuadrin institucional në nivel kombëtar dhe vendor, për të siguruar menaxhimin e burimeve ujore dhe përafrimin me Direktivat kryesore të BE-së lidhur me mjedisin dhe ujin, përfshi këtu DTUNU-n, Direktivën për Ujin e Pijshëm (DUP) dhe pjesërisht Direktivat për Ujërat Nëntokësore (DUN) dhe Përmbytjet (DP).

Struktura qeverisëse e menaxhimit të ujit gjendet në vija të përgjithshme te Figura 1-1. AMBU është autoriteti kompetent për hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive, planeve, programeve dhe projekteve që synojnë menaxhimin e integruar të burimeve ujore, përfshi edhe PMBU-të.

KBU-të janë organet përgjegjëse vendore për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në basenin përkatës, përfshi edhe konservimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore, si dhe shpërndarjen e barabartë të burimeve ujore brenda basenit ujor në fjalë (LMIBU, Neni 12).

Figura 1-1 – Rregullimet Administrative për Qeverisjen e Burimeve Ujore



[9] Vendimi i QShA-së, Vendimi i Këshillit të Ministrave - Vendimi Nr. 696, datë 30.10.2019 "Për miratimin e kufijve territorialë dhe hidrografikë të baseneve ujore"

[10] Komisioni Evropian, Direktiva 2000/60/KE – Neni 3(2)

Zyrat e Administrimit të Basenit Ujor (ZABU) janë njësi operacionale të AMBU-së. Detyra e tyre kryesore është hartimi i planeve të menaxhimit të burimeve të baseneve ujore përkatëse dhe mbajtja e inventarëve për burimet ujore (Neni 13, LMIBU).

1.4 Koordinimi i Autoritetit Kompetent dhe Marrëdhëniet Institucionale

AMBU vepron si organi përgjegjës kryesor për hartimin dhe koordinimin e PMBU-së. Megjithatë, PMBU-të janë nisma mjaft komplekse, që kërkojnë bashkëpunim të gjerë dhe konsultim midis Ministrive, Agjencive Qeveritare dhe rregullatorëve, të quajtura ndryshe edhe "autoritete kompetente".

Tabela 1-1 përcakton autoritetet kompetente për këtë Plan dhe përshkruan detyrat e detyrimet e tyre, si dhe mekanizmat e koordinimit me Autoritetin e Rajonit të Basenit Ujor. Ky koordinim ndodh rutinë, nëpërmjet mekanizmave qeverisëse.

Institucionet përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve për administrimin dhe organizimin e organeve kombëtare për Menaxhimin e Burimeve Ujore janë: Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar i Ujit, Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore, Këshilli i Baseneve ujore dhe Zyrat e Administrimit të Burimeve Ujore. (Neni 7, LMIBU).

KBU-të ndihmohen nga ZABU-të, të cilat funksionojnë si sekretariat i KBU-ve. ZABU-të janë përgjegjëse për vlerësimin teknik të përdorimeve të ujit (sipërfaqësore dhe nëntokësore), japin rekomandime për miratim nga KBU-ja, mbështesin bashkitë në zgjidhjen e çështjeve që lidhen me burimet ujore dhe janë përgjegjëse për mbikëqyrjen (dhe monitorimin) e të gjitha veprimtarive lidhur me përdorimin e burimeve ujore. Megjithatë, ZABU-të kanë autoritet të kufizuar lidhur me zbatimin e detyrueshëm të procedurave ligjore dhe rregullatore.

Urdhri i Kryeministrit Nr. 129 datë 21.09.2015 "Për marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe ngritjen e grupeve të menaxhimit të integruar të politikës" institucionalizoi për herë të parë qasjen sektoriale brenda Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), që është sistemi kryesor vendimmarrës, i cili përcakton drejtimin strategjik dhe shpërndarjen e burimeve të vendit. Mekanizimi i Menaxhimit të Integruar të Sektorit u ngrit me qëllim zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e reformave sektoriale në Shqipëri. Kjo do të arrihet nëpërmjet hartimit të programeve kombëtare sektoriale dhe krijimit të një liste të vetme për projektet që kanë prioritet për investime strategjike. Mekanizmi u bazua në ngritjen e katër Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikës (GMIP) për katër fusha prioritare:

- Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore;
- Punësimi dhe Sektori Social;
- Konkurrueshmëria dhe Novacioni;
- Qeverisja e Mirë dhe Administrimi Publik.

Urdhri i Kryeministrit Nr. 157, datë 22.10.2018 "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes mbarësektoriale / ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit të integruar sektorial/ndërsektorial", riorganizoi dhe konsolidoi mekanizmin GMIP në mbështetje të marrjes së masave organizative, ndërinstitucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes mbarësektoriale / ndërsektoriale. Me këtë organizim të ri, GMIP-ja do të operojë në funksion të qasjes së integruar mbarësektoriale / ndërsektoriale në fushat prioritare. Në këtë drejtim, është shtuar edhe pikëpamja ndërsektoriale, ndryshe nga organizimi i parë, që e vuri theksin vetëm te pikëpamja sektoriale. Krahas GMIP-ve, është shtuar edhe një formë e re organizimi: Komitetet Drejtuese Sektoriale (KDS) ndarë në pesë. Ka shumë rëndësi që të përcaktohet roli i këtij mekanizmi në procesin e përdorimit dhe zbatimit të Instrumentit Financiar të Mbështetjes Buxhetore Sektoriale. Urdhri i Kryeministrit në vitin 2015 përcaktoi se: mekanizmi synon të zhvillojë, zbatojë dhe monitorojë reformat sektoriale në Shqipëri nëpërmjet hartimit të programeve kombëtare sektoriale dhe krijimit të një liste të vetme për projektet me prioritet për investime strategjike në përputhje me procesin e anëtarësimit në BE dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë".

Të gjithë palët e interesit të basenit ujor nga përdoruesit fundorë e deri te autoritetet kombëtare (institucionet qeveritare) përfaqësohen nga subjekte të ndryshme që operojnë në sektorin e ujit, si: bujqësi, industri, urbanizim, energji; OJF-të, komuniteti shkencor, donatorët dhe shoqëritë civile në përgjithësi.


Tabela 1-1 – Regjistri i Autoriteteve Kompetente Lidhur me Planin

AUTORITETI KOMPETENT DHE AUTORITETI LIGJOR	AKTIVITETET KRYESORE QË KONTRIBUOJNË NË DKU	MEKANIZMAT E KOORDINIMIT ME AK-TË E TJERA
Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) (Kryeministria) Ligji Nr. 111/2012 ndryshuar me Ligjin nr. 6/2018 për ''Menaxhimin e Integruar të Burimeve ujore'' VKM Nr. 221, datë 26.4.2018 ''Për organizimin dhe funksionimin e AMBU-së'	Zbatimi dhe koordinimi i ligjit për menaxhimin e integruar të burimeve ujore Zbatimi dhe koordinimi i Direktivës Kuadër të Ujit Përgatitja e Planeve të Menaxhimit të Baseneve ujore Përgatitja e Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet Përgatitja e Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Thatësirat Mbajtësi i Regjistrit të Nxjerrjeve të Ujit (në KKBU)	Publikimi i Planeve të Menaxhimit të Baseneve ujore dhe Dokumenteve Plotësuese Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të MIBU-së Mbajtja e regjistrit të operatorëve të burimeve ujore Mbajtja e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore
Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) Ligji Nr. 10431 datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" VKM Nr. 568, datë 17.7.2019 ''Për organizimin dhe funksionimin e AKM-së''	Monitorimi Kombëtar Mjedisor i Trupave Ujorë Lumorë Monitorimi Kombëtar Mjedisor i Trupave Ujorë Liqenorë Monitorimi Kombëtar Mjedisor i Trupave Ujorë Bregdetarë Lejet Mjedisore të lëshuara për të gjitha veprimtaritë industriale në vend VNM-të dhe VSM-të periodike	Publikimi i Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit (vjetor) Mbajtja e Regjistrit të Lejeve Mjedisore Mbajtja e Regjistrit të Çlirimit dhe Shkarkimit të Ndotësve
Departamenti i Klimës dhe Mjedisit, Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO) Kodi i procedurave administrative' VKM Nr. 490, datë 6.7.2011 ''Për krijimin e IGJEO-it'' (shkrirja e institucioneve të mëparshme ekzistuese)	Mbledhja, verifikimi dhe shpërndarja e të dhënave meteorologjike (monitorimi i reshjeve) Mbledhja, verifikimi dhe shpërndarja e të dhënave hidrologjike (monitorimi i prurjes)	Publikimi i Buletinit Mujor të Klimës në faqen e internetit
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Ligji Nr.81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura" VKM Nr. 102, datë 4.2.2015 "Për ngritjen e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura", ndryshuar në 2016	Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura Zbatimi i Direktivës së BE-së për Shpendët dhe Habitatet	Publikimi i planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura, të gjitha llojet Mbajtja e regjistrit për zonat e mbrojtura - bazuar në GIS. Mbajtja e inventarit kombëtar të florës dhe faunës.
Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) Ligji Nr. 93/2015 ''Për turizmin'' VKM Nr. 569, datë 17.7.2019 "Për ngritjen e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit"	Mbrojtja dhe zhvillimi i mjedisit të qëndrueshëm në bregdet Monitorimi dhe kontrolli i aktiviteteve të paligjshme turistike në bregdet (plazhet)	Mbajtja e inventarit kombëtar të bregdetit Monitorimi i zbatimit të instrumenteve të planifikimit të territorit

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit Ligji Nr.107/2014 "Për zhvillimin dhe planifikimin e territorit" VKM Nr. 427, datë 8.6.2016 "Për ngritjen e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit"	Përgatitja e planeve të menaxhimit të territorit në mënyrë të koordinuar - përmes qeverive vendore. Përgatitja e planeve të integruara tematike (përfshi infrastrukturën, përmbytjet, ujërat, bujqësinë, zhvillimin urban etj.)	Publikimi i Planeve Kombëtare të Zhvillimit Koordinimi i përgatitjes së planeve të menaxhimit të territorit nga qeveritë vendore Publikimi i Planit të Integruar Ndërsektorial të Bregdetit, bazuar në GIS Publikimi i Planit të Integruar Ndërsektorial të Bregdetit për Rajonin Tiranë-Durrës, bazuar në GIS (përfshi bashkitë Tiranë, Durrës, Kamëz, Vorë, Shijak dhe Krujë). Mbajtja e Bazës së të Dhënave për Planifikimin e Integruar.
Shërbimi Shqiptar Gjeologjik (ShGjSh) Ligji Nr.111/ 2015, datë 15.10.2015 ''Për Shërbimit Gjeologjik Shqiptar''	Studimi dhe monitorimi i ujërave nëntokësore, akuiferëve, shtresave gjeologjike, hidrogjeologjisë.	Publikimi i raporteve për cilësinë e ujërave nëntokësore Mbajtja e bazës së të dhënave bazuar në GIS për gjeologjinë, hidrogjeologjinë dhe akuiferët nëntokësorë Anëtar i EuroGeoSurveys, që prej 2007-s
Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) Ligji Nr. Nr. 7/2017 ''Për përdorimin e burimeve të rinovueshme'' VKM Nr. 547, datë 9.8.2006 ''Për krijimin e AKBN-së'', ndryshuar në 5017	Mbajtja e bazës së të dhënave kombëtare për përdorimin/kapacitetin e sektorit energjetik. Monitorimi dhe inspektimi i sektorit energjetik, përfshi hidrokarburet, vajrat dhe të gjitha burimet e tjera natyrore. Përgatitja e planit kombëtar të veprimit për përdorimin e burimeve të rinovueshme për prodhimin e energjisë, çdo dy vjet. Monitorimi i hidrocentraleve. Analiza e mineraleve.	Publikimi i buletinit për potencialet/investimet hidroenergjetike në vend. Mirëmbajtja e sistemit të bazuar në GIS për energjinë.
Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) Ligji Nr. Nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për ujësjellës-kanalizimet", ndryshuar me ligjin nr. 9915, datë 2008. (është përgatitur projektligji i ri, por nuk është miratuar ende). VKM Nr.431, datë 11.7.2018 ''Për krijimin e AKUM-it''.	Zbatimi i politikës dhe strategjisë për ujësjellës-kanalizimet (Masterplani për UK-në dhe Mbetjet). Trajtimi i ujërave të ndotura. Planifikimi i infrastrukturës për mbetjet. Planifikimi i nevojave për investime në furnizim me ujë/trajtimin e ujërave të ndotura dhe menaxhimin e mbetjeve.	Mirëmbajtja e platformës kombëtare të GIS-it për asetet e ujësjellës-kanalizimeve. Publikimi i raporteve/statistikave për performancën e shoqërive UK.

Drejtoritë Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit. Ligji Nr. 24/2017 ‘’Për ujitjen dhe kullimin” VKM Nr. 437, datë 17.5.2017 “Për ngritjen e 4 drejtorive rajonale për ujitjen dhe kullimin”	4 drejtori rajonale të ngritura: Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë. Inventari i infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet. Planifikimi i nevojave/kërkesës për ujë në sektorin e ujitjes. Planifikimi i ndërhyrjeve rehabilituese në infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet.	Mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet.
Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP) Ligji nr. 5/2016 i datës 04.02.2016 “Për shpalljen e moratoriumit për pyjet” VKM Nr. 570, datë 17.7.2019 ‘’Për krijimin e AKP-së’’. Urdhri Nr. 24, datë 03.02.2020 ‘’Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve” Ligji Nr. 57/2020 ‘’Për Pyjet” dt.30/04/2020	Përgatitja e inventarit për pyjet. Përgatitja e hartave të bazuara në GIS. Zbatimi i programit të monitorimit vjetor për pyjet, biodiversitetin, habitatet etj. Monitorimi/kontrolli/inspektimi	Mirëmbajtja e sistemit të integruar për pyjet (regjistri, baza e të dhënave, sistemi GIS). Ngre dhe mirëmban Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor. Harton metodologjinë për inventarizimin e pyjeve, organizimin dhe drejtimin e punës në nivel kombëtar. Publikimi i raporteve për statusin e pyjeve dhe të dhëna/informacione të tjera përkatëse.
Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile (ish-Drejtoria e Përgjithshme për Emergjencat Civile) Ligji Nr. 45/ 2019, datë 18.7.2019 ‘’Për mbrojtjen civile’’	Përgatitja e strategjisë kombëtare për zvogëlimin e risqeve nga fatkeqësitë natyrore. Përgatitja e planit kombëtar për emergjencat civile. Ndërhyrjet në infrastrukturë në zonat e dëmtuara.	Mbajtja e bazës së të dhënave për humbjet dhe dëmet. Ngritja e Fondit të Solidaritetit.
Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) Ligji Nr.72/2012, datë 28.6.2012 ‘’Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës shtetërore për informacionin gjeohapësinor”	Zbatimi i kërkesave të Direktivës INSPIRE Përgatitja e standardeve kombëtare për informacionin gjeohapësinor. Përgatitja e hartave tematike, në sistemin GIS	Përgatitja e të gjitha hartave të tipologjisë/sektorit në nivel vendor/rajonal/kombëtar. Mirëmbajtja e sistemit kombëtar GIS për të gjitha llojet e informacionit. Mirëmbajtja e Gjeoportalit Kombëtar (faqes së internetit) me informacion tematik, vënë në dispozicion të publikut
Instituti i Shëndetit Publik Ligji Nr. 10 138, , datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik’’ VKM nr. 379, datë 25.5.2016 për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”	Vlerësimi cilësor i ujit të pijshëm (analiza e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe impiantet e trajtimit të ujërave) Monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm Analiza e të dhënave të monitorimit të cilësisë së ujit të pijshëm të kryer nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetsor	Publikimi i raporteve për çështjet/gjendjen shëndetësore. Publikimi i revistës mjekësore shëndetësore. Publikimi i buletinit shëndetësor në faqen e internetit. Publikimi në faqen e internetit i Raportit Vjetor të Cilësisë së Ujit të Pijshëm.

Harta1-1 – Shtrirja e Basenit të Lumit Ishëm



1.5 Struktura e Përgjithshme e Kuadrit të PMBU-së dhe Dokumentacionit

1.5.1 Komponentët Parësorë

Sipas kontekstit të Direktivës Kuadër të Ujit (DKU), Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor (PMBU) duhet të paraqesë në mënyrë të detajuar se si do të përmbushen objektivat mjedisore të basenit ujor (objektivat për statusin ekologjik, statusin sasior, statusin kimik dhe të zonës së mbrojtur) brenda afatit të përcaktuar kohor. Për më tepër :

- Masat për mbrojtjen e cilësisë dhe sasisë së të gjitha burimeve ujore, përfshi edhe ekologjinë ujore dhe habitatet.
- Masat për mbrojtjen e burimeve ujore që përdoren për ujë të pijshëm, qofshin nëntokësore, apo sipërfaqësore.
- Masat për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të burimeve ujore për sa i përket nevojave mjedisore dhe ekonomike.
- Masat për mbrojtjen e ujërave të larjes dhe ujërave të tjera me rëndësi ekonomike.

Këto objektiva duhen përfshirë për çdo basen ujor. Në përgjithësi, programet e masave ndahen në:

i) "Masa bazë" që përfshijnë kërkesat kyç të përputhshmërisë që parashtrohen në disa Direktiva të BE-së, si në Pjesën A, Shtojcën VI të DKU-së;
ii) "Masat plotësuese" që lihen në diskrecionin e AMBU-së, sipas nevojës, për arritjen e objektivave mjedisore, të parashtruara në Pjesën A, Shtojcën VI të DKU-së.

Paralelisht, duhet kryer edhe analiza e detajuar ekonomike e përdorimit të ujit brenda basenit ujor. Vendosja e kostos së duhur dhe rikuperimi i kostove të ujit shërbejnë si stimuj për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, duke ndihmuar kështu në arritjen e objektivave mjedisore në kuadër të Direktivës. Për më tepër, analiza ekonomike lehtëson diskutimin racional për efikasitetin e kostove të masave të ndryshme të renditura më lart.

1.5.2 Komponentët Dytësorë

Në nivel baseni ujor , menaxhimi i integruar i burimeve ujore i bazuar në praktikat më të mira dhe gjithëpërfshirëse, duhet parë nga një kënd më i gjerë nga sa parashtrohet në pikën 1.5.1 më lart. Formulimi i DKU-së i referohet shumë pak herë në mënyrë të shprehur menaxhimit të burimeve ujore, menaxhimit të përmbytjeve, menaxhimit të thatësirave dhe menaxhimit të bregdetit.

Këto veprimtari mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme te masat e parashikuara në 1.5.1, dhe brenda strategjive ose planeve plotësuese shtesë që janë parashikuar (menaxhimi i burimeve ujore, risqeve nga përmbytjet dhe thatësirat), këto strategji sektoriale duhet të raportojnë në mënyrë të veçantë për ndikimin e këtyre strategjive te objektivat mjedisore të basenit ujor dhe statusi i trupit ujor, kur është e mundur.

Por, ato kërkojnë edhe plane dhe/ose strategji të veçanta të rëndësishme dhe komplekse nga pikëpamja teknike, gjë që shkon përtej fushëveprimit të ngushtë të "cilësisë së ujit" që parashikohet në DKU.

Në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, kuadri i PMBU-së për Shqipërinë parashikon strategji dhe/ose plane plotësuese shtesë të koordinuara me, por të ndryshme nga dokumenti bërthamë i PMBU-së (masat në 1.5.1.). Në mënyrë të veçantë, parashikohet kur shihet e nevojshme:

- Plani ose Strategjia për Menaxhimin e Burimeve Ujore;
- Plani ose Strategjia për Menaxhimin e Rrezik nga Përmbytjet;
- Plani ose Strategjia për Menaxhimin e Rrezik nga Thatësirat;
- Plani ose Strategjia për Menaxhimin e Zonave Bregdetare;
- Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për propozimet e PMBU-së.

Përmbajtja dhe objektivat e këtyre strategjive mbështetëse shpjegohen më tej në Kapitullin 9. Në nënseksionin përkatës qartësohet nëse këto strategji dhe plane nuk janë hartuar ende (ose nuk gjejnë zbatim) për basenin ujor në fjalë.

Për ta përmbledhur, të gjitha autoritetet rregullatore, kompetente, por dhe operatorët që kontribuojnë në çdonjërën prej strategjive dhe/ose planeve të mësipërme duhet të kuptojnë se objektivat e përgjithshme mjedisore të parashtruara në nenin 25 të LMIBU-së dhe nenin 4 të DKU-së shërbejnë si parime paraprake udhëzuese për përputhshmërinë mjedisore të këtyre strategjive plotësuese. Këto strategji duhet të marrin parasysh dhe të koordinohen me objektivat mjedisore të përcaktuara në PMBU, ose të jenë plotësisht në përputhje me kërkesat e rasteve përjashtimore të parashtruara në nenin 4(7) të DKU-së.

1.5.3 Elementet Mbështetëse

Legjislacioni kombëtar parësor dhe Direktivat e BE-së nuk mund të ofrojnë udhëzime të mjaftueshme lidhur me mënyrën se si duhen përgatitur Planet e Menaxhimit të Basenit Ujor. Prandaj, mund të merren në konsideratë procedurat apo problematikat teknike specifike parashikuar me dispozita në legjislacion dytësor, në Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM 1015/2020) apo Procedura Teknike Standarde (PTS) të përgatitura nga AMBU, por edhe politikat, evidencat dhe procedurat mbështetëse të ofruara në Strategjinë e BE-së për Zbatim të Përbashkët[11]. Praktikat më të mira ndërkombëtare janë gjithashtu shumë të rëndësishme.

Këto elemente mbështetëse janë të shumta në numër, ndaj në Tabelën 1-2 paraqitet një përmbledhje e dokumenteve më relevante.

1.5.4 Ilustrimi i Kuadrit të Raportimit të PMBU-së

Tabloja ilustruese e kuadrit të PMBU-së në Shqipëri, që shërben si format model për të gjitha PMBU-të e ardhshme, paraqitet në Tabelën 1-3.

https://ec.europa.eu/environment/water/water-framework/objectives/implementation_en.htm

Tabela 1-2 – Elementet Mbështetëse të Kuadrit të PMBU-së

DIREKTIVAT PARËSORE LIDHUR ME DIREKTIVËN KUADËR TË UJIT	
Direktiva 2000/60/KE	Ngritja e kuadrit për veprim komunitar në fushën e politikave për burimet ujore
Direktiva 2006/118/KE;	Për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe degradimi
Direktiva 2013/39/BE	Ndryshimi i Direktivave 2000/60/KE dhe 2008/105/KE lidhur me substancat prioritare në fushën e politikës së ujit
Direktiva (BE) 2020/2184	Për cilësinë e ujit për konsum njerëzor
Direktiva 91/676/KEE	Për mbrojtjen e burimeve ujore ndaj ndotjes së shkaktuar nga nitratet që vijnë nga burimet bujqësore
Direktiva 2006/7/KE	Për menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes
Direktiva 2010/75/EU	Për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i ndotjes së integruar)
Direktiva 2001/42/KE	Për vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe programeve të caktuara në mjedis
Direktiva 91/271/KEE	Për trajtimin e ujërave të ndotura urbane
Direktiva 97/62/KE;	Për konservimin e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër.
DOKUMENTET UDHËZUESE PARËSORE TË STRATEGJISË SË PËRBASHKËT TË ZBATIMIT TË DKU-SË	
Dokumenti Udhëzues 2	Identifikimi i Trupave Ujorë
Dokumenti Udhëzues 3	Analiza e Presioneve dhe Ndikimeve
Dokumenti Udhëzues 4	Identifikimi dhe Përcaktimi i Trupave Ujorë Tepër të Modifikuar
Dokumenti Udhëzues 7	Monitorimi sipas Direktivës Kuadër të Ujit
Dokumenti Udhëzues 13	Qasja e përgjithshme kundrejt klasifikimit të statusit dhe potencialit ekologjik
Dokumenti Udhëzues 19	Udhëzues për Monitorimin Kimik të Ujërave Sipërfaqësore në kuadër të Direktivës Kuadër të Ujit
Dokumenti Udhëzues 27	Orientime teknike për standardet cilësore mjedisore
Dokumenti Udhëzues 31	Rrjedhat ekologjike në zbatimin e Direktivës Kuadër të Ujit
Dokumenti Udhëzues 34	Për zbatimin e bilanceve ujore për të mbështetur zbatimin e DKU-së
Dokumenti Udhëzues 35	Udhëzues për Raportimin mbi Direktivën Kuadër të Ujit 2016 – 6.0.6

QEVERIA SHQIPTARE – AKTET LIGJORE	
Ligji Nr. 111/2012	Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore
Ligji Nr. 431/2011	Për Mbrojtjen e Mjedisit
Ligji Nr. 44/2015	Për procedurat administrative
Ligji Nr. 81/2017	Për Zonat e Mbrojtura
Ligji Nr. 93/2015	Për turizmin
Ligji Nr. 107/2014	Agjencia për Zhvillimin dhe Planifikimin e Territorit
Ligji Nr. 111/2015	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
Ligji Nr. 7/2017	Për përdorimin e burimeve të rinovueshme
Ligji Nr. 102/1996	Për ujësjellës-kanalizimet
Ligji Nr. 24/2017	Për ujitjen dhe kullimin
Ligji Nr.90/2012	Për administratën publike
Ligji Nr. 45/2019	Për mbrojtjen civile
Ligji 72/2012	Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës shtetërore për informacionin gjeohapësinor


Ligji Nr. 138/2009	Për shëndetin publik
QEVERIA SHQIPTARE - VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE	
VKM Nr. 21/2018	Për krijimin e AMBU-së
VKM Nr. 1015/2020	Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjive Kombëtare të Ujit, Planeve të Menaxhimit të Rajoneve të Baseneve ujore dhe Planeve për Menaxhimin e Riskut nga Përmbytjet
VKM nr.568/2019	Për krijimin e AKM-së
VKM nr.490/2011	Për krijimin e IGJEO-it
VKM nr.102/2015	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura
VKM nr. 27/2016	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit
VKM nr. 47/2006	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore
VKM nr.431/2018	Për krijimin e AKUM-it
VKM nr.437/2017	Për krijimin e 4 drejtorive rajonale për ujitjen dhe kullimin
VKM nr.570/2019	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve


Tabela 1-3 – Ilustrim i strukturës së Kuadrit Raportues të PMBU-së për Shqipërinë

Faza e Fillimit dhe Konsultimit

Dokumenti	Dokumenti
Deklarata e Konsultimit	Vështrim i Përgjithshëm i Problematikave Kryesore të Menaxhimit të Burimeve Ujore

Plani i Menaxhimit të Basenit ujor – Dokumenti Themelor (nga versioni draft në përfundimtar)





Shtojcat

Shtojca 1 - Hidrologjia

Shtojca 2 – GIS

Shtojca 3 –Dataset

Shtojca 4 – Presionet

Shtojca 5 –Hidrobiologji

.....

Shtojca 11 – PiM

Shtojca 12 - Trajnimet

Hartëzimi Teknik



Planet dhe Strategjitë Mbështetëse

Dokumenti	Dokumenti	Dokumenti	Dokumenti	Dokumenti
Analiza Ekonomike	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor	Burimet Ujore dhe Strategjia e Nxjerrjes së Ujit	Strategjia e Rrezikut nga Përmbytjet	Strategjia e Rrezikut nga Thatësirat

2 Masat e Konsultimit me Ekspertët dhe Publikun

2.1 Konteksti Ligjor

Një prej kërkesave më të gjera të Direktivës Kuadër të Ujit të BE-së është të promovojë pjesëmarrjen aktive të publikut dhe palëve të tjera të interesit ("palëve të interesuara") në hartimin, rishikimin dhe përditësimin e Planeve të Menaxhimit të Basenit Ujor[12].

2.1.1 Shqipëri

Dispozitat dhe procedurat e përgjithshme lidhur me konsultimin publik për problematikat e menaxhimit të burimeve ujore janë transpozuar në LMIBU [13] dhe ligjin për konsultimin publik[14]. VKM-ja Nr.1015, datë 16.12.2020 "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjive Kombëtare të Ujit, Planeve të Menaxhimit të Rajonit të Basenit Ujor dhe Planeve të Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet" përmban disa dispozita për të siguruar ndërmarrjen e një serie masash për konsultim publik dhe për pasojë, ndryshimesh në plan (në përafrim me DKU-në, Shtojca VII).

2.1.2 Bashkimi Evropian

Sipas praktikës më të mirë të Bashkimit Evropian, marrëdhëniet me palët e interesit duhen rregulluar mbi katër parime kryesore [15]:

- Pjesëmarrja: miratimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse duke zhvilluar konsultime sa më të gjera që të jetë e mundur;
- Transparenca dhe informimi: procesi i konsultimit dhe mënyra se si ndikon ai në vendimmarrje duhet të jenë transparente për palët e përfshira dhe publikun e gjerë;
- Efikasiteti: konsultohuni atëherë kur pikëpamjet e palëve të interesit mund të nxisin ndryshime, duke respektuar proporcionalitetin dhe kufizimet e veçanta;
- Koherenca: siguroni konsistencën e proceseve të konsultimit përgjatë të gjitha grupeve, sektorëve dhe shërbimeve, si dhe vlerësimin, rishikimin dhe kontrollin e duhur të cilësisë.

Për hartimin e PMBU-ve, DKU-ja përcakton qartë në nenin 14 rendin e hapave të konsultimit:

1. Deklarata e Masave Konsultuese, që përfshin kalendarin, programin e punës, listën e palëve të interesit që do të konsultohen dhe metodat e përzgjedhura, publikuar në PMBU tre vjet përpara fillimit të planit të propozuar.
2. Përmbledhja e Çështjeve të Rëndësishme të Menaxhimit të Ujërave të identifikuara nga AMBU, publikuar dy vjet përpara fillimit të planit të propozuar.
3. Draft Plani i Menaxhimit të Baseneve Ujore, publikuar një vit përpara fillimit të planit të propozuar.

Në çdo rast, duhet lënë në dispozicion një periudhë konsultimi 6 mujore për të mundësuar përfshirjen aktive të grupeve të interesit. Këto kërkesa minimale nuk i përjashtojnë konsultimet e tjera të posaçme me grupet e ekspertëve apo operatorë të rëndësishëm, me kusht që këto konsultime të jenë të regjistruara në mënyrë transparente.

[12]Direktiva Kuadër e Ujit, Neni 14, Shtojca VII (9)

Qeveria Shqiptare, Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, Kreu XVII, Neni 91.

Qeveria Shqiptare, Ligji për Konsultimin Publik, Neni 15 dhe Neni 17.


[15]Komisioni Evropian– Udhëzime për Rregullim më të Mirë, SWD (2017) 350, 2017

2.2 Masat Kryesore të Konsultimit për Basenin ujor të Ishmit

2.2.1 Deklarata e Konsultimit

Deklarata e Konsultimit për Planin e Menaxhimit të Basenit Ujor u publikua nga AMBU në tetor të 2019-s dhe u postua në faqen e internetit të Agjencisë për t'u vënë në dispozicion të publikut[16]. Për shkak të kufizimeve në burime dhe në kapacitete, ishte e pamundur që kjo Deklaratë të publikohej në përputhje me rregullin tre vjeçar (synimi ishte janari i 2019-s).

Figura 2-1 –Deklarata e Masave të Konsultimit



2.2.2 Përmbledhja e Çështjeve të Rëndësishme të Menaxhimit të Ujërave (PCRMU)

Dokumenti u publikua në faqen e internetit të AMBU-së në maj të 2020-s (synimi ishte Janari 2020). Për shkak të kufizimeve në burime e kapacitete, si dhe pandemisë së COVID-19, ky Dokument nuk u arrit të publikohej në përputhje me rregullin tre vjeçar (synimi ishte janari i 2020-s).

Hartimi i Dokumentit u nda në dy faza:

i) drafti iu shpërnda për komente disa institucioneve ("Grupi Ekspert"), për t'u siguruar që përmbajtja e PCRMU-së t'i përfaqësojë si duhet çështjet kryesore që prekin basenin ujor. Lista e kontribuesve përmblidhet në Tabelen 2-2, referuar Shtojcës Teknike XII.

ii) PCRMU-ja përfundimtare u publikua në faqen e AMBU-së në maj të 2020-s, për konsultime në shkallë të gjerë.

PCRMU-ja nuk është dokument teknik, por shërben për t'i paraqitur publikut të gjerë dhe palëve të tjera të interesit panoramën e përgjithshme të mangësive dhe problemeve kryesore që lidhen me ujërat, të cilat duhen trajtuar për të mbrojtur ekosistemet dhe burimet e çmuara ujore, si dhe për të siguruar cilësinë dhe sasinë e qëndrueshme të burimeve ujore në plan afatgjatë.

PCRMU-ja duhet të jetë po aq informuese sa të nxisë dhënien e përgjigjeve dhe reagimeve nga një larmi palësh të interesuara. PCRMU-ja është strukturuar sipas disa temave lehtësisht të dallueshme, përmbledhur në Tabela 2-1. Në këtë dokument, AMBU sugjeron masat e mundshme menaxheriale dhe operacionale për zbutjen e praktikave të paqëndrueshme dhe dëmtuese të përdorimit të burimeve ujore.

Komentet gjatë konsultimit dhe përmbledhja se si këto pikëpamje janë marrë në konsideratë në Programin e Masave në PMBU, paraqiten në Shtojcën Teknike XII.

2.2.3 Draft Plani i Menaxhimit të Basenit ujor

Raporti i draft-it final të PMBU-së u publikua në faqen e AMBU-së në prill 2022. Periudha e konsultimit do të zgjatë 6-muaj. Komentet gjatë procesit të konsultimit dhe përmbledhja e këtyre pikëpamjeve do të merren parasysh edhe në Programin e Masave, e cila paraqitet në Shtojcën Teknike XII të PMBU-së.

2.2.4 Takime me publikun, Fushata Prezantimi dhe Trajnime

Përgatitja e PMBU-së kërkon një seri hapash të identifikuara dhe veprimtaritë në formë workshop-i/trajnimi strukturohen sipas këtyre hapave. Hapat janë këto:

- Fillimi i procesit të PMBU-së
- Karakterizimi

[16] http://www.ambu.gov.al/wp-content/uploads/2019/10/190521-VS-Draft-Statement-of-Proposed-Consultation-Measures-for-the-Ishem.pdf

- Vlerësimi i Presionit-Ndikimit
- Zonat e mbrojtura
- Vlerësimi i monitorimit
- Objektivat mjedisore
- Vlerësimi ekonomik
- Programi i Masave
- Plani i Menaxhimit të Baseneve Ujore
- Konsultimi

Këto hapa mbështeten në DKU-në e BE-së dhe në Strategjinë e BE-së për Zbatimin e Përbashkët të DKU-së, që shoqërohen nga një seri dokumentesh udhëzuese.

Krahas moduleve që lidhen drejtpërdrejt me procesin e PMBU-së, janë zhvilluar edhe disa module për sfondin e përgjithshëm, transpozimin ligjor dhe zbatimin pas miratimit të PMBU-së.

Çdo modul përmban disa aktivitete (trajnime, workshop-e, shembuj praktikë, punë në terren, trajnim në vendin e punës) në varësi të modulit. Zbatimi i të gjitha aktiviteteve të parashikuara mund të zgjasë disa muaj, pasi është në vijim të procesit të punës lidhur me progresin e PMBU-së.

Produkti i progresit të PMBU-së përfshin 10 seksione kyç.

Çdo modul workshop-i/trajnimi lidhet dhe mbështet drejtpërdrejt të paktën një seksion të PMBU-së, madje me raste mbështet më tepër se një.

Pjesëmarrja në veprimtari të ndryshme workshop-i/trajnimi duhet të përfshijë të gjitha institucionet e përfshira në përgatitjen e PMBU-së, si AMBU, apo institucione të tjera të përfshira drejtpërdrejt ose tërthorazi, si Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM).

Në këtë kuadër është miratuar Urdhëri i Kryeministrit Nr. 32 datë 01.03.2021 për "Ngritjen dhe funksionimin e grupeve ndër-institucionale të punës për përgatitjen e planeve të menaxhimit të baseneve ujore Mat, Ishëm dhe Erzen". Me qëllim zhvillimin e një diskutimi të hapur mbi hapat e ndjekur dhe në funksion të përgatitjes së planeve të menaxhimit të baseneve ujore të sipërpermendura, vijimi i punës deri në hartimin e projekt planeve, AMBU së bashku me ekspertët kombëtare dhe ndërkombëtare të kontraktuar nga projekti "Mbështetja e BE-së për menaxhimin e integruar të ujit në Shqipëri" kanë zhvilluar gjatë vitit 2021 4 (katër) takime me përfaqësuesit e GNP-së.

Janë organizuar dhe drejtuar mbledhjet e takimeve të zhvilluara me përfaqësuesit e zgjedhur nga institucionet e përmendura në pikën numër 4 të Urdhrit të Kryeministrit. Institucionet e përfaqësuara në këtë grup pune janë Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Agjencia Kombëtarë e Zonave të Mbrojtura, Instituti i Shëndetit Publik, Instituti i Statistikave, Zyra e Administrimit e Basenit Ujor Mat, Ishëm, Erzen dhe Zyrat e Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura të Tiranës, Durrësit dhe Lezhës.

Mbledhjet e takimeve që janë zhvilluar përgjatë vitit 2021, kanë patur në fokus shpërndarjen e materialeve të draft-planeve për basenet Mat, Ishëm dhe Erzen tek përfaqësuesit e grupit për të marr komentet dhe kontributet e tyre për kapitujt e diskutuar. Këto materiale janë dërguar nëpërmjet postës elektronike dhe gjithashtu janë mbledhur edhe komentet e dhëna nga secili prej përfaqësuesve.

Janë realizuar 4 (katër) mbledhje, ku mbledhja e :

- Takimit të Parë është mbajtur në datën 28.5.2021;
- Takimit të Dytë është mbajtur në datën 23.6.2021;
- Takimit të Tretë është mbajtur në datën 23.7.2021;

- Takimit të Katërt është mbajtur në datën 27.9.2021.

Mbledhjet e takimeve janë mbajtur në formatin hibrid, me pjesëmarrje të kufizuar në numër personash në sallë dhe nëpërmjet platformave online, për të respektuar rregullat e vendosura nga Komiteti Teknik i Ekspertëve për shëndetin. Gjithashtu edhe për të lehtësuar mënyrën e përfshirjes së përfaqësuesve të grupit në çdo takim të mbajtur.

2.2.5 Plani Përfundimtar i Menaxhimit të Baseneve Ujore

Programi i Masave, i parashtruar në PMBU (Kapitulli 13) është produkti kryesor që synon arritjen e objektivave mjedisore në basenin ujor, sikurse përcaktohet në Kapitullin 3 të këtij dokumenti. PiM-ja duhet përfshirë brenda plani të periudhës 2024-2029 dhe në kuadër të legjislacionit kombëtar, masat duhen konsideruar si të detyrueshme me ligj për autoritetet e përcaktuara pas miratimit të PMBU.

Periudha e dytë e konsultimeve publike përfundoi në shtator 2022 dhe u shoqërua gjithashtu me procesin e hartimit të Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur takime me përfaqësues të grupit të punës ndërinstitucionale, me përfaqësues nga organizata të ndryshme joqeveritare dhe me Këshillin e Basenit Ujor. Drafti i planit u shpërnda për konsultim dhe mbledhje mendimesh në institucionet e linjës, duke ndjekur rrugën e procedurës institucionale.

Ka pasur edhe kontribute nga ekspertë të fushave të ndryshme, të fokusuara kryesisht në programin e masave. Këto ndryshime u pasqyruan në Planin përfundimtar të Menaxhimit të Basenit Ujor për lumin Ishëm.

Tabela 2-1 – Përmbledhja e Temave të Rëndësishme të Menaxhimit të Ujërave

TEMA KRYESORE	KOMENTAR PËR PRESIONET KYÇ, GJENDJEN OSE NDIKIMET
MJEDISI	**ÇËSHTJE TË MUNDSHME**
Ndryshimet Klimatike dhe Burimet Ujore	• Reduktimi i pritur prej -8% i sasisë së reshjeve deri në vitin 2025. • Reduktimi i pritur prej -20% i sasisë së reshjeve deri në vitin 2050. • Ndikimet e konsiderueshme të pritshme për disponueshmërinë e ujit për të gjitha përdorimet.
Sistemet e të dhënave hidrometeorologjike dhe monitorimit	• Mosfunksionimi i sistemit për monitorimin e ujërave sipërfaqësore që prej vitit 2000. • Mungesa e të dhënave të kohëve të fundit rreth ndryshimeve klimatike apo analizave të burimeve ujore për ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore.
Zonat e Mbrojtura dhe Ekosistemet Ujore	• Mospërcaktimi i kufijve dhe mungesa e mbrojtjes së burimeve të ujit të pijshëm. • Zonat e mbrojtjes natyrore nuk janë respektuar dhe shumë habitate të Natura 2000 nuk janë përcaktuar. • Të dhënat e disponueshme janë shumë të kufizuara; sistemi i monitorimit mund të mos përshtatet me qëllimin.
Përmbytjet dhe Thatësirat	• Nuk janë hartuar Plane për Menaxhimin e Riskut nga Përmbytjet. • Nuk janë hartuar Plane për Menaxhimin e Riskut nga Thatësirat.
Morfologjia dhe Vazhdimësia e Kanaleve dhe Fushave Lymore	• Nxjerrja e jashtëligjshme e zhavorrit dhe habitatet e shkatërruara. • Pengesat për vazhdimësinë e lumenjve për shkak të barazheve, digave dhe hidrocentraleve.
Rrjedhat Ekologjike	• Mospërcaktimi i qartë i prurjeve ekologjike për asnjërin nga lumenjtë; • Degradimi i konsiderueshëm i diversitetit të llojeve për shumë ekosisteme ujore.
PËRDORIMI I UJIT	**ÇËSHTJE TË MUNDSHME**
Përdorimi i Ujit, Nxjerrja e Ujit dhe Leja për Nxjerrje	• Përdorimi joeficient i ujit nga bashkitë, me humbje reale prej +60% në sistemet efurnizimit me ujë. • Mungesa e metodologjive dhe udhesuesve per rikuperimin e plotë të kostove perdorimit dhe ndikimeve atyre mjedisor sa i perket uji të përdorimit të ujit ur nga Operatorët.
Shkarkimet e Ujit, Ndotja e Ujit dhe Leja për Shkarkim	• Mostrajtimi i ujërave të ndotura urbane në Tiranë, Kamëz apo zonat me intensitetë të lartë popullsie dhe aktivitet industrial. • Degradimi dhe ndotja e lartë e lumenjve kryesorë nga shkarkimet e pa trajtuara dhe pa u pajisur me leje për këto aktivitete. • Mosarritja e mundshme e standardeve të nevojshme të cilësisë së mjedisit nga lejet e shkarkimit .
Digat dhe hidrocentralet	• Ndërprerja e vazhdimësisë së ekosistemit dhe rrjedhave ujore nga digat dhe pritat.
Përdorimi, Mbrojtja dhe Monitorimi i Ujërave Nëntokësorë	• Nxjerrja e tepërt e pakontrolluar e ujërave nëntokësore. • Sistemi i monitorimit të cilësisë dhe sasisë së pamjaftueshme.. • Risk për intruzionin e ujërave detare në ujërat e ëmbla nëntokësore, si rezultat i mbishfrytëzimit.
MENAXHIMI I VIJËS BREGDETARE	**ÇËSHTJE TË MUNDSHME**
Cilësia e ujërave bregdetare, ujërat e plazheve, habitatet	• Rreziku ndaj shëndetit njerëzor për shkak të ndotjes së ujërave sipërfaqësore të ndotur që shkarkohen në zonat bregdetare. • Degradimi i habitateve bregdetare për shkak të depozitimit të mbetjeve të ngurta.

Menaxhimi i bregdetit, risku i përmbytjeve dhe erozionit	• Parashikimet për ngritjen e nivelit të detit në masën 0,2 - 0,3 m deri në vitin 2050 flasin për risk të konsiderueshëm nga përmbytjet detare dhe uljes së aftësisë shkarkuese të lumenjve në deltat e tyre. • Rritja e nivelit të detit mund të rrisë trysninë e intruzionit detar në ujëra nëntokësore.

3 Objektivat Mjedisore për Basenin Ujor

3.1 Vështrim i përgjithshëm

Të gjitha PMBU-të në vendet e BE-së kanë si qëllim kryesor përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit ujor. Kjo arrihet nëpërmjet një seri masash, të cilat bëjnë të mundur që të gjitha burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore) të kenë cilësi dhe sasi të kënaqshme për të përmbushur nevojat mjedisore dhe ekonomike. Si cilësia, ashtu edhe sasia kanë karakteristika komplekse që shpjegohen më poshtë.

Ky kapitull shpjegon përkufizimet dhe parimet kryesore përmes së cilave vlerësohet cilësia dhe sasia e burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, dhe është i vetmi kapitull në këtë raport që nuk është specifik vetëm për basenin e lumit Ishëm. Megjithatë, konceptet dhe procedurat e parashtruara më poshtë diktojnë edhe strategjinë për mbrojtjen e mjedisit ujor të basenit të lumit Ishëm përmes a) politikave mjedisore të përgjithshme (Kapitulli 12) dhe b) masave mbrojtëse ose rehabilituese për trupa ujorë të veçantë (Kapitulli 13).

3.1.1 Shqipëri

Shqipëria spikat për diversitetin e saj të pasur biologjik dhe natyror. Diversiteti i ekosistemeve dhe habitateve mundëson jetën e një larmie bimësh dhe kafshësh. Nga 3,200 llojet e identifikuara të bimëve vaskulare, 27 janë endemike dhe 160 nënendemike. Ekosistemet lumore dhe ligatinat e Shqipërisë janë të pasura në tipologji habitatesh, si dhe bashkësi dhe lloje kafshësh e bimësh. Ato janë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë natyrore jo vetëm për vetë vendin, por edhe për rajonin e Mesdheut në përgjithësi.

Objektivat mjedisore për trupat ujorë sipërfaqësorë, nëntokësorë, si dhe për zonat e mbrojtura vendosen me qëllim parandalimin e dëmtimit të trupave ujorë, si dhe mbrojtjen, përmirësimin dhe rehabilitimin e statusit të të gjithë trupave ujorë, si sipërfaqësorë, ashtu edhe nëntokësorë". LMIBU, Neni 25 (1).

Kërkesat e LMIBU-t të miratuar nga QSh-ja janë në përputhje me legjislacionin e BE-së.

3.1.2 Bashkimi Evropian

Neni 4 i DKU-së shpjegon konceptin bazë të DKU-së dhe qëllimin specifik të PMBU-ve, që është zbatimi i masave të përshtatshme për të:

- Parandaluar degradimin e statusit të të gjithë trupave ujorë sipërfaqësorë dhe arritur statusin ose potencialin e mirë ekologjik;
- Reduktuar në mënyrë progresive ndotjen nga substancat prioritare dhe ndotësit specifikë të baseneve ujore, për të arritur statusin e mirë kimik për ujërat sipërfaqësore;
- Parandaluar ose kufizuar shkarkimin e ndotësve në ujëra nëntokësore dhe përmirësuar tendencat negative;
- Parandaluar degradimin e statusit të të gjithë trupave ujorë nëntokësorë, të përcaktuar nga statusi sasior dhe kimik, dhe për të arritur statusin e mirë kimik për të gjithë trupat ujorë nëntokësorë;
- Siguruar ekuilibrin e qëndrueshëm midis nxjerrjeve të ujërave nëntokësore dhe rimbushjes vjetore.

3.2 Koncepti i Statusit të Trupit Ujor

3.2.1 Statusi Ekologjik

Statusi ekologjik është vlerësimi i cilësisë së strukturës dhe funksionimit të ekosistemeve të ujore sipërfaqësore. Tregon ndikimin e presioneve (p.sh nxjerrjeve të ujit, ndotjes ose degradimit të habitatit) për elementet e identifikuar të cilësisë.

Statusi ekologjik për lumenjtë, liqenet, ujërat kalimtare dhe ujërat bregdetare përcaktohet në bazë të elementeve të cilësisë biologjike (ECB) (fitoplankton, makrofite, fitobentët, fauna bentike jovertebrore dhe peshqit). Elementet mbështetëse fiziko-kimike janë gjendja e oksigjenit, temperatura, lëndët ushqyese, tejdukshmëria, kripësia, ndotësit specifikë të basenit ujor (NSBU), si dhe substancat prioritare. Elementet e cilësisë hidromorfologjike janë regjimi i prurjeve, lidhja me ujërat nëntokësore, vazhdimësia e lumit dhe kushtet morfologjike (Figura 3-1). Nuk ka standarde europiane për statusin ekologjik; çdo Shtet Anëtar duhet të zhvillojë standardet e veta, specifike për llojin (shihni Seksionin 3.3).

3.2.2 Statusi Kimik

Legjislacioni i Bashkimit Evropian parashikon masa kundër ndotjes kimike të ujërave sipërfaqësore. Ka dy komponentë: a) përzgjedhja dhe rregullimi i substancave që përbëjnë shqetësim për mbarë BE-në (substancat prioritare, substancat prioritare të rrezikshme), b) përzgjedhja e substancave që përbëjnë shqetësim kombëtar ose vendor për Shtetet Anëtare (ndotësit specifikë për basenin ujor) që duhen kontrolluar në nivelin përkatës.

Për ujërat sipërfaqësore, statusi i mirë kimik do të thotë se përqëndrimi i substancave prioritare [17] nuk i tejkalon standardet e cilësisë mjedisore (SCM) të përcaktuara në Direktivën për Standardet e Cilësisë Mjedisore (DSCM) 2008/105/KE (ndryshuar me Direktivën për Substancat Prioritare 2013/39/EU). SCM-ja synon të mbrojë speciet ujore më të ndjeshme nga toksiciteti i drejtpërdrejtë dhe shëndetin e njerëzve. Standardet për ndotësit specifikë për basenin ujor (NSBU) përcaktohen nga autoriteti kompetent kombëtar. Në mënyrë që ujërat nëntokësore të arrijnë statusin e mirë kimik, duhet parandaluar hyrja e substancave të rrezikshme në ujërat nëntokësore dhe hyrja e të gjithë ndotësve të tjerë (p.sh nitratet) duhet të jetë nën nivelet e përcaktuara.

3.2.3 Statusi Sasior

Më parë, sasia e ujit është konsideruar kryesisht si element dytësor i statusit ekologjik në DKU, ndërsa tani, sasia e ujit, në aspektin e regjimit të prurjeve shihet si element parësor i statusit të mirë ekologjik[18,19].Veçanërisht për lumenjtë, duhet të kryhet një vlerësim specifik për të identifikuar "rregjimin e prurjes mjedisore" dhe për të vlerësuar shkallën e ndikimit të ndryshimit të rregjimit të prurjes të trupi ujor. Aktualisht në Shqipëri, nuk ka një metodologji e cila ndërthur faktorë të ndryshëm mjedisor dhe ekologjik të cilët lidhen me sasinë e nevojshme minimale në trupat ujor sipërfaqësor. Për ujërat nëntokësore, statusi sasior përcaktohet duke krahasuar normën e rimbushjeve vjetore të stokut të ujërave nëntokësore me konsumin e tyre. Nxjerrjet e ujit që e tejkalojnë normën e rimbushjeve qoftë edhe në plan afatshkurtër ndikojnë negativisht në nivelin e ujërave nëntokësore vendore, çka sjell pasoja për a) prurjet e ujërave sipërfaqësore dhe ekosistemet, b) disponueshmërinë e përdorimeve ekonomike të ujërave nëntokësorë në përgjithësi.

3.2.4 Nivelet e Statusit

Koncepti i statusit të trupit ujor është kyç për kuadrin ligjor mjedisor të LMIBU-së dhe DKU-së në përgjithësi, dhe PMBU-të në veçanti. Statusi shihet si koncept relativ që lidhet me "kushtet e referencës", të cilat janë gjithmonë specifike për llojin (seksioni 5.2.2). Kushtet e referencës (KR) nuk janë domosdoshmërisht të barasvlershme me kushtet e pashqetësuara, krejtësisht të qeta. Ato mund të marrin parasysh shqetësime shumë të vogla, çka do të thotë se mund të lejohen disa presione antropogjene, me kusht që të mos ketë fare ose të ketë efekte ekologjike shumë të vogla. KR-të përafrohen gjithmonë me statusin shumë të mirë ekologjik.

Zakonisht:

- Statusi shumë i mirë- -Nuk ka ose ka shumë pak ndryshime antropogjene të elementeve biologjike, fiziko-kimike dhe hidromorfologjike të trupit ujor
- Statusi i mirë - -Ka disa ndryshime të vogla në përbërjen dhe numrin e elementeve të cilësisë biologjike, ku kushtet fiziko-kimike dhe hidromorfologjike janë në përputhje me arritjen e cilësisë së mirë biologjike
- Statusi i moderuar - Ka devijime modeste të elementeve cilësore biologjike që lidhen me statusin shumë të mirë, ku kushtet fiziko-kimike dhe hidromorfologjike janë në përputhje me arritjen e cilësisë së mirë biologjike
- Statusi i dobët - -Ujërat paraqesin ndryshime të konsiderueshme në vlerat e elementeve të cilësisë biologjike
- Statusi i keq - -Ujërat paraqesin ndryshime të mëdha në vlerat e elementeve të cilësisë biologjike

[17] Komisioni Evropian – Direktiva Kuadër e Ujit, Neni 16, dhe Shtojca X zëvendësuar nga DSCM-ja, Shtojca II.

[18] Komisioni Evropian – Udhëzimi CIS Nr. 31 – Rrjedhat Ekologjike në zbatimin e DKU-së

[19] Komisioni Evropian - Rrjedhat Mjedisore si Mjet për Arritjen e Objektivave të DKU-së - Dokument Diskutimi, 2012

Për ujërat nëntokësore, statusi përcaktohet vetëm nga niveli më i ulët i statusit sasior dhe kimik, pra statusi është:

- 'i mirë' -
- ose 'i keq'-

Figura 3-1 Elementet Cilësore të Statusit Ekologjik të Trupave Ujorë




Figura 3-1 tregon komponentët e ndryshëm që lidhen me vlerësimin e statusit ekologjik në përgjithësi. Lista e përgjithshme e të gjithë elementeve të cilësisë paraqitet në Shtojcën Teknike III. Rezultatet e vlerësimit biologjik duhen shprehur duke përdorur shkallën numerike 0.00-1.00, që është "Norma e Cilësisë Ekologjike" (NCE). Vlera e NCE-së = 1.00 përfaqëson kushtet specifike të referencës për llojin (pra kushtet plotësisht natyrore). Vlerat afër 0.00 = Statusi i Keq Ekologjik (SKE).

Objektivi i NCE-së është të sigurojë krahasueshmërinë midis metodave të ndryshme të vlerësimit, pra të ofrojë një shkallë të përbashkët të cilësisë ekologjike midis baseneve ujore të ndryshme. Intervalet e NCE-së që paraqiten në Figura 3-1 shërbejnë vetëm për qëllime treguese dhe mund të ndryshojnë në varësi të ECB-së në proces vlerësimi.

Nxjerrja e ujit ndikon drejtpërdrejt në statusin ekologjik, qoftë edhe në nivel modest. Figura 3-1 tregon se nxjerrjet e përhershme ose për një kohë të gjatë të ujit në sasi > 30% të prurjes mesatare kanë shumë gjasa që ta kufizojnë elementin e cilësisë hidromorfologjike në arritjen e statusit të moderuar vetëm.[20] Për shkak të rëndësisë së regjimit të prurjeve në përgjithësi, ka shumë mundësi që statusi ekologjik i trupit ujor të klasifikohet si i moderuar.

3.3 Objektivat Mjedisore për Trupat Ujorë Sipërfaqësorë

Për të shënuar progres lidhur me përcaktimin e statusit të trupave ujorë individualë, statusi i tyre aktual duhet krahasuar me kushtet referencë specifike për llojin. Tipologjitë e trupave ujorë shpjegohen më në detaje në seksionin 5.2 dhe 6.2.

Për çdo lloj të trupave ujorë sipërfaqësorë, kushtet biologjike, hidromorfologjike dhe fiziko-kimike specifike për llojin duhen përcaktuar në mënyrë të tillë që të përfaqësojnë vlerat e elementeve të përcaktuara për atë lloj të trupit ujor sipërfaqësor me status shumë të mirë ekologjik[21]. Prandaj, "statusi" është një gjendje që lidhet me kushtet referencë, që në përgjithësi përkufizohet si trup ujor me "status shumë të mirë". Përcaktimi i kushteve biologjike të referencës për çdo trup ujor është çështje procedurash kombëtare, ndonëse janë përcaktuar disa kritere të standardeve të BE-së, veçanërisht lidhur me substancat prioritare të parashikuara në Direktivën 2013/39/KE [22].

[20] Komisioni Evropian – Udhëzimi CIS Nr. 31 – Rrjedhat Ekologjike në zbatimin e DKU-së

[21] Komisioni Evropian - Direktiva Kuadër e Ujit, Shtojca II, 1.3

22 Komisioni Evropian – Direktiva 2013/39/EU – Direktiva për Substancat Prioritare Mjedisore

3.3.1 Kushtet Referencë për Elementet e Cilësisë Biologjike

Në Evropë janë përdorur qasje të shumta për të vlerësuar kushtet cilësore biologjike të ujërave sipërfaqësore duke vlerësuar të dhënat taksonomike. Qasja e përgjithshme ishte që të përdorej përbërja (e përkufizuar si diversitet + numër i madh) e komunitetit të çdo zone për të përcaktuar kushtet e cilësisë së ujit. Disa makro invertebrorë kanë prirjen të jenë më tolerantë ndaj cilësisë së dobët të ujit si p.sh *Diptera* dhe klasa *Oligochaeta*. Organizma të tjerë, për shembull familjet *Ephemeroptera*, *Plecoptera* dhe *Trichoptera* janë më të ndjeshme ndaj ndotjes.

Në varësi të llojit të trupit ujor (shihni seksionin 5.2), taksonet e ndjeshme priten të jenë të pranishme dhe të shumta në numër vetëm në ato zona me "cilësi të mirë uji", në varësi të kushteve kombëtare specifike. Në mënyrë të ngjashme, në zonat e ndjeshme pritet të ketë më tepër prani dhe numër llojesh që i tolerojnë kushtet e cilësisë së dobët të ujit. Cilësia ekologjike shprehet si NCE, që tregon ngjashmëritë midis statusit aktual dhe KR-ve. Kështu, mund të nënkuptohet se nëse një prej elementeve të caktuara të cilësisë biologjike të statusit të trupit ujor p.sh cilësia fiziko-kimike, ndotësit specifikë dhe/ose hidro-morfologjia janë tejet negative, ECB-të priten të jenë më të ulët se NCE-ja.

KR-të dhe standardet e klasave të cilësisë më të ulët për ECB-të mund të shprehen si indeks, pra si Indeksi Biotik, BMWP, ASPT, EPT, etj. Megjithatë, standardet e këtyre indekseve për klasat e cilësisë ekologjike duhet të jenë specifike për llojin dhe ekorajonin. Kjo do të thotë se standardet e përdorura në vendet e tjera të BE-së nuk mund të përdoren si të tilla. Duke qenë se për trupat ujorë sipërfaqësorë në Shqipëri nuk ka thuajse asnjë të dhënë biologjike të disponueshme (të dhënat duhet të jenë të disponueshme për të gjitha llojet e ujërave dhe për çdo klasë cilësie brenda çdo lloji), në këtë moment nuk mund të jepet asnjë përshkrim për KR-të Biologjike të llojeve të trupave ujorë në Shqipëri. Një prej alternativave do të ishte të përdoreshin standardet e Greqisë (sepse Greqia ndodhet në të njëjtin Ekorajon me Shqipërinë; Ballkani Perëndimor Helenik), por as Greqi nuk ka standarde, për shkak të mungesës së të dhënave.

Metoda e preferuar për përcaktimin e metodës së vlerësimit biologjik të Shqipërisë është fillimisht kampionimi i shumë trupave ujorë (që mbulojnë të gjitha llojet dhe klasat e cilësisë brenda llojit) dhe më pas analizimi i të dhënave, duke përdorur teknikat e analizës multivariate si Analiza e Përputhshmërisë Kanonike (Detrendizuar). (Referim për më shumë informacion në Aneksin V për Hidrobiologjinë)

3.3.2 Kushtet Referencë për Elementet e Cilësisë së Përgjithshme Fiziko-kimike

Sikurse shpjegohet edhe në seksionet e mëparshme: elementet e cilësisë së përgjithshme fiziko-kimike mbështesin elementet e cilësisë hidrobiologjike. Koncepti i kushteve referencë specifike për llojin gjen zbatim edhe për elementet e cilësisë së përgjithshme fiziko-kimike. Për shembull, gjeologjia gëlqerore prek parametrat e cilësisë së ujit, si alkalinitetin dhe pH.

Ende nuk është e mundur që për elementet e cilësisë së përgjithshme fiziko-kimike të zbatojmë skemat e klasifikimit në përputhje me DKU-në për shkak të:

- mungesës së KR-ve dhe NCE-ve specifike për llojin për elementet e cilësisë hidrobiologjike;
- mungesës së të dhënave të monitorimit/terrenit për të mbështetur me prova kushtet referencë specifike për llojin të elementeve të cilësisë së përgjithshme fiziko-kimike.

Megjithatë, skema e klasifikimit që përdor AKM-ja për lumenjtë, është e përshtatshme për periudhën e ndërmjetme dhe i paraprin edhe përsosjes së kërkesave për elementet e cilësisë hidrobiologjike. Skema përfshihet në Tabela 3-1.

Tabela 3-1 Skema e klasifikimit të AKM-së për vlerësimin e parametrave fiziko-kimikë të lumenjve [23]

Parametri	Njësia	I Lartë	I Mirë	I Mesëm	I Ulët	I Keq
Oksigjeni i tretur	mg/l	>7	>6	>5	>4	<3
BOD_5	mg/l	<2	<3.5	<7	<18	>18
pH (acid)	-	-	>6.5	>6	-	-
pH (alkaliniteti)	-	-	<8.5	<9	-	-
NH_4	mg N/l	<0.05	<0.3	<0.6	<1.5	>1.5
NO_2	mg N/l	<0.01	<0.06	<0.12	<0.3	>0.3
NO_3	mg N/l	<0.8	<2	<4	<10	>10
PO_4	mg P/l	<0.05	<0.10	<0.2	0.5	>0.5
Totali P	mg P/l	<0.1	<0.20	<0.4	<1	>1

3.3.3 Kushtet referencë për substancat prioritare dhe disa ndotës të tjerë

Substancat prioritare dhe disa ndotës të tjerë të Direktivës 2013/39/BE përfshijnë edhe substanca sintetike (të bëra prej njeriut), edhe substanca josintetike. Me përkufizim, nuk ka KR natyrore për substancat sintetike. Substancat josintetike janë metalet e rënda dhe disa hidrokarbure aromatike policiklike (PAH). Direktiva 2013/39/BE përcakton sa më poshtë lidhur me kadmiumin (Cd), plumbin (Pb), mërkurin (Hg), nikelin (Ni):

> *Gjatë vlerësimit të rezultateve të monitorimit kundrejt NCE-ve përkatëse, Shtetet Anëtare duhet të marrin parasysh: (a) përqendrimin në kushte natyrore të metaleve dhe komponimeve të tyre kur këto përqendrime pengojnë përputhshmërinë me NCE-të përkatëse; (b) fortësinë, pH, karbonin organik të shpërbërë ose parametra të tjerë të cilësisë së ujit që prekin biodisponueshmërinë e metaleve dhe përqendrimet e biodisponueshme që përcaktohen nëpërmjet përdorimit të modelimit të përshtatshëm të biodisponueshmërisë.*

Duke marrë parasysh nxjerrjen e metaleve (të rënda) në Shqipëri, mund të pritet një rritje e caktuar e përqendrimeve natyrore (gjeogjenike) në rajone të ndryshme. Megjithatë, ka mungesë të të dhënave të monitorimit që mbështesin me prova KR-të specifike për llojin për substancat prioritare.

3.3.4 Kushtet Referencë për "Ndotësit e Tjerë Specifikë për Basenin Ujor"

Ndotësit specifikë sinstetikë dhe josintetikë që përmenden në DKU, Shtojcën V.1.1, janë:

- Ndotja nga të gjitha substancat prioritare që janë identifikuar se shkarkohen në trup ujor.
- Ndotja nga substanca të tjera që janë identifikuar se shkarkohen në trup ujor në sasi të konsiderueshme.

Ndërkohë, substancat prioritare janë bërë pjesë e "Substancave prioritare dhe disa ndotësve të tjerë të caktuar", përfshirë Direktivën 2013/39/BE, që përdoret për përcaktimin e statusit kimik.

Nuk ka asnjë listë të paracaktuar për "Ndotësit Specifikë", ndonëse Shtojca VII e DKU-së jep disa tregues ndotësish me interes (referuar në Aneksin V me tabelat me informacion). Ndërkohë, është vënë re se disa ndotës të përmendur në Shtojcën VIII të DKU-së janë përfshirë tashmë te "Substancat prioritare dhe ndotësit e tjerë të caktuar" dhe "Elementet e cilësisë së përgjithshme fiziko-kimike". Lista e "Ndotësve të tjerë specifikë" nuk është hartuar ende për basenet shqiptare. Vetëm BOD_5 dhe COD_{Cr} monitorohen në mënyrë rutinë nga AKM-ja. Megjithatë, këto të dhëna nuk janë të përshtatshme për përcaktimin e KR-ve specifike për llojin për BOD_5 dhe COD_{Cr}.

[23] BOD_5: kërkesa biokimike për oksigjen (pesë ditë); NH_4: amon; NO_2: nitrite; NO_3: nitrate; PO_4: ortofosfat; P-total: fosfori total Raport për Statusin Mjedisor 2015, Shtojcë e Rregulluar.docx (Environmental Status Report 2015, Corrected Annex); http://www.akm.gov.al/assets/rgjm-2015per-botim.rar

3.3.5 Kushtet Referencë për Prurjen Mjedisore


Identifikimi i saktë dhe respektimi i sasisë së prurjes mjedisore (prurja e nevojshme për të mbështetur funksionet e ekosistemit ujor përgjatë vitit) janë thelbësore për statusin e trupave ujorë. Legjislacioni kombëtar, procedurat teknike dhe/ose studime supozojnë në mënyrë krejtësisht të gabuar se ka vetëm një prurje minimale përgjatë gjithë vitit, e cila nëse lejohet të qëndrojë në trupin ujor, mjafton për të plotësuar nevojat ekologjike.

Sikurse tregohet në Figura 3-2, në fakt, prurja mjedisore është vijimësia përgjatë diapazonit të regjimit të prurjes (siç paraqitet në Kurbën e Qëndrueshmërisë së Prurjes, KQP). Për çdo tejkalim të prurjes (p.sh Q50), prurja mjedisore është e barasvlershme me rrjedhën e pashqetësuar (natyrore) të lumit (vija BUu). Ka shumë vlera të prurjes mjedisore, në varësi të pozicionit të KQP-së, dhe zakonisht pozicionet e KQP-së në Q_{10}, Q_{25}, Q_{50}, Q_{75} dhe Q_{90} përdoren si "prurje indeks", për të kontrolluar nivelin e devijimit të prurjes së matur (të ndikuar artificialisht) nga rrjedha plotësisht natyrore.

Lejohen disa devijime nga kurba rritëse e rrjedhës plotësisht natyrore, por këto devijime nuk mund të jenë më shumë se +/- 30% përpara se të ndikohet Statusi i Mirë. Prandaj, për të gjitha kurbat rritëse të prurjes mjedisore, caktohet limiti i poshtëm dhe i sipërm, me të cilin rrjedha natyrore mund të ndryshohet përpara se trupi ujor të degradojë nga SEM-ja.

Figura 3-2 tregon se për prurje të larta dhe jo të shpeshta p.sh Q_{10}, edhe prurja mjedisore do të jetë më e lartë, ashtu siç mund të jetë edhe niveli absolut i nxjerrjes së ujit ose shkarkimit, por pa ndikuar SEM-në. Në skajin e kundërt, p.sh në Q_{90}, prurja mjedisore është më e vogël, por edhe nivelet e nxjerrjes së lejuar të ujit janë më të ulëta, zakonisht më pak se 10% për trupat ujorë të ndjeshëm.

Figura 3-2- Koncepti i Praktikës më të Mirë të Kurbave të Prurjes Mjedisore



Limitet precize +/- % të indeksit të prurjeve mjedisore janë specifike për ekosistemin dhe kërkojnë monitorim të detajuar ekologjik për të konfirmuar nivelin e ndjeshmërisë ndaj nxjerrjes së ujit, dhe për rrjedhojë vlerën bazë dhe lakueshmërinë e kurbave rritëse. Avantazhi i kësaj qasjeje është se kurbat e qëndrueshme të prurjes mjedisore (dhe vlerat në çdo pikë të KQP-së) mund të ndërtohen sipas rregullave matematikore.

$Q_{(QX)} = Q_{90} \times e^{[k \times t]}$

ku $Q_{(QX)}$ = vlera e prurjes mjedisore në KQP X; Q_{90} është vlera e natyralizuar e prurjes bazë nga KQP-ja

e = baza e algoritmeve natyrore; k = konstantja e rritjes; t = numri i hapave 5% të KQP-së nga Q90

Aktualisht, në Shqipëri, këto kurba rritëse të prurjes mjedisore mbeten ende për t'u zhvilluar, dhe nuk mund të formulohen deri kur të ringrihet rrjeti hidrometrik me të dhëna të besueshme dhe të përditësuara për prurjet. Ky koncept prezantohet për të nënvizuar metodologjinë e propozuar për këtë plan në lidhje me caktimin e prurjes mjedisore dhe se si kjo prurje mund të llogaritet mbi baza objektive.

3.3.6 Kushtet Referencë për Ndikimin Hidromorfologjik

Metodologjia kryesore që po përdoret aktualisht në kuadrin e PMBU-së në Shqipëri synon që të mundësojë një vlerësim sa më objektiv të ndikimit hidrologjik dhe/ose morfologjik (kur ka të dhëna), sipas Standardit Teknik Evropian të mirënjohur, por pak të përdorur [24]. Standardi për ndryshimet fizike ofron disa sisteme objektive pikëzimi.

Metoda objektive e paraqitur më lart mund të përdoret për çdo lloj ndryshimi të regjimit të prurjes, për shembull nxjerrja e ujit për qëllime bujqësore apo arritjen e pikut hidrik (shtimi i prurjeve) për shkak të aktiviteteve të pakontrolluara hidroenergjetike.

Standardi EN 15843 (për më shumë informacion referuar Ankesit VI për hidromorfologjinë) sugjeron gjithashtu një tipar tjetër jashtëzakonisht të rëndësishëm të statusit sasior: shtimi i prurjeve mbi regjimin natyror mund të jetë po aq i dëmshëm për ekosistemet ujore. Ky aspekt shpërfillet në vlerësimin e statusit në shumë PMBU. Ky kusht rrjedh veçanërisht nga ndikimet e hidroenergjetikës për shkak të shkarkimeve të papërshtatshme të ujit nga hidrocentralet, kryesisht gjatë periudhave me prurje natyrore të ulëta. Këto shkarkime të ujit mund të jenë shumëfish më të mëdha në magnitudë krahasuar me rrjedhën natyrore, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme, dhe shpesh të pakthyeshme në ekosistemet e rrjedhës së poshtme. Për shembull, një rritje me 100% e prurjes mesatare (pra dyfishi) për vetëm 40% të kohës tregon se trupi ujor ka status të moderuar, pavarësisht statusit të çdo elementi tjetër biologjik ose fiziko-kimik. Shumë hidrocentrale në Shqipëri, veçanërisht HEC-e me skema derivacioni, e ushtrojnë aktivitetin në këto nivele pa bërë asnjë vlerësim apo pa pasur asnjë rregullore të përshtatshme.

3.3.7 Kushtet Referencë për TUTM-të dhe TUA-të

Sipas nenit 2(9) të DKU-së, përkufizimi i TUTM-së ka dy komponentë kryesorë. Që të klasifikohet si TUTM, një trup ujor duhet : (i) të ketë ndryshuar fizikisht për shkak të veprimtarisë njerëzore (ii) të ketë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme në karakter. Trupi ujor mund të klasifikohet si tepër i modifikuar vetëm nëse i është nënshtruar procedurës së përcaktimit që përfshin të dy testet e parashikuara në nenin 4(3)(a) & (b) të DKU-së. Testet janë krijuar në mënyrë të tillë që të sigurohet se një trup ujor shpallet si TUTM vetëm kur nuk ekziston më asnjë mundësi e arsyeshme që të arrihet statusi i mirë për atë trup ujor, dhe si rrjedhojë duhet të jenë specifik për trupin ujor. Shpallja dhe arsyet e shpalljes duhen përmendur në mënyrë specifike në PMBU.

Për sa i përket trupave ujorë natyrorë, objektivat mjedisore për TUTM-të dhe TUA-të përcaktohen në varësi të një kushti referencë, që është potenciali ekologjik maksimal (PEM) i trupit ujor. PEM-ja është gjendja kur statusi biologjik reflekton, sa më shumë që të jetë e mundur, statusin më të afërt dhe të krahasueshëm të trupit ujor sipërfaqësor, duke marrë parasysh karakteristikat e modifikuara të trupit ujor. Për sa i përket statusit biologjik, Potenciali i Mirë Ekologjik (PME) lejon vetëm "pak ndryshime" nga PEM-ja.

Pas shpalljes si TUTM ose TUA, objektivat mjedisore janë "potenciali i mirë ekologjik" (PME) dhe statusi i mirë kimik. PME-ja është objektiv më pak shtrëngues se SME-ja pasi lejon ndikime ekologjike që vijnë për shkak të ndryshimeve fizike që janë të nevojshme për të mbështetur një përdorim të caktuar si p.sh mbrojtjen nga përmbytjet, hidroenergjetikën.

[24] Standardi Evropian EN 15843 - Cilësia e Ujit - Standard orientues për përcaktimin e shkallës së modifikimit të hidromorfologjisë së lumit

3.3.8 Ndikimet Hidromorfologjike të Hidrocentraleve dhe Shpallja e TUTM-së

Shtimi i hidrocentraleve të vegjël në vend, mungesa e vlerësimit të përshtatshëm të ndikimit mjedisor, kriteret e papërshtatshme të lejeve, dëmet ndaj ekosistemit dhe prishja e regjimit të prurjeve janë konsideruar si shqetësime ndërkombëtare[25] ,[26].

Përcaktimi objektiv i shkallës së ndikimit të mundshëm hidromorfologjik nga HEC-et lidhet ngushtësisht me statusin e trupave ujorë. Gjendja hidromorfologjike e trupit ujor është pjesë përbërëse e statusit të tij të përgjithshëm. Siç u konfirmua nga Udhëzimi 31 i CIS-it, regjimi i prurjes ka efekt kontrollues të jashtëzakonshëm në shëndetin e ekosistemit, dhe si rrjedhojë në statusin e trupit ujor.

Veprimtaria e hidrocentralit ka ndikim të madh pasi, shumë shpesh, regjimi i prurjes së rrjedhës së poshtme prishet tërësisht ose për shkak të magnitudës së nxjerrjes së ujit që lidhet me prurjen mesatare në pikën e marrjes së ujit, dhe/ose për shkak të kohëzgjatjes në kohë të nxjerrjes. Kjo prishje e regjimit të prurjes i bashkëngjitet ndikimeve kryesisht morfologjike (fizike) që parashikohen në Dokumentin Udhëzues 4 të CIS-it të BE-së. Prandaj, është e nevojshme të kryhet një vlerësim objektiv për të përcaktuar nivelin e ndikimit të hidrocentralit, brenda kontekstit të shpalljeve të Trupave Ujorë Tepër të Modifikuar (TUTM).

Ndërtimi i kapërdredhësve, pritave apo digave të mëdha duket se ka ndikim të konsiderueshëm fizik te trupi ujor, duke prishur plotësisht vazhdimësinë gjatësore dhe integritetin e ekosistemit. Ambivalenca në Dokumentin Udhëzues 4 [27](2003) të CIS-it të BE-së lidhur me faktin nëse ndryshimi i prurjes përbën ndryshim thelbësor në karakter apo jo (3.1.1 - Në rastet e ndryshimeve thelbësore të përkohshme ose të ndërprera në kohë, nuk mund të thuhet se trupi ujor ka pësuar ndryshime thelbësore në karakter) është dukshëm e pasaktë dhe është trajtuar në Dokumentin Udhëzues 31 (2016) të BE-së.

Siç dihet edhe nga të gjithë inxhinierët e hidrocentraleve (dhe siç dokumentohet në EN 15843), ndryshimet e vazhdueshme në regjimin e prurjes mund të kenë ndikim katastrofik në qëndrueshmërinë e ekosistemit[28]. Devijimi me 75%+ i rrjedhës së lumit gjatë periudhave tejet të thata është tipike për shumë HEC-e në Shqipëri, njësoj si tendenca për të ndërtuar sisteme me derivacion që krijojnë një ndryshim të rrjedhës natyrore në trupin ujor për segmente në disa raste prej shumë kilometrash. Zakonisht, në këto segmente nuk kalon asnjë rrjedhë lumi gjatë muajve me prurje të pakta.

Zakonisht, arritja e pikut hidrik nga shkarkimet e ujit përmes turbinave i rrit prurjet e lumit në magnitudë shumë herë më të madhe nga sa pritet normalisht, duke dëmtuar elementet e cilësisë biologjike, kryesisht peshqit dhe makro invertebrorët. Kështu, statusi i pamjaftueshëm i trupit ujor (për shkak të prurjeve të shumta ose të pakta, në varësi të veprimtarisë së HEC-it) shtrihet në të gjithë gjatësinë e trupit ujor.

Për shumicën e HEC-eve në Shqipëri, mungesa e vazhdimësisë gjatësore, prurja mjedisore e ndërprerë në kohë në nivele zero, dhe magnituda dhe kohëzgjatja e dëmtimit të regjimit të prurjes nënkuptojnë se edhe Potenciali i Mirë Ekologjik (PME) (statusi i synuar për TUTM-të) ka gjasa që të mos arrihet asnjëherë nga shumë hidrocentrale, pasi operatorët duhet të përmbushin disa objektiva të detyrueshme me ligj për prodhimin e energjisë elektrike të përcaktuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe periudha (fikse) e koncesionit zakonisht është 20-30 vjet. Regjimet e prurjes mjedisore në rrjedhën e poshtme të HEC-eve rrallë herë janë përcaktuar ose monitoruar siç duhet nga autoritetet kompetente.

Për rrjedhojë, shumë HEC-e në Shqipëri mund të ishin zbatuar në një mënyrë më të qëndrueshme ekologjike (dhe për pasojë nuk do të ishin subjekt i testit në nenin 4(3)(a) & (b)) po të ishte përfshirë vlerësimi dhe zbutja e ndikimeve hidromorfologjike që në fazën e projektimit.

Seksioni 10.6 paraqet një Përmbledhje objektive të ndikimeve të mundshme hidromorfologjike dhe statusin e trupave ujorë të prekur nga HEC-i brenda basenit ujor. Në të ardhmen mund të përdoret po e njëjta metodologji,

---

[25]Projekti HELP-CSO - Identifikimi i konflikteve për burimet ujore lidhur me projektet e hidrocentraleve në Shqipëri, 2017

[26]Hidroenergjetika në Ballkanin Perëndimor - Kush paguan, Kush fiton?, CEE Bankwatch & WWF, 2019

[27]Strategjia e Përbashkët e Zbatimit e BE-së, Dokumenti Udhëzues 4, Identifikimi dhe Shpallja e Trupave Ujorë Tepër të Modifikuar dhe Trupave Ujorë Artificialë

[28]Strategjia e Përbashkët e Zbatimit e BE-së, DKU-ja dhe Raporti Teknik i Presioneve Hidromorfologjike, 2006.

bazuar te përcaktimi i statusit të modifikuar përmes EN 15843, për të përcaktuar regjime operacionale mjedisore më të qëndrueshme për HEC-et ekzistuese dhe të ardhshme.

Fotografia 3-1-Devijimi Maksimal i Prurjes dhe Piku i Shfrytëzimit nga HEC-i (HEC Cekreze)




Gjatësia e zonës me shfrytëzim me skema derivacioni të HEC-eve është faktor kritik për ndikimet në ekosistem. Piku i shfrytëzimit përkufizohet si gjatësia e trupit ujor që shtrihet midis pikës së marjes së ujit dhe pikës së shkarkimit të prurjes (Figura 3-3). Zona e Pikut të shfrytëzimit ka prirjen të jetë e madhe kur operatori i hidrocentralit kërkon të maksimizojë fuqinë hidrike (H) që vepron në turbinë, duke maksimizuar kështu prodhimin e energjisë elektrike. Nëse sistemi i HEC-it është jashtë linje, atëherë maksimizimi i fuqisë do të thotë se piku i shfrytëzimit është shumë i madh, gjë. që është më se e zakonshme për HEC-et në Shqipëri.

Statusi hidromorfologjik i pamjaftueshëm do të gjejë zbatim për të gjithë gjatësinë e pikut të shfrytëzimit, ndonëse mbi bazën e një ekuilibri të reduktuar. Në pikën e shkarkimit të hidrocentralit, prurja e lumit rikthehet, dhe për sistemet me tubacione, rivendoset ekuilibri.

Megjithatë, në rastin e projektimit më të keq digë e madhe + sistem HEC-i me derivacion (pra HEC jo në digë), në pikën e shkarkimit (ku turbina vepron kryesisht në funksion të depozitimit dhe jo të rrjedhjes së lumit), dëmtimi i regjimit ujor mund të vijojë për një distancë të konsiderueshme në rrjedhën e poshtme, ku turbinat shkarkojnë shumë më tepër se rrjedha natyrore e pritshme, shkalla e ndikimit të së cilës varet nga hidrologjia në rrjedhën e poshtme. Këto shembuj janë shumë të përhapur në Shqipëri.

Prandaj, një sistem HEC-i jashtë linje me një depozitë të vetme të madhe mund të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme një distancë prej 20km+ të një trupi ujor, duke e pakësuar prurjen në rrjedhat e sipërme, dhe duke e kompensuar në rrjedhat e poshtme, si dhe duke prishur ndjeshëm, duke ndërprerë kështu ose, në mos duke shkatërruar plotësisht, ekosistemin ujor.

Figura 3-3 – Koncepti i Pikut të Shfrytëzimit si pasojë e Hidrocentralit




3.3.9 Format e Tjera të TUTM-ve dhe TUA-ve

Për basenin e lumit Ishëm gjejnë zbatim edhe disa forma tradicionale të TUTM-ve, të cilat janë subjekt i nenit 4(3) (a) & (b) të DKU-së dhe objektivit të PME-së. Zakonisht, këto përfshijnë krijimin e kanaleve në lumenj që përshkojnë qendrat urbane për të kontrolluar erozionin dhe siguruar mbrojtjen nga përmbytjet, ose ndërtimin e argjinaturave kundër përmbytjevel. TUTM-të dhe TUA-të e identifikuara renditen në Kapitullin 10 të Vlerësimit të Statusit të Presioneve.

3.3.10 Përcaktimi i Statusit Përfundimtar të Trupave Ujorë Sipërfaqësorë

Statusi përfundimtar ose i përgjithshëm i çdo trupi ujor të përvijuar përcaktohet përmes një vlerësimi kompleks të elementeve të paraqitura në Figura 3-4. Sipas udhëzimit të CIS-it për DKU-në[29], statusi përfundimtar i trupit ujor duhet të derivojë nga elementi më ulët në klasifikim , të secilit grup.

Figura 3-4 –Procedura për Përcaktimin e Statusit të Përgjithshëm të Trupit Ujor



[29] Komisioni Evropian, Udhëzimi 13 i CIS-it, Qasja e përgjithshme kundrejt klasifikimit të statusit dhe potencialit ekologjik

3.4 Objektivat Mjedisore për Trupat Ujorë Nëntokësorë

DKU-ja u kërkon Shteteve Anëtare që t'i përcaktojnë të gjithë trupat ujorë më vete dhe të sigurohen që secili prej tyre të arrijë statusin kimik dhe sasior (DKU, neni 2(24) (25)). Përcaktimi i statusit të trupave ujorë nëntokësorë nuk është aq kompleks sa i trupave ujorë sipërfaqësorë. Megjithatë, mbrojtja e trupave ujorë nëntokësorë i nënshtrohet një serie Direktivash të ndërlidhura me njëra-tjetrën, duke përfshirë kryesisht Direktivat 2006/118/KEE dhe 291/676/KEE[30]. Kryesisht përmes Direktivës 2006/118/KE [31], duhet përcaktuar regjimi i menaxhimit i cili vendos standardet e cilësisë së ujërave nëntokësore dhe masat për parandalimin ose kufizimin e ndotësve që depërtojnë në ujëra nëntokësore. Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë standardet në nivelet më të përshtatshme të mundshme dhe të marrin parasysh kushtet vendore dhe rajonale[32].

3.4.1 Kushtet e Referencës për Sasinë e Ujërave Nëntokësore

Niveli i ujërave nëntokësore përdoret zakonisht si matësi kryesor i statusit sasior. Për të arritur statusin e mirë sasior të ujërave nëntokësore, burimi ujor nëntokësor i disponueshëm (si p.sh norma mesatare afatgjatë e rimbushjes së ujërave nëntokësore minus normën vjetore të shkarkimit të ujërave nëntokësore, që kërkohet për të arritur objektivat e cilësisë ekologjike për ujërat sipërfaqësore të lidhura me to) nuk duhet ta tejkalojë normën vjetore mesatare afatgjatë të nxjerrjes së ujit (DKU, neni 2(27)). Për këtë arsye, norma vjetore e rimbushjes që përshkruhet në seksionin 4.2.3 (bilanci vjetor i ujit) është një shifër shumë e rëndësishme për përdorimin e përshtatshëm të burimeve ujore nëntokësore. Nxjerrja e burimit ujor nëntokësor mbi normën vjetore të rimbushjes kompromenton a) burimet të disponueshme në periudha afatgjata b) regjimet e prurjeve të ujërave sipërfaqësore dhe statusin ekologjik të tyre.

Përcaktimi i normës vjetore të rimbushjes së ujërave nëntokësore është mjaft sfiduese nga pikëpamja teknike, pasi kërkon rrjete gjithëpërfshirëse dhe të sakta të monitorimit të nivelit të ujërave nëntokësore. Megjithatë, praktika më e mirë ndërkombëtare pranon se indeksi i prurjes bazë të natyralizuar (IPB), ndonëse i përafërt, është një tregues i mirë i normës vjetore të shkarkimit të ujërave nëntokësore në sistemin e ujërave sipërfaqësore[33] ,[34]. IPB-ja përcaktohet nga KQP-ja e duhur; shkarkimet e ujërave nëntokësore duhet të jenë të barabarta me rimbushjen. Ka të ngjarë që rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore në basenin e lumit Ishëm të mos jetë në cilësinë dhe nivelin e duhur për të përcaktuar rimbushjen e ujërave nëntokësore përmes bilancit të ujit ose teknikave të modelimit.

Elementi i dytë i kushteve të referencës për sasinë e ujërave nëntokësore është masa në të cilin nxjerrja e ujërave nëntokësore sjell devijim të rrjedhës së ujërave nëntokësore në mënyrë të tillë që të ndërpritet shkarkimi i tyre në rrjedhat sipërfaqësore. Shkarkimi i ujërave nëntokësore është një komponent i rëndësishëm për pjesën më të madhe të rrjedhës, dhe në nënbasene ose në ligatina të mëdha, ose në ato zona ku IPB-ja e rrjedhës është më e madhe se 0.5 për shembull, ka shumë të ngjarë që ekosistemet tokësore të varen shumë nga niveli i mirëmbajtjes së kësaj prurjeje. Nxjerrja e ujërave nëntokësore i ndryshon pjerrësitë hidraulike në mënyrë të tillë që të reduktohet norma e shkarkimeve në lumenj, duke ndikuar drejtpërdrejt në prurjen mjedisore (ekologjike). Në raste ekstreme, mbinxjerrja e ujit mund të krijojë pjerrësi të rrjedhës së kundërt, çka bën që rrjedha e lumit të shkarkohet negativisht në ujërat nëntokësore, e njohur ndryshe edhe si "rimbushje e imponuar"(Figura 3-5). [35] Një prej variacioneve me rëndësi mjaft të madhe vendore ka të bëjë me burimet, të cilat shfrytëzohen masivisht për furnizim me ujë në basenin e Ishmit. Duke qenë se ujërat mblidhen në pikën e shkarkimit natyror, nxjerrja nuk ka ndikim te statusi i trupit ujor nëntokësor, por ndikon te pakësimi i rrjedhës bazë së trupit ujor sipërfaqësor pritës.

Zakonisht, ndikimet fikse të ndërveprimit ujëra nëntokësore-ujëra sipërfaqësore janë të lokalizuara dhe tejet teknike, ndaj si të tilla kërkojnë vlerësime modelimi. Megjithatë, mund të përgjithësohet se p.sh reduktimi me

[30]Komisioni Evropian, Direktiva 91/676/EEC për mbrojtjen e ujërave kundër ndotjes së shkaktuar nga nitratet që vijnë nga burimet bujqësore

[31] Komisioni Evropian - Direktiva 2006/118/KE- për mbrojtjen e ujërave nëntokësore kundër ndotjes dhe degradimit

[32]Komisioni Evropian – Kuadri ligjor për ujërat nëntokësore https://ec.europa.eu/environment/water/water-framework/groundwater/framework.htm

[33] Instituti i Hidrologjisë në MB - Raporti për Prurjet e Pakta nr.1, Raport Studimor, NERC, 1980.


[34]"Prurja e natyralizuar" = Prurja aktuale + (nxjerrjet + eksportet) – (kthimet+importet)

[35]Shërbimi Gjeologjik i Shteteve të Bashkuara – Ujërat Nëntokësore dhe Ujërat Sipërfaqësore – Një Burim i Vetëm– Qarkore e USGS-së 1139, 1997.

10% i burimit ujor nëntokësor (p.sh për shkak të konsumit) sjell 10% reduktim të shkarkimit të ujërave nëntokësore në sistemin e ujërave sipërfaqësore në vit. Një tjetër aspekt që mund të ndikojë statusin sasior të trupave ujorë nëntokësorë në basenin e lumit Ishëm është roli i transfertave të ujit midis baseneve dhe midis trupave ujorë. Burimi i Selitës në GW35140409, ujërat sipërfaqësore të rezervuarit të Bovillës dhe burimi i Shën Mërisë në basenin e lumit Erzen transferohen në trupin ujor nëntokësor të Tiranës (GW35140103).

Për shumë lumenj, përfshi edhe ato në Shqipëri, duke qenë se komponenti i ujërave nëntokësore është zakonisht 30%+ i prurjes mesatare vjetore, reduktimi me 10% i rimbushjes neto të ujërave nëntokësore mund të sjellë reduktim me mesatarisht 3% të prurjes së rrjedhës në vit. Megjithatë, gjatë periudhave sezonale me prurje të pakta p.sh gjatë verës kur IPB-ja është zakonisht 0.9+, po i njëjti reduktim rimbushjeje me vlerë 10% mund të sjellë një reduktim të prurjes sezonale me 9%. Këto reduktime mund të kenë ndikime negative të pakthyeshme në ekosistemin ujor[36].

Figura 3-5 – Shembulli i Pakësimit të Prurjes Sipërfaqësore për Shkak të Nxjerrjes së Ujërave Nëntokësore



3.4.2 Kushtet e Referencës për Cilësinë e Ujërave Nëntokësore

DUN-i i jep fleksibilitet Shteteve Anëtare për sa i përket caktimit të vlerave kufi duke kërkuar marrjen në konsideratë të mjediseve të ndryshme pritëse të trupit ujor nëntokësor, risqeve dhe funksioneve, karakteristikave dhe sjelljes së ndotësve dhe karakteristikave hidrogjeologjike të përfaqësuara nga nivelet bazë. Marrja në konsideratë e këtyre kërkesave të ndryshme, të cilat janë unike për çdo trup ujor nëntokësor, sjell përdorimin e qasjeve të ndryshme nga Shtetet Anëtare.

Në terma më të gjerë, cilësia e ujërave nëntokësore përcaktohet përmes statusit kimik, i cili përkufizohet kryesisht përmes:

- Shkallës së intruzionit të ujërave të kripura, që tregohet kryesisht përmes parametrit të përcjellshmërisë elektrike (PE) Ndonëse intruzioni i ujërave detaret është kushti kryesor ku mbështetet testi i statusit, DKU-ja/DUN-i identifikon edhe intruzione të tjera që përfshijnë infiltrimin e rrymave të ndotura dhe flukseve në hyrje anësore nënsipërfaqësore nga akuiferë të tjerë. Të dyja gjejnë zbatim në basenin e lumit Ishëm.
- Standardet e cilësisë mjedisore (SCM) për parametrat fiziko-kimike të përgjithshme të cilat janë kryesisht oksigjeni i shpërbërë, pH, përcjellshmëria, nitratet, klori dhe amoniumi, pesticidet dhe ndotësit e tjerë, siç parashikohen në DUN, Shtojca I.
- Shkalla në të cilën statusi kimik i ujërave nëntokësore mbështet statusin ekologjik të ujërave sipërfaqësore.

Standardet e cilësisë mjedisore për ujërat nëntokësore përcaktohen shprehimisht në Direktivën e BE-së 2006/118/KEE për parametrat e a) nitrateve - 50 mg/l b) pesticideve totale – 0.5 µg/l). Derivimi i vlerave kufi përshkruhet në Kapitullin 10. Standardet për ujin e pijshëm përdoren zakonisht si bazë për vlerat prag të statusit kimik, sikurse përcaktohen në Direktivën e BE-së për Ujin e Pijshëm 98/83/KE, standardet ndërkombëtare të OBSh-së, ose objektivat e cilësisë mjedisore të parashtruara në Direktivën 2013/39/BE[37].

[36]Komisioni Evropian – Ujërat nëntokësore si burim - https://ec.europa.eu/environment/water/water-framework/groundwater/resource.htm

[37]Komisioni Evropian – Direktiva 2008/176/KEE – Shtojca I (Substancat Prioritare), Shtojca II (zëvendëson Shtojcën X të DKU-së) identifikimi i Substancave Prioritare të Rrezikshme

Duhet theksuar se sipas DKU-së, dispozitat për statusin kimik nuk gjejnë zbatim për nivelet e larta natyrore të substancave ose joneve, apo treguesve të tyre për shkak të kushteve specifike hidrogjeologjike të cilat nuk mbulohen nga përkufizimi i ndotjes. Për shkak se nivelet bazë mund të jenë shumë të larta për disa prej parametrave dhe disa lloje të trupave ujorë nëntokësorë, ka shumë rëndësi që këto nivele bazë të identifikohen si hap i parë i vlerësimit të statusit dhe tendencave. Standardet e Cilësisë Mjedisore të miratuara për trupat ujorë nëntokësorë në Shqipëri paraqiten në Shtojcën Teknike VII.

3.4.3 Kushtet e Referencës për Ujërat Nëntokësore të Varura nga Ekosistemet Tokësore


Ujërat nëntokësore të varura nga ekosistemet tokësore (UNVET) janë një rast i veçantë i karakterizimit të ujërave nëntokësore dhe kushteve të referencës të lidhura me to[38].

UNVET-ët janë pjesë e vlerësimit të statusit për ujërat nëntokësore. Prandaj, ata janë të rëndësishëm në karakterizimin dhe vlerësimin e riskut të TUN-ëve (shihni Figura 3-7). Rëndësia e UNVET-ëve lidhur me statusin e trupit ujor nëntokësor ka të bëjë me faktin se krahas testeve bazë për sasinë (3.4.1) dhe cilësinë (3.4.2) e ujërave nëntokësore, TUN-ët mund të mos e kalojnë testin e "statusit të mirë" nëse vlerësohet se ekosistemi i ujërave sipërfaqësore prej të cilit varen është kompromentuar për shkak të cilësisë dhe sasisë së pamjaftueshme të ujërave nëntokësore që i ushqejnë ato.

Shumë ekosisteme ujore sipërfaqësore janë përshtatur dhe varen së tepërmi nga shkarkimet e ujërave nëntokësore, kryesisht në formën e "prurjes bazë", si pjesë e prurjes totale në lum. Kjo sepse, prurja bazë (gjithë vjetore) është e pranishme gjatë gjithë vitit hidrologjik, ndërsa vërshimet sipërfaqësore janë kryesisht të ndërprera në kohë, me ndikime afatshkurtra dhe kalimtare te cilësia dhe sasia e ujit.

Ujërat nëntokësore shkarkohen zakonisht te sistemi i ujërave sipërfaqësore kryesisht nëpërmjet zonës hiporike (Figura 3-6). Kjo zonë është mjaft e rëndësishme për sa i përket ndërveprimeve kimike dhe biotike midis ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, pasi ofron habitatin për invertebrorët bentikë, bën të mundur reduktimin e përqendrimeve të ndotësve dhe stabilizimin e pH, oksigjenit dhe temperaturës së ujit.

Figura 3-6 – Ilustrimi i Zonës Hiporike



Nuk është aspak e lehtë të përcaktosh se cilat ekosisteme tokësore varen drejtpërdrejt nga TUN-i, pasi gjithmonë ka një sërë ekosistemesh midis atyre që varen nga ujërat nëntokësore të një TUN-i dhe atyre që varen nga burime të tjera ujore.

Zakonisht, kërkohen monitorime ekologjike të specializuara për të konfirmuar praninë e specieve veçanërisht të përshtatura për shkak të ndryshimit të kimisë natyrore të ujërave nëntokësore krahasuar me ujërat sipërfaqësore. Këto monitorime nevojiten për të përcaktuar vlerat kufi (VK) të ndotësve ose treguesve të ndotjes (pra, statusi kimik) që mund të ndikojë negativisht në ETVUN[39]. Direktiva për Ujërat Nëntokësore (DUN 2006/118/KE, Shtojca II, Pjesa A) parashtron në mënyrë të veçantë kërkesën që vlerat kufi të marrin parasysh edhe nivelin e ndërveprimit midis ujërave nëntokësore dhe ekosistemeve ujore dhe ekosisteme tokësore të varura.

[38] Komisioni Evropian, CIS, Raporti Teknik për Ujërat Nëntokësore të Varura nga Ekosistemet Tokësore, Raporti Teknik 6, 2011

[39] Komisioni Evropian, Dokumenti Udhëzues i CIS-it 18, Udhëzim për statusin e ujërave nëntokësore dhe vlerësimin e tendencave.


Testi i dytë praktik që derivon nga hidrologjia e ujërave sipërfaqësore shërben për të përcaktuar Indeksin e Prurjes Bazë (IPB) të regjimit të prurjes. IPB-ja përcaktohet si mesatarja vjetore afatgjatë e prurjes sipërfaqësore e shprehur në raportin Q_{90} / $Q_{50.}$ Sa më e madhe të jetë pjesa e prurjes bazë që ushqen prurjen totale, aq më shumë gjasa ka që ekosistemi ujor sipërfaqësor të varet nga kontributi i ujërave nëntokësore. Një vlerë IPB-je më e vogël se 0.5 tregon se 50%+ e prurjes totale vjen nga shkarkimi i ujërave nëntokësore, ndaj ka shumë gjasa që ekosistemet të jenë tejet të përshtatura dhe të varura nga ujërat nëntokësore që shkarkohen në to.

Mungesa e plotë e të dhënave aktuale të besueshme për prurjet që prej vitit 1992 për pjesën më të madhe të lumenjve në Shqipëri, së bashku me mungesën e theksuar të të dhënave të monitoruara dhe të raportuara për nxjerrjet dhe shkarkimet nga operatorët, lënë të nënkuptohet se për asnjë prej ETVUN-ve nuk mund të përcaktohen[40] prurjet e natyralizuara Q_{50} dhe Q_{90}.

3.4.4 Testet e Ndara në Hapa për Statusin e Cilësisë dhe Sasisë së Ujërave Nëntokësore

Procedura formale për përcaktimin e statusit të ujërave nëntokësore që përdoret në Shqipëri është në përputhje me udhëzimin standard të CIS-it, sipas Figura 3-7[41].

Figura 3-7 – Procedura Standarde për Përcaktimin e Statusit të Përgjithshëm të Trupit Ujor Nëntokësor



[40] Prurja e natyralizuar përcaktohet nëpërmjet formulës Prurja Aktuale Vjetore (ose e matur) + Nxjerrjet – Kthimet. Formula parashikon rrjedhën natyrore (në intervale ditore, mujore, sezonale, vjetore) duke hequr të gjitha ndikimet artificiale. Prurjet e matura Q90 dhe Q50 nuk mund të përdoren për të përcaktuar kushtet natyrore, përveç se kur ndikimet janë thuajse zero.

[41] Komisioni Evropian, Dokumenti Udhëzues i CIS-it 18, Udhëzim për statusin e ujërave nëntokësore dhe vlerësimin e tendencave

3.5 Objektivat Mjedisore për Zonat e Mbrojtura

Sipas nenit 6 dhe Shtojcës IV të DKU-së, Shtetet Anëtare sigurohen që të kenë krijuar regjistrin/at e të gjitha zonave brenda çdo RBU-je, të cilat janë shpallur në mbrojtje të veçantë sipas legjislacionit të posaçëm të Komunitetit për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ose për konservimin e habitateve dhe llojeve që varen drejtpërdrejt nga uji, përfshi edhe mbrojtjen e zonave të Natura 2000 dhe llojeve ujore me rëndësi ekonomike (p.sh butakët).

Përmbledhja e regjistrit të Zonave të Mbrojtura duhet të jetë pjesë e PMBU-ve, duke përfshirë këtu edhe hartat që tregojnë vendndodhjen e çdo zone të mbrojtur dhe përshkrimin e legjislacionit të Komunitetit, kombëtar ose vendor, sipas të cilit janë shpallur këto zona të mbrojtura. Për trupat ujorë që janë shpallur si Zona të Mbrojtura, Objektivat Mjedisore që janë vendosur shkojnë zakonisht përtej statusit të mirë, pasi për këto zona përcaktohen objektiva më shtrënguese në legjislacionin përkatës të Komunitetit.

Shtojca VII (7)(1) e DKU-së kërkon që PMBU-ja të përmbajë "përmbledhjen e masave të kërkuara nga legjislacioni i Komunitetit për mbrojtjen e burimeve ujore". Masat shtesë për Zonat e Mbrojtura duhet të jenë pjesë përbërëse e PMBU-së, në mënyrë që kërkesat e këtyre Zonave të Mbrojtura të përfshihen në menaxhimin e përgjithshëm të basenit ujor dhe të sigurohet koherenca e të gjithë planifikimit të burimeve ujore me objektivat e përcaktuara tashmë nga legjislacioni i Komunitetit dhe ai kombëtar.

Programet e monitorimit duhet të përfshijnë nënprograme specifike për zonat e përfshira në regjistrin e zonave të mbrojtura. Krahas kërkesave për statusin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, Neni 8 i DKU-së parashtron edhe kërkesat për monitorimin e zonave të mbrojtura. Ky monitorim specifik duhet të garantojë vlerësime sipas standardeve dhe objektivave të përcaktuara për llojin e veçantë të zonës së mbrojtur.

Objektivat e zonave të mbrojtura përcaktohen në Pikën 1.c të Nenit 4 të DKU-s: Shtetet Anëtare "sigurojnë përputhshmërinë me të gjitha standardet dhe objektivat brenda 15 viteve nga data e hyrjes në fuqi së kësaj direktive, përveç se kur parashikohet ndryshe në legjislacionin e Komunitetit, sipas të cilit janë krijuar zonat e mbrojtura individuale". Për këto objektiva gjejnë zbatim kryesisht mundësitë për përshtatje të parashikuara nga DKU-ja. Kështu, për zonat e mbrojtura duhen arritur dy lloje objektivash: objektivat e veçanta të direktivës përkatëse që janë vendimtare për përvijimin e zonës (shihni Shtojcën 4 të DKU-së) dhe standardet kombëtare të zbatimit dhe objektivat e DUKU-së. Disa zona të mbrojtura përkojnë me trupa ujorë. Regjistri i zonave të mbrojtura duhet të mbulojë zonat e identifikuara nga DKU-ja ose direktivat e tjera përkatëse të BE-së.

Llojet e përgjithshme të ZM-ve janë pesë:

- Trupat ujorë të përdorur për nxjerrjen e ujit të pijshëm;
- Zonat ku janë zbatuar masa për mbrojtjen e llojeve ujore me rëndësi ekonomike (ZM-të sipas Direktivës 2006/44/KE (direktiva për peshqit e ujërave të ëmBUa); Direktiva për Butakët 79/923/KEE);
- Ujërat e larjes (ZM-të sipas Direktivave për Ujërat e Larjes 2006/7/KE)
- Zonat e ndjeshme ndaj lëndëve ushqyese (ZM-të sipas Direktivës 91/676/KEE; Direktivës për Trajtimin e Ujërave të Ndotura 91/271/KEE).
- Zona të rëndësishme për mbrojtjen e habitateve dhe/ose llojeve ku mirëmbajtja ose përmirësimi i statusit të ujit është faktor shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e tyre, (zonat e Natura 2000 të shpallura sipas Direktivës për Shpendët 79/409/KEE dhe Direktivës për Habitatet 92/43/KEE).

Duke qenë se harmonizimi i legjislacionit kombëtar të Shteteve Joanëtare të BE-së me standardet e BE-së nuk ka përfunduar ende, nuk mund të bëhet inventarizimi i plotë i ZM-ve për mbarë basenin, që gjë që kërkohet nga DKU-ja. Prandaj, mund të përdoret një qasje e modifikuar, që të marrë parasysh:

- Standardet kombëtare për përvijimin e ZM-ve;
- Statusin e ndryshëm në kuadër të zbatimit të Konventës së Bernës dhe rrjetit NATUA 2000 në vend;
- Nivelin e ndryshëm të përshtatjes së legjislacionit kombëtar të Shteteve Joanëtare të BE-së me legjislacionin dhe standardet e BE-së;
- Mungesën e përgjithshme të regjistrave dhe/ose bazave efikase të të dhënave për ZM-të në vend;
- Përgjegjësinë e përbashkët për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e zonave të ujit të pijshëm midis autoriteteve kompetente në nivel kombëtar dhe nënkombëtar;
- Përgjegjësinë e përbashkët për monitorimin e zonave të mbrojtura të ujit të pijshëm;

3.5.1 Zonat e Përvijuara për Nxjerrjen e Ujit të Pijshëm

Legjislacioni përkatës i BE-së për mbrojtjen e ujit të pijshëm me objektiva më të shtrënguese përfshin DUP-in, ndryshuar me Direktivën 2020/2184 dhe me shumë mundësi DN-në. Objektivat për Zonat e Mbrojtura të Ujit të Pijshëm (ZMUP) janë:

•Sigurimin që, pas zbatimit të regjimit të trajtimit të ujit, uji i pijshëm që prodhohet t'i plotësojë kërkesat e DUP-in;

•Sigurimin e mbrojtjes së nevojshme në ZMUP, me qëllim që të shmanget përkeqësimi i cilësisë ë ujit për të reduktuar nivelin e trajtimit purifikues të kërkuar për prodhimin e ujit të pijshëm.

- Objektivi i i parë do të arrihet duke plotësuar kërkesat e DUP-it.
- Objektivi i dytë do të arrihet duke ndërmarrë veprime që synojnë të sigurojnë se nuk do të ketë përkeqësim të cilësisë së ujit për shkak të nxjerrjeve për furnizim me ujë të pijshëm. Në shumicën e rasteve, veprimet kërkojnë pak kohë të japin efekt dhe të ndalojnë ose të zhbëjnë përkeqësimin. Objektivi arrihet duke ndërmarrë masa të mjaftueshme.

3.5.2 Zonat e përvijuara për mbrojtjen e llojeve ujore me rëndësi ekonomike

Në dhjetor të 2013-s, Direktiva për Butakët u zëvendësua me DKU-në e BE-së. Neni 4.9 i DKU-së përcakton se direktiva ofron nivel mbrojtjeje të paktën të njëjtë me atë të çdo direktive që shfuqizon. Rregullorja 2003 transpozon shumë detyrime të DKU-së dhe përcakton pjesën më të madhe të detyrimeve dhe standardeve të cilësisë së ujit që kërkohen nga Direktiva për Butakët. Këto rregullore amenduese përmbajnë ndryshime shtesë të Rregulloreve të 2003-shit, për të siguruar vijimin e identifikimit, mbrojtjes dhe monitorimit të ujërave të populluara nga butakët.

Objektivi për ujërat e populluara nga butakët, i parashtruar në Direktivën për Butakët, ishte të mbrohej dhe, kur shihej e nevojshme, të përmirësohej cilësia e ujërave të populluara nga butakët për të mbështetur jetën dhe zhvillimin e butakëve (moluskëve bivalvë dhe gastropodë), duke kontribuar kështu në cilësinë e lartë të produkteve butake që konsumohen drejtpërdrejt nga njeriu.

Zonat e përvijuara për mbrojtjen e llojeve ujore me rëndësi ekonomike janë zona ku mbrohen ujërat e brendshme sipërfaqësore, ujërat kalimtare, ujërat bregdetare dhe ujërat nëntokësore, gjë që: parandalon përkeqësimin e mëtejshëm dhe mbron e forcon statusin e ekosistemeve ujore dhe, lidhur me nevojat e tyre për ujë, ekosistemet tokësore dhe ligatinat që varen drejtpërdrejt nga ekosistemet ujore. Këto zona janë të lidhura me zonat e ujërave bregdetare dhe të ligatinave, si dhe me trupa ujorë kalimtarë të populluar nga lloje ujore me rëndësi ekonomike.

Ekosistemet ligatinore janë pjesë ekologjike dhe funksionale e mjedisit ujor, duke luajtur me shumë gjasë rol mjaft të rëndësishëm në mundësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të basenit ujor. DKU-ja nuk ka përcaktuar objektiva mjedisore për ligatinat. Megjithatë, nga detyrimet e DKU-së për mbrojtjen dhe restaurimin e statusit të ujit përfitojnë edhe ligatinat që varen nga trupat ujorë nëntokësore, që janë pjesë e trupit ujor sipërfaqësor, ose që janë zona të mbrojtura. Presionet në ligatina (për shembull modifikimi fizik ose ndotja) mund të ndikojnë te statusi ekologjik i trupave ujorë. Prandaj, masat për menaxhimin e këtyre presioneve duhen parë si pjesë e planeve të menaxhimit të basenit ujor, që duhen përmbushur për të arritur objektivat mjedisore në Direktivë.

Krijimi dhe përforcimi i ligatinave mund të ofrojë në rrethana të caktuara mekanizma të qëndrueshëm, me kosto efikase dhe të pranueshëm nga pikëpamja sociale për të ndihmuar arritjen e objektivave mjedisore të Direktivës. Ligatinat në veçanti mund të ndihmojnë në pakësimin e ndikimeve të ndotjes, zbutjen e efekteve të thatësirave dhe përmbytjeve, arritjen e menaxhimit të qëndrueshëm të bregdetit dhe rimbushjen e ujërave nëntokësore. Disa prej ZM-ve përfshijnë edhe habitate ligatinore dhe lloje që varen drejtpërdrejt nga ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore. Andaj, një prej aspekteve më thelbësore të krijimit të Regjistrit të ZM-ve do të ishte identifikimi i habitateve dhe llojeve brenda rrjetit Natura 2000 që klasifikohen sipas kritereve të DKU-së.

3.5.3 Trupat ujorë të përvijuar si ujëra Rekreative

Ky seksion i referohet zonave të përvijuara sipas Direktivës 2006/7/KE për menaxhimin e Cilësisë së Ujërave të Larjes (që shfuqizon Direktivën 76/160/KEE). Kjo direktivë përmban dispozita për:

a) monitorimin dhe klasifikimin e cilësisë së ujërave të larjes;
b) menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes; dhe
c) informimin e Publikut për cilësinë e ujërave të larjes.

Qëllimi i kësaj direktive është të ruajë, mbrojë e përmirësojë cilësinë e mjedisit, si dhe të mbrojë shëndetin e njeriut duke plotësuar DKU-në. Kjo Direktivë gjen zbatim për çdo element të ujërave sipërfaqësore ku autoriteti kompetent pret të lahen shumë njerëz dhe nuk ka vendosur asnjë ndalim të përhershëm lidhur me larjen, ose nuk ka dhënë asnjë këshillim të përhershëm kundër larjes (referuar në vijim si ujëra të larjes). Nuk zbatohet për:

a) pishinat dhe spa-të;
b) ujërat e rrethuara që i nënshtrohen trajtimit ose përdorimit për qëllime terapeutike;
c) ujërat e rrethuara të krijuara artificialisht, të ndara nga ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore;

“Masat e menaxhimit” nënkupojnë masat e mëposhtme që merren për ujërat e larjes:

a) krijimi dhe ruajtja e profilit të ujërave të larjes;
b) përcaktimi i kalendarit të monitorimit;
c) monitorimi i ujërave të larjes;
d) vlerësimi i cilësisë së ujërave të larjes;
e) klasifikimi i ujërave të larjes;
f) identifikimi dhe vlerësimi i shkaqeve të ndotjes që mund të prekin ujërat e larjes dhe dëmtojnë shëndetin e atyre që lahen në to;
g) informimi i Publikut;
h) ndërmarrja e veprimeve për të parandaluar ekspozimin e atyre që lahen ndaj ndotjes;
i) ndërmarrja e veprimeve për reduktimin e riskut të ndotjes.

Identifikimi dhe karakterizimi i ujërave të larjes në Shqipëri nuk realizohet sipas kërkesave të Direktivës për Ujërat e Larjes. Ka disa përpjekje për të monitoruar përdorimin e ujërave të larjes si plazhet ose ujërat Rekreative, por klasifikimi i tyre nuk mbështetet te një proces i drejtuar nga kërkesat e BE-së.

Direktiva për Ujërat e Larjes synon të parandalojë dhe reduktojë ndotjen e ujërave të larjes në nivele të tilla që të mos e dëmtojnë shëndetin e njeriut dhe mjedisin; është instrumenti kryesor që BE-ja ka për mbrojtjen e njerëzve gjatë larjes. Përkufizimi i ujërave rekreative u referohet lumenjve, liqeneve dhe ujërave bregdetare që përdoren për qëllime rekreative.

Në basenin e lumit Ishëm, shumica e liqeneve artificiale janë krijuar dhe përdorur për ujitje në bujqësi.

Në bashkinë e Tiranës, ka shumë rezervuarë të ndërtuar gjatë viteve me qëllim ujitjen e tokave bujqësore, prodhimin e energjisë elektrike, furnizimin me ujë të pijshëm, ose si parqe natyrore. Gjatë fazës së projektimit, janë marrë masa që digat të jenë të sigurta dhe vëllimet e ujit të mundësojnë funksionalitetin e tyre. Sipas

studimeve të deritanishme, zhvillimi urban informal i këtyre viteve i ka tjetërsuar veprat e rezervuarëve dhe ka sjellë humbje të funksioneve të tyre, për shkak të mungesës së mirëmbajtjes[42].

a) Liqeni Artificial i Tiranës është luginë me erozion që ndodhet midis një vargu kodrinor, ku kryqëzohen disa rrjedha që përfundojnë në liqen. Liqeni furnizohet kryesisht vetëm nga ujërat e liqenit dhe reshjet. Kapaciteti i liqenit është 2,500.00 m^3; diga u ndërtua në periudhën 1957-1958 me lartësi fillestare prej 12.5 m, e cila u rrit me 2 metra në vitin 1962. Liqeni u ndërtua duke pasur fillimisht si qëllim kryesor furnizimin me ujë industrial të ish-fabrikës së tekstileve. Më pas, liqeni u furnizua nga Liqeni i Farkës, i cili u përdor për ujitje. Parku i Liqenit Artificial është 289ha dhe ndodhet në pjesën jugore të Tiranës.
b) Rezervuari i Paskuqanit u ndërtua në vitin 1983, me një sipërfaqe prej 2500 ha dhe vëllim prej 9 Mm^3 në atë kohë.
c) Rezervuari i Kasharit (Purez) u ndërtua në vitin 1971 me qëllim ujitjen e tokave bujqësore të fermave, me vëllim 1.5 Mm^3. Sot, sipërfaqja e këtij rezervuari është reduktuar thuajse në sipërfaqen fillestare prej 500 ha kur u ndërtua.
d) Rezervuari i Kasharit u ndërtua në 1963-shin me një vëllim prej 1.8 Mm^3 dhe zona e ujitshme është rreth 500 ha.
e) Rezervuari i Çekrezës u ndërtua në 1968-n me një vëllim prej 4.8 Mm3 dhe me zonë të ujitshme rreth 300 ha.
f) Rezervuari i Farkës dhe u ndërtua në 1984-n, me vëllim prej 9.0 Mm^3 dhe me zonë të ujitshme rreth 1900 ha. Sot, sipërfaqja është pakësuar. Liqeni i Farkës është liqen artificial dhe park bashkiak në juglindje të Tiranës. Është rreth 9.6 km larg qendrës së qytetit. Ky liqen është rreth 75 ha më i madh se Liqeni Artificial i Tiranës. Ka një gjatësi maksimale prej dy kilometrash dhe gjerësi maksimale prej 700 m. Diga në jug është rreth 300 m e gjatë.

3.5.4 Zonat e Ndjeshme ndaj Lëndëve Ushqyese

Objektivat e përgjithshme të Direktivës së Nitrateve janë:

- reduktimi i ndotjes së ujit, shkaktuar apo nxitur nga nitrate që vijnë nga burime bujqësore
- parandalimi i mëtejshëm i kësaj ndotjeje.

Këto objektiva do të arrihen nëpërmjet përvijimit të Zonave të Ndjeshme nga Nitratet (ZNN) dhe programeve të veprimit që po zbatohen në këto zona. ZNN-të përfshijnë të gjitha tokat ku kullojnë "ujëra të ndotura", sipas përkufizimit të Direktivës. Është publikuar edhe Kodi i Praktikës së Mirë Bujqësore, i cili i këshillon fermerët se si të reduktojnë humbjet e nitrateve në mjedis. Pasurimi i ujërave me lëndë ushqyese (sidomos me fosfate dhe nitrate), që sjell eutrofikimin e ujërave, është një prej pikave më të rëndësishme të statusit të trupit ujor. Shkarkimi i lëndëve ushqyese në trupa ujorë trajtohet nga tre Direktiva Evropiane:

- Direktiva Kuadër e Ujit (DKU)(2000/60/KE)
- Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (DTUNU)(91/271/KEE)
- Direktiva për Nitratet (DN)(91/676/KEE)

Zonat e shpallura si zona të pambrojtura trajtohen nga Direktiva 91/676/KEE, ndërsa zonat e shpallura si zona të ndjeshme trajtohen nga Direktiva 91/271/KEE.

Direktiva e Këshillit 91/271/KEE trajton kryesisht veprimet menaxhuese që kërkohen për mbrojtjen e trupave ujorë nga ujërat e ndotura urbane (familjare), mbetjet industriale dhe vërshimet sipërfaqësore. Standardet për lëndët ushqyese dhe standardet ekologjike në DKU përdoren pikësëpari për të identifikuar trupat ujorë të eutrofikuar, të cilët do të mund të kontrollohen më pas sipas standardeve të DTUNU-t ose DN-së.

[42]Plani i përgjithshëm i qytetit të Tiranës Ndryshuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, datë 14.04.2017

Nëse shkarkimet nga ITUN-ët (ato që i shërbejnë një ekuivalenti popullsie (p.e.) më të madh se 10,000), vlerësohen se shkaktojnë eutrofikim (ose mund të shkaktojnë) drejtpërdrejtë apo tërthorazi, ose sjellin nivele të tepërta të fosfatit total (pra > 2.0 mg/l P) dhe të azotit total (pra > 15 mg/l N)[43], ose > 50 Mg/ l NO3) në furnizimet me ujë të pijshëm, trupi ujor identifikohet si i ndjeshëm dhe për rrjedhojë kërkohet një nivel trajtimi që shkon përtej nivelit dytësor, me qëllim mbrojtjen e këtyre zonave. Direktiva e Këshillit 91/676/KEE për mbrojtjen e ujërave kundër ndotjes së shkaktuar nga nitratet me origjinë nga bujqësia. Për shkak të natyrës shpërndarëse të këtij lloji të ndotjes, zakonisht aplikohet qasja "i gjithë baseni" për zbatimin e DN-së, ku Programi i Veprimit sipas DN-së gjen zbatim për të gjithë fermerët.

3.5.5 Zonat e Shpallura për Mbrojtjen e Habitateve ose Specieve

Këtu përfshihen zona ku ruajtja ose përmirësimi i statusit të burimeve ujore është faktor shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e tyre, përfshi edhe zonat e Natura 2000 të shpallura sipas Direktivës 92/43/KEE dhe Direktivës 79/409/KEE. "Zonë e Mbrojtur" përfshin tokën, ujërat, hapësirën detare dhe bregdetare, të përkufizuara mjaft qartë gjeografikisht, me përcaktim të qartë kufijsh dhe të menaxhuara me mjete ligjore ose mjete të tjera efikase, për arritjen e konservimit/ mbrojtjes afatgjatë të natyrës, lidhur me shërbimet e ekosistemeve dhe vlerat kulturore. Sipas legjislacionit të BE-së, një zonë e mbrojtur është një zonë gjeografike e përcaktuar qartë, e cila është i dedikohet arritjes së konservimit afatgjatë të natyrës. Kategoritë e menaxhimit të zonave të mbrojtura të IUCN-së i klasifikojnë zonat e mbrojtura sipas objektivave të tyre të menaxhimit.[44] Në shkallë BE-je, rrjeti Natura 2000 u krijua nëpërmjet Direktivës për Shpendët dhe Direktivës për Habitatet. Qëllimi kryesor është të sigurohet konservimi i llojeve dhe habitateve të shënjestruara dhe me interes evropian Rrjeti Emerald i BE-së është një rrjet ekologjik i përbërë nga Zona me Interes të Veçantë Konservimi. Objektivi është mbijetesa afatgjatë e llojeve dhe habitateve të Konventës së Bernës, të cilat kërkojnë masa të veçanta mbrojtjeje.

Objektivi i Zonave të Mbrojtura të Natura 2000, i identifikuar në lidhje me zonat përkatëse të përvijuara në kuadër të Direktivës së Habitateve është të:

"Mbrojë dhe, kur është e nevojshme, përmirësojë statusin e mjedisit ujor deri në shkallën e nevojshme për arritjen e objektivave të konservimit që synojnë mbrojtjen ose përmirësimin e llojeve të habitatit natyror të zonës, me rëndësi për Komunitetin, për t'u siguruar që zona të vijojë të kontribuojë në ruajtjen ose restaurimin e statusit të favorshëm të konservimit".

Kur një Zonë e Mbrojtur e Natura 2000 synon të jetë pjesë e një trupi ujor, ose kur një trup ujor është pjesë e një Zone të Mbrojtur në Natura 2000, krahas kërkesave për ruajtjen e statusit të favorshëm të konservimit, ose restaurimin e këtij statusi, gjejnë zbatim edhe objektivat e DKU-së. Disa trupa ujorë që përkojnë me Zonat e Mbrojtura nga Natura 2000 janë përvijuar si trupa ujorë artificialë ose tepër të modifikuar. Në këto raste, vlen qëllimi i arritjes së potencialit të mirë ekologjik, krahas objektivit të statusit të favorshëm të konservimit. **Shtojca B** përcakton objektivat për statusin e çdo trupi ujor dhe tregon se ku trupi ujor përkon me Zonën e Mbrojtur të Natura 2000. Objektivat e trupit ujor janë të pavarura nga objektivat e statusit të trupit ujor në Shtojcën B, por të gjitha objektivat duhen përmbushur në përputhje me Direktivat përkatëse të KE-së. Duhet vërejtur se objektivat e statusit të trupit ujor në **Shtojcën B** nuk përkojnë gjithnjë me objektivat e Zonës së Mbrojtur nga Natura 2000 në këtë Shtojcë, edhe kur elementi është i njëjtë, fjala vjen fosfati.

Një trup ujor mund t'i arrijë objektivat e "statusit të mirë", por mund të mos i arrijë objektivat e Zonës së Mbrojtur Natura 2000 për konservimin ose restaurimit të statusit të favorshëm të konservimit. Trupi ujor mundet ta arrijë statusin e favorshëm të konservimit (për shembull për salmonin), por mund të mos e arrijë "statusin e mirë" në një trup tjetër ujor (për shembull për peshqit, duke qenë se DKU-ja kërkon veprime për mbrojtjen dhe rikthimin e një game të gjerë të llojeve të peshqve). Ndonëse objektivi për të restauruar ose ruajtur statusin e favorshëm të konservimit në zonat Natura 2000 përcaktohet nga Direktivat e BE-së për Habitatet dhe Shpendët, nuk ka asnjë datë të caktuar për arritjen e tij. DKU-ja ka përcaktuar vitin 2015 si afat, i cili vlen për Zonat e Mbrojtura Natura 200 (ZVR dhe ZVM që varen nga ujërat) të listuara (referuar Shtojcës VI). Nëse zona e mbrojtur është edhe trup ujor, ose është pjesë e një trupi ujor, afati për rehabilitimin e statusit të favorshëm të konservimit mund të zgjatet kur plotësohen kushtet në Nenin 4.4 të DKU-së. Nëse zona e mbrojtur

[43] Azoti Total (AT) = Σ (azoti joorganik + azoti organik). Azoti joorganik = amon (NH4) + nitrate (NO3) + nitrite (NO2)

[44] https://www.iucn.org/theme/protected-areas/about/protected-area-categories

nuk është trup ujor, por për shembull kënetë ose moçal, afati për arritjen e statusit të favorshëm të konservimit nuk mund të zgjatet. Puna për menaxhimin e zonave të Natura 2000[45] ka nisur vetëm së fundi. Në kuadër të projektit NaturAL, është identifikuar shpërndarja e mundshme e Zonave të Natura 2000 me Interes për Komunitetin (ZIK), gjë që ka sjellë hartimin e listës paraprake me 43 zonat e propozuara për të gjithë vendin. Sipas kësaj liste, në basenin e lumit Ishëm, si zona të Natura 2000 me interes për komunitetin janë identifikuar tri zona të mbrojtura (tabela 3-2).

Tabela 3-2 – Zonat e Mbrojtura sipas Natura 2000 në basenin e lumit Ishëm

KODI_I ZONËS	EMRI_I ZONËS	ZM-ja ekzistuese	Harta e Habitatit
AL0000007	Dajt	Po	Jo
AL0000015	Bizë-Brosh-Berdhet	Po	Jo
AL0000024	Rrushkull-Bisht Pallë	Po	Jo

[45] BE - Forcimi i Kapaciteteve Kombëtare për Mbrojtjen e Natyrës – Përgatitja për Rrjetin Natura 2000, Mars 2019

4 Vështrim i Përgjithshëm rreth Basenit Ujor

Qëllimi i vështrimit të përgjithshëm të basenit ujor është të paraqesë një përmbledhje të përgjithshme të tipareve kryesore të hidro-meteorologjisë, topografisë, gjeologjisë, popullsisë, përdorimit të tokës dhe përdorimit të ujit në basen, për sa kohë që këto karakteristika mund të ndikojnë në tipologjinë dhe statusin e trupave ujorë. Këto elemente mund të konsiderohen si "forcat drejtuese (nxitëse)" të basenit ujor.

4.1 Ndarja në Nënbasene

Rajonet e baseneve ujore, madje edhe vetë basenet shumë rrallë mund të kenë karakter homogjen dhe nuk analizohen ose menaxhohen me efikasitet si njësi të vetme. DKU-ja lejon ndarjen në nën-njësi më të vogla dhe më homogjene (basene dhe nënbasene) brenda rajonit të basenit ujor,[46] në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare. Për shembull, problematikat menaxheriale të ndotjes së shpërndarë (difuze) analizohen dhe menaxhohen më mirë në nivel nënbaseni, jo në nivel trupi ujor individual.

Qasja e ndjekur në Shqipëri ka qenë kryesisht ndarja e çdo baseni në jo më shumë se pesë nënbasene, bazuar te një karakteristikë e vetme e përbashkët (p.sh digë e madhe, lloji gjeologjik mbizotërues, lloji mbizotërues i përdorimit të tokës) ose kombinimi i disa karakteristikave të tjera ndikuese, duke përfshirë por pa u kufizuar te:

- Kufij të ndryshëm të formacioneve gjeologjike të mëdha p.sh karboniferik deri në silicor.
- Ndryshime në lartësi të konsiderueshme ekologjike ose mbulesë toke p.sh < 200 m ose > 800 m, pyjore në urbane etj.
- Pikat e kthesës natyrore të krijuara nga degët(tributarët) e mëdha furnizuese, infrastruktura e modifikimeve të lumit p.sh diga të mëdha, kanalizimi i lumenjve etj.
- Përqendrimet e ndikimeve antropogjene p.sh zona me dominim urban ose bujqësor.

Duhet vërejtur se këto diferencime kaq të gjera përkojnë në përgjithësi me të njëjtën tipologji caktimi kufijsh që përdoret për trupat ujorë. Prandaj, karakteristikat e nënbasenit duhet të pasqyrojnë karakteristikat e trupit ujor në përgjithësi. Ndarja në nënbasene është mjaft e vlefshme për të hartuar politika dhe strategji më të fokusuara, veçanërisht lidhur me presionet e përdorimit të tokës si zhvillimi urban apo ndotja e shpërndarë që vjen nga bujqësia (Kapitulli 12).

4.2 Klima dhe hidrometeorologjia

Klima në përgjithësi dhe reshjet vjetore dhe sezonale në veçanti (reshjet e dëborës dhe/ose të shiut) veprojnë si nxitësit kryesorë të të gjitha ndërveprimeve ujore në basenin ujor . Vlerësimi i hidrometeorologjisë është i rëndësishëm për të kuptuar presionet, gjendjen/statusin dhe ndikimet në gjendjen natyrore të trupave ujorë në basenin ujor.

Vlerësimi i plotë teknik i hidrometeorologjisë dhe ndikimeve të saj të detajuara në basen paraqiten kryesisht në Planin e Menaxhimit të Burimeve Ujore ose në strategji të tjera të ngjashme plotësuese. Hidrometeorologjia lidhet vetëm me objektivat mjedisore të basenit ujor, për të përcaktuar:

- Burimet vjetore të rinovueshme të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, pra burimet që mund të shfrytëzohen çdo vit pa kompromentuar qëndrueshmërinë në të ardhmen
- Regjimin e prurjes natyrore sezonale (me zero ndikime antropogjene) që përfshin kohën, magnitudën dhe kohëzgjatjet e prurjeve të specifikuara
- Regjimin e prurjes mjedisore (ekologjike) të natyralizuar (pjesën e rrjedhës së plotë natyrore, që është minimumi i kërkuar për të ruajtur ekosistemet ujore). Prurja mjedisore nuk është vetëm një vlerë minimale, por është vazhdimësia e rrjedhës natyrore përgjatë të gjithë vitit.

[46] Agjencia Evropiane e Mjedisit, Direktiva Kuadër e Ujit, raportimi për burimet, Fondi Qendror i të Dhënave të EIONET, (Skema SWB: EUSubUnitCode). http://cdr.eionet.europa.eu/help/WFD/WFD_521_2016

Ndikimet e konsiderueshme dhe të pakontrolluara antropogjene në secilën prej sa më lart që nuk shoqërohen me masa zbutëse ka shumë gjasa që të sjellin reduktim të statusit ekologjik të trupit ujor mbi të cilin ushtrohet ndikimi, dhe për rrjedhojë moskalimin e testeve parësore të DKU-së, përkatësisht që "trupat ujorë të gëzojnë Status të Mirë" dhe "të mos ketë përkeqësim të statusit poshtë nivelit aktual". Prandaj, hidrometeorologjia bazë është një pjesë mjaft e rëndësishme e kushteve të referencës për statusin ekologjik.

4.2.1 Klima dhe Meteorologjia - Baseni i Lumit Ishëm

Reshjet vjetore në të gjithë basenin e lumit Ishëm me sipërfaqe prej 721 km² arrijnë në 1440 mm. Kjo vlerë shpërndahet nga pikëpamja hapësinore sipas Hartës 4-1 nëpër stacionet përfaqësuese. Këto të dhëna vijnë nga 20 stacione të monitorimit të reshjeve që ndodhen në qendër ose në periferi të basenit. Statistikat klimatike mujore paraqiten në Tabela 4-1 për vendndodhje të caktuara. Njësoj si për pjesën më të madhe të Shqipërisë Perëndimore, pjerrësia e reshjeve ulet kur kalojmë nga lindja në perëndim, për shkak të uljes së lartësisë. Baseni shkarkon në lumin kryesor të Ishmit, me degë mjaft të mëdha furnizuese që formohen nga lumenjtë e Tiranës, Lanës, Tërkuzës dhe Zezës. Ato përbëhen nga disa rrjedha të mëdha dhe të vogla, të cilat derdhen në lumin kryesor të Ishëmit.

Regjimi vjetor meteorologjik përgjatë basenit përmblidhet në Figurën 4-6 për të tre Stacionet përfaqësuese në lartësi të ndryshueshme[47]. Viti më i lagësht sipas standardit klimatik WMO për periudhën 1991-2020 [48] raportohet të ketë qenë viti 1991 me reshje vjetore totale prej 1993 mm në Stacionin Dajt[49]. Viti më i thatë regjistrohet viti 2011 me një vlerë totale reshjesh prej 1085 mm në Stacionin Dajt (shihni Shtojcën Teknike III për të dhënat).

Në të gjitha stacionet haset po i njëjti regjim meteorologjik, ku 30 %+ e totalit të reshjeve vjetore të shiut bien zakonisht në sezonin tetor-nëntor-dhjetor. Dy muajt më të thatë janë korriku dhe gushti, të cilët përfaqësojnë < 10% të totalit vjetor.

Tabela 4-1 – Variablat Klimatike Kryesore – Baseni Ishëm

PARAMETRI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	Σ
TEMPERATURA MESATARE	6.3	7.7	9.8	13.1	17.4	21.6	23.8	23.4	20	15.4	11.3	7.7	
RESHJET[50]	145	135	111	93	87	60	35	41	72	107	166	155	1207
EVAPOTRANSPIRIMI [51]	37	45	65	86	120	154	172	150	107	66	47	39	1088
EVAPOTRANSPIRIMI [52]	22	32	62	92	122	150	23	31	60	64	35	23	716

[47] Instituti i Gjeoshkencave (IGjEO) për periudhën 1991-2018.

[48] Organizata Botërore Meteorologjike, Rregulloret Teknike, "Normalet Standarde Klimatologjike"

[49] Raportuar si vite kalendarike, (jo si vite hidrologjike që fillojnë në tetor).

[50] Sipas burimeve në internet.

[51] Përkufizuar si Evapotranspirim Referencë ET_0. Burimi Laska, A. e të tjerë "Evapotranspirimi dhe Vlerësimi i tij në Shqipëri", BALWOIS 2010. FAO 56 Përdorimi i ekuacionit Penman-Monteith në Durrës.


[52] Përkufizuar si Evapotranspirim Referencë ET_0. Burimi Laska, A. e të tjerë "Evapotranspirimi dhe Vlerësimi i tij në Shqipëri", BALWOIS 2010. Përdorimi i ekuacionit Thornthwaite në Durrës.

4.2.2 Hidrologjia - Baseni i Lumit Ishëm

Në stacionin matës të rrjedhës më të poshtme të basenit (Lumi Ishëm në Sukth Vendas), prurja mesatare vjetore (PMV) për periudhën 1968-1992 [53] ishte 18.6 m³/s (raportuar si 20.2 m³/s në hidrologjinë e Shqipërisë 1984).[54] E faktorizuar për të gjithë zonën e basenit (704/624 km²), kjo vlerë na jep një normë të përafërt mesatare për shkarkimet vjetore në basenin ujor prej 22.8 m³/s. Hidrografika e prurjes për tre regjimet përfaqësuese të lumit (Tiranë, Zezë dhe Ishëm) paraqitet në Figurën 4-7 për periudhën 1960-1992[55]. Që prej vitit 1990, baseni i lumit Ishëm ka pësuar ndryshime të konsiderueshme hidrologjike, ku më e rëndësishmja është rritja e popullsisë nga 244,000 (1990) në 814,000 (2018, vlerësim i përafërt nga UKT-ja).

Rezervuari i Bovillës u vu në punë në vitin 1999/2000 dhe ka rëndësi mjaft të madhe hidrologjike pasi devijon rreth 207 Ml/ditë (2.40 m³/s) ujë të depozituar nga Ujëmbledhësi i Tërkuzës, i cili derdhet në Bovillë (ISH3) në Ujëmbledhësit pritës të lumit të Tiranës dhe Lanës (ISH1). Ndikimi i bilancit të ujit është minimal, pasi lumenjtë e Tërkuzës, Tiranës dhe Lanës bashkohen në kufirin e rrjedhës së poshtme të ISH1. Megjithatë, rrjedha e Tërkuzës është privuar e gjitha tashmë nga rrjedha e poshtme e Digës së Bovillës pasi projektimi i saj nuk parashikonte prurje mjedisore ose kompensuese. Regjimi i prurjes dhe prishja ekologjike e Tërkuzës duket se janë në nivele të konsiderueshme dhe si rrjedhojë është klasifikuar si Trup Ujor Tepër i Modifikuar (TUTM). Ndryshimi drastik i kurbës së kohëzgjatjes së prurjes në lumin e Tërkuzës paraqitet në Figurën 4-1.

Figura 4-1 - Kurbat e kohëzgjatjes së prurjes për lumin e Tërkuzës përpara dhe pas ndërtimit të Digës së Bovillës.



Krahas regjimeve të prurjes vjetore, hidrologjia e basenit ujor karakterizohet më së miri nga Kurbat e Qëndrueshmërisë së Prurjes, që paraqesin kohën për të cilën barazohet ose tejkalohet një prurje e caktuar. Prurjet treguese të Q_{10}, Q_{25}, Q_{50}, Q_{75} dhe Q_{90} kanë rëndësi të veçantë. Q50 është matja më e besueshme e prurjes së mundshme (duke mbizotëruar ndaj vlerave më ekstreme të regjistruara) ndaj kjo vlerë duhet përdorur për planifikimin afatgjatë të shpërndarjes së burimeve ujore, dhe jo si vlerë mesore. Zakonisht, raporti Q_{90}/Q_{50} shërben si tregues i mirë i shkarkimeve të ujërave nëntokësore si pjesë e prurjes totale të matur, që quhet ndryshe edhe Indeksi i Prurjes Bazë (BFI). Në baza vjetore mesore, prurja mjedisore minimale absolute nuk duhet

[53] Të dhënat janë marrë nga dy periudha: 1968-1992 dhe 1992-2008. Të dhënat janë të disponueshme për të treguar magnitudën relative të prurjeve të lumit (të cilat mund të kenë ndryshuar që prej vitit 1992).

[54] Ka disa mosrakordime midis të dhënave që iu ofruan projektit dhe të dhënave historike për Hidrologjinë Shqiptare 1984. Prurjet vjetore mesatare në Raportin e Shqipërisë për 1984-n janë 15-18% më të larta, gjë që do të thotë se ka gabime ose ndryshime të konsiderueshme të të dhënave për hidrologjinë gjatë periudhës 1984 – 2008, ku kjo e fundit nuk ka të ngjarë.


[55] Banka Botërore, Për krijimin e platformës institucionale dhe rregullatore për qeverisjen dhe funksionimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore në Shqipëri, Raporti i Vlerësimit WRIP/WMA/3/CS/006, 2019.

të jetë më e vogël se Q_{95}, ndërsa në sistemet e ndikuara nga ujërat nëntokësore (BFI ≥ 0.35+) duhet të jetë të paktën e barabartë ose më e madhe se Q_{90}. Krahasimi me profilet meteorologjike dhe hidrologjike tregon se piku i reshjeve shënohet në Nëntor për pjesën më të madhe të stacioneve. Megjithatë, piku i prurjeve regjistrohet në janar dhe shkurt. Kjo vonesë vjen për shkak se depozita e ujërave nëntokësore rimbushet përpara se ujërat nëntokësore të arrijnë nivelet e mjaftueshme për t'u shkarkuar në sistemet lumore në formën e prurjes bazë. Kurbat e Qëndrueshmërisë së Prurjes për të tre stacionet matëse të prurjeve janë te Tabela 4-2. Mungesa e plotë e të dhënave të besueshme për prurjet që prej vitit 1992 kompomenton ndjeshëm shumë aspekte të objektivave mjedisore për basenin ujor, pasi prurja është komponent kritik i statusit ekologjik të trupit ujor dhe shërben si bazë për shumë tregues volumetrikë të presionit. Prurjet aktuale, nivelet e rimbushjes, disponueshmëria e burimeve ujore dhe kontributi i ujërave nëntokësore në ujërat sipërfaqësore, vlerat e prurjes mjedisore dhe komponenti i ngarkesës kimike të ujërave sipërfaqësore janë përditësuar deri në vitin 2008.

Tabela 4-2 – Kurbat e Qëndrueshmërisë së Prurjes për Stacionet Matëse të Prurjeve në Basenin e Lumit Ishëm [56]

STACIONI MATËS I PRURJEVE	LUMË	GJERËSIA WGS84 [57]	GJATËSIA WGS84	Q_{10}	Q_{25}	MAF	Q_{50}	Q_{75}	Q_{90}	Q_{95}
Zall Dajt	Tiranë	41.400424°	19.925794°	2.64	2.20	1.70	1.67	1.04	0.76	0.66
Brar Shupal	Tiranë	41.379939°	19.859456°	4.05	3.84	3.10	3.04	2.60	2.23	2.05
Hotel Dajti	Lana	41.323944°	19.820972°	0.67	0.54	0.49	0.44	0.34	0.27	0.22
Ura Gjoles	Ishëm	41.467361°	19.691667°	26.52	18.9	14.8	12.43	8.2	5.9	5.2
Lorushk [58]	Tërkuza	41.445442°	19.699505°	9.13-	7.62	6.57	6.37	5.19	4.27	3.81
Zall-Herr (Pinar)	Tërkuza	41.409516°	19.833934°	5.25	4.28	3.32	3.37	2.62	2.29	2.27
Arameras Fushë-Krujë	Zezë	41.474083°	19.720750°	5.42	3.42	1.95	1.82	1.12	0.69	0.48
Sukth Vendas	Ishëm	41.525694°	19.618389°	32.67	22.32	17.15	14.95	9.31	7.32	5.75

Figura 4-2 - Shembull i Kurbës së Qëndrueshmërisë së Prurjes në stacionin matës të Zall Dajtit, lumi i Tiranës - (*Majtas, kurba e kohëzgjatjes afatgjatë të prurjes dhe djathtas, kurbat vjetore*)



4.2.3 Përmbledhja e Bilancit Ujor të Basenit Ujor të Lumit Ishëm

Përcaktimi i një bilanci të besueshëm uji për një basen ujore të caktuar është mjaft i vështirë, pasi kërkon të dhëna të sakta dhe të kohëve të fundit për matjet e flukseve në hyrje, flukseve në dalje dhe niveleve të konsumit.

[56] Të dhënat hidrometrike (të prurjes) për basenin lumor janë përditësuar deri në 2008-n. Këto të dhëna përdoren për të llogaritur kushtet aktuale hidrologjike.

[57] Koordinatat e WGS84. Koordinatat e stacionit matës të ofruara nga IGJEO-i nuk janë verifikuar në terren dhe mund të mos jenë të sakta.

[58] Të dhënat janë marrë nga raporti i Hidrologjisë së Shqipërisë, 1984.

Megjithatë, është thelbësore të kuptojmë cilat janë burimet parësore të prurjeve hyrëse në basen dhe si konsumohet apo transferohet uji midis burimeve (burime sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe së fundi se si shkarkohet te pika dalëse (në det ose në basenin ndërkufitar të rrjedhës së poshtme), në mënyrë që të korrigjojmë mënyrën si e kuptojmë hidrodinamikën e basenit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave. Vlerësimi i plotë dhe i detajuar i kërkesës dhe ofertës së burimeve ujore është subjekt i një raporti më teknik, i cili aktualisht nuk mbulohet nga PMBU-ja.

Bilanci standard i ujit të basenit ujor , i zbatuar rishtas në Shqipëri, na lejon të kuptojmë një sërë çështjesh kyç (shihni Tabelën 4-6 [59]):

- Ndërlidhja midis ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ndonëse shpesh menaxhohen dhe raportohen më vete, në të vërtetë janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën [60]. Volumi i rimbushjes së ujërave nëntokësore në veçanti është vlerë kritike për ekosistemet ujore dhe licensimin e nxjerrjeve dhe shpeshherë nuk raportohet si duhet në vlerësimet MIBU.
- Për të gjetur Burimin e Rinovueshëm Vjetor (BRV), humbjet natyrore (avullimi, transpirimi dhe flukset në dalje të ujërave nëntokësore ndërkufitare) duhen zbritur nga flukset në hyrje në total (reshjet, flukset në hyrje në ujërat sipërfaqësore ndërkufitare dhe flukset në hyrje në ujërat nëntokësore).
- Nëse BRV-ja e ujërave sipërfaqësore apo nëntokësore (ose e të dyjave) tejkalohet vazhdimisht nëpërmjet nxjerrjeve dhe konsumit të tepërt, baseni ujor[61], ndodhet në një pozicion të pafavorshëm që mund të sjellë rënie të prurjeve lumore dhe/ose nivelit të ujërave nëntokësore. Objektivat mjedisore të basenit ujor ndikohen në të dyja rastet.
- Duhen vlerësuar sektorë të caktuar ekonomikë për të identifikuar sektorët përgjegjës për nivelet më të larta të konsumit[62]. Zakonisht, ky sektor është thuajse gjithnjë bujqësia, për shkak të niveleve të larta të transpirimit të kulturave bujqësore të ujitura intensivisht dhe praktikave joefikase të ujitjes, por edhe uji për qëllime bashkiake shkakton humbje të konsiderueshme të ujërave sipërfaqësore në ujëra nëntokësore dhe anasjelltas. Skemat hidroenergjetike mund të devijojnë sasi të mëdha uji midis nënbaseneve. Këto transferime të ujit mund të dëmtojnë rëndë objektivat mjedisore nëse nuk ndërmerren veprimet e duhura zbutëse.
- Një prej objektivave themelore të menaxhimit të shëndoshë të burimeve ujore është të përcaktohen dhe kontrollohen indekset kyç të shfrytëzimit të ujit për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, për të mbrojtur kërkesat e prurjes ekologjike dhe siguruar sasi afatgjata për përdorime ekonomike[63].

4.2.4 Vlerësimi dhe Ndikimet e Ndryshimeve Klimatike Globale

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara kanë përgatitur tre komunikime kombëtare për Shqipërinë sipas Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike[64].

Sikurse tregon Figura 4-3, Figura 4-5, Tabela 4-3, Tabela 4-4, sipas Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNNK), skenari më pesimist i përkeqësimit të ndryshimeve (Itinerari i Përqendrimit Përfaqësues (RCP) 8.5), rritjet e konsiderueshme të temperaturës dhe pakësimi i reshjeve priten të ndikojnë veçanërisht Evropën Juglindore[65]. Për Evropën Juglindore, reshjet vjetore mund të reduktohen deri në 20% deri në 2100, krahasuar me nivelin bazë të 1990-s.

---

[59] Praktika më e mirë e Bilancit Gjithëpërfshirës të Ujit të Basenit është në përputhje me konceptet e përgjithshme të Sistemit të OKB-së së Llogaridhënies Mjedisoro-Ekonomike për Ujin (UN SEEAW), UN DESA, 2012

[60] Ujërat Nëntokësore dhe Sipërfaqësore - Një Burim i Vetëm, ShBA Qarkore e Anketës Gjeologjike 1139, 1998

[61] KONSUMI– përkufizuar hidrologjikisht si: (Nxjerrje + Eksporte) – (Kthime + Importe).

[62] KONSUMI në këtë kontekst është në përputhje me përkufizimin e UN SEEAW: Nxjerrjet Totale = Kthimet Totale + Konsumi i Ujit

EUROSTAT – Indeksi i Shfrytëzimit të Ujit - https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-datasets/-/t2020_rd220

[64] Komunikimi Kombëtar i Parë (2002), i Dytë (2009), i Tretë (2016) i RepuBUikës së Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike

[65] IPCC – Raporti i Vlerësimit 5 (AR5) - Ndryshimet Klimatike 2014: Ndikimet, Përshtatja dhe Cenueshmëria, WGII, IPCC 2014.

Këto ndryshime meteorologjike mund të kenë ndikime masive dhe katastrofike për përshtatjen e ekosistemeve ujore, [66]thatësirat, [67]burimet ujore dhe bujqësinë përgjatë të gjithë baseneve ujore në Shqipëri.[68] Analiza e detajuar e këtyre ndikimeve u është lënë strategjive specifike për sektorin lidhur me burimet ujore, përmbytjet dhe thatësirat që mbështesin elementet e PMBU-së.

Për sa i përket objektivave të kësaj PMBU-je, ndryshimet klimatike janë të rëndësishme pasi ndikojnë te statusi i ardhshëm i trupave ujorë. Prandaj, ndryshimet klimatike përfaqësojnë një prej presioneve më kritike të mjedisit ujor, të cilat manifestohen nëpërmjet:

- Rritjes së evapotranspirimit të sipërfaqeve të tokës, duke reduktuar kështu rimbushjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe rritur humbjet e ujit (ndryshime të bilancit të ujit).
- Pakësimit të reshjeve, duke reduktuar burimet ujore në përgjithësi dhe duke rritur nevojën për ujitje gjatë verës dhe tharë rrjedhat mjedisore
- Pakësimit të vërshimeve, duke reduktuar rimbushjen e ujërave nëntokësore dhe rezervuarëve, si dhe pakësuar volumet e disponueshme për hidroenergji
- Reduktimit të prurjes së lumit, duke e pakësuar prurjen nën nivelin minimal ekologjik dhe duke rritur përqendrimet e ndotësve.

Figura 4-3 – Treguesit e Ndikimeve të Ndryshimeve Klimatike për Evropën Jugore




Burimi: IPCC Raporti i 5-të i vlerësimit, Grupi II i Punës, 2014

Edhe rritja e nivelit të detit shihet si mjaft e rrezikshme për shumë zona të ulëta bregdetare, duke kërcënuar shumë habitate të vyera ekologjike, trupat ujorë nëntokësorë, infrastrukturën bregdetare dhe atë bujqësore. .

Figura 4-4 tregon zonat e rrezikuara nga përmbytja me një probabilitet bazë prej 10% për vijën bregdetare të Ishmit, sipas skenarit RCP 8.5 brenda 30 vjetësh[69].

Figura 4-4 - Zonat Bregdetare të Rrezikuara nga Përmbytja të Parashikuara për Periudhën 10-vjeçare deri në 2050-n



[66] BioScience, 2019, Vëll. 70, Nr. 1, "Paralajmërimi i Shkencëtarëve në Botë për një Emergjencë Klimatike"

[67] IPPC – Raport i Veçantë – Ngrohja Globale prej 1.5°C, IPCC 2018

[68] Banka Botërore – 'Cilësi e Panjohur – Kriza e Padukshme e Ujit', Grupi i BB-së 2019

[69] Climate Central - E ARDHMJA E PËRMBYTUR: Cenueshmëria Globale e Rritjes së Nivelit të Detit më e Rrezikshme nga sa Mendohej më Parë, 2019

Figura 4-5 – Ndryshimet e Reshjeve sipas Modelit të Shumëfishtë Global të IPCC-së – RCP8.5 [43]




Tabela 4-3 – Ndryshimi indikativ në % i Temperaturës Globale, IPCC, viti bazë 1990-a

Vitet	2030	2050	2080	2100
Vjetore	1.0 (0.7 to 1.2)	1.7 (1.3 to 2.2)	2.8 (2.0 to 3.5)	3.2 (2.4 to 4.1)
Dimër	0.8 (0.7 to 0.9)	1.2 (1.0 to 1.4)	2.8 (1.7 to 2.3)	2.4 (1.9 to 2.7)
Pranverë	1.0 (0.8 to 1.12)	1.5 (1.3 to 1.8)	2.6 (2.2 to 3.0)	3.1 (2.6 to 3.6)
Verë	1.6 (0.5 to 1.8)	2.5 (2.1 to 2.8)	4.3 (3.8 to 4.9)	5.3 (4.6 to 6.0)
Vjeshtë	1.0 (1.0 to 1.1)	1.6 (1.5 to 1.8)	2.8 (2.7 to 3.0)	3.5 (3.2 to 3.7)

Tabela 4-4 - Ndryshimi indikativ në % i Reshjeve Globale, IPCC, viti bazë 1990-a

Vitet	2030	2050	2080	2100
Vjetore	3.84 (-35.4 to 27.7)	-8.46 (-56.0 to 47.4)	-14.37 (-78.6 to 81.1)	-18.13 (-69.7 to 94.9)
Dimër	-5.96 (-15.9 to 4.0)	-10 (-27.9 to 7.7)	-14.3 (-44.6 to 16.1)	-18.1 (-55.8 to 19.6)
Pranverë	-2.45 (-11.9 to 7.0)	-7.26 (-25.3 to 10.75)	-14.26 (-45.1 to 16.6	-17.7 (-55.3 to 19.8)
Verë	-10.4 (-12.8 to -7.9)	-19.7 (-24.1 to -15.3)	-41.9 (-49.2 to -34.5)	-50.4 (-59.4 to -41.3)
Vjeshtë	0.5 (-10.1 to 11.1)	-2.5 (-21.3 to 16.3)	-6.9 (-38.1 to 25.2)	-9.5 (-48.1 to 29.1)

4.2.5 Skenari Ndryshimeve Klimatike në nivel vendor - Basenet Ishëm dhe Erzen

Modelet Klimatike Globale (GCM) dhe raportet e IPCC-së paraqesin një vështrim të përgjithshëm të skenarëve të mundshëm në të ardhmen, por analiza e të dhënave vendore nuk mund të zëvendësohet kurrsesi, veçanërisht nëse ka të dhëna prej shumë kohësh. Analiza e vetme dhe më e dobishme që duhet kryer është "testi statistikor i dallimeve të konsiderueshme" për dy vlerat mesatare vjetore të reshjeve afatgjata. Në mënyrë që ky test të jetë i vlefshëm, kërkohen të paktën të dhëna 40+ vjeçare (2x20) për mesatare vjetore, të cilat duhen ofruar nga një stacion meteorologjik i besueshëm që ka qëndruar në po të njëjtin vend gjatë periudhës së vlerësimit.

Stacioni meteorologjik afatgjatë i Tiranës ka ekzistuar që prej viteve 1950. Të dhënat meteorologjike (për reshjet) thjesht duhen ndarë në dy periudha klimatike normale të barabarta sipas WMO-së, në (1961-1990) dhe (1991-2020), dhe për të dy mesataret afatgjata kryhet testi i dallimeve të konsiderueshme (Tabela 4-5). Vlera P ≤ se niveli i besueshmërisë (α) tregon se ka dallime statistikore të konsiderueshme midis dy mesatareve. Prandaj, ky dallim i atribuohet efekteve të ndryshimeve klimatike. Magnituda e dallimeve midis mesatareve aritmetike të reshjeve është tregues i drejtpërdrejtë i ndryshimit në burimet ujore të disponueshme pasi reshjet janë "ushqyesit" e të gjitha burimeve ujore.

Tabela 4-5 – Testi i Dallimeve Statistikore – Mesatarja aritmetike e Reshjeve Afatgjata

PERIUDHA E TË DHËNAVE	AFATGJATË MESATARJA (mm)	N	VARIANCA	DEVIJIMI STANDARD	ALPHA CL α (5%)	t-STAT	P (T≤t) (1-zona e përjashtuar)	P (T≤t) (2-zona e përjashtuar)
1961-1990	1358	30	85.77	101.50	0.05	2.8129	0.0024565	0.0049130
1991-2020	1396	30	117.22					

Për shkak të shkatërrimit virtual të sistemit të monitorimit efikas të ujërave sipërfaqësore në vitin 1992, AMBU nuk është në gjendje aktualisht të vlerësojë me saktësi ndryshimet e disponueshmërisë së burimeve ujore në basenin e Ishmit për periudhën 1991 – 2020. Të dhënat që janë të disponueshme për prurjen i përkasin periudhës 1960-1990 dhe disa të dhëna janë detajuar më tej për të kuptuar më mirë ndryshimet e regjimit të lumit për periudhën 1992-2008. Për më tepër, të dhënat që u ofruan për reshjet i përkasin një periudhe krejtësisht tjetër (1991-2018) dhe për pasojë, duke qenë se dy grupet e të dhënave nuk përkojnë, është vështirë të llogariten bilance uji që të përfaqësojë më së miri kushtet aktuale.

Tabela 4-6 – Bilanci i Përgjithshëm i Ujit për Basenin e Ishmit

BILANCI I UJIT (PRURJET AKTUALE)	PERIUDHA E TË DHËNAVE:	BILANCI I UJIT TË BASENIT TË ISHMIT (të gjitha njësitë shprehen në milion		NËNBASENI: SEZONI: Vjetor	
FLUKSET NATYRORE NË HYRJE SIPAS BURIMIT	**Flukset Sipërfaqësore Ndërkufitare në Hyrje: 0**	**Reshjet e Drejtpërdrejta në Basenin Ujor: 1046.166**		**Flukset Nëntokësore Ndërkufitare në Hyrje**	**TOTALI**
FLUKSET BRUTO VJETORE NË HYRJE	**Nga rrjedha e sipërme** [70]	**Reshjet në US**	**Reshjet në UN** [71]	**Nga Ujërat Nëntokësore** [72]	
RIMBUSHJA E BURIMEVE	**Rimbushja Vjetore e Ujërave Sipërfaqësore**		**Rimbushja Vjetore e Ujërave Nëntokësore**		
HUMBJET NATYRORE	**Evapotranspirimi Aktual (ET_A)** [73] **:** 516.56		**Flukset në Dalje të Ujërave Nëntokësore Ndërkufitare**		
BURIMI VJETOR I RINOVUESHËM (A)	**Burimi Vjetor i Rinovueshëm (BVR: US):** 631.34		**Burimi Vjetor i Rinovueshëm (BVR: UN)**		
SEKTORËT PARËSORË TË PËRDORIMIT EKONOMIK TË UJIT	**IMPORT** / **BASHKIA** / **INDUSTRIA** / **BUJQËSIA** / **ENERGJIA** / **EKSPORTET**		**IMPORT** / **INDUSTRIA** / **BASHKIA (Ujësjell** / **BUJQËSIA** / **ENERGJIA** / **EKSPORTET**		
UJI FURNIZUAR SEKTORIT[74]	**Konsumi i detajuar vjetor i ujit siperfaqes sipas sektorit**		**Konsumi i detajuar vjetor i ujit nëntokësor sipas sektorit**		
KONSUMI SIPAS SEKTORIT[75]	përllogaritur 57.38 million m^3				
KTHIMET NGA UJËRAT SIPËRFAQËSORE NË					
KTHIMET E UJËRAVE NËNTOKËSORE					
KONSUMI NETO SIPAS SEKTORIT					
KONSUMI NETO TOTALI SIPAS BURIMEVE (B)	**Konsumi Vjetor i Ujërave Sipërfaqësore**		**Konsumi Vjetor i Ujërave Nëntokësore**		
FLUKSI VJETOR NETO NË DALJE (A – B)	**Shkarkimet Neto të Ujërave Sipërfaqësore (përfshi Prurjen Bazë): 573.96**		**Shkarkimet Neto të Ujërave Nëntokësore (si Prurje Bazë)** [77] 67.8		
INDEKSET E SHFRYTËZIMIT TË UJIT	**Indeksi i Shfrytëzimit të Ujërave Sipërfaqësore ($IShUS^+$)** 10.07 %		**Indeksi i Shfrytëzimit të Ujërave Nëntokësore (IShUN+)**		

[70] Flukset natyrore ndërkufitare në hyrje nga lumenjtë. Termi ndërkufitar përfshin basene të tjera në Shqipëri.

[71] Reshjet që bien në zonat feratike përmes filtrimit të thellë

[72] Transferimet e ujërave nëntokësore ndërkufitare në basen përgjatë kufirit të ujëmbledhësit sipërfaqësor

[73] Evapotranspirimi Aktual (ETA) nga të gjitha sipërfaqet e tokës, me përjashtim të diferencës neto që i atribuohet bujqësisë

[74] Uji i furnizuar për përdorim ekonomik supozohet të jetë i barabartë me shfrytëzim + furnizim - humbje anësore

[75] Uji që i është furnizuar sektorit dhe nuk është kthyer as në ujëra sipërfaqësore, as në ujëra nëntokësore. E njëjta gjë për ujërat nëntokësore

[76] Uji i furnizuar nga burimet natyrore, por që është kthyer në ujëra nëntokësore. Anasjelltas për ujin e furnizuar nga ujërat nëntokësore

[77] Sasia e ujërave nëntokësore që mbërrin në sistemin e ujërave sipërfaqësore dhe që shkarkohet nga baseni ujor

4.3 Hidrologjia dhe Ujërat Nëntokësore

4.3.1 Vështrim i përgjithshëm

Burimi më i besueshëm i të dhënave për hidrologjinë dhe potencialin e ujërave nëntokësore është Harta Hidrogjeologjike 1:200 000 e Shqipërisë[78]. Ky vlerësim njeh shtatë lloje hidrologjike parësore, që rrjedhin kryesisht nga potenciali i rendimentit të akuiferit. Akuiferët klasifikohen më tej sipas litologjisë në shkëmbinj të konsoliduar në formën e shkëmbinjve sedimentarë (gur ranor, konglomeratë, shist argjilor, gur gëlqeror, flishe dhe dolomite që hasen më së shumti) dhe shkëmbinjve magmatikë dhe metamorfikë (bazikë dhe ultrabazikë, vullkanikë dhe konglomerate të metamorfizuara dhe gurë ranorë). Për sa i përket formacioneve hidrogjeologjike, sistemi shqiptar i klasifikimit nuk është harmonizuar plotësisht me sistemin e raportimit WISE të BE-së[79],por përafrimet midis këtyre sistemeve paraqiten të përmbledhura nëTabela 4-7.

4.3.2 Formacionet dhe Veçoritë Gjeologjike - Baseni i Ishmit

Tabela 4-7 dhe Harta 4-2 paraqesin një vështrim të përgjithshëm hidrogjeologjik për Basenin e Ishmit. Veçoritë hidrogjeologjike më të rëndësishme janë:

- Formacionet e mëdha të akuiferëve aluvialë “tipi 1”në pllajën bregdetare midis Kamzës dhe bregdetit. Ky akuifer i ofron qytetit të Tiranës rreth 13.27 Mm³ ose 14% të ujit të pijshëm[80]. Ujërat nëntokësore shfrytëzohen përmes pus-shpimeve me pompë, zakonisht në thellësi pompimi prej 30-40 m. Trashësia e akuiferit është zakonisht 50 m nën tokë në kufirin juglindor në afërsi të Tiranës, por shkon deri në 150-200+ në bregdet.
- Akuiferët aluvialë karakterizohen nga nivele të larta transmetueshmërie, që janë tregues për vlerat e larta “K”
- Akuiferët aluvialë ose ndërgranularë shërbejnë si burim i volitshëm ujërash nëntokësore relativisht të cekëta, që shfrytëzohen nga sistemet vendore të ujësjellësave dhe sektori i bujqësisë, megjithëse ka qenë thuajse e pamundur të matet niveli i nxjerrjeve pasi shumë puse operojnë pa leje. Prandaj, praktikat bujqësore mund të ndikojnë te nivelet e kontaminimit të akuiferit me nitrate.
- Një pjesë e konsiderueshme e qytetit të Tiranës mbivendoset mbi fundin juglindor të akuiferit aluvial, çka rrit potencialin për kontaminim nga hidrokarburet dhe ndotja në përgjithësi. Ç’është e vërteta, shumë prej pus-shpimeve më të mëdha që furnizojnë rrjetin e qytetit ndodhen brenda zonave të qytetit (Laknas, Bukas, Pema) pa asnjë shkallë mbrojtjeje sipërfaqësore në formën e Zonave të Mbrojtjes së burimeve ujore të shfrytëzuara për Ujit të Pijshëm (ZMUP).
- Një pjesë e konsiderueshme e importit të ujërave nëntokësore në basenin e Ishmit ndodh në afërsi të basenit ujor të Matit. Fusha me puse (7-9 puse) gjendet përgjatë zonës së Thumanës dhe pompon rreth 400 l/s (34.5 Ml/ditë) përmes një linje të madhe shpërndarjeje në qytetin e Durrësit.
- Rendimenti i një pusi të vetëm ndryshon në varësi të akuiferit aluvial, por mund të arrijë edhe deri në 65 l/s. Ndonëse mbizotëron më tepër në basenin ujor të Matit rreth zonës së Laçit, shumë prej puseve në zonën bregdetare operojnë nën presionin artezian, ku rënia e ujit gjenerohet nga shkëmbinjtë sipërfaqësorë të gurit ranor dhe formacionet e flishit që ndodhen rreth e rrotull.
- Në zonën Bilaj afër Fushë-Krujës ndodhet një burim dhe llixhë arteziane termale.
- Një prej veçantive më tipike të sistemit hidrogjeologjik janë shkëmbinjtë karakteristikë sipërfaqësorë të karstit kryesisht në boshtin juglindor deri në veriperëndimor. Këto zona të ngritura përmbajnë një sërë burimesh me rendiment të lartë, shumica e të cilave janë përdorur për qëllime vendore dhe rajonale. Për shembull, Ujësjellësi i Tiranës përdor tre burime të mëdha karstike në lindje të Tiranës: Selitën, Shën Mërinë

[78] Harta Hidrogjeologjike e Shqipërisë, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, 2015

[79] WISE 2016, Dokument Udhëzues i CIS-it të BE-së 2016, elementi i skemës së raportimit: <FormacioniGjeologjik>

[80] Shifrat e prodhimit 2018, Ujësjellësi Tiranë

dhe Bovillën e Vjetër. Burimet karstike të gjitha së bashku kanë një rendimet prej 400-700 l/s dhe përfaqësojnë rreth 32.370 Mm^3 ose 43% të prodhimit të sistemit në Tiranë.

- Sistemi i karstit në Shqipëri është pjesë e sistemit të karstit dinarik, i cili shtrihet nga Sllovenia deri në Greqi përgjatë bregdetit të Adriatikut, dhe është i rëndësishëm jo vetëm për rimbushjen e ujërave nëntokësore dhe furnizimin me ujë, por edhe për shkak të ekosistemeve të varura nga ujërat nëntokësore dhe habitatet endemike, të cilat janë komponentë domethënës të statusit ekologjik të trupit ujor.

Gjeologjia e pellgut ujëmbledhës të Ishmit, sipas Hartës Gjeologjike të Shqipërisë 2002, përbëhet nga formacione të periudhës kretake, paleogjene dhe kuaternare. Këto formacione klasifikohen në katër grupe litologjike: formacione karbonatike, formacione flishi, formacione molasike dhe formacione kuaternare.

Formacionet karbonatike janë më të vjetrat në basen dhe përfaqësohen nga gurët gëlqerorë, dolomitet e periudhës kretake të Vonë (Cr2) dhe gurët gëlqerorë eocenë (Pg2). Gurët gëlqerorë të periudhës kretake të vonë gjenden në antiklinalin e Makareshitnë sipërfaqe dhe nën formacionet molasike të depresionit Tiranë-Ishëm, ndërsa gurët gëlqerorë eocenë ndajnë sinklinalin Tiranë-Ishëm nga struktura e Makareshit.

Formacionet e flishit përfaqësohen nga formacionet paleogjene (Pg) në pjesën lindore të basenit të Ishmit, duke ndarë strukturat e antiklinalit të Makareshit, Malit të Dajtit, Malit me Gropa dhe të basenit në jug. Litologjia e flishit përfaqësohet nga argjila, aleurolitet, gurët ranorë dhe konglomeratet. Formacionet neogjene (N) ndodhen në jug dhe jugperëndim të basenit. Litologjia e tyre përfaqësohet nga gurët ranorë, aleurolitet, argjila, marli, konglomeratet dhe gurët gëlqerorë litotamnikë. Formacionet molasike e rrethojnë depresionin e Tiranës në anën jugore, lindore dhe perëndimore të Miocenës (Tortoniane, Mesiniane) dhe Pliocenës së Vonë. Gjenden të përhapura nga Krraba, fshatrat e Mushqetës deri në Manëz në perëndim e deri te fshatrat Skuterrë-Priskë dhe Burizanë në lindje. Në litologjinë e Miocenës mbizotërojnë gurët ranorë në të cilët janë ndërfutur argjilë, aleurolite dhe gurë gëlqerorë litotamnikë, ndërsa litologjia e formacioneve Pliocene përfaqësohet nga gurët ranorë dhe konglomeratet.

Formacionet kuaternare shtrihen në qendër të basenit të lumit Ishëm përgjatë lumenjve dhe rrjedhave kryesore në rrëzë të kodrave, si dhe në shpatet e maleve. Ata përfaqësohen nga:

- Proluvionet (Qp-h) nuk janë fort të përhapura në jug, juglindje dhe janë shumë më pak të tilla në pjesën perëndimore të basenit. Zakonisht përfaqësojnë formacione që formohen nga rrymat që rrjedhin në luginat e mëdha lumore. Litologjia mbizotërohet nga rëra, zhavorri dhe aleurolitet me trashësi 3.0 – 8.0 m.

- Aluvionet (Qh) janë të përhapura në qendër të basenit, nga Tirana drejt veriperëndimit të Rinasit, në Fushë-Krujë e në Ishëm. Këto formacione përbëhen nga zhavorri, guralecët dhe rëra. Gjenden në sipërfaqe të tokës së tarracave të lumenjve të Tiranës, Tërkuzës, Zezës dhe Drojës. Ato shtrihen mbi sipërfaqe mjaft të madhe nga Tirana, Rinasi, Fushë-Kruja e deri në Ishëm. Litologjia e tyre përfaqësohet nga zhavorr ranor, me grimca dhe copëza të mbuluara me argjilë dhe rërë kafe në të verdhë, të shkrifëta dhe poroze me përmbajtje të oksidit të hekurit. Trashësia e tyre ndryshon kur i drejtohemi veriperëndimit. Prandaj, nga Tirana në Laknas, luhatet nga 5.5 m, 20 m deri në 75 m, ndërsa në Fushë–Krujë–Mamurras trashësia rritet nga lindja në perëndim nga 20 m deri në 101 –119 m. Trashësia e mbulesës argjilore shkon 60-80 m.

Në pjesën jugperëndimore të basenit të lumit Ishëm gjenden aluvione të tarracës së parë të periudhës Holocene të Hershme, ndërsa në dalje të lumit Ishëm gjendet ato të periudhës së Holocenit të Vonë. Përfaqësohen nga aleurolitet, rëra e imët dhe pak më tepër argjilë. Përgjatë tarracave dhe luginave të lumenjve dhe gjarpërimeve të tyre gjejmë formacione moçalore (Qh) të përhapura në pjesën veriperëndimore të basenit. Ato karakterizohen nga prania e torfës dhe lëndës së bollshme organike, si dhe ndërfutja e argjilës, aleuroliteve, rërës dhe guralecëve. Në Hartën Hidrogjeologike të Shqipërisë dallojmë pesë lloje akuiferësh dhe shkëmbinjsh në basenin e lumit Ishëm:

1. Shtresat ujëmbajtëse, të gjera dhe poroze me depërtueshmëri të lartë dhe të pasura në UN;
2. Shtresa ujëmbajtëse, lokale dhe të varfra në UN;
3. Shtresa që mbajnë ujë karstik të pasura në UN;
4. Shkëmbinj me fizura dhe porozë me kapacitet të ulët ujëmbajtës;
5. Shkëmbinj pa UN.

Tabela 4-7 – Përmbledhja e Formacioneve Gjeologjike Kryesore dhe Potencialit të Ujërave Nëntokësorë

PËRSHKRIMI HIDROGJEOLOGJIK [81] LITOLOGJIA MBIZOTËRUESE	KODI SHQIPTAR I LLOJEVE	KODI I BE-SË I LLOJEVE	ZONA (km^2)	ZONA %	TRANSMETUESHMËRIA (T) (m^2/DAY) [82]	POTENCIALI I UJËRAVE NËNTOKËSORE [83]
Porozitet ndërgranular. Akuiferë të mëdhenj, me produktivitet mesatar deri në shumë të lartë. Rërë+ zhavorr, rërë+ zhavorr+ baltë/lym	1	1	156	22.2%	$> 10^3$	Poroze - shumë produktive
Porozitet ndërgranular. Akuiferë të mëdhenj, me produktivitet mesatar deri në shumë të lartë. Argjilë+ rërë+ lym+ zhavorr	2	2	0		$10^2 – 10^{-1}$	Poroze - mesatarisht produktive
Poroze/me porozitet me fizura. Akuiferë të mëdhenj, me produktivitet shumë të ulët deri mesatar. Gurë ranorë, gurë argjilorë, konglomerate.	3	2	0		10^2 - 10	Poroze - mesatarisht produktive
Me fizura/porozitet i karstifikuar. Akuiferë të mëdhenj, me ndryshime të theksuara, me produktivitet shumë të lartë. Gurë gëlqerorë, dolomite.	4	3A	91	12.9%	$10^4 – 10^{-1}$	Me fizura - shumë produktive
Porozitet me fizura. Akuiferë të mëdhenj, me ndryshime, me produktivitet mesatar deri në të ulët. Shkëmbinj bazikë, ultrabazikë.	5	4B	215	30.5%	$10^2 – 10^{-1}$	Poroze - mesatarisht produktive
Praktikisht shkëmbinj jo akuiferor . Formacionet argjilore, flish, evaporite	6	5	-		$< 10^{-1}$	Akuiferë të papërfillshëm. Ujëra nëntokësore të kufizuara
Poroze/me porozitet me fizura. Akuiferë të lokalizuar, me produktivitet të ulët deri në shumë të ulët. Gurët ranorë, aleurolitet .	7	5	0		$< 10 – 10^{-1}$	Akuiferë të papërfillshëm. Ujëra nëntokësore të kufizuara

[81] Marrë nga legjenda e Hartës Hidrogjeologjike të Shqipërisë, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, 2015. Kodi Shqiptar i Llojeve përkon me kategoritë e dosjeve të GIS .shp

[82] Transmetueshmëria (T) është norma e prurjes përmes një njësie gjerësie të akuiferit, e cila llogaritet me formulën përcjellshmëri hidraulike (K, m/ditë) x trashësia e saturuar e akuiferit (b, m), pra P = m2/ditë


[83] Përkon me Dokumentin Udhëzues të CIS-it të BE-së 2016, elementi i skemës së raportimit: <FormacioniGjeologjik>

4.4 Topografia dhe Përdorimi i Tokës

4.4.1 Basenin e Lumit Ishëm

Figura 4-6 dhe Harta 4-3 përmbledhin nënbasenet kryesore dhe përdorimet e tokës në basenin ujor të Ishmit, të marra nga baza e të dhënave CORINE e BE-së për mbulesën e tokës (2018)[84]. Arsyetimi për përvijimin e nënbaseneve paraqitet në Dokumentin ''Përmbledhja e Çështjeve të Rëndësishme të Menaxhimit të Ujërave''. Tabela 4-13 përmbledh statistikat kryesore për përdorimin e tokës në nivel nënbaseni, përfshi popullsinë, prurjet kryesore të indeksit Q_{50} dhe Q_{90} kur mund të llogariten[85] dhe zbërthimin në % të llojeve kryesore të përdorimit të tokës në Grupin e të Dhënave të projektit CORINE për mbulesën e tokës (2018)[86,87]. Zonat e ujitura nuk janë verifikuar me terrenin dhe mendohet se shifrat janë shumë më të ulëta se sipërfaqja që ujitet realisht.

Figura 4-6 – Llojet Kryesore të Përdorimeve të Tokës sipas Nënbaseneve



4.5 Rajonet Bashkiake dhe Shpërndarja e Popullsisë

4.5.1 Njësitë Administrative Bashkiake dhe Popullsia

Figura 4-7 dhe Harta 4-5 paraqesin rajonet administrative dhe aglomeratet kryesore të baseneve ujore. Shpërndarja e popullsisë me përafërsi paraqitet në tabelën 4-13. Siç parashikohej, kufijtë e nën-njësive të basenit ujor nuk përkojnë me kufijtë administrativë bashkiakë, prandaj bashkive u kërkohet të bashkëpunojnë përgjatë ujëmbledhësve topografikë për të arritur objektivat e planit të basenit ujor.


[84] https://land.copernicus.eu/pan-european/corine-land-cover

[85] Nuk ka të dhëna hidrometrike për prurjen që prej vitit 1995. Këto vlera janë përllogaritur me përafërsi sipas të dhënave të stacioneve matëse 1960-1995 dhe janë zbatuar për nënbasenet duke bërë thjesht korrigjimin e zonës. Këto të dhëna janë vetëm treguese, dhe jo të besueshme.

[86] https://www.eea.europa.eu/puBUications/COR0-landcover

[87] https://www.eea.europa.eu/data-and-maps/data/copernicus-land-monitoring-service-corine

Figura 4-7 – Autoritetet Kryesore Bashkiake dhe Zonat Urbane



4.6 Përdorimet Kryesore të Ujit dhe Infrastruktura

4.6.1 Vështrim i përgjithshëm

Qëllimi i këtij seksioni është të përmbledhë veprimtaritë ose aktivitetet aktuale më kryesore ("ndikimet artificiale" ose "nxitësit") të cilat ndikojnë në objektivat mjedisore në përgjithësi, ose në statusin e trupave ujorë në veçanti. Shkalla në të cilën këto aktivitete veprojnë si presione në nivel nën-baseni ose ndikojnë drejtpërdrejt në statusin e nivelit të trupit ujor trajtohet në Kapitullin 10.

Rëndësi të veçantë ka edhe infrastruktura që lidhet ose me nxjerrjet e mëdha ose me transferimet e shpeshta të ujit, pasi këto të dyja kanë shumë gjasa që të ndikojnë në prurjen mjedisore dhe/ose disponueshmërinë e burimeve ujore në nivel lokal. Vlerësimi i detajuar i infrastrukturës së përdorimit, shpërndarjes dhe nxjerrjes së ujit duhet paraqitur në Planin plotësues të Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Në përgjithësi, nxitësit kryesorë që kanë gjasa të ndikojnë në karakteristikat dhe/ose statusin e trupit ujor përcaktohen në WISE-në e DKU-së, ku raportohen listat e numeracionit, dhe renditen në tabelat në Shtojcën IV për presionet.

4.6.2 Përmbledhja e Shërbimeve të Ujit

Sipas përkufizimit të DKU-së, "shërbimet e ujit" janë të gjitha operacionet e lidhura me ujin të cilat furnizojnë familjet, institucionet publike ose veprimtaritë ekonomike, dhe që mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në statusin e ujit:

(a) nxjerrja, grumbullimi, ruajtja, trajtimi dhe shpërndarja e ujit sipërfaqësor ose nëntokësor
(b) mbledhja dhe trajtimi i ujërave të ndotura, të cilat më pas shkarkohen në ujëra sipërfaqësore

Tabela 4-8 ofron bilancin e përgjithshëm të ujit për sektorët kryesorë, sikurse kërkohet prej Nenit 9 (1) të DKU-së. Parametri i konsumit ka rëndësi të veçantë për ndikimet mjedisore të "shërbimeve të ujit" dhe rikuperimit të kostove të mjedisit dhe burimeve. Thënë më thjesht, konsumi është volumi që humbet përgjithnjë nga baseni ujor për shkak të veprimtarisë ekonomike. Shërbimet e ujit mund të ndikojnë ndjeshëm edhe bilancet e ujit brenda burimeve ujore, nga ku ujërat e nxjerra sipërfaqësore mund të transformohen në ujëra nëntokësore pas përdorimit dhe anasjelltas.

Tabela 4-8 – Përmbledhja e Nxjerrjeve, Përdorimeve dhe Konsumeve Kryesore Sektoriale të Ujit-Baseni Ishëm

TË DHËNAT SEKTORIALE	SIPËRFAQJA E NXJERRË [88] (milionë m³)	UJËRAT NËNTOKËSORE TË NXJERRA[89] (milionë m³)	KTHYER NË UJËRA SIPËFAQËSORE [90]	KTHYER NË UJËRA NËNTOKËSORE [91]	Σ KTHIMI (MCM)	KONSUMI (MCM) [92]	INDEKSI I SHFRYTËZIMIT WEI (%) [93]	SHËRBIMET E UJIT NJËSITË[94]	VSHB M €
FAMILJE [95]	70.00	30.35						Popullsia	
INSTITUCIONALE	-	-						Njësia	
TREGTARE	-	-						Megavat orë	
INDUSTRIALE [96]	0	0.419353						Njësia	
BUJQËSIA [97]	43.002	0.3775						Hektarë	
HIDROENERGJETIKË	36.795	0						MWh	
TJETËR		0.0459							
TOTALI	149.80	31.20							

[88]Përkufizuar si ujë i nxjerrë për përdorime brenda basenit ose për t'u eksportuar në një basen të afërt nëpërmjet lumenjve, rezervuarëve dhe burimeve (bazuar në të dhënat e prodhimit)

[89]Përkufizuar si ujë i nxjerrë për përdorime brenda basenit ose për t'u eksportuar në një basen të afërt nëpërmjet burimeve nëntokësore (bazuar në të dhënat e prodhimit)

[90]Përkufizuar si sasia totale e ujit (qoftë sipërfaqësor, qoftë nëntokësor) që kthehet ose importohet në sistemin e ujërave sipërfaqësore. Vetëm përllogaritje.

[91]Përkufizuar si sasia totale e ujit (qoftë sipërfaqësor, qoftë nëntokësor) që humbet, kthehet ose importohet në sistemin e ujërave nëntokësore.

[92]Përkufizuar si diferenca midis Σ ujit të nxjerrë dhe Σ ujit të kthyer. Në përputhje me përkufizimin e SEEAW të OKB-së "Nxjerrjet totale = Kthimet totale + Konsum"

[93] Përkufizuar si Indeksi i Shfrytëzimit të Ujit (WEI+) = [(Nxjerrjet + Eksportet) – (Kthimit+ Importet)] / Burimet ujore të rinovueshme vjetore

[94]Përkufizuar si numri i njësive të shërbimeve që furnizohen me ujë: popullsia, ekuivalenti i popullsisë, hektarët e ujitur, megavat orë

[95] Sipas të dhënave të publikuara për shoqërinë UK Tiranë dhe shoqërinë UK Fushë-Krujë - Enti Rregullator i Ujit (ERRU), Raport Bilanci i Ujit i Shoqërive UK 2018.

[96]Përkufizuar si njësia më e madhe që përdor kryesisht burimet e veta të ujit

[97] Konsumi bujqësor përfshin humbjet gjatë transmisionit për shkak të kërkesave të evaporimit dhe evapotranspirimit të kulturave bujqësore të ujitura


4.6.3 Infrastruktura Lidhur me Nxjerrjen e Ujit të Pijshëm

Furnizimi me ujë është sektor me rëndësi të veçantë dhe ndjeshmëri të madhe, pasi ndikon drejtpërdrejtë cilësinë e jetesës së qytetarëve.

Teksa flasim, në basenin e lumit Ishëm veprojnë 4 shoqëri publike UK që furnizojnë me ujë të pijshëm vetëm një pjesë të popullsisë që banon në këtë basen. Në territorin e basenit ujor veprojnë vetëm dy shoqëri UK (U.K Krujë, U.K. Kamëz); ndërsa dy të tjerat (U.K. Tirana, U.K. Vora) veprojnë pjesërisht në territorin e basenit të lumit Ishëm dhe pjesërisht në territorin e basenit të lumit Erzen. Duke iu referuar në veçanti Tiranës, shumë pak përdorues (rreth 10%) jetojnë jashtë basenit ujor të Ishmit; pjesa dërrmuese banon brenda territorit të basenit.

Këto shoqëri UK i nënshtrohen monitorimit të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) nëpërmjet vlerësimit të performancës së shërbimeve të ofruara sipas treguesve kryesorë të performancës teknike dhe financiare. Krahas kësaj, shoqëritë UK kanë nënshkruar edhe kontrata performance me bashkitë përkatëse për të treguar llogaridhënien e tyre lidhur me shërbimin e ofruar. Të dhënat e fundit tregojnë se rreth 87% e popullsisë së basenit është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Vazhdimësia e shërbimit është ndjeshëm më e lartë në zona urbane krahasuar me zonat rurale, por sidoqoftë vlerat mbeten mjaft të ulëta përgjatë basenit.

Figura 4-8 Popullsia që merr shërbime nga ujësjellësi për çdo bashki që i përket basenit ujor të Ishmit.



Popullsia i kompenson rezultatet e ulëta të "vazhdimësisë së shërbimit" duke blerë dhe instaluar pompa dhe depozita uji që fillojnë të mbushen kur sistemi i shpërndarjes gjendet në presion. Faktorët kryesorë që shkaktojnë ulje të vazhdimësisë të furnizimit me ujë janë humbjet e ujit nga mbikonsumi i pamatur, lidhjet e paligjshme dhe humbjet teknike në rrjet për shkak të rrjedhjeve/infrastrukturës së vjetëruar.

Siguria e furnizimit me ujë ndikohet nga mbrojtja e burimeve, që janë kryesisht puse dhe burime natyrore të cilat ndodhen në basenin ujor të Ishmit, dhe klorinimi i sasisë së furnizuar që hyn në sistemet e shpërndarjes. Ka politika kombëtare (ligje dhe rregullore) që përcaktojnë mbrojtjen e burimeve natyrore dhe të fushave apo grykave të puseve. Qëllimi përfundimtar i këtyre rregulloreve është që në burim të mos ketë kontaminim. Pavarësisht masave të sigurisë të zbatuara në burim, të gjitha shoqëritë UK në Shqipëri duhet të bëjnë klorinim të vazhdueshëm për të eliminuar kontaminimin nga mikroorganizmat që mund të depërtojnë në rrjetin e shpërndarjes. Siguria e furnizimit me ujë monitorohet nga Njësitë Vendore të kujdesit Shëndetsor (NjVKSh). IShP-ja teston klorin e mbetur në pika të ndryshme përdorimi, si dhe teston praninë e baktereve fekale koliforme.

Tabela 4-9 paraqet të dhëna për sistemet e ujësjellësit dhe shoqëritë UK që veprojnë në territorin e basenit të lumit Ishëm.

Tabela 4-9 -: Furnizimi me ujë dhe kanalizimet në Rajonin e Basenit Ujor të Lumit Ishëm[98]

Rajoni	Bashkia	Njesia administrative	Urbane/Rurale	Popullsia	Popullsia e lidhur me sistemin e UK	Lidhjet e ujit	Mbulimi	Vazhdimesia e shërbimit të UK (hours/day)	Shoqëria UK
TIRANË	**Tiranë**	Tiranë, Dajti, Zall Bastar, Zall Herr, Kashar	**U+R**	782,750	774,474	**233 946**	99%	15.4	Sh.a U.K Tirane
	Kamëz	Kamëz, Paskuqan	**U+R**	137,886	65,880	**15 976**	48%	4.0	Sh.a U.K Kamez
	Vorë	Bërxull, Prezë	**U+R**	14,600	8,250	**1 835**	**57%**	8.0	Sh.a U.K Vore
DURRËS	**Krujë**	Krujë, Fushë-Krujë, Thumanë, Bubq, Cudhi, Nikel	**U+R**	80,807	35,140	**6 126**	43%	8.0	Sh.a U.K Kruje

Treguesi i performancës për vazhdimësinë e shërbimit për vitin 2020 mbetet në mesataren 13.8 orë/ditë, që konsiderohet si mjaft e ulët në kuadër të cilësisë së shërbimit ndaj klientit. Në zonën e basenit ka shumë shoqëri UK që furnizojnë nën mesatare, si shoqëria UK Kamëz, UK Krujë dhe UK Vorë, të cilat ofrojnë ujë të pijshëm nga 4 deri në 8 orë në ditë. Ky tregues, krahas nivelit të ulët të shërbimit, lidhet edhe me rreziqet ndaj Shëndetit Publik për shkak të mundësisë së hyrjes së ujit në tubacionet e ujërave nëntokësore që ndodhen në presion negativ, që krijohet kur tubacionet janë të zbrazura.

Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm për familjet, shoqëritë dhe institucionet përfshin (i) Nxjerrjen, (ii) Depozitimin, (iii) Trajtimin dhe (iv) Shpërndarjen. I vetmi burim i ujit me përdorim familjar dhe industrial janë ujërat nëntokësore (nxjerrë në burim ose pompuar nga puset). Nga kjo praktikë përjashtohet vetëm shoqëria UK Tiranë, e cila përdor ujërat sipërfaqësore të liqenit të Bovillës. Më pas, uji trajtohet në Impiantin e Trajtimit të Ujit, me një kapacitet prodhues prej 1800 l/s. Impianti i trajtimit të ujit të Bovillës është zgjeruar me një kapacitet depozitimi prej 15,000 m^3 me parametra identike me ato të impiantit ekzistues, me një kapacitet prodhues prej 3000 l/s në total.

Ujërat nëntokësore janë subjekt i faktorëve klimatikë, morfologjikë, hidrologjikë, gjeografikë dhe antropogjenë. Faktori më i rëndësishëm, ku mbështeten ujërat nëntokësore, janë reshjet. Uji është në cilësi të mirë dhe nuk kërkon trajtim dytësor: mjafton vetëm dezinfektimi (me klor). Prandaj, veprimtaritë industriale përfitojnë edhe nga cilësia e mirë e ujit me kosto të ulët, ndonëse furnizimi me ujë i një cilësie më të ulët do të mjaftonte për qëllimet e tyre.

Shoqëria UK identifikon zonën e mbrojtjes për çdo pus. Sidoqoftë, këto zona janë zakonisht shumë të vogla dhe distanca mesatare e puseve nga banesat është shumë e vogël për të mundësuar mbrojtje të besueshme.

Tabela 10-4 tregon nivelin e tarifave të ujit, që janë nën nivelin eficient dhe të qëndrueshëm. Për ta korrigjuar këtë situatë, veprimet e ardhshme kanë nevojë për programe ambicioze për përmirësimin e eficiencës, ku kjo e fundit përfshin efikasitetin e përdorimit të energjisë, efikasitetin e stafit dhe të proceseve të tjera operacionale, efikasitetin e mbledhjes dhe rënien e nivelit të ujit pa të ardhura. Klientët mund të pranojnë rritje të çmimit të një shërbimi të caktuar vetëm kur ky shërbim është përmirësuar ndjeshëm. Në çdo rast, këto tarifa mund të rriten deri në një nivel të caktuar, duke marrë parasysh sa e përballojnë familjet mesatare pagesën. Me këtë

[98] Enti Rregullator i Ujit (Raporti i Performancës së Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve 2019 - 2020

nivel tarifimi, fluksi i lirë i parave nga operacionet mund të financojë afro gjysmën e investimeve të nevojshme për 20 vitet e ardhshme, pra deri në 2040-n. Pjesa e mbetur duhet të financohet nëpërmjet financimit me ndërmjetësim në formën e huave dhe granteve për investime kapitale.

Aktualisht, ka shumë pak financim tregtar të disponueshëm për sektorin. Përvoja ndërkombëtare tregon se pavarësisht kuadrit të përshtatshëm ligjor dhe institucional, financimi tregtar i sektorit të ujësjellës-kanalizimeve (UK) në Shqipëri (në formën e huave, koncesioneve ose PPP-ve të tjera) do jetë i mundur vetëm nëse rritja e tarifës bazë ndërmerret për të gjeneruar një fluks parash që të mbështesë shlyerjen e borxheve.

Tabela 4-10 - Tarifat e shërbimit të ujit për çdo shoqëri UK në basenin e lumit Ishëm

Shoqëri UK	Uji i pijshëm lek/m3			Tarifa fikse lek/klient/muaj			Për ujërat e ndotura		
	Familjare	Shtetërore	Private	Familjare	Shtetërore	Private	Familjare	Shtetërore	Private
UK Tiranë	65	140	155	200	200	200	11	30	35
U.K Vorë	65	140	155	200	200	200	15	30	35
U.K Kamez[99]									
U.K Krujë	35	80	100	100	200	200	8	12	12

4.6.4 Infrastruktura Lidhur me Trajtimin e Ujërave të Ndotura

Aktualisht, shumica e shoqërive UK që ofrojnë shërbime kanalizimesh për klientët në basenin e lumit Ishëm kanë rrjet kanalizimesh, të paktën në zonat urbane, si dhe mbledhin edhe ujërat e ndotura të zonës. Mbulimi i rrjetit të kanalizimeve është shumë më i ulët se ai i furnizimit me ujë. Në zonat urbane, ujërat e ndotura mblidhen kryesisht nëpërmjet rrjetit publik të kanalizimeve. Sistemet e kanalizimeve janë të kombinuara, ndaj i grumbullojnë së bashku ujërat e ndotura dhe ujërat e reshjeve. Për shkak të mirëmbajtjes së dobët të kanaleve të kanalizimit dhe diametrit të vogël të tubave, rrjedhjet nëpër kanale janë shpeshherë rrezik për kontaminimin e ujit të pijshëm. Në shumë zona nënurbane dhe rurale të qyteteve, ka mungesë të sistemeve të kanalizimit dhe ujërat e ndotura mblidhen në gropa septike.

Në zonat rurale, vendbanimet janë shumë të shpërndara. Familjet përdorin mjetet e veta për shkarkimin e ujërave të ndotura, zakonisht duke i mbledhur në gropa septike dhe duke përdorur kamionë privatë për largimin e tyre prej zonës së banimit. Lëvizjet e mëdha demografike kanë sjellë mbipopullim të qyteteve dhe zonave urbane dhe popullim të zonave në afërsi të lumenjve, duke sjellë shkarkime të patrajtuara të ujërave urbane e industriale dhe duke rritur për pasojë nivelin e ndotjes së ujërave sipërfaqësore. Problemi i ndotjes së ujit është më akut në qytete të mëdha me densitet të lartë të popullsisë dhe në zona bregdetare, ku veprimtaritë socio-ekonomike janë më intensive krahasuar me pjesën tjetër të vendit.

Sistemi ekzistues i kanalizimeve për Tiranën dhe Kamzën është planifikuar të përdoret në maksimum. Për zonën e re pa sistem Publik kanalizimesh, është planifikuar një sistem kanalizimesh i ndarë (i ri).

Tabela 4-11 paraqet një Përmbledhje të situatës aktuale lidhur me mbledhjen e ujërave të ndotura në basen.

Tabela 4-11 - Situata aktuale lidhur me mbledhjen e ujërave të ndotura në zonën e basenit të lumit Ishëm

Rajoni	Bashkia	Njësia Administrative	Komente
TIRANË	Tiranë	Dajt	Sistem i pjesshëm kanalizimesh që shkarkohet më pas pa trajtim
	Tiranë	Zall Bastar	Nuk ka lidhje me kanalizimet.

[99] Tarifa që nuk janë miratuar ende nga ERrU.

	Tiranë	Tiranë	Sistemi ekzistues i mbledhjes së ujërave të ndotura është sistem kanalizimesh i kombinuar për kullimin e ujërave të ndotura urbane të përziera me ujërat nga reshjeve. Sistemi shkarkohet në lumin e Lanës dhe Tiranës. Sistemi ekzistues i kanalizimeve është planifikuar të përdoret në maksimum. Për zonën e re pa sistem Publik kanalizimesh, është planifikuar një sistem kanalizimesh i ndarë. ITUN-u Tiranë është në ndërtim e sipër, por punimet ndërtimore janë pezulluar.
	Tiranë	Zall Her	Nuk ka lidhje me kanalizimet.
	Tiranë	Kashar	Sistem i pjesshëm kanalizimesh që shkarkohet pa trajtim
	Kamëz	Kamëz	Sistemi i ujërave të ndotura mbulon vetëm zonën e qytetit të Kamzës. Sistemi ekzistues i mbledhjes së ujërave të ndotura është sistem kanalizimesh i kombinuar për kullimin e ujërave të ndotura urbane të përziera dhe ujërave nga reshjet. Sistemi shkarkohet në lumin e Tiranës. Sistemi ekzistues i kanalizimeve është planifikuar të përdoret në maksimum. Për zonën e re pa sistem Publik kanalizimesh, është planifikuar një sistem kanalizimesh i ndarë.
	Kamëz	Paskuqan	Sistem i pjesshëm kanalizimesh. Ujërat e ndotura mblidhen nga rrjeti publik dhe më pas shkarkohen në lumin e Tiranës, pa trajtim.
	Vorë	Bërxull	Nuk ka lidhje me kanalizimet.
	Vorë	Prezë	Nuk ka lidhje me kanalizimet.
DURRËS	Krujë	Cudhi	Nuk ka lidhje me kanalizimet.
	Krujë	Nikel	Nuk ka lidhje me kanalizimet.
	Krujë	Bubq	Nuk ka lidhje me kanalizimet.
	Krujë	Krujë	Sistemi ekzistues i mbledhjes së ujërave të ndotura është sistem kanalizimesh i kombinuar për kullimin e ujërave të ndotura urbane të përziera me ujërat e reshjeve. Sistemi shkarkohet pa trajtim.
	Krujë	Fushë-Krujë	Sistemi i ujërave të ndotura mbulon vetëm zonën e qytetit të Fushë-Krujës. Ujërat e ndotura mblidhen nga rrjeti Publik dhe më pas shkarkohen pa trajtim në lumin Zezë.
	Krujë	Thumanë	Sistemi i ujërave të ndotura në Njësinë Administrative të Thumanës mbulon vetëm një pjesë të popullsisë, kryesisht atë që jeton në zonën e qytetit tëThumanës.
	Durrës	Ishëm (pjesërisht)	Nuk ka lidhje me kanalizimet.
Rajoni	Bashkia	Njësia Administrative	Komente
TIRANË	Tiranë	Dajt	Sistem i pjesshëm kanalizimesh që shkarkohet më pas pa trajtim
	Tiranë	Zall Bastar	Nuk ka lidhje me kanalizimet.
	Tiranë	Tiranë	Sistemi ekzistues i mbledhjes së ujërave të ndotura është sistem kanalizimesh i kombinuar për kullimin e ujërave të ndotura urbane të përziera dhe ujërave nga reshjet. Sistemi shkarkohet në lumin e Lanës dhe Tiranës. Sistemi ekzistues i kanalizimeve është planifikuar të përdoret në maksimum. Për zonën e re pa sistem Publik kanalizimesh, është planifikuar një sistem kanalizimesh i veçantë. ITUN-u Tiranë është në ndërtim e sipër, por punimet ndërtimore janë pezulluar.
	Tiranë	Zall Her	Nuk ka lidhje me kanalizimet.
	Tiranë	Kashar	Sistem i pjesshëm kanalizimesh që shkarkohet më pas pa trajtim

	Kamëz	Kamëz	Sistemi i ujërave të ndotura mbulon vetëm zonën e qytetit të Kamzës. Sistemi ekzistues i mbledhjes së ujërave të ndotura është sistem kanalizimesh i kombinuar për kullimin e ujërave të ndotura urbane të përziera dhe ujërave nga reshjet. Sistemi shkarkohet në lumin e Tiranës. Sistemi ekzistues i kanalizimeve është planifikuar të përdoret në maksimum. Për zonën e re pa sistem Publik kanalizimesh, është planifikuar një sistem kanalizimesh i veçantë.
	Kamëz	Paskuqan	Sistem i pjesshëm kanalizimesh. Ujërat e ndotura mblidhen nga rrjeti Publik dhe më pas shkarkohen në lumin e Tiranës, pa trajtim.
	Vorë	Bërxull	Nuk ka lidhje me kanalizimet.
	Vorë	Prezë	Nuk ka lidhje me kanalizimet.
DURRËS	Krujë	Cudhi	Nuk ka lidhje me kanalizimet.
	Krujë	Nikel	Nuk ka lidhje me kanalizimet.
	Krujë	Bubq	Nuk ka lidhje me kanalizimet.
	Krujë	Krujë	Sistemi ekzistues i mbledhjes së ujërave të ndotura është sistem kanalizimesh i kombinuar për kullimin e ujërave të ndotura urbane të përziera dhe ujërave nga reshjet. Sistemi shkarkohet pa trajtim.
	Krujë	Fushë-Krujë	Sistemi i ujërave të ndotura mbulon vetëm zonën e qytetit të Fushë-Krujës. Ujërat e ndotura mblidhen nga rrjeti Publik dhe më pas shkarkohen në lumin Zezë, pa trajtim.
	Krujë	Thumanë	Sistemi i ujërave të ndotura në Njësinë Administrative të Thumanës mbulon vetëm një pjesë të popullsisë, kryesisht atë që jeton në zonën e qytetit tëThumanës.
	Durrës	Ishëm (pjesërisht)	Nuk ka lidhje me kanalizimet.

Në basenin e lumit Ishëm nuk ka impiant funksional për trajtimin e ujërave të ndotura. Të gjitha tubacionet e kanalizimeve shkarkohen direkt në trupin ujor më të afërt, pa trajtim. ITUN-i Tiranë është në ndërtim e sipër, por punimet ndërtimore janë pezulluar. Ndodhet në Tiranë, pranë Kasharit dhe financohet nga JICA (*8,168,997,956 ndërtimi JPY + 1,555,999,618 mbikëqyrja JPY*). Punimet ndërtimore të ITUN-it të Tiranës janë pezulluar aktualisht.

Ky ITUN-i është pajisur me sistemin biologjik të filtrimit me pikim dhe flukseve të vazhdueshme në hyrje, që krahasohet me standardet evropiane. Ka një sipërfaqe prej 53 ha dhe është projektuar për trajtimin e ujërave të ndotura për 345 000 banorë. Master Plani i Kanalizimeve të Tiranës së Madhe propozon dy ITUN-ë, një në Kashar dhe një tjetër në Bërxull. Të dy impiantet përdorin një proces filtrimi me pikim që kërkon zonë më të madhe, por teknologji më pak të sofistikuar për operim dhe mirëmbajtje se procesi alternativ i llumit të aktivizuar. Trajtimi i ujërave të zeza prodhon çdo ditë llum. Llumi largohet nga depozitat parësore dhe dytësore të sedimentimit, i cili më pas trashet dhe tretet. Kjo gjë mund të realizohet duke e tharë llumin në natyrë ose duke bërë ndarjen mekanike të tij nga uji. Tharja natyrale (duke përdorur shtretërit e tharjes) kërkon sipërfaqe të madhe, por pak energji. Studimi propozon që të përdoret tharja natyrale deri në shkallën e mundshme, brenda kufizimeve të zonës. Kjo do të ulte nevojën për energji dhe kostot operative. Sipërfaqja që mbulohet nga plani i kanalizimeve përfshin të gjitha ose një pjesë të këtyre zonave: 1) bashkinë Tiranë, 2) bashkinë Kamëz, 3) Kasharin, 4) Paskuqanin, 5) Bërxullin. Sipërfaqja e planifikimit u përcaktua duke marrë në konsideratë vendndodhjen e banesave dhe godinave ekzistuese, topografinë, shtrirjen e basenit ujor, kufijtë e bashkive/komunave, zonën e furnizuar me ujë nëpërmjet tubacioneve dhe Planin Strategjik.

4.6.5 Infrastruktura Lidhur me Ujitjen

Sipërfaqja totale e tokave bujqësore në Shqipëri është 657,000 ha[100], që mbulon 23% të vendit, ku 80% është në pronësi private dhe 20% në pronësi shtetërore. Kulturat bujqësore kryesore janë perimet, pemët frutore, vreshtat, drithërat dhe ullishtat.

Bujqësia në Shqipëri kërkon ujë shtesë për ujitje në verë, pasi reshjet e shiut gjatë këtij sezoni përbëjnë rreth 20% të reshjeve vjetore në total. Deficiti ujor midis qershorit dhe gushtit luhatet nga 400 deri në 500 mm, duke e bërë ujitjen të nevojshme për prodhimin efikas të kulturave bujqësore. Nga ana tjetër, kullimi është i rëndësishëm në dimër për të lehtësuar përmbytjet, erozionin dhe mbingopjen e tokës me ujë.

Një pjesë e mirë e sistemeve të ujitjes dhe kullimit është amortizuar për shkak të mungesës së investimeve dhe buxhetit të pamjaftueshëm për operim dhe mirëmbajtje. Për më tepër, privatizimi i tokës ka mundësuar krijimin e 400,000 fermave të vogla në nivel kombëtar (midis 0.5 dhe 3.0 ha). Këto ferma të vogla private e kanë ndryshuar rrënjësisht karakterin e bujqësisë dhe i kanë ndërlikuar shërbimet bujqësore, përfshi edhe procesin e ujitjes. Për këtë arsye, Qeveria Shqiptare miratoi politikën për t'ia transferuar përdoruesve të ujit përgjegjësinë e operimit të kanaleve dytësore ujitëse.


Aktualisht, pronari i skemave të ujitjes është shteti, ndërsa operimi dhe mirëmbajtja e skemave u delegohet bashkive. Por ligji nr. 24/2017 parashikon që kjo e drejtë ti transferohet Shoqatave të Përdoruesve të Ujit, Shoqatave Kooperativiste Bujqësore, ose mund të përdoren mjete të tjera transferimi nëpërmjet një Vendimi të Këshillit të Ministrave.

Organizatat e Përdoruesve të Ujit (OPU) janë shoqata vullnetare fermerësh që janë themeluar dhe operojnë sipas dispozitave të ligjit nr. 24/2017. OPU-ja është subjekt ligjor, vetëfinancues me qëllime jofitimprurëse. Deri më tani, OPU-të nuk janë formalizuar ende. Fermerët furnizohen me ujë nëpërmjet skemave të ujitjes dhe burimeve ujore publike të menaxhuara nga bashkitë. Ka edhe fermerë që ujisin jashtë këtyre skemave të ujitjes. Nuk ka informacion të disponueshëm për ta.

Në këtë basen, menaxhimi i ujitjes realizohet nga 4 bashki (Krujë, Kamëz, Vorë dhe Tiranë), ku disa prej tyre ndodhen tërësisht brenda territorit të basenit, ndërsa të tjerat pjesërisht. Në basenin ujor të lumit Ishëm vepron Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës.

Sipas MBZhR-së, sipërfaqja e tokës bujqësore në basenin e lumit Ishëm është rreth 26,000 ha. Sipërfaqja ku fermerët kanë akses në ujitje është rreth 8000 ha, kundrejt sipërfaqes potenciale të ujitjes që është rreth 14000 ha. Në 2020-shin, sipërfaqja e tokave të ujitura në këtë basen ishte afërsisht 6000 ha. Në nivel BU-je, rreth 54% e tokës bujqësore është sipërfaqe potenciale për ujitje dhe 31% e tokës bujqësore është tokë e ujitur (23% në 2020-n). Figura 4-9 paraqet situatën për çdo bashki në basenin e lumit Ishëm.

Figura 4-9 - Totali i tokës së punueshme, sipërfaqes potenciale për ujitje dhe sipërfaqes së tokës së ujitur në 2020-n për çdo bashki në basenin e lumit Ishëm.



[100]Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Për shkak të zhvillimit të shpejtë të infrastrukturës gjatë dekadave të fundit, vetëm një pjesë e tokave të punueshme mund të ujiten ose të përdoren gjithnjë për prodhim bujqësor. Sipërfaqja totale e tokave bujqësore në Shqipëri është 657,000 ha, që mbulon 23% të vendit, ku 80% është në pronësi private dhe 20% në pronësi shtetërore. Kulturat bujqësore kryesore janë perimet, pemët frutore, vreshtat, drithërat dhe ullishtat.

Bujqësia në Shqipëri kërkon ujë shtesë për ujitje në verë, pasi reshjet e shiut gjatë këtij sezoni përbëjnë rreth 20% të reshjeve vjetore në total. Deficiti ujor midis qershorit dhe gushtit luhatet nga 400 deri në 500 mm, duke e bërë ujitjen të nevojshme për prodhimin efikas të kulturave bujqësore. Nga ana tjetër, kullimi është i rëndësishëm në dimër për të lehtësuar përmbytjet, erozionin dhe mbingopjen e tokës me ujë.

Një pjesë e mirë e sistemeve të ujitjes dhe kullimit është amortizuar për shkak të mungesës së investimeve dhe buxhetit të pamjaftueshëm për operim dhe mirëmbajtje. Për më tepër, privatizimi i tokës ka mundësuar krijimin e 400,000 fermave të vogla në nivel kombëtar (midis 0.5 dhe 3.0 ha). Këto ferma të vogla private e kanë ndryshuar rrënjësisht karakterin e bujqësisë dhe i kanë ndërlikuar shërbimet bujqësore, përfshi edhe procesin e ujitjes. Për këtë arsye, Qeveria Shqiptare miratoi politikën për t'ia transferuar përdoruesve të ujit përgjegjësinë e operimit të kanaleve dytësore ujitëse.

Aktualisht, pronari i skemave të ujitjes është shteti, ndërsa operimi dhe mirëmbajtja e skemave u delegohet bashkive. Por ligji nr. 24/2017 parashikon që kjo e drejtë ti transferohet Shoqatave të Përdoruesve të Ujit, Shoqatave Kooperativiste Bujqësore, ose mund të përdoren mjete të tjera transferimi nëpërmjet një Vendimi të Këshillit të Ministrave.

Organizatat e Përdoruesve të Ujit (OPU) janë shoqata vullnetare fermerësh që janë themeluar dhe operojnë sipas dispozitave të ligjit nr. 24/2017. OPU-ja është subjekt ligjor, vetëfinancues me qëllime jofitimprurëse. Deri më tani, OPU-të nuk janë formalizuar ende. Fermerët furnizohen me ujë nëpërmjet skemave të ujitjes dhe burimeve ujore publike të menaxhuara nga bashkitë. Ka edhe fermerë që ujisin jashtë këtyre skemave të ujitjes. Nuk ka informacion të disponueshëm për ta.


Në këtë basen, menaxhimi i ujitjes realizohet nga 4 bashki (Krujë, Kamëz, Vorë dhe Tiranë), ku disa prej tyre ndodhen tërësisht brenda territorit të basenit, ndërsa të tjerat pjesërisht. Në basenin ujor të lumit Ishëm vepron Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës.

Sipas MBZhR-së, sipërfaqja e tokës bujqësore në basenin e lumit Ishëm është rreth 26,000 ha. Sipërfaqja ku fermerët kanë akses në ujitje është rreth 8000 ha, kundrejt sipërfaqes potenciale të ujitjes që është rreth 14000 ha. Në 2020-shin, sipërfaqja e tokave të ujitura në këtë basen ishte afërsisht 6000 ha. Në nivel BU-je, rreth 54% e tokës bujqësore është sipërfaqe potenciale për ujitje dhe 31% e tokës bujqësore është tokë e ujitur (23% në 2020-n). Figura 4-9 paraqet situatën për çdo bashki në basenin e lumit Ishëm.

Figura 4-9 tregon se përqindja e sipërfaqeve të ujitura të tokës në basenin e lumit Ishëm luhatet nga 20% në 56%. Burimet ujore të ujitjes janë rezervuarët e ujitjes, lumenjtë ose ujërat nëntokësore, të cilat mundësohennëpërmjet stacioneve të pompimit. Ujitja realizohet ose me gravitet, ose me stacione pompimi, ose duke i kombinuar të dyja. Metoda kryesore e ujitjes është përdorimi i kanaleve të hapura ose ujitjes me brazda, që e shpërndan ujin nëpërmjet një rrjeti dytësor dhe tretësor. Ujitja në masë praktikohet kryesisht në terrene të ulëta dhe bregdetare, ku pjesa më e madhe e skemës së ujitjes është e amortizuar. Në basenin e lumit Ishëm ka shumë skema të vogla ujitjeje, por shumica nuk janë funksionale. Baseni i lumit Ishëm ka rreth 416 km kanale ujitje (256 km kanale kryesore dhe 10 km kanale dytësore).


Në përgjithësi, ujërat sipërfaqësore konsiderohen si burim kryesor për ujitje, me lumenjtë Ishëm dhe Zezë si burime kryesore. Në rrjedhën e sipërme të basenit të lumit Ishëm janë ndërtuar disa rezervuarë për qëllime ujitjeje, për të plotësuar kërkesën. Baseni i lumit Ishëm numëron gjithsej 42 diga (rezervuarë) ujitëse (Figura 4-10). Sipas të dhënave të disponueshme, kapaciteti fillestar i projektuar për rezervuarët e ujitjes është reduktuar me rreth 50%, pas 40 vjetësh përdorim.

Figura 4-10 - Digat e ujitjes për çdo bashki në basenin e lumit Ishëm



Për sezonin e fundit të ujitjes (2020), sipas sipërfaqeve të mbjella dhe normave të zbatuara të ujitjes (uji për ujitjen e sipërfaqeve) në nivel kombëtar, ka pasur në dispozicion 473 milionë m^3 ujë për një sipërfaqe të ujitur prej afro 182 000 ha. Volumi total i ujit në basenin e lumit Ishëm që përdoret për ujitje është afro 15 milionë m^3 për një sipërfaqe të ujitur prej rreth 6, 000 ha, ku Tirana është përdoruesi më i madh (sezoni 2020).Figura 4-11 paraqet situatën për çdo bashki në basenin e lumit Ishëm.

Figura 4-11 - Volumi i ujit të përdorur për ujitje në 2020-n për çdo bashki në basenin e lumit Ishëm



Një prej faktorëve më kritikë që kontribuon në cenueshmërinë e sektorit bujqësor është teprica e ujit gjatë përmbytjeve, që dëmton prodhimet bujqësore duke kufizuar rritjen e kulturave bujqësore ose duke shkatërruar bimët. Infrastruktura e sistemit të kullimit është ndërtuar kryesisht përpara viteve 1990. Për shkak të zhvillimit të shpejtë të infrastrukturës urbane gjatë dekadave të fundit, sistemi i kullimit mbulon vetëm një pjesë të tokës bujqësore. Baseni i lumit Ishëm ka 486 km kanale kullimi dhe sistemi i rrjetit të kullimit është thuajse 17,615 ha.

Duke marrë parasysh burimet ujore dhe infrastrukturën e kullimit në basenin e lumit Ishëm, duhen marrë masa për uljen e cenueshmërisë dhe rritjen e fleksibilitetit të bujqësisë. Këto masa lidhen kryesisht me modernizimin e bujqësisë (miratimi i Praktikave më të Mira), përmirësimin e infrastrukturës së ujitjes e kullimit, si dhe përdorimin e metodave të reja për ujitje (ujitje me spërkatje dhe pikim).

4.6.6 Infrastruktura lidhur me Hidroenergjetikën

Baseni i lumit të Ishmit ka 4 hidrocentrale, prej të cilëve 3 janë në gjendje pune dhe 1 është në ndërtim e sipër. Fuqia totale është 7.14 MW. Prurja e instaluar është 5.91 m^3/sek. Prurja vjetore mesatare është 4.496 m^3/sek. (shihni Shtojcën Teknike III).

4.6.7 Infrastruktura lidhur me Instalimet sipas Direktivës DEI [101](parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes)

Direktiva 2010/75/BE për Emetimet Industriale (DEI) gjen zbatim për operacionet dhe instalimet nga sektorë të ndryshëm industrialë dhe parashtron rregullat e reja për parandalimin, reduktimin dhe, kur është e mundur, eliminimin e ndotjes për shkak të veprimtarive industriale në përputhje me parimin "ndotësi paguan" dhe parimin e parandalimit të ndotjes. Operacionet e instalimeve bazohen te Teknologjia më e Mirë e Disponueshme (TMD), e cila zhvillohet për sektorë industrialë specifikë.

Direktiva 2010/75/BE për emetimet industriale (DEI) është transpozuar vetëm pjesërisht nëpërmjet një serie aktesh ligjore që mbulojnë pjesë të ndryshme të direktivës. Kuadri ligjor për ndotjen industriale përfshin aktet e mëposhtme kryesore:

1. Ligji Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e Mjedisit", i ndryshuar nga Ligji Nr. 52/2020, është përafruar pjesërisht me Direktivën 2010/75/BE për Emetimet Industriale, ndaj nevojiten më tepër veprime për transpozimin e saj.
2. Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar
3. Ligji Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar
4. VKM-ja Nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", transpozon pjesërisht Direktivën 2010/75/BE, datë 24 nëntor 2010, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes).
5. VKM Nr. 178, datë 6.3.2012 "Për incinerimin e mbetjeve ".

Problemet kryesore kanë të bëjnë me transpozimin dhe zbatimin e TMD-ëve dhe Vlerave Kufi të Emetimeve. Megjithatë, dhënia e lejeve për instalimet që janë objekt i kësaj direktive nuk është e integruar dhe një instalim duhet të marrë disa leje për të operuar. Dhënia e lejeve nuk është plotësisht në përputhje me kërkesat ligjore dhe nuk ka monitorim të pavarur të ndotjes industriale. Të dhënat për ndotjen industriale janë të kufizuara dhe mbështeten kryesisht te vetëmonitorimi dhe vetëdeklarimi i shoqërive. Ka një procedurë që ndiqet për aplikimin, dhënien dhe kontrollin e lejes në nivel qendror dhe vendor, ku dallohen tre nivele aplikimi: niveli kombëtar (MIE dhe AKM), degët rajonale të AKM-së dhe Inspektorati. Merren parasysh edhe kërkesat në raportet e vetëmonitorimit përgatitur nga vetë operatorët. Megjithatë, mungon zbatimi i TMD-ëve.

Përllogaritet se objekt i DEI-t janë 20 instalime, çka do të thotë se janë instalime të pajisura me leje mjedisore të tipit A, sipas përkufizimeve të legjislacionit kombëtar në fuqi. Megjithatë, nuk ka asnjë regjistër për këto instalime dhe nuk ka vlerësime as për nivelin e zbatimit të kërkesave të direktivës. AKM-ja është përgjegjëse për zbatimin dhe përputhshmërinë me standardet mjedisore gjatë procesit të dhënies së lejes (dhënia e lejeve mjedisore të tipit A dhe B). Për më tepër, nuk ka as hartë me koordinatat përkatëse, ku të tregohet vendndodhja e të gjitha instalimeve industriale të pajisura me leje mjedisore, të paktën e atyre me leje mjedisore të tipit A, gjë që e vështirëson identifikimin e tyre dhe vlerësimin e presionit që ushtrojnë mbi basenet ujor, por vështirëson edhe identifikimin e ndikimeve të tyre grumbulluese në basenin e lumit Ishëm. Krahas kësaj, nuk ka të dhëna as për shkarkimet e ndotësve nga këto instalime në ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore.

[101]Komisioni Evropian, Direktiva 96/61/KE për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes

Kjo direktivë nuk është më në fuqi, pasi është shfuqizuar me Direktivën 2010/75/BE për emetimet industriale (parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes)

4.7 Sistemi i Kodimit të Unifikuar për Basenet, Trupat Ujorë dhe Bazën e të Dhënave, propozuar për Shqipërinë

Zbatimi i sistemit kombëtar logjik të kodimit për Shqipërinë shkon përtej objektit të kësaj PMBU-je. Megjithatë, shihet e nevojshme ngritja e një sistemi kodimi me të cilin të punohet lehtësisht për të gjitha objektet brenda basenit ujor që i nënshtrohen menaxhimit të ujit. Një sistem i tillë novator dhe i mirëstrukturuar kodimi mund të shërbejë si model i dobishëm edhe për basenet e tjera ujore. Qasja e përdorur harmonizon nga pikëpamja logjike basenet ujore (në nivel BE-je), trupat ujorë, pikat e monitorimit, presionet dhe masat sipas një sistemi konsistent numerik kodimi, i cili përmblidhet në Shtojcën Teknike II.

Për ta përmbledhur, sistemi numerik i kodimit i përdorur për Planin e Menaxhimit të Basenit Ujor të Lumit Ishëm bazohet te grupet e të dhënave të Modelimit dhe Karakterizimit të Baseneve Ujëmbledhëse Mbarevropiane (CCM), ku për çdo lum dhe basen ujëmbledhës me rëndësi në Evropë caktohet një kod unik reference.[102] [103] Basenet Ujore identifikohen në kahun orar sipas oqeanit (Mesdhe, M) dhe detit (Mesdheu Lindor, 4).

Për sa i përket trupave ujorë të veçantë, Shtetet Anëtare me kapacitete më të mëdha teknike po përdorin sistemin e kodimit Pfafstetter. Ky sistem është rekomanduar nga Grupi i Punës GIS sipas CIS-it dhe përshkrimin teknik të tij mund ta gjeni në këtë referencë[104].


Analiza GIS ka përcaktuar kodin **3514** si kod evropian fillestar për basenin e lumit Ishëm.(për më shumë informacion për hartat dhe mënyrën e kodifikimit referohuni në Shtojcën e GIS)

[102] https://ec.europa.eu/jrc/en/puBUication/reference-reports/pan-european-river-and-catchment-database

[103] Komisioni Evropian - Baza Panevropiane e të Dhënave për Lumenjtë dhe Pellgjet Ujëmbledhëse, JRC 2007

[104] De Jager, A.L. & Vogt, J.V. (2010) - Zhvillimi dhe demonstrimi i sistemit të strukturuar të kodimit hidrologjik për Evropën, Revista e Shkencave Hidrologjike, 55(5) 661-675.

Harta 4-1- Shpërndarja e Reshjeve, Lumenjtë Kryesorë dhe Rrjetet Hidrometrike



Harta 4-2 – Formacionet Kryesore Hidrogjeologjike





Tabela 4-12 – Statistikat Kyç Përmbledhëse për nënbasenet e lumit Ishëm


ISHËM	Sipërfaqja (km²)	Reshjet vjetore (mm)	Q50	Q90	Popullsia [105]	Zonë urbane (%)	Zonë e punueshme (%)	Zonë e ujitur (%)	Kultura të përhershme (%)	Kullota (%)	Pyje (%)	Zona natyrore	Trupa ujorë	Ujëra detare
ISH0	213	1279	4.21	1.56	51,816	10.11	3.31	2.44	51.26	2.77	12.99	16.74	0.31	0.07
ISH1	286	1351	4.99	1.84	683,373	29.78	2.51	0.00	31.00	6.08	12.96	16.45	1.23	0.00
ISH2	51.6	1749	1.08	0.41	531	0.00	0.00	0.00	22.29	0.00	27.89	49.26	0.57	0.00
ISH3	94.4	1795	3.28	2.02	852	0.00	0.00	0.00	21.03	1.51	27.94	45.05	4.47	0.00
ISH4	80.7	1578	3.21	2.16	591	0.00	0.00	0.00	13.72	0.00	45.47	40.81	0.00	0.00
Gjithsej	726	1441	16.77	7.99	737,163									

[105] Bazuar te të dhënat e Censusit të 2011-s, parashikimi i INSTAT-it për 2019-n në nivel bashkie dhe përllogaritjet e ponderuara të GIS-it të popullsisë urbane dhe rurale të nënbaseneve


Harta 4-3 – Nënbasenet dhe përdorimi i tokës



Harta 4-4 – Infrastruktura Kryesore e Përdorimit të Ujit në Basenin e Lumit Ishëm



Harta 4-5 – Populllsia sipas rajoneve administrative dhe aglomerateve kryesore të basenit ujor



5 Karakterizimi dhe Përvijimi i Trupave Ujorë Sipërfaqësorë

5.1 Vështrim i përgjithshëm

5.1.1 Bashkimi Evropian

DKU-ja përcakton një kornizë ligjore për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore të brendshme, ujërave kalimtare, ujërave bregdetare dhe ujërave nëntokësore. Suksesi i zbatimit të Direktivës në arritjen e këtij qëllimi dhe objektivave përkatëse matet kryesisht nga statusi i "trupave ujorë". Për këtë arsye, trupat ujorë janë njësi themelore që duhen përdorur për analizën, raportimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore kryesore të Direktivës[106]. Çdo trup ujor duhet të jetë nën-njësi koherente në basenin ujor (ose rajonin e basenit ujor) për të cilin gjejnë zbatim objektivat mjedisore të Direktivës. Prandaj, qëllimi kryesor i identifikimit të trupave ujorë është vlerësimi dhe krahasimi i saktë i statusit me objektivat mjedisore, pra nëpërmjet programeve të monitorimit, trupi ujor duhet klasifikuar në një klasë të vetme të statusit ekologjik me saktësinë dhe precizionin e duhur.

5.2 Kategorizimi dhe Tipologjia e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë

5.2.1 Kategoritë e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë

Procedura për karakterizimin e trupave ujorë përcaktohet qartësisht në DKU[107]. Trupat ujorë sipërfaqësorë brenda rajonit të basenit ujor duhen klasifikuar në një prej këtyre kategorive të trupave ujorë sipërfaqësorë: lumenj, liqene, ujëra kalimtarë, ujëra bregdetare, ose trupa ujorë artificialë dhe trupa ujorë tepër të modifikuar. Secila prej këtyre kategorive duhet identifikuar dhe raportuar më vete, brenda kuadrit të PMBU-së.

Trupat ujorë lumorë përkufizohen në Nenin 2(4) të DKU-së si trupa ujorë të brendshëm që rrjedhin kryesisht në sipërfaqe të tokës, por që një pjesë e gjatësisë së tyre mund të rrjedhë edhe nën tokë.

Liqenet përkufizohen në Nenin 2(5) të DKU-së si ujëra të brendshme të ndenjura.

Ujërat kalimtarë përkufizohen në nenin 2(6) të DKU-së si trupa ujorë sipërfaqësorë në afërsi të grykëderdhjeve të lumenjve, që janë pjesërisht me karakter të kripur, si rezultat i afërsisë së tyre me ujërat bregdetare, por që ndikohen kryesisht nga rrjedhat e ujërave të ëmbla për sa i përket regjimit të rrjedhës apo kripësisë. Ujërat kalimtarë karakterizohen zakonisht nga veçoritë e tyre morfologjike dhe kimike, lidhur me përmasat dhe natyrën e lumenjve që rrjedhin në to.

Trupat ujorë bregdetarë përkufizohen në Nenin 2(7) të DKU-së, dhe shtrihen 1 milje nautike (1852 m) nga kepi tokësor.[108] Të gjithë trupat ujorë të përkohshëm dhe bregdetarë në Shqipëri gjenden brenda Ekorajonit 6 (Deti Mesdhe).

Trupat ujorë artificialë dhe *tepër të modifikuar* përkufizohen në nenin 2(8) dhe (9) të DKU-së. Në këto kushte, DKU-ja i lejon Shtetet Anëtare që t'i identifikojnë dhe shpallin trupat ujorë artificialë (TUA) dhe trupat ujorë tepër të modifikuar (TUTM) sipas nenit 4(3) të DKU-së. Shpallja dhe arsyetimi përkatës përmenden në mënyrë specifike në planet e menaxhimit të basenit ujor .

Domethënia dhe rëndësia e shpalljes së këtyre tipave të trupave ujorë për objektivat mjedisore të PMBU-së ka të bëjë pikërisht me faktin se TUTM-të janë trupa ujorë mjaft individualë që, për shkak të ndryshimeve fizike nga veprimtaria njerëzore, ndryshojnë thelbësisht në karakter dhe si rrjedhojë nuk mund ta arrijnë "statusin e mirë ekologjik" (SME). Vendosja e objektivave mjedisore më pak shtrënguese për këto trupa ujorë (raste përjashtime) përcaktohen në nenet 4(4) dhe 95) të DKU-së.

Duke qenë se cilësia ekologjike e ujit të TUA-ve dhe TUTM-ve vlerësohet në lidhje me kategorinë "fillestare", ne do i konsiderojmë TUA-të dhe TUTM-të si një formë e veçantë e një prej kategorive të tjera. Kjo do të thotë se

---

[106] Komisioni Evropian, Dokumenti Udhëzues i CIS-it Nr. 2, Identifikimi i Trupave Ujorë

[107] Komisioni Evropian - Direktiva 2000/60/KE - Shtojca II

[108] Vija bregdetare tejet e thyer mund të vizatohet si vijë drejtvizore. Dokumenti Udhëzues Nr.5, DKU CIS

çdo trup ujor karakterizohet (i) si një prej kategorive: lum, liqen, ujëra kalimtare ose ujëra bregdetare; dhe (ii) si një prej formave: tepër i modifikuar, artificial, natyror.

5.2.2 Tipologjia e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë

Për secilën prej kategorive të ujërave sipërfaqësore, duhet të bëhet dallimi midis trupave ujorë sipërfaqësorë brenda rajonit të basenit ujor sipas tipologjisë. Këto lloje përkufizohen duke përdorur ose 'Sistemin A', ose 'Sistemin B' të DKU-së (Shtojca II). Në këtë plan, u zbatua procedura e Sistemit A.

Në thelbin konceptual të qasjes së "statusit ekologjik" të DKU-së qëndron pikërisht kodimi i llojit të trupave ujorë. Objektivi parësor është të arrihet të paktën "Statusi i Mirë" (përkufizuar si statusi i mirë ekologjik dhe kimik) për çdo trup ujor (Seksioni 8). Rrjedhimisht, për të përcaktuar statusin aktual ose ekzistues të trupit ujor x, duhet krahasuar me një "kusht reference" (kushte plotësisht natyrore) për atë lloj të trupit ujor. Ç'është më kryesorja, LLOJET e ndryshme të trupave ujorë qoftë edhe brenda po të njëjtës KATEGORI (p.sh lumenj) kanë kushte të ndryshme reference. Sa më i madh të jetë devijimi i gjendjes së trupit ujor nga kushtet e referencës, aq më i madh është ndikimi në përcaktimin e statusit përkatës.

Kushtet plotësisht natyrore (referencë) për pjesën më të madhe të trupave ujorë, përcaktuar përmes gjykimit të ekspertëve, varen kryesisht nga tre përshkrues hidro-ekologjik parësorë:

- *Lartësia* - ky parametër ndikon më së shumti regjimet e temperaturave ditore, sezonale dhe vjetore të ekosistemeve ujore.
- *Përmasa* - ky parametër (p.sh zona ujëmbledhëse e trupit ujor lumor ose sipërfaqja e trupit ujor liqenor) ka ndikime mjaft komplekse, por ndikimet më të dukshme vërehen te sasia e ujit brenda ekosistemit ujor (magnituda e prurjes ose depozitimit), prurja sezonale ose regjimi i depozitimit, si dhe me shumë gjasa te habitati i ekosistemit dhe vazhdimësisë së tij.
- *Gjeologjia* - ky parametër ndikon më së shumti kiminë e ujërave pritëse ndaj ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe të madh te llojet ujore të përshtatura veçanërisht ndaj këtyre kushteve fiziko-kimike. Ndikimet parësore gjeokimike mund të ndahen në formacione gjeologjike gëlqerore (karbonati), silicore (silice) ose organike (humike).

Për të garantuar qëndrueshmërinë e analizimit dhe raportimit të kushteve të referencës së statusit ekologjik për Shtetet Anëtare, po zbatohet prej shumë vitesh tashmë procesi i 'ndër-kalibrimit' (duke përdorur edhe Sistemin A edhe Sistemin B). Puna e kryer së fundi mbi këtë çështje për ripërkufizimin e tipologjive të gjera për lumenjtë dhe liqenet europiane përafrohet më mirë me llojet e gjera të ndërkalibrimit evropian, ndaj është miratuar në kuadër të kësaj PMBU-je[109].

Sipas Shtojcës II, 1.1.v të D-së, diferencimi i tipologjisë për trupat ujorë artificialë (TUA) dhe tepër të modifikuar (TUTM) duhet kryer në përputhje me përshkruesit për cilëndo kategori të ujërave sipërfaqësore natyrore që ngjason më tepër me TUA-në apo TUTM-në në fjalë. Në mënyrë të ngjashme, elementet e cilësisë duhet të jenë ato që gjejnë zbatim për çdo kategori të ujërave sipërfaqësore natyrore që ngjasojnë më tepër me TUA-n apo TUTM-në (DKU, Shtojca 1.1.5). Kjo do të thotë se rezervuarët e krijuar përmes ndërtimit të digave në lumenj mund të kategorizohen si lumenj tepër të modifikuar, por duhet të klasifikohen në lloje dhe vlerësuar duke përdorur elementet dhe mjetet e duhura për liqenet, pasi liqenet janë një kategori e ujërave sipërfaqësore natyrore me të cilët rezervuarët kanë ngjashmëri të madhe.

5.2.3 Tipologjia e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë që Ndikon Përvijimin

Përvijimi i trupave ujorë (përcaktimi i ndarjeve të sakta gjeografike brenda lumenjve, liqeneve, ujërave nëntokësore në elemente më të vogla) përshkruhet në seksionin 5.4 dhe përbën fazën e tretë të procesit të karakterizimit. Për sa i përket klasave tipologjike, duke qenë se ndryshimet në tipologjinë e trupit ujor ka shumë të ngjarë që të lidhen me një ndryshim të kushteve të referencës, dhe se kushtet e referencës duhet të zbatohen

[109]Shkenca e Mjedisit Total - Tipologji e re e gjerë për lumenjtë dhe liqenet në Evropë: Kryerja dhe zbatimi i vlerësimeve mjedisore në shkallë të gjerë, Elsevier, 2019

në mënyrë të njëtrajtshme për atë trup ujor individual, rrjedh që ndryshimi i tipologjisë të trupit ujor duhet të sjellë ndryshim edhe në përcaktimin e kufijve të atij trupi ujor të përvijuar.

Për shembull, për një trup ujor lumor të ngjashëm të së njëjtës klasë dhe gjeologji me zonën ujëmbledhëse, kalimi nga lartësi e madhe (> 800 m) në lartësi mesatare (> 200 < 800 m) do të kërkonte ndarje në dy trupa ujorë për të pasqyruar kushtet e ndryshme të referencës (dhe mundësisht, statusin aktual). Thënë më thjesht, trupi ujor i përvijuar nuk duhet t'i kalojë kufijtë tipologjikë, që përkufizohen nga lartësia, përmasa dhe klasat gjeologjike të DKU-së në Shtojcën II.

Lidhur me rastin e veçantë të trupave ujorë artificialë (TUA) ose trupave ujorë tepër të modifikuar (TUTM), kufijtë tipologjikë gjejnë zbatim të njëtrajtshëm edhe për këto kategori. Sipas Shtojcës II të DKU-së, diferencimi i tipologjisë duhet kryer në përputhje me përshkruesit për cilëndo kategori të ujërave sipërfaqësore natyrale që ngjason më së shumti me TUA-në ose TUTM-në në fjalë.

5.2.4 Presionet dhe Ndikimet e Trupit Ujor Sipërfaqësor që Ndikojnë Përvijimin

Përvijimi duhet kryer deri në ato nivele sa për të pasur një përcaktim të saktë të statusit të çdo trupi ujor individual, pa krijuar nën-ndarje të panumërta në trupa ujorë më të vegjël që nuk japin kontribut domethënës kundrejt qëllimeve të Direktivës. Duke qenë se janë të të njëjtit TIPOLOGJI (seksioni 5.2.2), elementet e ngjashme të ujërave sipërfaqësore me të njëjtin status mund të kombinohen në një trup ujor të vetëm, për shembull disa degë të vogla furnizuese në fuqinë e basenit.

Megjithatë, kur trupi ujor i nënshtrohet një presioni të konsiderueshëm (qoftë pikësor, apo të shpërndarë), si p.sh shkarkimet e përqendruara të ujërave të ndotura, atëherë ka të ngjarë që të aplikohet një ndarje të paktën për të veçuar trupat ujorë të rrjedhës së sipërme nga ato në rrjedhën e poshtme të shkarkimit të ndotësve, pasi edhe statusi do të jetë i ndryshëm.

5.3 Koherenca dhe Metodologjia e Përvijimit të Trupave Ujorë

Parimet e bashkim-ndarjes të parashtruara në seksionin 5.2.4 duhet të marrin parasysh jo vetëm statusin aktual, por edhe ndryshimet e mundshme të statusit brenda trupit të vetëm ujor për shkak të presioneve dhe ndikimeve që priten në të ardhmen. Për shembull, zgjerimi urban, veprat e mbrojtjes nga përmbytjet, ofrimi i shërbimit të trajtimit të ujërave të ndotura, hidrocentralet ose sistemet e reja të marrjes dhe shkarkimit të ujit kanë gjasa të ndikojnë në status në pika të ndryshme përgjatë lumit.


Këto presione pikësore ose të shpërndara mund të tregojnë se trupi ujor i bashkuar aktualisht duhet ndarë në disa trupa ujorë më të vegjël në të ardhmen, në mënyrë që të bëhet një identifikim sa më i saktë i statusit të secilit. Me qëllim menaxhimin efikas të bazës së të dhënave dhe shmangien e ricaktimit të kodeve unike të trupave ujorë (Kodi Evropian i Trupave Ujorë Sipërfaqësorë) [110] preferohet që në disa raste, trupi ujor të mos thjeshtohet më tepër seç duhet, ndonëse karakteristikat dhe statusi i tyre aktual mund të jenë uniform. Ky paralajmërim vlen sidomos kur rritet gjatësia e trupit ujor.

Problematika që haset në Shqipëri është se programet e monitorimit mbikëqyrës të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nuk mjaftojnë për të mbuluar të gjithë trupat ujorë, pra statusi i shumë trupave ujorë të përvijuar nuk njihet. Ky është rasti për planin 2024-2029. Për pasojë, duhet gjykuar se ku mund të ndodhë ndryshimi në status aktualisht ose në të ardhmen për shkak të karakteristikave natyrore ose presioneve antropogjene.

Figura 5-1 ilustron metodologjinë e përdorur të përvijimit. Supozohet se fillimisht kemi të bëjmë me një trup të vetëm lumor të ngjashëm me "Status shumë të mirë". Megjithatë, kur kalojmë nga e majta në të djathtë, hidrocentrali në pikën (A) ndikon ndjeshëm në elementet hidromorfologjike në rrjedhën e poshtme, duke sjellë një përkeqësim të statusit. Ndikimi mund të kompensohet deri në njëfarë shkalle nga hyrja e degës furnizuese në pikën (B), në varësi të relativitetit të prurjes. Nxjerrjet e ujit për industrinë (C), veprat e mbrojtjes nga përmbytjet (D), furnizimi me ujë në nivel bashkie (E) dhe shkarkimi i ujërave të ndotura urbane (F) ndikojnë që të gjitha në një mënyrë tejet komplekse në disa ndryshime të statusit brenda trupit ujor.

[110] Komisioni Evropian, Dokumenti Udhëzues WISE GIS për Raportimin e të Dhënave Hapësinore për të Dhënat Hapësinore të WISE, Versioni 6.0.6, 2016

Figura 5-1 – Shembull i një Trupi Ujor të Llojit të Ngjashëm me Status të Larmishëm



Në këtë shembull, duhen përvijuar gjashtë trupa ujorë për t'i përmbushur me saktësi kërkesat e DKU-së. Në praktikë, përvijimi i trupave ujorë mund të mos jetë aq kompleks sa ky shembull; rasti më lart është marrë për të treguar se presionet, statusi ose ndikimet aktuale dhe/ose të ardhshme janë që të gjitha faktorë të procesit të përvijimit të trupave ujorë që shkojnë përtej përvijimeve të thjeshta, të cilat vijnë për shkak të kushteve gjeologjike, hidromorfologjike dhe kufitare tipologjike.


5.4 Trupat Ujorë Sipërfaqësorë në Basenin e Ishmit

5.4.1 Trupat Ujorë Lumorë

Për basenin e Ishmit janë përcaktuar 22 trupa ujorë lumorë (TUL). Këta trupa ujorë janë karakterizuar sipas Sistemit A të Shtojcës II të DKU-së, siç paraqitet në Tabela 5-1. Numrat janë caktuar sipas sistemit Pfafstetter dhe paraqiten në Harta 5-1[111].

Figura 5-2 – Madhësitë e Trupave Ujorë Lumorë sipas Frekuencës – Ishëm

Lloji	Lartësia	Madhësia	Gjeologjia
R-02	<200	Medium-	silicor
R-03	<200	e vogël	silicor
R-04	<200	Medium-	Gëlqeror/l
R-05	<200	e vogël	Gëlqeror/l
R-06a	<200	e vogël	Organik/silicor
R-06b	<200	Medium-	Organik/silicor
R-10	200-	Medium-	Gëlqeror/l
R-11	200-	e vogël	Gëlqeror/l



Procedura e karakterizimit të përdorur në Shqipëri e sheh rëndësinë e regjimit të rrjedhës së lumit si element kritik të kushteve të referencës të llojeve të ndryshme të trupave ujorë. Sipas rastit dhe kur ka të dhëna në dispozicion, Tabela 5-1 paraqet 'regjimin vjetor të prurjes', të përmbledhur, duke përshkruar 'prurjet treguese' për Q_{10}, Q_{50}, Q_{90}, të cilat përkojnë përkatësisht me vlerat e larta, mesatare dhe të ulëta të prurjes[112]. Prurja

[111]Sistemi i përgjithshëm i kodimit të veçorive hidrologjike në Shqipëri (basenet, nënbasenet, trupat ujorë, stacionet e monitorimit etj.) nuk ka qenë në përputhje me qëllimin që prej vitit 2020. Agjencitë kryesore të monitorimit (AMBU, ShGjSh, AKM) nuk përdorin një sistem konsistent ose logjik ndërmjet tyre. PMBU KBU-ja përdor sistemin standard të caktimit të numrave për basenet lumore mbarevropiane, që rrjedh nga sistemi i kodimit të Karakterizimit dhe Modelimit të Ujëmbledhësit (CCM) të JRC-së së KE-së. Zakonisht, kodet e trupave ujorë i marrin 4-6 shifrat e para nga baseni lumor (i njohur edhe si "kodi fillestar"), të cilat pasohen nga numra të tjerë. Për trupat ujorë lumorë është zbatuar me rreptësi sistemi i kodimit Pfafstetter. AMBU-t i kërkohet të punojë sistematikisht për prezantimin e sistemit të kodimit logjik dhe në përputhje me WISE-n në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore.

https://www.eea.europa.eu/data-and-maps/data/external/ccm-v.2

[112] Vlerat e prurjes janë marrë nga të dhënat e Stacioneve të Monitorimit të Prurjes të përshkruar në Seksionin 4.2, faktorizuar me Zonën. Gjithsesi, këto vlera bazohen te të dhënat e periudhës 1965-1995, ndaj nuk janë të besueshme për analizë aktuale.

mesatare përshkruan prurjen afatgjatë me 50% probabilitet për të ndodhur dhe është treguesi që përfaqëson më mirë 'prurjen mesatare'. Q_{10}, Q_{50} dhe Q_{90} janë 'tregues të prurjes mjedisore'.

Ndryshimet e konsiderueshme të këtyre prurjeve nga kushtet natyrore (p.sh për shkak të depozitimit, devijimit ose mbinxjerrjes së ujit) shërbejnë si tregues i presioneve në trupin ujor dhe me shumë gjasa mund ta reduktojnë statusin ekologjik (shihni seksionin 3.3.5).

Q_{90}-a ka një rëndësi të jashtëzakonshme për kushtet e referencës së prurjes mjedisore. Vlera e raportit Q_{90}/ Q_{50} nga Kurba e Qëndrueshmërisë së Prurjes përfaqëson zakonisht kontributin e ujërave nëntokësore në rrjedhën e lumit, njohur ndryshe edhe si "Indeksi i Prurjes Bazë" (IPB). Në basenet ujore shqiptare, ujërat nëntokësore japin një kontribut vjetor prej të paktën 30% të rrjedhës totale të lumit. Gjatë verës, kur prurjet janë të pakta, ujërat nëntokësore shërbejnë si komponent parësor i rrjedhës. Prandaj, gjatë këtyre periudhave, kontributi i ujërave nëntokësore përbën të gjithë prurjen mjedisore dhe duhet mbrojtur si i tillë. Shkarkimet e ujërave nëntokësore dhe kontributi i tyre në % ndryshon përgjatë vitit, por Q_{90}-a vjetore shërben si vlerë referencë e përafërt.

5.4.2 Trupat Ujorë Liqenorë

Edhe trupat ujorë liqenorë të basenit të Ishmit karakterizohen sipas DKU-së, Shtojca II, Sistemi A. Përdoren po të njëjtët përshkrues të tipologjisë si për lumenjtë, përkatësisht lartësia, gjeologjia, përmasat e liqenit dhe thellësia. Minimumi normal i sipërfaqes së një liqeni është 0.5 km² (DKU, Shtojca II, 1.2.2). Megjithatë, duke qenë se shumë rezervuarë apo trupa ujorë liqenorë në Shqipëri nuk janë monitoruar më parë, në këtë hartim të parë të PMBU-së së Ishmit, janë përfshirë katër trupa ujorë < 0.5 km².

Duke qenë se në Shqipëri ka shumë trupa ujorë liqenorë që veprojnë si rezervuarë hidrocentralesh, raportimi sipas Sistemit A për Shqipërinë përfshin parametrin e thellësisë Δ, që përshkruan luhatjet tipike vjetore të nivelit të ujit, që ndikon ndjeshëm në morfologjinë e habitatit.

Për basenin e Ishmit janë përcaktuar 4 trupa ujorë lumorë (TUL). Për basenin e Ishmit janë identifikuar 4 trupa ujorë liqenorë (TULQ). Këtu përshihet edhe rezervuari ujësjellës publik i Bovillës, i cili përdoret nga ujësjellësi Tiranë. Karakterizimi i këtyre trupave ujorë paraqitet në tabelën Tabela 5-2 dhe Harta 5-1.

Zakonisht, liqenet/rezervuarët e basenit të Ishmit janë të vegjël (< 1 km²), me lartësi të vogël dhe origjinë silicore. Përjashtim bën rezervuari i Bovillës (4.07 km², 78 Mm³), i krijuar në vitin 1998 përmes ndërtimit të digës në lumin Tërkuzë. Baseni ujor kontribues (ISH3) është 94.4 km², me gjeologji të përzier silicore dhe gëlqerore (shihni Harta 4-2). Rezervuari i Bovillës karakterizohet nga luhatje të mëdha (7-10 m) të nivelit të ujit sezonal, pasi përdoret kryesisht për furnizim me ujë të pijshëm. Një tjetër pikë për t'u vërejtur është Indeksi jashtëzakonisht i lartë i Prurjes Bazë (IPB) për nënbasenin ISH3 (0.71), i cili tregon se 70% e prurjes në dalje të ujëmbledhësit (në Bovillë) vjen nga shkarkimet e ujërave nëntokësore.

Asnjë prej TULQ-ve në basenin e Ishmit nuk është matur dhe monitoruar, ndaj regjimi i prurjes në hyrje nuk dihet. Përjashtim bën rezervuari i Bovillës, ku të dhënat historike (1951-1987) tregojnë një prurje mesatar vjetor në hyrje prej 3.3 m³/s[113].

5.4.3 Ujërat e Përkohshme

Ujërat kalimtare janë trupa ujorë sipërfaqësorë në afërsi të grykëderdhjeve të lumenjve në det, që janë pjesërisht me karakter të kripur, si rezultat i afërsisë së tyre me ujërat bregdetare, por që kryesisht ndikohen nga rrjedhat me ujëra të ëmbla (DKU, neni 2(6)).

Ujërat e përkohshme në Shqipëri nuk janë përvijuar më parë në PMBU dhe nuk ka asnjë kusht referencë për to. Në PMBU-në e Ishmit, kufiri midis trupit ujor lumor dhe trupit ujor të përkohshëm në rrjedhën e poshtme është përllogaritur përmes matjeve të përcjellshmërisë elektrike të lumit që tregon nivelin e kripësisë, të kryera gjatë fushatës së kampionimit të PMBU-së (shihni seksionin 8.3). Për basenin e Ishmit është identifikuar vetëm një trup ujor i përkohshëm. Këta trupa ujorë janë karakterizuar në përputhje me Sistemin A të DKU-së, Shtojca II, dhe paraqiten në Tabelën 5-3 dhe Hartën 5-1.

[107] Dokumentacioni i mbajtur nga Ujësjellësi Tiranë. Që prej vitit 1990, fluksi në hyrje ka shumë të ngjarë që të jetë ndikuar nga ndryshimi klimatik.

EMRI I LIQENIT	LOKAL NËNBASEN	TRUPI UJOR KODI I BE-SË	LARTËSIA mmnd	ZONA km²	LLOJI I GJEOLOGJISË	TIPOLOGJIA KODI I BE-SË	THELLËSIA m	Forma	GJATËSIA km	Δ NIVELI m	REGJIMI I PRURJES HYRËSE AKTUALE			
											Q10	**Q50**	**Q90**	**BFI**
Bovilla	ISH3	LW351401	317	4.068	Gëlqeror/I përzier	L-14	45	Artificial	3.9	10	4.35	3.28	2.32	0.71
Qyteti	ISH1	LW351402	116	0.406	silicor	L-15		Artificial			0.21	0.06	0.03	0.50
Çerkezë	ISH1	LW351403	94	0.590	silicor	L-13		Artificial			0.63	0.18	0.09	0.50
Tapizë	ISH1	LW351404	46	0.651	silicor	L-13		Artificial			1.323	0.378	0.189	0.50

Tabela 5-3

5.4.4 Trupat Ujorë Bregdetarë

Gjatë përcaktimit të shtrirjes së ujërave bregdetare në një rajon të basenit ujor, objektivi është që të sigurohemi se ujërat bregdetare t'i caktohen sipas njësisë së menaxhimit më të afërt ose më të përshtatshme nga pikëpamja natyrore për të minimizuar ndarjen e panevojshme të trupave ujorë bregdetarë.

Lagunat bregdetare (të pranishme në basenin ujor të Ishmit) mund të jenë ose ujëra bregdetare ose kalimtarë, në varësi të faktit nëse laguna përkon me përkufizimin e ujërave të përkohshme në Direktivë sipas nenit 2(6) të DKU-së. Për basenin e Ishmit është identifikuar vetëm një trup ujor bregdetar. Këta trupa ujorë janë karakterizuar në përputhje me Sistemin A të DKU-së, Shtojca II dhe paraqiten në Tabelën 5-4.

EMRI I TRUPIT KALIMTAR	LOKAL NËNBASEN	TRUPI UJOR KODI I BE-SË	FORMA	GJATËSIA	KRIPËSIA MESATARE VJETORE	PËRCJELLSHMËRIA ELEKTRIKE	BATICA MESATARE DIAPAZONI	TEMPERATURA MESATARE E UJIT	TURBULLIRA	
Ishëm	ISH0	TË351411	Natural	2.8						

Tabela 5-4

5.4.5 Trupat Ujorë Tepër të Modifikuar dhe Trupat Ujorë Artificialë

Sipas nenit 4(3) të DKU-së, TUTM-të janë trupa ujorë natyrorë që, për shkak të ndryshimeve fizike nga veprimtaria njerëzore, ndryshojnë thelbësisht në karakter dhe për rrjedhojë nuk mund ta arrijnë "statusin e mirë ekologjik" (SME). Në vend të statusit të mirë ekologjik, objektivi mjedisor për TUTM-të dhe TUA-të është potenciali i mirë ekologjik (PME). TUA-të ndryshojnë nga TUTM-të nga fakti se trupi ujor artificial është krijuar në një vend ku nuk ka ekzistuar më parë. Elementet e vogla të ujërave sipërfaqësore (pellgjet e përkohshme, përrenjtë etj) mund të shpërfillen[114].

Neni 2(9) i DKU-së i përcakton TUTM-të si:

- Trupa të ndryshuar fizikisht - p.sh diga, rezervuarë, kanalizime, vepra të mbrojtjes nga përmbytjet etj.
- Trupa me ndryshime të ndjeshme në karakter - ç'është më e rëndësishmja këtu përfshihen edhe ndryshimet e regjimit të prurjes

[114] Komisioni Evropian, Dokumenti Udhëzues i CIS-it Nr. 4, Identifikimi dhe Përcaktimi i Trupave Ujorë Tepër të Modifikuar (3.1.2)

- Sipas kritereve të Nenit 4(3) - ndryshimet e trupit ujor për të arritur SME-në do të ndikojnë negativisht në veprimtaritë për të cilat janë krijuar TUTM-të, ose objektivat e vendosura për shkak të modifikimeve nuk mund të arrihen për arsye të realizueshmërisë teknike ose kostove disproporcionale përmes mjeteve të tjera mjedisore më të mira.

Për basenin e Ishmit janë identifikuar 8 TUA ose TUTM të kategorive të ndryshme. Këta trupa ujorë janë karakterizuar në përputhje me Sistemin A të DKU-së, Shtojca II, dhe paraqiten në Tabela 5-1 dhe Tabela 5-2. Kodet janë caktuar sipas sistemit Pfafstetter dhe paraqiten në Harta 5-1.

TUTM-të dhe TUA-të përfshihen në Tabelat e karakterizimit për trupat ujorë me të cilët ngjasojnë më së shumti, pasi kështu përcaktohet potenciali ekologjik i TUTM-së/TUA-së (Kapitulli 10).

Tabela 5-1 Baseni ujor i Ishmit, Karakterizimi i Trupit Ujor, Kategoria e LUMENJVE

EMRI I LUMIT	**LOKAL** NËNBASEN	TRUPI UJOR KODI I BE-SË (RW)	LARTËSIA mmnd	ZONA km²	LLOJI I GJEOLOGJISË	TIPOLOGJIA KODI I BE-SË	FORMA E LUMIT	GJATËSIA km	GJERËSIA m	REGJIMI I PRURJES AKTUALE			
										Q10	**Q50**	**Q90**	**IPB**
Ishëm	ISH0	351413	<200	693	Organik + Silicor	R-06b	Natural	23.8	21	33.53	15.97	7.61	0.48
Zezë	ISH0	351421	<200	100	Gëlqeror + Përzier	R-04	Natural	4.1	11	5.48	1.88	0.72	0.38
Zezë	ISH0	351422	<200	28	Gëlqeror + Përzier	R-05	Natural	17.5	7	1.53	0.53	0.20	0.38
Zezë	ISH0	351423	<200	65.5	Gëlqeror + Përzier	R-05	Natural	7.1	28	3.95	1.35	0.52	0.38
Zezë	ISH0	351425	<200	51.7	Gëlqeror + Përzier	R-05	Natural	6.9	55	3.16	1.08	0.41	0.38
Zezë	ISH0	351427	>200<800	32.1	Gëlqeror + Përzier	R-11	Natural	8.4	19	2.18	0.75	0.29	0.38
Ishëm	ISH0	35143	<200	474	Organik + Silicor	R-06b	Natural	6.7	22	28.05	14.09	6.89	0.49
Terkuza	ISH1	351441	<200	176	Organik + Silicor	R-06b	Natural	13.3	28	7.67	4.82	3.07	0.64
Terkuza	ISH1	351443	<200	129	Organik + Silicor	R-06b	TUTM	13.8	60	6.85	3.89	2.54	0.65
Terkuza	ISH3	351444	>200<800	15.2	Gëlqeror + Përzier	R-11	Natural	3	66	1.14	0.76	0.49	0.64
Terkuza	ISH3	351445	>200<800	40.7	Gëlqeror + Përzier	R-11	Natural	7.4	88	2.99	1.99	1.28	0.64
Tiranë	ISH1	35145	<200	286	Organik + Silicor	R-06b	Natural	8.1	20	20.38	9.27	3.82	0.41
Tiranë	ISH1	35146	<200	31.4	Silicor	R-03	Natural	3.8	4	2.51	1.14	0.47	0.41
Tiranë	ISH1	35147	<200	211.5	Organik + Silicor	R-06b	Natural	7.6	34	17.87	8.13	3.35	0.41
Lana	ISH1	351481	<200	61.8	Silicor	R-03	Natural	4.8	11	1.60	0.86	0.52	0.60
Lana	ISH1	351482	<200	14.1	Silicor	R-03	Natural	3.2	6	0.41	0.22	0.13	0.60
Lana	ISH1	351483	<200	41.5	Organik + Silicor	R-06a	Natural	4.2	10	1.19	0.64	0.39	0.60
Lana	ISH1	351485	<200	31.0	Organik + Silicor	R-06a	TUTM	7.2	7	0.89	0.48	0.29	0.60
Lana	ISH1	351487	>200 <800	9.9	Organik + Silicor	R-06a	Natural	1.8	4	0.31	0.17	0.10	0.60
Tiranë	ISH1	351491	<200	127	Organik + Silicor	R-06b	TUTM	10.1	35	6.22	4.70	3.16	0.67
Tiranë	ISH1	351493	<200	99.2	Gëlqeror + Përzier	R-05	TUTM	6.4	27	5.10	3.85	2.59	0.67
Tiranë	ISH4	351495	>200 <800	80.7	Gëlqeror + Përzier	R-05	Natural	18.4	45	4.25	3.21	2.16	0.67

Tabela 5-2 – Karakterizimi i Trupave Ujorë – Kategoria e LIQENEVE

EMRI I LIQENIT	LOKAL NËNBASEN	TRUPI UJOR KODI I BE-SË	LARTËSIA mmnd	ZONA km²	LLOJI I GJEOLOGJISË	TIPOLOGJIA KODI I BE-SË	THELLËSIA m	Forma	GJATËSIA km	Δ NIVELI m	REGJIMI I PRURJES HYRËSE AKTUALE			
											Q10	Q50	Q90	BFI
Bovilla	ISH3	LW351401	317	4.068	Gëlqeror/I përzier	L-14	45	Artificial	3.9	10	4.35	3.28	2.32	0.71
Qyteti Tiranë	ISH1	LW351402	116	0.406	silicor	L-15		Artificial			0.21	0.06	0.03	0.50
Çerkezë	ISH1	LW351403	94	0.590	silicor	L-13		Artificial			0.63	0.18	0.09	0.50
Tapizë	ISH1	LW351404	46	0.651	silicor	L-13		Artificial			1.323	0.378	0.189	0.50


Tabela 5-3 – Karakterizimi i Trupave Ujorë – Kategoria e Ujërave KALIMTARE

EMRI I TRUPIT KALIMTAR	LOKAL NËNBASEN	TRUPI UJOR KODI I BE-SË	FORMA	GJATËSIA	KRIPËSIA MESATARE VJETORE	PËRCJELLSHMËRIA ELEKTRIKE	BATICA MESATARE DIAPAZONI	TEMPERATURA MESATARE E UJIT	TURBULLIRA	
Ishëm	ISH0	TË351411	Natural	2.8						

Tabela 5-4 – Karakterizimi i Trupave Ujorë – Kategoria e Ujërave BREGDETARE

EMRI I TRUPIT BREGDETAR	LOKAL NËNBASEN	TRUPI UJOR KODI I BE-SË	FORMA	GJATËSIA	KRIPËSIA MESATARE VJETORE	THELLËSIA MESATARE	BATICA MESATARE DIAPAZONI	TEMPERATURA MESATARE E UJIT	TURBULLIRA	
Luka Rodini	ISH0	CW351402	Natyror (bregdet)	15.0						

Harta 5-1 – Kategoria dhe Përvijimi i Trupit Ujor Sipërfaqësor



6 Karakterizimi dhe Përvijimi i Trupave Ujorë Nëntokësorë

6.1 Vështrim i përgjithshëm

Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor duhet të paraqesë karakterizimin fillestar të të gjithë trupave ujorë nëntokësorë për të vlerësuar përdorimet e tyre dhe shkallën në të cilën ata rrezikojnë të mos i arrijnë objektivat mjedisore, përkatësisht statusin e mirë sasior dhe atë kimik. Këto trupa ujorë nëntokësorë të identifikuar si në risk për të mos arritur objektivat mjedisore kërkojnë karakterizim dhe hetim të mëtejshëm për të bërë një vlerësim më të saktë të domethënies së këtij risku dhe identifikuar masat e kërkuara.

6.1.1 Shqipëri

Autoriteti kompetent në Shqipëri për identifikimin dhe raportimin e burimeve të ujërave nëntokësore, tendencat dhe ndikimet është Shërbimi Shqiptar Gjeologjik (ShGjSh). Aktivitetet e ShGjSh-së lidhen ngushtësisht me ato të AKM-së (përmes monitorimit dhe raportimit) dhe AMBU-së (përmes dhënies së lejeve dhe shpërndarjes së burimeve ujore).

6.1.2 Bashkimi Evropian

Qëllimi kryesor i DKU-së është të parandalojë përkeqësimin e mëtejshëm dhe të përmirësojë statusin e ekosistemeve ujore lidhur me nevojat e tyre për ujë, si dhe ekosistemet tokësore që varen drejtpërdrejt nga ekosistemet ujore. Objektivi i mbrojtjes dhe përmirësimit të statusit të mirë të ujërave nëntokësore është hartuar në mënyrë të tillë që të arrihet ky qëllim. Kërkesat për identifikimin dhe vlerësimin e ujërave nëntokësore përafrohen ngushtësisht me objektivat e Direktivës 2006/118/KE[115] dhe Direktivës 91/676/KEE[116]. Kjo Direktivë përcakton regjimin që vendos standardet e cilësisë së ujërave nëntokësore dhe masat për parandalimin ose kufizimin e ndotësve që depërtojnë në ujëra nëntokësore.

6.2 Kategorizimi dhe Tipologjia e Trupave Ujorë Nëntokësorë

6.2.1 Kategoritë e Trupave Ujorë Nëntokësorë

Ujërat nëntokësore 'nuk kategorizohen njësoj si ujërat sipërfaqësore', pasi konsiderohen si element individual. Megjithatë, ka disa dallime mjaft të rëndësishme midis ujërave nëntokësore të përgjithshme (i gjithë uji poshtë sipërfaqes së tokës), akuiferëve (shtresa me depërtueshmëri të mjaftueshme për të lejuar nxjerrjen e sasive të konsiderueshme të ujit) dhe trupave ujorë nëntokësorë (volume të ndryshme ose të përvijuara ose zona me ujëra nëntokësore brenda akuiferëve të njohur).

Testi i Direktivës Kuadër të Ujit për të provuar nëse trupi ujor nëntokësor ka potencialin e mjaftueshëm për t'u sjellë si akuifer varet nga dy kritere:

a) A mjafton burimi për të ofruar ujë në sasi > 10 m³/ditë ose për 50 persona?
b) A do të ndikonte nxjerrja e ujit nga burimi i ujërave nëntokësore në statusin ekologjik të një trupi ujor sipërfaqësor apo një ekosistemi të varur prej tij?

Përmasa minimale e një trupi ujor nëntokësor është normalisht 10 km², sipërfaqe kjo që është vendosur për t'u përshtatur me zonën minimale ujëmbledhëse të trupit ujor sipërfaqësor të përcaktuar në DKU, Shtojca II (1.2.1). Njësitë më të vogla janë të volitshme nëse trupi ujor nëntokësor kërkon menaxhim të veçantë për sa i përket mbrojtjes së një ekosistemi të varur ose furnizimeve të lokalizuara të ujit të pijshëm për më shumë se 50 persona. (Në shtojcën për ujërat nëntokësor jepet përkufizimi dhe skema sipas DKU).

[115] Komisioni Evropian - Direktiva 2006/118/KE për mbrojtjen e ujërave nëntokësore kundër ndotjes dhe degradimit, ndryshuar me Direktivën 2014/80/EU

[116] Komisioni Evropian, Direktiva 91/676/EEC për mbrojtjen e ujërave kundër ndotjes së shkaktuar nga nitratet që vijnë nga burimet bujqësore

6.2.2 Llojet e Trupit Ujor Nëntokësor dhe Përvijimi Bazë

Praktika më e mirë ndërkombëtare bën një dallim midis akuiferëve në varësi të potencialit të burimit të tyre. Zakonisht, ato ndahen në a) akuiferë parësorë b) akuiferë dytësorë c) shtresa joproduktive. Këto dallime pranohen gjerësisht në tipologjinë e DKU-së për ujërat nëntokësore, ku ujërat nëntokësore klasifikohen sipas tetë llojeve parësore. Është e mundur dhe e lejueshme që një akuifer i tërë të mund të formojë edhe një trup ujor të vetëm nëntokësor, por vetëm nëse është krejtësisht homogjen për sa i përket veçorive hidraulike, variacioneve të kimisë natyrore, presioneve dhe ndikimeve.

Poshtë kritereve të nivelit të lartë të potencialit të burimit të ujërave nëntokësore, përvijimi i mëtejshëm i akuiferëve në trupa ujorë individualë duhet të marrë parasysh:

- Ndarjet e rrjedhës së ujërave nëntokësore, duke përdorur Ujëmbledhësit e ujërave sipërfaqësore dhe kufijtë gjeologjikë si pika të përafërta ku informacioni është i kufizuar.
- Variacionet kimike natyrore, ku vendosin një limit për vlerën e nxjerrjes së ujit të pijshëm nga burimi, ose ku ndikojnë në ndjeshmërinë ndaj dhe në menaxhimin e presioneve.

Tabela 6-1– Llojet Kryesore të Ujërave Nëntokësore në Shqipëri, Raportimi

SHQIPËRI KODI	RAPORTIMI I SHQIPËRISË FORMACIONI GJEOLOGJIK [117]	RAPORTIMI EKUIVALENT ME WISE FORMACIONI GJEOLOGJIK [118]
1	Poroze - produktivitet i lartë	Poroze - shumë produktive
2	Poroze - produktivitet mesatar	Poroze - mesatarisht produktive
3	Poroze - produktivitet i ulët	Poroze - mesatarisht produktive
4	Poroze - produktivitet i lartë	Akuiferë me fizura dhe karstike - shumë produktive
5	Frakturuar - produktivitet mesatar	Akuiferë me fizura - mesatarisht produktive
6	Frakturuar - produktivitet i ulët	Akuiferë me fizura - mesatarisht produktive
7	Jo-akuiferë	Akuiferë të parëndësishëm - ujëra nëntokësore të kufizuara
8	I padisponueshëm ose i panjohur	I panjohur

6.2.3 Përvijimi i Ndikuar nga Horizontet e Trupit Ujor Nëntokësor


Sistemi shqiptar e bën dallimin mes akuiferëve në varësi të produktivitetit: i lartë (10 – 100 l/s) dhe shumë i lartë (> 100 l/s) janë baras me kategorinë WISE “shumë produktivë”; mesatar (1 – 10 l/s) dhe i ulët (0.1 – 1 l/s) janë baras me kategorinë WISE “mesatarisht produktivë”; shumë i ulët (<0.1 l/s) është baras me kategorinë WISE “jo-akuifer”.

Formacionet gjeologjike (duke përfshirë akuiferët) gjenden në tre dimensione dhe zakonisht përmbajnë karakteristika gjeologjike komplekse të cilat mund të ndikojnë në a) rendimentin e trupave ujorë individualë b) cenueshmërinë ndaj presioneve të ndotjes c) lidhjen me sistemet e ujërave sipërfaqësore.

Figura 6-1- Ilustrimi i Trupave Ujorë të Shumtë brenda një Akuiferi të Vetëm

[117] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar – Harta Hidrologjike 1:200 000 e Shqipërisë, 2015. Tabulimet e llojeve të akuiferëve në raportimin e Shqipërisë është në përputhje me hartën 1:200 000 dhe dosjet GIS .shp. Për përvijimin e llojeve janë përdorur përkufizimet e GIS .shp për llojin.

[118] DKU– Dokumenti Udhëzues i Raportimit WISE GIS 2016 – skema GWB – elementi i skemës – *Formacioni Gjeologjik*



Sistemi shqiptar e bën dallimin mes akuiferëve në varësi të produktivitetit: i lartë (10 – 100 l/s) dhe shumë i lartë (> 100 l/s) janë baras me kategorinë WISE “shumë produktivë”; mesatar (1 – 10 l/s) dhe i ulët (0.1 – 1 l/s) janë baras me kategorinë WISE “mesatarisht produktivë”; shumë i ulët (<0.1 l/s) është baras me kategorinë WISE “jo-akuifer”.

Formacionet gjeologjike (duke përfshirë akuiferët) gjenden në tre dimensione dhe zakonisht përmbajnë karakteristika gjeologjike komplekse të cilat mund të ndikojnë në a) rendimentin e trupave ujorë individualë b) cenueshmërinë ndaj presioneve të ndotjes c) lidhjen me sistemet e ujërave sipërfaqësore.


Figura 6-1 ilustron 3-dimensionalitetin e mundshëm të disa akuiferëve. Kur veçoritë e secilit horizont vertikal janë tepër të ndryshëm lidhur me a) deri në c) më lart, atëherë çdo horizont ose shtresë mund të identifikohet si trup ujor nëntokësor i veçantë. Horizonteve iu caktohen kode në rend ngjitës nga sipërfaqja.

6.2.4 Përvijimi i Ndikuar nga Presionet dhe Ndikimet e Trupit Ujor Nëntokësor

Njësoj si për ujërat sipërfaqësore, përvijimi i trupave ujorë nëntokësore duhet të sigurojë përcaktimin e saktë të statusit sasior dhe kimik të secilit trup ujor. Në shembullin e Figurës 6-2, një akuifer i vetëm mund të hasë ndotje të konsiderueshme të lokalizuar nga ndikimet e sipërme, duke sjellë status kimik të ndryshëm përgjatë akuiferit[119]. Në këtë rast, duhen përvijuar tre trupa ujorë nëntokësorë për të reflektuar me saktësi ndryshimin në status.


Po të njëjtat kritere vlejnë edhe për zonat me nxjerrje intensive të ujit, të cilat mund të krijojnë presione të lokalizuara në nivelin e ujërave nëntokësore. Në rastin e Figura 6-3, pompimi krijon një “kon depresioni” dhe me shumë mundësi një ndryshim të konsiderueshëm të statusit sasior të ujërave nëntokësore lokale. Për pasojë, ‘zona e ndikimit’ do të përvijohej si trup ujor nëntokësor individual, ndonëse është pjesë e akuiferit të ngjashëm. Në këtë shembull ndodh edhe rimbushja e imponuar nga trupi ujor sipërfaqësor i afërt, e cila sjell kritere shtesë për përvijim nëse ekosistemi ujor sipërfaqësor varet në mënyrë të konsiderueshme nga shkarkimet e ujërave nëntokësore. Prandaj, faza përfundimtare e përvijimit të trupit ujor është një proces përsëritës, në të cilin duhen vlerësuar edhe presionet dhe ndikimet antropogjene përgjatë një akuiferi të vetëm, për të bërë dallimin midis niveleve të ndryshme të statusit brenda akuiferit.

Figura 6-2 –Përvijimi i trupit ujor nëntokësor që vjen nga ndryshimi i statusit kimik



[119] Komisioni Evropian– Dokumenti Udhëzues i CIS-it - Raporti Teknik për Karakterizimin e Trupit Ujor Nëntokësor, 2004.

Figura 6-3 –Përvijimi i trupit ujor nëntokësor që vjen nga ndryshimi në statusin sasior



6.3 Vlerësimet e Mëparshme të Trupave Ujorë Nëntokësorë

6.3.1 Formacionet Kryesore Hidrogjeologjike

Ujërat nëntokësore në Shqipëri janë të pranishme në formacione të ndryshme që i përkasin periudhës Kuateriane deri në Palaeozoike. Struktura gjeologjike e maleve Shqiptare përmban kryesisht sedimente karstike me bazë karboni (p.sh formacione gëlqerore). Këto, së bashku me akuiferët shumë të depërtueshëm të zhavorrit në ultësira, janë dy akuiferë tepër produktivë. Të dy këto lloje janë shumë të pranishme në basenin e Ishmit.

Tabela 6-2 – Përmbledhja Kombëtare e Formacioneve Hidrogjeologjike[120]

SHQIPËRI KODI	LLOJI I AKUIFERIT	LITOLOGJIA TREGUESE	NUMRI I TUN-ëve	RENDIMENTET E REALIZUESHME l/s
ALG1	Akuiferë karbonati	Gurë gëlqerorë, dolomite	18	4500 - 6100
ALG2	Akuiferë porozë	Aluvione	12	1200 - 1300
ALG3	Akuiferë magmatikë	Shkëmbinj intruzivë bazikë	6	345 - 630
ALG4	Konglomerat/gur ranor	Sipas përcaktimit	9	430 -570
ALG5	Akuiferë me depërtueshmëri të		10	< 300

6.3.2 Identifikimi Paraprak i Trupave Ujorë Nëntokësorë në Shqipëri

Puna paraprake për karakterizimin e akuiferëve dhe përvijimin e trupave ujorë nëntokësorë u realizua me pjesëmarrjen e ShGjSh-së. Falë kësaj pune u identifikuan pesë formacione të mëdha hidrogjeologjike në të gjithë Shqipërinë dhe u përvijuan 55 trupa ujorë nëntokësorë individualë (Ujërat nëntokësore në Shqipëri janë të pranishme në formacione të ndryshme që i përkasin periudhës Kuateriane deri në Palaeozoike. Struktura gjeologjike e maleve Shqiptare përmban kryesisht sedimente karstike me bazë karboni (p.sh formacione gëlqerore). Këto, së bashku me akuiferët shumë të depërtueshëm të zhavorrit në ultësira, janë dy akuiferë tepër produktivë. Të dy këto lloje janë shumë të pranishme në basenin e Ishmit.

Tabela 6-2).

Megjithatë, karakterizimi i realizuar në kuadër të projektit CEMSA 2008 paraqiti mangësi në një sërë fushash:

a) Nuk u mor parasysh rëndësia e nën-ndarjes së akuiferëve të mëdhenj rajonalë në TUN-ë më të vegjël mbi bazën e kritereve të presioneve dhe ndikimeve të nxjerrjeve, statusit të ndotjes ose ekosistemeve tokësore të varura në shkallë lokale. Të gjitha këto janë 'teste' thelbësore për të dalluar një TUN të veçantë nga një akuifer më i gjerë.

[120] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Inventari i Burimeve të Ujërave Nëntokësore dhe Modelet e tyre të Përdorimit, projekti CEMSA, 2008

b) Sistemi i caktimit të numrave të trupave ujorë nëntokësorë, ndonëse lidhet me "llojin"sipas Ujërat nëntokësore në Shqipëri janë të pranishme në formacione të ndryshme që i përkasin periudhës Kuateriane deri në Palaeozoike. Struktura gjeologjike e maleve Shqiptare përmban kryesisht sedimente karstike me bazë karboni (p.sh formacione gëlqerore). Këto, së bashku me akuiferët shumë të depërtueshëm të zhavorrit në ultësira, janë dy akuiferë tepër produktivë. Të dy këto lloje janë shumë të pranishme në basenin e Ishmit.

c) Tabela 6-2, është shumë e përgjithshëme për sa i përket shkallës (55 TUN-u për të gjithë Shqipërinë bazuar kryesisht te formacionet gjeologjike).

d) Sistemi i caktimit të numrave të trupave ujorë nëntokësorë bazohej te një rend kombëtar arbitrar, pa iu referuar basenit ujor brenda trupit ujor nëntokësor. Ndonëse shumë trupa ujorë nëntokësorë janë ndërkufitarë, në praktikë, kufiri hidrogjeologjik pasqyron ndarjen topografike të sipërfaqes.

e) Trupat ujorë nëntokësorë në basene lumore të ndryshme menaxhohen zakonisht nga autoritete kompetente të ndryshme, ndaj është më e leverdishme nga pikëpamja administrative që të përdoret një sistem numerik që e njeh basenin ujor në të cilin ndodhet TUN-i (duke njohur edhe rëndësinë e sigurimit të menaxhimit konsistent përgjatë trupave ndërkufitarë).

Megjithatë, puna fillestare u pasua nga një punë shumë më detajuese për formacionet hidrogjeologjike përmes Publikimit të Hartës Gjeologjike të Shqipërisë në shkallën 1:200 000 në vitin 2015. Vlerësimi gjithëpërfshirës ofron tashmë bazën për identifikimin e detajuar të trupave ujorë nëntokësorë individualë të mundshëm në Shqipëri, në kuadrin e raportimit të PMBU-së së re. Në fazën e re të PMBU-ve në Shqipëri, identifikimi dhe raportimi i të gjitha atributeve të trupit ujor synohet që të përafrohet më ngushtësisht me skemën e raportimit WISE të BE-së, krahasuar me studimet e mëparshme[121]. Kjo do të thotë se janë përdorur llojet kryesore hidrologjike të përcaktuara në Praktika më e mirë ndërkombëtare bën një dallim midis akuiferëve në varësi të potencialit të burimit të tyre. Zakonisht, ato ndahen në a) akuiferë parësorë b) akuiferë dytësorë c) shtresa joproduktive. Këto dallime pranohen gjerësisht në tipologjinë e DKU-së për ujërat nëntokësore, ku ujërat nëntokësore klasifikohen sipas tetë llojeve parësore. Është e mundur dhe e lejueshme që një akuifer i tërë të mund të formojë edhe një trup ujor të vetëm nëntokësor, por vetëm nëse është krejtësisht homogjen për sa i përket veçorive hidraulike, variacioneve të kimisë natyrore, presioneve dhe ndikimeve.

Poshtë kritereve të nivelit të lartë të potencialit të burimit të ujërave nëntokësore, përvijimi i mëtejshëm i akuiferëve në trupa ujorë individualë duhet të marrë parasysh:

- Ndarjet e rrjedhës së ujërave nëntokësore, duke përdorur Ujëmbledhësit e ujërave sipërfaqësore dhe kufijtë gjeologjikë si pika të përafërta ku informacioni është i kufizuar.
- Variacionet kimike natyrore, ku vendosin një limit për vlerën e nxjerrjes së ujit të pijshëm nga burimi, ose ku ndikojnë në ndjeshmërinë ndaj dhe në menaxhimin e presioneve.

Tabela 6-1, krahasuar me ato të projektit CEMSA 2008 i cili nuk përdor përkufizimet standarde.

6.4 Trupat Ujorë Nëntokësorë në Basenin e Ishmit

Duke qenë se ka mungesë të theksuar të dhënash dhe detajesh të besueshme rreth cilësisë së ujit, statusit sasior, presioneve dhe ndikimeve në pjesën më të madhe të trupave ujorë nëntokësorë në Shqipëri, përvijimi i parë (2024-2029) është kryer, në mënyrë të pashmangshme, bazuar kryesisht te gjykimi i ekspertëve. Kapitulli 10 bën një raportim më të plotë të presioneve të trupave ujorë nëntokësorë, statusit aktual dhe ndikimeve të tyre tek këta trupa ujorë të veçantë.

6.4.1 Sistemi i Rishikuar i Caktimit të Numrave për Trupat Ujorë Nëntokësorë

Sistemi i caktimit të numrave, për trupat ujorë nëntokësorë të përvijuar në basenet e Ishmit dhe Erzenit përdor të njëjtën qasje të përgjithshme si për Lumenjtë, Liqenet dhe Ujërat Bregdetare (identifikuar nga prefiksi i

[121]Udhëzimi për Raportimin e Direktivës Kuadër të Ujit - http://cdr.eionet.europa.eu/help/WFD/WFD_521_2016

përshtatshëm i kategorisë WISE)[122], duke përdorur protokollin që TUN-i përfaqëson një trup ujor nëntokësor. Është shumë e rëndësishme të japim disa indikacione për potencialin e akuiferit në sistemin e caktimit të numrave, bazuar në kategoritë shqiptare të përmendura në Tabelën 6-1.

Praktika më e mirë ndërkombëtare bën një dallim midis akuiferëve në varësi të potencialit të burimit të tyre. Zakonisht, ato ndahen në a) akuiferë parësorë b) akuiferë dytësorë c) shtresa joproduktive. Këto dallime pranohen gjerësisht në tipologjinë e DKU-së për ujërat nëntokësore, ku ujërat nëntokësore klasifikohen sipas tetë llojeve parësore. Është e mundur dhe e lejueshme që një akuifer i tërë të mund të formojë edhe një trup ujor të vetëm nëntokësor, por vetëm nëse është krejtësisht homogjen për sa i përket veçorive hidraulike, variacioneve të kimisë natyrore, presioneve dhe ndikimeve.

Poshtë kritereve të nivelit të lartë të potencialit të burimit të ujërave nëntokësore, përvijimi i mëtejshëm i akuiferëve në trupa ujorë individualë duhet të marrë parasysh:

- Ndarjet e rrjedhës së ujërave nëntokësore, duke përdorur Ujëmbledhësit e ujërave sipërfaqësore dhe kufijtë gjeologjikë si pika të përafërta ku informacioni është i kufizuar.
- Variacionet kimike natyrore, ku vendosin një limit për vlerën e nxjerrjes së ujit të pijshëm nga burimi, ose ku ndikojnë në ndjeshmërinë ndaj dhe në menaxhimin e presioneve.

Tabela 6-1TUN + Kodi Fillestar (4 shifror) i basenit CCM + Lloji i akuiferit të mundshëm (1 deri në 7) + Numri Unik i Serisë (2 shifra). Lloji i akuiferit të mundshëm rrjedh nga shtatë llojet e identifikuara në Hartën Gjeologjike të Shqipërisë në shkallën 1:200 000 hartuar nga ShGjSh-ja (Praktika më e mirë ndërkombëtare bën një dallim midis akuiferëve në varësi të potencialit të burimit të tyre. Zakonisht, ato ndahen në a) akuiferë parësorë b) akuiferë dytësorë c) shtresa joproduktive. Këto dallime pranohen gjerësisht në tipologjinë e DKU-së për ujërat nëntokësore, ku ujërat nëntokësore klasifikohen sipas tetë llojeve parësore. Është e mundur dhe e lejueshme që një akuifer i tërë të mund të formojë edhe një trup ujor të vetëm nëntokësor, por vetëm nëse është krejtësisht homogjen për sa i përket veçorive hidraulike, variacioneve të kimisë natyrore, presioneve dhe ndikimeve.

Poshtë kritereve të nivelit të lartë të potencialit të burimit të ujërave nëntokësore, përvijimi i mëtejshëm i akuiferëve në trupa ujorë individualë duhet të marrë parasysh:

- Ndarjet e rrjedhës së ujërave nëntokësore, duke përdorur Ujëmbledhësit e ujërave sipërfaqësore dhe kufijtë gjeologjikë si pika të përafërta ku informacioni është i kufizuar.
- Variacionet kimike natyrore, ku vendosin një limit për vlerën e nxjerrjes së ujit të pijshëm nga burimi, ose ku ndikojnë në ndjeshmërinë ndaj dhe në menaxhimin e presioneve.

Tabela 6-1). Kodi i serisë është një nëngrupim i llojit të akuiferit të mundshëm pra për llojin e akuiferit 04 (akuifer karstik me produktivitet të lartë), mund të ketë trup ujor individual 01, 02, 03 të llojit 04 brenda basenit ujor . P.sh TUN-i 3514 04 09 përfaqëson trupin ujor nëntokësor individual të nëntë të llojit 4 në basenin e Ishmit (3514). Nuk ka asnjë logjikë fikse për caktimin e numrave rendorë përveç rregullit të përgjithshëm arbitrar që sa më i lartë të jetë numri, aq më i largët është TUN-i nga pika e shkarkimit sipërfaqësor të basenit ujor . Sistemi mundëson identifikimin e 99 trupave ujorë nëntokësorë në çdo basen ujore, në rend fleksibël.

6.4.2 Trupat Ujorë Nëntokësorë të Përvijuar në Basenin e Ishmit

Në basenin e Ishmit janë identifikuar 13 trupa ujorë individualë. Për shumë sisteme të trupave ujorë nëntokësorë vërehet se disa trupa ujorë nëntokësorë janë ndërkufitarë midis baseneve ujore të afërta. Rrjedhimisht, këto lidhje duhen marrë parasysh nga regjimet e menaxhimit të trupave ujorë nëntokësorë. Për qëllime raportimi, janë përcaktuar tre grupe të ujërave nëntokësore bazuar te (i) ngjashmëria dhe vazhdimësia gjeologjike; (ii) mungesa e informacioneve të monitorimit; (iii) mungesa e informacioneve për presionet të konsiderueshme të nxjerrjes së ujit dhe (iv) mungesa e informacioneve për presionet e konsiderueshme të ndotjes. Tre grupet kryesore të raportimit renditen në Tabelën 6-3. Përshkrimi i shkurtër të trupave ujorë nëntokësorë dhe përshkrimi i plotë të grupeve përkatëse gjendet në Shtojcën Teknike VII.

[122] DKU– Dokumenti Udhëzues i Raportimit WISE GIS 2016 – skema TUN– elementi i skemës – FormacioniGjeologjik - RW, LW, TW, CW


Tabela 6-3 –Grupet e Raportimit për Trupat Ujorë Nëntokësorë në Basenin e Lumit Ishëm

Grupi	LLOJI I AKUIFERIT	LITOLOGJIA	GJEOMETRIA	KODI TUN-it	EMRI I TUN-it	SIPËRFAQJA (km2)
A	T4: Akuiferë karsstikë me fizura - produktivitet i lartë deri shumë i lartë	Gur gëlqeror	I ngjashëm	GW35140403	Kroi I Madh	9
				GW35140405	Bovilla	17
				GW35140411	Dajt	11
B	T5: Akuiferë porozë / porozë me fizura - produktivitet mesatar deri i ulët	Konglomerate, gurë ranorë dhe gurë balte	I ngjashëm	GW35140501	FUSHË-KRUJË	31
				GW35140503	QINAM	30
				GW35140505	BRAR	45
C	T5: Akuiferë porozë / porozë me fizura - produktivitet mesatar deri i ulët	Konglomerate, gurë ranorë dhe gurë balte	I ngjashëm	GW35140507	KASHAR	37
				GW35140509	BUBQ	72

Tabela 6-4 –Karakterizimi dhe Përvijimi i Trupave Ujorë Nëntokësorë

UN	Emri	Grupi i Raportimit	LITOLOGJIA	LLOJI I AKUIFERIT DHE PRODUKTIVITETI	SHTRESA E SIPËRME	HORIZONTI I	KUFIZUAR	ZONA km²	THELLËSIA 80	SY %	K m/d	T m²/d	NDËR KUFITAR	EKOSISTEM I VARUR
GW35140101	Thumanë	-	Aluvione	Lloji 1	Argjilë ranore	Po	1	69.0	25-40	21	148	10^{2}-10^{-1}	Po	Gjola River
GW35140103	Tiranë	-	Aluvione	Lloji 1	Argjilë ranore	Jo	2	87.2	30-60	24	300	$>10^{3}$	Po	Lumenjtë e Tiranës dhe
GW35140401	Makareshi	-	Gur gëlqeror	Lloji 4	Shtresë dheu e hollë ose shkëmb i zhveshur	Jo	1	13.6	700	14		10^{4} – 10^{-1}	Po	N
GW35140403	Kroi I Madh	A (Masivi i Dajtit)	Gur gëlqeror dolomitik	Lloji 4	Shtresë dheu e hollë ose shkëmb i zhveshur	Jo	1	9.1	500	14		10^{4} – 10^{-1}	Po	N
GW35140405	Bovilla Dajt							17.0	500	14		10^{4} – 10^{-1}	Po	N
GW35140411	Dajt							11.1	500	14		10^{4} – 10^{-1}	Po	N
GW35140407	Pas Mali i Dajtit Brar Selite I Malit	-	Gur gëlqeror	Lloji 4	Shtresë dheu e hollë ose shkëmb i zhveshur	Jo	1	22.1	1700	14		10^{4} – 10^{-1}	Po	N
GW35140409	Selite I Malit		Gur gëlqeror	Lloji 4	Shkëmb i zhveshur	Jo	1	18.3	300	14		10^{4} – 10^{-1}	Po	N
GW35140501	Fushë-Krujë	B (Krujë)	Gur ranor, konglomerat dhe gur argjilor	Tipi 5	Flish	Po	1	31.2	1100	27	0.05	10^{2} - 10	Po	N
GW35140503	Qinam							30.4	1650	27	0.03	10^{2} - 10	Po	N
GW35140505	Brar							44.7	1450	27	0.03	10^{2} - 10	Po	N
GW35140507	Kashar	C (Kashar-Bubq)	Gur ranor, konglomerat dhe gur argjilor	Tipi 5	Flish	Po	1	36.9	1700	21	0.03	10^{2} - 10	Po	N
GW35140509	Bubq							72.2	1100	21	0.03	10^{2} - 10	Po	N

Harta 6-1 – Kategoria dhe Përvijimi i Trupit Ujor Nëntokësor



7 Karakterizimi dhe Përvijimi i Zonave të Mbrojtura

7.1 Vështrim i përgjithshëm

7.1.1 Shqipëri

Përvijimi i zonave të mbrojtura ka shumë rëndësi, pikërisht për t'u mbështetur te përpjekjet e mëparshme dhe për të përdorur një metodologji shkencore gjithëpërfshirëse për përvijimin e kufijve të ekosistemeve që përfshijnë zona të mbrojtura individuale, sidomos për identifikimin e hapësirës përreth zonës së mbrojtur, ku veprimtaritë njerëzore mund të ndikojnë në procese të rëndësishme ekologjike, si dhe te qëndrueshmëria e popullatave vendase brenda zonës së mbrojtur. Kjo zonë me sipërfaqe më të madhe vendoset në fokusin logjik të monitorimit, studimit dhe menaxhimit bashkëpunues, të nevojshme për ta mbajtur zonën e mbrojtur në gjendje funksionale dhe të mirë. Këtyre zonave u referohemi si zona të mbrojtura – ekosisteme qëndrore.

7.1.2 Bashkimi Evropian

Sipas nenit 6 dhe Shtojcës IV të DKU-së, kërkohet që të ngrihet regjistri për të gjitha zonat brenda çdo rajoni të basenit ujor , për të cilin kërkohet mbrojtje e veçantë në kuadër të legjislacionit të Komunitetit për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore ose për konservimin e habitateve dhe specieve që varen drejtpërdrejt nga uji. Nevojiten edhe hartat që tregojnë vendndodhjen dhe madhësinë e zonave të mbrojtura, si dhe përshkrimin e legjislacionit të Komunitetit ose kombëtar sipas të cilit janë përcaktuar këto zona.

7.2 Zonat e Mbrojtura të Ujit të Pijshëm për Konsum nga Njeriu

7.2.1 Vështrim i përgjithshëm

Sipas nenit 7 të DKU-së (që rrjedh nga Direktiva e BE-së 2020/2184)[123] të gjithë trupat ujorë që furnizojnë > 10 m^3/ditë ose 50 persona kërkojnë përvijim dhe njihen si Zona të Mbrojtura të Ujit të Pijshëm (ZMUP). Udhëzimet e CIS-it përcaktojnë se në rastin e trupave ujorë nëntokësorë, ZMUP-të duhet të gjejnë zbatim për të gjithë trupin ujor nëntokësor të përvijuar dhe jo vetëm për një pjesë përbërëse të tij. [124] Prandaj, për një akuifer të ngjashëm që furnizon ujë të pijshëm i cili nuk ndahet në trupa ujorë individualë (shihni seksionin 6.2.4), i gjithë akuiferi në tërësi duhet shpallur ZMUP.

Megjithatë, ZMUP-të duhen dalluar nga "zonat e mbrojtjes" (neni 7(3) DKU-së). Zonat e mbrojtjes janë zona të përvijuara brenda ZMUP-së që synojnë veçanërisht kufizimin e drejtpërdrejtë të operacioneve apo veprimtarive të dëmshme që mund të ndotin burimet e ujërave nëntokësore ose sipërfaqësore. Sipas praktikës më të mirë ndërkombëtare, zakonisht përvijohen tre zona rreth fushës me puse ose rezervuarit, ku rregulloret bëhen më të rrepta sa më shumë t'i afrohemi burimit.

Zona e jashtme përshkruhet zakonisht si "Ujëmbledhësi i burimit' ose ZMUP siç përshkruhet më lart. Për këto zona kërkohen politika dhe masa mbrojtëse të përgjithshme si për shembull kufizimi i ujërave të ndotura të patrajtuara nga fshatrat në rrjedhën e sipërme në rastin e një rezervuari për furnizim me ujë të pijshëm si p.sh rezervuari i Bovillës. Në rastin e shfrytëzimit të ujërave nëntokësore që ndodhen në zona bujqësore, e gjithë zona e ZMUP-së mund të shpallet si Zonë e Cenueshme nga Nitratet (ZCN) [125] (shihni seksionin 7.5).

Zona e Jashtme 2 është kryesisht zonë buferike ku risqet e kontaminimit nga substancat prioritare të rrezikshme dhe ndotësit specifikë për basenet ujore (NSBU) duhen kontrolluar rreptësisht. Si në burimet e ujërave nëntokësore, ashtu edhe në burimet e ujërave sipërfaqësore, madhësia e zonës së jashtme përcaktohet kryesisht nga tiparet hidraulike të shpejtësive mesatare (pra të mesme) të lumit që shkarkojnë në rezervuar, ose përcjellshmëria hidraulike (k) e formacioneve gjeologjike. Këto identifikojnë kohën minimale të udhëtimit që i

[123] Komisioni Evropian – Direktiva(BE) 2020/2184për cilësinë e ujit për konsum njerëzor

[124] Komisioni Evropian, Dokumenti Udhëzues 16 i CIS-it, Udhëzime për Ujërat Nëntokësore në Zonat e Mbrojtura të Ujit të Pijshëm

[125]Komisioni Evropian, Direktiva 91/676/KEE për mbrojtjen e ujërave kundër ndotjes së shkaktuar nga nitratet që vijnë nga burimet bujqësore

nevojiten substancave të rrezikshme për të mbërritur në burim. Zona e Brendshme 1 është kryesisht një zonë sigurie rreth burimit ose pikës së nxjerrjes. (Figura 7-1 referuese e zonimit ndodhet në Shtojcën VIII)

7.2.2 Zona të Mbrojtjes së Ujit të Pijshëm në Ishëm

Teksa flasim, ka mangësi të konsiderueshme lidhur me menaxhimin aktual të ZMUP-ve në të gjithë Shqipërinë. Shumë burime të mëdha për nxjerrje nuk kanë Leje për nxjerrje, madje vendndodhjet e tyre nuk janë hartëzuar saktë. Shumë pak i kanë të identifikuara zonat e mbrojtjes higjeno-sanitare, sidomos për burimet e ujërave nëntokësore.

Regjistri i Burimeve të Ujit të Pijshëm, që mbahet nga shoqëria UK, paraqitet në Shtojcën Teknike III. Ka mungesë konsistence dhe të dhënash për shkak të cilësisë së dobët të raportimit. Aktualisht, raportohet se të gjitha stacionet e pompimit që monitorohen kanë një zonë të mbrojtur me rreze 10-15 m (me raste shkon deri në 25 m), e cila rrethohet me gardh metali, mur tulle ose mur guri.

Në fazën e parë të hartimit të PMBU-së për Ishmin 2024-2029 mjafton që për shumicën e ZMUP-ve të përvijohet një kufi i thjeshtë që të përcaktojë ujëmbledhësin e burimit p.sh për rezervuarë të mëdhenj si Bovilla, ose një zonë arbitrare buferike si p.sh 500 m rreth të gjithë burimeve të ujërave nëntokësore sipas Figurës 7-1. Këto harta janë përgatitur përmes GIS-it, por mund të kërkojnë edhe legjislacion dytësor për të vënë në zbatim zonat buferike.

ZMUP-të që mund të përcaktohen në këtë fazë të ndërmjetme (por jo domosdoshmërisht të mbrojtura në legjislacion) paraqiten në Regjistrin e ZMUP-së, Tabela 7-3.

Një prej prioriteteve urgjente të ZMUP-së si pjesë e Programit të Masave është të identifikojë, regjistrojë dhe zbatojë të gjitha Lejet e nxjerrjes dhe të përvijojë e publikojë zonat e mbrojtjes higjeno-sanitare. Këto harta u duhen vënë në dispozicion të gjitha autoriteteve kompetente përgjegjëse për përdorimin e ujit ose veprimtaritë e përdorimit të tokës që mund të ndikojnë te ZMUP-të, përfshi shoqëritë UK që mbajnë përgjegjësi të parat për mbrojtjen dhe kufizimin e praktikave të dëmshme në ZMUP.

7.3 Zonat e Shpallura për Speciet Ujore me Rëndësi Ekonomike

7.3.1 Vështrim i përgjithshëm

Disa zona të ujërave të grykëderdhjes dhe bregdetit përvijohen si ujëra të populluara nga butakët. Ujërat e populluara nga butakët janë zona që kërkojnë mbrojtje ose përmirësim për të mundësuar jetën dhe rritjen e butakëve dhe për të kontribuar në cilësinë e lartë të tyre për konsum njerëzor. Peshku është në krye të zinxhirit ushqimor të ekosistemeve ujore dhe përdoret gjerësisht si organizëm tregues i cilësisë së ujit. Diversiteti i madh i peshqve kontribuon jo vetëm në ofrimin e shërbimeve socio-ekonomike, por edhe në ruajtjen e balancës ekologjike të burimeve natyrore. Restaurimi i habitateve të peshqve dhe shtimi i popullatave të peshqve të rrezikuar mund të kontribuojë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme të ekosistemit. E kundërta ndodh me reduktimin e biodiversitetit të peshqve, pasi mund të sjellë ndikim negativ te vlera e shërbimeve kulturore të ekosistemeve ujore, si argëtimi, ekoturizmi dhe edukimi. Nëse vlera kulturore prishet një herë, nuk rikuperohet më kurrë. Prandaj, konservimi i biodiversitetit të peshqve ka përfitime të mëdha mjedisore dhe mbron biodiversitetin ujor për brezat e ardhshëm.

7.3.2 Zonat e Mbrojtura me Rëndësi Ekonomike në Ishëm

Objektivi për ujërat e populluara nga butakët, i parashtruar në Direktivën për Ujërat nga Butakët, është që ato të mbrohen dhe, kur shihet e nevojshme, të përmirësohet cilësia e ujërave të populluara nga butakët për të mbështetur zhvillimin dhe jetën e butakëve (moluskëve bivalvë dhe gastropodë), duke kontribuar kështu në cilësinë e lartë të produkteve butake për konsum drejtpërdrejt nga njeriu.

Ky objektiv do të arrihet duke përmbushur standardet e detyrueshme dhe duke respektuar standardet udhëzuese të Direktivës për Ujërat e Populluara nga Butakët.

Tabela 7-1 – Lista e zonave të mbrojtura me rëndësi ekonomike

EMRI I VIJËS SË UJIT	PËRVIJIMI	STATUSI I PËRPUTHSHMËRISË
Rezervuari i Bovillës	*Ciprinid*	Në kushte mbijetese
Lumi Ishëm 1	*Cyprinid, Salmonid*	Në kushte mbijetese
Zezë	*Cyprinid, Salmonid*	Në kushte dështimi për mbijetesë
Tërkuza	*Ciprinid*	Në kushte mbijetese
Hamallaj	*Ciprinid*	Në kushte mbijetese
Lumi Tiranës	*Ciprinid*	Në kushte mbijetese

Vështrimi i përgjithshëm i hartës së zonave të mbrojtura me rëndësi ekonomike (ZMRE) të identifikuara në mënyrë ligjore, ose provizore paraqitet në Shtojcën Teknike VIII.

7.4 Zonat e Përvijuara për Ujërat Rekreative dhe të Larjes

7.4.1 Vështrim i përgjithshëm

Ujërat e larjes janë ujëra dhe plazhe të përcaktuara ku frekuentohen nga një numër mjaft i madh njerëzish. Për ujërat e larjes, objektivi është të mbrohet dhe përmirësohet cilësia e mjedisit dhe të mbrohet shëndeti i njeriut duke përmbushur standardet e cilësisë së 'mjaftueshme' të ujit, të parashtruara në Direktivën për Ujërat e Larjes, dhe të merren masa realiste, proporcionale dhe të përshtatshme, me qëllim që numri i ujërave të larjes që klasifikohen si "të shkëlqyera" ose "të mira" të rritet sa më shumë.

Sipas VKM nr.797, datë 29.9.2010 për miratimin e rregullores higjeno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes", ujërat e larjes janë çdo trup (element) ujor sipërfaqësor ku autoriteti kompetent pret të lahen një numër mjaft i madh njerëzish dhe ku nuk ka ndalim apo rekomandim të përhershëm për të mos u larë.

Kriteret janë vendosur për të mbrojtur publikun nga ekspozimi ndaj patogjenëve të dëmshëm, ndërkohë që marrin pjesë në veprimtari ujore, si në not, vozitje ose sërf, në të gjithë trupat ujorë të cilët janë përcaktuar për qëllime përdorimi Rekreative.

Vlerësimi i plazhit ose i ujërave të larjes duhet të marrë parasysh disa aspekte kyç, përfshi:

- praninë dhe natyrën e rreziqeve natyrore ose artificiale;
- rëndësinë e rreziqeve krahasuar me pasojat shëndetësore;
- disponueshmërinë dhe praktikueshmërinë e veprimeve riparuese;
- shpeshtësinë dhe densitetin e përdorimit; dhe
- nivelin e zhvillimit.

Menaxhimi i integruar i zonës bregdetare (MIZB) dhe menaxhimi i integruar i basenit ujor (MIBU) ndërmerren zakonisht në përgjigje të çështjeve që kanë të bëjnë me peshkimin, argëtimin/turizmin, rreziqet dhe pakësimin e rizoforeve. Prandaj, rreziqet e ujërave rekreative janë vetëm një prej çështjeve, interesave dhe kufizimeve të larmishme që prekin planifikimin dhe menaxhimin e zonave bregdetare ose baseneve ujore. Vendimet lidhur me menaxhimin e rreziqeve duhen marrë duke iu referuar të gjitha politikave qeveritare përkatëse dhe faktorëve të tjerë që ndikojnë te përshtatshmëria dhe përdorimi i basenit bregdetar/lumor. Duhen marrë parasysh të gjithë faktorët socialë, ekonomikë, estetikë, argëtues dhe ekologjikë. MIZB-ja dhe MIBU shërbejnë si ombrella për koordinimin e fushave të ndryshme të ndërhyrjes, duke mbuluar sistemet ekonomike, abiotike/biotike dhe sociale[126].

[126]Organizata Botërore e Shëndetësisë Udhëzime për mjedise të sigurta të ujërave rekreative. Vëllimi 1. Ujërat bregdetare dhe të ëmbla.

Ujërat e larjes klasifikohen si “të dobëta” nëse, në grupin e të dhënave për cilësinë e ujërave të larjes për periudhën e fundit të vlerësimit (1), vlerat e përqindjes (2) për numeracionet mikrobiologjike janë më keq (3) se vlerat “e mjaftueshme” të përcaktuara në Shtojcën Teknike VIII, Tabela 2, kolona D.

Ujërat e larjes klasifikohen si “të mjaftueshme” nëse, në grupin e të dhënave për cilësinë e ujërave të larjes për periudhën e fundit të vlerësimit, vlerat e përqindjes për numeracionet mikrobiologjike janë të barabarta ose më të larta (4) se vlerat “e mjaftueshme” të përcaktuara në Shtojcën Teknike VIII, Tabela 2, kolona D; dhe nëse ujërat e larjes i nënshtrohen ndotjes afatshkurtër.

Ujërat e larjes klasifikohen si “të mira” nëse në grupin e të dhënave për cilësinë e ujërave të larjes për periudhën e fundit të vlerësimit, vlerat e përqindjes për numeracionet mikrobiologjike janë të barabarta ose më të larta (4) se vlerat “e cilësisë së mirë” të përcaktuara në Shtojcën Teknike VIII, Tabela 2, kolona C; dhe nëse ujërat e larjes i nënshtrohen ndotjes afatshkurtër.

Ujërat e larjes klasifikohen si “të shkëlqyera” nëse, në grupin e të dhënave për cilësinë e ujërave të larjes për periudhën e fundit të vlerësimit, vlerat e përqindjes për numeracionet mikrobiologjike janë të barabarta ose më të larta se vlerat “e cilësisë së shkëlqyer” të përcaktuara në Shtojcën Teknike VIII, Tabela 2, kolona B; dhe nëse ujërat e larjes i nënshtrohen ndotjes afatshkurtër.

7.4.2 Zonat e Mbrojtjes së Ujërave Rekreative dhe të Larjes në Ishëm

Zonat bregdetare dhe detare janë më të pasurat për sa i përket diversitetit biologjik. Ekosistemet komplekse të lagunave bregdetare strehojnë mbi 70% të faunës vertebrore në vend, sidomos shpendët shtegtarë dhe dimërues. Në lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdha në vend gjenden rreth 70 lloje shpendësh dhe zogjsh ujorë, popullsia e të cilëve shkon deri në 180,000 individë gjatë dimrit.

Në basenin e lumit Ishëm gjejmë :

Zona e Mbrojtur “Kune-Vain-Patok-Fushëkuqe-Ishëm”

- Rezervat Natyrore të Menaxhuara, Kategoria IV IUCN, miratuar me VKM-në Nr. 60, datë 26.01.2022.
- Zonat e rëndësishme për shpendët (ZRSh) si habitate për shpendët shtegtarë (Urdhri i Ministrit të Mjedisit Nr. 283, datë 10.04.2013).

Habitate të rëndësishme:

- Grykëderdhjet e lumenjve Mat dhe Ishëm
- Lagunat bregdetare (Patoku, Gryka e Patokut, Godulla))
- Dunat bregdetare me Juniperus oxycedrus subsp. Macrocarpa
- Pyjet e dunave bregdetare me Pinus halepensis, P. pinea, P. pinaster

Një tjetër zonë është **Kepi i Rodonit – Gjiri i Lalzit – Pylli i Ishëmit** (25 km), i cili është propozuar si peizazh i mbrojtur natyror/detar. Kepi i Rodonit ndodhet në pjesën më perëndimore të vargut kodrinor Prezë-Rodon, i cili ndan basenin e Erzenit (që përfundon te Gjiri i Lalzit) nga baseni i Ishmit (që përfundon të Kepi i Rodonit). Formohet nga tokë terrigjene dhe përbëhet nga brigje të larta vertikale deri në 25 m. Sipërfaqja e tokës gërryhet dhe brehet vazhdimisht nga dallgët e detit. Bregdeti, që përfaqësohet nga brigje ranoro-argjilore Tortoniane, është zonë me erozion dhe djerrë në përgjithësi. Në bimësinë tokësore mbizotëron makja mesdhetare. Zona përfshin disa habitate mjaft të rëndësishme, si dhe lloje me interes të veçantë konservimi. Hidro-dinamika detare ose ndryshimet klimatike e kanë shtuar më tej erozionin në Lalëz. Erozioni është përforcuar edhe nga ndikimi njeriut. Bonifikimi i tokës dhe tharja e ligatinave kanë ndodhur masivisht, në çdo cep të vendit. Për më tepër, rezervuarët e rinj ujitës në pellgun ujëmbledhës dhe veprimtaria intensive minerare në shtretërit e lumenjve gjatë dekadave të fundit, e kanë shqetësuar së tepërmi sistemin hidrologjik të bregdetit dhe grykëderdhjet e lumenjve të Erzenit dhe Ishmit. Kepi i Rodonit është pjesë e listës së Monumenteve Natyrore të Shqipërisë për shkak të vlerave të veçanta natyrore[127]. Diversiteti i madh biologjik natyror: Përfshin habitate detare dhe bregdetare të populluara nga lloje të larmishme. Prania e ligatinave në afërsi e ka pasuruar

127 Miho A., Kashta L., Beqiraj S. (2013): Midis Tokës dhe Detit

biodiversitetin natyror. Përfaqësimi: vijë bregdetare ranore dhe shkëmbore në detin Adriatik. Produktiviteti: I lartë; për shkak të pranisë së degëve lumore dhe ligatinave. Me rëndësi për lloje si: breshka e detit, delfinët etj. (Harta e zonave të mbrojtura rekreative të identifikuara në mënyrë ligjore ose provizore paraqitet në Shtojcën Teknike VIII.)

7.5 Zonat e Përvijuara si Zona të Ndjeshme ndaj Lëndëve Ushqyese

7.5.1 Vështrim i përgjithshëm

Legjislacioni i BE-së parashikon dy zona të llojeve të ndryshme që duhen mbrojtur nga ndotja e sipërfaqes:

- Zonat me përdorim aktual apo potencial për nxjerrjen e ujit të pijshëm, ku përqendrimi i nitrateve për shkak të praktikave në sipërfaqe është më i lartë se 50 m/l, sipas Direktivës së Nitrateve.[128] Këto zona duhen shpallur si "zona të ndjeshme ndaj lëndëve ushqyese" (ZNLU), ku të zbatohen praktikat e duhura të menaxhimit të tokës.
- Zonat e shpallura si "zona të ndjeshme ndaj lëndëve ushqyese", [129] sipas Direktivës për Ujërat e Ndotura Urbane (DUNU). Në këto zona, trupat ujorë janë eutrofikë, ose mund të bëhen eutrofikë nëse nuk merren masa mbrojtëse, ose kur kërkohet trajtim i mëtejshëm i ujërave të ndotura për mbrojtjen e habitateve ose specieve (DUNU, Shtojca II).

Zonat e Ndjeshme ndaj Lëndëve Ushqyese (ZNLU) shpallen atëherë kur përqendrimi i nitrateve në trupa ujorë është i lartë, ose në rritje, apo kur trupat ujorë janë ose po bëhen eutrofikë për shkak të ndotjes nga nitratet bujqësore. Fermerët brenda ZNLU-ve duhet të veprojnë në përputhje me programin e veprimit të masave të detyrueshme për reduktimin e humbjeve të nitrateve bujqësore. Krahas kësaj, është hartuar edhe kodi i praktikës bujqësore, i cili duhet zbatuar vullnetarisht nga të gjithë fermerët.

7.5.2 Zonat e Ndjeshme ndaj Lëndëve Ushqyese në Ishëm

Identifikimi i Zonave të Ndjeshme ndaj Lëndëve Ushqyese në Basenin e Lumit Ishëm nuk ka përfunduar dhe nuk ka ende hartë për identifikimin e zonave të ndryshme.

ZNLU-të janë zona të shpallura si zona në rrezik nga ndotja për shkak të nitrateve që vijnë nga bujqësia. Sipas Direktivës për Nitratet dhe Rregulloreve për Nitratet ujërat përkufizohen si të ndotura nëse:

- përmbajnë ose mund të përmbajnë, nëse nuk merren masa parandaluese, nitrate me përqendrim më të madh se 50 mg/l;
- janë eutrofike, ose po bëhen eutrofike, nëse nuk merren masa parandaluese.

Për të përvijuar ZNLU-të, fermerët duhet të mbajnë të dhëna për burimet e lëndëve ushqyese në fermë dhe plehëruesit e hedhur në fusha. Fokusi do të jetë te volumet e ujërave të pistë dhe të papastër, jashtëqitjeveve të shpendëve, mbetjeve të shpendëve dhe jashtëqitjeve të tjera të ngurta që prodhohen në fermë. Falë këtyre të dhënave, instrumenti do të përllogarisë sasitë e lëndëve ushqyese (azot dhe të tjerë) që prodhohen në fermë. Më pas, duke ditur vendndodhjen e fermës dhe ngastrave, mund të llogaritet sasia e plehëruesve që do të hidhet në çdo parcelë, për të përmbushur rregulloret për ZNLU-të. Instrumenti llogarit edhe kërkesat minimale për depozitimin e jashtëqitjeve të shpendëve dhe ujërave të papastra, i mundëson fermerët të përgatisin kalendarët e përdorimit të plehëruesve ose të shtojnë rezultatet e analizës së dheut për të përmirësuar llogaritjet. Harta e ZNLU-ve ose zonave të mbrojtura të ndjeshme ndaj lëndëve ushqyese (ZMNLU) të identifikuara në mënyrë ligjore ose provizore paraqitet në Shtojcën Teknike VIII.

[128] Komisioni Evropian, Direktiva 91/676/EEC për mbrojtjen e ujërave kundër ndotjes së shkaktuar nga nitratet që vijnë nga burimet bujqësore

[129] Komisioni Evropian – Direktiva 91/271/KEE për trajtimin e ujërave të ndotura urbane

7.6 Zonat e Shpallura për Mbrojtjen e Habitateve dhe Specieve

7.6.1 Vështrim i përgjithshëm

Duke qenë se harmonizimi i legjislacionit kombëtar të Shteteve Joanëtare të BE-së me standardet e BE-së nuk ka përfunduar ende, nuk mund të bëhet inventarizimi i plotë i ZM-ve për mbarë basenin, gjë që kërkohet nga DKU-ja. Prandaj, mund të përdoret një qasje e modifikuar, që të marrë parasysh:

- Standardet kombëtare për përvijimin e ZM-ve;
- Statusin e ndryshëm në kuadër të zbatimit të Konventës së Bernës dhe rrjetit NATURA 2000 në vend;
- Nivelin e ndryshëm të përshtatjes së legjislacionit kombëtar të Shteteve Joanëtare të BE-së me legjislacionin dhe standardet e BE-së;
- Mungesën e përgjithshme të regjistrave dhe/ose bazave efikase të të dhënave për ZM-të në vend;
- Përgjegjësinë e përbashkët për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e zonave të ujit të pijshëm midis autoriteteve kompetente në nivel kombëtar dhe nënkombëtar;
- Përgjegjësinë e përbashkët për monitorimin e zonave të mbrojtura të ujit të pijshëm;

7.6.2 Zonat e Mbrojtjes së Habitatit në Ishëm

Brenda kufijve të basenit ujor të lumit Ishëm ndodhen pesë zona të mbrojtura të përcaktuara sipas legjislacionit shqiptar. Qasja për përcaktimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura në Shqipëri përshkruhet në Ligjin për Zonat e Mbrojtura. Ligji përcakton mbrojtjen e gjashtë (6) kategorive të zonave të mbrojtura. Kategorizimi i zonave, statusi dhe shkalla e mbrojtjes për çdo zonë bazohen të kriteret e Qendrës Botërore të Konservimit të Natyrës. Në kuadër të rishikimit dhe vlerësimit të Zonave të Mbrojtura, në territorin e këtij baseni ujor shtrihen pesë zona të mbrojtura me sipërfaqet që zënë përkatësisht si në tabelën më poshtë.

Tabela 7-2 – Zonat e mbrojtura në basenin e lumit Ishëm

Kategoria sipas IUCN	Sipërfaqe (ha)	Përshkrimi i kategorisë së ZM	Emri i ZM	VKM e shpalljes
IV	1,471.84	Park Natyror	Qafë Shtamë	VKM Nr.10, datë 28.12.2020
II	19,837.71	Park Kombëtar	Pas Mali i Dajtit	VKM nr.402, date 21.06.2006
IV	8092	Rezervë Natyrore e Menaxhuar	Kune-Vain-Patok-Fushë kuqe-Ishëm	VKM nr.60, datë 26.01.2022
IV	749.23	Park Natyror	Mali me Gropa-Bizë-Martanesh	VKM Nr.10, datë 28.12.2020
V	1,441.50	Peizazh i mbrojtur	Krastë-Verjon	VKM nr. 468, date 26.7.2018

Puna për menaxhimin e zonave të Natura 2000[130] ka nisur vetëm kohët e fundit. Në kuadër të projektit NaturAL, është identifikuar shpërndarja e mundshme e Zonave të Natura 2000 me Interes për Komunitetin (ZIK), gjë që ka sjellë hartimin e listës paraprake me 43 zonat e propozuara për të gjithë vendin. Në basenin ujor të lumit Ishëm janë identifikuar tre zona të Natura 2000 me interes për komunitetin.

Sipas legjislacionit përkatës të zonave të mbrojtura, këto kategori të ZM-ve duhen menaxhuar sipas planeve të tyre të menaxhimit. Situata aktuale e menaxhimit ka treguar se jo të gjitha ZM-të në basenin e lumit Ishëm kanë plane individuale menaxhimi. Katër prej pesë ZM-ve të renditura kanë plane menaxhimi. Rezerva e Mbrojtur Natyrore Patok-FushëKuqe-Ishëm dhe tre zona të tjera kanë përgatitur plane menaxhimi. Programi i veçantë i masave është pjesë përbërëse e këtyre planeve, ku parashtrohen masat përkatëse lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e burimeve ujore dhe ekosistemeve të varura prej tyre. Informacioni përmbledhës për çdo zonë të mbrojtur gjendet në Shtojcën Teknike VII.

[130] BE - Forcimi i Kapaciteteve Kombëtare për Mbrojtjen e Natyrës – Përgatitja për Rrjetin Natura 2000, Mars 2019

Tabela 7-3 – Regjistri i Zonave të Mbrojtura – Kategoria e ZONAVE TË MBROJTURA TË UJIT TË PIJSHËM

EMRI I ZONËS SË MBROJTUR	NËNBASENET	FUNKSIONI	DATA E KRIJIMIT	LEGJISLACIONI KOMBËTAR PËRKATËS	LEGJISLACIONI PËRKATËS I BE-SË	TRUPAT UJORË PËRKATËS	STATUSI AKTUAL	KUFIJTË E SHPALLUR
ZONA E MBROJTJES HIGJENO-SANITARE E REZERVUARIT UJËMBLEDHËS TË BOVILLËS	ISH3	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE	351444 351445	2 2	
BURIMI UJOR SELITË	ISH3	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE	351444	2	
BURIMI UJOR SHËN MËRI	ISH2	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE			
BURIMI UJOR QAFË MOLLË	ISH3	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE			
BURIMI UJOR SHPELLA E TUJANIT	ISH3	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE	351495 351493	4 2	
BURIMI UJOR LAKNAS	ISH2	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE	351481 35147	5 5	
BURIMI UJOR BËRXULL	ISH1	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE	35146	3	

BURIMI UJOR YZBERISHT	ISH1	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE	351483	5	
BURIMI UJOR FUSHË-KRUJË	ISH1	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE	351423	3	

Tabela 7-4 - Regjistri i Zonave të Mbrojtura - Kategoria e LLOJEVE UJORE ME RËNDËSI EKONOMIKE

EMRI I ZONËS SË MBROJTUR	NËNBASENET	FUNKSIONI	DATA E KRIJIMIT	LEGJISLACIONI KOMBËTAR PËRKATËS	LEGJISLACIONI PËRKATËS I BE-SË	TRUPAT UJORË PËRKATËS	STATUSI AKTUAL	KUFIJTË E SHPALLUR
Rezervuari i Bovillës	ISH3	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE	351444	2	
Lumi Ishëm 1	ISH0	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE	351413	4	
Zezë	ISH2	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE	351425 351423	3	
Terkuza	ISH2	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE	351441 351443	5 4	
Hamallaj	ISH0	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE			
Lumi Tiranës	ISH2	ZMUP			Direktiva 2000/60/KE Direktiva 91/676/KEE	351495 351493 351491	4 2 5	

Tabela 7-5 – Regjistri i Zonave të Mbrojtura – Kategoria e UJËRAVE REKREATIVE DHE TË LARJES

EMRI I ZONËS SË MBROJTUR	NËNBASENET	FUNKSIONI	DATA E KRIJIMIT	LEGJISLACIONI KOMBËTAR PËRKATËS	LEGJISLACIONI PËRKATËS I BE-SË	TRUPAT UJORË PËRKATËS	STATUSI AKTUAL	KUFIJTË E SHPALLUR
Kune-Vain-Patok-Fushëkuqe-Ishëm	ISH0	ZMRNM	VKM Nr.60 datë 26.01.2022	Ligji 81/217 datë 04.05.2017	Direktiva 2006/7/KE;	351411	3	Ka


Tabela 7-6 - Regjistri i Zonave të Mbrojtura – Kategoria e ZONAVE TË NDJESHME NDAJ LËNDËVE USHQYESE

EMRI I ZONËS SË MBROJTUR	NËNBASENET	FUNKSIONI	DATA E KRIJIMIT	LEGJISLACIONI KOMBËTAR PËRKATËS	LEGJISLACIONI PËRKATËS I BE-SË	TRUPAT UJORË PËRKATËS	STATUSI AKTUAL	KUFIJTË E SHPALLUR
	ISH3	ZMURL			Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE			

Tabela 7 -7 – Regjistri i Zonave të Mbrojtura – Kategoria e HABITATEVE DHE LLOJEVE TË MBROJTURA

EMRI I ZONËS SË MBROJTUR	NËNBASENET	FUNKSIONI	DATA E KRIJIMIT	LEGJISLACIONI KOMBËTAR PËRKATËS	LEGJISLACIONI PËRKATËS I BE-SË	TRUPAT UJORË PËRKATËS	STATUSI AKTUAL	KUFIJTË E SHPALLUR
Park Natyror Qafë Shtamë	ISH3	ZMURL	VKM Nr.10, datë 28.12.2020	LIGJI NR. 81/2017 PËR ZONAT E MBROJTURA	Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE	351427	1	Ka
Park Kombëtar Mali i Dajtit	ISH3	ZMURL	VKM Nr.402, datë 21.06.2006	LIGJI NR. 81/2017 PËR ZONAT E MBROJTURA	Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE	351495	4	
Rezervë Natyrore e Menaxhuar Kune-Vain-Patok-Fushëkuqe-Ishëm	ISH0	ZMRNM	VKM Nr.60 datë 26.01.2022	LIGJI NR. 81/2017 PËR ZONAT E MBROJTURA	Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE	351411	3	Ka
Park Natyror Mali me Gropa-Bizë-Martanesh	ISH3	ZMURL	VKM Nr.10, datë 28.12.2020	LIGJI NR. 81/2017 PËR ZONAT E MBROJTURA	Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE			
Peizazh i mbrojtur Krastë-Verjon	ISH2	ZMURL	DCM nr. 468, datë 26.7.2018	LIGJI NR. 81/2017 PËR ZONAT E MBROJTURA	Direktiva 91/676/KEE Direktiva 91/272/KEE	351425	3	

Harta 7-1 – Harta e të gjitha zonave të mbrojtura – Ishëm



8 Rrjetet e Monitorimit dhe të Dhënat e Mbikëqyrjes

8.1 Konteksti Ligjor

8.1.1 Shqipëri

Direktiva e BE-së 2008/105/KE është transpozuar me VKM-në Nr. 246, datë 30.4.2014 "Për vendosjen e standardeve të cilësisë mjedisore për ujërat sipërfaqësore" [131] ,[132]. Programet aktuale të monitorimit të ujit janë përgatitur në bazë të VKM-së Nr. 1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit".

AMBU duhet të përdorë informacionet e mbledhura nëpërmjet monitorimit të ujit dhe çdo informacion tjetër përkatës që përmban të dhëna ekzistuese nga monitorimi i mjedisit, për të bërë vlerësimin e probabilitetit që kanë trupat ujorë sipërfaqësorë në basen për të mos i përmbushur objektivat e cilësisë mjedisore të vendosura për trupat ujorë. AMBU mund të përdorë teknikat e modelimit për të ndihmuar vendimmarrjen. Sipas karakterizimit dhe vlerësimit të ndikimit, të realizuara në përputhje me Shtojcën 1 të VKM-së Nr. 1015, datë 16.12.2020, për çdo periudhë gjatë së cilës zbatohet plani i menaxhimit të basenit ujor hartohet programi i monitorimit mbikëqyrës dhe programi i monitorimit operacional, madje në disa raste edhe programet e monitorimit hulumtues. Institucionet shtetërore përgjegjëse për monitorimin duhet të monitorojnë ato parametra që janë tregues të statusit të çdo elementi të cilësisë. Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore shërben si bazë të dhënash për burimet e gjeoreferimit në sistemin GIS. Të dhënat për shtresat, që gjenden në të Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore, Publikohen në faqen e internetit të ASIG-ut.

8.1.2 Bashkimi Evropian

Programi i monitorimit në përputhje me DKU-në në nivel kombëtar synon mbledhjen e të dhënave për vlerësimin e statusit bazë, identifikimin e tendencave të cilësisë së ujit dhe rishikimin e efikasitetit të masave të zbatuara për mbrojtjen e burimeve ujore. Shtojcat II dhe V të DKU-së përcaktojnë vlerësimin e përgjithshëm dhe planin e monitorimit për ujërat. Kjo gjen zbatim si për trupat ujorë sipërfaqësorë, ashtu edhe për trupat ujorë nëntokësorë dhe për zonat e mbrojtura[133].

Aspektet kyç të programeve të monitorimit përfshijnë:

- Llojet e monitorimit dhe objektivat (vrojtuese, mbikëqyrëse, operacionale [134]dhe hetimore);
- Zgjedhjen e pikave të monitorimit (me qëllim që të ofrohet një panoramë sa më koherente dhe e përgjithshme e statusit kimik brenda çdo baseni ujor);
- Elementet e cilësisë (EC) që do të monitorohen dhe shpeshtësia e kërkuar e monitorimit.

8.2 Programi i Monitorimit të Sasisë së Ujërave Sipërfaqësore

8.2.1 Autoriteti Kompetent

Autoriteti kompetent përgjegjës për monitorimin sasior të ujërave sipërfaqësore është Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEO). Instituti është një njësi kërkimore kombëtare që operon në varësi të Universitetit Politeknik të Tiranës.

---

[131]Direktiva 2008/105/KE për standardet e cilësisë mjedisore në fushën e politikave të ujit, që ndryshon dhe shfuqizon Direktivat e Këshillit 82/176/KEE, 83/513/KEE, 84/156/KEE, 84/491/KEE, 86/280/KEE dhe Direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit

[132] Direktiva 2008/105/KE është ndryshuar me Direktivën 2013/39/BE që ndryshon edhe Direktivat 2000/60/KE dhe 2008/105/KE lidhur me substancat prioritare në fushën e politikës së ujit

[133]Direktiva Kuadër e Ujit, Shtojca V

[134] Termi "fushatë monitorimi" nuk përdoret në DKU, por përdoret në kontekstin shqiptar për të treguar vlerësimin gjithëpërfshirës dhe të shpejtë të kushteve biologjike dhe/ose fiziko-kimike ku programi i monitorimit kombëtar është i pamjaftueshëm, për të nxjerrë edhe përafrimet e para lidhur me statusin e mundshëm të trupit ujor

Ky institut ka hasur vështirësi mjaft të mëdha menaxhuese, financuese dhe organizative gjatë viteve të fundit lidhur me ofrimin e të dhënave bazë dhe të besueshme për prurjen, të përpunuara në përputhje me standardet e pranueshme minimale ndërkombëtare.[135] Pavarësisht asistencës teknike të ofruar në mënyrë të përsëritur nga agjencitë e mëdha ndërkombëtare që prej vitit 2007, shumica e stacioneve të monitorimit meteorologjik dhe hidrologjik nuk janë funksionale ose kanë probleme të mëdha kalibrimi.

8.2.2 Rëndësia e Rrjetit të Monitorimit të Sasisë së Ujërave Sipërfaqësore

Një rrjet i besueshëm hidrometrik aktual është tejet i rëndësishëm për të pasur një MIBU sa më efikas. Të dhënat e përpunuara për prurjen e ujërave sipërfaqësore janë të domosdoshme për katër arsye:

- Përcaktimi i regjimeve aktuale të prurjes vjetore dhe disponueshmëria e burimeve ujore, në mënyrë që burimet vendore, rajonale dhe kombëtare të mund të përcaktohen me saktësi për qëllimet e shpërndarjes së burimeve ujore, përmes mekanizmit të bilanceve të ujit.
- Përcaktimi i tendencave të reshjeve dheprurjet në dalje të basenit për të vlerësuar ndikimet e ndryshimeve klimatike.
- Përcaktimi i regjimeve të rrjedhës në përgjithësi dhe prurjeve ekologjike në veçanti, në mënyrë që aspektet ekologjike të statusit të trupit ujor të mund të përcaktohen me saktësi.
- Përcaktimi i volumeve të sakta të prurjes, në mënyrë që ngarkesat e ndotësve në ujërat pritëse (dhe për rrjedhojë masat e nevojshme korrigjuese) të mund të llogariten me besueshmëri.

Është më se e dukshme se pa një rrjet efikas dhe funksional hidrometrik, shumica e objektivave për basenin ujor në kuadër të strategjisë së përgjithshme të MIBU-së nuk do të arrihen .

8.2.3 Statusi i Rrjetit të Monitorimit të Sasisë së Ujërave Sipërfaqësore

Vendi ka pasur historikisht (1960-1992) një rrjet efikas dhe të besueshëm kombëtar hidrometrik. Megjithatë, ky plan mund të realizohet vetëm nëse ka të dhëna historike për prurjet nga viti 2008 e në vijim. Mungesa e të dhënave të besueshme të kohëve të fundit për prurjet ngre shumë pikëpyetje lidhur me saktësinë dhe integritetin e strategjisë MIBU të parashikuar në këto raporte dhe strategji, por edhe në të tjera. Përdorimi i të dhënave të vjetra për prurjet, të cilat nuk është se marrin parasysh ndryshimet e shumta që ka pësuar baseni, e jo më ndryshimet e mundshme klimatike, shihen me skepticizëm të madh.

8.3 Programi i Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore

8.3.1 Autoriteti Kompetent

Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore (lumenj, liqene, ujëra të përkohshme dhe bregdetare) në basenin ujor të Ishmit dhe programet përkatëse të kampionimit janë nën administrimin e AKM-së pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit[136]. AKM-ja Publikon çdo vit Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, i cili përcakton pikat dhe parametrat e shënjestruara të monitorimit[137].

8.3.2 Rëndësia e Rrjetit të Monitorimit Mbikëqyrës të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore

Idealja do të ishte që rrjeti i monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore të ngrihet në përputhje me kërkesat e nenit 8 dhe shtojcës V, 1.3 të DKU-së. Rrjeti i monitorimit duhet projektuar në mënyrë të tillë që të ofrojë një tablo sa më koherente dhe gjithëpërfshirëse të statusit ekologjik dhe kimik brenda çdo baseni ujor dhe duhet të lejojë klasifikimin e trupave ujorë në pesë klasa, në përputhje me përkufizimet normative të statusit ekologjik për ujërat sipërfaqësore. Rrjeti aktual i monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore i administruar nga AKM-ja paraqitet në Harta 8-1.

---

[135] Për krijimin e platformës institucionale dhe rregullatore për qeverisjen dhe funksionimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore Banka Botërore/SIDA – Maj 2020

[136] Qeveria Shqiptare, VKM Nr. 1189 "Për rregullat dhe procedurat e zbatimit të Programit Kombëtar të Monitorimit", 2009

[137] Agjencia Kombëtare e Mjedisithttp://www.akm.gov.al/cil%c3%absia-e-mjedisit.html#raporte_puBUikime

8.3.3 Statusi i Rrjetit të Monitorimit Mbikëqyrës të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore dhe të Dhënat

Aktualisht, për shkak të burimeve dhe kapaciteteve të kufizuara, Elementet e Cilësisë Biologjike (ECB) nuk kampionohen apo analizohen në mënyrë të vazhdueshme në vend. Laboratori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit punon në përputhje me ISO 17025:2017 dhe është i akreditуar për parametrat kryesore fiziko-kimike: pH, përçueshmëria, alkaliniteti, mbetjet e ngurta pezull, kërkesa për oksigjen kimik, kërkesa për oksigjen biokimik, nitrite, nitrate, amonium, ortofosfor dhe fosfor total.

Aktualisht, substancat prioritare (ato që paraqesin risk të konsiderueshëëm për mjedisin ujor) [138] nuk monitorohen në mënyrë rutinë. Ndotësit specifikë për basenin ujor (NSBU) (ata ndotës që konsiderohen nga autoriteti kompetent si me rëndësi të veçantë për basenin ujor) nuk janë përcaktuar ende. Numri i pikave të monitorimit ndryshon çdo vit në varësi të kufizimeve buxhetore. Monitorimet rutinë të ujërave sipërfaqësore kanë vënë në dispozicion të dhëna rreth cilësisë së ujit për shtatë pika monitorimi në lumenj brenda basenit të lumit Ishëm. Rrjeti aktual i monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore i administruar nga AKM-ja paraqitet në Tabelën 8-1. Rezultatet e përzgjedhura nga rrjeti i monitorimit paraqiten për parametrat BOD_5, Total P dhe NH4 në Shtojcën Teknike IX. Këto tre parametra shërbejnë si tregues të përgjithshëm mjaft të mirë për ndotjen nga burimet antropogjene që mund të dëmtojnë sistemet ujore. Të dhënat e plota fiziko-kimike nga programet e monitorimit të AKM-së për periudhën 2014 – 2019 paraqiten në Shtojcën Teknike IX.

Tabela 8-1 – Stacionet e monitorimi të Cilësisë së Ujit në basenin e lumit Ishëm

Emri i Stacionit	Kodi i Stacionit -	Lumi -	Latituda WGS84-	Longlituda WGS84-	Lartesia mmnd	MAF (Q m^3/S)	Frekuenca e matjes [139]	Parametrat e monitoruar					
								ECBs (QE1)	Hidromorf (QE2)	Prurja (QE2-1)	Fiz-Kim (QE3-1)	St. prioritare (Aneksi X)	RBSPs (QE3-3)
TIRANA, URA BRARIT	AL_RV_041	Tirana	41.379000	19.859000	150	?	2 to 4				√		
TIRANA, URA k. KAMES	AL_RV_043	Tirana	41.355000	19.772000	70	*n/a*	2 to 4				√		
LANA, LANABREGAS	AL_RV_044	Lana	41.330000	19.880000		*n/a*	2 to 4				√		
2 to 4 LANA, YRSHEK	AL_RV_046	Lana	41.337993	19.776542		*n/a*	2 to 4				√		
ISHEM,URA RINAS	AL_RV_047	Ishem	41.436011	19.696884		*n/a*	2 to 4				√		
ISHEM, URA GJOLES	AL_RV_048	Ishem	41.466990	19.691910		?	2 to 4				√		
ISHEM, URA SALMER	AL_RV_049	Ishem	41.541177	19.610505	4	?	2 to 4				√		

[138] Komisioni Evropian - Direktiva 2013/39/BE që ndryshon Direktivën 2000/60/KE dhe 2008/105/KE lidhur me substancat prioritare në fushën e politikës së ujit

[139] Frekuencat e kampionimit të realizuara përgjatë periudhës 2014-2019, në vit


8.3.4 Fushata e Monitorimit gjatë 2019-s

Nga tabela 8-1 del mjaft qartë se numri i stacioneve në programin kombëtar aktual të monitorimit nuk është shumë i madh dhe nuk përfaqëson shumicën e trupave ujorë të përvijuar në basenet ujore. Kështu, programi aktual i AKM-së nuk i përmbush kërkesat e përputhshmërisë me Shtojcën V 1.3 të DKU-së. Për të bërë një vlerësim sa më të mirë të mundshëm të statusit të trupit ujor, në shtator të 2019-s u realizua një "fushatë monitorimi" më gjithëpërfshirëse në basenin e Ishmit. Fushata e korrikut të 2019-s përfshiu 28 pika përgjatë baseneve të Ishmit, ku u analizuan 11 parametra fiziko-kimike. Analizat e detajuara paraqiten në Shtojcën Teknike IX. Fushata gjithëpërfshirëse mundësoi një vlerësim sasior të statusit të mundshëm të të gjithë trupave ujorë në basenet ujore. Harta 8-2 përmbledh këto pika, ku paraqiten vlerat për dy treguesit më të rëndësishëm fiziko-kimikë të ndotjes antropogjene dhe ndikimit të mundshëm në ECB-ve, BOD_5 dhe NH_4 (mg/l). Grupet e plota të të dhënave paraqiten në Shtojcën Teknike IX. Nivelet BOD5> 15.0 mg/l (tregojnë statusin e keq ekologjik të çdo trupi ujor) u vërejtën në 9 nga 28 pika të kampionuara, kryesisht në rrjedhat e poshtme të urbanizuara të lumit të Lanës, Tiranës, Ishmit dhe Tërkuzës. Nivelet NH4> 8.0 mg/l (tregojnë statusin e keq ekologjik të çdo trupi ujor) u vërejtën në 9 nga 28 pika të kampionuara, kryesisht në rrjedhat e poshtme të urbanizuara të lumit të Lanës, Tiranës, Ishmit dhe Tërkuzës. Të dhënat e plota fiziko-kimike nga fushata e monitorimit paraqiten në Shtojcën Teknike IX.

8.3.5 Fushatat biologjike në terren gjatë 2021-shit

Sikurse u përmend edhe më lart, ujërat sipërfaqësore në Shqipëri nuk u nënshtrohen monitorimeve rutinë për elementet e cilësisë hidrobiologjike. Projekti EUSIWM organizoi gjatë periudhës prill-korrik 2021 fushata në terren të cilat synonin trupat ujorë sipërfaqësorë të përvijuar në basenin e lumit Ishëm. Për kategorinë e trupave ujorë lumorë u përzgjodh fauna bentike jovertebrore (prill 2021), ndërsa për trupat ujorë liqenorë (qershor/korrik 2021) u përzgjodh fitoplanktoni. Krahas kësaj, janë kryer analiza edhe për parametrat fiziko-kimike. Rezultatet dhe gjetjet e detajuara gjenden në Shtojcën teknike IX. Aktualisht, Shqipëria nuk ka asnjë metodë për vlerësimin e statusit biologjik në përputhje me kërkesat e DKU-së. Megjithatë, është përdorur në mënyrë provizore indeksi ASPT (Pikët Mesatare për Takson). Indeksi ASPT mbështetet te indeksi BMWP (Procedura e Punës për Monitorimin Biologjik)[140]. Rezultatet e vlerësimit të statusit duke përdorur indeksin ASPT paraqiten në Figura 8-1 dhe në Shotjcën Teknike V lidhur me Hidrobiologjinë. Ky vlerësim është një tregues i pakët, sepse mbështetet te një matje e vetme dhe nuk i përmbush ende kërkesat e përgjithshme të DKU-së për vlerësimin e statusit ekologjik.

Figura 8-1 - Vlerësimi paraprak i statusit ekologjik të lumenjve



[140] Armitage PD, D Moss, JF Wright & MT Furse (1982). Performanca e sistemit të ri të pikëzimit të cilësisë biologjike të ujërave duke përdorur jovertebrorët e mëdhenj në një seri pikash monitorimi të ndotjes në ujëra të rrjedhshme. Burimet Ujore Vëll. 17, nr. 3, f: 333-347.

8.3.6 Vlerësimet hidromorfologjike

Sipas DKU-së, elementet e cilësisë hidromorfologjike konsiderohen si elemente që mbështesin elementet e cilësisë biologjike. Kjo do të thotë se elementet e cilësisë hidrobiologjike mund të preken jo vetëm nga cilësia e ujit, por edhe nga kushtet hidrologjike dhe/ose morfologjike. Teksa flasim, Shqipëria nuk ka dispozita që të parashikojnë vlerësimin e statusit hidromorfologjik. Shkaku kryesor i gjendjes së dobët të monitorimit hidrologjik dhe i mungesës së monitorimeve sistematike të elementeve të cilësisë morfologjike. Megjithatë, është bërë një lloj përpjekjeje paraprake për vlerësimin e statusit hidromorfologjik të trupave ujorë sipërfaqësorë të përvijuar në basenin e lumit Ishëm. Detajet rreth qasjes dhe metodologjisë gjenden në Shtojcën Teknike VI.

8.4 Programi i Monitorimit të Ujërave Nëntokësore

8.4.1 Autoriteti Kompetent

Rrjeti i plotë i monitorimit të ujërave nëntokësore (i cili ndryshon çdo vit) paraqitet në Shtojcën Teknike VII[141].

8.4.2 Rëndësia e Rrjetit të Monitorimit të Sasisë së Ujërave Nëntokësore

Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ujërave nëntokësore duhet të ngrihet në përputhje me kërkesat e nenit 8 dhe Shtojcës V, 2.2 dhe 2.3 të DKU-së. Rrjeti i monitorimit duhet projektuar në mënyrë të tillë që të ofrojë një tablo koherente dhe të përgjithshme të statusit kimik dhe sasior për çdo trup ujor individual. Matja parësore e statusit sasior ka të bëjë me thellësinë ose lartësinë e nivelit të ujërave nëntokësore te puset e ndërtuara për qëllime monitorimi. Kjo gjen zbatim të plotë tek akuiferët aluvialë dhe ranoro-konglomerate (Llojet 1, 2 dhe 5). Megjithatë, te akuiferët me masivë gëlqerorë tepër karstikë (akuiferë të llojit 4), ku ka pak pompim nga puset e shpuara, rrjedhat e burimeve shihen si tregues më i mirë i statusit sasior (dhe cilësor).

8.4.3 Statusi i Rrjetit të Monitorimit të Sasisë së Ujërave Nëntokësore dhe të Dhënat

Monitorimi i sasisë së ujërave nëntokësore ka të bëjë vetëm me matjen e thellësisë së ujit dhe nga pikëpamja hapësinore dhe kohore është e paplotë. Nivelet janë matur te pikat e përzgjedhura të nxjerrjes në trupa aluvialë të ujërave nëntokësore GW35140101 (Thumanë) dhe GW35140103 (Tiranë) gjatë periudhës 2015 - 2019:

- Shp. 16/97 Rruga e Kavajës,
- Laknas (puset 32/87, 33/87 dhe 33 Laknas)
- 416 Bilaj Fushë Krujë.

Raportet e ShGjSh-së japin shumë pak të dhëna për numrin e madh të puseve gjatë viteve 2000 (matje të vetme) dhe për vitin 2004 (katër matje), ku përfshihen pesë puset e renditura më lart.

Rezultatet e përzgjedhura nga rrjeti i monitorimit paraqiten për parametrat e nivelit të ujit tek Shtojca Teknike IX. Monitorimi i nivelit është i nevojshëm për të arritur objektivin e ruajtjes së balancës së qëndrueshme të ujërave nëntokësore. Ulja e nivelit të ujërave nëntokësore për një periudhë të gjatë kohore (mbi 5 vjet) tregon mbishfrytëzim, që duhet vendosur nën kontroll. Të dhënat në dispozicion tregojnë se ka një rënie të ndjeshme të nivelit të ujit midis periudhës së monitorimit të 2004-s dhe të pas 2004-s. Megjithatë, nuk ka tendenca të qarta për sa i përket niveleve, që të mund të konfirmohen ose refuzohen gjatë periudhës 2015-2019. Nuk ka të dhëna të disponueshme për nivelin e ujit të trupat ujore nëntokësore në basenin e lumit Ishëm. Ka matje të posaçme të rrjedhave të burimeve, duke iu referuar edhe luhatjeve sezonale, por nuk ka grupe të dhënash sistematike për shkarkimet të ndara sipas periudhave. Të dhënat e disponueshme në Shtojcën Teknike IX për ujërat nëntokësore.

8.4.4 Statusi i Rrjetit të Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Nëntokësore dhe të Dhënat

DKU-ja dhe DUN-i kërkojnë monitorim në shkallë të gjerë të parametrave kimike për të përcaktuar statusin cilësor të ujërave nëntokësore. Aktualisht, matet në mënyrë rutinë vetëm një pjesë e parametrave të kërkuara: anionet (Cl, SO_4, NO_3 dhe alkaliniteti), kationet (Na, K, Ca, Mg, Fe dhe NH_4) dhe parametrat treguese (pH, T, EC

[141]Vendndodhja dhe statusi preciz i shumë pikave të monitorimit të ujërave nëntokësore nuk do të ishin identifikuar në mungesë të komunikimit intensiv me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.

dhe TDS). Për më tepër, vërehet monitorim në nivele të ulëta për metalet e rënda si Cu, Cr, Pb, Ni, Mn, Zn, Co dhe Cd, për të cilat nuk ka dokumentacion të disponueshëm për sa i përket kampionimit, protokolleve analitike dhe kontrollit të cilësisë.

Monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësore u realizua nëpërmjet shpimeve të puseve në dy trupa aluvialë ujorë nëntokësorë (GW35140101 dhe GW35140103). Në këto puse ndodh përzierja midis ujërave nga një sipërfaqe e madhe dhe nga thellësi të ndryshme, ndaj janë kaq efikasë në identifikimin e pranisë së kontaminantëve, por jo dhe aq kur vjen puna te zbulimi i burimit ose i përqendrimeve në zonën burimore. Burimet e mëdha përdoren për qëllime të ngjashme në akuiferët karstikë.

Raportet për Gjendjen e Mjedisit që prej vitit 2012 parashikojnë matje të rregullta, deri në katër herë në vit, të joneve kryesore dhe metaleve të rënda. Të dhënat vijnë nga analizat laboratorike të kampionëve të ujit të marrë nga ShGjSh-ja nga 13 - 15 puse shpime, përfshi shumicën e puseve që janë përdorur për monitorimin e nivelit të ujit. Nuk ka monitorim rutinë të cilësisë së ujërave nëntokësore në puse ose burime.

Tabela 8-2 - Puset nxjerrëse të përdorura për monitorimin e nivelit të ujit.

Nr.	Puset	Vendndodhja
1	1P Selitë. Tirana:	Pusi nr. 1. Unaza Re - Buka. Yzberisht - Tiranë
2	2P Selitë. Tiranë Nr.13. Kombinat. Tirana:	Nr.160. Thumanë Fushë - Krujë
3	Nr.2/97 Rinas. Tirana: Nr.3/97 Valias - Rinas. Tirana:	Shpimi nr. 1N Gramez. Fushë - Krujë
4	Nr.327. Fushë - Krujë	Shpimi nr. 30B Laknas. (Shinat e Trenit)
5	Nr.47. Bërxull. Tirana: Nr.59. Ura Gjolës	Shpimi nr.6 Laknas. Tirana: Shpimi nr.16/97 Rr. Kavajës. Tirana:

Rezultatet e përzgjedhura nga rrjeti i monitorimit për parametrin e nitrateve (NO3 mg/l) dhe përcjellshmërinë elektrike (PE µS/cm) gjenden në Shtojcën Teknike IX. Monitorimi i NO_3 ka zbuluar tendenca negative për një prej ndotësve kryesorë për shkak të burimeve të lëndëve ushqyese, të cilat mund të jenë të rrezikshme për shëndetin (SCM< 50 mg/l), ose mund të jenë shkak për eutrofikimin e ujërave sipërfaqësore. Në zonat bregdetare, vlera e lartë e PE-së (p.sh. > 1500 µS/cm) në ujëra të thella nëntokësore (> 30m) mund të tregojë intruzion të kripësisë në ujërat nëntokësore. Të dhënat e plota fiziko-kimike nga programet e monitorimit të ujërave nëntokësore për periudhën 2014 – 2019 paraqiten në Shtojcën Teknike IX.

8.4.5 Fushata e Monitorimit gjatë 2019-s

Nga Harta 8-3 del mjaft qartë se numri i stacioneve në programin kombëtar aktual hidrogjeologjik të monitorimit nuk është shumë i madh dhe nuk përfaqëson shumicën e trupave ujorë nëntokësorë të përvijuar në basenet ujore. Kështu, programi aktual i ShGjSh-së nuk i përmbush kërkesat e përputhshmërisë së Shtojcës V 2.2 dhe 2.4 të DKU-së. Për të bërë një vlerësim sa më të mirë të statusit të mundshëm të trupit ujor, në nëntor të 2019-s u realizua një fushatë monitorimi më gjithëpërfshirëse në basenin e Ishmit. Në 9 trupa ujorë nëntokësorë përgjatë baseneve të Ishmit, ku u analizuan 11 parametra fiziko-kimike. Analizat e detajuara paraqiten në Shtojcën Teknike IX, së bashku me hartëzimin e dy vlerave më të rëndësishme fiziko-kimike të ndotjes antropogjene dhe ndikimit të mundshëm të statusit kimik të ujërave nëntokësore, përcjellshmërisë elektrike (µS/cm) dhe NO3 (mg/l).

8.5 Programet e Monitorimit të Zonave të Mbrojtura

8.5.1 Autoritetet Kompetente

Neni 6 dhe Shtojca IV e DKU-së përmbledhin disa lloje të zonave të mbrojtura për t'u trajtuar në PMBU. Këto janë:

- Zonat e shpallura të ujit të pijshëm për konsum nga njeriu.
- Zonat e përvijuara për mbrojtjen e specieve ujore me rëndësi ekonomike.
- Zonat e shpallura si ujëra Rekreative, përfshi edhe ujërat e larjes sipas Direktivës së BE-së 2006/7/KE.
- Zonat e shpallura si 'të ndjeshme ndaj lëndëve ushqyese' sipas Direktivave të BE-së 91/676/KEE dhe 91/271/KEE.
- Zonat e shpallura si zona të rëndësishme për habitatin, zonat e veçanta të konservimit (ZVK) dhe zonat e Natura 2000[142].

Për këtë arsye, nevojitet koordinim midis disa autoriteteve kompetente, më konkretisht:

- Përcaktimi i nxjerrjes së ujit është pjesë e sistemit të lejeve të AMBU-së. Operatorët e mëdhenj si shoqëritë UK në nivel bashkie kanë detyrimin ligjor të respektojnë kufizimet e Lejes së Ujit;
- Shoqëritë UK nuk i raportojnë drejtpërdrejt AMBU-së lidhur me sasinë e nxjerrë, por i raportojnë çdo vit autoritetit kompetent, Entit Rregullator të Ujit (ERrU), si pjesë e përputhshmërisë vjetore me nivelet e shërbimit.
- Shoqëritë UK kanë programet e veta rutinë të monitorimit fiziko-kimik për burimet përkatëse dhe pikate (të përzgjedhura) të nxjerrjes;
- Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetsor (NjVKSh) kryejnë kampionimin rutinë fiziko-kimik dhe patogjen të të gjitha pikave të nxjerrjes së uji të pijshëm (faza pas trajtimit) në Shqipëri për qëllime të shëndetit publik. Duke qenë se këto të dhëna kampionimi konsiderohen si pjesë e rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm, ky program nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektivat mjedisore të basenit ujor. [143].
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) synon të ndalë humbjen e biodiversitetit në Shqipëri përmes menaxhimit të përmirësuar të zonave të mbrojtura dhe hedhjes së bazave për zbatimin e rrjetit Europian Natura 2000.

Duhet vërejtur se zonat e mbrojtura në Shtojcën IV të DKU-së ndodhen brenda trupave ujorë; Rezervuari i Bovillës për shembull është edhe trup ujor, edhe burim për nxjerrjen e ujit të pijshëm. Andaj, gjejnë zbatim objektivat mjedisore dhe kërkesat e monitorimit të DKU-së. Supozohet se trupat ujorë me "status të mirë" i mbështesin kushtet e përgjithshme për sa i përket zonave të mbrojtura. Megjithatë, Direktivat përkatëse parashikojnë kërkesa shtesë për monitorimin dhe vlerësimin. Për shembull, patogjenët (bakteriet, viruset, protozoanët, kërpudhat) nuk janë pjesë e përkufizimeve të statusit ujor të DKU-së, por janë të rëndësishëm për cilësinë e ujërave të larjes dhe ujit të pijshëm. Për më tepër, zonat e mbrojtura kanë pikat dhe shpeshtësinë e vet të monitorimit, përveç atyre që priten në kuadër të DKU-së.

8.5.2 Monitorimi Kombëtar dhe Raportimi pranë Komisionit Evropian

Çdo katër vjet, Shteteve Anëtare u kërkohet ti raportojnë Komisionit Evropian për:

- Përqendrimin e nitrateve në ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore.
- Nivelet e eutrofikimit të ujërave sipërfaqësore.
- Vlerësimin e ndikimit të programeve të veprimit në cilësinë e ujit dhe praktikat bujqësore.

---

[142] Komisioni Evropian – Natura 2000 - https://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/index_en.htm

[143] VKM nr.797, datë 29.09.2010 për miratimi e rregullores higjeno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes".

- Rishikimin e ZNLU-ve dhe programeve të veprimit.
- Përllogaritjen e tendencave të ardhshme të cilësisë së ujit.

Krahas Zvicrës, Shqipëria është i vetmi Shtet Joanëtar i BE-së që raporton çdo vit për cilësinë e ujërave të larjes pranë Agjencisë Evropiane e Mjedisit[144]. AKM-ja ia raporton Agjencisë Evropiane të Mjedisit rezultatet e programeve të monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore nëpërmjet 'WISE EIONET' (Sistemit të Informacionit për Ujërat në Evropë, Rrjetit Evropian të Informacionit dhe Vrojtimit të Mjedisit)[145].

8.5.3 Statusi Operacional i Rrjeteve të Monitorimit të Zonave të Mbrojtura në Ishëm

Zonat e mbrojtura përbëjnë teksa flasim rreth 21.4% të territorit të Shqipërisë. Në rastin e basenit të lumit Ishëm, është AdZM Tiranë për Parkun Kombëtar të "Malit të Dajtit" dhe AdZM Durrës për Parkun Natyror të "Qafë Shtamës" dhe Peizazhin e Mbrojtur të "Krastë-Verjon".

Për Parkun Kombëtar "Mali i Dajtit" dhe Parkun Natyror "Qafështamë" janë hartuar dy draft plane menaxhimi, por ende nuk janë miratuar. Draft Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të "Malit të Dajtit" është në fazë të avancuar pasi konsultimet me palët e interesit kanë përfunduar dhe pritet shumë shpejt miratimi i tij. Për sa i përket Peizazhit të Mbrojtur të "Krastë-Verjon", ende nuk është hartuar Plani i Menaxhimit. Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura në rang qarku është një tjetër institucion qendror që përfshihet në menaxhimin e çdo zone të mbrojtur.

Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit për çdo vit, por në rastin konkret për vitin 2021, përcakton në kapitullin "Biodiversiteti" këto tregues mjedisorë të situatës:

- diversiteti i ekosistemeve dhe habitateve në zonat e mbrojtura - përpunimi statistikor, lista e llojeve dhe habitateve;
- afërsia e infrastrukturës së transportit me zonat e mbrojtura.

Fauna e egër në zonat e mbrojtura mjedisore përshkruhet në kapitullin "KONSERVIMI I NATYRËS" (shihni informacionin dhe tabelat 8-4, 8-5, 8-6 dhe 8-7 në Shtojcën Teknike IX).


[144] Krahasoni, për shembull: Cilësia e ujërave të larjes në Shqipëri për 2019-n https://www.eea.europa.eu/themes/water/europes-seas-and-coasts/assessments/state-of-bathing-water/country-reports-2019-bathing-season/al-bw-country-reports-2020.pdf

[145] Vizitoni për shembuj: https://cdr.eionet.europa.eu/al/eea/wise_soe/wise6/envx_ilxq

Harta 8-1 – Vendndodhja e Pikave të Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore të AKM-së



Harta 8-2 – Vendndodhja e Pikave të Monitorimit të Cilësisë dhe Sasisë së Ujërave Nëntokësore të ShGjSh-së



9 Përmbledhja e Strategjive dhe Planeve Plotësuese

9.1 Vështrim i përgjithshëm

9.1.1 Shqipëri

Qëllimi i Strategjive, Dokumenteve të Politikës dhe Planeve është të trajtojnë sfidat që hasen në sektorin e ujit, si dhe të garantojnë menaxhimin dhe qeverisjen efikase të burimeve ujore.
Strategjitë, Dokumentet e Politikave dhe Planet kryesore në sektorin e ujit janë:

- **Axhenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm**, e cila parashtron 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) në formën e thirrjes urgjente për veprim nga të gjitha vendet, me qëllim arritjen e tyre deri në vitin 2030. Axhenda 2030 e OZhQ-ve është miratuar në 2015-n.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZhI) 2015-2020 është një prej dokumenteve strategjike kryesore që ndërthur axhendën e integrimit në BE me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit. Shtylla 4 e kësaj strategjie parashikon rritje nëpërmjet ndërlidhjes, përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit territorial përmes:

- mjedisit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm;
- përmirësimit të sistemeve të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe menaxhimit të mbetjeve;
- shtrirjes së planeve të trajtimit të ujërave të ndotura në të gjithë vendin në dobi të popullsisë;
- menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve ujore.

- **Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027** është strategjia kryesore dhe shërben si bazë për reformimin e sektorit të ujërave. Kjo strategji u mundëson institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore të arrijnë standardet evropiane duke përcaktuar objektivat kryesore për këtë sektor:

Për të arritur objektivin e katërt të SKMIBU-t 2018-2027 "*Sigurimi i modeleve dhe të dhënave të njohura gjerësisht, si të besueshme rreth ujit dhe klimës për të gjitha palët e interesit dhe hartimi i politikave në sektorin e ujit duke u bazuar mbi këto të dhëna dhe modele*", AMBU ka themeluar Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore që shërben si bazë të dhënash për burimet e gjeoreferuara në sistemin GIS. Të dhënat gjeohapsinore, që gjenerohen dhe administrohen nga AMBU-ja dhe institucionet e linjës, publikohen në gjeoportalin e KKBU-së dhe gjenden në link-un (http://kadastraujore.gov.al/).

- (Draft) **Programi Kombëtar Sektorial për Ujin 2018-2030** për menaxhimin e integruar të ujit synon të sigurojë nevojat bazike, konkurencën e përdorimit dhe reduktimin e risqeve të ujit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë qëndrueshmërisë së ekosistemeve ujore. Vizioni i këtij programi është qeverisja e sektorit të ujit në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane, duke pasur si qëllim kryesor promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore, mbrojtjen e tyre dhe mbrojtjen nga uji.

- **Strategjia Kombëtare për Ujitjen dhe Kullimin 2019-2031** ka përcaktuar katër komponentë strategjikë:
    - Komponenti strategjik 1 "Ujitja",
    - Komponenti strategjik 2 "Kullimi",
    - Komponenti strategjik 3 "Siguria e digave dhe përdorimi i tyre",
    - Komponenti strategjik 4 "Mbrojtja nga përmbytjet",
- **Politikat Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit në Shqipëri**

Objektivi kryesor është të kontribuojë në nivel kombëtar në parandalimin e humbjeve të biodiversitetit dhe degradimit të shërbimeve të ekosistemit nëpërmjet zbatimit të plotë të kuadrit ligjor të Shqipërisë dhe BE-së, në reduktimin e presioneve ndaj biodiversitetit, në restaurimin e ekosistemeve në mënyrë të drejtë dhe të

barabartë nga pikëpamja biologjike, në transferimin e teknologjive përkatëse, në kanalizimin e çështjeve dhe vlerave të biodiversitetit, si dhe në zbatimin efikas të politikave të përshtatshme.

- (Draft) **Strategjia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve**

Qëllimi është të përmirësohet cilësia e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve që i ofrohet qytetarëve shqiptarë dhe të mbështetet zhvillimi ekonomik i vendit, bazuar te ofrimi i një shërbimi me infrastrukturë kyç.

- **Plani Kombëtar i Emergjencave Civile (2004)** ka si qëllim:
    - Të parandalojë, lehtësojë dhe rehabilitojë çdo dëmtim që mund të shkaktohet nga emergjencat civile dhe që mund të prekë popullsinë, kafshët, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin;
    - T'i ofrojë kushtet shtetit dhe institucioneve publike e private, veprimtarive ekonomike dhe popullsisë që t'i përballojnë situatat e emergjencës me sa më pak humbje.
    - Të garantojë përdorimin e të gjitha burimeve të mundshme shtetërore për të mundësuar sigurinë publike, qëndrueshmërinë e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, identifikimin e zonës së emergjencës dhe zbutjen e pasojave.

- **Plani i Integruar Ndërsektorial për Zonën Tiranë-Durrës (PINS)**

PINS-i për zonën ekonomike Tiranë-Durrës është hartuar në përgjigje të zhvillimit territorial dhe socio-ekonomik gjatë 25 viteve të fundit dhe shërben si udhërrëfyes për zhvillimin ekonomik, social e mjedisor të rajonit, duke promovuar ekonominë dhe përmirësuar mjedisin. PINS-i për zonën Tiranë-Durrës synon që zhvillimin e territorit ta realizojë duke pasur një vizion që të shërbejë si emërues i përbashkët për njësitë e qeverisjes vendore (NjQV). Plani do të shërbejë si udhërrëfyes për NjQV-të, në mënyrë që ato të koordinohen për politikat, projektet dhe planet e tyre vendore, si dhe të angazhohen në koordinim dhe bashkëpunim. Plani u shërben si garanci investitorëve të huaj dhe bizneseve që po planifikojnë të përfshihen më tej në zhvillimin e metropolit Tiranë-Durrës.

- **Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin**

Plani i Integruar Ndërsektorial (PINS) për Bregdetin shërben si sistem rregullator për të siguruar standardet lidhur me planifikimin dhe garantimin e instrumenteve që mundësojnë shërbime cilësorë turistike. Objektivat dhe parimet janë të sigurohet përdorimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i zonave bregdetare për të konservuar habitatet bregdetare natyrore, peizazhet, burimet natyrore dhe ekosistemet, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe normat ligjore në fuqi.

- **Planet e Përgjithshme Vendore**

Procesi i përgatitjes së planeve të përgjithshme vendore për të gjitha bashkitë në vend ka nisur që prej vitit 2017, ku bashkitë pjesë e basenit të lumit Ishëm ishin të parat. Bashkitë e Tiranës, Kamzës, Vorës dhe Krujës kanë PPV, ndërsa PPV-ja e bashkisë Durrës është në proces finalizimi.

9.1.2 Bashkimi Evropian

Planet e menaxhimit të basenit ujor mund të plotësohen më tej nga hartimi i programeve dhe planeve më të detajuara të menaxhimit për nënbasenin, sektorin, çështjen ose llojin e burimit ujor, për të trajtuar aspekte të veçanta të menaxhimit të burimeve ujore. Zbatimi i këtyre masave nuk i përjashton Shtetet Anëtare nga detyrimet e tjera të DKU-së.

Në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, kuadri i PMBU-së për Shqipërinë parashikon strategji dhe/ose plane plotësuese shtesë të koordinuara me dokumentin bërthamë të PMBU-së (masat në 1.5.1.), por të ndryshme prej tij. Në disa raste, këto plane dytësore përmenden shprehimisht në Direktivën Kuadër të Ujit p.sh DP-ja ose në mënyrë të nënkuptuar në politikat e Komisionit Evropian për pamjaftueshmërinë e ujit dhe thatësirat[146].

Këto strategji ose plane (analiza thelbësore në vetvete) referohen në mënyrë të kryqëzuar në Planin Bërthamë të DKU-së (ky dokument) duke iu referuar vetëm mënyrës se si do të ndikojë strategjia përkatëse apo aktivitetet

[146]Komisioni Evropian, Direktiva Kuadër e Ujit– Neni 13(5)

ose skemat e propozuara në objektivat mjedisore të basenit ujor. Skemat që kanë ndikim tek objektivat mjedisore p.sh te statusi i trupave ujorë duhet ose (i) të zbatojnë masat e duhura zbutëse për ruajtjen e statusit ekologjik ose (ii) të tregojnë se objektivat në funksion të të cilave janë bërë modifikimet apo ndryshimet e trupit ujor nuk mund të arrihen me mjete të tjera, të cilat paraqesin në fakt një mundësi shumë më të mirë mjedisore, për shkak të realizueshmërisë teknike ose kostove disproporcionale[147].

9.1.3 Plani i Menaxhimit të Burimeve Ujore

Plani i Menaxhimit të Burimeve Ujore siguron pikësëpari që bilanci i ujit në basenin ujor (ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore) të përcaktohet si duhet dhe të menaxhohet në mënyrë të tillë që të sigurohet qëndrueshmëri afatgjatë. Kjo duhet të përfshijë regjistrat për nxjerrjet e ujit në nivel nënbaseni, kontrollet e menaxhimit dhe identifikimin e kërkesave dhe masave për mbrojtjen e prurjes ekologjike. Strategjia e Përbashkët e BE-së për Zbatimin e DKU-së (CIS) i ka cilësuar së fundmi këto elemente si aktivitete dytësore të rëndësishme[148, 149].

Tashmë është pranuar gjerësisht se regjimi i prurjes në të gjithë lumenjtë luan rol parësor në strukturën dhe funksionimin e 9 ekosistemeve ujore dhe është, deri diku, shumë më i rëndësishëm se "elementi dytësor" që referohet në DKU. Duke qenë se nxjerrja e ujit për përdorime ekonomike ka në përgjithësi ndikim të konsiderueshëm në regjimin e prurjes dhe në prurjet ekologjike, menaxhimi i burimeve ujore mund të konsiderohet si i lidhur ngushtësisht me masat e seksionit 1.5.1, ndaj "menaxhimi i burimeve ujore" duhet konsideruar si pjesë thelbësore e PMBU-së bazë. Nuk ka gjasa që një trup ujor ta arrijë "Statusin e Mirë" nëse regjimi i prurjes nuk menaxhohet në mënyrë të tillë që të jetë sa më afër regjimit të prurjes natyrore.

Megjithatë, qëndrueshmëria e burimeve ujore është një fushë mjaft e gjerë politikash për Komisionin Evropian dhe tematikë kryesore menaxhimi për pjesën më të madhe të baseneve ujore[150]. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore kërkon që fokusi të mos ngushtohet vetëm te nevojat e ekosistemit për ujë, por kërkon politika dhe mjete për efikasitetin e burimeve, si dhe një vlerësim dhe planifikim të ndërveprimeve me burime të tjera, veçanërisht me sigurinë ushqimore dhe energjetike. Masat për përforcimin e efikasitetit të burimeve ujore kanë ndikime të ndryshme, qoftë pozitive apo negative, edhe në sektorë të tjerë, veçanërisht në bujqësi dhe hidroenergjetikë për shembull[151].

9.1.4 Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet

Përmbytjet katastrofike vënë në rrezik jetën dhe sjellin humbje të mëdha ekonomike. Masat për lehtësimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet kanë kosto dhe nuk mund të zbatohen për të gjithë basenin. Krahas masave të përshtatjes të bazuara në ekosistem (norma e lejuara), nevojitet identifikimi i fushave prioritare për mbrojtjen nga përmbytjet dhe vlerësimi kosto-përfitim, për t'u siguruar se masat për mbrojtjen nga përmbytjet drejtohen nga një qasje e bazuar në risk.

Këto koncepte janë trajtuar në nivel europian, në Direktivën 2007/60/KE [152] dhe Programin e BE-së për Menaxhimin e Rrezikut nga Përmbytjet[153], ku identifikohen zonat në rrezik përmbytjeje dhe parashikohet hartimi në shkallë RBU-je ose baseni ujor, sipas rastit, i Planeve të Menaxhimi të Rrezikut nga Përmbytjet (PMRP), të cilat ndërthurin konceptet e parandalimit, mbrojtjes dhe gatishmërisë. Për një RBU të caktuar mund të kërkohen disa PMRP në varësi të risqeve për përmbytje lokale.

DP-ja kërkon shprehimisht që masat dhe ndikimet e çdo vepre mbrojtëse të propozuar të marrin plotësisht parasysh objektivat mjedisore të DKU-së të parashtruara në PMBU (DP, neni 7, neni 9). Kur objektivat mjedisore nuk përmbushen, atëherë mund të mos arrihet kërkesa kryesore e "Statusit të Mirë" të trupave ujorë të prekur

[147]Komisioni Evropian, Direktiva Kuadër e Ujit– Neni 4(7).

[148]Komisioni Evropian, Dokumenti Udhëzues 31, Prurja ekologjike në zbatimin e Direktivës Kuadër të Ujit, Raporti Teknik 2015-086, 2015

[149]Komisioni Evropian, Dokumenti Udhëzues 34, Për zbatimin e bilanceve të ujit për mbështetjen e zbatimit të DKU-së, Raporti Teknik 2015-090, 2015

[150]Agjencia Evropiane e Mjedisit, Ndryshimet klimatike dhe problematikat e përshtatjes së ujit, EEA, Raporti Teknik Nr. 2/2007, 2007

[151]Agjencia Evropiane e Mjedisit, Drejt përdorimit eficient të burimeve ujore në Evropë, EEA, Raporti Nr. 1/2012, 2012

[152]Komisioni Evropian, Direktiva 2007/60/KE për vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve nga përmbytjet, "Direktiva për Përmbytjet"

[153] https://ec.europa.eu/environment/water/flood_risk/flood_risk.htm

Nëse ndikimet mjedisore të veprave të propozuara për përmbytjet nuk trajtohen dhe zbuten siç duhet, atëherë trupat ujorë (zakonisht "trupat ujorë tepër të modifikuar") nuk do ta kalojnë dot testin e nenit 4(7) të DKU-së.

9.1.5 Plani i Menaxhimit të Risqeve nga Thatësirat

Për shkak të rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë dhe pakësimit të burimeve nga ndryshimet klimatike, pamjaftueshmëria e ujit dhe thatësirat po kthehen në fenomene mjaft të përhapura dhe të shpeshta në Bashkimin Evropian. Ç'ekuilibri afatgjatë për shkak të tejkalimit të potencialit të burimeve ujore nga kërkesa për ujë mund të sjellë pasoja katastrofike.

Politika e BE-së për ujin lidhur me pamjaftueshmërinë e ujit është hartuar për të parandaluar dhe zbutur situatat e mundshme të pamjaftueshmërisë së ujit dhe thatësirave, duke i dhënë prioritet kalimit në ekonomi nga pikëpamja efikase e ujit dhe e kursimit të tij[154,155]. Ka shumë rëndësi të theksojmë se kërkohet që politikat kombëtare të zbatimit të DKU-së të fokusohen më tej te çështjet e lidhura me sasinë.[156]

Në mungesë të një Direktive ose kuadri të posaçëm për menaxhimin e pamjaftueshmërisë së ujit[157], praktika më e mirë ndërkombëtare sugjeron që Planet e Menaxhimit të Riskut nga Thatësirat të përgatiten në shumë nivele, pra nëse është e mundur në nivel baseni ujor dhe sidomos në nivel nënbaseni dhe bashkie, ku ndikimi i thatësirave mund të jetë mjaft i madh për ekosistemet ujore ose furnizimin me ujë të pijshëm ose furnizmin me ujë në bujqësi.

9.1.6 Plani i Menaxhimit të Zonave Bregdetare

Sipas DKU-së, Planet e Menaxhimit të Basenit Ujor duhet të marrin parasysh shprehimisht trupat ujorë bregdetarë, duke vlerësuar presionet, gjendjen, ndikimin dhe objektivat mjedisore të përbashkëta me kategoritë e tjera të trupave ujorë. Megjithatë, rajonet bregdetare kanë problematika të konsiderueshme lidhur me menaxhimin që shkojnë përtej fokusit të ngushtë të seksionit 1.5.1. Për shembull, erozioni bregdetar, zhvillimi i infrastrukturës, turizmi dhe përmbytjet bregdetare për shkak të ndryshimeve klimatike janë problematika të konsiderueshme teknike që kanë shumë pak gjasa të mbulohen nga fokusi kryesor i PMBU-së së DKU-së.

Protokolli i MIZB -së (nënshkruar në vitin 2008 dhe hyrë në fuqi në vitin 2011) është një prej hallkave në fushën e menaxhimit të zonës bregdetare. Shqipëria ka qenë firmëtare e Konventës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut (Konventa e Barcelonës) që prej vitit 1990 dhe i ka pranuar ndryshimet e Konventës se vitit 1995 në 2001-shin.

Shqipëria aderoi në Konventën e Barcelonës për "Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut" në vitin 2000, nëpërmjet ligjit nr. 8690, datë 16/11/2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut dhe 6 protokolleve të saj shoqëruese". Në 2010-n, Shqipëria pranoi një tjetër Protokoll të Konventë së Barcelonës, miratuar me ligjin nr. 10 234, datë 18.2.2010 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin "Për Menaxhimin e Integruar të Zonës Bregdetare në Mesdhe" të Konventës së Barcelonës "Për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajoneve Bregdetar të Mesdheut".

Në këtë kontekst, në vitin 2014, Këshilli Kombëtar i Territorit miratoi nismën e hartimit të Planit të Integruar Ndërsektorial për bregdetin Shqiptar, i cili synon të përcaktojë mënyrat më të përshtatshme të zhvillimit të rajonit nëpërmjet përdorimit racional të territorit dhe burimeve e pasurive të tij, duke u fokusuar te kujdesi për ekosistemet. Objektivat kryesore të këtij plani janë:

- Zhvillimi i qëndrueshëm;
- Mbrojtja e kapaciteteve mjedisore dhe vlerave të peizazhit, duke ruajtur karakterin e lokaliteteve të vijës bregdetare;

[154]Komisioni Evropian, Trajtimi i sfidave të pamjaftueshmërisë së ujit dhe thatësirave, COM(2007)414,

[155]Komisioni Evropian, Udhërrëfyesi për Mbrojtjen e Burimeve Ujore të Evropës, COM(2012)673

[156]Komisioni Evropian, Raporti për Rishikimin e Politikës Evropiane të Pamjaftueshmërisë së Burimeve Ujore dhe Thatësirave, COM(2012)672,

[157]Partneriteti Global për Ujin, Udhëzimet për përgatitjen e Planeve të Menaxhimit të Thatësirave, Zhvillimi dhe zbatimi në kontekstin e Direktivës Kuadër të Ujit të BE-së, 2015.

- Shtimi i zonave të mbrojtura natyrore;
- Transformimi i bregdetit në destinacion unik;
- Shtrirja e kohëzgjatjes së sezonit turistik për zhvillimin e turizmit në mënyrë sa më të larmishme gjatë gjithë vitit;
- Shpërndarja e barabartë e investimeve dhe barazi sociale në të gjithë territorin.

9.2 Menaxhimi i Burimeve Ujore në Basenin ujor të Ishmit.

9.2.1 Autoriteti Kompetent dhe Masat e Koordinimit

Autoriteti kompetent për hartimin dhe zbatimin e strategjisë së burimeve ujore është AMBU. Regjistri i nxjerrjeve të ujit mbahet në nivel qendror nga AMBU në Tiranë dhe është i aksesueshëm nga publiku përmes Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore.

Gjatë këtij procesi, ka shumë rëndësi të ndërmerren aktivitete të detajuara konsultimi dhe koordinimi me përdoruesit e tjerë të ujit dhe rregullatorët përkatës, kryesisht në sektorët e bujqësisë dhe hidroenergjetikës.

Këshilli i Basenit Ujor (KBU) është organi përgjegjës për vendimmarrjen lidhur me burimet ujore në basenin përkatës. Baseni i lumit Ishëm është pjesë e KBU-së Ishëm, me 15 anëtarë. KBU-të lëshojnë autorizime dhe leje vetëm kur veprimtaria zhvillohet brenda kufijve të një baseni të vetëm.

AMBU, si institucioni që drejton menaxhimin e burimeve ujore në nivel kombëtar, koordinon dhe kontrollon punën e organeve vendore të menaxhimit të burimeve, si dhe harton e zbaton planet e menaxhimit të basenit ujor. Qëllimi është sigurimi i mbrojtjes së burimeve ujore nga ndotja dhe keqpërdorimi që cenon cilësinë dhe sasinë e tyre, zhvillimi dhe shpërndarja e drejtë e burimeve ujore. AMBU pranon dhe shqyrton aplikime për leje/autorizim për përdorimin e burimeve ujore, proces ky që aktualisht realizohet online në: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13279

Në nivel rajonal, baseni i lumit Ishëm menaxhohet nga ZABU Ishëm-Erzen-Mat (Tiranë). Kompetencat kryesore të ZABU-ve janë hartimi i draft planit për burimet ujore në basenin përkatës; dërgimi i këtij plani pranë Këshillit të Basenit Ujor për miratim; monitorimi i zbatimit të vendimit të KBU-së. Pra, ZABU-të shërbejnë si sekretariat teknik për çdo Këshill Baseni Ujor.

9.2.2 Strategjia e Burimeve Ujore

Sipas legjislacionit shqiptar dhe DKU-së, me qëllim menaxhimin e burimeve ujore në nivel kombëtar, është hartuar dhe po zbatohet Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (SKMIBU) për periudhën 2018-2027. Strategjia kombëtare përcakton pesë objektiva kyç.

Kapitulli i parë i strategjisë përcakton bilancin e ujit (1.2.1) për burimet ujore në nivel kombëtar dhe bilancin e ujit për prurjet mesatare vjetore në hyrje vetëm për muajt e verës, për të gjashtë basenet, me qëllim realizimin e vlerësimit rigoroz të burimeve ujore në kuadër të zbatimit të DKU-së, bazuar te "Dokumenti udhëzues për zbatimin e bilancit të ujit për qëllimet e zbatimit të DKU-së", që është edhe udhërrëfyesi zyrtar i Komisionit Evropian për bilancin ujor.

Për të ndërmarrë ndërhyrjet e përshtatshme strategjike, duhet të identifikojmë mirë të gjitha presionet e çdo baseni ujor. Me të përfunduar identifikimin, çdo presioni i duhet caktuar pesha specifike që do të lejojë të gjykojmë me saktësi nëse presionet kanë ndikim më të madh; në këtë rast, shihet me prioritet ndërhyrja për t'i minimizuar ose mbajtur nën kontroll.

Ndërhyrjet strategjike lidhur me çështjet e identifikuara në basenin e lumit Ishëm janë:

- *Monitorimi i vijave të ujit në basenin ujor që në burim, përgjatë të gjithë gjatësisë dhe lidhur me të gjitha përdorimet e tyre.*
- *Informacioni për bilancin e ujit në basenin ujor që duhet pasqyruar në KKBU.*
- *Shpallja dhe përcaktimi i zonave të mbrojtura për të ruajtur kushtet optimale për zonën ujëmbledhëse të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në basenin ujor .*
- *Zonimi dhe përcaktimi i kufijve për përdorimin e ujëmbledhësve/burimeve ujore në disa zona të caktuara të basenit ujor që i janë nënshtruar degradimit për shkak të mbipopullimit.*

- *Rritja e vetëmjaftueshmërisë rajonale.*
- *Rikuperimi i nivelit të ujërave nëntokësore dhe përmirësimi i cilësisë së tyre pas mbipërdorimit.*
- *Përcaktimi i kufijve për përdorimin e ndotësve të mundshëm të ujit që vijnë nga industria, zonat urbane, veprimtaritë minerare, fermat bujqësore dhe akuakultura.*
- *Ndërtimi dhe/ose mirëmbajtja e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane.*
- *Kontrolli i ndotjes së ujit, restaurimi i korridorit rrjedhës dhe rikuperimi i kapacitetit rural dhe urban të kullimit.*
- *Masat hidromorfologjike si përmirësimi i vazhdimësisë së ujit.*
- *Kontrolli dhe menaxhimi efikas dhe shkencor i përmbytjeve. Rritja e nivelit të përgatitjes rajonale për thatësirat dhe përmbytjet.*
- *Kontrolle të rrepta dhe përcaktimi i kushteve hapësinore për licensimin e veprimtarive që synojnë nxjerrjen e materialeve nga shtretërit e lumenjve dhe monitorimin e vazhdueshëm të subjekteve ekzistuese.*
- *Stabilizimi i shtretërve të lumenjve që u janë nënshtruar nxjerrjes së agregateve, ndryshimeve të ngarkesës sedimentare, ndryshimeve të brigjeve, përdorimit të tokës për grumbullim mbetjesh ose përdorime të tjera që cenojnë kushtet mjedisore natyrore.*
- *Kufizimi i përdorimit të ujërave Rekreative me qëllim shmangien e dëmeve të mundshme që mund të pësojnë burimet natyrore.*
- *Përfshija e variacioneve, pasigurive dhe riskut në procesin vendimmarrës.*
- *Promovimi i koordinimit dhe bashkëpunimit midis qeverisë dhe agjencive vendore, organizatave publike e private.*

9.2.3 Aktivitetet ose Skemat e Reja të Burimeve Ujore që Ndikojnë te Statusi i Trupit Ujor

Tabela 9-1 përmbledh ato trupa ujorë statusi i të cilëve mund të ndikohet nga skemat e burimeve ujore dhe për këtë shkak mund të rrezikojnë të mos i arrijnë objektivat mjedisore të parashtruara në Seksionin 8. Programi i Masave duhet të përfshijë edhe masat zbutëse ose arsyetimin e mosarritjes së statusit të mirë (Kapitulli 13).

Tabela 9-1 Trupat Ujorë Mund të Ndikohen nga Aktivitetet e Burimeve Ujore

TRUPI UJOR EMRI	NËNBASEN	TRUPI UJOR KODI I BE-SË	FORMA AKTUALE	STATUSI AKTUAL	NDIKIMI POTENCIAL
Tërkuza	ISH1	351443	TUTM	I Keq	Regjimi i prurjes i ndikuar nga rezervuari i Bovillës

9.3 Menaxhimi i Rrezikut nga Përmbytjet në Basenet e Ishmit.

9.3.1 Autoriteti Kompetent dhe Masat e Koordinimit

AMBU, në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Emergjencat Civile, harton projektligje që përcaktojnë planet dhe rregullat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, në përputhje me legjislacionin në fuqi për emergjencat civile dhe Planin Kombëtar për Emergjencat Civile. Për çdo basen ujor, AMBU:

- Përgatit vlerësimin paraprak të riskut nga përmbytja bazuar te informacioni i disponueshëm, si për shembull të dhëna dhe studime për zhvillimet afatgjata, veçanërisht për ndikimet e ndryshimeve klimatike në rast përmbytjesh;
- Përgatit hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe hartat e riskut nga përmbytjet, në shkallë të përshtatshme, për zonat e shpallura në rrezik nga përmbytjet;
- Përgatit Planet e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet (PMRP), të koordinuara në nivelin e basenit ujor, mbështetur te hartat e rrezikut të përmbytjeve dhe hartat e rrezikut nga përmbytjet.

Këto plane fokusohen te parandalimi, mbrojtja, gatishmëria, duke përfshirë edhe parashikimin e përmbytjeve dhe sistemeve të paralajmërimit të hershëm, që koordinohen nga organet përgjegjëse për emergjencat civile. AMBU kontribuon, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, në parandalimin e emergjencave civile. Këtu përfshihet zbatimi i koordinuar i politikave për menaxhimin e basenit ujor dhe menaxhimin e riskut nga

përmbytjet, në përputhje me legjislacionin në fuqi për emergjencat civile dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Emergjencave Civile.

MBZhR-ja përgatit dhe kryen investime për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe kullimin e stacioneve të pompimit bazuar te planet MRP.

Bashkitë janë përgjegjëse për mbrojtjen e zonave urbane nga risku nga përmbytjet, bazuar te plani MRP.

Agjencia për emergjencat civile përgatit dhe zbaton planet kombëtare për emergjencat civile, të cilat koordinohen me planet e menaxhimit për riskun nga përmbytjet.

9.3.2 Përmbledhja e historikut të përmbytjeve

Sipas DP-së së BE-së, analiza e vlerësimit paraprak të riskut nga përmbytjet përfshin hartat e rajoneve të basenit ujor dhe nënbaseneve, historikun e përmbytjeve dhe ngjarjeve të mëparshme, si dhe ndikimin negativ te popullsia, ekonomia, zhvillimi dhe trashëgimia kulturore. Përfshin edhe një përshkrim të ngjarjeve të pritshme në të ardhmen dhe efektet e tyre të mundshme.

Tabela 9-1 dhe Tabela 9-2[158] përmbledhin të dhënat rreth periudhës se kur kanë ndodhur këto ngjarje, në cilat bashki, numrin e personave të lënduar, numrin e banesave të dëmtuara, dëmet e shkaktuara (në lekë), tokat e përmbytura dhe dëmet ndaj bagëtisë dhe infrastrukturës.

Në zbatim të Direktivës, informacioni për përmbytjet e mëparshme jepet me qëllim identifikimin e zonave ku ka risk të mundshëm për përmbytje ose të zonave në basenin e lumit Ishëm me gjasa për t'u përmbytur.

Tabela 9-1 - Të dhënat e përgjithshme për dëmet nga përmbytjet gjatë periudhës 1946-2018 në Bashkinë Tiranë

Data	Bashkia	Humbje jete	Shtëpi të shkatërruara/dëmtuara	Persona të prekur	Humbje (në Lekë)	Numri i pikave të interesit:	Kulturat e dëmtuara bujqësore (ha)	Humbjet në bagëti	Rrugët e dëmtuara (km)
1946/10/23	Dajt, Kamëz, Tiranë	9	35					243	205
1962/11/16	Tiranë				95000				
1976/10/31	Kamëz								
1976/06/06	Tirana:				500000		362		
1979/11/16	Tirana:		4						
1985/11/19	Tirana:		200	800					
1998/10/01	Tirana:								
2001/05/07	Tirana:			584					
2002/12/18	Tirana:								
2002/09/27	Tiranë		150		180000000				
2003/11/03	Paskuqan								
2004/01/28	Paskuqan		16	24					

[158]Hartat e projektit ProNews të përgatitura për basenin e lumit Ishëm

2005/12/17	Tirana:								
2008/12/03	Tirana:				394500				
2008/06/13	Tiranë		1						
2009/01/07	Kamëz								
2012/04/15	Tiranë								
2012/05/27	Tiranë								
2009/01/07	Kamëz		1		1067220				
2012/04/15	Tirana:								
2012/05/27	Tiranë								
2013/10/15	Paskuqan, Tiranë, Kamëz		799						
2013/03/14	Kamëz								
2015/11/22	Paskuqan		24						
2016/01/06	Tiranë								
2016/01/07	Tiranë								
2018/02/03	Bërxullë								

Tabela 9-2 - Të dhënat e përgjithshme për dëmet nga përmbytjet gjatë periudhës 1961-2016 në Bashkinë Tiranë

Data	Bashkia	Humbje jete	Shtëpi të shkatërrua	Persona të prekur	Humbje (në Lekë)	Numri i pikave të	Kulturat e dëmtuara	Humbjet në bagëti	Rrugët e dëmtuara
1961/11/15	Kodër Thumanë				30000		5		
1962/11/16	Ishëm				2503700				
1970/12	Kodër Thumanë						400		
1973/11/8	Kodër Thumanë						430		
1976/10/31	Bubq, Fushë Krujë; Ishëm						500		
1976/11/2	Kodër Thumanë, Ishëm						410		
1976/9/1	Kodër; Thumanë								
1978/3/22	Fushë Krujë; Ishëm						420		
1979/11/16	Kodër; Thumanë; IIshëm Ishëm		3				4260		
1995/9/21	Bubq, Fushë Krujë, Kodër Thumanë				7700000		500		

2000/11/8	Fushë Krujë		147	1200					
2005/12/1	Bubq								
2005/3/17	Bubq								
2005/3/5	Kodër Thumanë						30		
2006/3/24	Bubq		30				300		
2010/1/31	Bubq		1						
2010/11/11	Bubq, Fushë Kruje		256				600		
2013/10/16	Bubq								
2015/11/23	Fushë Krujë		10						
2016/1/6	Fushë Krujë								
2016/1/8	Ishëm								

Zonat më të rrezikuara nga përmbytjet për shkak të daljes së lumenjve ndodhen kryesisht në ultësirën perëndimore të vendit. Këto zona, kryesisht me zhvillim bujqësor, janë shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Lëvizjet demografike pas viteve 1990 e kanë shtuar densitetin e popullsisë dhe e kanë shtuar ritmin e ndërtimeve urbane, duke rritur kështu edhe riskun për dëme nga përmbytjet. Në basenin Ishëm, përmbytjet për shkak të daljes së lumenjve mund të zgjasin nga disa orë deri në disa ditë, në varësi të llojit të ngjarjes. Në pjesën e poshtme, lumenjtë dalin nga shtrati duke shkaktuar dëme ekonomike dhe kërcënuar jetën e popullsisë që jeton në ato zona, kryesisht në Fushë-Krujë. Disa prej zonave më në risk ndodhen në fshatrat Murqinë, Mallkuc, Bilaj dhe Gramëz. Investimet e para për mbrojtjen nga përmbytjet në Shqipëri filluan pas përmbytjeve historike të periudhës 1962-1963. Këto investime kanë vijuar përgjatë një periudhe 15 vjeçare dhe pas 1980-s u fokusuan më tepër tek mirëmbajtja e infrastrukturës për mbrojtjen nga përmbytjet. Për 40-50 vjet nuk ka pasur më investime domethënëse në infrastrukturë për mbrojtjen nga përmbytjet; ka pasur kryesisht mirëmbajtje vendore ose investime korrigjuese, pa analizuar të gjithë skemën e sistemit të mbrojtjes nga përmbytjet.

9.3.3 Strategjia e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet

DP-ja e BE-së është transpozuar në Shqipëri si pjesë e politikës "Përmbajtja, zhvillimi dhe zbatimi i Strategjive Kombëtare të Ujit, Planeve të Menaxhimit të Rajoneve të Baseneve ujore dhe Planeve të Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet".

Përmbytjet janë dukuri natyrore që nuk mund të shmangen. Megjithatë, ka disa veprimtari njerëzore dhe ndryshime klimatike që mund të rrisin probabilitetin për efekte negative. Përmbytjet kërcënojnë vazhdimisht jetën e njeriut, mjedisin dhe zhvillimin ekonomik, por mund të sjellin edhe zhvendosje të popullsisë.

Qasja moderne e direktivës është të bashkëpunohet me të gjithë aktorët përkatës "që të jetojmë me përmbytjet", të mbrojmë dhe nëse është e mundur t'i përshtatim përdorimet dhe ndërtimet me risqet nga përmbytjet në zonat përkatëse, sidomos të jemi të përgatitur së bashku me të gjithë personat, organizatat, administratat dhe bizneset e prekura.

AMBU, me mbështetjen e projektit të ProNews "Programi për Përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe Parandalimit të Përmbytjeve në Shqipëri", mbështetur nga Bashkimi Evropian, ka:

- Hartuar raportin për vlerësimin paraprak të riskut nga përmbytjet për basenet e lumenjve Ishëm dhe Erzen;

- Identifikuar 3 zona ku ka risk të mundshëm nga përmbytjet ose zona në basenin e lumit Ishëm me gjasë për t'u përmbytur;
- Krijuar hartën e rreziqeve për një territor që përfshin dy zona të identifikuara, ku ka risk të mundshëm nga përmbytjet ose zona në basenin e lumit Ishëm me gjasë për t'u përmbytur;

Aktualisht, nuk ka plan për menaxhimin e përmbytjeve në basenin e lumit Ishëm dhe hartat e rreziqeve nga përmbytjet nuk janë përgatitur për të gjitha zonat ku ka risk të mundshëm ose gjasa për përmbytje. E njëjta gjë vlen edhe për hartat e riskut nga përmbytjet.

9.3.4 Aktivitetet ose Skemat e Reja të Menaxhimit të Përmbytjes që Ndikojnë te Statusi i Trupit Ujor

Tabela 9-3 përmbledh ata trupa ujorë statusi i të cilëve mund të ndikohet nga aktivitetet e menaxhimit të riskut nga përmbytjet dhe që për këtë shkak mund të rrezikojnë të mos i arrijnë objektivat mjedisore të parashtruara në Seksionin 3. Programi i Masave duhet të përfshijë edhe masat zbutëse ose arsyetimin e mosarritjes së statusit të mirë (Kapitulli 13). Tabela më poshtë paraqet trupat ujorë që kanë potencial të madh për përmbytje, duke iu referuar hartave të rrezikut, me probabilitet përmbytjeje një herë në 50 vjet. Thellësia mesatare e ujit varion nga 3 në 6 metra[159].

Tabela 9-3 – Trupat Ujorë që Mund të Ndikohen nga Aktivitetet e Burimeve Ujore

EMRI I TRUPIT UJOR	NËNBASENI	TRUPI UJOR KODI I BE-SË	FORMA AKTUALE	STATUSI AKTUAL	NDIKIMI POTENCIAL
Ishëm	ISH0	TW351411	Natyral	I Mesëm	Shumë i lartë
Ishëm	ISH0	RW351413	Natyral	I Ulët	Shumë i lartë
Zezë	ISH0	RW351421	Natyral	I Ulët	Shumë i lartë
Ishëm	ISH0	RW35143	Natyral	I Ulët	Shumë i lartë
Tiranë	ISH1	RW35145	Natyral	I Ulët	Shumë i lartë

9.4 Menaxhimi i Riskut nga Thatësirat në Basenin e Lumit Ishëm

9.4.1 Autoriteti Kompetent dhe Masat e Koordinimit

Risqet që lindin për shkak të pamjaftueshmërisë së ujit (thatësirat) trajtohen nëpërmjet menaxhimit efikas të burimeve ujore dhe investimeve që i shërbejnë të gjitha interesave, në zbatim të akteve kombëtare ligjore dhe nënligjore të cilat kanë transpozuar Direktivat e BE-së. Sipas Komisionit Evropian, thatësirat duhen trajtuar në mënyrë të ngjashme me menaxhimin e riskut nga përmbytjet. Ndonëse nuk ka direktiva nga BE-ja, ka udhëzime të qarta të bazuara te DKU-ja për përgatitjen e Planeve të Menaxhimit të Thatësirave (GWPCEE, 2015).

Kur përgatitemi për përballimin e thatësirave dhe pamjaftueshmërisë së ujit, ka shumë rëndësi të kuptojmë se janë dy fenomene të ndryshme. Thatësirat kanë orgjinë natyrore ndërsa pamjaftueshmëria e ujit (ose pakësimi i ujit) ka të bëjë me faktin se burimet ujore janë të pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat për përdorim afatgjatë të ujit. Planifikimi i përballimit të thatësirave dhe menaxhimit të sasive të vogla të ujit është kombinim kompleks i monitorimit të tendencave hidrometeorologjike me menaxhimin teknik të burimeve ujore dhe zbutjen e ndikimeve socio-ekonomike.

[159] Material i prodhuar nga projekti ProNews: Zhvillimi i hartave të rrezikut nga përmbytjet në përputhje me Direktivën e BE-së për Përmbytjet, në vijim të Udhëzimeve IPA për Përmbytjet

Për sa i përket Menaxhimit të Riskut nga Thatësirat, nuk ka VKM për ngritjen dhe funksionimin e një organi kompetent, përgjegjës për menaxhimin e riskut nga thatësirat.

MBZhR-ja përmbush disa përgjegjësi nëpërmjet shkëmbimit të informacionit midis bashkive dhe bordeve të kullimit. Për më tepër, Strategjia për Ujitjen dhe Kullimin në Shqipëri e mbulon pjesërisht menaxhimin e thatësirave në nivel vendi.

9.4.2 Përmbledhja e Historikut të Thatësirave

Regjimi i reshjeve në Shqipëri është tipik mesdhetar dhe faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në reshjet atmosferike janë vendndodhja gjeografike dhe topografia. Pjesa juglindore e vendit ka më pak reshje, ku sasia vjetore arrin deri në 600 mm, ndjekur nga Fusha e Myzeqesë me 1000 mm në vit. Në territorin shqiptar bien mesatarisht rreth 1480 mm reshje në vit. Sasia më e madhe e reshjeve regjistrohet gjatë muajve të ftohtë (tetor-mars), me 75% të totalit. Muaji me sasinë më të madhe të reshjeve në të gjithë territorin është nëntori, ndërsa muajt më të thatë janë korriku dhe gushti. Shqipëria është vend me ujëra të bollshme. Volumet e burimeve ujore të rinovueshme shkojnë deri në 41.7 miliardë m^3 brenda vitit, prej të cilave rreth 65% gjenerohen në Shqipëri dhe pjesa e mbetur nga vendet fqinje të rrjedhës së sipërme. Shumica e lumenjve paraqesin karakteristika të parregullta sezonale në prurje. Thuajse të gjithë mbartin më pak se 10% (ndonjëherë edhe zero) të mesatareve të sezonit të dimrit në sezonin e verës. Liqenet zënë rreth 4% të territorit të vendit. Vendi ka 3 liqene të mëdha dhe 247 liqene më të vogla. Janë ndërtuar 630 rezervuarë me kapacitet depozitues 5.60 miliardë m^3 në vit, kryesisht përgjatë lumenjve, për mbrojtje nga përmbytjet, ujitje dhe prodhim të energjisë hidrike.

Në Shqipëri gjen 3 lloje thatësirash:

- thatësira meteorologjike - përkufizuar në bazë të deficitit të reshjeve të shiut
- thatësira hidrologjike - shkaktohet kryesisht nga mungesa e akumuluar e prurjeve të lumenjve dhe nga rimbushja e ujërave nëntokësore.
- thatësira bujqësore - faktor kritik është disponueshmëria e ujit në tokë gjatë sezonit të kultivimit.

Thatësira hidrologjike është lloji më i rëndësishëm i thatësirës për sektorin ekonomik. Kjo ndodh sepse burimet ujore luajnë rol kyç në ekonomi. Rreth 97% e prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike gjenerohet nga veprat hidroenergjetike, të ndodhur kryesisht në 3 lumenj. Kjo lloj thatësire ndikon edhe te sektori i bujqësisë, sepse rreth 50% e ngastrave (400 000 ha) që ujiten përbëjnë rreth 80% të prodhimit bujqësor.

9.4.3 Përmbledhja e Historikut të Thatësirave

Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Basenit ujor ofron mundësi të mira për trajtimin e çështjeve lidhur me thatësirën dhe pamjaftueshmërinë e ujit. Më konkretisht, kërkesa e DKU-së për arritjen e statusit sasior të ujërave nëntokësore përfshin edhe vendosjen e balancës midis pakësimit dhe rimbushjes së ujërave nëntokësore. Për sa i përket kërkesës së arritjes së statusit të mirë ekologjik për ujërat sipërfaqësore, ka shumë rëndësi të përcaktojmë rrjedhën minimale (ekologjike) të çdo lumi, që mundëson arritjen e objektivave specifike për zonën lidhur me biodiversitetin ujor. Masat për arritjen e këtyre objektivave duhen përfshirë në Planet e Menaxhimi të Basenit ujor .

Lidhur me menaxhimin e thatësirës, duke qenë se prek ndër të tjera drejtpërdrejt furnizimin me ujë për ujitje, thatësira duhet trajtuar si koncept i qartë klimatik që karakterizohet nga mungesa të përkohshme uji për periudhë të gjatë kohore, krahasuar me furnizimin normal (një sezon, një vit, disa vjet). Për sa i përket rolit të tipologjisë (thatësirë meteorologjike, bujqësore ose hidrologjike), ajo përcakton fillimin, agravimin dhe përfundimin e thatësirës.

Strategjia për Ujitjen dhe Kullimin në Shqipëri përfshin përshkrimin e situatës aktuale dhe sfidave kryesore për ujitjen, kullimin, digat, rezervuarët dhe mbrojtjen nga përmbytjet. Sistemet e ujitjes dhe kullimit në të gjithë vendin kanë degraduar për shkak të mungesës së mirëmbajtjes dhe riparimeve të nevojshme për vite me radhë. Ndryshimet lidhur me modelet e kultivimit dhe metodat e përdorimit të ujit, si dhe ndryshimet klimatike kërkojnë sofistikim të strukturave për të mundësuar përdorim më eficient të ujit dhe procedura menaxhimi e financimi më intensive e të besueshme. Gjithashtu, Planet e Menaxhimit të Thatësirave duhen hartuar dhe

zbatuar në përputhje me standardet ndërkombëtare, përfshi edhe mekanizmat e angazhimit nëpërmjet komunikimit midis institucioneve dhe palëve përkatëse të interesit dhe përfshirjes së tyre në plan.

9.4.4 Aktivitetet ose Skemat e Reja të Menaxhimit të Thatësirave që Ndikojnë te Statusi i Trupit Ujor

Shtimi i nxehtësisë dhe pakësimi i reshjeve të shiut sjellin reduktim të burimeve ujore, gjë që ka ndikim negativ drejtpërdrejt te popullatat e ekosistemeve. Duhet të ofrohet infrastruktura dhe informacioni i përshtatshëm për ndryshimet e shtuara klimatike, në mënyrë që të përballohen me sukses (GWP, 2009). Burimet ujore priten të bien me 14% (EVN / Starkraft, 2009) deri në 2050-n dhe me rreth 6% deri në 2027-n. Përllogaritet se gjatë verës, rrjedhja e mbetur në basenin e lumit Ishëm do të arrijë pjesën më të madhe të prurjes aktuale Q_{95}.

Krahasimi midis nxjerrjes dhe disponueshmërisë së ujit tregon se baseni i lumit Ishëm parashikohet të vuajë nga mungesa të theksuara të ujit në verën e 2050-s, edhe në skenarin më optimist (CESR, 2011).

Tabela 9-4 përmbledh ata trupa ujorë statusi i të cilëve mund të ndikohet nga aktivitetet e menaxhimit të riskut nga thatësirat dhe që për këtë shkak mund të rrezikojnë të mos i arrijnë objektivat mjedisore të parashtruara në Seksionin 4. Programi i Masave duhet të përfshijë edhe masat zbutëse ose arsyetimin për mosarritjen e statusit të mirë (Kapitulli 12).

Tabela 9-4 – Trupat Ujorë që Mund të Ndikohen nga Aktivitetet e Menaxhimit të Thatësirave

EMRI I TRUPIT UJOR	NËNBASEN	TRUPI UJOR KODI I BE-SË	FORMA AKTUALE	STATUSI AKTUAL	NDIKIMI POTENCIAL

9.5 Plani i Menaxhimit të Zonave Bregdetare

9.5.1 Autoriteti Kompetent dhe Masat e Koordinimit

Në Shqipëri, planet e menaxhimit të zonave bregdetare nuk janë hartuar ende plotësisht. Agjencia Kombëtare e Bregdetit e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë vijën bregdetare të Republikës së Shqipërisë në zona, territore, objekte dhe veprimtari që ndodhen ose zhvillohen në të gjithë apo në një pjesë të vijës bregdetare, ose që kanë ndikim tek ajo. Agjencia është përgjegjëse për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare, duke monitoruar dhe kontrolluar potencialin ekzistues të të gjithë zonës bregdetare, siguron performancën e zonave bregdetare nëpërmjet menaxhimit të integruar të vijës bregdetare dhe zbatimin e tyre. Krijon dhe përditëson Inventarin Kombëtar të Zonës Bregdetare; kontribuon në informimin, konsultimin dhe përfshirjen e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave dhe strategjive lidhur me menaxhimin e integruar të zonës bregdetare; merr pjesë në hartimin e politikave dhe strategjive kombëtare për menaxhimin e integruar të bregdetit dhe koordinon punën për zbatimin e tyre; propozon ndryshime dhe përmirëson kuadrin ligjor dhe nënligjor për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare; kontrollon zbatimin e kritereve dhe kushteve të subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike, në vijim të dispozitave ligjore në fuqi; ushton kontrolle dhe inspekton mjediset dhe dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike.

9.5.2 Strategjia për Menaxhimin e Bregdetit

Fusha e menaxhimit të zonës bregdetare rregullohet nga dy dokumente kuadër operacionale:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2030;
- Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin 2030 (PINB).

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit synon zhvillimin e destinacioneve, zonave dhe produkteve dhe rritjen e vlerës së shtuar të potencialeve turistike për zhvillimin social dhe ekonomik të vendit, nëpërmjet planeve të veprimit për çdo rajon.

Plani i integruar ndërsektorial ka të bëjë me krijimin dhe zhvillimin e rajonit bregdetar, i cili promovon zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, integritetin social dhe mbrojtjen e burimeve për 15 vitet e ardhshme.

Në Shqipëri, mungesa e planeve hapësinore dhe moszbatimi i bazës ligjore konsiderohet si një prej pengesave më të mëdha të zhvillimit të qëndrueshëm të bregdetit. Mungesa e Planit të Integruar Ndërsektorial ka sjellë edhe fragmentimin e planifikimit, ku janë ndarë kompetencat territoriale dhe juridiksionet.

Kjo gjë ka penguar hartimin e planeve rajonale, të cilat me shumë mundësi mund të mbivendosen nëse paraprihen nga Plani i Integruar sektorial për Bregdetin. Për më tepër, të gjitha planet vendore e rajonale (të pakta në numër), si dhe zhvillimet e deritanishme, janë zbatuar pa pasur një vizion të qartë rajonal e kombëtar.

9.5.3 Aktivitetet ose Skemat e Reja të Menaxhimit të Bregdetit që Ndikojnë te Statusi i Trupit Ujor

Tabela 9-5 përmbledh ata trupa ujorë statusi i të cilëve mund të ndikohet nga aktivitetet e menaxhimit të riskut nga përmbytjet që mund të rrezikojnë të mos i arrijnë objektivat mjedisore të parashtruara në Seksionin 4. Programi i Masave duhet të përfshijë edhe masat zbutëse ose arsyetimin për mosarritjen e statusit të mirë (Kapitulli 12).

Bashkia Durrës rrezikohet nga përmbytjet e lumit Ishëm, nga Dreveni deri në grykëderdhje, si dhe nga përmbytjet nga lumi Erzen, nga Pejzga deri në grykëderdhje. Kjo bashki rrezikohet edhe nga përmbytje detare nga grykëderdhja e lumit Ishëm deri te Kepi i Rodonit dhe nga Kepi i Rodonit deri në Porto Romano; rrezikohet nga erozioni detar në Kepin e Rodonit në pjesën jugore dhe Bishti i Pallës sërish në jug të zonës. Vazhdimisht ka rrëshqitje dheu përgjatë Kepit të Rodonit nga Shkallnuri në Seferaj.

Tabela 9-5 – Trupat Ujorë që Mund të Ndikohen nga Aktivitetet e Menaxhimit të Bregdetit

EMRI I TRUPIT UJOR	NËNBASEN	TRUPI UJOR KODI I BE-SË	FORMA AKTUALE	STATUSI AKTUAL	NDIKIMI POTENCIAL
Ishëm	ISH0	TW351411	Tranzitor	3	Niveli i kripësisë
Kepi i Rodonit	ISH0	CW351402	Natural		Përmbytjet nga bregdeti

9.6 Vlerësimi Strategjik Mjedisor

9.6.1 Autoriteti Kompetent dhe Masat e Koordinimit

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një prej instrumenteve kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikim strategjik dhe vendimmarrje. Duke qenë se PM-ja është produkt kryesor i PMBU-së dhe këto masa mund të kenë në vetvete implikime mjedisore të mëdha rajonale ose ndërsektoriale, ka shumë gjasa që në shumicën e rasteve PMBU-ja të ketë nevojë për shqyrtimin e VSM-së. Në Shqipëri, Ligji 91/2013 për VSM-në dhe të gjitha aktet nënligjore janë kërkesat minimale për realizimin e VSM-së. Ligji është përafruar gjerësisht me Direktivën 2001/42/KE[160]. Në Shqipëri, ligji 91/2013 shërben për të ofruar mbrojtje mjedisore dhe zhvillim të qëndrueshëm përmes përfshirjes së problematikave mjedisore në hartimin ose rishikimin e planeve apo programeve që mund të kenë pasoja negative në mjedis, të cilat mund të përfshijnë për shembull Planin e Menaxhimit të Basenit ujor. Vendimi nëse duhet ndërmarrë VSM-ja është kompetencë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Procedura e VSM-së për planet dhe programet kombëtare dhe vendore realizohet në nivel kombëtar dhe përfshin këto hapa:

- Njoftimin e Ministrisë së Mjedisit nga autoriteti propozues;
- Konsultimin me palët e interesit në bazë të çështjeve që do të trajtohen në raportin e VSM-së (përcaktimi i objektit);
- Konsultimet publike për hartimin e raportit paraprak të VSM-së;

[160] Komisioni Evropian, Direktiva 2001/42/KE për vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe programeve për mjedisin, Direktiva për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

- Hartimin e raportit përfundimtar të VSM-së;
- Shqyrtimin e raportit përfundimtar të VSM-së dhe lëshimin e deklaratës së ministrit;
- Vendimin e autoritetit propozues për miratimin e planit ose programit;
- Monitorimin e efekteve të planit ose programit për mjedisin dhe raportimin.

Në rast se autoriteti propozues nuk i ka zbatuar kërkesat e ligjit për VSM-në, atëherë ministria i komunikon autoritetit propozues mosmarrjen në konsideratë të miratimit të deklaratës, duke dhënë arsyet përkatëse. Nëse plani ose programi nuk miratohet brenda 2 vjetësh nga data e miratimit të deklaratës, atëherë deklarata e ministrit për VSM-në bëhet e pavlefshme dhe procedura e VSM-së fillon nga e para. Autoriteti kompetent, për miratimin përfundimtar të PMBU-së sigurohet që, përpara marrjes së vendimit për miratim ose jo, të jenë përmbushur kërkesat e ligjit për VSM-në dhe propozuesi ta ketë marrë deklaratën e ministrit për VSM-në.

9.6.2 Elementet Kryesore të Vlerësimit Strategjik Mjedisor

VSM-ja mund të kuptohet si "proces sistematik dhe paraprak, i ndërmarrë me qëllim analizimin e efekteve mjedisore të planeve, programeve dhe veprimeve të tjera strategjike të propozuara, si dhe integrimin e gjetjeve në vendimmarrje".

Ligji shqiptar për VSM-në identifikon katër elemente kryesore (Tabela 9-6):

- Përgatitjen e raporteve për vlerësimin strategjik.
- Sigurimin e pjesëmarrjes publike dhe debatit publik.
- Marrjen parasysh të rezultateve të vlerësimit strategjik dhe pjesëmarrjes publike në fazën e vendimmarrjes.
- Ofrimin e informacionit për marrjen e vendimeve.

Tabela 9-6 – Elementet Kryesore të Procesit të VSM-së

FAZA	OBJEKTIVAT	STATUSI I PËRFUNDIMIT
Faza e shqyrtimit nga autoriteti kompetent	Vendimi nëse kërkohet VSM për PMBU-në dhe në cilat kushte.	*Ligji nr.91/2013*
Përcaktimi i objektit dhe konsultimi statutor	Objekti dhe niveli i detajeve që do të merren në konsideratë në vlerësimin mjedisor, si dhe lista e palëve kryesore të interesit dhe masat e koordinimit	*Përfunduar më 01.09.2022*
Raporti i vlerësimit mjedisor dhe konsultimi publik	Vlerësimi i ndikimeve domethënëse në mjedis që lindin nga zbatimi i Programit të Masave në PMBU dhe koordinimi me alternativat e arsyeshme. Projekt raporti i VSM-së duhet të jetë dokument shoqërues i PMBU-së.	*Përfunduar më 01.10.2022*
Deklarata e VSM-së nga autoriteti kompetent	Deklarata se si janë integruar aspektet mjedisore dhe konsultimet në PMBU-në përfundimtare, me lëshimin e deklaratës përfundimtare të VSM-së.	*Publikuar më 24.10.2022*

Procesi i VSM-së e ndihmon autoritetin përgjegjës dhe vendimmarrësin në kuadër të PMBU-së që të marrë parasysh:

- Tendencat, potencialet dhe kufizimet kryesore mjedisore që mund të prekin ose mund të preken nga PMBU-ja;
- Objektivat mjedisore dhe treguesit që lidhen me PMBU-në;
- Efektet mjedisore domethënëse të masave të propozuara dhe zbatimin e PMBU-së;
- Masat për shmangien, reduktimin ose zbutjen e efekteve negative dhe përforcimin e efekteve pozitive;

- Informimi publikut nga autoritetet përkatëse, si dhe kur është e mundur, vendet fqinje që mund të preken.

Vlerësimi strategjik mjedisor në kuadër të PMBU-së përfshin:

a. përgatitjen e raportit mjedisor;
b. zhvillimin e konsultimeve;
c. marrjen parasysh të (i) dhe (ii) në vendimmarrje
d. informacion rreth vendimit.

9.6.3 Përfundimet Kryesore të Vlerësimit Strategjik Mjedisor

Raporti i VSM-së duhet të përmbledhë të gjitha gjetjet dhe përfundimet e arritura gjatë të gjithë procesit të VSM-së dhe të shërbejë si bazë për konsultimet me autoritetet dhe palët përkatëse të interesit.

VSM nuk është instrument për vendimmarrje. Ai jep informacion rreth ndikimeve të mundshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, shkaktuar nga vendimi.

Megjithatë, përfundimet e procesit të VSM-së duhen marrë parasysh gjatë marrjes së vendimit (dhe më vonë gjatë zbatimit të PMBU-së).

10 Presionet ndaj Trupit Ujor, Statusi dhe Vlerësimi i Ndikimeve

10.1 Vështrim i përgjithshëm

Në qendër të objektivave të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor është vlerësimi i strukturuar i të gjitha presioneve që mund të ndikojnë te trupat ujorë të basenit ujor, ndryshimi i statusit dhe ndikimet në ekosistemet ujore si rezultat i këtyre presioneve. Presionet (kryesisht antropogjene ose "ndikimet artificiale", por edhe ndryshimet klimatike) mund të sjellin ndryshime të statusit (treguesi qendror i "shëndetit" të trupit ujor), gjë që mund të rezultojë në ndikime negative. Këto mund të jenë ndryshime negative në cilësinë e ujit, sasinë e ujit, morfologjinë e ekosistemit ose të gjitha së bashku.

Statusi i pamjaftueshëm (rreziku i mosarritjes së objektivave) për çdo trup ujor krijon një lloj hendeku lidhur me objektivat mjedisore (OM) të parashtruara në Kapitullin 3. Kur arrihet "Statusi i Mirë", politikat mjedisore dhe sistemi rregullator duhet të përpiqen që ta ruajnë atë status (Kapitulli 12). Kur "Statusi i Mirë" nuk arrihet, duhet zbatuar një plan veprimi riparues për të ruajtur ose përmirësuar çdo trup ujor që rrezikon të mos i arrijë OM-të e parashtruar në Programin e Masave (Kapitulli 13).

DKU-ja kërkon identifikimin sistematik të presioneve domethënëse (të rëndësishme) nga ndikimet me origjinë antropogjene, siç janë burimet pikësore të ndotjes, burimet e shpërndara të ndotjes, modifikimet e regjimeve të prurjeve përmes nxjerrjeve ose rregullimit, ndryshimet morfologjike, si dhe presione të tjera[161] (DKU, neni (5)). "Domethënës" do të thotë se presionet kontribuojnë në një ndikim të caktuar që mund të sjellë mospërmbushjen e objektivit mjedisor "Status i Mirë" të DKU-së, neni 4(1) i DKU-së. Në disa raste, presionet e moderuara nga disa nxitës dytësorë mund të kombinohen me njëra-tjetrën dhe të bëhen të rëndësishme.

Fazat kryesore të qasjes së përgjithshme të përcaktuara në DKU janë:

- Identifikimi i forcave shtytëse (ndikimeve).
- Identifikimi i presioneve të rëndësishme.
- Identifikimi i statusit pasues.
- Vlerësimi i ndikimeve.
- Vlerësimi i riskut të mosarritjes së objektivave.
- Propozimi i masave zbutëse/mbrojtëse.

10.2 Shembuj të Presioneve dhe Ndikimeve

Zakonisht, presionet dhe ndikimet janë pikësore ose të shpërndara. [162] Presionet e shpërndara, p.sh. ndotja nga nitratet me origjinë bujqësore ose mbinxjerrja e ujërave nëntokësore, mund të kërkojnë politika të përgjithshme mjedisore ose strategji menaxhimi që zbatohen për një zonë të gjerë (p.sh. nënbasen, grup trupash ujorë ose akuifer). Nga ana tjetër, presionet pikësore si shkarkimet e ujërave të ndotura ose prurjet në dalje të hidrocentralit mund të kërkojnë veprime për disa trupa ujorë individualë, megjithatë nevoja për masa riparuese të veçanta në shumë raste duhet të parandalohet, të paktën teorikisht, me anë të politikave të nivelit të lartë të përcaktuara dhe të zbatuara si duhet. Të gjitha llojet e ndryshme të presioneve dhe ndikimeve janë të pranishme në basenin e Ishmit, ndonëse në nivele të ndryshme. (Lidhur me shembuj të ndryshëm referohuni në Shtojcën Teknike XI).

[161] Komisioni Evropian, Dokumenti Udhëzues 3 i CIS-it, Analiza e Presioneve dhe Ndikimeve, KE 2003

[162] Komisioni Evropian, Dokumenti Udhëzues 2 i CIS-it, Analiza e Presioneve dhe Ndikimeve

10.3 Vlerësimi i Standardizuar i Presioneve Mbështetur në Procedurat e Raportimit WISE

10.3.1 Lista Standarde e Numeracionit të Presioneve dhe Treguesve nga WISE

Në mënyrë që raportimi i presioneve në PMBU të jetë i përafruar me saktësi me detyrimet e raportimit WISE, Vlerësimi i presioneve dhe statusi si rezultat i këtij vlerësimi janë themelore për të kuptuar dhe vlerësuar nga ana sasiore hendeqet midis objektivave mjedisore dhe gjendjes aktuale të trupave ujorë në basenin ujor. Vlerësimi ndërthur kriteret analitike dhe përshkruese, në varësi të nivelit të të dhënave në dispozicion.

Vlerësimi i statusit të trupit ujor është një ushtrim i vështirë krahasuar me standardet provizore bazuar në një model të vetëm analitik. Vlerësimi i presioneve është më kompleks sepse presionet janë zakonisht më abstrakte dhe më të vështira për t'u vlerësuar në sasi dhe/ose presionet e ndryshme kombinohen në mënyra komplekse për të ndikuar në statusin e trupit ujor. Vlerësimi sasior i presioneve, ndonëse i realizueshëm, kërkon të dhëna të konsiderueshme cilësore, shumë prej të cilave nuk mblidhen aktualisht në Shqipëri.

Vërehet se shumë prej "treguesve të presionit" kërkojnë që të raportohet një sasi e volumit, ose si pjesë e llogaritjes së përafërt të ngarkesës së ndotësve, ose si pjesë e ndikimit të prurjes ekologjike. Treguesit kuptimplotë të presionit nuk mund të përcaktohen për shkak të shkatërrimit tërësor të rrjetit kombëtar hidrometrik, mungesës së të dhënave hidrologjike të përdorshme të kohëve të fundit dhe mungesës së konsiderueshme të të dhënave për volumet e mbetjeve të lëngëta pas trajtimit të monitoruara nga institucionet dhe industritë.

Për të përmirësuar politikëbërjen mjedisore dhe për të identifikuar "pikat e nxehta mjedisore" që mund të kërkojnë rregullore më strikte (përmes kushteve të lejes dhe zbatimit) nevojitet një lloj indeksimi sasior i presionit. Tabela 10-1 dhe 10-2 paraqesin dy grupe treguesish për presionin, të cilat janë që të dyja në përputhje me skemën e raportimit WISE 2016.

"Treguesit e përgjithshëm" janë 'sasitë' e nivelit të lartë të presionit që lidhen me objektet si numri i pikave të shkarkimit, numri i hidrocentraleve ose pikave të nxjerrjes së ujit për qëllime bujqësore, gjatësia e trupave ujorë të prekur, numri i instalimeve pa leje, etj. Këto duhet të jenë lehtësisht të përcaktueshme edhe në rastin e funksionimit aktual të kufizuar të Kadastrës, bazuar në shqyrtimet e dokumentacionit ose inspektimet e shpejta në terren.

"Treguesit precizë" në përputhje me WISE 2016 kërkojnë matje dhe raportim sektorial tejet të përmirësuar krahasuar me ato të dhëna aktualisht në dispozicion përmes KKBU-së, veçanërisht lidhur me matjen e parametrit të mbetjeve të lëngëta pas trajtimit dhe volumeve të prurjes së lumit. Këto tabela janë plotësuar pjesërisht, aty ku ka të dhëna të disponueshme, dhe ndodhen në Shtojcën Teknike IV.

Tabela 10-1 dhe Tabela 10-2 paraqesin llojet kryesore të presioneve, së bashku me dy variantet e "treguesit të presionit", që rrjedhin nga udhëzimi WISE 2016 dhe që janë riprodhuar plotësisht në Shtojcën Teknike 4[163, 164].

"Llojet" e presionit janë format kryesore të ndikimit antropogjen që mund të ndikojnë në statusin e trupit ujor: p.sh. ujërat e ndotura urbane të patrajtuara, ndryshimi hidrologjik për shkak të hidrocentralit, nxjerrjet për ujitje.

"Treguesit" e presioneve tregojnë fuqinë sasiore të presionit që duhet reduktuar për të arritur objektivat mjedisore, p.sh. ngarkesa e BOD_5 në vijën ujore pritëse, reduktimi i prurjes ose i orëve të punës së HEC-it.

Kodet në listën e numeracionit të presioneve (Tabela 10-1,Tabela 10-2) janë pjesë e "Presioneve-Statusit" (Shtojca teknike IV) dhe duhet të jenë pjesë edhe e listës së atributeve të klasës së veçorive të Trupit Ujor të Kadastrës.

[163] Qasja e miratuar në modelin e ri të PMBU-ve në Shqipëri do të përafrohet ngushtësisht me kërkesat e raportimit WISE për sa i përket klasave të veçorive dhe atributeve. Mbledhja e të dhënave fokusohet vetëm te ajo çka nevojitet për raportimin WISE dhe EIONET, si dhe strukturat e të dhënave të KKBU-së orientohen në mënyrë të tillë që të përafrohen me rezultatet e DKU-së.

[164] Sistemi i Informacionit të Ujit për Evropën, Dokumenti Udhëzues i WISE GIS për raportimin e të dhënave hapësinore në WISE, Versioni 6.0.6, 2016.

10.3.2 Identifikimi dhe Vlerësimi Sasior i Presioneve dhe Treguesve

Vlerësimi i presioneve dhe statusi si rezultat i këtij vlerësimi janë themelore për të kuptuar dhe vlerësuar nga ana sasiore hendeqet midis objektivave mjedisore dhe gjendjes aktuale të trupave ujorë në basenin ujor. Vlerësimi ndërthur kriteret analitike dhe përshkruese, në varësi të nivelit të të dhënave në dispozicion.

Vlerësimi i statusit të trupit ujor është një ushtrim i vështirë krahasuar me standardet provizore bazuar në një model të vetëm analitik. Vlerësimi i presioneve[165] është më kompleks sepse presionet janë zakonisht më abstrakte dhe më të vështira për t'u vlerësuar në sasi dhe/ose presionet e ndryshme kombinohen në mënyra komplekse për të ndikuar në statusin e trupit ujor. Vlerësimi sasior i presioneve, ndonëse i realizueshëm, kërkon të dhëna të konsiderueshme cilësore, shumë prej të cilave nuk mblidhen aktualisht në Shqipëri.

Vërehet se shumë prej "treguesve të presionit" kërkojnë që të raportohet një sasi e volumit, ose si pjesë e llogaritjes së përafërt të ngarkesës së ndotësve, ose si pjesë e ndikimit të prurjes ekologjike. Treguesit kuptimplotë të presionit nuk mund të përcaktohen për shkak të shkatërrimit tërësor të rrjetit kombëtar hidrometrik, mungesës së të dhënave hidrologjike të përdorshme të kohëve të fundit dhe mungesës së konsiderueshme të të dhënave për volumet e mbetjeve të lëngëta pas trajtimit të monitoruara nga institucionet dhe industritë.

Për të përmirësuar politikëbërjen mjedisore dhe për të identifikuar "pikat e nxehta mjedisore" që mund të kërkojnë rregullore më strikte (përmes kushteve të lejes dhe zbatimit) nevojitet një lloj indeksimi sasior i presionit. Tabela 10-1 dhe 10-2 paraqesin dy grupe treguesish për presionin, të cilat janë që të dyja në përputhje me skemën e raportimit WISE 2016.

"Treguesit e përgjithshëm" janë 'sasitë' e nivelit të lartë të presionit që lidhen me objektet si numri i pikave të shkarkimit, numri i hidrocentraleve ose pikave të nxjerrjes së ujit për qëllime bujqësore, gjatësia e trupave ujorë të prekur, numri i instalimeve pa leje, etj. Këto duhet të jenë lehtësisht të përcaktueshme edhe në rastin e funksionimit aktual të kufizuar të Kadastrës, bazuar në shqyrtimet e dokumentacionit ose inspektimet e shpejta në terren.

"Treguesit precizë" në përputhje me WISE 2016 kërkojnë matje dhe raportim sektorial tejet të përmirësuar krahasuar me ato të dhëna aktualisht në dispozicion përmes KKBU-së, veçanërisht lidhur me matjen e parametrit të mbetjeve të lëngëta pas trajtimit dhe volumeve të prurjes së lumit. Këto tabela janë plotësuar pjesërisht, aty ku ka të dhëna të disponueshme, dhe ndodhen në Shtojcën Teknike IV.

Tabela 10-1 – Llojet dhe Treguesit Standardë të Presionit, Lloji 1 deri në 3

Presioni Sektorial	Kodi [166]	Lloji A Treguesi i përgjithshëm [167]	Lloji B Treguesi preciz [168]
	1	**Presionet e ndotjes pikësore**	
Ujërat e ndotura urbane	1.1	Nr. i pikave të shkarkimit që nuk i kanë arritur objektivat	Reduktimi i ngarkesës së Bod/N/P (T/Vit)
Daljet nga shtrati për shkak të uiërave urbane të	1.2	Nr. i pikave të shkarkimit që nuk i kanë arritur objektivat	Reduktimi i volumit të ujërave të shiut
Industria - Impiantet DEI	1.3	Nr. i zonave që nuk i kanë arritur objektivat	Reduktimi i ngarkesës së BOD/NH_4/SP (t/vit)
Industria – Impiantet jo DEI	1.4	Nr. i zonave që nuk i kanë arritur objektivat	Reduktimi i ngarkesës së BOD/NH_4/SP (t/vit)

[165] Në shumë raste, në basenet lumore në Shqipëri, numri i pikave të monitorimit është i pamjaftueshëm për të mbuluar të gjithë trupat ujorë të përvijuar. Për rrjedhojë, presionet dhe statusi i trupave ujorë të pamonitoruar duhet të supozohet.

[166] Klasifikimi bazuar në elementin e skemës së raportimit WISE 2016 GIS, *Llojet e Presionit Domethënës në US; Llojet e Presionit Domethënës në UN*

[167] Treguesit e Përgjithshëm duhen interpretuar si numri/gjatësia e instalimeve/pikave/objekteve që supozohet se kanë ndikim negativ. a) Lejet ose nuk ekzistojnë, ose nuk janë respektuar b) Lejet janë të pamjaftueshme për sa i përket VKE-ve dhe/ose SCM-ve.

[168] Treguesit Precizë duhen interpretuar si reduktim sasie që nevojitet për arritjen e objektivave mjedisore, shprehur zakonisht në tonë/vit, Mm^3/vit, orë/vit.

Zonat e kontaminuara	1.5	Nr. i zonave që nuk i kanë arritur objektivat	Reduktimi i ngarkesës në SP/SPBU (t/vit)
Asgjësimi i mbetjeve në lendfill	1.6	Nr. i zonave që nuk i kanë arritur objektivat	Reduktimi i ngarkesës në SP/SPBU (t/vit)
Largim i ujërave nga miniera	1.7	Nr. i zonave që nuk i kanë arritur objektivat	Reduktimi i ngarkesës në SP/SPBU (t/vit)
Fermat e peshkut Akuakulturë	1.8	Nr. i zonave që nuk i kanë arritur objektivat	Reduktimi i ngarkesës së BOD/NH4/PO4 (t/vit)
Të tjera të paspecifikuara	1.9		
	2	**Presionet e ndotjes së shpërndarë**	
Vërshimet urbane	2.1	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Reduktimi i ngarkesës në SP/SPBU (t/vit)
Vërshimet nga bujqësia	2.2	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Reduktimi i ngarkesës së N/P (t/vit)
Vërshimet nga pylltaria	2.3	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur	Reduktimi i ngarkesës së N/P (t/vit)
Autostrada/Transporti	2.4	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur	Reduktimi i ngarkesës së PM/NO2/RBSP
Zonat e braktisura	2.5	Nr. i zonave që nuk i kanë arritur	Reduktimi i ngarkesës në SP/SPBU
Mbetjet e shpërndara	2.6	Nr. i zonave që nuk i kanë arritur	Reduktimi i ngarkesës në SP/SPBU
Depozitat atmosferike	2.7	Ujëmbledhësit që nuk i kanë arritur	Reduktimi i ngarkesës së PM/NO2
Kontaminimi nga minierat	2.8	Nr. i zonave që nuk i kanë arritur	Reduktimi i ngarkesës në SP/SPBU
Akuakulturë	2.9	Nr. i zonave që nuk i kanë arritur	Reduktimi i ngarkesës së BOD/NH4/PO4
Të tjera të paspecifikuara	2.10		
	3	**Nxjerrja e prurjes/presionet e devijimit**	
Bujqësia	3.1	Nr. i pikave të nxjerrjes	Volumi që do të reduktohet (Mm^3/vit)
Ujësjellësi Publik	3.2	Nr. i pikave të nxjerrjes	Volumi që do të reduktohet (Mm^3/vit)
Industria	3.3	Nr. i pikave të nxjerrjes	Volumi që do të reduktohet (Mm^3/vit)
Energji, Ujë ftohës	3.4	Nr. i pikave të nxjerrjes	Volumi që do të reduktohet (Mm^3/vit)
Hidroenergjetika	3.5	Nr. i pikave të nxjerrjes	Volumi që do të reduktohet (Mm^3/vit)
Fermat e peshkut	3.6	Nr. i pikave të nxjerrjes	Volumi që do të reduktohet (Mm^3/vit)
Të tjera	3.7	Nr. i pikave të nxjerrjes	Volumi që do të reduktohet (Mm^3/vit)

Tabela 10-2 – Llojet dhe Treguesit Standardë të Presionit, Lloji 4 deri në 8

Presioni Sektorial	Kodi [169]	Lloji A Treguesi i përgjithshëm	Lloji B Treguesi preciz
	4	**Presionet morfologjike**	
Veprat e mbrojtjes nga përmbytjet	4.1.1	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Km e strukturave që nuk i kanë arritur objektivat
Bujqësia	4.1.2	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Km e strukturave që nuk i kanë arritur objektivat
Lundrimi	4.1.3	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Km e strukturave që nuk i kanë arritur objektivat
Modifikime të tjera	4.1.4	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Km e strukturave që nuk i kanë arritur objektivat
Strukturat hidroenergjetike	4.2.1	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Km e strukturave që nuk i kanë arritur objektivat

[169] Klasifikimi bazuar në elementin e skemës së raportimit WISE 2016 GIS, *Llojet e Presionit Domethënës në US; Llojet e Presionit Domethënës në UN*

Strukturat e mbrojtjes nga përmbytjet	4.2.2	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Km e strukturave që nuk i kanë arritur objektivat
Strukturat bashkiake	4.2.3	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Km e strukturave që nuk i kanë arritur objektivat
Strukturat e ujitjes	4.2.4	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Km e strukturave që nuk i kanë arritur objektivat
Strukturat Rekreative	4.2.5	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Km e strukturave që nuk i kanë arritur objektivat
Strukturat e industrisë	4.2.6	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Km e strukturave që nuk i kanë arritur objektivat
Strukturat e lundrimit	4.2.7	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Km e strukturave që nuk i kanë arritur objektivat
Struktura të tjera	4.2.8	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Km e strukturave që nuk i kanë arritur objektivat
	4	**Presionet hidromorfologjike**	
Bujqësia	4.3.1	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur	Indeksi i modifikimit të prurjes
Transporti	4.3.2	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur	Indeksi i modifikimit të prurjes
Hidroenergjetika	4.3.3	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur	Indeksi i modifikimit të prurjes
Uji i bashkisë	4.3.4	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur	Indeksi i modifikimit të prurjes
Akuakulturë	4.3.5	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur	Indeksi i modifikimit të prurjes
Aktivitete të tjera	4.3.6	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur	Indeksi i modifikimit të prurjes
Humbja e habitatit	4.4	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur	Humbja e habitatit në km2
Modifikime të tjera	4.5		
	5	**Bujqësia dhe presionet**	
Llojet invazive	5.1	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur	Nr. i llojeve invazive
Shfrytëzimi i llojeve	5.2	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur	Nr. i pikave të regjistruara
Tarifat e mbetjeve të ngurta	5.3	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur objektivat	Nr. i pikave të regjistruara
	6	**Presionet e ujërave nëntokësore**	
Rimbushja e ujërave	6.1	Nr. i TUN-ve të ndikuara nga rimbushja	Volumi i rimbushjes për t'u
Volumi i ujërave	6.2	Nr. i pikave të nxjerrjes	Volumi i shfrytëzimeve për t'u
	7-8	**Presione kimike dhe të ndryshme**	
Presione të tjera	7	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur	Siç kërkohet
SP i panjohur	8	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur	Reduktimi i ngarkesës së SP
SPBU i panjohur	8	Km e trupave ujorë që nuk i kanë arritur	Reduktimi i ngarkesë së SPBU

10.3.3 Lista Standarde e Numeracionit të Llojeve të Ndikimit

Tabela 10-3 riprodhon Shtojcën 1b të kërkesave të raportimit WISE 2016, për sa i përket ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore[170]. Identifikimi i presioneve që gjejnë zbatim për trupin ujor duhet të përcaktojë edhe llojin më të përshtatshëm të ndikimit. Një presion i vetëm mund të ketë disa ndikime. Për shembull, hidrocentrali mund të dëmtojë temperaturat e ujit në rrjedhën e poshtme, morfologjinë e habitatit dhe regjimin e rrjedhës.

Tabela 10-3 – Llojet Standarde të Ndikimeve

Lloji i Ndikimit	Ujërat përkatëse sipërfaqësore	Ujërat përkatëse nëntokësore
Ndotja me lëndë ushqyese	Y	Y
Ndotja Organike	Y	Y
Ndotja Kimike	Y	Y

[170] WISE 2016 GIS elementi i skemës së raportimit: <Llojet e Ndikimit të Konsiderueshëm në US>, <Llojet e Ndikimit të Konsiderueshëm në UN>

Ndërhyrja e ujrave të kripura	Y	Y
Acidifikimi	Y	N
Temperaturat e larta	Y	N
Habitatet e shndërruara për shkak të ndryshimeve hidrologjike	Y	N
Habitatet e shndërruara për shkak të ndryshimeve morfologjike (përfshirë lidhjen)	Y	N
Hedhja e mbeturinave (ndikimi sipas MSFD)	Y	N
Ndotja mikrobioliogjike	Y	Y
Zvogëlimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore të ndërlidhura për arsye kimike/sasiore	N	Y
Dëmtimi i ekosistemeve tokësore të varura nga ujërat nëntokësore për arsye kimike/sasiore	N	Y
Ndryshimet në drejtimet e rrjedhës që rezultojnë në depërtimin e ujit të kripur	N	Y
Nxjerrja e ujit tejkalon burimin e disponueshëm GW (ulja e nivelit të ujit)	N	Y
Ndikime të tjera të rëndësishme	Y	Y

10.4 Presionet e Trupit Ujor Sipërfaqësor dhe Vështrim i Përgjithshëm i Vlerësimit të Statusit

10.4.1 Vlerësimi i Presioneve në Nivel Nënbaseni

Për qëllimet e politikës së përgjithshme dhe fokusit rregullator (p.sh lejet), në tabelat e Shtojcës Teknike IV (treguesit e përgjithshëm dhe precizë) paraqitet një Përmbledhje e dobishme e presioneve në vijim të listës Tabela 10-1 dhe Tabela 10-2. Aty ku KKBU-ja nuk ka të dhëna, treguesit nuk raportohen. Përmirësimet lidhur me mbledhjen e të dhënave për objektivat mjedisore janë masë kyç për pjesën më të madhe të Programit të Masave (PiM).

Matrica në këto tabela (ku vlerat e raportuara janë reflektim direkt i shkallës së presioneve potenciale) e ndihmon Autoritetin Kompetent që të përdorë një qasje bazuar në risk, pra të identifikojë zonat me prioritet për hetim ose rregullim më shtrëngues. “Treguesit precizë” në përputhje me WISE 2016 kërkojnë matje dhe raportim sektorial tejet të përmirësuar krahasuar me ato të dhëna aktualisht në dispozicion nëpërmjet KKBU-së, veçanërisht lidhur me matjen e parametrit të mbetjeve të lëngëta pas trajtimit dhe volumeve të prurjes së lumit.

Nxjerrjet dhe presionet hidroenergjetike janë marrë nga “Regjistri i Lejeve të Ujit” të AMBU-së dhe paraqiten në Shtojcën Teknike III. Regjistri nuk është ende plotësisht i përditësuar ose i koordinuar në mënyrë të saktë në shumë raste. Kur ka të dhëna, nxjerrjet përfshijnë pikat e shfrytëzimeve të mëdha të ujit për ujitje, ndonëse statusi operacional për shumë pika nxjerrjeje për ujitje ende nuk është identifikuar nga AMBU.

Edhe të dhënat për shkarkimet e ujërave të ndotura janë të paplota; pikat e shkarkimeve të mbetjeve të lëngëta industriale pas trajtimit merren kryesisht nga regjistri i lejeve që mbahet nga autoriteti kompetent, pra AKM-ja. Megjithatë, ndikimin kryesor në cilësinë e ujit të lumit duket se e kanë ujërat e ndotura urbane bashkiake, dhe aktualisht nuk ekziston asnjë regjistër për këto pika shkarkimi bashkiake specifike me koordinata precize. Për pasojë, niveli i përgjithshëm i ndotjes nga ujërat e ndotura urbane duhet të përcaktohet duke u nisur nga numri i pikave të regjistruara të shkarkimit të ujërave të ndotura (Treguesit 1.1, 1.2, 1.3 të Vlerësimi i presioneve dhe statusi si rezultat i këtij vlerësimi janë themelore për të kuptuar dhe vlerësuar nga ana sasiore hendeqet midis objektivave mjedisore dhe gjendjes aktuale të trupave ujorë në basenin ujor. Vlerësimi ndërthur kriteret analitike dhe përshkruese, në varësi të nivelit të të dhënave në dispozicion.

Vlerësimi i statusit të trupit ujor është një ushtrim i vështirë krahasuar me standardet provizore bazuar në një model të vetëm analitik. Vlerësimi i presioneve është më kompleks sepse presionet janë zakonisht më abstrakte dhe më të vështira për t’u vlerësuar në sasi dhe/ose presionet e ndryshme kombinohen në mënyra komplekse

për të ndikuar në statusin e trupit ujor. Vlerësimi sasior i presioneve, ndonëse i realizueshëm, kërkon të dhëna të konsiderueshme cilësore, shumë prej të cilave nuk mblidhen aktualisht në Shqipëri.

Vërehet se shumë prej "treguesve të presionit" kërkojnë që të raportohet një sasi e volumit, ose si pjesë e llogaritjes së përafërt të ngarkesës së ndotësve, ose si pjesë e ndikimit të prurjes ekologjike. Treguesit kuptimplotë të presionit nuk mund të përcaktohen për shkak të shkatërrimit tërësor të rrjetit kombëtar hidrometrik, mungesës së të dhënave hidrologjike të përdorshme të kohëve të fundit dhe mungesës së konsiderueshme të të dhënave për volumet e mbetjeve të lëngëta pas trajtimit të monitoruara nga institucionet dhe industritë.

Për të përmirësuar politikëbërjen mjedisore dhe për të identifikuar "pikat e nxehta mjedisore" që mund të kërkojnë rregullore më strikte (përmes kushteve të lejes dhe zbatimit) nevojitet një lloj indeksimi sasior i presionit. Tabela 10-1 dhe 10-2 paraqesin dy grupe treguesish për presionin, të cilat janë që të dyja në përputhje me skemën e raportimit WISE 2016.

"Treguesit e përgjithshëm" janë 'sasitë' e nivelit të lartë të presionit që lidhen me objektet si numri i pikave të shkarkimit, numri i hidrocentraleve ose pikave të nxjerrjes së ujit për qëllime bujqësore, gjatësia e trupave ujorë të prekur, numri i instalimeve pa leje, etj. Këto duhet të jenë lehtësisht të përcaktueshme edhe në rastin e funksionimit aktual të kufizuar të Kadastrës, bazuar në shqyrtimet e dokumentacionit ose inspektimet e shpejta në terren.

"Treguesit precizë" në përputhje me WISE 2016 kërkojnë matje dhe raportim sektorial tejet të përmirësuar krahasuar me ato të dhëna aktualisht në dispozicion përmes KKBU-së, veçanërisht lidhur me matjen e parametrit të mbetjeve të lëngëta pas trajtimit dhe volumeve të prurjes së lumit. Këto tabela janë plotësuar pjesërisht, aty ku ka të dhëna të disponueshme, dhe ndodhen në Shtojcën Teknike IV.

Tabela 10-1).

Presionet fizike janë konsideruar për të përfshirë ndryshimet e konsiderueshme të morfologjisë së lumit për shkak të pikave të marrjes së inerteve të lumit ose modifikimeve të kanalit për qëllime bujqësore, të mbrojtjes nga përmbytja ose të ndërhyrjeve rregulluese.

Presionet kimike përfshijnë pikat e nxehta të ndotjes (vendgrumbullimet e mbetjeve të ngurta dhe mbetjet kimike) dhe aktivitetet minerare. Të gjithë Trupat Ujorë Tepër të Modifikuar (TUTM) ushtrojnë një farë presioni fizik në ekosistemet lumore, ndaj TUTM-të paraqiten edhe në Harta 10-2.

10.4.2 Metodologjia e Përcaktimit të Statusit në Nivelin e Trupit Ujor

Tabela 10-4 deri në Tabelën 10-9 përmbledhin përcaktimin e statusit për të gjithë trupat ujorë të basenit Ishëm (Shtojca XIII). Procedura e përgjithshme paraqitet në seksionin 3.3. Në 2021-shin, u realizua monitorimi i vetëm biologjik i të gjithë trupave ujorë dhe vlerësimi paraprak i statusit ekologjik.

Metoda paraprake për vlerësimin e të dhënave biologjike u bazua në indeksin ASPT (Pikët Mesatare për Takson). Ky indeks u publikua në 1982-shin nga Armitage etj. dhe u përdor më vonë në shumë vende. Indeksi bazohet te vlera treguese ekologjike duke përdorur familjet e jovertebrorëve të mëdhenj. Për të vlerësuar trupat ujorë në lumin Ishëm u desh që të bëhej një përshtatje në llogaritjen e këtij indeksi: në vend që të përdorej vetëm prania/mungesa e familjeve, u mor parasysh edhe sasia e tyre (numri i individëve). Për të shmangur peshën e sasive tepër të larta, variablat transformohen në formë logaritmike. Metoda shpjegohet më hollësisht në raportin për kampionimin biologjik të lumenjve në 2021-shin (shihni Shtojcën Teknike V). Sugjerohet që kjo metodologji të përdoret gjatë viteve të ardhshme për vlerësimin e statusit ekologjik të lumenjve, duke përdorur jovertebrorët e mëdhenj. Për vlerësimin e statusit hidromorfologjik, u përdor metodologjia britanike (shihni Shtojcën Teknike VI).

Sikurse nënvizohet edhe në kapitujt 3 dhe 8: ka mungesë të theksuar të të dhënave sistematike e të përditësuara për monitorimin rutinë, të nevojshme për kryerjen e vlerësimeve të statusit të trupave ujorë sipërfaqësorë në përputhje me DKU-në. Për pasojë, në publikimin e parë të PMBU-së për Shqipërinë (2024-2029), pjesa më e madhe e vlerësimeve të statusit të trupave ujorë janë kryer në bazë të 'të dhënave dhe informacioneve të disponueshme më të mira' (shihni Shtojcat Teknike).

Duke qenë se cilësia e të dhënave është thelbësore për metodologjinë e statusit, është e nevojshme që të raportohet për "nivelin e besueshmërisë" (NB) së vlerësimit të statusit.[171] Niveli i ulët i besueshmërisë dhe i saktësisë së të dhënave mund të jetë tregues i riskut të keqklasifikimit, ndaj NB-ja tregon besueshmërinë e vlerës së statusit. Udhëzimi WISE 2016 sugjeron klasifikimin e mëposhtëm për të treguar besueshmërinë e statusit ekologjik ose potencialin e përcaktuar:

'0' = nuk ka informacion; '1' = besueshmëri e ulët; '2' = besueshmëri mesatare; '3' = besueshmëri e lartë.

Kriteret janë si vijojnë:

I ulët = nuk ka të dhëna monitoruese, vetëm gjykimi ekspert; Mesatar = disa të dhëna që mbështesin elementin cilësor (EC) dhe të dhëna të kufizuara për një ECB; I lartë = të dhëna të mira për 1 + ECB dhe mbështetjen e EC-ve më të përshtatshme.

Lista e numeracionit për kategoritë e përdorura të "riskut" është si më poshtë vijon:

- **"Jo në risk"** (të dhënat ose gjykimi profesional tregojnë se trupi ujor ka shuma gjasa që të mos jetë në risk); Statusi mund të jetë 1 ose 2.
- **"Me gjasa në risk"** (të dhënat ose gjykimi profesional tregojnë se TU-ja është në kufi, pra në statusin 2 ose 3).
- **"Në risk"** (duke u bazuar në të dhënat FIZIKO-KIMIKE ose në presionin e konsiderueshëm, jemi të sigurt se TU-ja nuk është në status të mirë ose mesatar. Prandaj, statusi duhet të jetë 4 ose 5.

'"I panjohur" duhet përdorur kur nuk kemi asnjë të dhënë dhe kur presionet e konsiderueshme duken të mundshme. Statusi mund të jetë 2 ose 3. Që të jetë 4 ose 5, duhet të kemi të dhëna.

10.4.3 Llojet e Përjashtimit për Trupat Ujorë Tepër të Modifikuar

Objektivi kryesor i DKU-së është që TUTM-të/TUA-të të kenë më tepër potencial të mirë ekologjik sesa status të mirë ekologjik. Nevojitet informacion shtesë për përcaktimin dhe raportimin e TUA-ve dhe TUTM-ve për të arsyetuar disa raste përjashtimore nga objektivat mjedisore, të përcaktuar në nenin 4(2) deri në 4(7) të DKU-së, në mënyrë që të lejohet vijimi i këtyre përdorimeve të specifikuara (të cilat sjellin përfitime të mëdha sociale dhe ekonomike), por në të njëjtën kohë të nxiten edhe masat zbutëse që sjellin përmirësimin e cilësisë së ujit.[172]

10.5 Presionet e Ujërave Sipërfaqësore dhe Përmbledhja Kryesore e Statusit

10.5.1 Vështrim i përgjithshëm

Tabela 10-4 deri në Tabelën 10-9 paraqesin një prej rezultateve kryesore të PMBU-së së basenit të lumit Ishëm, përkatësisht regjistrin përfundimtar të trupave ujorë të përvijuar, presionet e mundshme, llogaritjen e përafërt të statusit të trupit ujor dhe vlerësimin e trupave ujorë që rrezikojnë të mos i përmbushin objektivat mjedisore, të paraqitur në Shtojcën XIII të kësaj PMBU-je.

Për përcaktimin e statusit zbatohen aktivitete të shumta. Nxitësit e përgjithshëm të përshkruar në Kapitullin 4, karakterizimi dhe përvijimi (Kapituj 5, 6, 7), rezultatet e monitorimit dhe të dhënat (Kapitulli 8), dhe ndikimet e mundshme nga strategjitë e lidhura (Kapitulli 9).

Tabela 10-9 përfshin trupat ujorë artificialë (TUA) dhe trupat ujorë tepër të modifikuar (TUTM), pasi procesi i përcaktimit të objektivave për TUTM-të dhe TUA-të duhet të jetë në të njëjtën linjë me parimet e përgjithshme që zbatohen për trupat ujorë natyrorë (përvijimi, presionet, elementet e statusit). Ndryshimi kryesor është se TUA-të/TUTM-të vlerësohen si të lidhura me kushtet e referencës të "potencialit ekologjik maksimal" (PEM) (shihni seksionet 3.3.6 & 10.5).

Shpesh, mënyra se si duhen klasifikuar rezervuarët nuk është shumë e qartë. Udhëzimi GIS i DKU-së sugjeron se rezervuarët e krijuar nga ndërtimi i digave në lumenj duhen klasifikuar si trupa ujorë lumorë tepër të modifikuar (por njëkohësisht duhet marrë parasysh diferencimi i tipologjisë dhe elementet e zbatueshme të cilësisë


[171] Udhëzimi i WISE GIS 2016 – Skema: TUS; elementi i skemës *<Besueshmëria Ekologjike e US>*

[172] Komisioni Evropian, Dokumenti Udhëzues i CIS-it 20, Përjashtimet nga Objektivat Mjedisore

mjedisore (ECM), në përputhje me përshkruesit e çdo kategorie të ujërave sipërfaqësore natyrore me të cilën TUA-ja ose TUTM-ja ngjason më tepër p.sh. liqenet). Kjo nuk është qasje logjike dhe në skemën e raportimit WISE pranohet që rezervuarët të klasifikohen në kategorinë e liqenit, me kusht që të jetë përmbushur elementi i skemës së raportimit <Rezervuar>. Kjo është qasja e përdorur në klasifikimin shqiptar.

Përqindjet e trupave ujorë në basenin ujor të Ishmit, të cilëve iu janë caktuar statuse të niveleve të ndryshme, paraqiten në Figurën 10-1. 79% e 23 trupave ujorë lumorë janë identifikuar si në risk për të mos i përmbushur objektivat mjedisore (status më i ulët se "I mirë") në kategorinë e "Lumenjve, TUTM-ve dhe Ujërave Kalimtare". Megjithatë, kjo përqindje shkon në 85% nëse si njësi matjeje merret gjatësia e trupit ujor, ku vetëm 15% të gjatësisë së trupit ujor gëzon status të mirë ose më lart. Gjatësia totale e trupave ujorë lumorë dhe të përkohshëm në basenin e Ishmit është 190.4 km.


Figura 10-1 – Përqindjet e trupave ujorë të përvijuar në varësi të niveleve të statusit



Statusi i trupit ujor sipas gjatësisë duhet të jetë njësia matëse më e preferuar, pasi kjo mënyrë matjeje e pasqyron më me saktësi ndikimin e përgjithshëm ekologjik të presioneve.

Përqindjet e trupave ujorë në basenin ujor të Ishmit, të cilëve iu janë caktuar statuse të niveleve të ndryshme, paraqiten në Figurën 10-2. 13 trupa ujorë sipërfaqësorë janë identifikuar si në risk për të mos i përmbushur objektivat mjedisore (status më i ulët se "I mirë") në kategorinë e "lumenjve, TUTM-ve dhe ujërave të përkohshme", 4 trupa ujorë sipërfaqësorë janë identifikuar si "potencialisht në risk", e trupa ujorë janë identifikuar si "Jo në risk" dhe 3 trupa ujorë sipërfaqësorë kanë status "Të panjohur" pasi nuk ka të dhëna. Nivelet e larta të trupave ujorë në gjendje të dobët ose të keqe pasqyrojnë nivelin e lartë të presioneve të ujërave të ndotura bashkiake dhe të ndikimeve të pakontrolluara morfologjike të nxjerrjes së zhavorrit.

Figura 10-2 – Përqindjet e TUTM-ve të përvijuar në varësi të niveleve të statusit



Lidhur me kategoritë e "liqeneve", thuajse nuk ka fare të dhëna për sa u përket aktiviteteve që ndikojnë në cilësinë e ujërave dhe nuk ka të dhëna lidhur me monitorimin e cilësisë së ujërave; Aktualisht, liqenet nuk monitorohen në mënyrë të vazhdueshme nga AKM-ja. Të dhënat e kufizuara lidhur me trupin ujor të Bovillës janë grumbulluar në sajë të vizitave në terren në kuadër të projektit. Mungesa e të dhënave lidhur me këtë kategori e pengon vlerësimin e duhur të riskut, ndaj statusi i përgjithshëm i trupit ujor të Bovillës identifikohet si "potencialisht në risk" dhe për trupat ujorë të tjerë liqenorë identifikohet si "i panjohur". Nuk mund të bëhet asnjë interpretim për trupat ujorë bregdetarë pasi AKM-ja nuk merr kampione uji për zona me gjerësi 1 milje (1.8 km) detare. Statusi i përgjithshëm i trupit ujor bregdetar të Ishmit klasifikohet si "I panjohur".

10.5.2 Trupat ujorë më "në risk"

Ky seksion shtjellon më tej supozimet që qëndrojnë pas përcaktimit të presioneve dhe statusit potencial të mundshëm të trupave ujorë individualë të cilët konsiderohen si "në risk për të mos i përmbushur objektivat mjedisore", që kërkojnë monitorim shtesë, zbatim të politikave të përgjithshme (Kapitulli 12), ose masa më të specifikuara (Kapitulli 13) në mënyrë që këta trupa ujorë të arrijnë "Statusin e Mirë". Është më se e qartë se statusi i përgjithshëm i pjesës më të madhe të trupave ujorë rrjedh nga të dhëna tejet të kufizuara për ''Elementet e Cilësisë'' (EC) individuale, të cilat janë kryesisht fiziko-kimike. Për pasojë, niveli i besueshmërisë (NB) ka një shkallë të lartë pasigurie. Supozimi metodologjik është se trupi ujor duhet të klasifikohet me "Status të Mirë" (klasa 2) ose "Status Shumë të Mirë" (klasa 1) vetëm nëse a) nuk ka prova për presione domethënëse në trupin ujor ose në rrjedhën e sipërme dhe b) statusi i matur i trupit ujor konfirmohet nga të dhënat për elementet e cilësisë. Për pasojë, 5 prej 23 trupave ujorë lumorë në basen u është caktuar statusi "i Moderuar" (klasa 3), pasi nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të mbështetur vlerësimin dhe duket se mund të ketë presione domethënëse që mund të ndikojnë në statusin e tyre të panjohur.

Në këta trupa ujorë të veçantë (**351411, 351423, 351425, 35146, 351482**), duhet kryer një hetim më i detajuar i presioneve të supozuara, si dhe kërkohet monitorim i mëtejshëm operacional (DKU, Shtojca V, 1.3.2) për të konfirmuar statusin e këtyre trupave ujorë. Trupat e tjerë ujorë, ku kushtet e vrojtuara dhe/ose statusi i matur janë më të sigurta, supozohet të jenë klasifikuar ose me "status të keq" (klasa 5) ose me "status të dobët" (klasa 4), (shihni Harta 10-3).

Trupi ujor **351495** – rrjedhat e sipërme të lumit të Tiranës – supozohet se aktiviteti mjaft i përhapur minerar për shfrytëzimin e zhavorrit aluvial përgjatë gjatësisë së trupit ujor ka ndikime negative në ekosistemin ujor për sa i përket morfologjisë së habitatit të lumit (presioni domethënës 4.1.4).

Trupi ujor **351491** – zonat e mesme të lumit të Tiranës – kjo pjesë e lumit të Tiranës është tejet e modifikuar për shkak të kanalizimeve në vite. Trupi ujor që kalon përmes qytetit është tepër i ndikuar nga ujërat e ndotura të patrajtuara, duke sjellë kështu nivele mjaft të larta të BOD_5 dhe të tarifave për mbetjet e ngurta (presionet domethënëse 1.1 dhe 1.2).

Trupi ujor **351487** – rrjedhat e sipërme të lumit të Lanës në skajet lindore të qytetit – ndonëse ende në formë natyrore, trupi ujor që kalon përmes qytetit është tepër i ndikuar nga ujërat e ndotura të patrajtuara, duke sjellë kështu nivele mjaft të larta të BOD_5 dhe depozitime të mbetjevet të ngurta (presionet domethënëse 1.1 dhe 1.2).

Trupi ujor **351485** – rrjedha e poshtme e **351487**, trupi ujor është tepër i kontaminuar nga ujërat e ndotura urbane të patrajtuara. Edhe kjo pjesë e lumit të Lanës është tepër e modifikuar për shkak të kanalizimeve, ndaj objektivi ekologjik për këtë trup ujor do të ishte "potenciali i mirë ekologjik" (presionet domethënëse 1.1 dhe 1.2).

Trupi ujor **351483** - për sa i përket trupave ujorë të rrjedhës së sipërme të Lanës, edhe trupi ujor **351483** është tepër i kontaminuar nga ujërat e ndotura urbane të patrajtuara, siç tregohet nga nivelet jashtëzakonisht të larta të BOD_5 (presionet domethënëse 1.1 dhe 1.2).

Trupi ujor **351481** - për sa i përket trupave ujorë të rrjedhës së sipërme të Lanës, edhe trupi ujor **351481** është tepër i kontaminuar nga ujërat e ndotura urbane të patrajtuara, siç tregohet nga nivelet jashtëzakonisht të larta të BOD_5 (presionet domethënëse 1.1 dhe 1.2).

Trupi ujor **35147 – 35147** është trupi ujor që përbëhet nga bashkimi i lumit të Tiranës dhe Lanës në qendër të qytetit. Ndonëse në formë natyrore, ujërat urbane të patrajtuara sjellin nivele mjaft të larta të BOD_5 në ujërat pritëse (presionet domethënëse 1.1 dhe 1.2).

Trupi ujor **35145** – trupi ujor i lumit Ishëm që formohet nga bashkimi i rrjedhave të sipërme të lumit të Tiranës dhe Lanës, nga Bërxulli në Rinas (rrethinat e aeroportit), zona që shtrihet në rrjedhën e sipërme të bashkimit me lumin e Tërkuzës - si rezultat i pranisë së ujërave të ndotura urbane të patrajtuara dhe shkarkimeve domethënëse industriale në rrjedhën e sipërme, këtij trupi ujor i është caktuar "Statusi i Dobët". Ka disa të dhëna që tregojnë se nivelet e BOD5, ndonëse ende mjaft të larta, janë reduktuar disi për shkak të efekteve holluese të rrjedhës (presionet domethënëse 1.1, 1.2 dhe 1.4)

Trupi ujor **351443** - zonat e mesme të Tërkuzës që ndodhen fill në rrjedhën e poshtme të rezervuarit të Bovillës - në periudhën e ndërtimit të Bovillës (1999/2000 kryesisht për furnizim me ujë të pijshëm), nuk ka pasur asnjë provë që të tregonte se janë bërë furnizime për kompensimin e prurjeve në rrjedhën e poshtme të lumit. Për pasojë, regjimi i rrjedhës mjedisore të këtij lumi, që me shumë mundësi zgjatet deri në Rinas, është kompromentuar krejtësisht. Ndryshimi fizik i trupit ujor për shkak të ndërtimit të digës tregon se trupi ka formën e TUTM-së. Supozohet se ndryshimi i regjimit të rrjedhës ka sjellë klasifikimin e këtij trupi ujor në "Statusin e Dobët" (presionet domethënëse 3.2 dhe 4.2.3). Ka shumë gjasa që për të rikthyer regjimin e duhur të nevojitet shkarkimi i një sasie të caktuar uji nga rezervuari i Bovillës.

Trupi ujor **351441** – rrjedhat e poshtme të Tërkuzës në rrethinat e Rinasit. Këtu kemi një ndërthurje të regjimit të pamjaftueshëm të rrjedhës me nivelet e larta të BOD_5 për shkak të ujërave të ndotura urbane të patrajtuara dhe presioneve të tjera të ndryshme, të cilat e klasifikojnë këtë trup ujor në kategorinë e "Statusit të Keq".

Trupi ujor **35143** - lumi kryesor i Ishmit ku derdhen rrjedhat e kombinuara të lumit të Tiranës, Lanës dhe Tërkuzës - Siç tregohet në Hartën 8-2 (pika e kampionimit S26), niveli i BOD_5 në **35143** është kryesisht 44 mg/l, dhe NH4 20 mg/l, të cilat sipas standardeve janë nivele ekstreme për lumenjtë e mëdhenj. "Statusi i Dobët" i këtij trupi ujor bazohet kryesisht në vlerat fiziko-kimike, të cilat janë prodhuar kryesisht nga shkarkimet e drejtpërdrejta të trupave ujorë në rrjedhën e sipërme. Duke qenë se 35143 është rrjedhë ujore "e kombinuar", trajtimi i ujërave të ndotura në rrjedhën e sipërme mund të sjellë përmirësimin e statusit të trupit ujor pa pasur nevojën e marrjes së masave të drejtpërdrejta për atë trup ujor (presionet 1.1, 1.2 dhe 1.4).

Trupi ujor **351422** – degët e vogla ushqyese të përroit të Zezës që derdhet në zonën e Fushë-Krujës – krahas ujërave të ndotura urbane, kjo zonë dominohet nga aktiviteti minerar për nxjerrjen e gurit gëlqeror dhe prodhimin e çimentos. (Presioni domethënës 1.4)

Trupi ujor **351413** - zona fundore e rrjedhës së sipërme të Ishmit e trupit ujor të përkohshëm 351411 - trupi ujor kalon përmes tokave bujqësore të Bilajt dhe Gramëzës, të cilat janë burime mjaft të rëndësishme të ujërave nëntokësore. Supozohet se presionet më të rëndësishme lokale janë ato të ndotjes së shpërndarë nga praktikat bujqësore dhe të nxjerrjes së ujit direkt nga ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore për ujitje. Megjithatë, Harta 8-2 e fushatës së monitorimit të vitit 2019 tregon se ka nivele mjaft të larta të BOD_5 dhe NH_4 (përkatësisht 34 mg/l dhe 19 mg/l), të cilat janë që të dyja treguese të ujërave të ndotura urbane të patrajtuara, prandaj 'Statusi i Dobët' i këtij trupi ujor ndikohet kryesisht nga nivelet e larta të ujërave të ndotura urbane në rrjedhën e sipërme të trupit ujor. Ka edhe disa prova për praninë e hollimit natyror për shkak të prurjes, pasi nivelet e BOD_5 janë më të ulëta krahasuar me ato në rrjedhën e sipërme. Presionet e rëndësishme janë 2.2 dhe 4.2.4.

10.5.3 Programi i Monitorimit të Ujërave Sipërfaqësore

Për të vlerësuar magnitudën e presioneve, Shtetet Anëtare duhet të monitorojnë ato elemente të cilësisë që janë tregues të atyre presioneve të cilave u nënshtrohen trupat ujorë të përvijuar. Për të vlerësuar ndikimin e këtyre presioneve, Shtetet Anëtare duhet të monitorojnë:

- Parametrat tregues të elementeve të cilësisë biologjike, ose elementet me ndjeshmërinë më të madhe ndaj presioneve të cilave u nënshtrohen trupat ujorë
- Të gjitha substancat prioritare të shkarkuara, si dhe ndotësit e tjerë që shkarkohen në sasi të konsiderueshme
- Parametrat tregues të elementit të cilësisë hidromorfologjike me ndjeshmërinë më të madhe ndaj presioneve të identifikuara.

Tabela 10-4 deri në Tabelën 10-9 të Shtojcës XIII paraqesin arsyet kryesore të supozuara për mosarritjen e objektivave mjedisore si presionet e cilësisë së ujit, presionet e sasisë së ujit (përfshi nxjerrjen dhe regjimin e prurjeve), si dhe presionet morfologjike (përfshi kanalizimet e shtratit, shfrytëzimin e zhavorrit dhe pengesat fizike). Në shumë raste, për shkak të mungesës së monitorimit në masë të mjedisit, arsyet për mosarritjen e objektivave mund të bazohen fillimisht te gjykimi i ekspertit ose shqyrtimi i dokumentacionit. Mungesa e sigurisë në vlerësimin e statusit reflektohet edhe në nivelin e besueshmërisë (NB). Niveli i besueshmërisë 0 ose 1 tregon se nuk ka të dhëna të disponueshme për trupin ujor nën vlerësim. Në këtë rast, sipas kërkesave të DKU-së, Shtojca V, 1.3.2 ose 1.3.3, mund të nevojitet që gjatë periudhës së zbatimit të PMBU-së (2024-2029) të kryhet monitorimi shtesë afatshkurtër (monitorimi operacional ose monitorimi investigativ), për të përcaktuar më me

saktësi vlerat e sakta të elementeve të ndryshëm të cilësisë, me qëllim konfirmimin e vlerësimit të presionit dhe statusit. Programi i monitorimit të ujërave sipërfaqësore detajohet në Shtojcën Teknike IX. Ky program nuk i ofron të gjitha kapacitetet ekzistuese të monitorimit, ndonëse supozohet se përmban disa dispozita shtesë:

Elementet e përgjithshme të cilësisë fiziko-kimike:

- AKM-ja do të monitorojë më tepër pika, të paktën për një kohëzgjatje tre vjeçare.
- Disa pika ekzistuese do të monitorohen më shpesh nga AKM-ja.

Përfshirja e monitorimit sistematik të elementeve të mëposhtme të cilësisë hidrobiologjike:

- Kategoria Lumenjtë: fauna bentike jovertebrore.
- Kategoria Liqenet: fitoplanktoni.

Përfshirja e monitorimit sistematik të elementeve të mëposhtme të cilësisë morfologjike:

- Luhatjet e thellësisë dhe gjerësisë së lumit, struktura dhe nënshtresa e shtratit të lumit.

Nuk është e nevojshme që trupat ujorë, të cilët nuk i arrijnë objektivat, të monitorohen që të gjithë në mënyrë individuale, pasi kjo gjë do të shoqërohej me kosto mjaft të larta. Në vend të kësaj, mund të kryhet planifikimi strategjik i monitorimit të konsoliduar në mënyrë të tillë që të jetë mjaftueshëm tregues i grupimeve të trupave ujorë, duke supozuar se këta trupa ujorë të grupuar u nënshtrohen po të njëjtave presioneve të ngjashme në zonat kontribuese. Monitorimi i konsoliduar nuk është masë në vetvete, por synon të shërbejë si bazë e mëtejshme për ngritjen e programit të masave për arritjen e objektivave mjedisore dhe të masave specifike të nevojshme për korrigjimin e efekteve të ndotjes aksidentale. Megjithatë, në këtë fillim të kuadrit të ri të PMBU-së, për shkak të pikave të dobëta të programeve të monitorimit dhe mungesës së theksuar të të dhënave mjedisore në përgjithësi, shihet e arsyeshme që përmirësimet specifike dhe të shënjestruara të monitorimit të shënohen si pjesë e PM-së. Në këtë kontekst, MLIK-ja përkatëse që mbulon monitorimin e përforcuar është MLK-ja 14 “Përforcimi i bazës së njohurive për reduktimin e pasigurive” (referojuni edhe tabelave në Shtojcës Teknike IX).

Tabela 10-4 – Presionet dhe Analiza e Statusit – Lumenjt

IDENTIFIKIMI			ANALIZA PRESIONEVE [173]								STATUSI I PËRGJITHSHËM ose POTENCIALI						VLERËSIM I I RISKUT	
EMRI I TU	KODI I TU	FORMA	PRESIONE PIKËSORE 1	PRESIONE PIKËSORE 2	PRESIONE TË SHPËRNDARA 1	PRESIONE TË SHPËRNDARA 2	PRESIONE TË NXJERRJES 1	PRESIONE TË NXJERRJES 2	PRESIONE MORFOLOGJIKE	PRESIONE HIDROMORFOLOGJIKE	ECB [174]	FIZ-KIM [175]	H-MORF [176]	ANEKSI X SP [177]	ANEKSI VIII RBSP	STATUSI I PËRGJITH	NIVELI I RISKUT [178]	VR [179]
Ishem	351413	Natural	1.3	1.4	-	**2.2**	3.1	-	**4.2.4; 4.1.4**	4.5; 5.3	5	4	2	-	-	4	Në risk	2
Zeze	351421	Natural	1.3	-	2.2	2.6	-	-	4.1.2	4.3.2; 4.5	4	2	2	-	-	2	Jo në risk	1
Zeze	351422	Natural	1.3	**1.4**	2.2	2.6; 2.8	-	-	4.1.2 ;4.1.4	4.5; 5.3	4	1	2	-	-	4	Në risk	1
Zeze	351423	Natural	1.1;1.3	1.4	2.2	2.6	-	-	-	4.5	5	3	3	-	-	3	Ndoshta	1
Zeze	351425	Natural	-	-	2.2	2.6	3.1	-	4.1.4; 4.2.4	4.5	3	1	1	-	-	3	Ndoshta	1
Zeze	351427	Natural	-	-	2.2	-	3.1	-	4.2.4	-	1	1	1	-	-	1	Jo në risk	1
Ishem	35143	Natural	**1.1;1.3**	**1.4**	2.2	2.6; 2.8	-	-	4.1.2		5	4	1	-	-	4	Në risk	1
Terkuza	351441	Natural	1.3	1.4	2.2	2.6; 2.8	3.1	-	4.2.4; 4.1.4	4.3.4; 4.3.2; 4.5; 5.3	4	5	3	-	-	5	Në risk	1

173 Llojet e presionit përputhen me Udhëzuesin e Raportimit të WISE GIS 2016 – Shtojca 1a

174 Koment mbi metodën BQE

175 Koment mbi të dhënat P-CHEM – Vlerësimi i statusit P-CHEM bazuar kryesisht në kampionimin në vend të korrikut 2019, duke përdorur vlerat BOD5 dhe/ose NH4 si vlera treguese.

176 Koment mbi metodologjinë H-MORPH – MORFOLOGJIA tregon pengim të konsiderueshëm të rrjedhave ujore ose ndryshime në morfologjinë e lumenjve për shkak të ndryshimeve fizike ose minerare; HYDROMORPH tregon ndryshim të rëndësishëm në regjimin e rrjedhës për shkak të abstraksioneve komunale, ujitëse ose hidrocentrale;


177 Substancat prioritare nëse monitorohen

178 Lista e numërimit për rrezik = Jo në rrezik; Ne rrezik; Mundësisht në rrezik; E panjohur;


179 Lista e numërimit për nivelin e besimit = '0' = nuk ka informacion; '1' = besim i ulët; '2' = besim mesatar; '3' = besim i lartë. E ulët = nuk ka të dhëna monitorimi, vetëm gjykimi i ekspertëve; E mesme = disa të dhëna të elementit të cilësisë mbështetëse (QE) dhe të dhëna të kufizuara për një BQE; E lartë = të dhëna të mira për 1+ BQE dhe mbështetja e QE-ve më të rëndësishme..

Terkuza	351443	TUTM	1.3	-	2.2	2.8	-	-	4.2.3; 4.1.4	4.3.4; 4.5; 5.3	4	2	4	-	-	4	Në risk	1
	351444	Natural	-	-	2.2	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	2	I panjohur	0
	351445	Natural	1.1	-	2.2	-	-	-	-	4.5	3	-	1	-	-	2	I panjohur	0
Tirana	35145	Natural	1.1; 1.3	1.4	2.2	2.6	-	-	4.1.2	4.3.6; 4.5	5	4	2	-	-	4	Në risk	2
	35146	Natural	1.1; 1.3	1.4; 1.6	2.2	2.6	-	-	-	-	5	-	1	-	-	3	Ndoshta	1
Tirana	35147	Natural	1.1; 1.3; 1.5	-	2.2	2.6	-	-	4.1.2;4.2.4	4.5; 5.3	4	5	2	-	-	5	Në risk	2
Lana	351481	Natural	1.1 ; 1.3;1.5	1.2	2.2	-	-	-	4.1.5; 4.2.4	4.3.1; 5.3	5	5	4	-	-	5	Në risk	2
	351482	Natural	1.1; 1.3	1.4	2.2	2.6	-	-	-	5.3	5	-	3	-	-	3	Ndoshta	1
Lana	351483	Natural	1.1; 1.3;1.5	-	2.2	2.6	-	-	4.1.5	5.3	5	5	4	-	-	5	Në risk	2
Lana	351485	TUTM	1.1; 1.3; 1.5	-	-	-	-	-	4.1.4	5.3	-	5	5	-	-	5	Në risk	1
Lana	351487	Natural	1.1; 1.3	-	-	-	-	-	-	4.5	5	5	3	-	-	5	Në risk	1
Tirana	351491	TUTM	1.1; 1.3	1.4	2.2	-	-	-	4.1.4	4.5; 5.3	5	5	3	-	-	5	Në risk	2
Tirana	351493	TUTM	1.1; 1.3	-	2.2	2.6; 2.8	-	-	4.1.4	4.5; 5.3	2	2	3	-	-	2	Jo në risk	2
Tirana	351495	Natural	-	-	2.2	2.8	-	-	4.1.4;	4.5; 5.3	2	4	2	-	-	4	Në risk	2


Harta 10-1 – Harta e Presioneve të Nxjerrjeve, hidroenergjetike dhe morfologjike



Harta 10-2 – Harta e Shkarkimeve të Ujërave të Ndotura dhe e Presioneve të Ndotjes së Shpërndarë



Harta 10-3 – Përcaktimi i Statusit Përfundimtar të Trupave Ujorë Sipërfaqësorë



10.6 Presionet e Trupit Ujor Nëntokësor dhe Vështrimi i Përgjithshëm i Vlerësimit të Statusit

10.6.1 Vlerësimi i Presioneve në Nivelin e Trupit Ujor Nëntokësor

Objektivat e DKU-së për ujërat nëntokësore janë: (i) parandalimi ose kufizimi i depërtimit të ndotësve dhe parandalimi i përkeqësimit të statusit; (ii) mbrojtja, përforcimi dhe rehabilitim i trupave ujorë nëntokësorë; dhe (iii) zhbërja e çdo tendence domethënëse që ka të bëjë me rritjen e përqendrimeve të ndotësve.

Procedurat e DKU-së/DUN-it kanë dallime kohore për sa i përket vlerësimit të statusit, i cili merr parasysh gjendjen aktuale sipas vlerësimit të riskut që mund të shfaqet gjatë kohëzgjatjes së planit të ardhshëm, pra që një trup ujor rrezikon të mos i arrijë objektivat mjedisore në fund të kohëzgjatjes së planit.

Tabela 10-6 përmbledh presionet kryesore të identifikuara për çdo trup ujor nëntokësor sipas të dhënave të kufizuara në dispozicion. Duke qenë se nuk ka asnjë inventar për rreziqet e ndotjes në burim, ky vlerësim mbështetet te baza e të dhënave GIS, krijuar nga AMBU për regjistrimin e vendndodhjeve të shkarkimit në trupa ujorë sipërfaqësorë. Këto vendndodhje gjendeshin mbi trupat ujorë nëntokësorë dhe tregojnë (i) vendndodhje të pjerrëta ku mund të ketë një ose më shumë ndotje pikësore të ujërave nëntokësore, ndonëse nuk mund të ketë komente të veçanta për këtë, dhe (ii) kufijtë e rrjedhës së poshtme ku çdo grimcë ndotjeje që hyn në lum mund të rrjedhë në ujëra nëntokësore (në varësi të gradientit hidraulik lokal). Në analizën e presioneve lidhur me trupat ujorë nëntokësorë janë përdorur edhe të dhënat e projektit GIS (burime, puse, pikat e nxehta të ndotjes, pikat e shkarkimit, popullsia dhe vendbanimet) edhe baza e të dhënave Corine[180] për përdorimin hapësinor të tokës, të cilat janë vendosur në Shtojcën Teknike VII për Ujërat Nëntokësore. Vlerësimi sasior i presioneve nga pus-shpimet dhe shkarkimi i ujërave nëntokësore është i kufizuar për shkak të mungesës së të dhënave dhe natyrës së shkarkimeve të burimeve, që mund të jetë më e madhe se 1 m^3/s. Burimet dhe shkarkimet natyrore, të shfrytëzuara për qëllime njerëzore, ndryshojnë nga nxjerrjet përmes pompimit/ pus-shpimit, të cilat realizohen nga aktiviteti human dhe reduktojnë shkarkimet natyrore. Analiza e GIS-it për shkarkimet burimore mundet që disa burime t'ia caktojë gabimisht trupave ujorë nëntokësorë sepse pika e shkarkimit mund të ndodhet fare pak përtej kufirit të njësisë gjeologjike[181]. Shumë burime, për të mos thënë shumica dërrmuese, janë inventarizuar në GIS. Nxjerrjet nga ujërat nëntokësore ndodhin në pesë burime: (i) puse me vendndodhje të përcaktuar në GIS, ndonëse shumica kanë shkarkime në nivele të ulëta; (ii) puse publike nxjerrëse me kapacitet të lartë që janë kryesisht të dokumentuara; (iii) pus-shpime private që janë kryesisht të padokumentuara, por që priten në ato zona ku nuk ka puse ose burime, apo tubacione publike për furnizim me ujë; (iv) puse private industriale që janë kryesisht të padokumentuara dhe mund të kenë rëndësi të madhe; dhe (v) puse për ujitje që janë kryesisht të padokumentuara dhe me gjasa të rëndësishme.

DKU-ja e përkufizon statusin e ujërave nëntokësore duke përdorur vetëm dy kritere, përkatësisht kriterin kimik dhe sasior, ku secili prej tyre është ose "i mirë" ose "i dobët" dhe statusi i përgjithshëm është ai që është më i ulëti prej këtyre dy përcaktimeve (pra nëse njëri është i dobët, statusi i përgjithshëm është "i dobët"). Statusi i përgjithshëm përcaktohet pas kryerjes së katër testeve sasiore dhe pesë testeve kimike (shihni Kapitullin 3). DUN-i kërkon ndër të tjera që të mos ketë tendenca domethënëse rritëse, të cilat mund të sjellin ndryshimin e statusit në të ardhmen e parashikueshme. Mund të vërehen dallime të mëdha midis presioneve që veprojnë në lloje të ndryshme akuiferësh në basenin e lumit Ishëm. Trupat ujorë nëntokësorë aluvialë (Lloji 1) janë të populluara dendur (90% e popullsisë), janë fokusi i zhvillimit industrial dhe tregtar, janë objekt i nxjerrjeve të shumta dhe kërcënohen nga disa burime të mundshme ndotjeje. Gjatë viteve të fundit ka pasur ndryshime rrënjësore të përdorimit të tokës për shkak të veprimtarisë bujqësore, strehimit dhe zhvillimit industrial. Kjo gjë e ka zëvendësuar riskun e ndotjes për shkak të plehëruesve, nitrateve dhe pesticideve me riskun e ndotjes nga mbetjet njerëzore dhe kimikatet industriale, dhe në të njëjtën kohë, nxjerrjet e ujit për qëllime ujitjeje janë

[180] Baza e të dhënave Corine përmban informacione për tokat urbane dhe industriale, të ujitura dhe të pa ujitura, kullotat, pyjet, lëndinat, ligatinat dhe ujërat e brendshme dhe detare.

[181] Kjo ndodh zakonisht në pikat e kontaktit midis depozitave me depërtueshmëri (dhe topografi) të lartë dhe depërtueshmëri të ulët, të cilat nuk mund të përcjellin sasi të mëdha uji dhe i detyrojnë ujërat nëntokësore të shkarkohen në sipërfaqe si burim.

zëvendësuar nga nxjerrjet bashkiake dhe industriale. Kështu, është nxitur rritja e përgjithshme e presioneve sasiore dhe kimike.

Masivët karbonikë (Lloji 4) në ujëmbledhësin e rrjedhës së mesme dhe të sipërme u nënshtrohen zakonisht ndërhyrjeve të pakta nga njeriu, me përjashtim të veprimtarive bujqësore dhe minerare, dhe shfrytëzimit të burimeve të mëdha për furnizimin e bashkive me ujë. Kjo e fundit mbështetet te shfrytëzimi i shkarkimeve natyrore, ndaj nuk rrezikon burimin në vetvete, por redukton rrjedhën bazë të përrenjve dhe ligatinave. Akuiferët ranorë dhe konglomeratët (Lloji 5) në kufi me basenin aluvial, ndonëse me rendiment më të ulët, janë të ngjashëm me akuiferët e Llojit 1. Në to jeton 7% e popullsisë dhe uji i tyre pompohet për furnizimin shtëpiak dhe industrial; janë subjekt i presioneve për ndotje nga mbetjet e krijuara nga njerëzit dhe kimikatet industriale.

10.6.2 Përcaktimi i Vlerave Prag

Vlerat Prag (VP) janë standarde cilësore të vendosura nga Shtetet për ndotësit që rrezikojnë të mos arrijnë objektivat mjedisore të DKU-së dhe kërkesat e Nenit 3.1 të DUN-it. VP-ja plotëson standardet bazë të cilësisë së ujërave nëntokësore (nitratet dhe pesticidet) të përmendura në Shtojcën I të DUN-it, kur këto të fundit nuk janë të përshtatshme për arritjen e objektivave mjedisore, dhe duhet të marrin parasysh të paktën ndotësit dhe treguesit e listuar në Shtojcën II, Pjesa B, të cilët janë:

- arseniku, kadmiumi, plumbi, merkuri, amoni, kloruri, sulfati, nitriti dhe fosfati;
- trikloroeteni (TCE) dhe tetrakloroeteni (PCE);
- treguesi (i përzgjedhur nga anëtari) i intruzionit të ujërave të kripura (ose të tjera).

Vlerat Prag përcaktojnë edhe pikënisjet për kthimin e tendencave sipas Nenit 5 të DUN-it. Përcaktimi i Vlerave Prag për basenin e lumit Ishëm detajohet në Shtojcën për Ujërat Nëntokësore. Vlerat Prag të propozuara në Tabela 10-55; megjithatë, duhet pranuar se zbatimi i disa VP-ve për metalet e rënda (As, Cd, Hg dhe Pb), pesticidet dhe tretësit e klorinuar (TCE dhe PCE) është tepër i kufizuar nga disponueshmëria e të dhënave për praninë e tyre në basenet Ishëm-Erzen-Mat, ndaj për ta mbështetur procesin është përdorur analiza e presioneve. Vlerësimi i Ishmit tregon nevojën e parashikueshme për kthim ose të paktën reduktim të tendencës së nitrateve, që mund të përllogariten në nivelin 75% të standardit të CUN-it, pra 37.5 mg/L. Rrjedhimisht, VP-të e propozuara në Tabela 10-5 gjejnë zbatim në nivel RBU-je, ndaj duhet të merren parasysh vlera më të rrepta në nivelin e trupit ujor nëntokësorë për trupa si Selita e Malit (GW35140409) , që me shumë mundësi përmban ujë me cilësi thuajse qelibar dhe shfrytëzohet për ujë të paketuar në shishe.

Tabela 10-5 – Vlerat Prag të Propozuara

Parametri	Njësia	Standardi i Cilësisë së TUN-it	Vlerat Prag (VP)	Shënime
Nitratet	mg/L	50	37.5	
Pesticidet	µg/L	0.1 0.5 (total)	0.075 0.375	
Arseniku	µg/L	10	7.5	
Kadmiumi	µg/L	5	3.75	
Plumbi	µg/L	5	3.75	
Merkuri	µg/L	1	0.75	
Amoni	mg/L	0.50	0.375	
Kloruri	mg/L	250	188	
Sulfati	mg/L	250	188	
Nitritet	mg/L	0.50	0.375	
Fosfatet	mg/L	?	?	

Trikloroeteni	µg/L	10	7.5	
Tetrakloroeteni	µg/L	10	7.5	
Kripësia si CM	µS/cm	2500	1875	

10.6.3 Metodologjia e Përcaktimit të Statusit në Nivelin e Trupit Ujor

Sipas DUN-it, kërkohet vlerësim i statusit të të gjithë trupave ujorë nëntokësorë që identifikohen si në risk dhe të lidhur me ujërat pritëse dhe çdo ndotës që kontribuon në atë karakterizim të TUN-it (DUN, Shtojca III). Trupat ujorë nëntokësorë jo në risk klasifikohen automatikisht si TUN me status të mirë. Statusi i trupit ujor nëntokësor vlerësohet në bazë të rrjetit të monitorimit, sikurse përshkruhet në Kapitullin 8, dhe nuk përjashton mundësinë e incidenteve të lokalizuara të ndotjes që nuk pasqyrohen në rrjetin e monitorimit.

Për shkak të mangësive lidhur me monitorimin mbikëqyrës të sasisë e cilësisë, si dhe përvijimit të thjeshtuar të trupave ujorë që prej vitit 2020, PMBU-ja 2024-2029 ka parashikuar edhe analizën e ndërmjetme për të gjithë trupat ujorë nëntokësorë për përcaktimin e tablosë së përgjithshme. Me rritjen e nivelit të monitorimit mbikëqyrës në të ardhmen, mund të përsoset dallimi midis "trupave ujorë në risk" dhe "trupave ujorë jo në risk". Rritja dhe përmirësimi i nivelit të monitorimit mbikëqyrës është çështje që trajtohet në Programin e Masave.

Duke qenë se cilësia e të dhënave është thelbësore për metodologjinë e statusit, është e nevojshme që të raportohet edhe për "nivelin e besueshmërisë" (NB) së vlerësimit të statusit. [182]Niveli i ulët i besueshmërisë dhe i saktësisë së të dhënave mund të jetë tregues i riskut të keqklasifikimit, ndaj NB-ja tregon besueshmërinë e vlerës së statusit. Udhëzimi WISE 2016 sugjeron klasifikimin e mëposhtëm për të treguar besueshmërinë e statusit ekologjik ose potencialin e përcaktuar:

'0' = nuk ka informacion; '1' = besueshmëri e ulët; '2' = besueshmëri mesatare; '3' = besueshmëri e lartë.

Kriteret janë si vijojnë:

I ulët= nuk ka të dhëna monitoruese, vetëm gjykimi ekspert; Mesatar= disa të dhëna që mbështesin elementin cilësor (EC) dhe të dhëna të kufizuara për një ECB; I lartë= të dhëna të mira për 1+ ECB dhe mbështetjen e EC-ve më të përshtatshme.

10.7 Presionet e Ujërave Nëntokësore dhe Përmbledhja Kryesore e Statusit

10.7.1 Vështrim i përgjithshëm

Tabela 10-6 përmbledh presionet kryesore të identifikuara te trupat ujorë nëntokësorë në basenin e lumit Ishëm. Harta 10-4 paraqet presionet kryesore që shkaktohen nga ndotja dhe pus-shpimet. Harta 10-5 përmbledh përcaktimin e statusit përfundimtar të trupave ujorë nëntokësorë në basenin e lumit Ishëm.

Trupi ujor nëntokësor **35140103** (Thumanë) - Nuk ka të dhëna për tejkalim të standardeve të cilësisë ujore, por ka goxha pasiguri lidhur me parametrat që nuk janë testuar. Ka shumë pasiguri edhe për tendencat e niveleve të ujërave nëntokësore që duket se nuk kanë gjasa të dështojnë në testin e bilancit të ujit, por matjet në Bilaj-416, nëse janë përfaqësuese, tregojnë se TUN-i po preket nga intruzioni nëpërmjet pompimit i ujërave të cilësisë së dobët që vijnë nga lumenjtë e ndotur, por kjo gjë nuk pasqyrohet në monitorim, prandaj nuk ndikon te statusi kimik ose sasior. Megjithatë, këto matje e klasifikojnë TUN-in si në risk për të mos i arritur objektivat mjedisore gjatë periudhës së planit të ardhshëm. Pranohet fakti se ka presione të konsiderueshme nga nitratet dhe pesticidet bujqësore, [183]por edhe nga pika burimore të shumëfishta si karburantet.

---


[182] Udhëzimi i WISE GIS 2016 – Skema: TUS; elementi i skemës *<Besueshmëria Ekologjike e US>*

[183] Ndonëse nuk ka pasur analizë pesticidesh në basenin e lumit Ishëm, ka raportuar ndotje të konsiderueshme të ujërave nëntokësore nga lindani (Hekzaklorociklohekzani ose HCH) nga një fabrikë në afërsi të Durrësit (Buletini i sondazheve detare. 2012, 64(3):472-8) dhe Barbieri etj. ka raportuar nivele më të larta ndotjeje të ujërave nëntokësore në basenin e lumit Buna (Shkenca e Tokës dhe Mjedisit; 2015, 74, 6325–6338. Nga kjo rrjedh se risku për kontaminim të Ishmit nga lindani është i konsiderueshëm.

Trupi ujor nëntokësor **35140103** (Tirana) - Nuk ka të dhëna për tejkalim të standardeve të cilësisë ujore, por ka goxha pasiguri lidhur me parametrat që nuk janë testuar dhe që njihen si presione aktive. Nivelet e ujërave nëntokësore qëndrojnë nën nivelin e lumit për pjesën më të madhe të vitit dhe për një pjesë të mirë të gjatësisë së TUN-it, dhe tregojnë se TUN-i po preket nga intruzioni nëpërmjet pompimit i ujërave të ndotura të lumenjve, por kjo gjë nuk pasqyrohet te të dhënat e monitorimit, prandaj nuk ndikon te statusi kimik ose sasior. Megjithatë, kjo kontribuon në klasifikimin e këtij trupi ujor si në rrezik për të mos i arritur objektivat mjedisore gjatë periudhës së planit të ardhshëm. Përqendrimet e nitrateve janë mbi normën natyrore (afro 30 mg/L) dhe tre nga dhjetë puse monitorimi paraqesin tendenca në rritje. Bazuar te tendencat aktuale, TUN-i rrezikon të mos i arrijë objektivat mjedisore lidhur me vlerën prag (37.5 mg/L). Për më tepër, natyra e veprimtarive industriale dhe tregtare sugjeron se shumë kimikate të rrezikshme që nuk janë testuar po depozitohen ose po përdoren mbi akuiferë, duke sjellë kështu pasiguri të konsiderueshme lidhur me vlerësimin e statusit. Pikat e nxehta aktuale dhe potenciale të ndotjes në këtë TUN janë regjistruar në bazën e të dhënave të AMBU-t, te Figura 10-3, dhe renditen së bashku me rreziqet e njohura ose të mundshme:

- PH_2 Vendgrumbullim mbetjesh (rreziqe të shumta)
- PH-3 ish Kinostudio “Shqiperia Sot” (cianid)
- PH_21 Instituti i Shëndetit Publik (nuk dihet)
- PH_25 Punishte për riciklimin e vajrave izolues elektrikë të përdorur (vajra, PCB, tretës)
- PH_26 Punishte për rehabilitimin e transformatorëve (vajra, PCB, tretës)
- PH_6 Uzina e Autotraktorëve me vendgrumbullim mbetjesh prej 250m deri në SSW (vajra, tretës)

Figura 10-3 – Përqendrimet e Nitrateve te Ujërat Nëntokësore dhe Pikat e Presionit të Ndotjes në Basenin e Lumit Ishëm



Të gjitha këto ndodhen mbi akuiferin e ujit të pijshëm dhe përbëjnë rrezik serioz ndaj ujërave nëntokësore dhe puseve private, numri i të cilëve nuk dihet. Gjithashtu, CEMSA (2012) ka identifikuar si pikë të nxehtë edhe ndërmarrjen metalurgjike Sh.A Dajti në afërsi të tregut të madh të Medresesë, ku janë raportuar grumbullime të mëdha cianidi.

Inventari i AMBU-t për pikat e shkarkimit në ujëra sipërfaqësore tregon se ka shumë burime të mundshme pikësore që ndotin ujërat nëntokësore, dhe nxjerr në pah risqet e përzierjes së ujit të ndotur të lumenjve me akuiferët. 42 pikat e shkarkimeve bujqësore tregojnë prani të mundshme të nitrateve dhe pesticideve.

Ndonëse nuk janë të pranishme në bazën e të dhënave të AMBU-t, ka shumë presione pikësore industriale dhe tregtare që i kërcënojnë ujërat nëntokësore, kryesisht karburantet dhe dyqanet e tjera të hidrokarbureve, punishtet inxhinierike që përdorin lëndë djegëse dhe tretës të klorinuar, pastrimet kimike apo stabilimentet e

përpunimit të ushqimeve. Përvoja ndërkombëtare tregon se shumë objekte të tilla mund të kontribuojnë ndjeshëm në ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore të cekëta. Shqetësim i veçantë në këtë drejtim është Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës; ndonëse nuk ka prova të drejtpërdrejta pro apo kundër këtij supozimi, aeroportet në mbarë botën dihet se shkaktojnë ndotje të ujërave nëntokësore për shkak të karburantit që përdorin për motorët reaktivë dhe të tretësve të klorinuar.

Raportimi për trupat ujorë nëntokësorë **Grupi A**: **Masivi i Dajtit** (35140403/05/11) - Tre TUN-ët përbëjnë seksionin qendror të masivit të Dajtit, që vijon në veri dhe në jug të basenit të lumit Ishëm, dhe ndahen nga rryma që ushqehen nga rrjedha bazë e masivit. Duke marrë parasysh se nuk ka nxjerrje uji me pompim, se ka monitorim të cilësisë së ujit dhe presione të papërfillshme ndotjeje, edhe statusi sasior edhe statusi kimik vlerësohet "i mirë". Duke qenë se nuk ka testim për pesticidet, niveli i besueshmërisë së këtij përcaktimi është mesatar dhe gjykohet se trupat ujorë nuk janë në risk.

Trupi Ujor **35140407** (Mali i Dajit) - Duke marrë parasysh se nuk ka nxjerrje uji me pompim, se ka monitorim të cilësisë së ujit dhe presione të papërfillshme ndotjeje, edhe statusi sasior edhe statusi kimik vlerësohet "i mirë". Duke qenë se nuk ka testim për pesticidet, niveli i besueshmërisë së këtij përcaktimi është mesatar dhe gjykohet se trupat ujorë nuk janë në risk.

Trupi Ujor **35140409** (Selitë e Malit) - Duke marrë parasysh se nuk ka nxjerrje uji me pompim, se ka monitorim të cilësisë së ujit dhe presione të papërfillshme ndotjeje, edhe statusi sasior edhe statusi kimik vlerësohet "i mirë". Duke qenë se nuk ka testim për pesticidet, niveli i besueshmërisë së këtij përcaktimi është mesatar dhe gjykohet se trupat ujorë nuk janë në risk. Megjithatë, sipërfaqja karstike e zhveshur e bën akuiferin tepër të cenueshëm në rast se zhvillohet veprimtari njerëzore në të ardhmen.

Raportimi për trupat ujorë nëntokësorë **Grupi B**: **Brar- Krujë** (35140501/03/05) - Gurët ranorë dhe konglomeratet e formacionit të Rrogozhinës mendohet të mbajnë ujëra nëntokësore natyrore me cilësi të mirë. Ka disa analiza historike, por nuk ka monitorim rutinë për nivelin apo cilësinë e ujërave nëntokësore. Raportet historike tregojnë se puset e hapura që herët kanë hasur nivele të ujit artezan, por situata aktuale është e pasigurt, pasi ka disa tregues që flasin për rënie të niveleve. Zgjerimi i natyrës së veprimtarive njerëzore tregon se presionet e ndotjes nga veprimtaritë sanitare shtëpiake dhe tregtare po rriten, sikurse po ndodh edhe me presionet sasiore nga puset e mëdhenj private, numri i të cilave nuk dihet. Prandaj, supozohet, ndonëse me nivel të ulët besueshmërie, se këta trupa ujorë nëntokësorë kanë status të mirë, por edhe rrezikojnë të mos i arrijnë OM-të.

Pjesë të konsiderueshme të këtyre trupave ujorë janë urbanizuar shumë shpejt së fundmi, gjë që ka sjellë presione të konsiderueshme për statusin e tyre sasior për shkak të reduktimit të rimbushjes si pasojë e konvertimit të bimësisë natyrore dhe sipërfaqeve të pjerrëta në sipërfaqe të ngurta si objekte betoni dhe çakëlli me bitum, shoqëruar me tubacionet e kullimit në sipërfaqe.

Raportimi për trupat ujorë nëntokësorë **Grupi C**: **Bubq- Kashar** (35140507/09) - Gurët ranorë dhe konglomeratet e formacionit të Rrogozhinës mendohet të mbajnë ujëra nëntokësore natyrore me cilësi të mirë. Megjithatë, përveç disa matjeve të pakta historike, nuk ka monitorim rutinë për nivelin apo cilësinë e ujërave nëntokësore. Nivelet e ujit të puseve të shpuara në fillim ishin artezane, por këto nivele duket se kanë rënë. Zgjerimi i natyrës së veprimtarive njerëzore tregon se presionet e ndotjes nga veprimtaritë sanitare shtëpiake dhe tregtare po rriten, sikurse po ndodh edhe me presionet sasiore nga puset e mëdhenj private, numri i të cilave nuk dihet. Njësoj si me Grupin B, urbanizimi po sjell presione të konsiderueshme për statusin sasior, për shkak të reduktimit të rimbushjes si pasojë e konvertimit të sipërfaqeve natyrore në sipërfaqe të forta. Prandaj, supozohet, ndonëse me nivel të ulët besueshmërie, se këta trupa ujorë nëntokësorë kanë status të mirë, por edhe rrezikojnë të mos i arrijnë OM-të.

10.7.2 Programi i Monitorimit të Ujërave Nëntokësore

Monitorimi i ujërave nëntokësore në basenin e Ishmit kërkon përmirësime të ndjeshme të disa zonave, të cilat gjeologjikisht dhe gjeografikisht mund t'i përkasin rajoneve të ndryshme, kryesisht të akuiferëve aluvialë, akuiferëve gëlqerorë dhe akuiferëve ranoro-konglomerate. Këto lloje akuiferësh paraqesin dallime themelore për sa i përket cenueshmërisë. Akuiferët aluvialë dhe ranorë ofrojnë vetvetiu një lloj mbrojtjeje falë zhvillimit të një shtrese dheu dhe sepse rrjedhja ndodh tërësisht ose kryesisht nëpërmjet strukturës granulare. Nga ana

tjetër, akuiferët karstikë gëlqerorë nuk kanë mbulesë dheu dhe dominohen nga rrjedhja nëpërmjet fizurave. Megjithatë, ky përcaktim nuk është fiks sepse mund të ketë mbulesa modeste dheu si në Masivin e Dajtit, por mund edhe të mos ketë fare të tillë si në rastin e Malit me Gropa. Pavarësisht statusit në dukje të mirë dhe niveleve të ulëta të presionit, ata janë tejet të cenueshëm nga ndotja: kontaminantët depërtojnë lehtë te pasqyra e ujit dhe mund të migrojnë shumë shpejt me të hyrë aty. Nevojiten përmirësime në këto fusha:

- *Mbulim hapësinor midis TUN-ve.* Vetëm dy trupa ujorë (GW35140101/03) përmbajnë puse që monitorohen në mënyrë rutinë (nga ShGjSh-ja) dhe të gjitha matjet bëhen në stacionet aktive të pompimit. Në dy trupa ujorë karstikë, matjet rastësore të cilësisë së ujit dhe shkarkimeve, ndonëse në shkallë më të ulët, bëhen te burimet kryesore. Puset që monitorohen (në GW35140101/03) janë puse prodhimi me filtrim për kohë të gjatë, të cilat nuk mund të përdoren për dalluar luhatjet vertikale të nivelit ose cilësisë së ujit.
- *Parametrat e matur kimikë.* Aktualisht, matjet kufizohen kryesisht te jonet më kryesore. Metalet e rënda dhe kimikatet organike sintetike, sikurse kërkohet nga DKU-ja dhe DUN-i, praktikisht nuk maten fare për shkak të mungesës së kapacitetit analitik.
- *Akuiferët Aluvialë*. Me përjashtim të burimeve të mëdha në terrene karstike, monitorimi i ujërave nëntokësore (pa pompim) është thelbësor për të kuptuar statusin sasior të trupave ujorë nëntokësorë. Shumica e puseve në rrjetin aktual janë puse prodhimi dhe si të tilla nuk janë të pajisura për monitorim. Edhe kur kjo është e mundur, nivelet prishen për shkak të pompimit.
- *Akuiferët Karstikë.* Në masivët gëlqerorë, ku shkarkimi i ujërave nëntokësorë ndodh kryesisht nëpërmjet burimeve, monitorimi i cilësisë së rrjedhës dhe ujit në të gjithë burimin, që kërkon volume të mëdha uji nga akuiferi, është mënyra më praktike e monitorimit të statusit të tyre.
- *Akuiferët ranoro-konglomeratë.* Mungesa e monitorimit në akuiferët ranorë me depërtueshmëri të ulët, që pompohen nga puset, tregon se statusi i tyre është tejet i pasigurt.
- *Monitorimi i Nivelit të Ujërave Nëntokësore.* Të dhënat sipas periudhave kohore të rëndësishme janë të disponueshme vetëm për tre puse që ndodhen në trupa ujorë në Thumanë dhe Tiranë. Këto të dhëna nuk mjaftojnë për të kuptuar veprimtaritë komplekse njerëzore që zhvillohen atje.
- *Puset e Monitorimit.* Në akuiferët aluvialë (porozë) dhe ranorë (porozë dhe të frakturuar), përdorimi i puseve të posaçme të monitorimit (piezometrave) duhet të jetë standard, për të bërë matje të besueshme të nivelit dhe cilësisë së ujit. Këto puse duhen instaluar si piezometër çift: dy puse me filtrim për kohë të shkurtër dhe me diametër të vogël, ku njëri të vendoset afër pasqyrës së ujit dhe tjetri afër bazës së zonës kryesore të prodhimit.
- *Frekuenca kohore.* Frekuenca e planifikuar (çdo tre mujor) e monitorimit kimik, ndonëse jo gjithmonë e realizuar në praktikë, duket se është e përshtatshme për të identifikuar tendencat e cilësisë së trupave ujorë. Megjithatë, kjo frekuencë nuk është e përshtatshme për zbulimin e tendencave afatgjata dhe luhatjeve sezonale të niveleve të ujërave nëntokësore. Për të bërë monitorime kohore sa më të mira të niveleve të ujit, pikat më të rëndësishme të monitorimit duhen pajisur me regjistrues automatikë të dhënash dhe telemetri, pasi kjo po bëhet de facto praktika standarde e monitorimit.
- *Nxjerrjet.* Monitorimi i nxjerrjeve nga puset dhe burimet bashkiake, industriale dhe ujitëse, edhe nëse bëhet, nuk është në dispozicion të agjencive të burimeve ujore (AMBU dhe ShGjSh). Informacioni për përdorimin dhe statusin e ujit duhet të qarkullojë lirisht midis agjencive dhe subjekteve të burimeve ujore në kohë reale ose virtuale.

Tabela 10-6 – Presionet dhe Vlerësimi i Statusit Përmbledhje – Kategoria UJËRAT NËNTOKËSORE


IDENTIFIKIMI			ANALIZA E PRESIONEVE[184]						STATUSI DHE STATUSI I PËRGJITHSHËM					VLERËSIMI I RISKUT	
GRUPI I RAPORTIMIT	EMRI I TRUPIT UJOR NËNTOKËSOR	KODI I TRUPIT UJOR SIPAS BE	PIKËSOR PRESIONI 1	PIKËSOR PRESIONI 2	PRESIONI I SHPËRNDARË 1	PRESIONI I SHPËRNDARË 2	NXJERRJA / PRESIONI I RRJEDHËS	PRESIONI I UJËRAVE NËNTOKËSORE	SAS.[185]	KIM[186]	SHTOJCA X SP	SHTOJCA VIII	STATUSI I PËRGJITHSHËM	NIVELI I RISKUT	CL
-	Thumanë	GW35140101	1.1	1.3/1.4	2.2/2.6		3.1/3.2/3.3	6.2	G (2)	G (2)			Mirë	Në risk	1
-	Tiranë	GW35140103	1.1/1.2	1.3/1.4/1.5/1.6/1.9	2.2/2.6	2.8	3.1/3.2/3.3	6.2	G (1)	G (1)			Mirë	Në risk	1
-	Makaresh	GW35140401		1.3/1.4	2.2		3.1/3.3		G (1)	G (2)			Mirë	Jo në risk	2
A	Kroi i Madh Bovilla Dajti	GW35140403 GW35140405 GW35140411			2.2		3.1/3.3		G (3)	G (2)			Mirë	Jo në risk	2
-	Mali i Dajtit	GW35140407							G (2)	G (2)			Mirë	Jo në risk	2
	Selita e Malit	GW35140409							G (2)	G (2)			Mirë	Jo në risk	3
B	Fushë-Krujë Qinam Brar	GW35140501 GW35140503 GW35140505	1.1/1.2	1.3/1.4	2.2	2.6	3.1/3.3	6.2	G (1)	G (1)			Mirë	Në risk	1
K	Kashar Bubq	GW35140507 GW35140509	1.1/1.2	1.3/1.4	2.2 2.2	2.6	3.1/3.3	6.2	G (1)	G (1)			Mirë	Në risk	1

[184] Lloji i presionit përputhet me Udhëzimin e WISE GIS për Raportimin 2016 – Shtojca 1a.


[185] Tregon statusin sasior të trupit ujor të përcaktuar nga koeficienti i shfrytëzimit të ShGjSH-së. Nxjerrja duhet të jetë më e vogël se rezultati Rimbushje - Prurje Ekologjike.

[186] Tregon statusin bazë fiziko-kimik të trupit ujor të përcaktuar kryesisht nga nivelet e nitrateve dhe/ose Përcjellshmërisë Elektrike

Harta 10-4 – Vështrim i Përgjithshëm i Presioneve të Nxjerrjeve dhe Ndotjes së Ujërave Nëntokësore



Harta 10-5 - Përcaktimi i Statusit Përfundimtar për të Gjithë Trupat Ujorë Nëntokësorë



11 Përmbledhje e Analizës Ekonomike

11.1 Analiza ekonomike sipas Nenit 5 të DKU-së, Shtojca III

Analiza ekonomike, mbështetur në Nenin 5 të DKU-së përmban informacion me detaje të mjaftueshme (që përfshin kostot e mbledhjes së të dhënave përkatëse) me qëllim:

(a) mundësimin e llogaritjeve përkatëse të nevojshme për marrjen parasysh të parimit të rikuperimit të kostove të shërbimeve të ujit të përcaktuara në nenin 9, duke marrë në konsideratë parashikimet afatgjata të kërkesës dhe ofertës për ujë në rajonet e basenit ujor, dhe kur është e nevojshme:

- llogaritjet e volumit, çmimit dhe kostove që lidhen me shërbimet e ujit; dhe
- llogaritjet e investimeve përkatëse, përfshi edhe parashikimet e këtyre investimeve;

(b) gjykimin rreth kombinimeve të masave më efikase të mundshme për kostot lidhur me përdorimet e ujit që do të përfshihen në PM, sipas nenit 11, bazuar te llogaritjet e kostove të mundshme të këtyre masave.

Për sa i përket Shqipërisë dhe si pjesë e kërkesave të përgjithshme për përgatitjen e PMBU-ve, AMBU duhet të përgatisë analizën ekonomike të përdorimit të ujit dhe rendimentit në basen, veçanërisht për të përcaktuar nëse uji po përdoret me efikasitet dhe nëse kostoja e vërtetë mjedisore po rikuperohet plotësisht nga përdoruesit e ujit.

Ky kapitull paraqet përmbledhjen e analizës ekonomike të basenit ujore të Ishmit.

Ndonëse në këtë fazë Shqipëria nuk i ka në dispozicion të gjitha informacionet e kërkuara (dhe nuk ishin të tilla as gjatë ciklit të parë të zbatimit për shumë Shtete Anëtare), është përgatitur raporti i analizës ekonomike për basenin ujor të Ishmit, i cili gjendet në Shtojcën X.

11.2 Baseni i lumit Ishëm: përmbledhje e shkurtër

Ishmi ka një basen ujor me sipërfaqe prej 721 km^2 dhe derdhet në detin Adriatik duke kaluar pranë qytezës së Ishmit. Rajoni i basenit të lumit Ishëm ndahet nga dy kodra të ulëta me basenin Erzen. Mbulon pjesët kryesore të kryeqytetit, përfshi edhe dy degët: lumi i Tiranës dhe i Lanës. Ky basen ka popullsi të dendur në relievet e ulëta, ku zhvillohen edhe veprimtari mjaft të rëndësishme ekonomike (dhe rrjedhimisht edhe presione të konsiderueshme).
Duke qenë se baseni ujor Ishëm lidhet ngushtë nga pikëpamja socio-ekonomike me basenin ujor të Erzenit (që në përgjithësi ka edhe lidhje hidrologjike), analiza ekonomike (në Shtojcën X) është mbështetur në përgjithësi te qasja e kombinimit të të dy baseneve. Kategorizimi i të dhënave të rëndësishme socio-ekonomike për këto dy basene do të ishte mjaft i vështirë (p.sh kategorizimi i të dhënave/informacioneve të disponueshme vetëm në bashkinë e Tiranës) dhe aspak i dobishëm në të njëjtën kohë, pasi një ndarje e tillë:

- do të sillte shqyrtim të veçantë të çështjeve socio-ekonomike, kur në praktikë këto dy zona përballen me presione/përdorime të përbashkëta të ujit;
- për sa i përket programit të masave, do të sillte propozime të veçanta që do të shkaktonin me shumë mundësi kosto më të larta (p.sh ndarja e objektit, masave përkatëse të trajtimit të ujërave të ndotura dhe strukturave të kërkuara); kështu do të nevojitej një pikëpamje e integruar kundrejt masave të kërkuara.

Për më tepër, edhe përkatësia e bashkive që janë pjesë e baseneve ujore Ishëm-Erzen flet për njëtrajtshmëri mjaft të mirë midis dy zonave të kombinuara të baseneve ujore (2.191 km^2), ku sipërfaqja e 7 bashkive që bien brenda kufijve të këtyre baseneve ujore është (2.213 km^2). Prandaj, analiza në këtë nivel ndarjeje mund të konsiderohet si e besueshme. Për sa i përket basenit ujor të Ishmit në veçanti, nuk është e mundur ndarja i informacionit në nivel prefekture (qytetet Tiranë dhe

Durrës janë pjesë e të dy baseneve, gjë që e bën ndarjen të parealizueshme/padobishme për shkak të pasigurive të mëdha).

Për t'u fokusuar sa më tepër të jetë e mundur vetëm te baseni ujor Ishëm, këto 3 bashki i përkasin vetëm Ishmit:

- Kamëz (100% në Ishëm);
- Krujë (kryesisht në Ishëm);
- Tiranë (një pjesë e madhe e territorit bie në basenin ujor të Erzenit, por pjesa më e madhe e popullsisë/veprimtarisë ekonomike ndodhet në Ishëm).

Sipas analizës ekonomike, bashkia Vorë i përket plotësisht basenit ujor të Erzenit; ndonëse gati gjysma e territorit të bashkisë bie në Ishëm, shumica e popullsisë/zonave urbane/veprimtarisë ekonomike ndodhet në Erzen.

Duhet vërejtur se analiza vetëm për Ishmin duhet parë me kujdes për shkak të vështirësive (të lartpërmendura) që kanë të bëjnë me ndarjen e Ishmit nga Erzeni nga pikëpamja e menaxhimit/socio-ekonomike. Përkatësia e bashkive më lart tregon se 3 bashki që mendohet se i përkasin Ishmit kanë një sipërfaqe prej 1.492 km^2, ndërsa sipërfaqja aktuale e basenit ujor të Ishmit është 721 km^2 (4 bashkitë që i përkasin Erzenit, konkretisht Durrësi, Kavaja, Vora, Shijaku mbulojnë një sipërfaqe prej 721 km^2, ndërsa sipërfaqja reale e basenit ujor të Erzenit është 1.370 km^2.

11.3 Karakteristikat dhe rëndësia ekonomike e përdorimeve të ujit

Objektivi kryesor i këtij seksioni është të vlerësohet rëndësia e ujit për ekonominë dhe zhvillimi socio-ekonomik i rajonit të një baseni të caktuar ujor. Këtu paraqitet profili ekonomik i basenit ujor lidhur me treguesit e përgjithshëm, p.sh. xhiroja ekonomike, të ardhurat bruto, punësimi ose numri i përfituesve nga përdorimet e ujit. Analiza duhet t'i hapë udhë vlerësimit të çështjeve të rëndësishme të menaxhimit të ujërave dhe analizës së efikasitetit të kostos, duke nxitur edhe hulumtime rreth kompromiseve të mundshme midis zhvillimit socio-ekonomik dhe mbrojtjes së burimeve ujore në basenin ujor, si dhe çështjeve të tilla si ajo e shpërndarjes së kostove dhe përfitimeve nga masat e menaxhimit të ujërave për përdorime të ndryshme të ujit.

11.3.1 Treguesit e përgjithshëm socio-ekonomikë

11.3.1.1 Popullsia, struktura urbane/rurale dhe familjare

Të dhënat aktuale (2020) për popullsinë janë të disponueshme në nivel bashkiak dhe të dhënat historike në nivel prefekture. Për më tepër, paraqitet si struktura rurale-urbane edhe ajo familjare e baseneve.

Është më se e qartë se baseni ujor i Ishmit dhe Erzenit (Tabela 11-1), janë zona me dendësi të madhe popullsie, duke mbuluar pjesën më të madhe të aglomeratit të Tiranës dhe të gjithë Durrësin e Kamzën (zonat urbane në bashkitë e basenit variojnë nga 6 deri në 56%). Ndonëse zona e basenit ujor Ishëm-Erzen përbën vetëm afro 7% të territorit të Shqipërisë, 42% e qytetarëve të këtij vendi jetojnë pikërisht në këto basene. Gjatë viteve të fundit (që prej 2017-ës) dhe në kontrast me rënien e lehtë të popullsisë për të gjithë Shqipërinë (prej afro 1%), basenet e Ishmit dhe Erzenit kanë pësuar rritje të ndjeshme të popullsisë (me afro 4.2%, ku më e larta është regjistruar për prefekturën e Tiranës dhe më e ulëta për Durrësin).

Për sa i përket menaxhimit të burimeve ujore, kjo situatë do të thotë se çështjet lidhur me popullsinë urbane (zgjerimi i ofrimit të shërbimit të ujit në zona urbane për shkak të shtimit të numrit të familjeve të vogla, ndotjes për shkak të mungesës së trajtimit të ujërave të zeza urbane, risqeve nga përmbytjet) janë veçanërisht të rëndësishme dhe do të bëhen edhe më domethënëse me ritme më të shpejta krahasuar me pjesën tjetër të Shqipërisë.

Tabela 11-1 – Populllsia Historike e baseneve Ishëm-Erzen (2017-2020)[187]

	% në RB	2017	2018	2019	2020
Shqipëria		2,876,591	2,870,324	2,862,427	2,845,955
Ishëm-Erzen RB		**1,147,184**	**1,173,624**	**1,185,286**	**1,196,863**
Prefektura Tiranë	100%	862,361	883,996	895,160	906,166
Prefektura Durrës	100%	284,823	289,628	290,126	290,697

11.3.1.2 Fuqia punëtore dhe punësimi

Për ta kuptuar më mirë situatën socio-ekonomike të popullsisë së një baseni, ka shumë rëndësi të shihen çështjet që prekin situatën e punësimit, si nga këndvështrimi moshës për punë dhe i ndryshimeve të punësimit/papunësisë së popullsisë, por edhe për sa i përket rëndësisë së sektorëve të ndryshëm për punësimin.

Për basenet ujore Ishëm-Erzen, mund të vërehet se mosha për punë dhe popullsia në moshë për punë janë rritur ndjeshëm vitet e fundit (përkatësisht me 10 dhe 15%), ndërsa popullsia në moshë për punë mbetet thuajse konstante dhe popullsia e punësuar rritet me ritëm më të ngadaltë (6%) për të gjithë Shqipërinë. Papunësia në basenet Ishëm-Erzen është më e larta në të gjithë vendin, me normë të ngjashme rënieje.

Ndonëse nuk ka pasur ndryshime të konsiderueshme gjatë viteve të fundit (2017-2019), rëndësia e madhe e sektorit të shërbimeve është më se e dukshme (62,7% e banorëve të kësaj zone janë të punësuar në këtë sektor, krahasuar me 43% për të gjithë Shqipërinë). Për sa i përket industrisë, diferenca është më e vogël, por ende e konsiderueshme (28,5% krahasuar me 29% për Shqipërinë), duke treguar kështu rëndësinë e madhe të industrisë. Së fundi, për sa i përket bujqësisë, është më se e qartë se ky sektor është shumë më pak domethënës krahasuar me të gjithë Shqipërinë (8,8% krahasuar me 36%).

11.3.2 Karakteristikat dhe rëndësia ekonomike e përdorimeve të veçanta të ujit[188]

Për sa i përket prodhimit të brendshëm bruto (PBB), basenet Ishëm-Erzen janë shumë të rëndësishme për Shqipërinë: ndonëse përfaqësojnë vetëm 7,3% të sipërfaqes së Shqipërisë, këto basene kontribuojnë me thuajse gjysmën e PBB-së kombëtare. Rëndësia ka ardhur në rritje gjatë viteve të fundit (2015-2019), pasi rritja e PBB-së në basenet Ishëm-Erzen ka qenë më e larta për të gjithë Shqipërinë (25% kundrejt 18%). PBB-ja për frymë është më e lartë sesa ajo e gjithë Shqipërisë dhe duket se po rritet me ritme të ngjashme (ndonëse disi më të ngadalta).

Lidhur me strukturën e sektorëve në baseneve Ishëm-Erzen dhe kontributin e tyre në Vlerën e Shtuar Bruto (VShB), tabelat përkatëse të analizës së plotë ekonomike (Shtojca X) konfirmojnë rëndësinë e madhe e gjithnjë në rritje të këtyre baseneve për ekonominë (norma e rritjes për periudhën 2014-2019 ka qenë 136% krahasuar me 120% për të gjithë Shqipërinë). Mund të shihet gjithashtu se, në basenet Ishëm-Erzen, bujqësia, pylltaria dhe peshkimi japin kontribut shumë më të ulët në VShB krahasuar me të gjithë Shqipërinë, ndërsa sektorët e tjerë janë “mbi mesatare” (p.sh. tregtia me pakicë/tregtia me shumicë/transporti/veprimtaritë me pasuritë e paluajtshme, veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike).

11.3.2.1 Bujqësia (përfshi bagëtitë) dhe kulturat bujqësore të ujitura

Bujqësia është e rëndësishme nga pikëpamja e menaxhimit të ujërave, si për sa i përket aspekteve të ndotjes (ndotja e shpërndarë nga plehëruesit/lëndët ushqyese, por edhe pesticidet), por edhe për sa i

[187] INSTAT

[188] Ka informacione të kufizuara për sa i përket kuantifikimit të përdorimit të ujit në Shqipëri, ku burimi kryesor i llogaritjes së rëndësisë së përdorimeve të ndryshme të ujit është baza e të dhënave të AMBU-t për lejet.

përket sasisë së ujit. Prandaj, ky kapitull jep informacione të përgjithshme rreth strukturës së bujqësisë, por edhe për ujitjen në mënyrë të veçantë.

Për sa i përket hektarëve të mbjellë (ara të mbjella me kultura bujqësore) në basenet ujore Ishëm-Erzen për periudhën 2019-2020, situata mbetet e qëndrueshme, ndërsa për të gjithë Shqipërinë vihet re një rritje e lehtë. Në përgjithësi, arat e mbjella me kultura bujqësore në basenet Ishëm-Erzen (13%) janë më të shumta krahasuar me Shqipërinë (7,3%)

- Nuk ka të dhëna të disponueshme për të ardhurat mesatare të gjeneruara nga puna në bujqësi dhe për vlerën e shtuar për ton të mbjellash/bagëtish, çka do sillte ndryshim të "vlerës së shtuar për sasi të prodhuar" në plan afatmesëm dhe afatgjatë.
- Nuk ka informacion të disponueshëm për depërtimet kryesore (të nitrateve, fosfateve, pesticideve), sistemet e fermave sipas llojeve (p.sh madhësia e fermës, intensive-tradicionale/e qëndrueshme, organike) dhe tendencat e kultivimit që mund të shërbejnë si tregues të presioneve lidhur me ndotjen/rrjedhjet.
- Megjithatë, për të përcaktuar rëndësinë e bujqësisë, është shumë e rëndësishme të njihen llojet e kulturave (pasi kultura të ndryshme kanë nevoja të ndryshme për ujë dhe kimikate); ky informacion është i disponueshëm në nivel vendi dhe bashkie, sipas zonave të mbjella dhe tonelatave të prodhuara.

Më hollësisht, për vitin 2020 mund të vërehet se basenet kanë rëndësi periferike për disa lloje kulturash, por marrin rëndësi parësore për sojën (23% e sipërfaqes së prodhimit vendas), perimet (19%), fasulen e bardhë (16%), foragjeret (15%), pataten (12%) dhe misrin, drithërat, tërshërën, grurin (përkatësisht 11, 9, 9 dhe 8%).

Në basenin e Ishmit, sipërfaqja e hektarëve të mbjellë mbetet e qëndrueshme (arë e mbjellë me kultura bujqësore), por sipërfaqja e përgjithshme e arave të mbjella me kultura bujqësore (6%) është më e lartë se e Shqipërisë (2.5%). Lidhur me llojin e kulturave bujqësore (në 2020-n), rëndësia e basenit ujor të Ishmit është e njëjtë me rëndësinë e baseneve Ishëm-Erzen, por rëndësia e këtij baseni është relativisht më e ulët për drithërat, grurin dhe elbin (pasi ndodhen kryesisht në basenin e Erzenit). Megjithatë, rëndësia e tij mbetet e njëjtë për sojën (100% e prodhimit në basenet Ishëm-Erzen).

Për sa i përket bagëtive, të dhënat tregojnë se basenet Ishëm-Erzen kanë rëndësi të madhe, si për nga numri i kapitujve, ashtu edhe për nga tonelatat/njësitë e prodhuara. Ndonëse basenet përbëjnë 7,3% të sipërfaqes së Shqipërisë, numri i krerëve është shumë herë më i madh për shpendët (29%), gjedhët (15%) dhe deri diku për bletët (11%), ku edhe prodhimi i produkteve kryesore të këtyre kategorive të bagëtive është në po të njëjtat nivele. Numri i madh i bagëtive në një sipërfaqe relativisht të vogël mund të sjellë presione të konsiderueshme në formën e ndotjes organike dhe kimike, por mund të prekë edhe sasitë e ujit.

Për basenin e Ishmit, konfirmohet rëndësia e madhe e bagëtive në raport me të gjithë Shqipërinë (2,5% e sipërfaqes së vendit, por rëndësi e madhe për nga numri i bagëtive (për bagëti si gjedhë, thundrakë, shpendë, bletë, dhe më pak për dele/dhi e derra), si për nga numri i krerëve, ashtu edhe për nga tonelatat/njësitë e prodhuara.

Për basenin e Ishmit në mënyrë të veçantë, analiza përcakton se mund të ujitet dhe në fakt është ujitur thuajse 6% e sipërfaqeve bujqësore, një përqindje shumë më e madhe se madhësia relativisht e vogël e basenit (2.5%). Volumet e ujit të përdorura për ujitje shkojnë deri në 27,1 milionë m^3/vit, që sërish është 6% e sasisë totale të ujit të përdorur për ujitje në Shqipëri.

Tabela 11-2 – Ujitja: sipërfaqet që mund të ujiten dhe që janë ujitur, basenet Ishëm-Erzen dhe baseni i Ishmit, 2020

Agrokultura	RB	Sipërfaqe toke totale për agrokulturë	Sipërfaqja potenciale - që mund të ujitet	Sipërfaqja aktuale - me infrastrukturë ujitëse	Sipërfaqja e ujitur (ha)
Shqipëria		657,481	357,245	244,950	181,704
RB Ishëm-Erzeni		78,110	42,681	27,435	20,991
RB Ishëm		36,401	19,685	12,852	10,856
Prefektura Tiranë					
Bashkia Tiranë	*Ishëm*	*20,638*	*11,841*	*9,726*	8,572
Bashkia Vorë	*Erzen*	*4,858*	*2,438*	*1,852*	1,061
Bashkia Kamëz	*Ishëm*	*589*	*380*	*331*	392
Bashkia Kavajë	*Erzen*	*11,540*	*6,026*	*3,276*	3,334
Prefektura Durrës					
Bashkia Durrës	*Erzen*	*18,028*	*11,235*	*6,883*	4,175
Bashkia Krujë	*Ishëm*	*15,174*	*7,463*	*2,795*	1,892
Bashkia Shijak	*Erzen*	*7,284*	*3,298*	*2,572*	1,565
I-E % krahasuar me Shqipërinë		12%	12%	11%	12%
Ishëm % krahasuar me Shqipërinë		6%	6%	5%	6%
Ishëm % krahasuar me I-E		47%	46%	47%	52%

11.3.2.2 Industria

Sipas bazës së të dhënave për lejet e përdorimit të ujërave,[189] 16% e lejeve në të gjithë Shqipërinë janë lëshuar pikërisht për në basenet Ishëm-Erzen (36 nga 226), me një sasi të parashikuar prej 640.000 m^3/vit (me përqindje të ngjashme të sasive për të gjithë Shqipërinë).

Duke marrë parasysh numrin e madh të ndërmarrjeve industriale në Shqipëri, numri i tyre në basenin e Ishmit duket i ulët. Megjithatë, nuk ka burim tjetër për kontrollin e kryqëzuar të këtij informacioni. Për sa i përket shkarkimeve, nuk është lëshuar asnjë leje për basenin e Ishmit. Për sa i përket furnizimit publik me ujë të industrisë/ndërmarrjeve si dhe shkarkimeve në sistemet e kanalizimeve publike, informacionet përkatëse i gjeni më poshtë në këtë kapitull.

11.3.2.3 Shërbimet

Për sa i përket shërbimeve, është e vështirë të merren të dhëna më të mira lidhur me rëndësinë ujit për sektorin, pasi:

[189] Regjistri i AMBU-t për përdoruesit e ujit

- *Për sa i përket vetëfurnizimit/shkarkimeve direkte, sistemi i AMBU-t për dhënien e lejeve nuk ka leje të veçanta për përdorimin e ujërave, sidomos në kuadër të apo lidhur me shërbimet. Prandaj, informacioni përkatës përfshihet në lloje të ndryshme të përdorimit të ujërave që mund të gjenden te kapitulli më lart për industrinë. Njëkohësisht, mund të pritet që vetëfurnizimi të mos jetë aq i rëndësishëm për këtë përdorim të ujërave;*
- *Për sa i përket furnizimit nga shoqëritë UK, ky informacion është pjesë e furnizimit të përgjithshëm të shoqërisë dhe do të trajtohet në kapitullin për shërbimet e ujit (dhe rikuperimin e kostove të tyre).*

11.3.2.4 Hidroenergjetika

Nw basenet Ishëm-Erzen ndodhen vetëm 5 hidrocentrale (nga mbi 200 të tilla në vend), ku në periudhën 2018-2020 vetëm 0,65-1,02% e energjisë elektrike u prodhua në vend. Kjo shifër është ndjeshëm më e ulët se shifra e krahasuar me të gjithë territorin e Shqipërisë (që përbën vetëm 7,3% të saj). Prandaj, hidroenergjetika mund të shihet si presion më i vogël (dhe ndikimet që sjellin risqe për arritjen e statusit të mirë ekologjik të trupave ujorë janë më të pakta) krahasuar me situatën në basenet ujore të tjera.

Në basenin e Ishmit ndodhen 3 hidrocentrale (një tjetër është në proces ndërtimi). Këto përfaqësojnë thuajse 2/3 e prodhimit të hidroenergjisë krahasuar me basenet Ishëm-Erzen; vlerësimi se hidroenergjetika nuk është aq e rëndësishme krahasuar me të gjithë Shqipërinë vlen edhe për basenin e Ishmit (ndonëse basenet zë 2,5% të territorit të Shqipërisë, prodhimi i hidroenergjisë është 0,44 deri në 0,73% krahasuar me të gjithë vendin).

11.3.2.5 Nxjerrja e zhavorrit (nga lumenjtë dhe/ose trupat e tjerë ujorë)

Në përgjithësi, nxjerrja e zhavorrit ndalohet dhe lejohet vetëm për segmente të veçanta të lumit (asnjëra nuk ndodhet në basenin e Ishmit), sikurse u parashikua në 2006-n me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 1 (datë 21.6.2006). Ky vendim u mbështet te gjetjet e studimit për "Vlerësimin e efekteve, ndikimit mjedisor dhe çështjeve hidrodinamike", realizuar brenda një periudhe të caktuar kohore. Për shkak të shqetësimeve mjedisore, u ndalua plotësisht nxjerrja e zhavorrit me vendim të Këshillit Kombëtar të Ujit në 2010-n. Bazuar te nevoja për materiale ndërtimi për të mbështetur zhvillimin e shpejtë infrastrukturor në vend, një vit më vonë (2011), Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) vendosi lejimin e nxjerrjes së zhavorrit, por vetëm për ndërtimin e rrugëve kombëtare dhe vetëm në segmente të caktuara lumenjsh (prej të cilëve asnjëri nuk ndodhet në basenin e Ishmit).

11.3.2.6 Turizmi

Fatkeqësisht, për basenin Ishëm nuk ka të dhëna të ndara për turizmin. Në nivel kombëtar, hyrje-daljet e turistëve të huaj u rritën me thuajse 75% gjatë periudhës 2014-2019, duke treguar kështu dinamikën e sektorit. Edhe numri i netëve të kaluara pranë strukturave akomoduese për periudhën 2018-2019 (*2020 ka qenë vit "i veçantë" për shkak të COVID-19, ndaj nuk merret në konsideratë)* ka pësuar rritje me 5,5% brenda vetëm një viti. Kjo nxjerr në pah zhvillimin me ritme të shpejt të sektorit dhe rëndësinë që duhet të ketë në menaxhimin e burimeve ujore në të ardhmen.

Për sa i përket vetëfurnizimit nga turizmi, nuk është dhënë asnjë leje për këto veprimtari në basenin e Ishmit. Për sa i përket përdorimit/shkarkimit të ujërave dhe shërbimeve të ofruara nga shoqëritë UK, sektori i turizmit shihet si pjesë e këtyre shoqërive; prandaj, informacionin përkatës mund ta gjeni te kapitulli për shërbimet e ujit (edhe nëse nuk ka informacion specifik për sektorin e turizmit për shkak të mosndarjes së të dhënave lidhur me faturimet, etj.)

11.3.2.7 Kontrolli i përmbytjeve dhe kullimi

Kontrolli i përmbytjeve dhe kullimi janë përdorime mjaft të rëndësishme të ujit nga pikëpamja e ndikimeve që kanë te aspektet mjedisore të trupave ujorë (zgjatja/thellimi i lumenjve, përforcimi i brigjeve, pendët, etj.) dhe nga pikëpamja e dëmeve ekonomike që mund të parandalojnë (dhe sigurisht shpëtimin e jetës së njeriut).

Informacioni socio-ekonomik i disponueshëm në Shqipëri lidhur me mbrojtjen nga përmbytjet, përfshi edhe informacionin për investimet përgjatë viteve për mbrojtjen nga përmbytjet, etj., ka qenë gjithnjë i kufizuar. Falë një projekti të veçantë, u bë e mundur mbledhja e të dhënave historike për basenet Ishëm-Erzen, si dhe vlerësimi i risqeve të mundshme nga përmbytjet (lidhur me ndodhshmërinë, zonat specifike, personat e prekur, etj.), bazuar te kërkesat e DP-së (shihni Kapitullin 9.3).

11.3.2.8 Kultivimi i peshqve dhe peshkimi për qëllime argëtimi

Shqipëria ka të dhëna shumë të kufizuara lidhur me numrin dhe madhësinë e vërtetë të veprimtarive të kultivimit të peshqve.

AMBU nuk ka dhënë asnjë leje në basenin e Ishmit për këtë përdorim të burimeve ujore. Njësia matëse e përdorur është "kilogram për peshk të shitur", ku volumi i përgjithshëm i lejuar/parashikuar është 55.500 kilogramë (55,5 tonë).

Ka disa të dhëna në nivel vendi për peshkun e kapur në zona të ndryshme të mjedisit ujor. Dy prej tyre paraqesin interes të veçantë:

- për sa i përket peshkimit në ujërat e brendshme, shifra e peshkut të kapur prej 2.844 tonësh në 2020-n tregoi rritje me 168% krahasuar me 2016-n.
- Për sa i përket akuakulturës, në vitin 2020 u prodhuan 8.799 tonë peshk (sigurisht si në ujërat detare, ashtu edhe në ato të brendshme), një rritje me 168% krahasuar me 2016-n.

Sikurse vërehet, rëndësia e akuakulturës në ujërat e brendshme mbetet e paqartë në shifra, ndaj mund të supozohet se sasitë reale janë më të mëdha se 55 tonët e lejuar në vit. Për sa i përket peshkimit për qëllime argëtimi, nuk ka informacion specifik që të na mundësojë vlerësimin e rëndësisë së veprimtarisë së përdorimit të burimeve ujore (pra, numri i personave që peshkojnë ose sasia e peshkuar në ditë, etj.).

Këto janë boshllëqet kryesore në vija të përgjithshme:

- për tregues të ndryshëm, vështirësi në ndarjen e të dhënave të disponueshme për basenet lumore (p.sh. për shkak të informacionit të disponueshëm në nivel kombëtar);
- bazë e kufizuar informacionesh për vlerësimin e rëndësisë ekonomike të veprimtarive të lidhura me ujërat (p.sh në nënindustri me gjurmë uji, turizëm), për të pasur informacion mbi xhiron dhe "vlerën e shtuar" për sasinë e prodhuar të ujit;
- informacion i copëzuar për sasitë e nxjerrjes/konsumit të ujit dhe shkarkimet e ujërave të zeza për përdorime të ndryshme të ujit, ku përdorimet e ujit për qëllime turistike, nxjerrjet e ujit për qëllime bujqësie (ujitjeje), si dhe përdorimet e ujit për vetëfurnizim në përgjithësi (p.sh. nxjerrjet e ujit dhe shkarkimet e ujërave të zeza nga industria) janë ndër çështjet më të rëndësishme;
- bazë informacionesh e kufizuar (p.sh. nuk ka informacion për volumet e zhavorrit të nxjerrë në mënyrë të paligjshme, numrin e femrave të peshkut dhe volumet e peshqve, apo rëndësinë e përgjithshme ekonomike të këtyre veprimtarive) për përdorimet e ujit jo për qëllime konsumi (p.sh. shfrytëzim zhavorri, kultivim peshku).
- për mbrojtjen nga përmbytjet, duhet përmirësuar informacioni ekonomik në dispozicion (duhet përditësuar informacioni për kostot korrente të strategjisë për mbrojtjen ndaj përmbytjeve për basenet ujore, por edhe informacioni për popullsinë dhe xhiron/veprimtaritë e mbrojtura ekonomike (ose që po planifikohen të mbrohen), humbjet e mundshme të pronave/veprimtarive ekonomike për shkak të mbrojtjes nën optimale nga përmbytjet, etj.).

11.4 Shërbimet e Ujit[190]

Elementet kryesore të analizuara në këtë kapitull janë statusi i shërbimeve të ujit, përmbledhja e tarifave të zbatuara dhe shkalla e rikuperimit të kostove (financiare, mjedisore) të shërbimeve të ujit. Këto çështje strukturohen sipas kufijve hidrologjikë/qasjes së basenit ujor, veçanërisht për faktin se

[190]Të dhënat e disponueshme në raportet e ERRU-t.

nuk është e mundur/dobishme të bëjmë ndarje të të dhënave/inforacioneve për shoqërinë UK të Tiranës.

Njëkohësisht, nënkapitujt më poshtë japin indicie të mundshme të dallimeve për basenin e Ishmit, krahasuar me analizën ekonomike të baseneve Ishëm-Erzen bashkë (Shtojca X). Këtu përfshihet edhe përkatësia e 3 bashkive/shoqërive UK (Tiranë, Kamëz, Krujë) në basenin e Ishmit.

Ka mangësi të mëdha informacioni lidhur me nxjerrjet e ujit për vetëfurnizim:

- Nuk dihet me saktësi numri i puseve/burimeve familjare për furnizim me ujë të pijshëm, ndaj nuk ka shifra (volumet e ujit, popullsia që vetëfurnizohet);
- Për sa i përket vetëfurnizimit të industrisë, ka informacione të disponueshme, por janë të fragmentuara;
- Për sa i përket vetëfurnizimit për qëllime bujqësie, ku ka dukshëm sipërfaqe të mëdha të ujitura (ndërkohë që rrjeti publik i furnizimit me ujë nuk përdoret për ujitje), asnjë prej nxjerrjeve të ujit nuk është regjistruar në bazën e të dhënave të AMBU-t për lejet;
- shumë familje nuk janë të lidhura me sistemin e kanalizimeve publike, por nuk ka përllogaritje të volumeve të ujërave të zeza të asgjësuara;
- për sa i përket industrisë, për shkarkimet direkte ka vetëm informacione të copëzuara; AMBU nuk ka dhënë leje për basenet ujore Ishëm-Erzen;

11.4.1 Prodhimi i ujit të pijshëm dhe shërbimi i furnizimit

Furnizimi me ujë të pijshëm në Shqipëri ofrohet nga 57 shoqëri UK publike në nivel bashkie, të cilat përkojnë në pjesën më të madhe të tyre me kufijtë e bashkive. Këto shoqëri UK i nënshtrohen monitorimit të AKUM-it nëpërmjet vlerësimit të performancës, ndërsa tarifat e tyre vlerësohen dhe miratohen nga ERrU.

11.4.1.1 Popullsia dhe Mbulimi i Furnizimit Publik me Ujë

Në basenet Ishëm-Erzem veprojnë 6 shoqëri UK, të cilat mbulojnë 7 zona bashkiake (shoqëria UK Durrës i shërben edhe Durrësit edhe Shjiakut). Kjo tregon se shoqëritë e shërbimit të ujësjellësit janë shumë më të mëdha se mesatarja në Shqipëri (vetëm 11% e shoqërive UK mbulojnë 40% të të gjithë popullsisë që merr shërbim[191]), për shkak të profilit urban mbi mesatare krahasuar me të gjithë Shqipërinë.

Për sa i përket basenit të Ishmit, 3 shoqëritë UK që veprojnë në këtë basen (Tirana, Kamza, Kruja që mbulojnë 3 bashki) janë edhe më të mëdha krahasuar me të gjithë Shqipërinë (5% e shoqërive UK mbulojnë 27% të popullsisë që merr shërbim). Mbulimin më të madh e ka shoqëria UK Tiranë.

Për sa u përket ndryshimeve lidhur me normat gjatë 3 viteve të fundit, vërehen disa ndryshime relativisht të vogla, si për basenin e Ishmit, ashtu edhe për të gjithë Shqipërinë. Kjo tregon se fokusi i investimeve të deritanishme ka qenë përmirësimi i cilësisë së komponentëve të tjerë të shërbimit (p.sh. vazhdimësia e shërbimit) dhe jo zgjerimi i mbulimit. Për më tepër, edhe nëse shtohet numri i lidhjeve në basenin e Ishmit, është e vështirë që të mbulohet kërkesa për lidhje të reja për shkak të shtimit të popullsisë.

11.4.1.2 Volumet dhe humbjet e ujit në sistemin publik të furnizimit me ujë

Nga uji i prodhuar (60% me pompim dhe 40% me gravitet në nivel kombëtar) për furnizim me ujë, faturohet vetëm 35% (në nivel kombëtar). Për basenin e Ishmit, shifra është vetëm 23%, për shkak të përqindjeve të ulëta të faturimit të shoqërisë UK Tiranë. Krahas këtyre, volume të konsiderueshme uji faturohen pa u matur (me matës). Për basenin e Ishmit situata është më keq (për shkak të shifrave të

[191]Vini re: informacioni për popullsinë e përgjithshme brenda zonës juridiksionale ku veprojnë bashkitë (edhe ERrU si rregullator) bazohet në supozime dhe të dhëna të ndryshme; për pasojë nuk janë përdorur shifrat e INSTAT-it (sikurse ka qenë rasti në raportin e analizës ekonomike (Shtojca X) dhe kapitulli 11.4.1.1. më lart), duke sjellë shifra më të mëdha të popullsisë që merr shërbim: 35% për Shqipërinë, 28% për basenet ujore Ishëm-Erzen.

shoqërisë UK Tiranë dhe rëndësisë së saj të madhe). Këto shifra janë volume të mëdha uji të nxjerra nga mjedisi, që në fakt nuk mbërrijnë te konsumatori/nuk sjellin të ardhura për shoqëritë UK. Çështja e mungesës së matjeve mbetet sërish e rëndësishme (edhe nëse vepritmaritë/investimet në këtë drejtim janë në zhvillim e sipër).
Për sa u përket humbjeve të përgjithshme të ujit gjatë viteve të fundit (shihni analizën ekonomike, Shtojca X), pavarësisht investimeve/përpjekjeve për përmirësim të eficiencës, situata po përkeqësohet, çka lë të nënkuptohet se degradimi i infrastrukturës është më i shpejtë se zbatimi i investimeve të nevojshme (mangësi investimesh).

Tabela 11-3 – Volumet e Ujit: të prodhuar, faturuar dhe humbur në basenet ujore Ishëm-Erzen dhe basenin ujor Ishëm, 2020

Kompanitë për shërbimin e Ujit	Volumi i ujit të prodhuar	*Nga të cilat matet*	Volumi i ujit të faturuar	*Nga të cilat matet2*	Humbjet e ujit në %
Shqipëria	**309,887,138**	*177,452,816*	**107,097,811**	*80,799,421*	65%
RB Ishëm-Erzeni	**153,940,589**	*121,419,917*	**51,153,082**	*43,682,060*	67%
RB Erzen	**50,533,549**	*48,805,549*	**11,625,802**	*9,736,662*	77%
Prefektura Tiranë					
Tiranë UK (Ishëm)	93,218,337	*62,425,665*	35,941,521	*31,337,081*	61%
Vorë UK (Erzeni)	1,814,000	*86,000*	614,000	*344,000*	66%
Kamëz UK (Ishëm)	7,682,400	*7,682,400*	2,777,830	*2,014,030*	64%
Kavajë UK (Erzeni)	6,073,000	*6,073,000*	2,283,000	*1,569,500*	62%
Prefektura Durrës					
Durrës UK (Erzeni)	42,646,549	*42,646,549*	8,728,802	*7,823,162*	80%
Krujë UK (Ishëm)	2,506,303	*2,506,303*	807,929	*594,287*	68%
I-E % krahasuar me Shqipërinë	50%	68%	48%	54%	
Erzeni % krahasuar me Shqipërinë	16%	28%	11%	12%	
Erzeni % krahasuar me I-E	33%	40%	23%	22%	

AMBU ka dhënë 53 leje për përdorimin/nxjerrjen e ujërave nëntokësore dhe 5 për përdorimin/nxjerrjen e ujërave sipërfaqësore të pijshme.

Vërehet "mospërputhje me lejet" kur krahasojmë sasitë e parashikuara të ujit në leje me sasitë e prodhuara të ujit sipas informacioneve të ERrU-t (mbledhur nga shoqëritë UK). Krahasimi tregon se vetëm 74% e volumeve të prodhuara të ujit parashikohet në leje/lejohet faktikisht në nivel vendi.

Për basenet Ishëm-Erzen, ky raport është 70% kur e krahasojmë më sasitë e parashikuara në leje dhe 95% kur e krahasojmë me sasitë faktikisht të faturuara. Për më tepër 2 shoqëri operojnë pa pasur leje për nxjerrjen e ujit të pijshëm (Vorë, Krujë), 2 kanë leje të pjesshme për pikat e nxjerrjes (Kavajë, Durrës) dhe 2 prej tyre kanë leje për të gjitha pikat e nxjerrjes (Tiranë, Kamëz). Për basenin e Ishmit në

mënyrë të veçantë, një shoqëri nuk ka leje për nxjerrjen e ujit të pijshëm (Kruja), ndërsa 2 të tjera kanë leje për të gjitha pikat e nxjerrjes (Tirana, Kamza)

11.4.2 Shërbimi i mbledhjes dhe trajtimit të ujërave të ndotura

Në zonat urbane të Shqipërisë, ujërat e ndotura mblidhen kryesisht nëpërmjet kanalizimeve publike. Sistemet e kanalizimeve janë të kombinuara, ku ujërat e ndotura dhe ujërat e reshjeve mblidhen së bashku. Për shkak të mirëmbajtjes së dobët të kanaleve të ujërave të ndotura dhe diametrit të vogël të tubave, rrjedhjet nga kanalet sjellin shpeshherë rrezik për kontaminimin e ujit të pijshëm.

Në shumë zona nënurbane dhe rurale të qyteteve, ka mungesë të sistemeve të kanalizimeve dhe ujërat e ndotura mblidhen në gropa septike. Familjet përdorin mjetet e veta për shkarkimin e ujërave të ndotura, zakonisht duke i mbledhur në gropa septike dhe duke përdorur kamionë privatë për largimin e tyre prej zonës së banimit.

Shumica e ujërave të ndotura në Shqipëri nuk trajtohen pasi shumë pak impiante të trajtimit të ujrave të ndotura janë në gjendje pune. Në basenin e Ishmit nuk ka impiant funksional. Të gjitha tubacionet e kanalizimeve shkarkohen direkt në trupin ujor më të afërt, pa trajtim. Impianti i trajtimit të ujrave të ndotura në Tiranë është në ndërtim e sipër (projektuar për trajtimin e ujërave të zeza për 345 000 banorë), por punimet ndërtimore janë pezulluar. Për sa u përket volumeve të shkarkuara në mjedis nëpërmjet shoqërive UK, ka informacion shumë të kufizuar në bazën e të dhënave të AMBU-t për lejet.

Për basenin e Ishmit, përqindjet e lidhjeve me kanalizimet ndryshojnë ndjeshëm: nga 100% për shoqërinë UK Kamëz në vetëm 26% për shoqërinë UK Krujë.

11.4.3 Vlerësimi i niveleve aktuale të rikuperimit të kostove për shërbimet e ujit

ERrU përcakton metodologjinë për llogaritjen e tarifave të ujit me pakicë dhe shumicë për konsum publik, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në përputhje me politikën e qeverisë për zhvillimin e sektorit dhe DKU-në e BE-së. Qëllimi kryesor i sektorit është të arrijë rikuperimin e plotë të kostove. Ata duhet t'i sigurojnë klientët se tarifat i paguajnë në bazë të kostove të nevojshme dhe të arsyeshme për shërbimet e ofruara. Politika që ndiqet për tarifën përfshin edhe rritjen graduale të tarifës gjatë viteve të ardhshme, me kusht që ofruesit e shërbimeve të përmirësojnë nivelin e ofrimit të shërbimit.

Ka tre grupe të ndryshme përdoruesish: familjet, institucionet dhe shoqëritë (përfshi industrinë). Për çdo lidhje zbatohet një tarifë fikse; për sa i përket furnizimit/konsumit të ujit të pijshëm (matur ose llogaritur aforfe), zbatohet një tarifë fikse për sasinë e prodhuar të ujit, që është më e ulët për lidhjet e institucioneve shtetërore. Tarifat për shoqëritë janë më të ulëta ose të njëjta me ato për familjet.

Për sa i përket largimit të ujërave të ndotura, llogariten/faturohen aq sasi të prodhuara sa sasia e ujit të përdorur. Edhe këtu vërehet se tarifat janë më të ulëta për institucionet shtetërore, ndërsa tarifat e ujërave të ndotura për shoqëritë janë më të ulëta ose të njëjta me ato për familjet. Nuk ka dallime për sa i përket përbërjes së ngarkesave të larguara të ujërave të ndotura/ndotjes, gjë që ka rëndësi të veçantë për shoqëritë/industrinë. Kjo do të thotë se institucionet shtetërore japin kontribut më të vogël te kostot e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve sesa dy grupet e tjera të përdoruesve.

Lidhur me tarifat për basenin e Ishmit, tarifat volumetrike për shoqërinë UK Krujë janë më të ulëta se ato për Tiranën, ndërsa për Kamzën nuk ka tarifa të miratuara nga ERrU.

Një çështje tjetër mjaft e rëndësishme lidhur me vendosjen e tarifave (dhe rritjet e mundshme që mund të nevojiten në të ardhmen për të përmirësuar nivelin e rikuperimit të kostos) është norma e mbledhjes së tarifave (% e faturave të lëshuara që janë paguar faktikisht nga konsumatorët).

Norma e përgjithshme e mbledhjes është 90% për të gjithë Shqipërinë, ndërsa për shoqëritë UK në basenet Ishëm-Erzen, kjo normë luhatet nga 70% (Kavaja) në 121%.

Vërehet rënie e Normës së Përgjithshme të Mbledhjes (nga 96% në 90%) krahasuar me grupet e të dhënave të 2020-ës. Kjo ka ndodhur pavarësisht përpjekjeve të shoqërive për ta përmirësuar këtë normë me marrëveshje midis tyre dhe klientëve debitorë, sipas të të cilave debitet e mbetura mblidhen si shtesa mbi faturat aktuale. Ndonëse shoqëritë kanë mbledhur në 2020-n rreth 1.3 milionë

lekë nga detyrimet e prapambetura, kjo shifër është rreth 300 milionë lekë më pak krahasuar me 2019-n.

11.4.3.1 Performanca Financiare e Shërbimit të Furnizimit me Ujë/Rikuperimi i Kostos së përgjithshme korrente financiare

Të ardhurat nga shoqëritë UK krahasohen në raport me dy kategori përmbledhëse kostosh (që përkojnë me përkufizimet e DKU-së), të cilat janë:

- Kostot e përgjithshme të operimit dhe mirëmbajtjes (OM) (përfshi kostot për punën, energjinë dhe riparimet; shërbimet e nënkontraktorëve; kostot e materialeve dhe kimikateve; si dhe kosto të tjera për tarifat rregullatore për ERrU-n, SHUKALB-in, Bordin e Drejtorëve, Ministrinë e Mjedisit për volumet e ujit të nxjerrë nga basenet, kontabilistët, kostot gjyqësore, etj.)
- Kostot e përgjithshme: ato që përfshihen shtesë janë kosto kapitale (amortizimi dhe kosto të tjera për taksat/huat/interesat e kredive).

Ajo që duhet vërejtur këtu është se norma e rikuperimit të kostos nuk duhet të përfshijë subvencionet nga shteti (për të mbuluar boshllëkun financiar të shpenzimeve për OM-në), gjë që është më se korrekte sepse analiza synon të tregojë realizueshmërinë financiare të shërbimeve në bazë të të ardhurave të veta. Për më tepër, lidhur me çështjen e investimeve të ardhshme (duke përjashtuar çështjen e rikuperimit të kostove të investimeve historike), këto nuk llogariten më vete në informacionin për shoqëritë UK.

Pasja e një tabloje të plotë është mjaft sfiduese për shkak të natyrës komplekse të financimit, ndryshimeve me ritme të shpejta, vështirësisë në bërjen e dallimit midis investimeve për mirëmbajtjen e sistemeve ekzistuese dhe atyre për përmirësimin/zgjerimin e shërbimeve dhe shpërndarjes së investimeve përgjatë viteve të ndryshme financiare.

Kategoritë kryesore të investimeve janë investimet shtetërore/qeveritare (nëpërmjet buxhetit qendror të shtetit/AKUM-it), të cilat për vitin 2020 kapën shifrën 4,8 miliardë lekë dhe investimet e huaja (dyplaëshe/ndërkombëtare) me një shumë totale prej 1,7 miliardë lekësh për po atë vit. Kjo është pjesë e planifikimit financiar të investimeve, e cila për periudhën 2020-2023 parashikoi 24,3 miliardë lekë (22,6 miliardë lekë nga buxheti i shtetit dhe 1,7 miliardë lekë nga burimet e huaja). Të gjitha duhen parë si subvencione pasi (deri më tani) nuk janë mbuluar nga të ardhurat e shoqërive UK.

Performanca e sektorit financiar për të gjithë Shqipërinë ka pasur rezultate negative (prej 3,3 miliardë lekësh), çka tregon situatën financiare në përgjithësi problematike të sektorit (dhe nevojën për subvencione që mbulon një pjesë të humbjeve OM prej 720 milionësh në 2020-n). Norma e rikuperimit të kostove totale mbetet ende e ulët në 75%, me vetëm 2 shoqëri UK, (ku njëra prej tyre ndodhet në basenin Ishëm (pra në Tiranë)), që i mbulojnë kostot e tyre totale.

Në nivelin e baseneve Ishëm-Erzen dhe basenin Ishëm (Tabela 11-4), norma e rikuperimit të kostos është shumë më e lartë se ajo e Shqipërisë: 95% për basenet Ishëm-Erzen dhe 103% për Ishmin (krahasuar me 75%). Sërish, shoqëria UK Tiranë ka ndikim shumë të madh pasi mbulon edhe koston e veta totale prej 109%. Gjithashtu, për sa i përket mbulimit të kostove OM, basenet Ishëm-Erzen arrijnë një normë mbi mesatare prej 124% dhe Ishmi prej 142%, sërish falë ndikimit të madh të Tiranës (150%).

Të gjitha shoqëritë e tjera përveç Tiranës kanë humbje financiare, ku norma e rikuperimit të kostos totale varion nga 31 deri në 89% për basenet Ishëm-Erzen dhe 58 deri në 60% për basenin Ishëm. Për sa i përket mbulimit të kostove OM, duke përjashtuar shoqërinë UK Tiranë, asnjë shoqëri UK nuk i mbulon kostot OM (me një NR që varion prj 41% deri në 99% për basenet ujore të Ishëm-Erzen dhe 68% deri në 85% për Ishmin), të gjitha nën mesataren kombëtare të NR-së kombëtare mesatare prej 103%.

Për sa i përket evoluimit të performancës financiare të shoqërive UK gjatë 3 viteve të fundit, vërehet tendencë negative si për të gjithë Shqipërinë, ashtu edhe për basenin Ishëm. Kjo vjen për shkak të rritjes së kostove OM dhe kostos totale për 2020-n, ndonëse të ardhurat mbeten praktikisht të njëjta (rritje me më pak se 1% krahasuar me 2019-n).

Tabela 11-4 – Performanca Financiare e Shërbimit të Furnizimit me Ujë/Rikuperimi i Kostos, basenet Ishëm-Erzen dhe basenet Ishëm, 2020

Kompanitë për shërbimin e Ujit	*Të ardhurat nga aktiviteti*	*Kosto totale*	*Operacioni dhe mirëmbajtja totale direkte*	*Subvencionet*	*Rezultati financiar 2020 (në '000 ALL)*	*Rikuperimi i kostos së kostove totale*	*Mbulimi i kostos së kostove të drejtpërdrejta operative dhe të mirëmbajtjes*
Shqipëria	**9,850,414**	**13,149,117**	**9,542,489**	**720,000**	**(3,298,699)**	**75%**	**103%**
RB Ishëm-Erzeni	5,877,491	6,180,050	4,758,199	78,689	(302,559)	**95%**	124%
RB Ishëm	4,345,967	4,208,786	3,055,352	21,471	137,181	**103%**	142%
Prefektura Tiranë							
Tiranë UK (Ishëm)	4,063,228	*3,725,658*	*2,705,671*	*0*	*337,570*	*109%*	*150%*
Vorë UK (Erzeni)	66,996	*75,339*	*75,019*	*6,686*	*(8,343)*	*89%*	*89%*
Kamëz UK (Ishëm)	225,605	*388,389*	*265,088*	*5,999*	*(162,784)*	*58%*	*85%*
Kavajë UK (Erzeni)	109,487	*358,216*	*265,364*	*20,357*	*(248,729)*	*31%*	*41%*
Prefektura Durrës							
Durrës UK (Erzeni)	1,355,041	*1,537,709*	*1,362,464*	*30,175*	*(182,668)*	*88%*	*99%*
Krujë UK (Ishëm)	57,134	*94,739*	*84,593*	*15,472*	*(37,605)*	*60%*	*68%*
I-E % krahasuar me Shqipërinë	60%	47%	50%	11%	9%		
Ishëm % krahasuar me Shqipërinë	44%	32%	32%	3%	-4%		
Ishëm % krahasuar me I-E	74%	68%	64%	27%	-45%		

11.4.3.2 Nivelet e rikuperimit të kostove financiare korrente të furnizimit publik me ujë dhe mbledhjes/trajtimit të ujërave të ndotura urbane

Për basenet Ishëm-Erzen, normat e rikuperimit të kostos për largimin e ujërave të ndotura urbane dhe për trajtimin e ujërave të ndotura janë ndjeshëm më të larta (përkatësisht 183% dhe 212%) se për furnizimin me ujë të pijshëm (Tabela 11-27). Gjithashtu, për basenin Ishëm, norma e rikuperimit të kostos për largimin e ujërave të zeza (pa trajtim) është 223%.

Po ta shohim situatën në nivel shoqërie në basenet Ishëm-Erzen, norma e rikuperimit të kostos për furnizimin me ujë të pijshëm varion nga 29% në Kavajë në 100% në Tiranë (për Ishmin, shifrat luhaten nga 56% për Krujën në 100% për Tiranën). Për largimin e ujërave të zeza, shifra për basenet Ishëm-Erzen dhe basenin Ishëm luhaten nga 27% në Kamëz deri në 531% në Tiranë (ndërkohë që në Tiranë nuk ka kosto të tjera për shërbimin e kanalizimeve, gjë që është mbresëlënëse dhe sjell normë të madhe rikuperimi). Për sa i përket trajtimit të ujërave të ndotura, në basenin ujor Ishëm nuk ka trajtim.

Së fundi, këshillohet të bëhet një llogaritje e kontributeve të përdorimeve të ndryshme të ujit (nga institucionet shtetërore, ndërmarrjet dhe familjet) në rikuperimin e kostos së shërbimeve të ujit, për të përcaktuar kontributin e tyre në rikuperimin e kostos. Kjo llogaritje nuk është bërë ende, por duke parë se familjet paguajnë tarifat më të larta, mund të supozohet se këta klientë e subvencionojnë në mënyrë të kryqëzuar përdorimin e shërbimit të ujit nga institucionet shtetërore (dhe në varësi të tarifave specifike të shoqërisë, edhe nga ndërmarrjet).

Tabela 11-5 – Norma e Rikuperimit të Kostos Totale për furnizimin me ujë, kanalizimet dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, basenet Ishëm-Erzen dhe basenin Ishëm, 2020.

Kompanitë për shërbimin e Ujit	TË ARDHURAT Uji	TË ARDHURAT Kanalizime	TË ARDHURAT IT e ujërave të ndotura	KOSTOT DIREKTE Uji (në '000 ALL)	KOSTOT DIREKTE Kanalizime (në '000 ALL)	KOSTOT DIREKTE IT e ujërave të ndotura (në '000 ALL)	KOSTO TË TJERA Uji (në '000 ALL)	KOSTO TË TJERA Kanalizime (në '000 ALL)	KOSTO TË TJERA IT e ujërave të ndotura (në '000 ALL)	Shkalla e rikuperimit total të kostos Uji	Shkalla e rikuperimit total të kostos Kanalizime	Shkalla e rikuperimit total të kostos IT e ujërave të ndotura
Shqipëria	**8,390,079**	**1,233,044**	**227,290**	**8,729,978**	**682,456**	**130,056**	**2,832,484**	**601,403**	**172,741**	**73%**	**96%**	**75%**
RB Ishëm-Erzeni	4,927,702	722,499	227,290	4,440,489	250,224	67,485	1,237,473	144,784	39,596	87%	183%	212%
RB Ishëm	3,883,529	462,439		2,948,300	107,052		1,052,803	100,632		97%	223%	n/a
Prefektura Tiranë												
Tiranë UK (Ishëm)	3,641,379	*421,849*	0	*2,626,273*	*79,398*	*0*	*1,019,988*	*0*	*0*	*100%*	*531%*	*n/a*
Vorë UK (Erzeni)	59,542	*7,454*	0	*73,387*	*1,632*	*0*	*320*	*0*	*0*	*81%*	*457%*	*n/a*
Kamëz UK (Ishëm)	192,623	*32,982*	0	*239,080*	*26,008*	*0*	*26,626*	*96,675*	*0*	*72%*	*27%*	*n/a*
Kavajë UK (Erzeni)	93,304	*15,905*	278	*250,010*	*5,942*	*9,412*	*67,433*	*8,442*	*16,977*	*29%*	*111%*	*1%*
Prefektura Durrës												
Durrës UK (Erzeni)	891,327	*236,701*	227,012	*1,168,792*	*135,598*	*58,073*	*116,917*	*35,710*	*22,619*	*69%*	*138%*	*281%*
Krujë UK (Ishëm)	49,526	*7,608*	0	*82,947*	*1,646*	*0*	*6,189*	*3,957*	*0*	*56%*	*136%*	*n/a*
I-E % krahasuar me Shqipërinë	59%	59%	100%	51%	37%	52%	44%	24%	23%			
Ishëm % krahasuar me Shqipërinë	46%	38%	0%	34%	16%	0%	37%	17%	0%			
Ishëm % krahasuar me I-E	79%	64%	0%	66%	43%	0%	85%	70%	0%			

Kostot mjedisore dhe burimore të furnizimit publik me ujë dhe mbledhjes/trajtimit të ujërave të zeza

Për sa i përket çështjes së kostove mjedisore dhe burimore (kostot MB), nuk ka llogaritje specifike për momentin. Kjo vlen për ato kategori kostosh që kanë të bëjnë me ndikimet e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe mbledhjes (e trajtimit) së ujërave të zeza (ka disa informacione të disponueshme, ndonëse të kufizuara, për volumet e ujit dhe informacione të copëzuara për ujërat e ndotura të larguara), por edhe për vetëfurnizimin, ku në fazën fillestare duhen hetuar volumet e përdorura/larguara dhe vendndodhja e tyre, për të përcaktuar ndikimin e tyre në statusin mjedisor sipas DKU-së. Krahas këtyre, kostot e PM-së në basenet ujore përkatëse mund të merren si vlera përfaqësuese (nëse masat e arrijnë statusin e mirë mjedisor sipas DKU-së, atëherë kostot e PM-së mund të shihen si më të ulëta se kostot MB). E megjithatë, në këtë fazë, PM-ja fokusohet te objektivat e lehta për t'u arritur dhe nuk mund të supozojmë se statusi i mirë arrihet për të gjithë trupat ujorë, madje edhe nëse zbatohet plotësisht. Për më tepër, kostimi i masave duhet detajuar më tej. Një prej opsioneve për të pasur të paktën kostimin e parë MB është që instrumentet t'i brendatrupëzojnë këto kosto, duke llogaritur kryesisht tarifat e mbledhura për nxjerrjen e ujit dhe largimin e ujërave të ndotura. Tarifat e reja për përdorimin e ujit janë një hap mjaft i mirë përpara; niveli i tarifave nuk lidhet me ndikimin mjedisor të përdorimit specifik të ujit (me vendndodhjen specifike dhe ndikimin e një përdorimi të caktuar te statusi i mirë, p.sh. ngarkesa specifike e ndotjes nga shkarkimi i ujërave të zeza në mjedis). Këto kategori kostosh janë një element mjaft i rëndësishëm i punës në të ardhmen, për të kuptuar më mirë ndikimet e përdorimit të ujit, gjë që sjell bazë më të mirë informacionesh për menaxhimin e qëndrueshëm të ujit.

Këto janë boshllëqet kryesore në vija të përgjithshme:

- Informacioni mbi vetofrimin e shërbimeve (p.sh. ujitja në bujqësi, nxjerrjet e ujit dhe shkarkimet nga industria dhe familjet);
- Pavarësisht përpjekjeve të ndërmarra për përmirësimin e situatës, nevojitet informacion më i besueshëm për volumet e matura/popullsinë që merr shërbim/humbjet, etj., por edhe informacion financiar për shoqëritë e ujësjellësit, si dhe duhet bërë ndarja e tyre;
- Informacioni për investimet e planifikuara dhe planet për mbulimin e kostove shtesë (p.sh. ITUN i ri) në mënyrë të tillë që të sigurohet një rikuperim i pranueshëm i kostos, por edhe i realizueshëm nga pikëpamja sociale, si dhe planet për sigurimin e realizueshmërisë financiare të shoqërive UK në terma afatgjatë, lidhur me investimet për rritjen e cilësisë së shërbimit;
- Vlerësimet e kostove mjedisore dhe burimore lidhur me ofrimin e shërbimeve të ujit.

11.5 Skenari bazë: me sytë drejt së ardhmes

Roli i analizës ekonomike në zhvillimin e skenarit bazë (SB) ka të bëjë me vlerësimin e parashikimeve të nxitësve ekonomikë kryesorë, që mund të ndikojnë te presionet dhe për rrjedhojë edhe te statusi i ujit. Fokusi duhet të jetë te ndryshimet e variablave të përgjithshme socio-ekonomike (p.sh shtimi i popullsisë), rritja ekonomike e sektorëve kryesorë, si dhe ndryshimet në zbatimin e investimeve të planifikuara lidhur me rregullimet ekzistuese.

Ka shumë rëndësi të vërejmë se për sa i përket ofertës, projeksionet duhen bërë nga pikëpamja hidrologjike. Një prej elementeve kyç janë ndikimet e parashikuara të ndryshimeve klimatike te disponueshmëria e ujit. Fatkeqësisht, në Shqipëri (si dhe në shumë vende të tjera), për shumë elemente thelbësore lidhur me kërkesën për ujë, nuk ka informacion sistematik për nxitësit socio-ekonomikë dhe efektet e tyre në menaxhimin e burimeve ujore. Për basenin ujor Ishëm-Erzen, projeksionet e popullsisë (të skenarit mesatar) tregojnë se pritet rritje prej 4% për periudhën 2021-2031, që është ndjeshëm më e lartë se rënia e pritshme e popullsisë gjatë kësaj periudhe për të gjithë Shqipërinë prej 4%. Kjo do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë te kërkesat e menaxhimit të burimeve ujore në shumë mënyra, sidomos lidhur me furnizimin me ujë dhe kanalizimet. Për t'i llogaritur sa më mirë këto ndryshime, nevojitet një analizë më e detajuar e ndryshimeve rajonale në basen, që lidhet edhe me ndryshimet e konsumit për frymë (ndërsa pasiguritë lidhur me popullsinë që merr shërbim dhe volumet e prodhuara duhen shqyrtuar/reduktuar).

Programi buxhetor afatmesëm 2022-2024 i Ministrisë së Financave tregon se pas një recesioni të fortë në 2020-n në nivelin -4.0%, sipas përllogaritjeve më të fundit të INSTAT-it, ekonomia pritet të rimëkëmbet në 2021-shin dhe të vijojë tendenca rritëse në planin afatmesëm. Rritja ekonomike parashikohet (5.5 % 2021) të mbesë nën 4 për qind në planin afatmesëm. Më konkretisht, rritja ekonomike parashikohet të jetë 4.8, 4.5 dhe 3.9 për qind përkatësisht për vitet 2022, 2023 dhe 2024. Përtej informacioneve të ofruara për investimet në seksionin e rikuperimit të kostos lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizimet (kapitulli 5.4.3 më lart), Programi Kombëtar për Sektorin e Ujit 2018-2030 parashtron[192] projeksionet lidhur me objektivat e sektorit të ujit. Projeksionet financiare bëhen duke marrë në konsideratë zërat e veçantë të buxhetit të renditur në PBA për çdo institucion përgjegjës, p.sh. linja e buxhetit për MIE-në lidhur me FUK, linja e buxhetit të Ministrisë së Mjedisit për monitorimin, etj. Si rezultat, nevojat e përgjithshme për financim për arritjen e këtyre objektivave llogariten të jenë 388,4 miliardë lekë deri në 2030-n, ndërsa buxheti aktual i parashikuar për këtë periudhë është 237,4 miliardë lekë. Kështu, ka hendek financiar prej 151 miliardë lekësh. Nuk mund të bëjmë llogaritje të përgjithshme të sakta (bazuar te projeksionet ekzistuese) të kërkesës së ardhshme për ujë (dhe boshllëkut në furnizim me ujë) dhe presioneve të ardhshme të lidhura me ujin te burimet ujore (për sa i përket sasisë, por edhe cilësisë), sepse shumë prej tyre nuk janë të disponueshme. Përveç nevojës që projeksionet të realizohen/zhvillohen më hollësisht dhe të mbështeten nga studime të veçanta, boshllëku më urgjent për t'u trajtuar është i orientuar drejt procesit. Këtu kërkohet një qasje e bazuar në skenarë sistematikë, pasi njohuritë/informacionet e ekspertëve zotërohen nga disa ministri (e bujqësisë, zhvillimit rural, ekonomisë, etj.), por edhe institucione e palë të tjera interesi (furnizuesit me ujë, shoqatat bujqësore, institutet dhe organizatat kërkimore, etj.) Planet strukturore dhe rajonale, si dhe planet vendore të autoritetit janë burime të rëndësishme informacioni. Ndonëse marrja e informacioneve për disa parametra të renditura në listën më lart është vërtetë e vështirë, duhen bërë përafrime/përllogaritje për çdo parametër/projeksion politike në bashkëpunim me minsitrinë/organin administrativ përgjegjës/kompetent për ofrimin e informacioneve/projeksioneve/gjykimeve të kërkuara eksperte. Qëllimi është që në të ardhmen të bëhen përllogaritje të përgjithshme të rajonalizuara të kërkesës për ujë në të ardhmen dhe presioneve të pritshme te burimet ujore (sasi/cilësi) të baseneve ujore.

[192]Projektprogrami Kombëtar për Sektorin, përgatitur nga AMBU në bashkëpunim me palët përkatëse të interesit. Është në të njëjtën vijë logjike me Axhendën 2030 të OKB-së për OZhQ-të lidhur me ujin. Nuk është miratuar ende, por është konsultuar në shkallë të gjerë me të gjitha palët e interesit në nivel kombëtar dhe vendor, ku janë zhvilluar edhe mbledhje të posaçme me ministritë e linjës.

12 Politikat Mjedisore në Nivelin e Basenit ujor

12.1 Politikat Mjedisore për Trupat Ujorë - Ishëm

Ky kapitull përmbledh politikat dhe qasjen e gjerë strategjike të PMBU-së 2024-2029 të parashikuar nga AMBU për arritjen e objektivave mjedisore të përshkruara në kapitullin 3. Këto politika dhe masa të gjera strategjike gjejnë zbatim si për ujërat nëntokësore, ashtu edhe për ujërat sipërfaqësore, sipas rastit.

Duhet bërë dallimi midis objektivave të përgjithshme të politikave mjedisore dhe Programit të Masave që është më i shënjestruar (PiM, Kapitulli 13). Për trupat ujorë që nuk i kanë arritur objektivat mjedisore nevojiten masa të shënjestruara, duke përcaktuar presionet dhe masave përkatëse. Megjithatë, një prej kërkesave themelore të Direktivës Kuadër të Ujit (DKU, Preambula 26) është se kur trupi ujor gëzon status të mirë, ky status duhet ruajtur dhe për pasojë ky objektiv nuk bën pjesë në Programin e Masave.

Qëllimi i këtij kapitulli është të përshkruajë në terma të gjerë politikën dhe/ose qasjen strategjike që do të zbatohet nga AMBU përgjatë basenit ujor . Qëllimi i këtyre politikave është të sigurojnë se të gjithë trupat ujorë që gëzojnë status të mirë ta ruajnë atë status (pra, të mos përkeqësohen). Rrjedhimisht, këto objektiva strategjike gjejnë zbatim për të gjithë trupat ujorë brenda basenit ujor dhe mund të përfshijnë një sërë udhëzimesh teknike dhe/ose instrumentesh ligjore ose fiskale për të arritur në veçanti:

- Ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit ujor (DKU 19);
- Reduktimin e substancave prioritare të rrezikshme (DKU 27);
- Koordinimin e masave afatgjata të qëndrueshmërisë brenda të njëjtave sisteme ekologjike, hidrologjike dhe hidrogjeologjike (DKU 33);
- Integrimin më të mirë të aspekteve cilësore dhe sasiore të sistemeve të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore (DKU 34);
- Zbatimin e qasjes së kombinuar në parandalimin dhe kontrollin e ndotjes, duke përfshirë vlerat kufi të emetimeve (VKE) dhe standardet cilësore mjedisore (SCM) (DKU 40).

Disa prej këtyre instrumenteve politik mund të lidhen drejtpërdrejt me trupat ujorë individualë ose grupimet e trupave ujorë si pjesë e Programit të Masave, por në këto raste, masat që do të zbatohen duhet të jenë të specifikuara për sa i përket tipit të masës dhe treguesit të masës (shihni Kapitullin 13).

12.1.1 Përmbledhja e Nismave për të Mbështetur Objektivat Mjedisore

Vështrimi i përgjithshëm i politikës së propozuar, strategjisë së përgjithshme dhe praktikave të konsoliduara të rregullimit ose zbatimit paraqitet në Tabela 12-1. Zbatimi i këtyre politikave, strategjive dhe masave të mundshme vijuese mund të kërkojë koordinim dhe buxhet nga disa autoritete kompetente nën drejtimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) dhe në disa raste mund të nevojitet edhe legjislacioni plotësues.

Tabela 12-1 nuk është matricë e “alternativave të mundshme”. Qëllimi i saj është të tregojë, në të mirë të grupeve të interesit, se ku AMBU synon që të ndërmarrë në mënyrë aktive nisma për ndryshime në politikë dhe/ose ndërhyrje strategjike për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të burimeve ujore dhe shërbimeve të ujit.

Metodologjitë dhe ndërveprimet sektoriale për çdo politikë ose ndërhyrje zbatuese përvijohen me detaje në seksionet 12.1.2 deri në 12.1.11, siç janë kërkesat për koordinimin midis autoriteteve kompetente.

12.1.1.1 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Monitorim të Përshtatshëm Sasior të Ujërave Sipërfaqësore

Në basenin e lumit Ishëm nuk ka pasur rrjet hidrometrik të besueshëm dhe të vazhdueshëm për rrjedhën ujore të lumit gjatë dy dekadave të fundit. Informacioni më i fundit i publikuar për sasitë e ujërave sipërfaqësore i përket vitit 1984 “Hidrologjia e Shqipërisë”. Rrjeti kombëtar hidrometrik (meteorologjik dhe hidrologjik) është nën autoritetin kompetent të IGjEO-it (Instituti i Gjeoshkencave- Departamenti i Ekonomisë së Ujit dhe Energjisë së Rinovueshme), por ky autoritet nuk ka as administrim të përshtatshëm dhe as burime të mjaftueshme për të

ofruar një rrjet kombëtar të besueshëm. [193]Shumica e stacioneve ndërkombëtare të matjes së prurjes standarde për mbikëqyrjen rutinore të prurjes së lumit në basenin e Ishmit janë prishur.

Shumë prej aspekteve thelbësore të PMBU-së së bazuar në një MIBU kuptimplotë nuk mund të arrihen pa një burim të besueshëm për prurjet aktuale në vendndodhjet strategjike brenda basenit ujor . Më konkretisht:

- Nuk ka informacion për shpërndarjen e burimeve ujore në basenin ujor , nuk mund të përcaktohet qoftë edhe një bilanc ujor bazë dhe nuk ka asnjë lloj lehtësie për përcaktimin e përshtatshëm të shpërndarjes së burimeve ujore midis sektorëve.
- Prurjet ekologjike, që janë jetike për ruajtjen e ekosistemeve ujore, nuk mund të llogariten me besueshmëri.
- Ngarkesat e ndotësve (faktor thelbësor për përcaktimin e statusit fiziko-kimik të trupave ujorë dhe/ose vlerat e synuara për masat propozuara) nuk mund të llogariten.
- Reduktimi i burimeve ujore në basenin ujor për shkak të ndryshimeve klimatike, nuk mund të vlerësohen duke marrë parasysh ndërlikimet kritike për menaxhimin e burimeve ujore, në të ardhmen.

Raporti më i fundit i BE-së në vitin 2021 e vë theksin te *"përafrimi i mëtejshëm me direktivat kryesore të ujit, duke miratuar paketën e re ligjore të sapopërgatitur; miratimi i strategjisë së re për furnizimin me ujë dhe kanalizimet 2021-2030; rritja e ndjeshme e burimeve financiare dhe rritja e kapaciteteve në agjencitë kombëtare përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore, furnizimin me ujë, kanalizimet dhe infrastrukturën e mbetjeve, zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të ujit"*

Për më tepër, plani i veprimit të Strategjisë Kombëtare për menaxhimin e integruar të burimeve ujore parashikon veprimtari të ndryshme monitorimi, që nuk zbatohen plotësisht për shkak të hendekut financiar, i cili fillimisht duhet plotësuar në mënyrë që këto veprimtari të zbatohen plotësisht.

Duke marrë parasysh sa më lart dhe kërkesat për zbatimin e Strategjisë Kombëtare, AMBU i ka kërkuar ndihmë financiare asistencës IPA III për përmirësimin e rrjetit të monitorimit (si dhe pajisje e asistencë teknike) nëpërmjet Dokumentit të Veprimit për Ujërat. Krahas AMBU-t, këtë asistencë e përfitojnë edhe institucione të tjera si AKM-ja, IGJEO-i, ShGjSh-ja, IShP-ja etj.

Objektivi (ndikimi) kryesor i këtij veprimi është "të ruajë dhe përmirësojë statusin cilësor të trupave ujorë në Shqipëri".

Objektivat (rezultatet) specifike të këtij veprimi, lidhur me dy fushat e mbështetjes të identifikuara në arsyetim (MIBU dhe TUN) janë:

- Rezultati 1: Rritja e shkallës së përafrimit të legjislacionit kombëtar me *AQUIS* e BE-së për ujin.
- Rezultati 2: Reduktimi i shkarkimeve të ujërave të ndotura në trupa ujorë, për të çuar përpara përafrimin me kërkesat e DTUNU-t.

Në kuadër të rezultatit 1, pritet të arrihet rezultati 1.3 "Përforcimi i monitorimit dhe raportimit për burimet ujore në përputhje me kërkesat e Direktivave përkatëse të BE-së për burimet ujore", më konkretisht:

1.3a: **Zhvillimi i kapaciteteve laboratorike** - Shtimi i kapaciteteve të monitorimit për sa i përket numrit të parametrave të monitorimit të burimeve ujore nga Direktivat e BE-së, për të cilat janë akredituar laboratorët referencë (AKM, ShGjSh, IShP, NJVKSh)
1.3b: **Monitorimi operacional në BU** - Shtimi i kapaciteteve të monitorimit për sa i përket numrit të stacioneve të monitorimit (fikse, me përdorim të varkave, ose me përdorim të mjeteve lundruese) në mënyrë rutinë (për ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, ujërat bregdetare, meteorologjinë, hidrometrinë)

1.3c: Numri i njoftimeve dhe veprimeve përforcuese të raportuara mbi baza vjetore (AKM, ShGjSh, IShP)

[193]Për Ngritjen e Platformës Institucionale dhe Rregullatore për Qeverisjen dhe Funksionimin (IRP) e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore në Shqipëri, Banka Botërore, Tetor 2019.

12.1.2 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Monitorim të Përshtatshëm të Ujërave Nëntokësore

Në kuadër të rezultatit 1 "Rritja e shkallës së përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis e BE-së për ujin", në dokumentin e veprimit për burimet ujore, pritet të arrihet rezultati 1.3 "Përforcimi i monitorimit dhe raportimit për burimet ujore në përputhje me kërkesat e Direktivave përkatëse të BE-së për burimet ujore", ku veçanërisht për monitorimin e ujërave nëntokësore kërkohet:

- Analiza kimike, morfologjia, sasitë, vlerësimi i ujërave nëntokësore në 7 BU.
- Shtimi i kapaciteteve të monitorimit për sa i përket numrit të parametrave të monitorimit të burimeve ujore nga Direktivat e BE-së, për të cilat janë akreditуar laboratorët referencë (AKM, ShGjSh, IShP, NJVKSh)
- Shtimi i kapaciteteve të monitorimit për sa i përket numrit të stacioneve të monitorimit - 40 stacione të reja monitorimi për ujërat nëntokësore.

12.1.3 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Monitorim të Përshtatshëm të Cilësisë së Ujit

Në kuadër të rezultatit 1 "Rritja e shkallës së përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis e BE-së për ujin", në dokumentin e veprimit për burimet ujore, pritet të arrihet rezultati 1.3 "Përforcimi i monitorimit dhe raportimit për burimet ujore në përputhje me kërkesat e Direktivave përkatëse të BE-së për burimet ujore", ku veçanërisht për monitorimin e cilësisë së ujërave kërkohet:

- Shtimi i kapaciteteve të monitorimit për sa i përket numrit të parametrave të monitorimit të burimeve ujore nga Direktivat e BE-së, për të cilat janë akreditуar laboratorët referencë (AKM, ShGjSh, IShP, NJVKSh)
- Shtimi i kapaciteteve të monitorimit për sa i përket numrit të stacioneve të monitorimit (fikse, me përdorim të varkave, ose me përdorim të mjeteve lundruese) të pajisura, instaluara dhe operuara në mënyrë rutinë (për ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, ujërat bregdetare, meteorologjinë, hidrometrinë; stacione të reja monitorimit për hidrometeorologjinë (15 stacione hidrologjike + 15 stacione meteorologjike)
- Hartimi i programit kombëtar të monitorimit.

12.1.4 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Monitorim të Përshtatshëm Hidrobiologjik

Në kuadër të rezultatit 1 "Rritja e shkallës së përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis e BE-së për ujin", në dokumentin e veprimit për burimet ujore, pritet të arrihet rezultati 1.3 "Përforcimi i monitorimit dhe raportimit për burimet ujore në përputhje me kërkesat e Direktivave përkatëse të BE-së për burimet ujore", ku veçanërisht për monitorimin hidrobiologjik kërkohet:

- Shtimi i kapaciteteve të monitorimit për sa i përket numrit të parametrave të monitorimit të burimeve ujore nga Direktivat e BE-së, për të cilat laboratorët referencë janë akreditуar nga AKM-ja.
- Kampionime dhe analiza, vlerësimi i statusit biologjik në 7 BU.
- Shtimi i kapaciteteve të monitorimit për sa i përket numrit të stacioneve të monitorimit (fikse, me përdorim të varkave, ose me përdorim të mjeteve lundruese) të pajisura, instaluara dhe operuara në mënyrë rutinë (për monitorim të përshtatshëm hidrobiologjik).

12.1.5 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Kontrollet e Nxjerrjeve të Ujit

Përdorimi i pakontrolluar ose mbishfrytëzimi i burimeve ujore renditen aktualisht në mesin e ndikimeve negative te burimet tona ujore. Kjo vlen për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, të cilat janë burime thelbësore dhe aktualisht furnizojnë sasi të mëdha të ujit të pijshëm dhe të ujit për ujitjen e tokave bujqësore, sidomos në zonat bregdetare të BU-së Ishëm. AMBU është autoriteti përgjegjës që duhet të sigurojë mbi baza vjetore që nevojat mjedisore dhe nevojat për konsumin total të ujit nga burimet ujore, të cilat nuk duhet t'i tejkalojnë nivelet e burimeve të rinovueshme vjetore.

Problemi me kontrollin e nxjerrjeve të ujit ka të bëjë kryesisht me operimin e mijëra përdoruesve që marrin shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm ose ujë për qëllime bujqësore (ujitje) apo industriale. Për shkak të këtij problemi, nuk dihet me saktësi bilanci vjetor i ujit në nivel baseni ujor, pasi të dhënat nuk janë të disponueshme ose mungojnë, përdoruesit nuk raportojnë rregullisht dhe regjistrimi i këtyre të fundit nuk është i plotë pasi ka shumë përdorues të paligjshëm.

Për t'i zgjidhur problemet e identifikuara lidhur me kontrollin e nxjerrjeve të ujit, është hartuar Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Burimeve Ujore, që është instrumenti kryesor politik dhe strategjik i ndërhyrjes. Objektivi i saj kryesor është të mbrojë sasinë e ujërave dhe, për pasojë, të sigurojë shpërndarje sa më efikase të

tij midis përdoruesve. Strategjia kërkon hartimin dhe zbatimin e PMBU-ve, të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës së shpërndarjes së ujit, nëpërmjet marrjes së masave mbrojtëse dhe marrjes parasysh të ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Kontrolli rutinë i përdoruesve të burimeve ujore në nivel vendi dhe baseni ujor, për sa i përket procedurave të aplikimit dhe dhënies së lejeve apo autorizimeve, parashikohet në dispozitat përkatëse të VKM-së Nr. 550, datë 15.07.2020.

Sipas dispozitave ligjore, përgjegjëse për vlerësimin teknik të aplikimeve dhe dhënies së lejeve për përdorimin e burimeve ujore është AMBU. Gjendja aktuale duhet përmirësuar për të arritur në të ardhmen një balancë të qëndrueshme midis nevojave ekonomike dhe mjedisore.

12.1.6 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Eficiencën e Përdorimit të Ujit

Bazuar te DKU-ja:

- Pika (19) parashikon se: Direktiva synon të mbrojë dhe përmirësojë mjedisin ujor në komunitet. Qëllimi kryesor i saj ka në qendër cilësinë e ujit në fjalë. Kontrolli i cilësisë është element shtesë që ndihmon në sigurimin e cilësisë së mirë të ujit, prandaj duhen marrë masat e nevojshme lidhur me sasinë, të cilat t'i shërbejnë arritjes së objektivit të sigurimit të cilësisë më të mirë të mundshme.
- Pika Nr. (41) parashikon se: Në lidhje me sasinë e ujit, duhet të përcaktohen parime të përgjithshme të kontrollit për marrjen dhe grumbullimin, me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëria mjedisore e sistemeve ujore të prekura.

Duke iu referuar kësaj direktive, është bërë i mundur identifikimi i problemeve kryesore lidhur me përdorimin eficient të burimeve ujore:

1. Kontrolli dhe regjisti i lejeve të dhëna për përdorimin e burimeve ujore
2. Ndryshimet klimatike globale (të ndikuara nga përmbytjet dhe thatësirat)
3. Monitorimi i sasisë dhe cilësisë së burimeve ujore.

Nëse flukset në hyrje në ujëra sipërfaqësore ulen dhe avullimi rritet, reduktohet edhe sasia e ujit e grumbulluar çdo vit në rezervuarë, çka do të thotë më pak ujë për njerëzit, HEC-et dhe bujqësinë, sidomos gjatë muajve kritikë (të thatë) të verës. Ujërat nëntokësore ndikohen nga pakësimi i ujërave sipërfaqësore, për shkak të reduktimit të reshjeve e rrjedhave sipërfaqësore, si dhe humbjeve të lagështisë së tokës prej rritjes së evapotranspirimit.

Autoritetet përgjegjëse për monitorimin e hidrometeorologjisë duhet të përmirësojnë urgjentisht disponueshmërinë dhe gamën e të dhënave lidhur me përdorimin eficient të burimeve ujore. Përgatitja e bilancit të përditësuar dhe të saktë të burimeve ujore në nivel baseni, rihapja e stacioneve të monitorimit (matja e flukseve në hyrje dhe operimi nga agjencitë kombëtare), vlerësimi paraprak i riskut nga përmbytjet ose thatësirat duke përgatitur planet përkatëse të menaxhimit, të cilat rregullohen dhe sanksionohen nga legjislacioni në fuqi.

Strategjia për Menaxhimin e Burimeve Ujore është instrumenti kryesor politik dhe strategjik i ndërhyrjes. Objektivi i saj kryesor është të mbrojë sasinë e ujërave dhe, për pasojë, të sigurojë shpërndarje sa më efikase të tij midis përdoruesve. Strategjia kërkon hartimin dhe zbatimin e PMBU-ve, të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës së shpërndarjes së ujit, nëpërmjet marrjes së masave mbrojtëse dhe marrjes parasysh të ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Kontrolli rutinë i përdoruesve të burimeve ujore në nivel vendi dhe baseni ujor , për sa i përket procedurave të aplikimit dhe dhënies së lejeve apo autorizimeve, parashikohet në dispozitat përkatëse të VKM-së Nr. 550, datë 15.07.2020.

Sipas dispozitave ligjore, përgjegjëse për vlerësimin teknik të aplikimeve dhe dhënies së lejeve për përdorimin e burimeve ujore është AMBU. Gjendja aktuale duhet përmirësuar për të arritur në të ardhmen një balancë të qëndrueshme midis nevojave ekonomike dhe mjedisore.

12.1.7 Politika dhe Ndërhyrjet Strategjike për Përputhshmërinë e Prurjes Ekologjike


Përcaktimi i saktë dhe mirëmbajtja e prurjes ekologjike thelbësore për arritjen e statusit të mirë ekologjik për pjesën më të madhe të sistemeve lumore (shihni seksionin 3.3.5). Sipas praktikës më të mirë, prurja ekologjike nuk konsiderohet si minimum i vetëm ose si prurje e pandryshueshme në kohë (Figura 12-1 majtas), mbi të cilën

lejohen të gjitha nxjerrjet e ujit pa dëmtuar ekosistemet ujore (siç nënkuptohet nga ligji aktual për MIBU-n në nenin 4 - prurja e qëndrueshme = prurje e tejkaluar për 355 ditë të vitit (Q_{97})). Në vend të kësaj, prurja ekologjike duhet të pasqyrojë të gjithë regjimin natyror të prurjes së lumit, i cili ndryshon sipas sezoneve (Figura 12-1 djathtas), ndaj prurja ekologjike mund të jetë mbi dhe/ose nën prurjet aktuale të krijuara nga ndikimet artificiale.

Përkufizimi aktual ligjor i "prurjes së qëndrueshme" në Shqipëri nuk është i barasvlershëm me praktikën më të mirë dhe në periudhën 2024-2029 do të ndërmerret shqyrtimi i metodologjisë kombëtare për prurjen ekologjike. Ndërkohë, subjektet do të duhet të respektojnë regjime prurjesh më të orientuara ndaj sezonit dhe më të përshtatshme nga pikëpamja ekologjike krahasuar me ato aktualet, të përcaktuara për çdo lum individual.

Subjektet që planifikojnë të nxjerrin, depozitojnë, devijojnë ose sharkojnë ujë për çdo qëllim, do të kenë detyrimin t'i planifikojnë operacionet e tyre në mënyrë që regjimi i prurjes ekologjike të mos ndikohet më tepër sesa duhet.

Figura 12-1 – Koncepti i Restaurimit të Prurjes Ekologjike



Regjimi hidrologjik i prurjeve në hyrje në shumë lumenj luan rol të rëndësishëm në strukturën dhe funksionimin e ekosistemeve ujore. Kur ndryshon regjimi natyror, për shembull nëpërmjet devijimit të prurjeve në hyrje për ndërtimin e HEC-eve, ose tejkalimit të niveleve të nxjerrjes së ujit për ujitje ose ujë të pijshëm, regjimi i ndryshuar pritet të ketë ndikim dëmtues, sidomos tek ekosistemet ujore, dhe të përkeqësojë statusin "e mirë" ekologjik të trupave ujorë. Ky koncept është objektivi kryesor mjedisor i DKU-së.

Është thuajse e sigurt se "prurja minimale ekologjik", i përshkruar në ligjin nr. 111/2012, ndryshuar dhe azhornuar me ligjin nr. 6/2018, bazuar te prurjet në hyrje ekuivalente me 355 ditë të vitit, nuk mjafton për mbrojtjen e ekosistemeve ujore. Shumë HEC-e në të gjithë vendin vijojnë të miratohen bazuar vetëm te këto kritere, duke lejuar me shumë gjasë të gjitha prurjet në hyrje mbi këtë limit minimal për shfrytëzim dhe devijim.

Figura 12-1 tregon një prej praktikave më të mira të menaxhimit të prurjes ekologjike, ku rrjedha minimale ekologjike identifikohet për çdo muaj të vitit. Për të ruajtur statusin e mirë ekologjik të trupit ujor, ky i fundit duhet përdorur gjatë periudhës së lagësht të vitit (mars, prill), gjë që mund të sjellë reduktim të përdorimit gjatë muajve të thatë të verës (për shembull gusht, shtator). Përdorimi i tepruar i ujit shkatërron statusin ekologjik të trupit ujor.

Për çdo ndërhyrje të parashikuar ose të planifikuar nga subjektet, ndërmerret vlerësimi mjedisor i ndikimeve (Ligji Nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit mjedisor"), që synon të sigurojë një nivel të lartë mbrojtjeje mjedisore, nëpërmjet parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmit mjedisor, nga projekte të propozuara përpara miratimit të zhvillimit të tyre; të sigurojë procese të hapura vendimmarrëse lidhur me identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore negative, në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme; si dhe të sigurojë përfshirjen e të gjithë palëve të interesit. Kushtet që duhen plotësuar nga subjektet (për përdorimin e ujërave sipërfaqësore, për ujë të pijshëm, ujitje, akuakulturë, qëllime industriale, etj.) parashtrohen në VKM-në Nr. 550, datë 15.07.2020.

Koncepti i prurjes ekologjike dhe zbatimit i saj te lejet për përdorimin e burimeve ujore në Shqipëri duhet rishikuar dhe rivlerësuar, bazuar te mendimi i ekspertëve dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Këto procedura teknike standarde duhen zbatuar për të përcaktuar me saktësi nivelin e ndikimit te veprimtarive të prurjes ekologjike te përdorimet e ndryshme të burimeve ujore, dhe shkarkimet që krijohen në ekosisteme ujore pas përdorimit të ujit. Këto shkatërrime bien ndesh me OM-të e parashtruara në DKU dhe për këtë arsye duhen marrë masa për të përmbushur kriteret e statusit të mirë ekologjik në Direktivë.

12.1.8 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Përmirësimin e Raportimit nga Subjektet

Rritja e kërkesës për përdorimin e burimeve ujore ka sjellë rritje të raportimeve rreth situatës dhe monitorimeve të trupave ujorë nga vetë subjektet. Çdo subjekt që planifikon të përdorë burime ujore duhet të marrë fillimisht lejen ose autorizimin përkatës, bazuar te dispozitat e Ligjit Nr. 111/2012, ndryshuar me Ligjin Nr.6/2018.

Kushtet përkatëse renditen si të detyrueshme për t'u plotësuar nga Subjektet menjëherë pas lëshimit të lejes nga AMBU (VKM Nr. 550, datë 15.07.2020), përfshi edhe detyrimet për të raportuar mbi sasinë e përdorur të ujit, pikat e shkarkimit dhe sasitë.

Për më tepër, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit mjedisor", Subjekteve i jepet leja mjedisore ose i nënshtrohen procedurave të vlerësimit të ndikimeve mjedisore përpara fillimit të një veprimtarie të caktuar industriale. Subjektet ndërmarrin monitorime periodike, për të cilat i raportojnë AKM-së. Përmbushja e detyrimeve dhe raportimi periodik mund të sjellin përmirësime dhe kontroll më efikas të burimeve ujore.

12.1.9 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Kontrollin e Ndotjes në Terren

Shkarkimet e ujërave të ndotura janë flukse në hyrje që derdhen kryesisht në ujëra lumore ose bregdetare, pasi të jenë shfrytëzuar dhe përdorur (për ujë të pijshëm, qëllime industriale, qëllime bujqësore ose prodhim të hidroenergjisë). Në rastin e ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura urbane, nëse nuk i nënshtrohen nivelit të duhur të trajtimit, ndotësit mund të shkarkohen në trupa ujorë sipërfaqësorë, duke sjellë ndikime të mëdha mjedisore për llojet ujore dhe duke përkeqësuar statusin ekologjik të trupave ujorë.

Problemi më i madh në Shqipëri është ndotja nga ujërat e ndotura urbane, sektori i industrisë dhe ai i bujqësisë, sepse ujërat e ndotura përmbajnë përqendrime të mëdha të patogjenëve, nitrateve, fosfateve, amonit, metaleve të rënda dhe hidrokarbureve. Hedhja e mbetjeve të ngurta industriale ose urbane direkt në lumenj ose zona në afërsi të bregdetit është një tjetër problem madhor që shkakton ndotje.

Kontrolli i ndotjes në pikën e trajtimit ose pas përdorimit rregullohet nga dispozitat e Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i cili synon të sigurojë nivel të lartë mbrojtjeje për mjedisin, ta ruajë dhe përmirësojë atë, të parandalojë ose reduktojë rreziqet për jetën dhe shëndetin e njeriut, të garantojë dhe përmirësojë cilësinë e jetesës në të mirë të brezave të ardhshëm, si dhe të ofrojë kushtet e përshtatshme për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Krahas ligjit të lartpërmendur, legjislacioni përkatës parashikon kërkesa specifike ligjore, që i përgjigjen aspekteve të ndryshme të sektorit ujor. Për kontrollin e cilësisë së ujërave të larjes, janë vendosur disa standarde dhe rregulla të caktuara, në përputhje me rregulloren e BE-së "Cilësia e ujit të pijshëm" (VKM Nr. 379, datë 25.5.2016). Krahas kësaj, për të parandaluar, reduktuar dhe shmangur ndotjen e mjedisit të ujërave pritëse nga substancat e rrezikshme, të cilat shkarkohen aty nëpërmjet ujërave të ndotura, dhe për të përcaktuar vlerat kufi për komponentët e lejuar, VKM-ja Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret për zonimin e mjedisit të ujërave pritëse" parashikon standarde dhe rregulla të posaçme.

Për më tepër, duke pasur si objektiv kontrollin e cilësisë së shkarkimeve të ujërave të ndotura në mjedis, Ligji Nr. 9115, datë 24.7.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura" parashikon rregulla të posaçme për trajtimin e tyre mjedisor, si dhe detyrimet e subjekteve që shkarkojnë ujëra të ndotura.

Për ta kontrolluar ndotjen në burim ose në vendin ku po përdoret uji, duhet të ketë një regjistër funksional dhe nevojitet forcimi urgjent i të gjitha kushteve për shkarkimet industriale për të pasur tregues më të mirë për presionet e ndotësve, ku të mund të vlerësohen në mënyrë individuale gjendjet dhe objektivat mjedisore për mjediset ujore pritëse dhe shkarkimet e derdhura në po të njëjtin trup ujor.

12.1.10 Politika dhe Ndërhyrjet Strategjike për Vetëmonitorimin e Subjekteve

Matja dhe menaxhimi i sasive të ujit është shumë i rëndësishëm për përdorimin afatgjatë të ujit. Matjet e sakta të reshjeve të shiut dhe shkarkimet e ujit në basen ujor janë elemente thelbësore për menaxhimin e flukseve në hyrje në ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe për vlerësimin e ndryshimeve klimatike.

Problemi lidhur me monitorimin hidromorfologjik është se AMBU po përballet me mungesën e vlerësimit sasior të burimeve ujore në basene ujore. Kjo mungesë njohurish kërkon ndërhyrje të menjëhershme pasi lidhet ngushtë me emergjencën e ndryshimeve klimatike globale.

Për sa i përket problemit të monitorimit të sasive të burimeve, ai haset edhe te përdoruesit e HEC-eve, të cilët nuk ia raportojnë rregullisht AMBU-t sasitë që përdorin. Kjo do të thotë se nuk mund të ndërmerret rishikimi ose kontrolli vjetor i bilancit të ujit në Kadastrën e Ujit.

Legjislacioni që është aktualisht në fuqi lidhet ngushtë me monitorimin dhe përcakton me saktësi mënyrat më të përshtatshme të veprimit të përdoruesve të burimeve ujore, por edhe të agjencive që i menaxhojnë dhe kontrollojnë burimet ujore.

Një prej institucioneve që ka në juridiksionin e vet trajtimin e përdorimit në masë të burimeve ujore për qëllime të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve në sektorin e konsumit është ERrU, i cili monitorin performancën e operatorëve të ujësjellës-kanalizimeve për t'u siguruar se po i përmbushin përgjegjësitë e veta dhe për të parë progresin e tyre në përmirësimin e shërbimeve. Monitorimi mundëson vlerësimin e saktë të performancës së çdo operatori dhe vendos objektiva sfiduese duke marrë parasysh kapacitetin aktual. Arritjet maten me Treguesit Kyç të Performancës Performanca e operatorit lidhur me shërbimin operacional, financiar dhe ndaj klientit i nënshtrohet çdo vit shqyrtimit Publik me publikimin e Raportit të Performancës.

Sipas dispozitave të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit mjedisor", subjekteve u jepet leja mjedisore ose u nënshtrohen procedurave të vlerësimit të ndikimit mjedisor përpara fillimit të një veprimtarie të caktuar industriale. Subjektet ndërmarrin monitorime periodike, për të cilat i raportojnë AKM-së.

Marrja e masave konkrete për përditësimin e statusit të bilancit të ujit, në sistemin e raportimit standard dhe të detyrueshëm me ligj për Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore, në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet e përfshira në këtë çështje, në mënyrë që trupi ujor të arrijë një status sa më të mirë përgjatë periudhës së zbatimit të këtij plani menaxhimi.

12.1.10.1 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Kontrollet e Shkarkimeve të Lëndëve Ushqyese

Ndotja nga lëndët ushqyese shihet si problem për shkak të ndikimeve të shumta ekonomike, sociale dhe mjedisore, që shkaktohen nga ndotës të ndryshëm me origjinë nga burime dhe aktivitete të ndryshme, të cilat ekzistojnë në kohë dhe hapësira të ndryshme. Natyra globale, rurale dhe urbane e problemit, e bën menaxhimin e ndotjes nga lëndët ushqyese edhe më të vështirë.

Kontrolli i ndotjes në pikën e trajtimit ose pas përdorimit rregullohet nga dispozitat e Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i cili synon të sigurojë nivel të lartë mbrojtjeje për mjedisin, ta ruajë dhe përmirësojë atë, të parandalojë ose reduktojë rreziqet për jetën dhe shëndetin e njeriut, të garantojë dhe përmirësojë cilësinë e jetesës në të mirë të brezave të ardhshëm, si dhe të ofrojë kushtet e përshtatshme për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Krahas ligjit të lartpërmendur, legjislacioni përkatës parashikon kërkesa specifike ligjore, që i përgjigjen aspekteve të ndryshme të sektorit ujor. Për kontrollin e cilësisë së ujërave të larjes, janë vendosur disa standarde dhe rregulla të caktuara, në përputhje me rregulloren e BE-së "Cilësia e ujit të pijshëm" (VKM Nr. 379, datë 25.5.2016). Krahas kësaj, për të parandaluar, reduktuar dhe shmangur ndotjen e mjedisit të ujërave pritëse nga substancat e rrezikshme, të cilat shkarkohen aty nëpërmjet ujërave të ndotura, dhe për të përcaktuar vlerat kufi për komponentët e lejuar, VKM-ja Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret për zonimin e mjedisit të ujërave pritëse" parashikon standarde dhe rregulla të posaçme.

Për më tepër, duke pasur si objektiv kontrollin e cilësisë së shkarkimeve të ujërave të ndotura në mjedis, Ligji Nr. 9115, datë 24.7.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura" parashikon rregulla të posaçme për trajtimin e tyre mjedisor, si dhe detyrimet e subjekteve që shkarkojnë ujëra të ndotura. Sipas legjislacionit dhe praktikave më të mira të kontrollit të shkarkuesve ushqimorë, duhen hartuar masat e duhura për parandalimin dhe minimizimin e ndotjes.

12.1.11 Politika ose Ndërhyrjet Strategjike për Restaurimin e Strukturave dhe Vazhdimësisë

Shqetësimi dhe prishja e habitateve ujore nëpërmjet kanalizimeve dhe ndryshimeve të zonave të përmbytura ka ndikim shumë të madh te llojet ujore. Këtu përfshihen dëmet e drejtpërdrejta që pësojnë ekosistemet ujore nëpërmjet veprimtarisë së pakontrolluar minerare, barrierave të lëvizjes, lëshimit të vezëve dhe migrimit të peshqve, ndjekur nga ndërtimi i barrierave, digave, argjinaturave, shkarkimet e ujërave të ndotura në lumenj për shkak të urbanizimit dhe zonimit të përmbytjeve natyrore nga korridori i lumit, si rezultat i skemave të

mbrojtjes nga përmbytjet. Të gjitha këto veprimtari ndikojnë te cilësia dhe qëndrueshmëria e ekosistemeve ujore.

Vërehet efekteve të dëmshme të ndërhyrjeve në morfologjinë dhe vazhdimësinë e lumenjve. Është lejuar ndërtimi i shumë skemave pa ndërmarrë më parë vlerësimin e hollësishëm të ndikimeve mjedisore. Digat dhe barrierat janë ndërtuar pa marrë parasysh rrugëkalimet e peshqve apo vazhdimësinë e habitatit. Argjinaturat për mbrojtjen nga përmbytjet dhe veprimtaritë e tjera në brigje e ndajnë kanalin nga shtrati natyror i zonës së përmbytshme.

Mbrojtja mjedisore dhe rehabilitimi i ekosistemeve rregullohet nga dispozitat e Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i cili synon të sigurojë nivel të lartë mbrojtjeje për mjedisin, ta ruajë dhe përmirësojë atë, të parandalojë ose reduktojë rreziqet për jetën dhe shëndetin e njeriut, të garantojë dhe përmirësojë cilësinë e jetesës në të mirë të brezave të ardhshëm, si dhe të ofrojë kushtet e përshtatshme për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Krahas ligjit të lartpërmendur, legjislacioni përkatës parashikon kërkesa specifike ligjore, që i përgjigjen aspekteve të ndryshme të sektorit ujor. Për të parandaluar, reduktuar dhe shmangur ndotjen e mjedisit të ujërave pritëse nga substancat e rrezikshme, të cilat shkarkohen aty nëpërmjet ujërave të ndotura, dhe për të përcaktuar vlerat kufi për komponentët e lejuar, VKM-ja Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret për zonimin e mjedisit të ujërave pritëse” parashikon standarde dhe rregulla të posaçme.

Për më tepër, duke pasur si objektiv kontrollin e cilësisë së shkarkimeve të ujërave të ndotura në mjedis, Ligji Nr. 9115, datë 24.7.2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” parashikon rregulla të posaçme për trajtimin e tyre mjedisor, si dhe detyrimet e subjekteve që shkarkojnë ujëra të ndotura.

Përgatitja e PMBU-ve mundëson përcaktimin e standardeve kyç në nivel baseni ujor lidhur me “ruajtjen” e statusit “të mirë” ose “të lartë” të një trupi ujor dhe përmirësimin e këtij statusi kur është mesatar ose më i ulët. Në fokus të marrjes së masave të menjëhershme duhet të jetë ndërhyrja e menjëhershme në gjatësi të caktuara të trupit ujor që ka pësuar modifikim fizik me ndikim të madh mjedisor.

Tabela 12-1 – Përmbledhja e Masave të Përgjithshme Politike ose Strategjike në Mbështetje të Objektivave Mjedisore 2024-2029

PRESIONET NGA SEKTORI DHE BURIMI	KONTROLLET E NXJERRJEVE	EFICIENCA E PËRDORIMITTË UJIT	POLITIKAT E VENDOSJES SË ÇMIMIT	TRAJTIMI NË TERREN	MONITORIMI DHE RAPORTIMI I OPERATORIT	KONTROLLI I LËNDËVE USHQYESE	PËRPUTHSHMËRIA ME RRJEDHËN EKOLOGJIKE	RESTAURIMI I HABITATIT	STRUKTURAT + VAZHDIMËSIA
FURNIZIMI I BASHKIVE ME UJË UJËRAT SIPËRFAQËSORE	Po (26) VKM-ja për SKMIBU-n VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020)	Po (8) VKM-ja për SKMIBU-n	Po (9) ERrU - VKM-ja Nr.993/2020 për tarifat	Po (13) VKM-ja Nr.379/2016	Po (14) VKM-ja Nr. 1122/2020 për KKBU-në VKM-ja Nr. 1189/2009 për PKMM-në Standardi i Krahasimit të ERrU-t / Raportimi i Performancës	Po (2)(3)(13) Ligji Nr. 111/2012 VKM-ja Nr.379/2016	Po (7) Ligji Nr. 111/2012 VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020	Po (6) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020 Ligji 128/2020 për VNM-në Ligji 81/2017 për AKZM-në	Po (5)(6) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020 Ligji 128/2020 për VNM-në
FURNIZIMI I BASHKIVE ME UJË UJËRAT NËNTOKËSORE	Po (26) VKM-ja për SKMIBU-n VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020)	Po (8) VKM-ja për SKMIBU-n	Po (9) ERrU - VKM-ja Nr.993/2020 për tarifat	Po (13) VKM-ja Nr.379/2016	Po (14) VKM-ja Nr. 1122/2020 për KKBU-në VKM-ja Nr. 1189/2009 për PKMM-në Standardi i Krahasimit të ERrU-t / Raportimi i Performancës	Po (2)(3)(13) Ligji Nr. 111/2012 VKM-ja Nr.379/2016	Po (7) Ligji Nr. 111/2012 VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020	Po (21) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020 Ligji 128/2020 për VNM-në Ligji 81/2017 për AKZM-në	Po (21) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020 Ligji 128/2020 për VNM-në

UJËRAT E NDOTURA BASHKIAKE	Nuk ka VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020 VKM nr.127, datë 11.02.2015 "për kërkesat për përdorim në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura"	Po (8) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020)	Po (9) ERrU - VKM-ja Nr.993/2020 për tarifat	Po (1) VKM-ja Nr.177/2005 VKKU nr.2/2015 Ligji Nr. 9115/2003 për TUNU	Po (14) VKM-ja Nr. 1122/2020 për KKBU-në VKM-ja Nr. 1189/2009 për PKMM-në	Po (1) VKM-ja Nr.177/2005 VKKU nr.2/2015 Ligji Nr. 9115/2003 për TUNU	Po (18) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020) Ligji 128/2020 për VNM-në	Po (19) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020) Ligji 128/2020 për VNM-në	Nuk ka VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020
FURNIZIMI INDUSTRIAL ME UJË UJËRAT SIPËRFAQËSORE	Po (26) VKM-ja për SKMIBU-n VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020)	Po (8) VKM-ja për SKMIBU-n	Po (10) ERrU - VKM-ja Nr.993/2020 për tarifat	Po (13) VKM-ja Nr.379/2016	Po (14) VKM-ja Nr. 1122/2020 për KKBU-në VKM-ja Nr. 1189/2009 për PKMM-në	Po (2)(3)(13) Ligji Nr. 111/2012 VKM-ja 379/2016	Po (7) Ligji Nr.111/2012 VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020	Po (21) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020 Ligji 128/2020 për VNM-në Ligji 81/2017	Po (21) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020 Ligji 128/2020 për VNM-në
FURNIZIMI INDUSTRIAL ME UJË UJËRAT NËNTOKËSORE	Po (26) VKM-ja për SKMIBU-n VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020)	Po (8) VKM-ja për SKMIBU-n	Po (10) ERrU - VKM-ja Nr.993/2020 për tarifat	Po (13) VKM-ja 379/2016	Po (14) VKM-ja Nr. 1122/2020 për KKBU-në VKM-ja Nr. 1189/2009 për PKMM-në	Po (2)(3)(13) Ligji Nr. 111/2012 VKM-ja Nr.379/2016	Po (7) Ligji Nr.111/2012 VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020	Po (6) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020 Ligji 128/2020 për VNM-në Ligji 81/2017	Po (5)(6) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020 Ligji 128/2020 për VNM-në

UJËRAT E NDOTURA INDUSTRIALE	Nuk ka VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020	Po (8) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020)	Po (10) ERrU - VKM-ja Nr.993/2020 për tarifat	Po (1) VKM-ja Nr.177/2005 VKKU nr.2/2015 Ligji Nr. 9115/2003 për TUNU	Po (14) Ligji 128/2020 për VNM-në Ligji 52/2020 për lejet mjedisore Regjistri i Emisioneve (Ajër/ Naftë)	Po (1) VKM-ja 177/2005 VKKU nr.2/2015 Ligji Nr. 9115/2003 për TUNU	Po (18) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020) Ligji 128/2020 për VNM-në	Po (19) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020) Ligji 128/2020 për VNM-në	Nuk ka VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020
BUJQËSIA UJËRAT SIPËRFAQËSORE	Po (26) VKM-ja për SKMIBU-n VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020	Po (8)(12) VKM-ja për SKMIBU-n	Po (11) Ligji nr. 24/2017 për administrimin e ujitjes dhe kullimit	Po (16) VKM-ja Nr.177/2005	Po (14) VKM-ja Nr. 1122/2020 për KKBU-në VKM-ja Nr. 1189/2009 për PKMM-në Ligji 52/2020 për lejet mjedisore	Po (2)(3)(18) Ligji Nr. 128/2020 për VNM-në Ligji 52/2020 për lejet mjedisore	Po (7) Ligji Nr.111/2012 VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020	Po (17)(22) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020) Ligji Nr. 128/2020 për VNM-në	Po (5)(6) Ligji Nr. 111/2012 VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020)
BUJQËSIA UJËRAT NËNTOKËSORE	Po (26) VKM-ja për SKMIBU-n VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020)	Po (8)(12) VKM-ja për SKMIBU-n	Po (11) Ligji nr. 24/2017 për administrimin e ujitjes dhe kullimit	Po (16) VKM-ja Nr.177/2005	Po (14) VKM-ja Nr. 1122/2020 për KKBU-në VKM-ja Nr. 1189/2009 për PKMM-në Ligji 52/2020 për lejet mjedisore	Po (2)(3)(18) Ligji 128/2020 për VNM-në Ligji 52/2020 për lejet mjedisore	Po (7) Ligji Nr. 111/2012 VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020	Po (17)(22) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020) Ligji 128/2020 për VNM-në	Po (5)(6) Ligji Nr. 111/2012 VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020)

HIDROENERGJETIKA UJËRAT SIPËRFAQËSORE	Po (26) VKM-ja për SKMIBU-n VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020)	Po (8) VKM-ja për SKMIBU-n	Po (10) ERrU - VKM-ja Nr.993/2020 për tarifat	Po (16) VKM-ja Nr.177/2005	Po (14) VKM-ja Nr. 1122/2020 për KKBU-në Ligji 128/2020 për VNM-në	Nuk ka	Po (7) Ligji Nr. 111/2012 VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020 Ligji 128/2020 për VNM-në	Po (23)(24)(6)(17)(18)(19) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020 Ligji 128/2020 për VNM-në Ligji 81/2017	Po (6) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020 Ligji 128/2020 për VNM-në Ligji 81/2017 për AKZM-në
AKTIVITETET MINERARE UJËRAT SIPËRFAQËSORE	Po (26) VKM-ja për SKMIBU-n VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020	Po (8) VKM-ja për SKMIBU-n	Po (10) ERrU - VKM-ja Nr.993/2020 për tarifat	Po (13) VKM-ja Nr.379/2016	Po (14) VKM-ja Nr. 1122/2020 për KKBU-në VKM-ja Nr. 1189/2009 për PKMM-në	Po (2)(3)(13) Ligji Nr. 111/2012 VKM-ja Nr. 379/2016	Po (7) Ligji Nr. 111/2012 VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020	Po (21) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020 Ligji 128/2020 për VNM-në Ligji 81/2017	Po (21) VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020 Ligji 128/2020 për VNM-në
MENAXHIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Po (13) VKM-ja Nr.379/2016	Po (14) VKM-ja Nr. 1122/2020 për KKBU-në	Po (1) Ligji Nr. 111/2012	Nuk ka	Po (4)(17)(21)(22)(24)(25) Ligji 53/2020 për lejet e mbrojtjes mjedisore	Po (6) VKM-ja për SKMIBU-n VKM-ja Nr.1015/2020
MENAXHIMI I RREZIKUT NGA THATËSIRAT	Po (26)(24)(13) VKM-ja për SKMIBU-n VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020)	Po (8) VKM-ja për SKMIBU-n	Po (10) Ligji nr. 24/2017 për administrimin e ujitjes dhe kullimit	Po (1)(16) VKM-ja Nr. 177/2005	Po (14) VKM-ja Nr. 1122/2020 për KKBU-në	Po (2)(3) Ligji Nr. 111/2012 VKM-ja 379/2016	Po (7) Ligji Nr.111/2012 VKM-ja Nr.550, datë 15.07.2020	Po (24)(23)(25) Ligji 53/2020 për lejet e mbrojtjes mjedisore	Po (6) VKM-ja për SKMIBU-n VKM-ja Nr.1015/2020

MARRËVESHJET NDËRKUFITARE	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka VKM-ja për tarifat	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka

13 Programi i Masave për Basenin e Ishmit

13.1 Vështrim i përgjithshëm

PMBU-ja është instrumenti kryesor i menaxhimit të ujërave për të gjithë trupat ujorë nëntokësorë dhe sipërfaqësorë në një rajon baseni të caktuar, dhe Programi i Masave për basenin ujor të Ishmit është rezultati kryesor i PMBU-së. Programet, përmirësimet ose zbatimet rregullatore dhe veprimet rehabilituese ose mbrojtëse të identifikuara për një trup ujor, zonë ose sektor ekonomik të caktuar, priten të bëhen të detyrueshme me ligj për autoritetet kompetente përkatëse, menjëherë pas miratimit zyrtar të PMBU-së nga Këshilli i Ministrave.

Në këtë raport, shkalla e mospërmbushjes së këtyre objektivave nga trupat ujorë përmblidhet kryesisht në Kapitullin 10, bazuar në dokumentacionin mbështetës të kapitujve 4 deri në 9. Edhe njëherë, objektivat mjedisore për basenin ujor të Ishmit janë:

- Parandalimi i përkeqësimit të mëtejshëm të statusit të të gjithë trupave ujorë nga statusi aktual ose potencial;
- Kur trupat ujorë nuk e arrijnë "statusin e mirë" ose rrezikojnë të mos i përmbushin objektivat, duhen ndërmarrë masa korrigjuese me qëllim forcimin dhe rikthimin e të gjithë trupave ujorë në "status të mirë" ose në "potencialin e mirë";
- Trupat ujorë artificialë dhe tepër të modifikuar mund t'u nënshtrohen objektivave mjedisore më pak të rrepta për "statusin e mirë ekologjik" dhe "potencialin e mirë ekologjik", me kusht që në planin e menaxhimit të basenit ujor të parashtrohen arsyet dhe argumentet teknike dhe/ose ekonomike.
- Substancat prioritare dhe substancat prioritare të rrezikshme që shkarkohen në mjedis duhen asgjësuar në mënyrë progresive.

Programi i Masave për basenin e Ishmit përmban "masat bazë" dhe "masat plotësuese", shihni seksionin 13.2 dhe 13.3.

13.1.1 Koncepti i Masave dhe Masave të Llojeve Kyçe (MLlK)

Përmbajtja dhe qëllimi i Programit të Masave (PiM) shpeshherë nuk kuptohet dhe nuk zbatohet në mënyrën e duhur nga agjencitë rregullatore.

PMBU-ja përcakton Programin e Masave që kërkohet për periudhën 2024-2029 për arritjen e "objektivave mjedisore" të përshkruara në Kapitullin 3, në përputhje me nenin 4 të DKU-së. PiM-ja nuk synon të trajtojë të gjitha problematikat që lidhen me menaxhimin dhe përdorimin e ujërave brenda basenit ujor , përfshi për shembull mungesën e kapaciteteve monitoruese të burimeve ujore në nivel kombëtar, mangësitë strukturore lidhur me kompetencat dhe koordinimin ndërinstitucional, furnizimin me ujë të zonave rurale, nevojën për skemat e mbrojtjes nga përmbytjet, planet e menaxhimit të riskut nga thatësirat, etj, ndonëse të gjitha sa më lart përfshihen në mënyrë të gabuar në PiM.

Këto problematika jostrukturore dhe/ose strukturore gjejnë zbatim vetëm për sa kohë që ndikojnë në qëllimin kryesor të arritjes së objektivave mjedisore në basenin ujor . "Masat" synojnë të sigurojnë vetëm mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të ujit në nivelin e basenit ujor. Synimi i DKU-së është të ruajë ose përmirësojë mjedisin ujor, ndaj ''masat'' trajtojnë kryesisht menaxhimin e cilësisë së trupave ujorë, dhe sasinë e tyre, kur kjo e fundit i shërben objektivit të cilësisë së mirë.

Pikërisht për shkak të këtij interpretimi kaq të gjerë midis Shteteve Anëtare dhe përfshirjes së papërshtatshme të "objektivave jomjedisore" në shumë PMBU, Dokumenti Udhëzues WISE i DKU-së 2016 ka identifikuar një listë bazë të Masave të Llojeve Kyç (MLlK), të cilat duhen ndjekur gjatë hartimit të PiM-ve. MLlK-të janë grupe masash të identifikuara nga Shtetet Anëtare në PiM, të cilat synojnë të njëjtin presion ose qëllim. Pritet që pjesa më e madhe e Shteteve Anëtare t'i raportojnë masat e tyre në kuadër të MLlK-ve të paracaktuara. Përdorimi i MLlK-ve "të reja" shtesë duhet të jetë tejet i kufizuar për të lehtësuar krahasueshmërinë dhe konsolidimin e

informacionit në nivel BE-je[194]. Pritshmëria për Shtetet Anëtare është që t'i "grupojnë" masat e tyre të veçanta kombëtare (zakonisht më të detajuara se MLIK-të) për t'i raportuar në mënyrë të përmbledhur si MLIK. [195]

Për sa i përket kapitujve të tjerë në këtë raport PMBU-je, qëllimi është të zhvillohen formate standarde të raportimit, të cilat të jenë të përafruara me kërkesat e raportimit WISE të BE-së. Kur Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore të bëhet plotësisht funksionale, rëndësia jetike e kësaj qasjeje të strukturuar dhe të përafruar ndaj mbledhjes së të dhënave dhe raportimit do të dalë edhe më në pah.

Masat duhet të përcaktohen në mënyrë të rreptë dhe të shënjestruar për sa i përket llojit dhe shkallës së tyre, për t'u siguruar që presionet e identifikuara në basen, nënbasen ose në nivelin e trupit ujor të menaxhohen si duhet dhe të sjellin vërtet përmirësime të matshme kundrejt arritjes së statusit ose potencialit të mirë në trupa ujorë individualë ose në grupe trupash ujorë.

Tabela 13-1 përmbledh Masat e Llojeve Kyç (MLIK) në përputhje me WISE-n e BE-së që janë përdorur gjerësisht në këtë PMBU. Duhet vërejtur se Shqipëria po prezanton këtë radhë një MLIK shtesë mjaft të veçantë në rang kombëtar, përkatësisht MLIK-në 26 "Kontrolli i nxjerrjeve të tepërta nëpërmjet përmes kushteve dhe zbatimit të lejeve për përdorimin e ujërave".

Kjo gjë reflekton situatën aktuale në Shqipëri ku shumë operatorë nuk disponojnë asnjë lloj leje për nxjerrjen e ujit dhe nxjerrjet janë kryesisht të parregulluara dhe në sasi të tepërta. Hapi i parë i masave do të ishte identifikimi i këtyre nxjerrjeve, vlerësimi i niveleve të përshtatshme të nxjerrjeve të ujit dhe zbatimi i tyre nëpërmjet përmirësimit të regjimit të lejeve dhe inspektimit.

Kontrolli i shkarkimeve urbane në sasi të tepërta, sektori bujqësor apo industrial (nëpërmjet kufizimeve të lejes dhe/ose politikave të vendosjes së çmimeve) mund të sjellë përfitime të shumëfishta për sa i përket përmirësimit të disponueshmërisë së burimeve ujore për sektorët e tjerë, rimëkëmbjes nga ndryshimet klimatike, përmirësimit të përputhshmërisë me prurjen ekologjike dhe përmirësimit të potencialit hollues për ngarkesat e ndotësve.

Është më tej e rëndësishme të theksohet se shumë nga MLIK-të e përmendura në Tabelën 13-1 mund të zbatohen si Zgjidhje të Bazuara në Natyrë (ZBN). Përtej MLIK 24 "Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike", masat e mëposhtme mund të zbatohen veçanërisht si ZBN:

• MLIK 6 "Përmirësimi i kushteve hidromorfologjike të trupave ujorë përveç vazhdimësisë gjatësore (p.sh. restaurimi i lumenjve, përmirësimi i zonave bregore, heqja e argjinaturave të forta, rilidhja e lumenjve me fushat e përmbytjes, përmirësimi i gjendjes hidromorfologjike të ujërave kalimtare, etj.)";

• MLIK 7 "Përmirësime në regjimin e prurjeve dhe/ose vendosjen e prurjeve ekologjike. Investimet për restaurimin e ekosistemeve të dëmtuara nga ndërhyrja njerëzore në mjediset lumore (devijimet e rrjedhave natyrore nga HEC-et apo qëllime të tjera, degradimi i ekosistemit)";

• MLIK 12 "Shërbimet këshillimore për bujqësinë" – nëpërmjet qasjeve përshtatëse të bazuara në ekosistem që rrisin elasticitetin e sektorit të bujqësisë, duke prodhuar njëkohësisht përfitime nga biodiversiteti;

• MLIK 13 "Mbrojtja e ujit të pijshëm. 1. Përcaktimi i Zonave Mbrojtëse dhe përfshirja në kontrollin e planifikimit";

• MLIK 17 "Masat për reduktimin e sedimenteve nga erozioni i tokës dhe rrjedhja sipërfaqësore. 1. Ruajtja dhe reduktimi i shkallës së erozionit për të mbrojtur tokat me rrezikshmëri të lartë. Rehabilitimi i infrastrukturës ekzistuese për mbrojtjen nga erozioni (argjinaturat, brushat e lumenjve). 3. Pyllëzimi i ri dhe shtimi i vegjetacionit."

Ndërsa disa nga MLIK -të e përmendura në Tabelën 13.1 mund të kualifikohen si ZBN, nuk është domosdoshmërisht rasti që do të kualifikohen, pasi kjo varet nga specifikat e dizajnit dhe kontekstit të masës. Standardi global i IUCN për zgjidhjet e bazuara në natyrën duhet të zbatohet për të dizajnuar MLIK që plotësojnë

[194]Në raste të jashtëzakonshme, Masat e Llojit Kyç mund të ndërmerret dhe raportohet nga ShA-ja nëse lista është e pamjaftueshme, sipas elementit të skemës WISE *"Masat e Reja të Llojit Kyç"*. Tabela 13-1MLIK është një masë e veçantë shqiptare.

[195]Komisioni Evropian, Dokumenti Udhëzues WISE për Raportimin 2016, Kapitulli 10. Schema "RBMPPOM"

kriteret e kërkuara ZBN. Në të vërtetë, Standardi Global mbështet financuesit, investitorët dhe vendimmarrësit për të hartuar iniciativa ZBN që janë efektive dhe të shkallëzueshme, të parandalojnë keqpërdorimet dhe të marrin në konsideratë ndikimet e jashtme të mundshme. Respektimi i kritereve dhe treguesve siguron hartimin, zbatimin dhe monitorimin dhe vlerësimin e ZBN që ofrojnë zgjidhje me kosto efektive për arritjen e objektivave mjedisore në menaxhimin e ujërave, si dhe sigurimin e aksesit në rritjen e fondeve për këto masa.

Në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në Menaxhimin e Baseneve Ujore, ekzistojnë një sërë llojesh masash ZBN për adresimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Përveç masave tradicionale, lloje të ndryshme ZBN që mund të aplikohen për të adresuar ndikimet e ndryshimeve klimatike në menaxhimin e baseneve ujore janë renditur në Tabelën 13.1 bazuar në Raportin AR6 të Grupit II të Punës të IPCC (Pörtner et al., 2022).

IPCC WGII (2022) vëren se qasjet ZBN në lumenj dhe ligatina për të reduktuar rrezikun e përmbytjeve pranohen gjithnjë e më shumë dhe kanë parë investime të konsiderueshme vitet e fundit. Qasje të tilla përfshijnë menaxhimin e përmbytjeve natyrore (MPN), i cili përfshin një sërë teknikash në sistemet e lumenjve dhe në bregdet.

Në basenin e lumit Ishëm, masat ZBN mund të zbatohen si për menaxhimin e ujëmbledhësve ashtu edhe për menaxhimin e kanalit (IPCC 2022). Për shembull, rivendosja e gjarpërinjve natyrorë në rrjedhat ujore të kanalizuara dhe lejimi i grumbullimit të mbeturinave drusore është efektiv në ngadalësimin e ritmeve të rrjedhave, ndërsa rivendosja e ligatinave në rrjedhën e sipërme ose krijimi i tyre në situata urbane dhe peri-urbane mund të mundësojë ruajtjen e ujit gjatë ngjarjeve të përmbytjeve (Acreman dhe Holden , 2013; Ameli dhe Creed, 2019; Wu et al., 2020).

Një lloj tjetër ZBN përfshin mbrojtjen dhe restaurimin e sistemeve natyrore të lumenjve dhe mbulesës natyrore të bimësisë brenda ujëmbledhësve. Për më tepër, ZBN mund të përfshijë teknikat e integrimit agro-ekologjik në sistemet bujqësore. Të gjitha masat e tilla mund të ndihmojnë në menaxhimin e rrezikut të thatësirës dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me ujë, veçanërisht në kushtet e ndryshimeve klimatike, pasi ato rrisin ruajtjen e ujit në ujëmbledhës dhe përmirësojnë cilësinë e ujit (Taffarello et al., 2018; Agol et al., 2021; Khaniya et al., 2021).

Tabela 13-1 – Masat e Llojeve Kyç të WISE të BE-së Hartëzuar në Programin Kombëtar Sektorial të Ujit

MLIK	PËRSHKRIMI I MLIK-së	PROGRAMI I MASAVE TË PROPOZUARA BAZUAR NË PKSU [196]	MASAT E BUTA/FORTA
1	Ndërtimi ose përmirësimi i impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.	1. Vënia në punë e impianteve ekzistuese të trajtimit të ujërave të ndotura dhe përputhshmëria me standardet e DKU-së 2000/60 / KE.	Masë e fortë
		2. Ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane.	Masë e fortë
		3. Ndërtimi i sistemeve të kanalizimeve me gropa septike.	Masë e fortë
2	Reduktimi i ndotjes nga lëndët ushqyese me origjinë nga bujqësia.	1. Investime për mbrojtje nga ndotësit me origjinë nga bujqësia, ndotës të përqendruar (pikësorë) dhe jo të përqendruar (të shpërndarë).	Masë e fortë
		2. Rehabilitimi dhe pastrimi i kanaleve të kullimit dhe ndërtimi i skemave të reja të ujitjes.	Masë e fortë
3	Reduktimi i ndotjes nga pesticidet me origjinë nga bujqësia.	1. Investime për mbrojtje nga ndotësit me origjinë nga bujqësia, ndotës të përqendruar (pikësorë) dhe jo të përqendruar (të shpërndarë).	Masë e fortë
		2. Rehabilitimi dhe pastrimi i kanaleve të kullimit dhe ndërtimi i skemave të reja të ujitjes.	Masë e fortë
4	Rehabilitimi i zonave të kontaminuara (ndotje historike, përfshi sedimentet, ujërat nëntokësore, tokën)	1. Rehabilitimi i "pikave të nxehta" të kontaminuara.	Masë e fortë
		2. Rehabilitimi i digave në miniera dhe sipërfaqeve të kontaminuara nga shkarkimet industriale.	Masë e fortë
		3. Ndërtimi i pikave të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve dhe hidrokarbureve nga anijet në të gjitha portet dhe pikat e nevojshme, duke kryer investime për reduktimin e risqeve nga fatkeqësitë natyrore.	Masë e fortë
5	Përmirësimi i vazhdimësisë gjatësore (p.sh. ndërtimi i rrugëkalimeve të peshqve, prishja e digave të vjetra).	*Përmirësimi i sistemeve të ujitjes për tokat e ujitura bujqësore dhe rehabilitimi e mirëmbajtja e digave sipas kushteve teknike dhe rekomandimeve të ICOLD-it, për të rritur sigurinë dhe reduktuar efektet e mundshme të shkaktuara nga dëmtimi i tyre.*	
		1. Rehabilitimi dhe pastrimi i kanaleve të kullimit dhe ndërtimi i skemave të reja të ujitjes.	Masë e fortë

[196] Këto janë masat e propozuara në Programin Kombëtar Sektorial të Ujit. http://ambu.gov.al/puBUic/PROGRAMI%20KOMB%C3%8BTAR%20SEKTORIAL%20I%20UJIT%202018-2030.pdf

MLIK	PËRSHKRIMI I MLIK-së	PROGRAMI I MASAVE TË PROPOZUARA BAZUAR NË PKSU [196]	MASAT E BUTA/FORTA
		2. Rehabilitimi i digave të tjera për të garantuar burimin ujor për ujitje dhe për të rritur sigurinë e tyre (vlerësuar më parë nga strukturat në varësinë e MBZHRAU-së).	Masë e fortë
6	Përmirësimi i kushteve hidromorfologjike të trupave ujorë përveç vazhdimësisë gjatësore (p.sh. restaurimi i lumit, përmirësimi i zonës ripariane, heqja e argjinaturave të forta, rilidhja e lumenjve me fushat e përmbytshme, përmirësimi i kushteve hidromorfologjike të ujërave të përkohshme, etj.)	1. Ndërtimi/rindërtimi i infrastrukturës së mbrojtjes nga përmbytjet në lumin Ishëm	Masë e fortë
		2. Ruajtja dhe reduktimi i shkallës së erozionit për të mbrojtur tokat me risk të lartë. Rehabilitimi i infrastrukturës ekzistuese për mbrojtjen nga erozioni (argjinaturat, pritat për mbrojtjen e lumit).	Masë e fortë
7	Përmirësimet e regjimit të rrjedhës dhe/ose krijimi i prurjeve ekologjike.	Investimet për restaurimin e ekosistemeve të dëmtuara nga ndërhyrjet e njeriut në mjediset lumore (devijimet e rrjedhës natyrore nga HEC-et ose për qëllime të tjera, degradimi i ekosistemit).	Masë e fortë
8	Eficienca e ujit, masat teknike për ujitjen, industrinë, energjinë dhe familjet.	1. Projektet e rehabilitimit/zgjerimit/sistemet e reja të furnizimit me ujë në zonat rurale dhe urbane.	Masë e fortë
		2. Ndërtimi i skemave të reja të pikave të marrjes së ujit dhe ujitjes.	Masë e fortë
		3. Investimet për trajtimin e ujërave industriale nga sektori privat.	Masë e fortë
9	Masat për politikën e vendosjes së çmimit të ujit lidhur me zbatimin e rikuperimit të kostove të shërbimeve të ujit nga familjet.	Blerja dhe instalimi i matësve për matjen e sasive të prodhuara të ujit.	Masë e fortë
10	Masat për politikën e vendosjes së çmimit të ujit lidhur me zbatimin e rikuperimit të kostove të shërbimeve të ujit nga industria.	Instalimi i matësve të ujit	Masë e fortë
11	Masat për politikën e vendosjes së çmimit të ujit lidhur me zbatimin e rikuperimit të kostove të shërbimeve të ujit nga bujqësia.	Instalimi i matësve të ujit në veprat e ujitjes.	Masë e fortë
12	Shërbimet këshilluese për bujqësinë.	Reduktimi i ndotjes nga kimikatet bujqësore	Masë e butë
13	Masat për mbrojtjen e ujit të pijshëm (p.sh. krijimi i zonave të ruajtjes, zonave buferike, etj.).	1. Forcimi i kapaciteteve laboratorike për monitorimin e ujërave nëntokësore.	Masë e fortë
		2. Përcaktimi i Zonave të Mbrojtjes dhe përfshirja e tyre në planifikimin e kontrollit	Masë e butë
14	Hulumtimi, përmirësimi i bazës së njohurive për të reduktuar pasiguritë.	Vlerësimet dhe hetimet për burimet ujore	Masë e butë
15	Masat për asgjësimin ose reduktimin e emetimeve, shkarkimeve dhe humbjeve të Substancave Prioritare ose Substancave Prioritare të Rrezikshme.	1. Rregullimet e industrisë	Masë e butë
		2.Kontrolli i planifikimit zonal të objekteve të reja	Masë e butë

MLIK	PËRSHKRIMI I MLIK-së	PROGRAMI I MASAVE TË PROPOZUARA BAZUAR NË PKSU [196]	MASAT E BUTA/FORTA
16	Përmirësimet ose përsosjet e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura industriale (përfshi fermat).	1. Ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.	Masë e fortë
		2. Ndërtimi i sistemeve të kanalizimeve me gropa septike.	Masë e fortë
17	Masat për reduktimin e sedimenteve nga erozioni i tokës dhe vërshimet sipërfaqësore.	1. Ruajtja dhe reduktimi i shkallës së erozionit për të mbrojtur tokat me risk të lartë. Rehabilitimi i infrastrukturës ekzistuese për mbrojtjen nga erozioni (argjinaturat, bimësia e brigjeve).	Masë e fortë
		2. Ndërtimi i digave malore.	Masë e fortë
		3. Ripyllëzimi dhe shtimi i bimësisë.	Masë e fortë
18	Masat për parandalimin dhe kontrollin e ndikimeve të dëmshme të llojeve të huaja invazive dhe të sëmundjeve për shkak të tyre.	Forcimi i kapaciteteve laboratorike për monitorimin e ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe bregdetare.	Masë e fortë
19	Masat për parandalimin dhe kontrollin e ndikimeve të dëmshme të rekreacionit, përshi peshkimin për sport.	Mbështetja për zbatimin e teknikave të akuakulturës që reduktojnë ndjeshëm ndikimet negative në mjedis, krahasuar me teknikat tradicionale.	Masë e fortë
20	Masat për parandalimin dhe kontrollin e ndikimeve të dëmshme të peshkimit dhe shfrytëzimit/largimit të kafshëve dhe bimëve.		
21	Masat për parandalimin dhe kontrollin e depërtimit të ndotjes nga zonat urbane, transporti dhe infrastruktura e ndërtuar.	1. Vënia në punë e impianteve ekzistuese të trajtimit të ujërave të ndotura dhe përputhshmëria me standardet e DKU-së 2000/60 / KE.	Masë e fortë
		2. Ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane.	Masë e fortë
		3. Impiantet e grumbullimit të mbetjeve në gotullën e lumit Ishëm.	Masë e fortë
		4. Instalimi i barrierave fizike për të reduktuar mbetjet urbane në drejtim të ujërave sipërfaqësore (liqeneve).	Masë e fortë
22	Masat për parandalimin dhe kontrollin e depërtimit të ndotjes nga pylltaria.	Investime për mbrojtje nga ndotësit me origjinë nga bujqësia, ndotës të përqendruar (pikësorë) dhe jo të përqendruar (të shpërndarë).	Masë e fortë
23	Masat natyrore për ujëmbajtjen.	Sisteme të qëndrueshme urbane kullimi	Masë e fortë
24	Përshtatja me ndryshimet klimatike	Zbatimi i zgjidhjeve natyrore për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	Masë e fortë
25	Masat kundër acidifikimit.	1. Rritja e eficiencës së përdorimit të kimikateve dhe materialeve të tjera për trajtimin e ujit të pijshëm.	Masë e fortë
		2. Forcimi i kapaciteteve laboratorike për monitorimin e ujërave sipërfaqësore.	Masë e fortë

MLIK	PËRSHKRIMI I MLIK-së	PROGRAMI I MASAVE TË PROPOZUARA BAZUAR NË PKSU [196]	MASAT E BUTA/FORTA
		3. Forcimi i kapaciteteve laboratorike për monitorimin e ujërave nëntokësore.	Masë e fortë
26	Kontrolli i nxjerrjeve të tepërta të ujit nëpërmjet kushteve dhe zbatimit të lejeve për përdorimin e ujërave.	1. Regjistrimi dhe lejimi i të gjitha nxjerrjeve	Masë e butë
		2. Leje të kufizuara në kohë që të përmbajnë kritere për eficiencën dhe disponueshmërinë e burimeve	Masë e butë

13.2 Masat Bazë

13.2.1 Vështrim i përgjithshëm

Masat bazë duhen interpretuar si kërkesat minimale të përputhshmërisë ligjore për të gjithë trupat ujorë, për të përmbushur vlerat kufi të emetimeve (VKE), standardet cilësore mjedisore (SCM) ose objektiva të tjera të parashtruara në direktivat kryesore të BE-së. [197]

Kjo mund të përfshijë masat ligjore dhe të përputhshmërisë për promovimin e përdorimit eficient dhe të qëndrueshëm të ujit, kontrollet e ndotjes nga burime pikësore dhe të shpërndara, kontrollet e nxjerrjeve të ujit dhe kontrollet hidromorfologjike për mbrojtjen dhe përmirësimin e habitatit, të cilat që të gjitha së bashku i nënshtrohen direktivave të ndryshme të BE-së.

13.2.2 Përputhshmëria Ligjore

Është më se e pritshme që masat bazë të zbatojnë kërkesat e disa direktivave të ndryshme të BE-së të përcaktuara në nenin 10 të DKU-së, të cilat vijojnë si më poshtë:

- Menaxhimi i Cilësisë së Ujërave të Larjes (2006/7/KE)
- Direktiva për Shpendët (79/409/KEE)
- Direktiva për Ujin e Pijshëm (80/778/KEE), ndryshuar me Direktivën (BE) (2020/2184)
- Direktiva për Aksidentet e Mëdha (Seveso) (96/82/KE)
- Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (85/337/KEE)
- Direktiva për Llumrat e Ujërat të Kanalizimeve (86/278/KEE)
- Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/KEE)
- Direktiva për Mbrojtjen e Produkteve Bimore (91/414/KEE)
- Direktiva për Nitratet (91/676/KEE)(91/676/ KEE)
- Direktiva për Habitatet (92/43/KEE)
- Direktiva për Kontrollin dhe Parandalimin e Integruar të Ndotjes (96/61/KE)
- Direktiva për Përgjegjshmërinë Mjedisore, Parandalimin dhe Rehabilitimin (2004/35/KE)

Një prej kërkesave të raportimit WISE 2016 është që të renditen Direktivat e zbatuara, si pjesë e masave bazë. Disa masa kombëtare mund të kontribuojnë në një Masë të vetme të Llojit Kyç dhe anasjelltas: një masë e vetme mund të jetë pjesë e disa MLlK-ve.

13.2.3 Rëndësia Operacionale e Masave Bazë

Nga pikëpamja operacionale, masat bazë trajtojnë kryesisht këto çështje:

- Masat për zbatimin e legjislacionit ekzistues komunitar për ujin dhe legjislacioneve të tjera mjedisore (të përcaktuara në nenin 10 të DKU-së dhe në Pjesën A të Shtojës VI, detajuar më lart).
- Masat për zbatimin e nenit 9 të DKU-së (rikuperimi i kostove), përfshi kostot burimore dhe ato mjedisore
- Masat për promovimin e përdorimit eficient dhe të qëndrueshëm të ujit
- Masat për mbrojtjen e cilësisë së ujit të pijshëm dhe reduktimin e nivelit të trajtimit të kërkuar
- Masat për kontrollin e nxjerrjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore
- Masat për kontrollin e shkarkimeve në ujërave nëntokësore

[197] Komisioni Evropian, Direktiva 2000/60/KE, Shtojca VI

- Masat për kontrollin e shkarkimeve nga burimet pikësore
- Masat për parandalimin ose kontrollin e depërtimit të ndotësve të shpërndarë
- Masat për trajtimin e ndikimeve të tjera të konsiderueshme në status, në veçanti në gjendjen hidromorfologjike
- Masat për ndalimin e drejtpërdrejtë të shkarkimeve në ujëra nëntokësore
- Masat për asgjësimin ose reduktimin e ndotjes nga Substancat Prioritare
- Masat për parandalimin e ndotjes aksidentale

13.3 Masat Plotësuese

Masat plotësuese përkufizohen në nenin 11(4) dhe Shtojcën VI, Pjesa B, të DKU-së. Krahas masave bazë të seksionit 13.2, mund të zbatohen edhe masa të tjera më të përgjithshme, si:

- Instrumentet ligjore
- Instrumentet administrative (përfshi tregtimin e licensës)
- Instrumentet ekonomike ose fiskale
- Marrëveshjet mjedisore të negociuara
- Kontrollet e emetimeve
- Kodet e praktikës së mirë
- Rehabilitimin e ligatinave
- Kontrollet e nxjerrjeve
- Masat e menaxhimit të kërkesës, ndër të tjera, promovimi i prodhimit bujqësor të përshtatur, siç janë kulturat me kërkesë të ulët për ujë në zonat e prekura nga thatësira
- Masat e eficiencës dhe ripërdorimit, ndër të tjera, promovimi i teknologjive efikase nga pikëpamja e ujit në industri dhe teknikat e ujitjes me kursim uji
- Projektet ndërtimore
- Impiantet e shkripëzimit
- Projektet e rehabilitimit
- Rimbushja artificiale e akuiferëve
- Fushatat edukuese
- Projektet hulumtuese, zhvillimore dhe demonstruese
- Masa të tjera përkatëse

Masat bazë dhe masat plotësuese mund të mbivendosen me njëra-tjetrën. Dallimi kryesor midis tyre është se masat bazë duhet të sigurojnë përputhshmëri me disa direktiva të ndryshme të BE-së, të transpozuara në legjislacionin kombëtar, ndërsa masat plotësuese mund të mos kërkojnë me domosdoshmëri transpozim të legjislacionit të BE-së në atë kombëtar.

13.4 Masat Shtesë

Koncepti i “masave shtesë” të identifikuara në nenin 11(5) të DKU-së shpeshherë keqkuptohet. Nëse objektivat mjedisore të identifikuara në nenin 4 të DKU-së (Kapitulli 3 i këtij raporti) nuk mund të arrihen për një trup ujor specifik, brenda fazës së parë të PMBU-së, atëherë kjo gjë sjell dështimin e të gjitha masave bazë dhe/ose plotësuese.

Nëse presionet kuptohen siç duhet dhe masat zbatohen me përpikëri, kjo situatë nuk ka gjasa të ndodhë. Megjithatë, mund të ketë disa arsye specifike që duhen hetuar më tej dhe "masa shtesë" që duhen formuluar, pra masa që nuk janë zbatuar ende në kuadër të qasjeve bazë dhe/ose plotësuese të DKU-së.

Sipas konventës WISE 2016 për raportimin, nëse zbatimi i një mase shtesë zgjat më shumë se një cikël i planifikimit të menaxhimit të basenit ujor, atëherë kjo masë kthehet ose në masë bazë, ose në masë plotësuese. Prandaj, marrja e masave shtesë shihet si e panevojshme dhe duhet konsideruar si mundësia e fundit.

13.5 Qasja Sistematike për Identifikimin e Masave

Qasja e re e kuadrit të PMBU-së në Shqipëri përdor praktika të mira për sa i përket ndjekjes së itinerareve të mirëpërcaktuara të proceseve lidhur me arritjen e masave të përshtatshme për presionet e caktuara. [198] Është e qartë se të gjithë trupat ujorë janë deri në njëfarë shkalle unikë, me karakteristika, vendndodhje, presione dhe masa specifike dhe komplekse. Megjithatë, si pikënisje, rekomandohet një qasje sistematike për identifikimin e masave të përshtatshme sipas një grupi alternativash bazë. Grupi i presione-masa për secilin prej pesë llojeve kryesore të presioneve paraqitet në Shtojcën Teknike 11.

Në Figura 13-1 paraqitet një shembull i ecurisë nga ndotja e burime të shpërndara.

Shembulli tregon se ndotja e shpërndarë bie në kategorinë e 2-të të raportimit WISE (shihni Vlerësimi i presioneve dhe statusi si rezultat i këtij vlerësimi janë themelore për të kuptuar dhe vlerësuar nga ana sasiore hendeqet midis objektivave mjedisore dhe gjendjes aktuale të trupave ujorë në basenin ujor. Vlerësimi ndërthur kriteret analitike dhe përshkruese, në varësi të nivelit të të dhënave në dispozicion.

Vlerësimi i statusit të trupit ujor është një ushtrim i vështirë krahasuar me standardet provizore bazuar në një model të vetëm analitik. Vlerësimi i presioneve është më kompleks sepse presionet janë zakonisht më abstrakte dhe më të vështira për t'u vlerësuar në sasi dhe/ose presionet e ndryshme kombinohen në mënyra komplekse për të ndikuar në statusin e trupit ujor. Vlerësimi sasior i presioneve, ndonëse i realizueshëm, kërkon të dhëna të konsiderueshme cilësore, shumë prej të cilave nuk mblidhen aktualisht në Shqipëri.

Vërehet se shumë prej "treguesve të presionit" kërkojnë që të raportohet një sasi e volumit, ose si pjesë e llogaritjes së përafërt të ngarkesës së ndotësve, ose si pjesë e ndikimit të prurjes ekologjike. Treguesit kuptimplotë të presionit nuk mund të përcaktohen për shkak të shkatërrimit tërësor të rrjetit kombëtar hidrometrik, mungesës së të dhënave hidrologjike të përdorshme të kohëve të fundit dhe mungesës së konsiderueshme të të dhënave për volumet e mbetjeve të lëngëta pas trajtimit të monitoruara nga institucionet dhe industritë.

Për të përmirësuar politikëbërjen mjedisore dhe për të identifikuar "pikat e nxehta mjedisore" që mund të kërkojnë rregullore më strikte (përmes kushteve të lejes dhe zbatimit) nevojitet një lloj indeksimi sasior i presionit. Tabela 10-1 dhe 10-2 paraqesin dy grupe treguesish për presionin, të cilat janë që të dyja në përputhje me skemën e raportimit WISE 2016.

"Treguesit e përgjithshëm" janë 'sasitë' e nivelit të lartë të presionit që lidhen me objektet si numri i pikave të shkarkimit, numri i hidrocentraleve ose pikave të nxjerrjes së ujit për qëllime bujqësore, gjatësia e trupave ujorë të prekur, numri i instalimeve pa leje, etj. Këto duhet të jenë lehtësisht të përcaktueshme edhe në rastin e funksionimit aktual të kufizuar të Kadastrës, bazuar në shqyrtimet e dokumentacionit ose inspektimet e shpejta në terren.


"Treguesit precizë" në përputhje me WISE 2016 kërkojnë matje dhe raportim sektorial tejet të përmirësuar krahasuar me ato të dhëna aktualisht në dispozicion përmes KKBU-së, veçanërisht lidhur me matjen e parametrit të mbetjeve të lëngëta pas trajtimit dhe volumeve të prurjes së lumit. Këto tabela janë plotësuar pjesërisht, aty ku ka të dhëna të disponueshme, dhe ndodhen në Shtojcën Teknike IV.

Tabela 10-1). Zakonisht, por jo vetëm, presionet e shpërndara e kanë origjinën nga bujqësia. Ndotja e shpërndarë mund ta ketë origjinën edhe nga zonat urbane, autostradat dhe pylltaria. Alternativat e

[198] Parimet bazë për përzgjedhjen e kombinimeve të masave më efikase nga pikëpamja e kostove për përfshirje në programin e masave të përcaktuar në nenin 11 të Direktivës Kuadër të Ujit - DORACAKU. Raporti UBA-FB 000563, Ekologjik 2004.

disponueshme janë mjaft të larmishme, në varësi të treguesit të presionit, p.sh. përqendrimet e pesticideve, ngarkesa vjetore e nitrateve, etj. Për zbatimin e masës, kërkohen masa bazë dhe/ose masa plotësuese për të qenë në përputhje me Direktivat përkatëse të BE-së.

Figura 13-1 – Shembull i zgjedhjes së Masave për Kategorinë e Presioneve "Burimet e shpërndara"[199]



13.6 Ndërhyrjet Operacionale për Trupat Ujorë që nuk i Arrijnë Objektivat Mjedisore

13.6.1 Menaxhimi Aktiv i Basenit Ujor

Kur të dhënat e monitorimit ose vlerësimet e tjera tregojnë se objektivat e përcaktuara në nenin 4 të DKU-së për trupin ujor nuk kanë gjasa të arrihen brenda periudhës së PMBU-së, kërkohet që [200]:

- Shkaqet e mosarritjes së mundshme të evidentohen nëpërmjet ndërmarrjes së studimeve të veçanta
- Lejet dhe autorizimet përkatëse të shqyrtohen dhe rishikohen sipas nevojës
- Programet e monitorimit të rishikohen dhe përshtaten sipas nevojës
- Të merren masa shtesë, si të shihet e nevojshme, për t'i arritur këto objektiva, përfshi edhe përcaktimin e VKE-ve dhe SCM-ve më të rrepta.

Ky proces kërkon menaxhim aktiv nga autoritetet kompetente (AK). Autoritetet përgjegjëse për monitorimin duhet të raportojnë të paktën një herë në vit nëse po arrihet ndryshimi i synuar në status apo jo. AMBU, në koordinim me agjenci të tjera, duhet të ndërmarrë veprime korrigjuese brenda periudhës së Planit.

13.7 Identifikimi Numerik dhe Raportimi i Masave

Dokumenti udhëzues për raportimin për Programin e Masave përcaktohet në WISE 2016, në seksionin 10.1.19. Një atribut mjaft i rëndësishëm dhe i detyrueshëm është kodi i masave ose identifikimi numerik i masës individuale.[201] Përcaktimi i kodit unik për çdo masë të basenit ujor kërkon krijimin e disa disiplinave mjaft të rëndësishme lidhur me PiM-në:

- Masa e identifikuar me kod dhe atributet e saj parësore mund të ruhen dhe aksesohen në një bazë të dhënash, siç është Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore (KKBU).

[199] Ekologjik 2004.

[200] Komisioni Evropian Direktiva Kuadër e Ujit 2000/60/KE– Neni 11(5)

[201] Komisioni Evropian, Dokumenti Udhëzues WISE për Raportimin 2016, Kapitulli 10. Skema "PiM-ja e PMBU-së", elementi i skemës: *Kodi i Masave*

- Kodi i masës mund t'i referohet në mënyrë të kryqëzuar të gjithë trupave ujorë në basenin ujor ku do të zbatohet ajo masë, dhe për rrjedhojë do të hartëzohet nga pikëpamja vizuale nëpërmjet Sistemit të Informacionit Gjeografik.
- Identifikimi i kodeve unike të masave të veçanta me atributet përkatëse (presionet, agjencia zbatuese, buxheti, treguesit, data e synuar, etj.) nxit fokusin dhe llogaridhënien për zbatimin e masës.

Kodimi i masave në PMBU përdor tashmë po të njëjtën qasje me identifikimin numerik të të gjithë objekteve të lidhura me menaxhimin e ujit në basenin ujor, siç përshkruhet në Shtojcën Teknike 4 dhe Seksionin 4.7.

13.7.1 Përdorimi i Treguesve për të Siguruar Arritjen e Masave

Treguesit mjedisorë luajnë rol thelbësor në politikëbërjen efikase dhe koherente, duke theksuar faktorët kyç në modelin nxitës-presione-gjendje-ndikim-reagim (NPGjNR) që shkaktojnë presione mjedisore dhe të cilat mund të synohen nga politika. [202] Treguesit mbështesin vlerësimet teknike duke ofruar informacion për gjendjen dhe tendencat e çështjeve prioritare, si dhe progresin kundrejt objektivave ose vlerave referencë. Prandaj, treguesit sasiorë janë mjet kyç menaxhimi dhe përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të përafërt të hendekut mes arritjes së statusit ose potencialit të mirë dhe progresit të synuar në një afat të caktuar. Skema e raportimit WISE 2016 hartëzon lidhjen e pritshme midis presioneve, treguesve të presioneve, masave dhe treguesve të masave, dhe ky model raportimi ndiqet edhe në procedurat e raportimit të PMBU-së. Lista përfundimtare e Treguesve të Masave dhe Masave të Llojit Kyç paraqitet në Tabela 13-2.

13.7.2 Informacioni për Raportimin e Masave të Përgjithshme dhe të Veçanta

Identifikimi dhe gjurmimi i çdo mase është thelbësor, megjithatë sistemi i raportimit duhet të funksionojë jo vetëm nga pikëpamja numerike (p.sh. mund të regjistrohet në KKBU me atributet numerike), por duhet edhe të ofrojë një sërë Tabelash dhe/ose Hartash praktike në raportet e PMBU-së, në mënyrë që masat e propozuara të mund të identifikohen dhe kuptohen lehtësisht. Të dyja metodat e raportimit duhet të sigurojnë që presionet, me karakter të përgjithshëm ose të veçantë, të identifikohen qartësisht dhe që masat e propozuara të ndikojnë drejtpërdrejt te presionet. Për më tepër, niveli i arritjes së masës duhet monitoruar nga përdorimi i këtyre treguesve (shihni 13.6.4).

Megjithatë, zbatimi i masave dhe ndërlidhjet midis llojeve të masave dhe grupit të synuar (bazë ose plotësuese, e përgjithshme ose e veçantë) mund të sjellë një sistem raportimi mjaft kompleks, shihni Tabela 13-3.

Tabelat raportuese të hartuara për Shqipërinë (hartimi është në diskrecion të ShA-ve, subjekt të kërkesave minimale WISE të BE-së[203]) marrin parasysh veçoritë dhe kompleksitetet në zbatimin e ri dhe novator të masave.

Tabela 13-3 përmbledh një grup përgjithësisht kompleks të kombinacioneve me këto pika kyç:

- Masat bazë dhe plotësuese mund të zbatohen në shkallë të përgjithshme dhe specifike
- Masat bazë dhe plotësuese në shkallë të përgjithshme mund të zbatohen kryesisht përmes politikeve ose strategjive në nivel baseni, instrumenteve fiskale ose instrumenteve të tjera
- Masat bazë dhe plotësuese në shkallë specifike zbatohen kryesisht përmes përcaktimit të kushteve specifike të lejes
- Treguesit e presionit dhe të masës janë elemente thelbësore për arritjen e objektivave mjedisore. Megjithatë, këta tregues janë të ndryshëm, në varësi të faktit nëse masa do të zbatohet në shkallë të përgjithshme ose specifike.

Udhëzimet për treguesit e presioneve dhe masave të përgjithshme paraqiten në Shtojcën 3 të WISE 2016. Zakonisht, këto kërkojnë statistika në nivel baseni, siç është ngarkesa vjetore e BOD5, volumi vjetor i ujit të marrë nga X sektor si % e burimit të rinovueshëm, etj. Edhe treguesit e masës janë në mënyrë të ngjashme në nivel baseni, siç është popullsi ekuivalent (p.e.) që do të shërbehet nga ITUNU, etj. Lista përfundimtare e

[202] Agjencia Evropiane e Mjedisit - PërmBUedhje e Treguesve të EEA-së 2014 – Raporti Teknik 8/2014.

[203] Strategjia e BE-së për Zbatimin e Përbashkët të DKU-së – Dokumenti Udhëzues WISE 2016 për Raportimin – seksionet 10.1.9 dhe 10.2.3

treguesve të masës në nivel të përgjithshëm paraqitet në Shtojcën 8 të WISE 2016, ku përfshihen më shumë se 80 tregues.

Masat specifike (që bien në kuadrin e Masave të Llojit Kyç, MLlK) duhet të trajtojnë presionet specifike që hasen në nivelin e trupit ujor. Mënyra më efikase për të reflektuar presionet përkatëse dhe masat vijuese është të përmblidhen elementet individuale që kontribuojnë në statusin ose potencialin e përgjithshëm të trupit ujor. Kur ka përjashtime sipas nenit 4(5) ose 4(7) të DKU-së, këto përjashtime duhen raportuar.

Tabela 13-2 –Lista Standarde e Numeracionit për Masat dhe Treguesit Kyç

Masa e Llojit Kyç	Kodi [204]	Treguesi i përgjithshëm Treguesi specifik
Ndërtimi/Përmirësimi i ITUNU-ve bashkiake	1	Numri i ITUNU-ve që kërkohen për arritjen e OM-së Popullsia ekuivalente që kërkon trajtim
Reduktimi i ndotjes së lëndëve ushqyese me origjinë nga bujqësia	2	Sipërfaqja e tokës së mbuluar nga strategjia e kontrollit
Reduktimi i ndotjes së pesticideve me origjinë nga bujqësia	3	Sipërfaqja e tokës së mbuluar nga strategjia e kontrollit
Rehabilitimi i zonave të kontaminuara	4	Numri i zonave që kërkojnë rehabilitim
Ndërlidhja gjatësore e lumenjve	5	Numri i barrierave që kërkojnë rehabilitim
Kushtet hidromorfologjike të lumenjve	6	Gjatësia e trupave ujorë që kërkojnë rehabilitim
Regjimi i prurjes dhe prurja ekologjike	7	Gjatësia e trupave ujorë që kërkojnë rehabilitim Numri i zonave që kërkojnë rishikimin e lejeve Indeksi i prurjes ekologjike për trupin ujor
Masat për eficiencën e ujit sektorial	8	Numri i familjeve/operatorëve të synuar Volumi i humbjeve reale + të mundshme
Masat për vendosjen e çmimit të ujit për familjet	9	Numri i familjeve të synuara
Masat për vendosjen e çmimit të ujit për industrinë	10	Numri i instalimeve të synuara
Masat për vendosjen e çmimit të ujit për bujqësinë	11	Sipërfaqja e tokës bujqësore të synuar
Shërbimet këshilluese për bujqësinë	12	Numri i fermave të synuara
Masat për mbrojtjen e ujit të pijshëm	13	Numri i kërkuar i zonave të mbrojtjes
Zhvillimi i bazës së njohurive (kadastra)	14	Numri i zonave që kërkojnë përmirësim të të dhënave
Masat për asgjësimin e SPRr-ve dhe SP-ve	15	Numri i zonave që kërkojnë rishikimin e lejeve
Ndërtimi ose përmirësimi i ITUNU-ve industrialë	16	Numri i ITUNU-ve që kërkohen për arritjen e OM-së
Strategjitë për kontrollin e sedimenteve	17	Sipërfaqja e tokës së mbuluar nga strategjia e kontrollit
Llojet invazive/Strategjia për kontrollin e sëmundjeve	18	Gjatësia e trupave ujorë që kërkojnë rehabilitim Numri i kërkuar i planeve të veprimit për llojet
Masat për kontrollin e ndikimeve Rekreative	19	Gjatësia e trupave ujorë që kërkojnë rehabilitim
Masat për kontrollin e ndikimeve të akuakulturës	20	Gjatësia e trupave ujorë që kërkojnë rehabilitim
Masat për kontrollin e ndotjes së shpërndarë urbane	21	Gjatësia e trupave ujorë që kërkojnë rehabilitim Numri i pritave lumore/zonave buferike/SQK-ve
Masat për kontrollin e ndotjes nga pylltaria	22	Sipërfaqja e tokës së mbuluar nga strategjia e kontrollit
Ujëmbajtja natyrore/masat buferike	23	Numri i zonave që kërkojnë zbatim

[204] Klasifikimi bazuar në elementin e Skemës së Raportimit GIS të WISE 2016 - *Masa e Llojit Kyç*

Masat për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	24	Numri i instalimeve që kërkojnë përshtatje
Masat për kontrollin e acidifikimit	25	Gjatësia e trupave ujorë që kërkojnë rehabilitim
Masat për kontrollin e nxjerrjeve të tepërta	26	Numri i lejeve të lëshuara me nxjerrje të kufizuara

13.8 Formatet e Përfunduara për Raportimin e Masave

Siç përmblidhet në Tabelat në Shtojcën për Programin e Masave, raportimi i masave për PMBU-në Ishëm ndjek një qasje të strukturuar, e cila është në përputhje me kërkesat minimale të sugjeruara nga WISE 2016. Këto tabela mund të zbatohen në mënyrë identike në të gjitha kategoritë e trupave ujorë. Atributet e masave përfshijnë si minimum:

Kodin e masës - emrin e masës - llojin e masës sipas nenit 11 - kategorinë e ujit (lum, liqen, ujë nëntokësor, etj.) - njësinë pritëse (basen, nënbasen, trup ujor) - presionet përkatëse - kontributin që masa pritet të japë drejt objektivat mjedisore – Autoritetin Kompetent – Operatorët ose sektorët e prekur nga masa – koston totale

Detajet e mëtejshme lidhur me financimin dhe zbatimin, veçanërisht për sa i përket burimeve të financimit dhe kostove të masave raportohen kryesisht në Kapitullin XI të këtij raporti (shihni edhe Shtojcën X).

13.8.1 Raportimi Përmbledhës i PiM-së në Nivelin e Basenit ujor

Krahas nivelit të detajuar të "raportimit kombëtar" (të përcaktuar në Shtojcën XIII,), një prej kërkesave të raportimit WISE është të ofrohet një Përmbledhje të nivelit të lartë të presioneve dhe masave në nivelin e basenit ujor . Shtetet Anëtare duhet të raportojnë një tregues të standardit të nivelit të lartë për secilin prej tetë Presioneve të Llojit Kyç dhe të paktën një tregues tjetër të paracaktuar (kombëtar) specifik për presionin individual ose substancën kimike.

Treguesi i presionit të ShA-së lehtëson krahasimin midis baseneve të ndryshme lumore, dhe treguesi i rekomanduar shërben thjesht për të treguar gjatësinë (sipërfaqen) e përgjithshme të trupit ujor që i nënshtrohet presionit të konsiderueshëm të identifikuar si % e totalit të gjatësisë/sipërfaqes së trupave ujorë në basen.

Për shembull, siç përcaktohet në Tabela 13-4, për presionin pikësor të ujërave të ndotura urbane të patrajtuara (PLIK 1), vlerësohet që 56.4% e gjatësisë së kombinuar të të gjithë trupave ujorë (lumorë) ndikohet nga ujërat e ndotura urbane të patrajtuara. Treguesi i ShA-së identifikon shkallën relative të presionit. Treguesi i presionit kombëtar tregon shkallën absolute, në këtë rast ose:

i) gjatësinë e përgjithshme reale të trupave ujorë të prekur (treguesi i përgjithshëm), 103 km sipas shembullit.
ii) ose ngarkesën e BOD-së (treguesi specifik, tonë/vit) që duhet reduktuar për të arritur objektivin mjedisor (p.sh. niveli i përputhshmërisë së BOD_5 me 'Statusin e Mirë', zakonisht < 4 mg/l).

Treguesi i presionit kombëtar është çështjeje zgjedhjeje e ShA-së, por duhet të jetë në përputhje me standardin e treguesve të përcaktuar në Vlerësimi i presioneve dhe statusi si rezultat i këtij vlerësimi janë themelore për të kuptuar dhe vlerësuar nga ana sasiore hendeqet midis objektivave mjedisore dhe gjendjes aktuale të trupave ujorë në basenin ujor. Vlerësimi ndërthur kriteret analitike dhe përshkruese, në varësi të nivelit të të dhënave në dispozicion.

Vlerësimi i statusit të trupit ujor është një ushtrim i vështirë krahasuar me standardet provizore bazuar në një model të vetëm analitik. Vlerësimi i presioneve është më kompleks sepse presionet janë zakonisht më abstrakte dhe më të vështira për t'u vlerësuar në sasi dhe/ose presionet e ndryshme kombinohen në mënyra komplekse për të ndikuar në statusin e trupit ujor. Vlerësimi sasior i presioneve, ndonëse i realizueshëm, kërkon të dhëna të konsiderueshme cilësore, shumë prej të cilave nuk mblidhen aktualisht në Shqipëri.

Vërehet se shumë prej "treguesve të presionit" kërkojnë që të raportohet një sasi e volumit, ose si pjesë e llogaritjes së përafërt të ngarkesës së ndotësve, ose si pjesë e ndikimit të prurjes ekologjike. Treguesit kuptimplotë të presionit nuk mund të përcaktohen për shkak të shkatërrimit tërësor të rrjetit kombëtar hidrometrik, mungesës së të dhënave hidrologjike të përdorshme të kohëve të fundit dhe mungesës së

konsiderueshme të të dhënave për volumet e mbetjeve të lëngëta pas trajtimit të monitoruara nga institucionet dhe industritë.

Për të përmirësuar politikëbërjen mjedisore dhe për të identifikuar "pikat e nxehta mjedisore" që mund të kërkojnë rregullore më strikte (përmes kushteve të lejes dhe zbatimit) nevojitet një lloj indeksimi sasior i presionit. Tabela 10-1 dhe 10-2 paraqesin dy grupe treguesish për presionin, të cilat janë që të dyja në përputhje me skemën e raportimit WISE 2016.

"Treguesit e përgjithshëm" janë 'sasitë' e nivelit të lartë të presionit që lidhen me objektet si numri i pikave të shkarkimit, numri i hidrocentraleve ose pikave të nxjerrjes së ujit për qëllime bujqësore, gjatësia e trupave ujorë të prekur, numri i instalimeve pa leje, etj. Këto duhet të jenë lehtësisht të përcaktueshme edhe në rastin e funksionimit aktual të kufizuar të Kadastrës, bazuar në shqyrtimet e dokumentacionit ose inspektimet e shpejta në terren.

"Treguesit precizë" në përputhje me WISE 2016 kërkojnë matje dhe raportim sektorial tejet të përmirësuar krahasuar me ato të dhëna aktualisht në dispozicion përmes KKBU-së, veçanërisht lidhur me matjen e parametrit të mbetjeve të lëngëta pas trajtimit dhe volumeve të prurjes së lumit. Këto tabela janë plotësuar pjesërisht, aty ku ka të dhëna të disponueshme, dhe ndodhen në Shtojcën Teknike IV.

Tabela 10-1 dhe Tabela 10-2. Niveli i matjes së sasisë së prurjeve në Shqipëri (mbetjet e lëngëta pas trajtimit dhe ujërat pritëse) është kaq i ulët në këtë kohë saqë treguesit volumetrikë (pra ngarkesat) nuk mund të llogariten në mënyrë të besueshme. Për pasojë, në planin e parë të periudhës 2024-2029 treguesit duhet të mbështeten në masat e thjeshtuara të gjatësisë së trupit ujor ose në numrin e pikave.

Lidhur me zbatimin e masave, duhet identifikuar Masa më e zbatuar e Llojit Kyç (MLlK) për Presionin e Llojit Kyç, si dhe treguesi që do të përdoret për të kuantifikuar progresin e masës. Duhet identifikuar treguesi më i përhapur për çdo MLlK, si dhe vlera bazë për 2021-shin. Për shembull, siç përcaktohet në Tabelën 12-6, presioni pikësor i ujërave të ndotura urbane duhet të trajtohet më mirë përmes ndërtimit të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUNU) (masë bazë në kuadër të Direktivës së Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane të BE-së, MLlK 1).

Ka shumë rëndësi që treguesi i masës të identifikohet dhe vlerësohet nga ana sasiore. Në rastin e ujërave të ndotura urbane, treguesi i masës që zbatohet më së shumti është niveli i popullsisë ekuivalente (p.e.), që kërkon trajtim të ujërave të ndotura për të arritur standardin e cilësisë mjedisore prej BOD_5 < 4 mg/l në trupin ujor pritës.

Treguesi i masës duhet të jetë një vlerë/objektiv e/i qartë e nivelit të pritshëm/aktual të progresit kundrejt objektivit mjedisor dhe duhet të paraqitet gjithnjë në formatin e "bilancit të reduktuar" (p.sh. presioni që mbetet) dhe për të paktën për periudhën bazë + dy periudha të ardhshme PMBU-je (pasi shumë masa mund të kërkojnë 6 ose mbi 12 vjet për të arritur objektivat).

Në shembullin e Tabela 13-4 vlerësohet që 750,000 p.e. janë aktualisht pa trajtim të ujërave të ndotura urbane sipas standardit të kërkuar. Në vijim të zbatimit të ITUNU-ve të ndryshëm, progresi i masës synon 500,000 dhe 250,000 përkatësisht deri në vitin 2029 dhe 2035. Për rrjedhojë, ekuivalenti i presionit deri në 250,000 p.e. mbetet ende të arrihet deri në 2035-n, duke kërkuar masa të mëtejshme pas vitit 2035, por kjo gjë është mëse e qartë nga formati i raportimit.

Rishikimi i progresit të zbatimit të masave (me arritjen e treguesve) është komponent themelor i rishikimit të PMBU-së në fund të periudhës gjashtë vjeçare.

13.8.2 Përmbledhja e Formateve të Raportimit për PiM-në Kombëtare

Atributet kyç të formateve të raportimit të masave tregojnë praktikën më të mirë lidhur me përcaktimin e masave:

- Masat duhet të synojnë presionet e identifikuara. Një masë merr kuptimin e nenit 11 të DKU-së kur provohet se kontribuon në reduktimin e presionit (dhe rrjedhimisht në përmirësimin e statusit të trupit ujor) ose në nivelin e basenit ujor , ose në nivelin e trupit ujor.

- Masat duhet të jenë realiste dhe të arritshme. Shumë PMBU të mëparshme, veçanërisht në vendet e para-aderimit, kanë objektiva krejtësisht jo realiste dhe të paarritshme, duke shpërfillur buxhetet qendrore të kufizuara, mangësinë e kapaciteteve teknike të stafeve, mungesën e të dhënave të monitorimit ose shkallën e koordinimit të nevojshëm midis Autoriteteve Kompetente.
- Masat duhet të jenë të vlerësuara nga ana sasiore për sa i përket progresit kundrejt objektivit. Nëse nuk vendosen objektiva të vlerësueshëm dhe nëse nuk ka monitorim progresiv, këto objektiva nuk mund të arrihen kurrsesi deri në fund të periudhës së PMBU-së. Kjo arrihet duke vendosur tregues standardë.
- Masat bazë dhe plotësuese mund të gjejnë zbatim në shkallë të përgjithshme (basen ujore) ose në shkallë specifike (trup ujor). Dallimi thelbësor midis masave të përgjithshme dhe masave specifike është zakonisht numri i trupave ujorë të prekur nga masat dhe ndarja e tyre hapësinore (të ndara ose të grupuara).
- Masat mund/duhet të diferencohen nga a) Autoritetet Kompetente b) presionet e ndryshme. Ndonëse dy Autoritetet Kompetente mund të punojnë në mënyrë paralele për të njëjtat presione, çdo AK duhet të përdorë instrumente specifike, lejet dhe kompetencat ligjore specifike, ndaj masat individuale duhen ndarë.
- "Praktika më e mirë" Tabela 13-4 (shihni edhe Shtojcën XIII,) përafrohet me kërkesat e raportimit të WISE 2016 që: Masat duhet të jenë të përcaktuara për sa i përket llojit dhe shkallës së sigurisë se presionet po trajtohen dhe se kjo gjë do të sjellë përmirësime kundrejt arritjes së statusit ose potencialit të mirë në trupat ujorë.
- Masat duhet të hartohen bazuar në vlerësimin e statusit aktual të trupit ujor, plotësuar me informacion nga analiza e presioneve dhe ndikimeve që prekin trupin ujor".

Shtojca XI paraqet shembujt se si duhen plotësuar Tabelat për dy grupet kryesore alternative të masave:

- Masë e vetme e përgjithshme që zbatohet për të gjithë trupat ujorë
- Masa të ndryshme specifike që zbatohen për një trup ujor të vetëm

Tabela 13-3 – Marrëdhënia midis Llojeve dhe Synimeve të Masave dhe Sistemit të Kodimit

	MASAT BAZË	MASAT PLOTËSUESE	TREGUESIT SHEMBUJ PËR PRESIONET[205]	TREGUESIT SHEMBUJ PËR MASAT
MASAT E PËRGJITHSHME **Zbatohen në nivel baseni ose nënbaseni, ose për trupa ujorë të shumëfishtë** **SISTEMI I KODIMIT** BM ose SM + ID-ja e basenit + Rendi p.sh. BM-3514-01	Direktivat e BE-së sipas rastit, veçanërisht: • Menaxhimi i Cilësisë së Ujërave të Larjes (2006/7/KE) • Direktiva për Ujin e Pijshëm (BE) (2020/2184) • Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/KEE) • Direktiva për Nitratet (91/676/KEE)(91/676/ KEE) • Direktiva për Habitatet (92/43/KEE) • Direktiva për Kontrollin dhe Parandalimin e Integruar të Ndotjes (96/61/KE) • Direktiva për Mbrojtjen e Produkteve Bimore (91/414/KEE)	• Tarifat/incentivat financiare • Marrëveshjet e bashkëpunimit • Qasjet këshilluese • Instrumentet statutore • Masat nuk marrin parasysh presionin e kohës dhe të sezonit	• Numri i pikave të shkarkimit të ujërave të ndotura të patrajtuara • Tonazhi i zbatuar vjetor i NPK-ve • Numri i trupave ujorë me ndërprerje morfologjike • Ngarkesa vjetore e pesticideve mbi SCM • Numri i impianteve hidroenergjetike • Volumi i nxjerrjeve të ujërave nëntokësore	• Popullsia ekuivalente që do të trajtohet nga ITUNU • Numri total i lejeve të reja/të mbartura • Zona bujqësore subjekt i kufizimeve të NPK-së • Reduktimi në % i nxjerrjeve dhe konsumit të ujit sektorial • Indeksi i Shfrytëzimit të Basenit Ujor • Indeksi i Prurjes Ekologjike në Basen
MASAT SPECIFIKE **Zbatohen në nivelin e një trupi ujor të vetëm ose në trupa ujorë të ngjashëm** **SISTEMI I KODIMIT** BM ose SM + ID e Trupit Ujor + Rendi p.sh. SM-GW35140409-01	Direktivat e BE-së sipas rastit, veçanërisht: • Menaxhimi i Cilësisë së Ujërave të Larjes (2006/7/KE) • Direktiva për Ujin e Pijshëm (BE) (2020/2184) • Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/KEE) • Direktiva për Nitratet (91/676/KEE)(91/676/ KEE) • Direktiva për Habitatet (92/43/KEE) • Direktiva për Kontrollin dhe Parandalimin e Integruar të Ndotjes (96/61/KE) • Direktiva për Mbrojtjen e Produkteve Bimore (91/414/KEE)	• Kushtet e lejes marrin parasysh kërkesat specifike për trupin ujor, p.sh vlerat kufi të emetimeve (VKE), prurjen ekologjike, zonat e mbrojtura, ekosistemet e varura nga ujërat nëntokësore, pikat e nxjerrjes, etj. • Masat do të marrin parasysh presionin e kohës dhe të sezonit	• Statusi i elementeve individuale të statusit të trupit ujor - Elementet cilësore biologjike - Elementet fiziko-kimike - Elementet hidromorfologjike - Shtojca X Substancat Prioritare - Shtojca VIII NSBU • Gjatësia e zonës së pikut të shfrytëzimit • koha e dëmtimit të trupit ujor në % • dëmtimi i prurjes së trupit ujor në % • Niveli i vrojtuar i ujërave nëntokësore	• Raporti i Cilësisë Ekologjike të Trupit Ujor • Indeksi i Prurjes Ekologjike në Trup Ujor • Ngarkesa sezonale e BOD-së g/m^3 • Ngarkesa sezonale e SPBU-së g/m^3 • Leja e operatorit lëshuar me kufizime sezonale (koha/prurja) • Instalimet industriale me trajtim në terren

[205] Treguesit e Përgjithshëm duhen interpretuar si numri/gjatësia e instalimeve/pikave/objekteve që supozohet se kanë ndikim negativ. a) Lejet ose nuk ekzistojnë, ose nuk janë respektuar b) Lejet janë të pamjaftueshme për sa i përket VKE-ve dhe/ose SCM-ve. Lidhur me Tabelën 10-2

Tabela 13-4 - Përmbledhja e presioneve dhe masave në nivel baseni: Baseni i Lumit Ishëm

Kodi i basenit	Kategoria e TU	Presionet dominuese	Indikatori i Presioneve	Presionet Indikatori i ShA Koha bazë 2023 [206] [207]	Presionet Indikatori kombëtar Koha bazë 2023 [208]	MLIK e aplikueshme	Indikatori i MLIK	Vlera e indikatorit Koha bazë 2023[209]	Vlera e indikatorit Pikësynimi 2029 [210]
3514	US	Lloji 1 – Ndotje pikësore (ujërat e ndotura urbane)	*Gjatësia e trupave ujorë të prekur (km)*	56.38%	103 km	MLLK 1	*Popullsia që kërkon ITUN (p.e.)*	1,000,000	553,009
	UN	Lloji 1 – Ndotje pikësore (ujërat e ndotura urbane)	*Zona e UN-ve me përqendrim mesatar të nitrateve mbi vlerën e pragut (km^2)*	56.38%	56.38%	MLLK 1	*Popullsia që kërkon ITUN (p.e.)*	1,000,000	553,009
	UN	Lloji 1.5 – Vende industriale të kontaminuara	*Numri i vendeve që potencialisht kërkojnë riparim (N)*	Nr	Nr	MLLK 4	*Vende për riparim (N)*	6	0
	US/UN	Lloji 1.6 – Vendet e depozitimit të mbetjeve të ngurta	*Numri i vendeve që potencialisht kërkojnë riparim (N))*	Nr	Nr	MLLK 21	*Numri i lendfilleve josanitare që do të mbyllen (N)*	0	0

[206] Treguesi Standard i Shtetit Anëtar shprehet si një përqindje relative për të lehtësuar krahasimin midis baseneve lumore. Në Kuadrin e ri të PMBU-së në Shqipëri, ky tregues përkufizohet si gjatësia e të gjithë trupave ujorë që i nënshtrohen atij Lloji Kryesor i Presionit (si % e gjatësisë totale të trupave ujorë në pellgun e lumit) OSE si % e sipërfaqes totale të trupave ujorë nëntokësorë në rasti i UN-ve. Ku

[207] Kur nuk është e përshtatshme të shprehet treguesi i shtetit anëtar si një % e gjatësisë totale të trupit (p.sh. presionet e pikave të izoluara), në mënyrë alternative përdoret numërimi absolut i objekteve

[208] Treguesi kombëtar shprehet si një vlerë absolute për të treguar shkallën ose sasinë e presionit specifik për pellgun e lumit

[209] Vlera e Treguesit Bazë përfaqëson shkallën e masës së kërkuar në fillim të periudhës së RBMP në mënyrë që të arrihet plotësisht objektivi(et) mjedisor në të gjithë pellgun e lumit

[210] Vlera e treguesit të synuar përfaqëson shkallën e masës që kërkohet ende për të arritur objektivat mjedisore për pellgun e lumit, në përputhje me procedurat e raportimit të WISE 2016

Kodi i basenit	Kategoria e TU	Presionet dominuese	Indikatori i Presioneve	Presionet Indikatori i ShA Koha bazë 2023 [206] [207]	Presionet Indikatori kombëtar Koha bazë 2023 [208]	MLIK e aplikueshme	Indikatori i MLIK	Vlera e indikatorit Koha bazë 2023[209]	Vlera e indikatorit Pikësynimi 2029 [210]
	UN	Llojis 1 & 2 – Ndotje pikësore dhe e shpërndarë	*Puset e Ujësjellësit Publik pa zona të përcaktuara mbrojtëse (N)*	%	Nr	MLLK 13	*Numri i zonave të mbrojtjes që kërkojnë përkufizim (N)*		
	US/UN	Lloji 2 – Diffuse pollution (agriculture)	*Gjatësia e trupave ujorë të prekur (km)*	16%	95.5 km	MLLK 2	*Gjatësia e trupave ujorë të synuar (km)*	95.5 km	50 km
	UN	Lloji 2 – Ndotje e shpërndarë (agrikultura)	*Zonat UN-ve me përqendrim mesatar të nitrateve mbi vlerën e pragut (km²)*	16%	%	MLLK 2 & 3	*Zona e trupave ujorë nëntokësorë që kërkojnë reduktim të NO_3-N nën vlerën e pragut (km²)*		
	US	Lloji 3.1 – Nxjerrje ose devijim për shkak të bujqësisë	*Vëllimi i ujit që mbiabstraktohet përtej përdorimit efikas (Mm³/vit)*	N/A	Mm³	MLLK 8 & 26	*Reduktimi i nxjerrjes së ujit që kërkohet për të arritur objektivat (Mm³ OSE %)*		
	US	Lloji 3.2 – Nxjerrje ose devijim për shkak të furnizimit me ujë të pijshëm publik	*Vëllimi i ujit që mbiabstraktohet përtej përdorimit efikas (Mm³/vit)*		Mm³	MLLK 8 & 26	*Reduktimi i nxjerrjes së ujit që kërkohet për të arritur objektivat (Mm³ OSE %)*		
	US	Lloji 3.5 – Nxjerrje ose devijim për shkak të hidrocentraleve	*Vëllimi i ujit që mbiabstraktohet përtej përdorimit efikas (Mm³/vit)*	Mm³/year	Mm³/year	MLLK 8 & 26	*Reduktimi i nxjerrjes së ujit që kërkohet për të arritur objektivat (Mm³ OSE %)*	XX Mm³	XXMm³

Kodi i basenit	Kategoria e TU	Presionet dominuese	Indikatori i Presioneve	Presionet Indikatori i ShA Koha bazë 2023 [206] [207]	Presionet Indikatori kombëtar Koha bazë 2023 [208]	MLIK e aplikueshme	Indikatori i MLIK	Vlera e indikatorit Koha bazë 2023[209]	Vlera e indikatorit Pikësynimi 2029 [210]
	US	Lloji 4.1 – Morfologjia e kanalit	*Gjatësia OSE numri i trupave ujorë të prekur nga ndryshimi fizik i kanalit (km)*	Nr	Nr	MLLK 6	*Gjatësia ose numri i trupave ujorë që kërkojnë riparim (km)*	10.895 km	
	US	Lloji 4.2 – Digat & Barrierat	*Numri i strukturave që prishin vazhdimësinë e lumit (N)*	Nr	Nr	MLLK 5	*Numri i strukturave që do të përmirësohen (N)*	53	20
	US	Lloji 4.3 – Ndryshimi Hidrologjik	*Gjatësia e trupave ujorë të prekur nga regjimi i ndërprerë i rrjedhës (%)*	%	km	MLLK 7 & 8	*Gjatësia ose numri i trupave ujorë ku duhet të rivendoset regjimi i prurjes mjedisore (km)*	31.881km	
	US/UN	Lloji 5.3 – Hedhja e mbetjeve të ngurta urbane dhe hedhjet pikësore	*Numri i vendeve që dështojnë objektivat (N)*	No	No	MLLK 21	*Numri i trupave ujorë që kërkojnë riparim (N)*	25	20
	UN	Lloji 6.1 – Rimbushja e ujërave nëntokësore (rrjedhje / infiltrim)	*Zhvillimi i ri urban që parandalon rimbushjen e UN (km²)*	%	%	MLLK 27	*Zhvillime të reja ose zona të nevojshme për të përfshirë drenazhimin ei qëndrueshëm ose aktivitete të rimbushjes (km²)*		

Kodi i basenit	Kategoria e TU	Presionet dominuese	Indikatori i Presioneve	Presionet Indikatori i ShA Koha bazë 2023 [206] [207]	Presionet Indikatori kombëtar Koha bazë 2023 [208]	MLIK e aplikueshme	Indikatori i MLIK	Vlera e indikatorit Koha bazë 2023[209]	Vlera e indikatorit Pikësynimi 2029 [210]
	UN	Lloji 6.2 – Nxjerrja e ujërave nëntokësore	*Sipërfaqja e UN-ve që po abstraktohet (km²)*	%	%	MLLK 14 & 26	*Numri i nxjerrjeve të ujërave nëntokësore që kërkojnë leje (N)*		

13.9 Përmbledhje e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë që Rrezikojnë të Mos i Përmbushin Objektivat Mjedisore

Bazuar në karakterizimin dhe vlerësimin e trupave ujorë të analizuar në Kapitullin 10, Përmbledhja e të gjithë trupave ujorë sipërfaqësorë që rrezikojnë të mos i arrijnë objektivat mjedisore të përcaktuara paraqitet në Tabela 13-5.

Aty ku ka pritshmëri që masat të zbatohen për një trup ujor specifik ose një grup të ngjashëm trupash ujorë, për masat bazë përmendet direktiva përkatëse ose për masat plotësuese përmenden instrumentet e tjera, sipas rastit. Masat e ardhshme shqyrtohen dhe rishikohen së bashku me palët e përshtatshme të interesit gjatë fazës së konsultimit të PMBU-së (gjatë 2022).

Për shkak të kompleksitetit teknik, financimit ose kufizimeve të tjera, mund të gjykohet se, pavarësisht statusit të pamjaftueshëm, nuk ka asnjë perspektivë realiste për zbatimin e masave të mjaftueshme brenda periudhës së PMBU-së për trupat ujorë të specifikuar. Arsyet e pamundësisë për të arritur përputhshmërinë duhen përmendur në pjesën përshkruese.

13.10 Përmbledhje e Trupave Ujorë Nëntokësorë që Rrezikojnë të Mos i Përmbushin Objektivat Mjedisore

Bazuar në karakterizimin dhe vlerësimin e trupave ujorë të analizuar në Kapitullin 10, Përmbledhja e të gjithë trupave ujorë nëntokësorë që rrezikojnë të mos i arrijnë objektivat mjedisore të përcaktuara paraqitet në Tabela 13-6.

Aty ku ka pritshmëri që masat të zbatohen për një trup ujor specifik ose një grup të ngjashëm trupash ujorë, për masat bazë përmendet direktiva përkatëse ose për masat plotësuese përmenden instrumentet e tjera që gjejnë zbatim sipas rastit. Masat e ardhshme shqyrtohen dhe rishikohen së bashku me palët e përshtatshme të interesit gjatë fazës së konsultimit të PMBU-së (gjatë 2022).

Për shkak të kompleksitetit teknik, financimit ose kufizimeve të tjera, mund të gjykohet se, pavarësisht statusit të pamjaftueshëm, nuk ka asnjë perspektivë realiste për zbatimin e masave të mjaftueshme brenda periudhës së PMBU-së për trupat ujorë të specifikuar. Arsyet e pamundësisë për të arritur përputhshmërinë duhen përmendur në pjesën përshkruese.

Tabela 13-5 –Përmbledhje e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë që Rrezikojnë të Mos i Përmbushin Objektivat Mjedisore

TRUPI UJOR OSE GRUPI	EMRI	FORMA	STATUSI I PËRGJITHSHËM	DËSHTIMI I CILËSISË?	DËSHTIMI I SASISË?	DËSHTIMI I MORFOLOGJISË?	MASAT E PROPOZUARA?	INSTRUMENTAT BAZË	INSTRUMENTAT PLOTËSUESE
RW351441	Tërkuza	Natural	5	Jo	Po	Po	Po	EU 2000/60/KE Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (85/337/KEE) Direktiva për Habitatet (92/43/KEE)	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011
RW351443	Tërkuza	TUTM	4		Po	Po	po	EU 2000/60/KE Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (85/337/KEE) Direktiva për Habitatet (92/43/KEE)	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011
RW351487	Lana	Natyror	5	po	po	po	po	91/271/KEE (Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane)	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011
RW351485	Lana	TUTM	5	po	po	po	po	91/271/KEE (Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane)	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011
RW351483	Lana	Natyror	5	po	po	po	po	91/271/KEE (Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane)	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011
RW351481	Lana	Natyror	5	po	po	po	po	91/271/KEE (Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane)	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011
RW351495	Tiranë	TUTM	4	po	po	po	po	91/271/KEE (Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane)	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011

RW351493	Tiranë	TUTM	2	po	po	po	po	91/271/KEE (Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane)	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011
RW351491	Tiranë	TUTM	5	po	po	po	po	91/271/KEE (Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane)	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011
RW35147	Tiranë	Natyror	5	po	po	po	po	91/271/KEE (Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane)	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011
RW35145	Tiranë	Natyror	4	po	po	po	po	91/271/KEE (Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane)	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011
LW351401	Rezervuari i Bovillës	TUTM	3	Jo	po	po	po	EU 2000/60/KE	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011
LW351402	Liqeni i Tiranës	TUA	3	po	Jo	po	po	EU 2000/60/KE	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011
LW351403	Ujëmbledhësi i Cekrezës	TUTM	3	Jo	Jo	po	po	EU 2000/60/KE	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011
LW351404	Ujëmbledhësi i Tapizës	TUTM	3	Jo	Jo	po	po	EU 2000/60/KE	Ligji 111/2012 Ligji Nr. 10431/2011

Tabela 13-6 –Përmbledhja e Trupave Ujorë Nëntokësorë Rrezikojnë të Mos i Përmbushin Objektivat Mjedisore

TRUPI UJOR OSE GRUPI	GRUPI	EMRI	STATUSI I PËRGJITHSHËM	DËSHTIMI I CILËSISË?	DËSHTIMI I RIMBUSHJES?	DËSHTIMI I NXJERRJES?	MASAT E PROPOZUARA?	INSTRUMENTAT BAZË	INSTRUMENTAT PLOTËSUESE
GW35140101	-	Thumanë	Mirë	Po Intruzion i ujërave të kripura	Jo	Jo	Po	BE 2000/60/KE BE 2006/118/KE	Ligji 111/2012
GW35140103	-	Tiranë	Mirë	Po Urbane dhe industriale	Jo	Po	Po	BE 2000/60/KE BE 2006/118/KE	Ligji 111/2012
GW35140501	B	Fushë-Krujë	Mirë	Po Kanalizime	Po	Jo	Po	BE 2000/60/KE BE 2006/118/KE	Ligji 111/2012
GW35140503		Qinam							
GW35140505		Brar							
GW35140507	C	Kashar	Mirë	Po Kanalizime	Po	Jo	Po	BE 2000/60/KE BE 2006/118/KE	Ligji 111/2012
GW35140509		Bubq							

Shënime:

1. Statusi i përgjithshëm i referohet gjendjes aktuale, që është e mirë gjithandej, ndonëse ka disa pasiguri të konsiderueshme.
1. Kolona e “dështimit” i referohet natyrës së riskut të identifikuar për planin e periudhës 2024-2029.
2. Dështimi i rimbushjes i referohet mosarritjes së bilancit të ujit; dështimi i nxjerrjes i referohet pamundësisë për të realizuar aktiviteteve të qëndrueshme pompimi
3. Ju lutemi të vini re që niveli i besueshmërisë për vlerësimet e Grupit B dhe C është caktuar zero.

13.11 Masat për Trupat Ujorë Sipërfaqësorë në Risk

Programi i masave bazë dhe/ose plotësuese synon trupat ujorë sipërfaqësorë në rrezikojnë të mos i përmbushin të objektivave mjedisore. Këta trupa ujorë kërkojnë vlerësim të detajuar të mënyrës se si do të trajtohet statusi aktual dhe ndikimeve vijuese gjatë kohëzgjatjes së planit (2024-2029). Masat bazë dhe plotësuese, të përgjithshme dhe specifike, duhen identifikuar së bashku me ndryshimin e pritshëm në status, autoritetin kompetent përgjegjës, datat e synuara dhe kostot e masave.

Duke qenë se duhet të përcaktojmë trupa ujorë individualë ose grupe të trupave ujorë, masat listohen sipas rendit të trupave ujorë, duke filluar me trupat ujorë të rrjedhës së sipërme.

Masat e përgjithshme për grupet e trupave ujorë ose masat e veçanta për trupat ujorë individualë paraqiten në Shtojcën Teknike XI.

PiM-të mbështetet te rezultatet e analizës së presioneve dhe vlerësimi i statusit të ujit (Kapitulli 10) dhe rrjedhimisht përfshijnë masa me rëndësi për mbarë basenin, të orientuara drejt vizioneve të dakorduara dhe objektivave të menaxhimit për 2029-n.

PiM-të janë strukturuar duke marrë parasysh presionet më domethënëse (ndryshimet organike, kimike, morfologjike dhe ato të lëndëve ushqyese) dhe trupat ujorë që gjenden në të gjithë basenin. Synimi është të arrihen objektivat e menaxhimit për të gjithë basenin, për çdo trup ujor sipërfaqësor dhe nëntokësor, në mënyrë që objektivat mjedisore të parashtruara në DKU të arrihen deri në përfundim të zbatueshmësisë së ciklit të parë të këtij plani. Gjetjet dhe përfundimet kryesore për masat e identifikuara dhe rëndësia e tyre për basenin, si dhe prioritetet lidhur me zbatimin e tyre në shkallë të gjerë paraqiten në PiM në formë të përmbledhur. Zbatimi i këtyre masave të rëndësishme në të gjithë basenin sigurohet duke u koordinuar me institucione që kanë si objektiv zbatimin e këtyre masave.

Nga analiza e presioneve dhe përcaktimi i statusit identifikohen të gjithë ata trupa ujorë që kanë dështuar në arritjen e OM-ve. Sipas Nenit 4 të DKU-së, duhen marrë masat e duhura për të parandaluar përkeqësimin e statusit të ujërave sipërfaqësore dhe arritjen e statusit ose potencialit të mirë ekologjik. Kapitulli 10 shpjegon burimin e këtyre ndotësve dhe ndikimin që kanë te trupat ujorë. Më poshtë gjeni listën e masave të propozuara për përmirësimin e statusit të këtyre trupave ujorë.

Masat duhet të jenë të përzgjedhura për sa i përket llojit dhe shkallës, për t'u siguruar se presionet po trajtohen dhe se kjo gjë do të sjellë përmirësime kundrejt arritjes së statusit ose potencialit të mirë të trupave ujorë. Masat duhen hartuar duke u bazuar te vlerësimi i statusit aktual të trupit ujor, plotësuar me informacion nga analiza e presioneve dhe ndikimeve që prekin trupin ujor.

Për çdo MLlK janë identifikuar treguesit sasiorë të shkallës dhe progresit të zbatimit të masave . Shtetet Anëtare mund të raportojnë edhe për treguesit e tyre nëse treguesit e propozuar nuk shihen të përshtatshëm për situatën kombëtare.

Grupimi i trupave ujorë u mbështet te disa faktorë mjaft të rëndësishëm si afërsia me njëri-tjetrin (trupa ujorë që i përkasin një lumi) dhe presioneve të njëjta që veprojnë mbi to. Ka disa trupa ujorë që me shumë gjasë nuk i arrijnë objektivat mjedisore. Lidhur me zbatimin e masave, duhet identifikuar MLlK-ja më e përshtatshme për PLlK-në, si dhe treguesi që do të përdoret për të vlerësuar nga ana sasiore për progresin e masës. Te tabelat në Shtojcën Teknike XI do të gjeni dy shembuj konkretë se si janë përzgjedhur masat për dy raste të një grupimi të trupave ujorë. Shpjegimi i metodologjisë dhe rruga e ndjekur gjenden gjithashtu në Shtojcën Teknike XI.

13.11.1 Grupi i Trupave Ujorë 351495-351493-351491

Trupat ujorë 351495 dhe 351491 janë rrjedhat e sipërme të lumit të Tiranës – supozohet se aktiviteti mjaft i përhapur minerar për nxjerrjen e zhavorrit aluvial përgjatë gjatësisë së trupit ujor ndikon negativisht te ekosistemi ujor për sa i përket morfologjisë së habitatit të lumit (presioni domethënës 4.1.4) dhe rrjedhat e mesme të lumit të Tiranës janë tepër të modifikuara për shkak të kanalizimeve. Trupi ujor që kalon përmes qytetit është tepër i ndikuar nga ujërat e ndotura të patrajtuara, duke sjellë kështu nivele mjaft të larta të BOD_5 dhe tarifave për mbetjet e ngurta (presionet domethënëse 1.1 dhe 1.2).

Zakonisht, presioni pikësor i ujërave të ndotura urbane (PLlK 1.1) duhet trajtuar nëpërmjet ndërtimit të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN - MLlK 1), por kur ndërtimi i ITUN-ut është i pamundur, ka MLlK të tjera që mund të ndërmerren për reduktimin e ngarkesës nga ujërat e ndotura urbane si masa për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes nga zonat urbane, transporti dhe infrastruktura e ndërtuar. (MLlK 21).

Një prej masave është reduktimi i pikave të shkarkimit të ujërave të ndotura, grumbullimi i tyre në një numër të vogël kolektorësh dhe ndarja e sistemeve të kombinuara nga ujërat e shiut, të cilat kanalizohen në sistemin e furnizimit me ujë dhe nuk lejohen të rrjedhin me trupin ujor të lumit të Tiranës.

Kanalizimi i trupave ujorë sjell ndikime negative për ekosistemin ujor për sa i përket morfologjisë së habitatit, ndaj propozohet që në trupin e modifikuar ujor me shtrat me strukturë jonatyrore të ndërtohen/lejohen itinerare të faunës ujore. Pastrimi i të gjitha pikave ku ka lendfille të mbetjeve të ngurta urbane pranë ose në shtratin e lumit. Heqja e pikave të shkarkimit të ujërave të ndotura urbane që nuk janë të lidhura me sistemin e kanalizimeve.

Këto masa do të ndihmojnë në përmirësimin e statusit aktual të këtyre trupave ujorë dhe me zbatimin e tyre pritet që në planet e ciklit të dytë të menaxhimit (nga viti 2029) statusi i keq të përmirësohet në status mesatar.

13.11.2 Grupi i Trupave Ujorë 351487-351485-351483

Trupat ujorë 351487, 351485, 351483 dhe 351481 janë pjesë e lumit të Lanës, që është tepër i kontaminuar nga ujërat urbane të patrajtuara (presionet domethënëse 1.1 dhe 1.2). Lumi i Lanës është trup ujor tepër i modifikuar për shkak të kanalizimeve.

Zakonisht, presioni pikësor i ujërave të ndotura urbane (Presioni i Llojit Kyç 1.1) duhet të trajtohet përmes ndërtimit të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN) (masë bazë në kuadër të DTUN-ut të BE-së, MLlK 1).

Aktualisht, ka përfunduar pjesa strukturore e impiantit në Kashar, por puna është ndërprerë për shkak të mospërmbushjes së kushteve të kontratës. Ky PMBU i kërkon autoritetit përkatës të përfundojë me ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane në mënyrë që të fillojë trajtimi i ujërave të ndotura urbane që vijnë nga zonat urbane të Tiranës.

Për këta trupa ujorë janë propozuar edhe masa të tjera krahas impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, të cilat do të sjellin përmirësimin e statusit të tyre. Një prej masave është reduktimi i pikave të shkarkimit të ujërave të ndotura, grumbullimi i tyre në një numër të vogël kolektorësh dhe ndarja e sistemeve të kombinuara nga ujërat e shiut, të cilat kanalizohen në sistemin e furnizimit me ujë dhe nuk lejohen të rrjedhin me trupin ujor të lumit të Lanës.

Kanalizimi i trupave ujorë sjell ndikime negative për ekosistemin ujor për sa i përket morfologjisë së habitatit, ndaj propozohet që në trupin e modifikuar ujor me shtrat me strukturë jonatyrore të ndërtohen/lejohen itinerare të faunës ujore.

Këto masa do të ndihmojnë në përmirësimin e statusit aktual të këtyre trupave ujorë dhe me zbatimin e tyre pritet që në planet e ciklit të dytë të menaxhimit (nga viti 2029) statusi i keq të përmirësohet në status mesatar.

Tabela 13-6 paraqet përmbledhjen e të gjitha presioneve dhe masave (shihni dhe Shtojcën XI për tabelat e detajuara për çdo trup ujor).

13.11.3 Grupi i Trupave Ujorë 351443-351441

Trupat ujorë 351443 dhe 351441 ndodhen në rrjedhat e mesme dhe të poshtme të Tërkuzës. Si pasojë, regjimi i rrjedhës mjedisore të këtij lumi, që zgjatet deri në Rinas, është ndryshuar krejtësisht. Ndryshimi fizik i trupit ujor për shkak të ndërtimit të digës tregon se trupi ka formën e TUTM-së. Dhe ndryshimi i regjimit të rrjedhës ka sjellë klasifikimin e këtij trupi ujor me “status të dobët” (presionet domethënëse 3.2 dhe 4.2.3). Për të rikthyer regjimin e duhur të nevojitet shkarkimi i një sasie të caktuar uji nga rezervuari i Bovillës. Këtu kemi edhe një ndërthurje të regjimit të pamjaftueshëm të rrjedhës me nivelet e larta të BOD_5 për shkak të ujërave të ndotura urbane të patrajtuara dhe presioneve të tjera të ndryshme, të cilat e klasifikojnë këtë trup ujor në kategorinë e “statusit të keq”.

MLlK-ja më e përshtatshme për reduktimin e presioneve dhe ndikimeve nga ndryshimi hidro-morfologjik i trupave ujorë është përmirësimi i kushteve hidro-morfologjike të trupave ujorë përveç vazhdimësisë gjatësore (MLlK 6).

Disa prej masave nxisin edhe rehabilitimin e zonës së nxjerrjeve të inerteve. Subjekteve u kërkohet të përmbushin kushtet e lejes për rehabilitimin e zonës dhe mbylljen e rrugëve lidhëse pas përfundimit të lejes.Gjithashtu edhe struktura mbrojtëse kundër erozionit të tokave bujqësore nga lumi. Heqja e pritave në lumë. Monitorimi i përmbushjes së kushteve të lejeve që u janë dhënë subjekteve që nxjerrin zhavorr nga shtrati i trupit ujor. Regjimi i prurjes duhet të lejojë që, gjatë stinës së thatë të verës, nga rezervuari i Bovillës të shkarkohet një sasi e caktuar e volumeve ujore për të mundësuar furnizimin me ujë të trupit ujor.

Këto masa do të ndihmojnë në përmirësimin e statusit aktual të këtyre trupave ujorë dhe me zbatimin e tyre pritet që në planet e ciklit të dytë të menaxhimit (nga viti 2029) statusi i keq të përmirësohet në status mesatar.

13.11.4 Trupat Ujorë 35147 dhe 35145

Trupat ujorë 35147 dhe 35145 kombinohen duke u derdhur në lumin e Tiranës dhe Lanës në qendër të qytetit. Ndonëse në formë natyrore, ujërat urbane të patrajtuara sjellin nivele mjaft të larta të BOD_5 në ujërat pritëse (presionet domethënëse 1.1 dhe 1.2).

Zakonisht, presioni pikësor i ujërave të ndotura urbane (Presioni i Llojit Kyç 1.1.) duhet të trajtohet përmes ndërtimit të ITUN-ëve (masë bazë në kuadër të DTUN-it të BE-së, MLlK 1).

Aktualisht, po ndërtohet ITUN-i i Kamzës me p.e 96,991 (2029) në trupin ujor 35147. Ky PMBU i kërkon autoritetit përkatës të përfundojë me ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane në mënyrë që të fillojë trajtimi i ujërave të ndotura urbane që vijnë nga zonat urbane të Kamzës.

Për këta trupa ujorë janë propozuar edhe masa të tjera krahas impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, të cilat do të sjellin përmirësimin e statusit të tyre. Një prej masave është reduktimi i pikave të shkarkimit të ujërave të ndotura, grumbullimi i tyre në një numër të vogël kolektorësh dhe ndarja e sistemeve të kombinuara nga ujërat e shiut, të cilat kanalizohen në sistemin e furnizimit me ujë dhe nuk duhet të lejohen të rrjedhin në trupat ujorë. Pastrimi i të gjitha pikave ku ka venddepozitime të mbetjeve të ngurta/interte urbane pranë ose në shtratin e lumit.

Këto masa do të ndihmojnë në përmirësimin e statusit aktual të këtyre trupave ujorë dhe me zbatimin e tyre pritet që, në planet e ciklit të dytë të menaxhimit (nga viti 2029), statusi shumë i keq të përmirësohet në status mesatar. Tabelat më të detajuara për çdo trup ujor ndodhen në Shtojcën Teknike XI)

13.12 Përcaktimi dhe Raportimi i Kostove dhe Burimeve të Financimit

13.12.1 Pasqyra e Kostove

Tabela e përgjithshme e PiM (referuar Shtojcës Teknike të PiM) përmbledh kostot e parashikuara për masat që synojnë trupat ujorë sipërfaqësorë në risk, të cilat janë si vijon:

- Kostot kapitale ose të instalimit lidhen në përgjithësi për zbatimin e masave specifike, referuar edhe si "kostot e instalimit" p.sh. ndërtimi i objekteve të trajtimit të ujërave të ndotura
- Kostot e operimit dhe mirëmbajtjes lidhen kryesisht me kostot e vazhdueshme të cilat kanë të bëjnë me kostot e instalimit më lart.
- Kostot e administrimit përkufizohen në përgjithësi si kosto që mbulohen nga autoritetet kompetente, ministritë dhe agjencitë e tjera qeveritare përgjegjëse për administrimin e masave të veçanta p.sh në formën e inspektimit dhe zbatimit, mbledhjes së taksave ose tarifave etj.
- Kostot e burimit janë kosto indirekte, referuar edhe si "kosto oportune" që lidhen me përdorimin e ujit (që supozohet se është një burim i shterushëm dhe i pakët) në mënyrë specifike. Kostot e burimit lindin vetëm nëse përdorimi alternativ i ujit do të sillte një vlerë më të lartë ekonomike se përdorimi aktual p.sh diferenca midis përfitimeve neto (përdorimi aktual kundrejt përdorimit alternativ) është negative p.sh kuota e ujit që rezervohet për ujitje mund të sjellë vlerë më të lartë ekonomike nëse do të ri-orientohej drejt përdorimit të hidroenergjetikës.

13.12.2 Vështrimi i Përgjithshëm i Fondeve

Në mënyrë që PiM-ja të jetë e vlefshme, duhen konfirmuar burimet e financimit. Nëse nuk ka një buxhet ose financim të dedikuar për ta mbështetur masën, kjo e fundit ka shumë pak gjasa që të zbatohet, ndaj duhet të shtyhet deri kur të konfirmohet financimi.

Duke qenë se konfirmimi përfundimtar i fondeve mund të kërkojë vite, qoftë përmes financimit ndërkombëtar, buxhetit fiskal kombëtar ose fondeve bashkiake, disa prej burimeve të financimit mund të jenë të parakohshme, p.sh gjatë rishikimit të draft PMBU-së brenda vitit 2022, konfirmimi përfundimtar i fondeve, nëse nuk është miratuar ende, merret i mirëqenë.

Burimet e mundshme të financimit janë:

- Grantet e jashtme ose huatë supozohen të vijnë nga burimet joqeveritare si p.sh agjencitë ndërkombëtare të financimit, programi i asistencës teknike
- Buxheti qendror ose i agjencisë supozohet të financohet përmes buxhetit qendror të qeverisë qendrore ose mekanizmit të financimit për Ministrinë ose agjencinë rregullatore
- Buxheti bashkiak - supozohet të financohet përmes mekanizmave të financimit të autoriteteve administrative rajonale ose bashkive
- Tarifat ose detyrimet shtetërore për ujin - supozohet që do të financohen përmes administrimit të instrumenteve të ndryshme fiskale për rikuperimin e kostove mjedisore në nivel kombëtar ose bashkie p.sh tarifat e nxjerrjes së burimit ujor, taksat e ndotjes së ujit
- Financimet e operatorit supozohen se do të financohen drejtpërdrejt nga të ardhurat e operatorit ku operatori duhet t'i financojë masat sipas parimit "ndotësi paguan" (DKU neni 9).

13.12.3 Raportimi i Kostove dhe Fondeve

Struktura e raportimit fleksibël Tabela 13-11 pranon se gjatë zbatimit të një mase të vetme mund të lindin lloje të shumëfishta kostosh dhe/ose mekanizma financimi. Për shembull, vendosja e kuotave të reduktuara të ujit nga autoriteti rregullator për ruajtjen e statusit të ujërave nëntokësore mund të kërkojë shpenzime nga ana e operatorëve të ujitjes për instalimin e teknologjive më efikase, me kosto që i atribuohen shërbimit kështillues

për fermerët, ku kostot e burimit lindin për shkak të rendimentit të reduktuar si rrjedhojë e kufizimit të përdorimit të ujit dhe kostove administrative për zbatimin e masave të eficiencës.

Me të përfunduar PiM-ve (Shtojca Teknike XIII), në një tabelë të vetme, por në rreshta të ndryshëm, detajohen kostot e ndryshme të mundshme që i atribuohen agjencive ose operatorëve të ndryshëm.

Në përputhje me praktikën e mirë të rekomanduar[211], duhet të identifikohen instrumentet (ligjore ose fiskale) që mbështesin masën; në rastin e masës së llojit bazë, duhet cituar direktiva më e përshtatshme e BE-së. Në rastin e masave plotësuese, duhet cituar legjislacioni kombëtar i zbatueshëm për taksat dhe tatimet kombëtare.

Raporti midis masave të veçanta dhe trupave ujorë të shënjestruar identifikohet më lehtë po t'i referohemi Tabelës 13-18 për ujërat sipërfaqësore (shihni edhe Shtojcën XIII).

13.13 Përmbledhja e Kostove për Masat e Trupit Ujor Sipërfaqësor

Tabela 13-9 paraqet përmbledhjen e kostove të parashikuara për të gjitha masat që synojnë trupat ujorë sipërfaqësorë në rrezik mund të gjendet në Shtojcën Teknike XIII. Rendi i kostimit ndjek rendin e masave të përsëritura në tabelat përkatëse.


[211]Studim krahasues i presioneve dhe masave në planet e menaxhimit të baseneve lumore kryesore në BE - Detyra 4b: Kostot dhe Përfitimet e Zbatimit të DKU-së, ACT*eon* 2012.

13.14 Përmbledhja Përfundimtare e Statusit Aktual dhe të Parashikuar të Trupit Ujor Sipërfaqësor

Figura 13-2 përmbledh rezultatet e pritshme të PMBU-së 2024-2029 për statusin e trupave ujorë sipërfaqësorë në basenin e lumit Ishmëm

- Pritet që 5 trupat ujorë me "status të mirë" ta ruajnë statusin e mirë.
- Pritet që 4 trupat ujorë me "status mesatar" ta ruajnë statusin mesatar
- Pritet që 6 trupat ujorë me "status të dobët" ta përmirësojnë statusin në status mesatar
- Pritet që 7 trupat ujorë me "status të keq" ta ngrenë statusin në status të dobët.

Figura 13-2 - Përqindjet Aktuale dhe të Parashikuara të Statusit të Trupave Ujorë Sipërfaqësorë



13.15 Procedurat e Monitorimit dhe Vlerësimit të Planit

13.15.1 Detajet e programit të propozuar të monitorimit të ujërave sipërfaqësore për periudhën 2024-2029

Programi i propozuar i monitorimit mbështetet te kapacitetet ekzistuese, por kërkon më tepër burime nga sa janë vendosur në dispozicion deri më tani.

13.15.1.1 Kategoritë e propozuara të burimeve ujore

DKU-ja përcakton katër kategori kryesore:

- Lumenj. AKM-ja ndërmerr monitorime rutinë në basenin e lumit Ishëm, me përjashtim të Tërkuzës dhe Zezës.
- Liqene. Kjo kategori përfshin edhe rezervuarët. Këta nuk monitorohen ende nga AKM-ja, por të paktën po sugjerohet të përfshihet rezervuari i Bovillës.
- Ujëra të Përkohshme. Sugjerohet të kapërcehen për periudhën 2024-2029, pasi kërkon mjete lundruese dhe pajisje për matje/kampionim në drejtim vertikal (thellësi).
- Ujëra bregdetare. AKM-ja merr kampione brenda ose në afërsi të vijës bregdetare, ndonjëherë edhe në grykëderdhjet e ujërave të ndotura. Këto kampione nuk mund të përdoren si përfaqësuese në vlerësimin e cilësisë së trupave ujorë bregdetare, që janë 1.8 km të gjerë (dhe disa metra të thellë). Mungojnë mjetet lundruese dhe pajisjet e nevojshme, ndaj kjo kategori e trupave ujorë mund të kapërcehet.

Prandaj, programi i monitorimit të ujërave sipërfaqësore sugjerohet për ato lumenj dhe liqene (rezervuarë) që ndodhen brenda basenit të lumit Ishëm.

13.15.1.2 Parametrat e propozuar të monitorimit

Shkurtesat F-KIM, ECB, SHTOJCA VII E PMBU-SË DHE H-MORF përkojnë me ato të përdorura në Vlerësimin e Presioneve dhe Statusit (sikurse paraqiten në Shtojcën XIII të kësaj PMBU-je).

13.15.1.3 Elementet e përgjithshme të cilësisë fiziko-kimike (F-KIM)

Parametrat që monitorohen në mënyrë rutinë nga AKM-ja përfshijnë të gjithë gamën e elementeve të përgjithshme të cilësisë fiziko-kimike të parashikuar në DKU. Ato monitorohen në lumenj dhe liqene (rezervuarë).

13.15.1.4 Elementet e cilësisë hidro-biologjike (ECB)

Kapaciteti i brendshëm i AKM-së është i kufizuar pasi mund të trajtojë vetëm faunën bentike jovertebrore. Ky parametër është tregues për gjendjen e trupave ujorë, por nuk është aq i përshtatshëm për liqenet/rezervuarët. Nga ana tjetër, fitoplanktoni, ndër të tjera, është i përshtatshëm si parametër për liqenet/rezervuarët. Fatkeqësisht, AKM-ja nuk ka punësuar ekspertë përkatës. Aktualisht, AKM-ja ndërmerr vetëm monitorime të faunës bentike jovertebrore në lumenj dhe të klorofilit-a në liqene/rezervuarë.

13.15.1.5 Ndotës të tjerë të veçantë (Shtojca VIIL PMBU)

BOD_5 dhe CODCr mund të konsiderohen si pjesë e "ndotësve të tjerë të veçantë". Ata analizohen në mënyrë rutinë nga AKM-ja dhe zbatohen edhe për lumenjtë, edhe për liqenet/rezervuarët.

13.15.1.6 Elementet e cilësisë hidromorfologjike

LUMENJTË: PRURJA

[212]IgjEO i monitoron nivelet e ujit të lumenjve në pesë stacione (nënseksioni13.15.1.7); nuk pritet rritje e stacioneve hidrologjike gjatë periudhës 2024-2029. Megjithatë, prurjet e trupave ujorë mund të llogariten me përafërsi nëpërmjet modelimit, që në fakt është përdorur në Tabela 5-1 prej PMBU-ve kryesore.

LUMENJTË: MORFOLOGJIA

Departamenti i Hidrogjeologjisë së ShGjSh-së është në gjendje të monitorojë luhatjet e thellësisë dhe gjerësisë së lumit, si dhe strukturën dhe nënshtresën e shtratit të tij.

LIQENET

IgjEO nuk i monitoron liqenet/rezervuarët brenda basenit të lumit Ishëm. Megjithatë, Ujësjellës Kanalizime Tiranë, UKT mund të mbledhë të dhëna të përshtatshme rreth për shembull niveleve të ujit në rezervuarin e Bovillës.

13.15.1.7 Pikat e monitorimit

LUMENJTË: F-KIM dhe ECB-të

Në parim, këto elemente cilësie monitorohen në të gjithë trupat ujorë të përvijuar. Megjithatë, disa mund të përjashtohen, për shembull sepse statusi i tyre mund të ndikohet nga trupat ujorë të afërt (referojuni shënimeve në fund të faqes në Tabela 3-1, Kapitullin 3).

Disa trupa ujorë janë mbuluar tashmë nga pikat e monitorimit të AKM-së. Shumica e trupave ujorë të përvijuar janë vizituar gjatë "Fushatës së Kampionimit të Lumenjve, prill 2021" në kuadër të projektit EUSIWM, duke ofruar kështu një lloj orientimi për pikat e mbetura. Megjithatë, përcaktimi i pikave të përshtatshme për kampionimin e faunës bentike jovertebrore kërkon punë përgatitore të mëtejshme.

[212] *Kurbat Q_h (të nevojshme për llogaritjen e prurjes nga niveli i ujit) nuk janë përditësuar prej 15 vjetësh, ndoshta edhe më shumë.*

LUMENJTË: PRURJET

Stacionet aktuale të monitorimit hidrologjik renditen në tabelën 13-14 dhe 13-15 në Shtojcën Teknike XII. Të dobishme janë, nëse ka, edhe të dhënat e UKT-së për shkarkimet e rezervuarit të Bovillës në lumin e Tërkuzës (trupi ujor RW311443), në kuadër edhe të rregullimit të prurjeve mjedisore.

LUMENJTË: ELEMENTET E CILËSISË BIOLOGJIKE

Profilet ndodhen kryesisht në zona ku ka nxjerrje (intensive) zhavori/rëre. Lumi i Lanës dhe Tiranës nuk përfshihen. Për shkak të lidhjes së elementeve të cilësisë hidromorfologjike me elementet e cilësisë hidrobiologjike (pra faunës bentike jovertebrore për sa i përket programit të propozuar të monitorimit 2024-2029), sugjerohet që:

- Të shtohet edhe një prerje tjetër tërthore përgjatë lumit Ishëm më tutje në rrjedhën e poshtme, për shembull në afërsi të stacionit të cilësisë ujore "Ura Salmer" të AKM-së.
- Të shtohen prerje tërthore përgjatë lumit të Lanës dhe Tiranës, p.sh në rrjedhën e sipërme, të mesme dhe të poshtme. Në këtë fazë, nuk mund të sugjerohen më pika të mundshme monitorimi.

LIQENET: F-KIM, klorofil-a

Këto liqene, rezervuarë nuk monitorohen në mënyrë rutinë nga AKM-ja, por u kampionuan gjatë Fushatës së Kampionimit të Liqeneve, qershor dhe korrik 2021", në kuadër të projektit EUSIWM. Kampionimi me varkë është parakusht (kampionet e marra nga brigjet nuk janë përfaqësuese për liqenet/rezervuarët). Nevojiten studime të mëtejshme për të përcaktuar nëse mjafton vetëm një pikë (vertikale) monitorimi, apo nevojiten më tepër pika të tilla për të bërë monitorim dhe vlerësim sa më përfaqësues të statusit. Për më tepër, mund të kërkohet marrja e (nën)kampioneve në thellësi të ndryshme (p.sh me kampionues uji Ruttner)

LIQENET: HIDROMORFOLOGJIA

Sugjerohet që ndërkohë të përdoren, nëse ka, të dhënat për nivelet e ujit, volumet e ujit etj. që mblidhen ndër të tjera nga UKT-ja, MBZhR-ja dhe të tjerë.

13.15.1.8 Frekuencat e monitorimit

Frekuencat e propozuara të monitorimit paraqiten në tabelën më poshtë (shihni edhe shtojcën IX).

Tabela 13-7 - Frekuencat e propozuara të monitorimit [një herë për interval të përmendur]

	LUMENJTË Mbikëqyrje	**Operacionale & Bazë**	LIQENET Mbikëqyrje	**Operacionale & Bazë**
Elementet e cilësisë biologjike				
fauna bentike jovertebrore	1 vit *	1 vit *	-	-
klorofil-a	-	-	1 muaj	3 muaj
Elementet e cilësisë hidromorfologjike				
hidrologjia	ditore	ditore	-	-
morfologjia	6 vjet	3 vjet	-	-
Elementet e cilësisë fiziko-kimike				
Elementet e përgjithshme të cilësisë fiziko-kimike	1 muaj	3 muaj	1 muaj	3 muaj
Ndotës të tjerë të veçantë (BOD_5, COD_{Cr})	1 muaj	3 muaj	1 muaj	3 muaj

*Një herë gjatë stinës së pranverës (së hershme), me gjasë në mars-maj.

Tabela 13-8 – Përmbledhje e Programit të Masave sipas Trupit Ujor Sipërfaqësor

Nr	Kodi i masës	Kodi i Trupit Ujor ose Kodi RB	Presion i rëndësishëm	KTM	Lloji i masës	Emri i masës	Autoriteti Përgjegjës	Treguesi KTM	Vlera e treguesit 2024	Vlera e treguesit 2029
1	BMRW3514 82-01	RW35145 RW35146 RW35147 RW351481 RW351482	1.1 – Ndotja pikësore e ujërave të ndotura urbane	1	*Bazë*	*Përfundimi i ndërtimit dhe vënia në punë e ITUN* Kashar pe 350,000 ***Trupi ujor 351482***	*AKUM* *AMBU*	*Ekuivalenti i popullsisë (p.e)* *Numri i ITUN* që kërkon të ndërtohet ose përmirësohet	*800,000* *4*	*450,000* *3*
2	BMRW3514 7-01	RW35147 RW35145 RW35143	1.1 – Ndotja pikësore e ndotura të ndotura urbane	1	*Bazë*	*Ndërtimi i ITUN Kamëz,*pe 96,991 (2027) ***Trupi ujor 35147***	*AKUM* *AMBU*	*Ekuivalenti i popullsisë (p.e)* *Numri i ITUN* që kërkon të ndërtohet ose përmirësohet	*800,000* *4*	*703,0003* *3*
3	SMSW3514-01	RBSW3514	1.3 - Impiante sipas DEI	16	*Shtesë*	*Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura industriale, duke kërkuar që çdo instalim industrial të ketë trajtimin e efluentit në vend, në zbatim të legjislacionit*	*AKM* *AMBU* *Subjekti privat*	*Numri i subjekteve qe nuk kane te instaluar impiant te trajtimit te ujerave te ndotura industriale*	*70*	*30*
4	SMSW3514-02	RBSW3514	3 – Nxjerrja ose devijimi i rrjedhës	8	*Shtesë*	*Përmirësimi i kushteve mjedisore në trupat ujor nëpërmjet rehabilitimit të segmenteve ujor të modifikuar.*	*AMBU* *AKM*	*Numri i lejeve të rishikuara të nevojshme për arritjen e objektivave*		

Nr	Kodi i masës	Kodi i Trupit Ujor ose Kodi RB	Presion i rëndësishëm	KTM	Lloji i masës	Emri i masës	Autoriteti Përgjegjës	Treguesi KTM	Vlera e treguesit 2024	Vlera e treguesit 2029
5	SMSW3514-03	RBSW3514	1.1 – Ndotja pikësore e ujërave të ndotura urbane *1.2 – Vërshime urbane prej shirave*	21	*Shtesë*	*Reduktimi i shkarkimeve të drejtpërdrejta të patrajtuara nga derdhjet e kanalizimeve me anë të devijimit në sistemet e reja të kolektorëve.*	*AKUM Bashkitë*	*Numri i sistemeve të kullimit të nevojshëm për të arritur objektivat*	76	30
6	SMSW3514-04	RW351413 RW351421 RW351422 RW351423 RW351425 RW351427 RW35143 RW351441 RW351443 RW351444 RW351445 RW35145 RW35146 RW35147 RW351481 RW351482 RW351483 RW351491 RW351493 RW351495	4.4 – Ndryshim hidromorfologjik, humbje fizike e të gjithë ose një pjese të trupit ujor	6	*Shtesë*	*Rehabilimi I trupave ujorë, kontroll i sedimenteve duke aplikuar qasjen ZBN (zgjedhjet e bazuara ne natyre), për të arritur objektivat mjedisore.*	*AMBU MIE*	*Gjatësia (km) ose sipërfaqja (km^2) e rrjetit lumor që do të ndikohet nga masat e nevojshme për arritjen e objektivave*		

Nr	Kodi i masës	Kodi i Trupit Ujor ose Kodi RB	Presion i rëndësishëm	KTM	Lloji i masës	Emri i masës	Autoriteti Përgjegjës	Treguesi KTM	Vlera e treguesit 2024	Vlera e treguesit 2029
7	SMSW3514-05	RBSW3514	2.2 – Bujqësia (e shpërndarë)	12	*Shtesë*	*Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit të ujitjes e kullimit së tokave bujqësore.*	*MBZhR Bashkitë*	*Gjatësia e lumit që kërkon zona tampon për të kapur ose reduktuar ngarkesat e sedimentit në lumenj për të arritur objektivat*	95.5 km	50 km
8	SMSW3514-06	RBSW3514	2.2 - Bujqësia (e shpërndarë)	2 dhe 3	*Shtesë*	*Zbatim i kufizimeve për reduktimin e ngarkesës të ndotjes nga plehëruesit kimik, pesticidet në tokat bujqesore.*	*MBZhR Sektori bujqesor/ privat Bashkitë*	*Hartimi I regjistrit te sasisë totale të lëndëve ushqyese dhe pesticideve të përdorura në praktikat bujqësore dhe permiresimi I politikave.*	0	1
9	SMSW3514-07	RBSW3514	1.6 – Lendfill/depozitim i mbetjeve	21	*Shtesë*	*Heqja/pastrimi i vendgrumbullimeve ilegale të mbetjeve të ngurta*	*AKUM MTM Bashkitë*	*numri i vendgrumbullimeve të paligjshme të identifikuara për t'u hequr*	19	0
10	SMSW3514-08	RBSW3514	*3 - Presionet e nxjerrjes/devijimi i rrjedhës*	26	*Shtesë*	*Përmiresimi i politikave per formalizimin dhe incentivimin e përdoruesve aktual të ujit*	*AMBU IKMT AKM ShGjSh Bashkite*	*Numri i pikave të nxjerrjes*		
11	SMSW3514-09	RBSW3514	*3 - Presionet e nxjerrjes/devijimi i rrjedhës*	7	*Shtesë*	*Përgatitja e një studimi për trupat ujorë të kërcënuar nga ndryshimet e prurjeve*	*IGJEO AMBU*	*Numri i trupave ujorë*		

Nr	Kodi i masës	Kodi i Trupit Ujor ose Kodi RB	Presion i rëndësishëm	KTM	Lloji i masës	Emri i masës	Autoriteti Përgjegjës	Treguesi KTM	Vlera e treguesit 2024	Vlera e treguesit 2029
12	SMLW351401-01	LW351401	3.2 -Nxjerrja ose devijimi i rrjedhës Furnizimi publik me ujë	7, 8, 26	*Shtesë*	*Ulja e humbjeve në rrjetin e furnizimit me ujë të bashkisë Tiranë dhe Kamzë, me qëllim reduktimin e nxjerrjes së tepërt të ujit nga rezervuari i Bovillës.*	*UKT- Tiranë AMBU*	*Sasia e ujit që do të rikuperohet (Mm³/Vit)*	15,7 Mm³/vit = 0,50 m³/s	6.307 mm3
13	SMRW351443-01	RW351443 RW351441	4.3.4 – Ndryshimi hidrologjik	7	*Shtesë*	*Përmirësimi i prurjes mjedisore në lumin Tërkuzë. Uji i 'rikuperuar' nga Bovilla do të përdoret për të siguruar rrjedhjen mjedisore për Tërkuzën*	*UKT AMBU*	*Gjatësia totale e trupave ujorë dhe sasia aktuale e rrjedhës.*	27,1 km 0,50 m³/s	0,00 km 0,20 m³/s
14	SMRW351485-01	RW351485 RW351491	4.1.4 - Ndryshimi fizik i kanalit/shtratit/zonës bregore/bregut - Të tjera	5	*Shtesë*	*Lejimi i kalimit të faunës ujore në trupin e modifikuar me strukturë të panatyrshme të shtratit të tij duke modifikuar pragjet aktuale.*	*AMBU/MIE/ Bashkitë*	*Gjatësia e mbetjes së kanaleve lumore të drejtëzuara të nevojshme për arritjen e objektivave*	5 km	3 km
15	SMRW3514-10	RW351485 RW351491 RW351481 RW351482 RW351483 RW351485 RW351487	4.1.4 - Ndryshimi fizik i kanalit/shtratit/zonës bregore/bregut - Të tjera	5	*Shtesë*	*Zëvendësimi i argjinaturës mbrojtëse të dëmtuar me një argjinaturë të re (ku ato mund të jenë në përputhje me masat/masat e bazuara në natyrën e ZBN).*	*AMBU/MIE/ Bashkitë*	*Gjatësia e mbetjes së kanaleve lumore të drejtëzuara të nevojshme për arritjen e objektivave*		
16	SMRW3514-11	RW351495 RW351493 RW351443 RW351441	3.1 - Abstragimi ose devijimi i rrjedhës - Bujqësia	7 dhe 12	*Shtesë*	*Zbatimi i praktikave më të mira mjedisore në lidhje me praktikat bujqësore (të reja)*	*MBZhR Bashkitë*	*Sipërfaqja e ujitur kërkohet të mbulohet me masa për arritjen e objektivave*		

Nr	Kodi i masës	Kodi i Trupit Ujor ose Kodi RB	Presion i rëndësishëm	KTM	Lloji i masës	Emri i masës	Autoriteti Përgjegjës	Treguesi KTM	Vlera e treguesit 2024	Vlera e treguesit 2029
17	SMLW351401	LW351401	3.2 -Nxjerrja ose devijimi i rrjedhës Furnizimi publik me ujë	13	*Shtesë*	*Identifikimi i zonës së mbrojtjes së ujit të pijshëm (DWPA) për rezervuarin e Bovillës*	*UKT AMBU*	*Hartëzimi*	*1*	0
18	SMSW3514-13	RW35143 RW351413		14	*Shtesë*	*Rehabilitimi dhe funksionimi i dy pikave të monitorimit të rrjedhave sipërfaqësore të pezulluara dhe jashtë funksionit.*	*AKM IGJEO AMBU*	*Vendet që kërkojnë stacion monitorimi*	2	0

Tabela 13-9 Tabelat përmbledhëse për kostot dhe fondet e masave për ujërat sipërfaqësore

A - Masa BMRV3514-01 Ministria përkatëse, Autoriteti Zbatues ose Operatori	Direktiva ose Instrumenti përkatës	Kostot kapitale ose të instalimit	Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes	Shpenzimet e Administrimit	Kostot e Burimeve	Kostot e tjera	Σ e Kostot€M	Burimet e Fondeve	Grant ose hua e jashtme	Buxheti qendror ose i agjencisë	Buxheti Komunës	Financuar nga Operatori	Tarifat ose Taksat Shtetërore të Ujit	Fonde të tjera	Σ e fondeve €M
Përfundimi i ndërtimit dhe vënia në punë e ITUN Kashar **AKUM/MIE /Bashkia e Tiranës/**	Direktiva e Ujërave të ndotura urbane (EU 91/271/KEE) Direktiva Kuadër e Ujit (2000/60/KE)	10,653,000,000.00 LEK													
Ndërtimi i ITUN Kamëz **AKUM/MIE /Bashkia e Tiranës/**	Direktiva e Ujërave të ndotura urbane (EU 91/271/KEE) Direktiva Kuadër e Ujit (2000/60/KE)	6,050,000,000.00 LEK													
Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura industriale, duke kërkuar që çdo instalim industrial të ketë trajtimin e efluentit në vend, në zbatim të legjislacionit	Direktiva e Ujërave të ndotura urbane (EU 91/271/KEE) Direktiva Kuadër e Ujit (2000/60/KE) Direktiva e Integruar e Kontrollit të Parandalimit të Ndotjes (96/61/KE)	24,200,000.00 LEK													

AMBU/ AKM/ Subjekti privat															
Reduktimi i shkarkimeve të drejtpërdrejta të patrajtuara nga derdhjet e kanalizimeve me anë të devijimit në sistemet e reja të kolektorëve. **AKUM/MIE /Bashkitë**		1,493,369,000.00 LEK													
Heqja/pastrimi i vendgrumbullime ve ilegale të mbetjeve të ngurta **AKUM/MIE /Bashkitë**		166,948,551.00 LEK[213]													
Lejimi i kalimit të faunës ujore në trupin e modifikuar me strukturë të panatyrshme të shtratit të tij duke modifikuar pragjet aktuale.	Direktiva për Habitatet (92/43/KEE) Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (85/337/KEE) Direktiva Kuadër e Ujit (2000/60/KE)	9,000,000.00 LEK													

[213] Referuar nga RAPORT FINAL - ZBUTJA E RISKUT NË VEND DEPOZITIME. Qershor 2018- Ky dokument u përgatit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, mbështetur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor, përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim, me ndihmesën teknike të konsulentit.

AMBU/MIE /Bashkitë															
Përmirësimi i kushteve mjedisore në trupat ujor nëpërmjet rehabilitimit të segmenteve ujore të modifikuara. **AMBU/MIE /Bashkitë**	Direktiva për Habitatet (92/43/KEE) Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (85/337/KEE) Direktiva Kuadër e Ujit (2000/60/KE)	1,936,000,000.00 LEK													
Zëvendësimi i argjinaturës mbrojtëse të dëmtuar me një argjinaturë të re (ku ato mund të jenë në përputhje me masat/masat e bazuara në natyrën e ZBN). **AMBU/MIE /Bashkitë**	Direktiva për Habitatet (92/43/KEE) Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (85/337/KEE) Direktiva Kuadër e Ujit (2000/60/KE)	36,000,000.00 LEK													
Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit të ujitjes e kullimit të tokave bujqësore. **MBZhR/Bashkitë**	Politika e Përbashkët Bujqësore e BE-së	1,210,000,000.00 LEK													

B - Masa BMRV3514-02 & SMRV3514-01 & SMRV3514-02 & SMRV3514-03 Ministria përkatëse, Autoriteti Zbatues ose Operatori	Direktiva ose Instrumenti përkatës	Kostot kapitale ose të instalimit	Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes	Shpenzimet e Administrimit	Kostot e Burimeve	Kostot e tjera	Σ e Kostot€M	Burimet e Fondeve	Grant ose hua e jashtme	Buxheti qendror ose i agjencisë	Buxheti Komunës	Financuar nga Operatori	Tarifat ose Taksat Shtetërore të Ujit	Fonde të tjera	Σ e fondeve €M
Zbatim i kufizimeve për reduktimin e ngarkesës të ndotjes nga plehëruesit kimik, pesticidet në tokat bujqesore. **MBZhR/AMBU/Bashkitë**	Politika e Përbashkët Bujqësore e BE-së	121,000,000.00 LEK													
Rehabilimi I trupave ujorë, kontroll I sedimenteve duke aplikuar qasjen ZBN (zgjedhjet e bazuara në natyrë), për të arritur objektivat mjedisore. **AMBU/AKM**		484,000,000.00 LEK													
Përmiresimi i politikave per formalizimin dhe incentivimin e përdoruesve aktual të ujit. **AMBU/IKMT/AKM/ShGjSh/Bashkitë**		121,000,000.00 LEK													

Identifikimi dhe zonimi i Zonave të Mbrojtjes së Ujit të Pijshëm (DWPA). *Kjo përfshin veçanërisht për rezervuarin e Bovillës dhe pikat kryesore të nxjerrjes së ujërave nëntokësore të përdorura nga UKT (Rezultati mund të jetë vetëm një hartë me një zonë sigurie të treguar rreth trupave ujorë. Këto Harta duhet të printohen si PDF dhe të vihen në dispozicion në faqen e internetit të AMBU.)* **AMBU/ UKT/ShGjSh**		484,000,000.00 LEK													

C - Masa SMRV3514-04 Ministria përkatëse, Autoriteti Zbatues ose Operatori	**Direktiva ose Instrumenti përkatës**	**Kostot kapitale ose të instalimit**	**Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes**	**Shpenzimet e Administrimit**	**Kostot e Burimeve**	**Kostot e tjera**	**Σ e Kostot€ M**	Burimet e Fondeve	**Grant ose hua e jashtme**	**Buxheti qendror ose i agjencisë**	**Buxheti i Komunës**	**Financuar nga Operatori**	**Tarifat ose Taksat Shtetërore të Ujit**	**Fonde të tjera**	**Σ e fondeve €M**
Ulja e humbjeve ne rrjetin e furnizimit me ujë të bashkisë Tiranë dhe Kamzë, me qëllim reduktimin e	Direktiva për Habitatet (92/43/KEE) Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit në	1,210,000,000.00 LEK													

nxjerrjes së tepërt të ujit nga rezervuari i Bovillës. *Përmirësimi i prurjes mjedisore në lumin Tërkuzë. Uji i 'rikuperuar' nga Bovilla do të përdoret për të siguruar rrjedhjen mjedisore për Tërkuzën* **UKT (Rezervuari i Bovillës) /AMBU**	Mjedis (85/337/KEE) Direktiva Kuadër e Ujit (2000/60/KE)														
Përgatitja e një studimi për trupat ujorë të kërcënuar nga ndryshimet e prurjeve **AMBU/IGJEO**		60,500,000.00 LEK													
Zbatimi i praktikave më të mira mjedisore në lidhje me praktikat bujqësore (të reja) **MBZhR/Bashkitë**	Politika e Përbashkët Bujqësore e BE-së	60,500,000.00 LEK													
Rehabilitimi dhe funksionimi i dy pikave të monitorimit të rrjedhave sipërfaqësore të pezulluara dhe		4,356,000.00 LEK													

jashtë funksionit. **AKM/IGJEO/AMBU**															
Totalet e kostove dhe fondeve		**24,123,873,551.00 LEK**													

13.16 Masat për Trupat Ujorë Nëntokësorë në Risk

Programi i masave bazë dhe/ose plotësuese synon trupat ujorë nëntokësorë që rrezikojnë të mos i arrijnë objektivat mjedisore. Këta trupa ujorë kërkojnë vlerësim të detajuar të mënyrës se si do të trajtohet statusi aktual dhe ndikimet vijuese gjatë kohëzgjatjes së planit (2024-2029). Masat precize, janë identifikuar së bashku me ndryshimin e pritshëm në status, autoritetin kompetent përgjegjës, datat e synuara dhe kostot e masave. Masat specifike përcaktojnë trupa ujorë individualë, ose grupe trupash ujorë, të cilët janë në risk.

DKU-ja/DUN-i përfshin dy masa të veçanta, por plotësuese, ku të parat janë ato që synojnë të rehabilitimin e trupave ujorë nëntokësorë që aktualisht nuk i përmbushin objektivat, ndërsa masat e tjera kanë të bëjnë me 'parandalimin dhe kufizimin'. Këto të fundit kanë të bëjnë me trupat ujorë nëntokësorë. DKU-ja thekson fuqishëm rëndësinë e parandalimit të ndotjes së konsiderueshme të ujërave nëntokësore, për shkak se merr për bazë përvojën evropiane dhe botërore që ka treguar se nëse ndoten, pastrimi i ujërave nëntokësore është i vështirë, i ngadaltë dhe me kosto të larta, ndërkohë që masat mbrojtëse janë relativisht të thjeshta, të shpejta dhe pa shumë kosto.

Neni 11(3) i DKU-së kërkon një 'qasje të kombinuar' për mbrojtjen e ujërave nëntokësore, që kombinon kontrollin e ndotjes në burim me përcaktimin e standardeve të cilësisë mjedisore; Neni 7 kërkon ruajtjen e cilësisë së ujit për uljen e nivelit të trajtimit të ujit të pijshëm. Rastet e ndotjes së lokalizuar nuk ndikojnë domosdoshmërish te statusi i të gjithë TUN-ëve, me kusht që ato të hetohen dhe nëse është e nevojshme të korrigjohen, si masa parandalimi dhe kufizimi.

Bazuar në analizën e presioneve në Kapitullin 10, në Shtojcën Teknike VII jepet një hartëzim i të gjitha masave për trupat ujorë nëntokësorë.

13.16.1 Masat për parandalim dhe kufizim për Ujërat Nëntokësore

DKU-ja dhe DUN-i theksojnë veçanërisht parandalimin dhe kufizimin e depërtimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të ndotësve në ujërat nëntokësore në të gjithë shtrirjen e trupave ujorë nëntokësorë. Dallimi ndërmjet depërtimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta shpjegohet në diagramin në vijim, i cili përqendrohet në faktin nëse burimi i ndotjes qëndron mbi apo nën pasqyrën e ujit. Shpjegimi më i detajuar i masave për Parandalim dhe Kufizim paraqitet në Shtojcën Teknike VII. Masat për parandalim dhe kufizim janë vija e parë e mbrojtjes për parandalimin e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe përfshijnë masa rregullatore si lejet dhe kodet e sjelljes. Për risqet e identifikuara të ndotjes, DKU-ja i shpreh këto objektiva mbrojtëse duke përcaktuar VKE dhe Vlera Përputhshmërie (VP), të cilat zbatohen në Pikat e Përputhshmërisë (PP) dhe që janë më të rrepta se Vlerat e Pragut. Vlera e Përputhshmërie është përqendrim (dhe regjimi përkatës i përputhshmërisë) i cili, kur nuk tejkalohet në PP, parandalon ndotjen. Ndryshon nga Vlera e Pragut, sepse kjo e fundi zbatohet në burim (pra në PP-0). Parandalimi i ndotjes kërkon marrjen e të gjitha masave që janë 'të nevojshme dhe të arsyeshme', ku 'të arsyeshme' do të thotë teknikisht të realizueshme pa përfshirë kosto joproporcionale. Projektimi i monitorimit për parandalim dhe kufizim përshkruhet në Dokumentin 17 të DKU-së së CIS-it.

Figura 13-3 - Pikat e Përputhshmërisë




Figure 4: points of compliance (POCs)

Masat për rregullimin e depërtimeve nga burimet pikësore përfshijnë përgjithësisht ndalimet, autorizimet dhe rregullat e përgjithshme shtrënguese, përfshi referimin e DTUNU-ut Kontrolli i burimeve të shpërndara është i ngjashëm dhe mund të arrihet përmes rregullimit paraprak, autorizimit paraprak, rregullave të përgjithshme shtrënguese dhe Kodeve statutore të Praktikave, përfshi referimin e Direktivave për Nitratet dhe Produktet për Mbrojtjen e Bimëve. DKU-ja mbizotëron mbi të gjitha direktivat e mëparshme dhe ndalon të gjitha depërtimet e drejtpërdrejta në ujëra nëntokësore.

13.16.2 Masat për Parandalim dhe Kufizim që Zbatohen për të Gjithë Trupat Ujorë Nëntokësorë

- Përmirësimi i Rrjetit dhe Programit të Monitorimit të Ujërave Nëntokësore

Foletë e piezometrave duhet të instalohen dhe monitorohen në të gjithë TUN-ut aluvialë dhe ranoro-konglomeratë, duke nisur me pikat kryesore të pompimit të bashkive, ku nivelet nuk mund të maten, dhe duke vijuar në zonat me pompim intensiv industrial ose për ujitje. Për qëllime të vazhdimësisë, monitorimi ekzistues në stacionet e pompimit duhet të vijojë të paktën deri në fund të PMBU-së së parë. Për më tepër, aftësitë analitike/zhvillim kapacitetesh duhet të përmirësohen me qëllim monitorimin e parametrave të nevojshëm për vlerësimin e statusit në përputhje me DKU-në/DUN-in, si dhe në përputhje me presionet e njohura nga përdorimi kimik.

Burimet me shkarkime të mëdha, veçanërisht ato që maten ose përllogariten të shkarkojnë 100 L/s ose më shumë, duhet të pajisen me një strukturë matëse (p.sh. kapërderdhës ose kanal artificial) dhe regjistrues të dhënash që regjistron nivelin e ujit dhe treguesit e cilësisë.

Rezultatet e matshme të këtij veprimi përcaktojnë qartësisht statusin dhe tendencat, sipas kërkesave të DKU-së.

- Shfrytëzimi i Ujërave Nëntokësore

Kontrolli i nxjerrjeve mund të kërkohet në një moment të caktuar, megjithatë, nuk ka ende ndonjë perspektivë për zbatimin e tyre derisa shumica e puseve private të jenë regjistruar. Regjistrimi është parakusht për monitorimin dhe të gjitha format e menaxhimit aktiv, si veprimtaritë e shumëllojshme për dhënien e lejeve, si edhe për mbrojtjen. Regjistrimi mund të nxitet duke kombinuar mbledhjen aktive të informacionit, me masat detyruese, masat e bazuara në incentiva, dhe përjashtimet ligjore.

Sistemi aktual i lejeve dhe licencimit të pus-shpimeve duhet të shqyrtohet dhe sipas rastit të përmirësohet për të përfshirë rishikimin periodik automatik të sasive të lejeve dhe mundësinë për të kërkuar masat e praktikës më të mirë për eficiencën e ujit, si dhe kushtin e rinovimit.

13.16.3 Masat për Parandalim dhe Kufizim për GW35140101 dhe GW35140103

Në ujërat nëntokësore aluviale të Thumanës dhe Tiranës janë të nevojshme masa të shumëfishta paralele:

- Përmirësimi i Rrjetit dhe Programit të Monitorimit të Ujërave Nëntokësore

Foletë e piezometrave (çifte me puse të cekëta dhe të thella me filtra të shkurtër) duhet të instalohen dhe monitorohen në të gjithë TUN-ët, duke nisur nga vendndodhjet pranë qendrave kryesore të pompimit të bashkive, ku nivelet nuk mund të maten, dhe duke vijuar në zonat me pompim intensiv industrial ose për ujitje. Për qëllime të vazhdimësisë, monitorimi ekzistues në stacionet e pompimit duhet të vijojë të paktën deri në fund të PMBU-së së parë. Për më tepër, aftësitë analitike/zhvillim kapacitetesh duhet të përmirësohen me qëllim monitorimin e parametrave të nevojshëm për vlerësimin e statusit në përputhje me DKU-në/DUN-in, si dhe në përputhje me presionet e njohura nga përdorimi kimik.

Rezultatet e matjeve nga ky veprim janë përfaqësim i saktë i gjendjes dhe tendencave hidraulike dhe kimike në akuiferë të cilët nuk janë shqetësuar nga ndryshim vertikal i karakteristikave si pasojë e veprimtarive natyrore ose të pompimit.

- Bashkëpunimi me Shoqëritë UK, Agjencitë e Linjës dhe Qeverisjen Vendore

Këto agjenci duhet të bashkëpunojnë për planifikimin, monitorimin dhe mbrojtjen e ujërave nëntokësore, bazuar te ndarja e informacionit në platformat digjitale publike. Kjo do të sigurojë të dhëna thelbësore dhe lidhje

institucionale për vlerësim dhe planifikim të përmirësuar të basenit. Shoqëritë e ujësjellësit janë shfrytëzuesit më të mëdhenj, dhe sipas përvojës ndërkombëtare, ata kanë edhe gjasa të jenë ndotësit më të mëdhenj (nga ujërat e ndotura urbane). Shoqëritë UK (çfarë monitorojnë tani?) dhe Agjencitë eLinjës duhet të përmirësojnë dhe bashkërendojnë veprimtaritë e monitorimit në mënyrë që të përputhen me objektivat mjedisore dhe statutore, si dhe t'i kombinojnë të dhënat e tyre të monitorimit në një platformë online. Së bashku me qeverisjen vendore, informacioni për numrin e madh, por të papërcaktuar, të puseve industriale, tregtare dhe për ujitje duhet të mblidhet në mënyrë sistematike.

Rezultatet e matshme të këtij veprimi do të pasqyrohen në bazën e të dhënave që përmban informacion për nxjerrjet dhe cilësinë e ujit për të gjitha puset bashkiake, përqindjen e përcaktuar (ende për t'u përcaktuar) të puseve të mëdha industriale dhe përqindjen e përcaktuar të puseve për ujitje.

- Hartëzimi i Rrezikut nga Ndotja, Zonat e Mbrojtjes Higjeno-Sanitare së Burimit të Ujërave Nëntokësore dhe Zonimi i Përdorimit të Tokës

Analiza e presioneve ka identifikuar risqet e ndotjes që lidhen me kimikatet e identifikuara në DKU dhe DUN. Në këtë kuadër nevojiten një sërë veprimtarish të lidhura me njëra-tjetrën. Veprimi i parë është identifikimi i llojit dhe vendndodhjes së kimikateve të rrezikshme të përdorura ose që depozitohen në TUN, të përmbledhura në një hartë digjitale rreziqesh. Së dyti, vjen përcaktimi i zonës së brendshme, të jashtme dhe të përgjithshme (pus-shpim) të mbrojtjes higjeno-sanitare (ZMHS) në puset bashkiake. Veprimi i tretë është përcaktimi i kufizimeve lidhur me përdorimin e tokës dhe praktikat e përdorimit të kimikateve në ZMHS-të e brendshme dhe të jashtme. Rezultatet e matshme të këtij veprimi janë reduktimi sasior i rrezikut në objekte të zhvendosura, zbatimi i masave zbutëse dhe në përjashtimi i rreziqeve të reja.

- Përmirësimi i Tendencës së Rritjes së Përqendrimit të Nitrateve

Besohet që shkaku i shtimit të nitrateve është kombinimi i ujërave të ndotura familjare që nuk janë të lidhura me kanalizimet, i ndërtimit dhe mirëmbajtjes së dobët të gropave septike, që sjellin rrjedhje të ujërave të zeza dhe ujërave të kulluara, dhe i inflitrimit nga lumenjtë e ndotur. Sidoqoftë, shkaku kryesor është menaxhimi i dobët i mbetjeve fekale, dhe si pasojë zgjidhja lidhet me përmirësimin e mbledhjes, trajtimit dhe inspektimit të mbetjeve fekale në sisteme të palidhura me sistemin kryesor të kanalizimeve, për sa i përket cilësisë së ujërave sipërfaqësore, siç u përmend edhe më lart. Rezultatet e matshme të këtyre veprimeve do të sjellin stabilizimin ose përmirësimin e tendencave të përqendrimeve të nitrateve.

- Modeli i Menaxhimit i Akuiferit Aluvial Ishëm - Mat - Drin

Një presion me gjasë i rëndësishëm nga pikëpamja sasiore lidhet me rrjedhat natyrore dhe si pasojë e pompimit të ujërave nëntokësore ndërmjet baseneve dhe ndërmjet trupave të ujërave nëntokësore në basenet e Ishmit, Matit dhe Drinit. Siç theksohet nga CEMSA (2012), aluvioni në pjesët e poshtme të baseneve të Ishmit, Matit dhe Drinit është për një akuifer të vetëm. Për shkak të nevojës, planet e baseneve ujore i përafrojnë trupat ujorë me Ujëmbledhësit sipërfaqësorë; megjithatë, pompimi nga pikat që janë në skajet e një trupi ujor nëntokësor do të ndikojë te trupit tjetër aty pranë. Gjurmët e këtyre akuiferëve shërbejnë si vendbanim për një pjesë të madhe të popullsisë së Shqipërisë dhe veprimtarive ekonomike, dhe ka gjasa që të rritet kërkesa për më shumë nxjerrje të ujërave nëntokësore. Risqet që lidhen me mbishpërndarjen e tepërt dhe mobilizimin e paqëllimshëm të ujërave nëntokësore të kontaminuara kërkojnë instrumente menaxhimi për mbarë akuiferin, me qëllim këshillimin e agjencive të bazuara në basen dhe agjencive të tjera vendore, dhe udhëzimin e menaxhimit të qëndrueshëm të ujërave nëntokësorë në trupat e përgjithshëm ujorë. Për këtë qëllim, një agjenci qendrore duhet ta përgatisë vetë ose ta porosisë dhe të mirëmbajë një model numerik të akuiferit aluvial Ishëm-Mat-Drin, me qëllim planifikimin, mbishpërndarjen dhe vlerësimin e kërkesave në basene të ndryshme. Duke marrë në konsideratë shqetësimet e shprehura më parë lidhur me të dhënat e monitorimit, ky program duhet të integrohet me trajnime dhe ngritje kapacitetesh, si dhe me përmirësimin e monitorimit të ujërave nëntokësore. Kështu, programi duhet të zbatohet për një periudhë disavjeçare, me qëllim krijimin e një modeli dhe pasjen e kapaciteteve të përshtatshme për menaxhimin e ujërave nëntokësore.

Duke supozuar që veprimet përkatëse ndërmerren bazuar te rekomandimet e tij, rezultatet e matshme të këtij veprimi do të pasqyrohen në mbishpërndarjen e koordinuar të nxjerrjeve ndërmjet baseneve dhe në shmangien e degradimit të rëndë të statusit sasior.

- Hulumtimi i Ndërveprimit Lum-Akuifer

Informacioni i disponueshëm sugjeron se rrjedhat ndërmjet trupave ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë mund të kenë ndikime sasiore dhe kimike serioze, por këto ndikime nuk janë vlerësuar. Kur hyn në akuifer, uji i lumit mund të ndihmojë në uljen e nivelit të ujërave nëntokësore dhe rritjen e rendimentit të qëndrueshëm të akuiferit, por me koston e mundshme të degradimit të cilësisë së ujërave nëntokësore. Hulumtimet në terren duhet të ndërmerren me qëllim përcaktimin sasior të këtyre rrjedhave dhe të ndryshimeve kimike. Rezultatet duhet të përdoren për të mbështetur Modelin e Menaxhimit të përshkruar më lart, parametrat hidraulikë dhe normat e justifikueshme të zbutjes për ujin e ndotur të lumit.

- Hulumtimet Specifike

Pavarësisht statusit të përgjithshëm të deduktuar nga monitorimi, ky status përcaktohet nga ndërmarrja e hulumtimeve, dhe nëse është e nevojshme, rregullimi i pikave të nxehta të ndotjes vendore të identifikuara në Kapitullin 10 dhe Figura 10-3 të renditura më poshtë.

- PH_2 Sheshgrumbullim mbetjesh
- PH_3 ish Kinostudioja “Shqipëria Sot” (përfshi riskun e cianidit)
- PH_21 Instituti i Shëndetit Publik
- PH_25 & 26 Punishte për ripërpunimin për riciklimin e vajit izolues elektrik dhe rehabilitimin e transformatorëve
- Ish-ndërmarrja metalurgjike pranë tregut të Medresesë (përfshi riskun e cianidit)

Përparësia më e madhe u duhet dhënë objekteve PH_25 dhe PH_26 që ndodhen rreth 750 m nga pusi nxjerrës i UKT-së ‘16/97 Kavajë) dhe që rrezikojnë ujësjellësin Publik, si edhe puset private në zonë. Ka edhe puse të shpuara në distancë prej 230 metrash.

- Reduktimi i Vërshimeve Urban dhe Përmirësimi i Rimbushjes

Urbanizimi po i shndërron zonat e ujërave nëntokësore natyrore në godina të papërshkueshme dhe zona të asfaltuara, duke shtuar dhe përshpejtuar vërshimet, dhe duke pakësuar rimbushjen, që si pasojë pakësojnë burimet e disponueshme të ujërave nëntokësore. Autoritetet bashkiake dhe ato planifikuese duhet të vënë në zbatim procedura që kërkojnë përshtatjen e infrastrukturës që bie nën emërtimin ombrellë të Sistemeve të Qëndrueshme Urbane të Kullimit, që përfshijnë ndërtimin e rrjeteve të ullukëve, kanaleve kulluese dhe asfaltimeve të depërtueshme, etj.

13.16.4 Masat për Parandalim dhe Kufizim për Grupin B të Trupave Ujorë Nëntokësorë (GW35140501, GW35140503 dhe GW35140505)

Grupi B përfshin tre trupa ujorë nëntokësorë: GW35140501 (Fushë-Krujë), GW35140503 (Qinam) dhe GW35140505 (Brar). Statusi “Në Risk” i Grupit të TUN-ëve vjen nga mungesa thuajse e plotë e informacionit për akuiferët, si dhe nxitësit dhe presionet e qarta që vijnë si pasojë e urbanizimit të shpejtë që po shoqërohet me nxjerrje të parregulluar të ujërave nëntokësore, risk ndotjeje nga ujërat e ndotura familjare dhe veprimtaritë tregtare, si dhe nga pakësimi i rimbushjes për shkak të shndërrimit të sipërfaqeve natyrore në sipërfaqe të betonizuara. Kjo përkeqësohet më tej nga mungesa e informacionit mbi veçoritë e akuiferëve, numrit dhe thellësisë së puseve, sasive të nxjerra dhe mungesa e plotë e monitorimit të niveleve dhe cilësisë së ujërave nëntokësore.

Nevojitet urgjentisht të zbatohet një program për regjistrimin e pus-shpimeve private.

Me qëllim trajtimin e efekteve të kombinuara të rritjes së shfrytëzimit dhe rimbushjes së pakësuar, autoritetet bashkiake dhe të planifikimit urban duhet të fillojnë zbatimin e atyre që në vende të ndryshme njihen si SQK dhe/ose Rimbushjes së Menaxhuar të Akuiferëve (RMA), dhe që përfshijnë një sërë masash për rritjen e infiltrimit dhe për zbutjen e hidrografit të vërshimeve. Këto përfshijnë mbledhjen e ujërave nga çatitë e reshjet duke i kaluar në rrjet ullukësh, asfaltimet e depërtueshme, pellgje ujëmbajtëse, kanale kulluese, diga kontrolli dhe hapjen e kanaleve anësore.

Përveç masave për Parandalim dhe Kufizim që zbatohen për të gjithë trupat ujorë nëntokësorë, dy pika të nxehta të ndotjes së mundshme (shihni Figura 10-3) kërkojnë hulumtim në terren me monitorim të posaçëm dhe

vlerësim risku, për përcaktimin e natyrës, shtrirjes dhe prirjes së ndotjes, që do të çojnë në marrjen e vendimit lidhur me korrigjimet e mundshme.

- GW35140501, PD-8, sheshgrumbullim mbetjesh në Fushë-Krujë
- GW35140505, PH_6, Uzina e Auto-Traktorëve (me sheshgrumbullim mbetjesh 250m nga JJP-ja)

Rezultatet e matshme të këtyre veprimeve do të jenë vlerësimi sasior i burimeve të disponueshme dhe bilancit ujor, si dhe përcaktimi i statusit sasior dhe kimik dhe tendencave me të paktën nivel mesatar besueshmërie.

13.16.5 Grupi C i Trupave Ujorë Nëntokësorë (GW35140507 dhe GW35140509)

Masat e përgjithshme të nevojshme janë të njëjta me ato të Grupit B, përfshi:

- Informacionin bazë për veçoritë e akuiferit, numrin dhe thellësinë e puseve, nxjerrjet dhe monitorimin e niveleve dhe cilësisë së ujërave nëntokësore.
- Një program për regjistrimin e pus-shpimeve private.
- Vënien në zbatim të Sistemeve të Qëndrueshme Urbane të Kullimit dhe/se Rimbushjes së Menaxhuar të Akuiferëve nga ana e autoriteteve bashkiake dhe planifikimit urban.

Rezultatet e matshme të këtyre veprimeve do të jenë përcaktimi sasior i burimeve të disponueshme dhe bilancit ujor, si dhe përcaktimi i statusit sasior dhe kimik dhe tendencave me të paktën nivel mesatar besueshmërie.

13.17 Përmbledhja e Kostimit të Masave për Ujërat Nëntokësor

Kostot e parashikuara të përmbledhura për të gjitha masat lidhur me trupat ujorë nëntokësorë dhe vlera totale e të gjitha kostove për të gjitha masat për periudhën e Planit 2024-2029 paraqiten në Shtojcën Teknike VII.

13.18 Përmbledhja Përfundimtare e Statusit Aktual dhe të Parashikuar të Trupit Ujor Nëntokësor

Figura 13-4 përmbledh rezultatet e pritshme të PMBU-së 2024-2029 për statusin e trupave ujorë nëntokësorë në basenin e Ishmit.

Figura 13-4 – Përqindjet Aktuale dhe të Parashikuara të Statusit të Trupave Ujorë Nëntokësorë




Tabela 13-10 – Përmbledhje e Programit të Masave sipas Trupit Ujor Nëntokësor

Nr	Kodi i masës	Kodi i Trupit Ujor ose Kodi RB	Presion i rëndësishëm	KTM	Lloji i masës	Emri i masës	Autoriteti Përgjegjës	Treguesi KTM	Vlera e treguesit 2024	Vlera e treguesit 2029
1	BMRB3514	GW35140101 GW35140103 GW35140501 GW35140503 GW35140505 GW35140507 GW35140509	1.1 – Ndotja pikësore e ujërave të ndotura urbane	1	*Bazë*	*Përmirësimi dhe Ndërtimi i gropave septike dhe kanalizimeve.*	*AKUM* *AMBU*	*Numri i gropave septike të ndërtuara sipas standardit*		
2	BMRB3514	GW35140101 GW35140103 GW35140501 GW35140503 GW35140505 GW35140507 GW35140509	1.1 – Ndotja pikësore e ndotura të ndotura urbane	1	*Bazë*	*Ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane* *1. Ndërtimi i ITUN Kashar* 2. *Ndërtimi i ITUN Kamëz*	*AKUM* *AMBU*	*Numri i ITUN* që kërkon të ndërtohet ose përmirësohet	4	2
3	BMRB3514	GW35140101 GW35140103 GW35140401 GW35140403 GW35140405 GW35140411 GW35140407 GW35140409 GW35140501 GW35140503 GW35140505 GW35140507 GW35140509	*1.9 – Pikësore të tjera*	13	*Shtesë*	*Përcaktimi i zonave mbrojtëse (në pus-shpime dhe vendburime të UN) e lidhur me kontrollin e zhvillimit urban*	*ShGjSh* *AMBU* *BAshkitë*	*Numri i lejeve të rishikuara të nevojshme për arritjen e objektivave*		

Nr	Kodi i masës	Kodi i Trupit Ujor ose Kodi RB	Presion i rëndësishëm	KTM	Lloji i masës	Emri i masës	Autoriteti Përgjegjës	Treguesi KTM	Vlera e treguesit 2024	Vlera e treguesit 2029
4	BMRB3514	GW35140101 GW35140103 GW35140401 GW35140403 GW35140405 GW35140411 GW35140407 GW35140409 GW35140501 GW35140503 GW35140505 GW35140507 GW35140509	2-2 Bujqësia (e shpërndarë)	2,3, 12	*Shtesë*	*Reduktimi dhe përmirësimi i praktikave bujqësore në përdorimin e plehrave dhe pesticideve*	*MBZhR* *AMBU*			
5	BMGW3514 0103	GW35140103	1.5- Pikat e ndotura ose zona industriale të braktisura	4	*Shtesë*	*Hetimi / mbyllja e vendeve të kontaminuara*	*MTM* *MIE* *AMBU*	*Numri i vendeve të kontaminuara të korrigjuara*		
6	BMRB3514	GW35140101 GW35140103 GW35140401 GW35140403 GW35140405 GW35140411 GW35140407 GW35140409 GW35140501 GW35140503	3.2 – Nxjerrja ose devijimi i rrjedhës - Furnizimi publik me ujë	7	*Shtesë*	*Kontroll mbi lejet e dhëna dhe identifikimi i çdo vendburimi*	*AMBU* *ShGjSh*	*Numri i lejeve të nxjerrjes me dhe pa kushte*		

Tabela 13-11 Tabela përmbledhëse për kostot dhe fondet e masave për ujërat nëntokësor

A - Masa BMRV3514-01 Ministria përkatëse, Autoriteti Zbatues ose Operatori	Direktiva ose Instrumenti përkatës	Kostot kapitale ose të instalimit	Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes	Shpenzimet e Administrimit	Kostot e Burimeve	Kostot e tjera	Σ e Kostot€ M		Grant ose hua e jashtme	Buxheti qendror ose i agjencisë	Buxheti i Komunës	Financuar nga Operatori	Tarifat ose Taksat Shtetërore të Ujit	Fonde të tjera	Σ e fondeve €M
Përmirësimi dhe ndërtimi i gropave septike dhe kanalizimeve.		1,493,369,000.00 LEK						Burimet e Fondeve							
Ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane 1. Ndërtimi i ITUN Kashar 2. Ndërtimi i ITUN Kamëz		16,703,000,000.00 LEK													
Përcaktimi i zonave mbrojtëse (në pus-shpime dhe vendburime të UN) e lidhur me kontrollin e zhvillimit urban		242,000,000.00 LEK													
Reduktimi dhe përmirësimi i praktikave bujqësore në përdorimin e		242,000,000.00 LEK													

plehrave dhe pesticideve															
Hetimi dhe mbyllja e vendeve të kontaminuara		242,000,000.00 LEK													
Kontroll mbi lejet e dhëna dhe identifikimi i çdo vendburimi		24,200,000.00 LEK													
Totalet e kostove dhe fondeve		**18,946,569,000.00 LEK**													

14 Shtojca Teknike

14.1 Dokumentacioni

Shtojcat Teknike të Raportit Përfundimtar të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor ofrohen në dokumente të ndryshme. Çdo Shtojcë e këtij Raporti ka një Fushë Teknike Specifike të cilës i korrespondon. Nëse nuk ka nevojë për të dhëna ose metodologji mbështetëse, Shtojca Teknike mund të lihet bosh qëllimisht.

14.2 Hartat

Të gjitha hartat e përfshira në këtë Raport janë të disponueshme si dokumente të veçanta në format PDF, së bashku me numrin përkatës të Hartës, p.sh. Harta 4 1 Shpërndarja e Reshjeve, Lumenjtë Kryesorë dhe Rrjetet Hidrometrike të Basenit Ujor të Ishmit. Zakonisht këto harta ofrohen në përmasa A4 ose A3.

Gjithashtu, janë përfshirë tre harta digjitale të rëndësishme në shkallë të vogël A1 (1:100.000 ose 1: 150.000) në shkallën e Rajonit të Basenit Ujor, që mbulon basenet ujore të Ishmit. Këto lehtësojnë inspektimin nga afër të trupave ujorë të përcaktuar dhe veçoritë përkatëse.

14.3 Lista e Shtojcave

Lista përkatëse e Shtojcave dhe Pozicioneve është si vijon:

Shtojca I Hidrologjia

Shtojca II GIS

Shtojca III Grupi i të Dhënave

Shtojca IV Presioni

Shtojca V Hidrobiologjia

Shtojca VI Hidromorfologjia

Shtojca VII Ujërat Nëntokësore

Shtojca VIII Zonat e Mbrojtura

Shtojca IX Monitorimi

Shtojca X Analiza Ekonomike

Shtojca XI Programi i Masave

Shtojca XII Trajnimi dhe Konsultimi Publik

Shtojca XIII Të Dhënat e AMBU-t

PLANI I MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR ISHËM

Shtojca Teknike I (Hidrologjia)

1. BILANCI E UJOR

1.1 Mbështetja e hidrologjisë, bilancit ujor, karakterizimit dhe përcaktimit të statusit të trupave ujorë në PMBU Ishëm

Të dhënat e përdorura për sasinë e ujit të PMBU Ishëm duhen përditësuar me informacione të reja. Qëllimi ishte shtrirja e serisë së të dhënave, që për momentin kanë qenë nivelet e ujit në seritë e shkarkimeve. Për PMBU Ishëm nga hetimi i bazës së të dhënave, ka pasur 8 vendndodhje të mundshme për përditësimin e kurbave të vlerësimit dhe zgjerimin e të dhënave deri në vitet 2007-2008. Zgjerimi i serisë ka lejuar përditësimin dhe krijimin e kurbave të qëndrueshmërisë për pellgun e lumit Ishëm. Procesi për analizat hidrologjike të 8 vendodhjeve përshkruhet më poshtë:

- Seritë e të dhënave të nivelit të ujit kontrollohen dhe korrigjohen nga referenca gjeodezike relative për 8 stacione;
- Mbledhja e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve nga ekspeditat e ndryshme nga viti 1992-2005 ose më vonë për 8 stacione;
- Kontrolli i cilësisë së të dhënave të monitorimit të shkarkimit për 8 stacione;
- Krijimi i kurbës së vlerësimit për 8 stacione;
- Kontrolli i cilësisë së serisë së të dhënave të shkarkimit për 8 stacione;
- Përditësimi ose krijimi i kurbave të qëndrueshmërisë së rrjedhës për 8 stacione;

1.2 Hidrologjia – Pellgu i lumit Ishëm

Për pellgun e lumit Ishëm, lumi i Tiranës përbën degën kryesore dhe më të gjatë të tij. Në përgjithësi, tre degët kryesore janë Tirana (281 km2), Tërkuza (182 km2) dhe Zeza (71.3 km2), që formojnë lumin Ishëm.

Vlerësimi i regjimit vjetor të rrjedhës së lumit Ishëm bazohet në vëzhgimet në stacionet hidrometrike, ku regjistrohen nivelet e ujit dhe matjet e prurjeve, si dhe ndërtohet marrëdhënia e nivelit të prurjes. Sipas këtyre marrëdhënieve, prurjet ditore, mujore dhe vjetore llogariten për të gjithë periudhën me të dhënat hidrometrike që janë të disponueshme.

Në stacionin matës të rrjedhës më të poshtme të pellgut të lumit (Lumi Ishëm në Sukth) prurja mesatare vjetore (PMV) në periudhën 1992-2008 ishte 17.15 m^3/s (raportuar si 20.2 m^3/s në serinë e vjetër para viteve '90). Vlerësuar në të gjithë basenin (704/624 km^2), kjo jep një pellg ujëmbledhës Q_{50} të përafërt prej 15.9 m^3/s.

Në një studim për periudhën 1960-1992 janë paraqitur hidrografitë e prurjes për tre regjime ujore përfaqësuese (Tiranë, Zezë dhe Ishëm). Tërkuza është një nga degët kryesore të lumit Ishëm. Diga krijon një rezervuar prej 80 milion m3 ujë, me lartësi kreshtë 130 m. Kjo digë është ndërtuar gjatë viteve 1994-1997. Shërben furnizimin e Tiranës me ujë të pijshëm si dhe për qëllime bujqësore. Pas vitit 1998 shërben vetëm për furnizim me ujë të pijshëm.

Që nga viti 1990, ndryshime të rëndësishme kanë ndodhur brenda basenit të lumit Ishëm, si pasojë e rritjes së popullsisë nga 244,000 (1990) në 814,000 (2018, vlerësimi i UKT).

Tabela 1- Përmbledhje e statistikave kryesore për nënbasenet e Ishmit

ISHËM	Sipërfaqja (km^2)	P vjetore (mm)	Q_{50}	Q_{90}
ISH0	213	1279	4.21	1.56
ISH1	286	1351	4.99	1.84
ISH2	51.6	1749	1.08	0.41
ISH3	94.4	1795	3.28	2.02
ISH4	80.7	1578	3.21	2.16
Total	726	1441	16.77	7.99

Tabela 2- Pellgu i lumit Ishëm - Karakterizimi i trupave ujore – Kategoria LUM

LUMI EMRI	N/BASENI	KODI TRUPIT UJOR	LARTËSIA (m)	ZONA km^2	GJATËSIA km	GJERËSIA m	REGJIMI AKTUAL I			
							P10	**Q_{50}**	**Q_{90}**	**IPB**
Ishëm	ISH0	351413	<200	693	23.8	21	33.5	15.9	7.61	0.48
Zezë	ISH0	351421	<200	100	4.1	11	5.48	1.88	0.72	0.38
Zezë	ISH0	351422	<200	28	17.5	7	1.53	0.53	0.20	0.38
Zezë	ISH0	351423	<200	65.5	7.1	28	3.95	1.35	0.52	0.38
Zezë	ISH0	351425	<200	51.7	6.9	55	3.16	1.08	0.41	0.38
Zezë	ISH0	351427	>200<800	32.1	8.4	19	2.18	0.75	0.29	0.38
Ishëm	ISH0	35143	<200	474	6.7	22	28.0	14.0	6.89	0.49
Tërkuza	ISH1	351441	<200	176	13.3	28	7.67	4.82	3.07	0.64
Tërkuza	ISH1	351443	<200	129	13.8	60	6.85	3.89	2.54	0.65
	ISH3	351444	>200<800	15.2	3	66	1.14	0.76	0.49	0.64
	ISH3	351445	>200<800	40.7	7.4	88	2.99	1.99	1.28	0.64
Tiranë	ISH1	35145	<200	286	8.1	20	20.3	9.27	3.82	0.41
	ISH1	35146	<200	31.4	3.8	4	2.51	1.14	0.47	0.41
Tiranë	ISH1	35147	<200	211.5	7.6	34	17.8	8.13	3.35	0.41
Lana	ISH1	351481	<200	61.8	4.8	11	1.60	0,86	0.52	0.60
	ISH1	351482	<200	14.1	3.2	6	0.41	0.22	0.13	0.60
Lana	ISH1	351483	<200	41.5	4.2	10	1.19	0.64	0.39	0.60
Lana	ISH1	351485	<200	31.0	7.2	7	0,89	0.48	0.29	0.60
Lana	ISH1	351487	>200 <800	9.9	1.8	4	0.31	0.17	0.10	0.60
Tiranë	ISH1	351491	<200	127	10.1	35	6.22	4.70	3.16	0.67
Tiranë	ISH1	351493	<200	99.2	6.4	27	5.10	3.85	2.59	0.67
Tiranë	ISH4	351495	>200 <800	80.7	18.4	45	4.25	3.21	2.16	0.67

Tabela 3- Karakterizimi i trupave ujorë – Kategoria LIQENE

LIKENI EMRI	N/BASENI	KODI TRUPIT	LARTËSIA (m)	ZONA km^2	REGJIMI AKTUAL I PRURJES			
					P_{10}	**Q_{50}**	**Q_{90}**	**IPB**
Bovillë	ISH3	LW351401	317	4.068	4.35	3.28	2.32	0.71
Qyteti i	ISH1	LW351402	116	0,406	0.21	0.06	0.03	0.50
Çerkezës	ISH1	LW351403	94	0,590	0,63	0.18	0.09	0.50
Tapizës	ISH1	LW351404	46	0,651	1.323	0,378	0,189	0.50

1.3 Përmbledhje Bilanci ujor i pellgut ujëmbledhës të Ishëm

Përcaktimi i një ekuilibri të besueshëm të ujit të basenit ujor është një ushtrim teknikisht sfidues, që kërkon të dhëna të sakta, të përditësuara mbi prurjet, daljet dhe nivelet e konsumit të matur. Megjithatë, të kuptuarit e burimeve parësore të prurjes në pellg dhe se si uji konsumohet ose transferohet ndërmjet burimeve (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe në fund shkarkohet në dalje (deti ose pellgu ndërkufitar në rrjedhën e poshtme), është thelbësor për të kuptuar saktë hidrodinamikën e basenit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit. Një vlerësim i plotë dhe i detajuar i ofertës dhe kërkesës për burime ujore është objekt i raportit më teknik, i cili aktualisht nuk përfshihet në PMBU. Bilanci standard i ujit të basenit ujor, i sapo aplikuar në Shqipëri, promovon një kuptim të dobishëm të disa çështjeve kryesore.

Ndërlidhja midis ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore.

Edhe pse shpesh menaxhohen dhe raportohen veçmas, ato janë të lidhura ngushtë. Vëllimi i rimbushjes së ujërave nëntokësore, në veçanti, është një vlerë kritike për ekosistemet ujore dhe licencimin e nxjerrjes së ujit shpesh keqraportohet në vlerësimet e MIBU.
Humbjet natyrore (avullimi, transpirimi dhe daljet ndërkufitare të ujërave nëntokësore) duhet të zbriten nga prurjet totale natyrore (reshjet, prurjet ndërkufitare të ujërave sipërfaqësore dhe hyrjet e ujërave nëntokësore) për të arritur në Burimin Vjetor të Rinovueshëm (BVR).
Nëse BVR i ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore (ose të dyjave) tejkalohet vazhdimisht përmes nxjerrjes dhe konsumit të tepërt, kjo është një situatë e paqëndrueshëm për baenin ujor dhe rezultat do të jetë reduktimi i prurjeve të lumenjve dhe/ose niveleve të ujërave nëntokësore. Në të dyja rastet, objektivat mjedisore të pellgut të lumit do të ndikohen.

Sektorë të veçantë ekonomikë duhet të vlerësohen gjerësisht për të identifikuar se cilët sektorë janë përgjegjës për nivelet më të larta të konsumit. Pa ndryshim ky është sektori i bujqësisë, për shkak të niveleve të larta të transpirimit të kulturave të ujitura intensivisht dhe praktikave joefikase të ujitjes, por edhe uji komunal është gjithashtu shpesh përgjegjës për 'humbjet' e konsiderueshme të ujërave sipërfaqësore në ujërat nëntokësore dhe anasjelltas. Skemat e hidrocentraleve mund të devijojnë sasi të mëdha uji midis nënbaseneve. Këto transferime ujore mund të jenë shumë të dëmshme për objektivat mjedisore pa zbutjen e duhur.

Është një objektiv themelor i menaxhimit të shëndoshë të burimeve ujore për të përcaktuar dhe kontrolluar “indekset kryesore të shfrytëzimit të ujit” për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore për të mbrojtur kërkesat e rrjedhës mjedisore dhe për të siguruar sasi afatgjata për përdorime ekonomike.

Kur të gjitha të dhënat nuk janë të disponueshme, mund të aplikohet një përdorim i thjeshtë i BU. Ligji i bilancit të ujit thotë se hyrjet në çdo sistem ose zonë ujore janë të barabarta me daljet e tij, duke shtuar ndryshimin e depozitimit gjatë një intervali kohor. Nëhidrologjia, një ekuacion i bilancit të ujit mund të përdoret për të përshkruar rrjedhën e ujit brenda dhe jashtë një sistemi. Një sistem mund të jetë një nga disa fusha hidrologjike ose ujore, të tilla si një kolonë dheu, pellgu kullues, një zonë vaditëse ose një qytet. Bilanci i ujit mund t'i referohet gjithashtu mënyrës se si një organizëm e mban ujin në kushte të thata ose të nxehta.
Ekuacioni i përgjithshëm i bilancit të ujit është:

$$P = R + ET + \Delta S$$

P është reshje
R është shpejtësia e rrjedhës
ET është evapotranspirim
ΔS është ndryshimi në ruajtje (ose çdo humbje tjetër nga sistemi)

Ky ekuacion përdor parimet e ruajtjes së masës në një sistem të mbyllur, ku çdo ujë që hyn në sistem (nëpërmjet reshjeve), duhet të transferohet ose në avullim, transpirim, rrjedhje sipërfaqësore (përfundimisht arrin në kanal dhe largohet në formën e shkarkimit të lumit), ose të ruajtura në tokë. Ky ekuacion kërkon që sistemi të jetë i mbyllur dhe aty ku nuk është (për shembull kur rrjedhjet sipërfaqësore kontribuojnë në një pellg tjetër), kjo duhet të merret parasysh.

1.4 Rrjeti hidrometeorologjik në Shqipëri

Platforma që menaxhon stacionin automatik është Winnet. Ky sistem ka disa komponentë për cilësinë e të dhënave për të dhënat automatike të rreshtit të stacionit. Rrjeti aktual i vëzhgimit plotëson kërkesat e këtij standardi. Këto kërkesa kanë të bëjnë me saktësinë e sensorëve, kushtet e vendndodhjes së stacionit dhe gjendjen e pozicionit të sensorit nga toka ose të paprekur nga bimësia, etj. Disa nga parametrat e matur nga rrjeti meteorologjik janë (Akumulimi i shiut, bora - niveli, rrezatimi, presioni, era, lagështia dhe temperatura).

Tabela 4- Stacione meteorologjike automatike

Rrjeti i sensorëve	Numri i stacioneve	Rezoluta hapësinore/kohore	Lloji i matjes
Shiu	46	NA / 2 orë	Monitorimi – në kohë reale
Niveli i borës	8	NA / 2 orë	Monitorimi – në kohë reale
Rrezatimi	20	NA / 2 orë	Monitorimi – në kohë reale
Presioni	30	NA / 2 orë	Monitorimi – në kohë reale
Era	25	NA / 2 orë	Monitorimi – në kohë reale
Lagështia	30	NA / 2 orë	Monitorimi – në kohë reale
Temperatura	30	NA / 2 orë	Monitorimi – në kohë reale

Tradicionalisht, shkarkimi i lumit në Shqipëri matet me metodën e shpejtësive të rrjedhës, duke përdorur matësat aktualë. Së fundmi janë prokuruar dy pajisje ADCP dhe stafi është trajnuar për përdorimin e teknologjisë së re. Nga matjet, një kurbë vlerësimi që lidh shkarkimin me nivelin e ujit në matës krijohet dhe përditësohet nëse ndodhin disa ndryshime në seksionin kryq ose profilin e lumit. Rekomandimet nga “Winnet” janë që një stacion duhet të ketë 6 deri në 8 matje shkarkimi në vit për të përditësuar kurbën e vlerësimit. Kurba e vlerësimit konsiderohet e vlefshme për gamën e shkarkimeve që janë matur; e më pas ekstrapolohet për prurje më të larta me formulën “Chezy”.

Tabela 5- Stacione hidrologjike automatike


Lloji i stacionit	Numri i stacioneve
Vëzhgimet hidrologjike (manual)	105

Stacione hidrologjike automatike	20
Stacionet e vëzhgimit bregdetar (të automatizuara)	4

Figura 1- Harta e rrjetit hidrologjik manual



Figura 2- Harta e rrjetit hidrologjik automatik



1.5 Ndërhyrja e nevojshme në programin e masave

Në këtë investigim, sipas standardeve minimale për një rrjet monitorimi të ujërave sipërfaqësore dhe gjendjes aktuale të rrjetit, janë dhënë disa kërkesa teknike, si dhe disa vendndodhje për rrjetin hidrometeorologjik, i cili përfshin rreth 42 stacione (22 hidrologjike dhe 20 meteorologjike). Nëse rrjeti aktual i automatizuar vazhdon të funksionojë normalisht, vendosja e këtyre stacioneve do të sigurojë mbulim të përshtatshëm për të përmbushur standardet DKU-së.

Tabela 6- Specifikimi i stacioneve hidrologjike

Përshkrimi i artikullit	Gama e vëzhgimit	Saktësia e vëzhgimit	Rezolucioni	Lartësia e sensorit	Të tjera
Niveli i ujit (sensori i nivelit të ujit të radarit)	0 - 20 m	2 cm	min 1 cm		
Sasia e reshjeve (matësi i shiut)	Si meteorologjike	Si meteorologjike	Si meteorologjike	Si meteorologjike	Si sensor meteorologjik
Regjister					Si sensor meteorologjik
Bateria					Si sensor meteorologjik
Panel diellor					Si sensor meteorologjik
Matës i nivelit të stafit					Matësit e nivelit të stafit për të treguar nivelin e ujit në një vend në nivelin e duhur për çdo vend. Matësit e personelit do të furnizohen në gjatësi 1.0 metër (aq sa nevojitet në varësi të vendndodhjes), të shënuara në përputhje me rrethanat.

Tabela 7- Përmirësimi i stacioneve hidrologjike

Nr.	lumi	Stacioni	Vendndodhja	
1	Kiri Prekal	Shkoder	42 08 03.9	19 35 23.7
2	Perroi Vermoshit	Vermosh Tamare	42 34 59.5	19 44 49.2
3	Valbona B. Curri	B. Curri	42 19 40.2	20 04 49.5
4	Fani I vogel Nderfan	Nderfan, Rrëshen	41 47 08.3	19 53 31.8
5	Mati Klos	Klos Fshat Burrel	41 29 21.8	20 05 42.1
6	Mati Shoshaj	Shoshaj Burrel	41 36 27.1	20 01 42.5
7	Mati Milot	Ura e Zogut-Mat, Milot	41 41 57.2	19 43 33.6
8	Fani i Bash Vau Shkjeze	Vau Shkjeze- Miridte	41 47 10.3	19 49 00.8
9	Letra Shkumbini	Letër - Elbasan	41 02 59.4	19 57 23.6
10	Shkumbini Librazhd	Restorant Moglica-LB.	41 10 38.9	20 18 53.9
11	Shkumbini Rogozhine	Cerma Sip Terbuf LU	41 03 45.9	19 38 43.6
12	Devolli Lozhan	Lozhan Korçe	40 44 07.5	20 34 10.3
13	Vjosa Çarshovë	Çarshove - Përmet	40 06 46.3	20 32 22.8
14	Vjosa Poçem	Pocem	40 29 36.0	19 43 40.5
15	Vjosa Memaliaj	Memaliaj	40 21 06.8	19 58 22.0
16	Erzeni Ibë	Ibe Tirane	41 14 08.1	19 55 18.1

17	Gjolja Ura Gjoles	Ura Gjolja Fush Krujë	41 28 02.5	19 41 30.0
18	Ishmi Sukth Vendas	Sukth Vendas Mamuras	41 31 32.5	19 37 06.2
19	Osumi Berat	Beratit	40 42 15	19 56 59
20	Osumi Ura Vajgurore	Ura Vajgurore BR.	40 46 19.8	19 52 36.2
21	Seman Ura Kuçit	Ura Kuçit - BERAT	40 50 41	19 48 17
22	Shushica Vodice	Vodice Shushice Vlore	40 24 58.8	19 34 57.3

Tabela 8- Përmirësimi i stacioneve meteorologjike

Përshkrimi i artikullit	Gama e matjes	Pasiguria e sensorit	Rezoluta e raportimit	Lartësia e sensorit	Të tjera
Sensori i shpejtësisë dhe drejtimit të erës (anemometër tejzanor)	Shpejtësia e erës: 0 - 60 m/s Drejtimi i erës: 0° - 360°	Shpejtësia e erës: 0,5 m/s për WS 5 m/s Drejtimi i erës: 5°	Shpejtësia e erës: min 0,5 m/s Drejtimi i erës: min 1°	10 m	- Pragu (vlera e parë): 0,5 m/s - Sensorët duhet të kenë një klasë mbrojtjeje IP65. - Sensori duhet të instalohet në direk paraekzistues ose të ri (nëse tregohet kështu në seksionin për punimet civile)
Temperatura e ajrit	-30°C - +60°C	0,2°C	min 0,1°C	1,25 - 2 m	- Matja e temperaturës së ajrit duhet të përdorë ose një termometër rezistence ose teknologji termoelement. - Sensori duhet të instalohet në një mburojë të ajrosur siç duhet. Mburoja e përdorur duhet të jetë prej një substance që ndikohet minimalisht nga rrezet e diellit dhe duhet të jetë brenda kufijve të përdorimit të WMO. Kontraktuesi do të sigurojë një katalog teknik për mburojën e ofruar. - Mund të ofrohet një sensor i kombinuar i temperaturës dhe lagështisë.
Lagështia relative e ajrit	0 - 100 %	3 %	min 1 %	1,25 - 2 m	- Sensori duhet të instalohet në një mburojë të ajrosur siç duhet. Mburoja e përdorur duhet të jetë prej një substance që ndikohet minimalisht nga rrezet e diellit dhe duhet të jetë brenda kufijve të përdorimit të WMO. Kontraktuesi do të sigurojë një katalog teknik për mburojën e ofruar. - Mund të ofrohet një sensor i kombinuar i temperaturës dhe lagështisë.
Presioni atmosferik	500- 1060 hPa	0,1 hPa	min 0,1 hPa	-	
Sasia e reshjeve (matësi i shiut)	0-500 mm/ditë	1 mm	min 0,1 mm	1 m	- Sensori i matësit të shiut mund të përdorë teknologjinë e bazuar në peshë për të matur sasinë dhe intensitetin e shiut, borës dhe breshërit ose teknologjinë e kovës së kthesës
Rrezatim diellor	0 – 2000 W·m-2, 0-24 orë (kohëzgjatja e diellit)	0,1 W·m-2	1 min gjithsej [0,9%]/1 orë totale, [0,7%]/gjithsej ditore [0,5%]	1.5 m	
Temperatura e tokës	-50 - +50 °C	0,1 °C	0,2 °C		
Lagështia e tokës	0,0001-0,55 m3/m3	0,001 m3/m3	5%		
Avullimi	1 - 100 mm	0.1 mm	0.1 mm		
Niveli i borës (sensori tejzanor i nivelit të borës)	0 - 10 m	1 cm	min 1 cm	Deri në 3 m	

